



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

**Kundrinat, rendi i tyre në fjali.
Studim përqasës mes gjuhës gjermane dhe asaj shqipe.**

*Punim për gradën shkencore „Doktor“ në Gjuhësi
Specialiteti: Sintaksë*

Punoi:
M. A. Evi Blushi

Udhëheqës shkencor:
Prof. Dr. Brikena Kadzadej

Tiranë 2019



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

**Kundrrinat, rendi i tyre në fjali.
Studim përqasës mes gjuhës gjermane dhe asaj shqipe.**

*Punim për gradën shkencore „Doktor“ në Gjuhësi
Specialiteti: Sintaksë*

KOMISIONI I MBROJTJES

- | | | |
|---------------------|--------------------------|-----------------|
| 1. Prof. Dr. | Viktor Ristani | Kryetar |
| 2. Prof. Dr. | Gjovalin Shkurtaj | Oponent |
| 3. Prof. Dr. | Shpresa Delija | Oponente |
| 4. Prof. Dr. | Aljula Jubani | Anëtare |
| 5. Prof. Dr. | Arben Skëndaj | Anëtar |

Tiranë 2019

MIRËNJOHJE

Do të doja të falënderoja dhe të shprehja mirënjohjen time ndaj të gjithë atyre që më ndihmuan dhe inkurajuan në realizimin e këtij punimi:

Së pari udhëheqësen e këtij studimi Prof. Dr. Brikena Kadzadej për mbështetjen dhe nxitjen e saj të vazhdueshme, orientimin plot dashamirësi drejt literaturës dhe materialeve ndihmëse, udhëzimet e vlefshme, si dhe rishikimin e palodhur gjatë gjithë rrugëtimit për realizimin e këtij punimi.

Së dyti Këshillin e Profesorëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës dhe Departamentin e Gjuhës Gjermane të UT që më dhanë mundësinë të rritem profesionalisht duke realizuar këtë punim.

Falënderoj gjithashtu profesorin e nderuar akademik Prof. Dr. Remzi Përnaska, për ndihmën e pakursyer për probleme të ndryshme që lidheshin me çështje të trajtuara në disertacion.

Kolegët e departamentit të gjermanishtes për mbështetjen e tyre morale, nxitjen dhe diskutimet e gjata e të frytshme lidhur me çështje të ndryshme gjuhësore si dhe çështje teknike lidhur me këtë temë punimi.

Thellësisht nga zemra falënderoj familjen time, për durimin, mirëkuptimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që më kanë dhënë për të realizuar këtë punim.

SHKURTIME

BShUSh = Buletin shkencor i Universitetit të Shkodrës

E = Ergänzung

GjJ = Gjuha jonë (Tiranë)

KGj = Kultura e gjuhës (Prishtinë)

NP = sintagmë emërore

O1 = kundrinë e drejtë

O2 = kundrinë e zhdrejtë pa parafjalë

Op = kundrinë e zhdrejtë me parafjalë

P = kallëzuesi

PE = Përbërësi emëror

PF = Përbërësi foljor

S = kryefjala

Sfil = Studime filologjike (Tiranë)

Sal = Studime albanologjike (Tiranë)

Sh.k.d. = Shenjuesi i kundrinës së drejtë

Sh.k.zh. = Shenjuesi i kundrinës së zhdrejtë

VP = sintagmë foljore

HYRJE

Përligjja e punimit

Një nga aftësitë dalluese kryesore të njeriut është aftësia e tij për të komunikuar me anë të gjuhës. Ajo është shtylla kryesore ku mbështetet i gjithë aktiviteti i tij mendor dhe përbën kështu mjetin kryesor të komunikimit për të.

Ndërsa për studiuesit e gjuhës, ajo mishëron aftësinë për të folur dhe kuptuar një gjuhë të caktuar, e megjithatë ajo mbetet një nga fenomenet më të komplikuar që njeriu është përpjekur të kuptojë.

Mund të thuhet se ende nuk është arritur të zbulohet plotësisht mënyra se si është strukturuar dhe funksionon gjuha brenda trupit të njeriut, megjithëse kemi mjaft përshkrime shteruese që i janë bërë gjuhëve të ndryshme si dhe plot krahasime, ku janë evidentuar dallimet dhe të veçantat mes tyre. Madje, në shumë raste, megjithëse kanë qenë studime që qëndrojnë në kufijtë e disiplinës gjuhësore apo që mundohen t'i zgjerojnë këta kufij, vërehet se kanë shërbyer thjesht për të nxjerrë në pah ndërlikimin, dinamikën dhe vështirësitë që hasen për ti përshkruar në mënyrë shteruese dhe sistematike ato.

Struktura gjuhësore karakterizohet nga rregullsia e fakteve të një gjuhe, ekzistenca e klasave, përparësia e tërësisë mbi njësinë e së fundi, dallimet dhe ngjashmëritë e strukturës së një gjuhe në dallim nga tjetra. Ngjashmëritë dhe dallimet mes gjuhëve përbëjnë shpesh objekt studimi në gjuhësinë e sotme. Mund të thuhet se të gjitha teoritë gjuhësore e pranojnë ekzistencën e tyre, por ajo çka i dallon është vënia e theksit mbi tiparet e përbashkëta apo dalluese të tyre. Kështu kemi dhe lindjen e dy tezave asaj të arbitraritetit, i cili është një koncept që ka si parim bazë pikënisjen nga dallimet dhe pikëmbërritjen tek ngjashmëritë, si dhe tezën apo konceptin e kundërt, atë të universaleve, i cili si pikënisje merr ngjashmëritë për të arritur tek dallimet.

Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit gjuhësor është parë si detyrë nga shumë gjuhëtarë të shekullit XX në mbarë botën. Në këtë kuadër kemi dhe lindjen e shkollave të ndryshme gjuhësore, të cilat përveç dallimeve e këndvështrimeve të ndryshme kanë dhe plot pikëtakime. Gjithsesi vetë krahasimi i këtyre teorive përbën mjaft vështirësi kryesisht për shkak të larmisë terminologjike, e cila fsheh ngjashmëritë ndërmjet koncepteve të shfaqura, por mund të themi dhe se nga ana tjetër, të qenët në një mendje nuk përkon gjithmonë edhe me vendin dhe vlerat që u jepen çështjeve të përbashkëta, pasi dhe pse e njëjta ide mund të mbrohet nga shkolla të ndryshme, theksi vihet mbi njërin ose tjetrin aspekt të dukurive gjuhësore.

Gjithashtu dhe përsa i përket përvetësimit të sintaksës vërehet se ajo mbetet një çështje e shumëdebatueshme si në disiplinën e gjuhësisë teorike, edhe në atë të gjuhësisë së aplikuar. Debatet mes studiuesve të gjuhës lidhen kryesisht me teoritë gjuhësore të cilat studiojnë zhvillimin dhe përvetësimin e gjuhës.

Fjalitë, në të dyja gjuhët, si atë gjermane dhe shqipe, përveç dy gjymtyrëve kryesore, kryefjalës e kallëzuesit, në të shumtën e rasteve kanë dhe gjymtyrë të tjera, të cilat plotësojnë gjymtyrët kryesore, i përcaktojnë më tej ato, lidhen me to nga ana kuptimore e strukturore. Vlen të theksohet se emërtimet “gjymtyrë kryesore” e “gjymtyrë të dyta” i kanë kryesisht për rolin që ato luajnë në organizimin e fjalisë, jo gjithnjë për peshën që kanë në kuptimin e dhënë. Vështrimet krahasuese të kategorive të ndryshme sintaksore, siç janë gjymtyrët e fjalisë ku bën pjesë dhe kundrina kanë qenë dhe mbeten objekt interesi të vazhdueshëm studimor. Mendova të sjell një këndvështrim të ri, shpresoj interesant, në lidhje me kundrinat dhe rendin apo topikën e tyre në fjali, në kuadër të gjuhësisë krahasuese mes dy gjuhëve, konkretisht asaj gjermane dhe shqipe. Një nga arsytet që më shtyu drejt kësaj teme është edhe fakti se gjuhë të tilla si ajo gjermane dhe shqipe, në dukje shumë larg njëra-tjetrës, meqenëse i përkasin degëve të ndryshme në familjen e madhe Indo-Evropiane të gjuhëve, në rrafshin sintaksor, dëshmojnë se ndajnë shumë karakteristika të përbashkëta, ashtu si dhe mjaft dallime mes tyre.

Punimi në fjalë përqëndrohet në trajtimin përqasës të kundrinave, duke marrë parasysh modelin tradicional të trajtimit të tyre në gjuhën gjermane, krahasuar me ato të gjuhës shqipe. Nëpërmjet përqasjes synohet gjetja e të përbashkëtave, ngjashmërive dhe ndryshimeve në të dyja gjuhët. Kam menduar të bëj një analizë të tillë nisur nga fakti se trajtimi tradicional i gramatikës haset kryesisht në trajtimin didaktik të tyre në institucionet shkollore, veçanërisht të ciklit të ulët e të mesëm, por shpeshherë dhe të lartë, sidomos në Shqipëri, duke e bërë kështu temën më të kuptueshme për lexuesit.

Arsyeja kryesore e përzgjedhjes së kësaj teme është interesi i madh që zgjon ajo duke qenë se prek një aspekt mjaft të rëndësishëm gramatikor. Një arsye tjetër është dhe fakti se kjo temë duke marrë parasysh aspektin e saj përqasës gjermanisht shqip, është shumë pak e studiuar. Deri më sot ka pasur vetëm disa punime sporadike, ku nuk është bërë një trajtim i mirëfilltë i temës në fjalë.

Një analizë e thelluar përqasëse e këtij lloji për kundrinën mendoj se është e rëndësishme edhe në aspektin didaktik, pasi përfundimet e analizës përcaktojnë qartë aspektet gramatikore që paraqesin vështirësi për nxënësit shqiptarë që mësojnë gjuhën gjermane. Punimi synon t'i ndërrojë mesimdhënësit dhe nxënësit se njohja e mirë e gjymtyrëve të fjalisë, konkretisht kundrinës në të dyja gjuhët, veçorive karakteristike dhe të përbashkëtave të tyre çon në të mësuarit më efektiv të gjuhës gjermane dhe përdorimin e saktë të saj. Pra, është e nevojshme ndërthurja e elementeve teorikë të studimit të kundrinës në gjuhën gjermane dhe shqipe me përdorimin e tyre praktik.

Objekti dhe hipotezat e punimit

Hulumtimi dhe krahasimi i funksioneve të kundrinës dhe rendit të saj në fjali në shqipen standarte si dhe ai në gjuhën gjermane përbën një objekt studimi tërheqës dhe sfidues në të njëjtën kohë. Gjuhëtarë të ndryshëm të të dyja gjuhëve kanë shkruar rreth kësaj kategorie sintaksore, duke e parë në këndvështrime të ndryshme, me koncepte teorike

nganjëherë të njëjta e nganjëherë krejtësisht të ndryshme e madje duke përdorur dhe terminologji mjaft të ndryshme.

Ky punim synon që, brenda caqeve të lejueshme për një studim të tillë, duke i pranëvënë dhe krahasuar kundrinat dhe rendin e tyre në fjali në të dyja gjuhët, të nxjerrë në pah dallimet dhe ngjashmëritë mes tyre. Gjithashtu synohet të bëhet një paraqitje sa më e plotë e kundrinës dhe rendit të saj në fjali në gjuhën gjermane dhe atë shqipe.

Kjo analizë, ndër të paktat e këtij lloji në gjuhësinë shqipe, mbështetet në teorinë tradicionale, por pa anashkaluar dhe teorinë më të reja gjuhësore. Ajo shkon përtej përshkrimit tradicional të kundrinave si dukuri gjuhësore, duke u përpjekur të sjellë një tablo krahasuese të parë nga këndvështrime të ndryshme, pasi synon të merret dhe me zanafillën e kundrinës në të dyja gjuhët dhe evoluimin e saj deri në ditët tona, duke u bazuar në modele të ndryshme gramatikore. Një analizë e tillë mendoj se kontribuon realisht në evidentimin e problematikës dhe zbulimin e rrugëve më efektive në mësimdhënien e gjuhës gjermane dhe asaj shqipe.

Në këtë punim është përfshirë edhe rendi i kundrinave në fjali, nisur nga fakti se ai luan një rol mjaft të rëndësishëm veçanërisht në ndërtimin e fjalive dëftore, si një nga mjetet më të rëndësishme të formësimit të fjalisë si në gramatikën tradicionale, ashtu dhe në atë bashkëkohore në të dyja gjuhët.

Një tjetër qëllim i rëndësishëm i punimit është të ndërjegjësojë të gjithë përdoruesit e gjuhës për rëndësinë që ka përvetësimi i saktë i strukturave gramatikore të gjuhës, në mënyrë që të realizohet zotërimi sa më i mirë i saj, duke krahasuar e nxjerrë në pah të përbashkëtat e dallimet mes dy gjuhëve, si dhe duke bërë një analizë kritike-krahasuese të trajtimit të sintaksës, konkretisht kundrinës në teori të ndryshme gramatikore.

Shpresoj, që të interesuarit në fushën e gjuhësisë që do të dëshirojnë ta lexojnë këtë punim, të gjejnë tek ai një ndihmesë, sado modeste, në lidhje me këndvështrimin krahasues të kundrinave në gjuhën gjermane dhe atë shqipe, bazuar kryesisht në teorinë tradicionale të sintaksës, por duke marrë parasysh dhe arritjet e fundit bashkëkohore në këtë fushë. Duke qenë një nga përpjekjet e pakta në këtë lëmë deri më tani, studimi nuk mund të jetë kurrësesi shterues. Në të analizohen llojet e kundrinave në të dyja gjuhët duke bërë krahasimin mes tyre. Ndërsa përsa i përket rendit të tyre në fjali kam zgjedhur ta trajtoj vetëm tek fjalitë e thjeshta dëftore, duke qenë se po të trajtohej në të gjitha llojet e fjalive do të nevojitej një studim më vete. Në përfundim mund të thuhet se kjo tematikë është mjaft e gjerë. Për këtë arsye, mendoj se do mbetet objekt i punimeve të tjera krahasuese në të ardhmen, analiza më e detajuar e aspekteve të veçanta, që kanë lidhje me problematikën e kundrinave dhe rendin e tyre në fjali në këto dy gjuhë.

Metodologjia dhe struktura e punimit

Punimi është një përpjekje për të analizuar e krahasuar kundrinat dhe rendin e tyre në fjali në gjuhën gjermane dhe atë shqipe. Pra, është zbatuar metoda hulumtuese, deskriptive e përjasëse-krahasuese. Megjithëse nuk janë shpërfillur e as mohuar qasje

të tjera gjuhësore, jam bazuar kryesisht në qasjen tradicionale. Kjo zgjedhje, siç e kam shprehur dhe më sipër, është bërë kryesisht për arsye se trajtimi tradicional i gramatikës haset kryesisht në trajtimin didaktik të tyre në institucionet shkollore, veçanërisht të ciklit të ulët e të mesëm, por shpeshherë dhe të lartë, sidomos në Shqipëri, duke e bërë kështu temën më të kuptueshme për lexuesit. Megjithëse vërehet se në gjuhën gjermane ka një përdorim të gjerë teoria gjuhësore e valencës dhe dependencës, e cila ka në fokus foljen, si dhe gjuhësia gjenerative, e cila ofron një qasje bashkëkohore të integruar ndaj dukurive bazë gjuhësore, ku vërehet se veçanërisht gjatë dy dekadave të fundit qasja gjenerative ka pasur një ndikim të gjerë aplikativ në shumë aspekte të dukurive gjuhësore. Vlen të theksohet se gjuha gjermane është një gjuhë e eksploruar më gjerësisht dhe më thellësisht krahasuar me gjuhën shqipe. Kundrinat dhe rendi i tyre në fjali janë studiuar nga pikëpamja ndërtimore dhe funksionale.

Materiali teorik që kam shfrytëzuar për këtë punim është kryesisht dygjuhësh. Në gjuhën gjermane mund të përmendim gramatika e botime të tjera të gjuhëtarëve e sintaksologëve të njohur gjermanë, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh në këtë lëmë, si: Beker, Vajsgerber, Pitner, Eroms, Henshel, Veid, Ramers, Busha, Helbig, Bynting, Engel, Grisbach, Shulc, Ajzenberg, Dyrshajd e mjaft të tjerë. Gjithashtu është shfrytëzuar dhe literaturë në të dyja gjuhët e marrë nga interneti. Përkthimi i citimeve është bërë nga vetë autorja e punimit.

Natyrisht kam shfrytëzuar dhe literaturë shqipe, duke filluar nga sintaksat e para të sintaksologëve shqiptarë nga të gjitha trevat, të cilët kanë lënë gjurmë përsa i përket gjuhësisë shqipe, të Xhuvanit, Sheperit, Rrotës, Domit, Cipos, Çabejt, Floqit, etj. e deri tek ato më bashkëkohoret me autorë Përnaska, Beci, Bokshi, Çeliku, Koleci, Turano, Memushaj, Totoni, Agalliu etj.. Gjithashtu kam shfrytëzuar dhe çdo punim që më ka rënë në dorë, i cili lidhej drejtëpërdrejtë apo tërthorazi me temën e punimit. Përsa i përket materialit faktik, i cilin është përdorur për ilustrimin e pjesës teorike, shembujt janë marrë nga letërsia e shkruar, libra gramatike, gazeta e revista të ndryshme si dhe një pjesë janë krijuar nga autorja e punimit dhe janë pasqyruar në bibliografinë në fund të punimit.

Nëpërmjet shembujve të larmishëm nga të dyja gjuhët janë krahasuar si dhe nxjerrë në pah dallimet dhe ngjashmëritë mes kundrinave dhe rendit të tyre në fjali në gjuhën gjermane dhe atë shqipe. Edhe pse shkenca e gjuhësisë si çdo shkencë tjetër bazohet tek përshkrimi i fenomeneve, në këtë rast gjuhësore, theksoj se krahasimi nuk është vetëm përshkrues, por edhe shpjegues, duke u përpjekur të hyjë në brendësi të fenomeneve gjuhësore në këto dy gjuhë e duke hedhur dritë, nga njëra anë, mbi parimet bazë gramatikore të përbashkëta për të dyja gjuhët, e nga ana tjetër, mbi të veçantat e specifikat e secilës prej tyre, pra duke u përpjekur të lidhim ura mes gjuhëve. Në fund, janë dhënë disa përfundime shpresoj të vlefshme teorike e praktike që mund të japin një ndihmesë në punën e mëtejshme kërkimore e didaktike.

Punimi i dizertacionit është konceptuar në nëntë krerë. Të nëntë krerët ndahen në vetvete përkatësisht në tri pjesë, ku në të parën trajtohet kundrina në të dyja gjuhët parë

në aspektin historik-krahasues, duke nisur nga fillimet e sintaksës e deri në ditët e sotme, në këndvështrimin e teorive të ndryshme gramatikore, të hartuara ndër vite. Në pjesën e dytë do të trajtohet në mënyrë mjaft të detajuar, kundrina në të dyja gjuhët, parë në këndvështrimin e gramatikës tradicionale. Ndërsa në pjesën e tretë të punimit do të trajtohet rendi i kundrinës në fjali në të dyja gjuhët. Duke bërë trajtimin e të njëjtit fenomen në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe, synohet ndërtimi i një të tërë që shpresoj të jetë ajo çka ky punim synon të mbërrijë.

Gjatë zhvillimit të shkencave të gjuhësisë në shekujt e fundit, kanë lindur shumë teori gramatikore të cilat kërkojnë që në mënyra të ndryshme të ndërtojnë një skemë për kompleksitetin e ndërtimit të një gjuhe. Për këtë arsye kundrina paraqitet në modele të ndryshme gramatikore dhe në mënyra të ndryshme. Në pjesën e parë të punimit, në kreun e parë të tij, pasi bëhet një lloj hyrje, do merrem me trajtimin e një vëzhgimi historiko- kritik të kundrinës në sintaksën e gjuhës gjermane, duke filluar me trajtimin e perceptimeve të koncepteve nga Aristoteli, më pas për të vijuar me gramatikat e para gjermane, ku trajtohet sintaksa e deri në ditët e sotme, duke e ndarë në katër periudha: gramatika tradicionale, më pas gramatika me orientim nga përmbajtja, do vazhdojë me trajtimin e kundrinës në gramatikën e valencës dependencës dhe në fund me trajtimin e saj në gramatikën gjenerative. Ndërsa në kreun e dytë, do bëhet një vëzhgim historiko- kritik i kundrinës në gramatikën e gjuhës shqipe, duke nisur nga gramatika e parë e Frashërit e duke vijuar më tej me gramatika të tjera në renditje kronologjike deri në ditët e sotme, duke e ndarë në tri periudha: gramatika tradicionale, më tej vijon gramatika e valencës dependencës dhe së fundi gramatika gjenerative. Në kreun e tretë të pjesës së parë të punimit do bëhet përqasja mes dy gjuhëve, duke bërë krahasimin e trajtimit të kundrinës në teoritë e ndryshme gramatikore të paraqitura në të dy krerët paraardhës, duke nxjerrë në pah të përbashkëtat e ndryshimet mes tyre. Gjithashtu do të trajtohet pikënisja dhe evoluimi i termit kundrinë, dhe do të vijohet me një vështrim të hollësishëm të trajtimit të tij në të gjithë gramatikat më të rëndësishmë e të njohura shqiptare dhe gjermane duke nxjerrë dhe dallimet si dhe të përbashkëtat mes tyre. Në këtë mënyrë i jepet dhe përgjigje pyetjes se si ka evoluar trajtimi i kundrinës, duke filluar me gramatikat e para e deri në ditët e sotme në të dyja gjuhët. Në këtë kre do të paraqitet gjithashtu dhe metoda teorike që do të zbatohet në këtë punim.

Në pjesën e dytë do të jepet një vështrim mbi kundrinën dhe llojet e saj në të dyja gjuhët në këndvështrimin e gramatikës tradicionale. Ashtu si e para dhe kjo pjesë e dytë e punimit do të ndahet në tri krerë. Në kreun e katërt do të trajtohen katër llojet e kundrinave në gjuhën gjermane, përkatësisht kundrina e rasës kallëzore, kundrina e rasës dhanore, kundrina me parafjalë dhe kundrina e rasës gjinore. Kjo e fundit është një kundrinë që nuk ekziston në gjuhën shqipe. Ndërsa në kreun e pestë do të trajtohen tri llojet e kundrinave në gjuhën shqipe, përkatësisht kundrinën e drejtë, kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinën e zhdrejtë me parafjalë. Një vend të veçantë në këtë kre do të zërë dhe trajtimi i shenjimit të kundrinës me trajtë të shkurtër, duke qenë se është një fenomen gjuhësor mjaft i rrallë, i cili nuk ekziston në gjuhën gjermane, duke përbërë kështu dhe një dallim thelbësor mes dy gjuhëve. Në kreun e gjashtë do të

trajtohen dallimet dhe të përbashkëtat përse i përket llojit të kundrinave në të dyja gjuhët, duke bërë të mundur krahasimin dhe evidentimin e pikave të takimit e ndarjes dhe me anën e shembujve konkretë.

Në pjesën e tretë do të trajtoj rendin e kundrinës në fjalinë dëftore në gjuhën gjermane dhe atë shqipe. Në kreun e shtatë do të trajtohet rendi i gjymtyrëve në gjuhën gjermane. Gjuha gjermane dallon rrënjësisht nga gjuhët e tjera përse i përket mënyrës së ndërtimit të fjalisë dhe rendit të gjymtyrëve në fjali. Kështu karakteristike për gjuhën gjermane është ndarja në dy pjesë e kallëzuesit, dhe përfshirja e të gjitha gjymtyrëve të tjera të fjalisë ndërmjet pjesës së parë (P1) dhe pjesës së dytë (P2) apo pjesët e tjera (Pn) të kallëzuesit. Këto pjesë të kallëzuesit përbëjnë dhe skeletin e fjalisë gjermane. Me pozicionet e tyre të përcaktuara P1, P2, ato formojnë tri fusha karakteristike për gjuhën gjermane në të cilat gjejnë vend gjymtyrët e fjalisë (Vorfeld, Mittelfeld, Nachfeld/ fillimi, mesi dhe fundi i fjalisë). Kjo ndarje e kallëzuesit dhe përcaktimi i rendit të tij quhet ndryshe dhe korniza e fjalisë apo kllapat që ngërthejnë fjalinë (Satzrahmen/ Satzklammer) dhe përbën një karakteristikë dalluese të kësaj gjuhe. Në këtë kre do të përqendrohem veçanërisht tek rendi i kundrinave në mesin e fjalisë (Mittelfeld), duke u nisur nga fakti se në të janë të renditura pothuajse të gjitha gjymtyrët e fjalisë, pra funksionon si një fjali. Në kreun e tetë do të trajtohet rendi i kundrinës në fjalinë dëftore në gjuhën shqipe. Pasi të jepet një vështrim historik, do të trajtohet rendi i tri kundrinavetë gjuhës shqipe në nënkrerët përkatës. Një nënkre i veçantë do t'i kushtohet dhe vendit të trajtës së shkurtër në fjali kur ajo shenjon kundrinën e drejtë apo atë të zhdrejtë. Në kreun e nëntë do bëhet trajtimi përmasës i rendit të gjymtyrëve në të dyja gjuhët duke nxjerrë në pah të përbashkëtat dhe ndryshimet mes tyre.

Në përfundim do të paraqiten përmbledhtas përfundimet në të cilat kam arritur, të cilat synojnë të përlligjin përzgjedhjen e kësaj teme dhe origjinalitetin e punimit si dhe çështjet dhe problemet që mbeten të hapura për studime të mëtejshme më të thelluara.

Punimi mbyllet me bibliografinë, ku përfshihen dhe burime elektronike.

Pasqyra e lëndës

MIRËNJOHJE.....	
SHKURTIME.....	
HYRJE.....	I
Përligjja e punimit	I
Objekti dhe hipotezat e punimit	II
Metodologjia dhe struktura e punimit	III
PJESA E PARË.....	1
Hyrje.....	1
KREU I - KUNDRINA NË TEORITË E NDRYSHME GRAMATIKORE NË GJUHËN GJERMANE.....	3
1.Origjina e termit kundrinë.	3
2.Gramatika tradicionale	5
2.1.Gramatika tradicionale e shekullit të 19-të dhe të 20-t.....	5
2.1.1. Vilhelm fon Humboldt (Wilhelm von Humboldt).....	7
2.1.2.Jakob Grim (Jakob Grimm).....	7
2.1.3.Karl Fridrish Beker (Karl Friedrich Becker)	8
2.1.4.Fridrish Blac (Friedrich Blatz)	13
2.2.Gramatika tradicionale e shekullit të 21	16
2.2.1.Dora Shulc/ Hans Grisbah (Dora Schulz/ Hans Griesbach)	16
2.2.2.Gerard Helbig (Gerhard Helbig)	18
2.2.3.Elke Henshel/ Harald Veid (Elke Hentschel/ Harald Weydt)	20
2.2.4.Duden	22
2.2.5.Angelika Volenshtajn- Lajsten/ Aksel Hajlman/ Peter Shtepan/ Sten Vikner (Angelika Wöllenstein-Leisten/ Axel Heilmann/ Peter Stepan/ Sten Vikner)	25
2.2.6. Karl- Ernst Zomerfeld/ Gynter Shtarke (Karl- Ernst Sommerfeld/ Günter Starke) ..	26
2.2.7.Brikena Kadzadej	27
2.2.8.Vilfrid Kyrshner (Wilfried Kürschner).....	27
3.Gramatika me orientim nga përmbajtja (Die inhaltsbezogene Grammatik).....	28
3.1.Leo Vajsgerber (Leo Weisgerber).....	28
3.2.Hans Glinz (Hans Glinz)	31
3.3.Angelika Linke/ Markus Nusbaumer/ Paul Linke Portman (AngelikaLinke / Markus Nussbaumer/ Paul Linke Portmann).....	32
3.4.Krista Dyrshajd (Christa Dürscheid).....	33
4.Gramatika e valencës dhe dependencës.....	34
4.1.Aktantet dhe rrethanorët (Aktanten dhe Angaben).....	35

4.2.Valenca.....	37
4.3.Karl Hajnc Ramers (Karl Heinz Ramers).....	38
4.4.Ulrich Engel (Ulrich Engel).....	41
4.5.Verner Eroms (Werner Eroms)	42
4.6.Heringer.....	42
4.7. Karin Pittner/ Judit Berman (Karin Pittner/ Judith Berman)	43
5.Gramatika gjenerative	45
5.1. Noam Avram Çomski.....	45
5.2.Teoria X-Bar.....	49
KREU II - KUNDRINA NË TEORITË E NDRYSHME GRAMATIKORE NË GJUHËN SHQIPE	54
1.Origjina e termit kundrinë	55
2. Gramatika tradicionale	57
2.1. Gramatika tradicionale e shekullit të 20-të.....	57
2.1.1. Sami Frashëri.....	57
2.2. Gramatika tradicionale e shekullit 21	57
2.2.1. Anton M. Xanoni.....	57
2.2.2. Aleksandër Xhuvani	58
2.2.3. Ilia Dilo Sheperi	59
2.2.4. Justin Rrota.....	60
2.2.5. Osman Myderrizi.....	62
2.2.6. Kristaq Cipo	63
2.2.7. Mahir Domi/ N. Hajvari	64
2.2.8. Stefan Prifti.....	66
2.2.9. Libri i gjuhës shqipe 3	69
2.2.10. Oda Buholc/ Wilfrid Fidler (Oda Bucholz/ Wilfried Fiedler).....	71
2.2.11. Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa	74
2.2.12. Remzi Përnaska	78
3. Gramatika e dependencës dhe valencës.....	82
3.1. Mehmet Çeliku,	83
4. Gramatika gjenerative	86
4.1. Flora Koleci, Giuseppina Turano	86
KREU III - VËSHTRIM HISTORIK PËRQASËS I KUNDRINËS NË GRAMATIKAT E GJUHËS GJERMANE DHE ATË SHQIPE	91
PJESA E DYTË.....	95
KREU IV - KUNDRINA NË GJUHËN GJERMANE	95

1. Gjymtyrët e fjalisë	95
1.1. Klasifikimi i gjymtyrëve kryesore	98
1.2. Vështirësi në përcaktimin e kundrinës	100
1.2.1. Kundrinë apo rrethor?	101
1.2.2. Kundrinë e rasës kallëzore apo kallëzuesor kundrinor (Objektsakkusativ/ Gleichsetzungsakkusativ/ Prädikatsakkusativ)?	104
1.2.3. Kundrinë e rasës kallëzore apo kallëzore ndajfoljore (Adverbialakkusativ)?	105
1.2.4. Kundrinë e rasës kallëzore apo kallëzore absolute (absoluter Akkusativ)?	105
1.2.5. Kundrinë e rasës gjinore apo gjinore ndajfoljore (Adverbialgenitiv)?	106
1.2.6. Kundrinë e rasës dhanore apo dhanore e lirë (freier Dativ)?	106
2. Kundrina në gjuhën gjermane, vështrim i përgjithshëm	114
2.1. Kuptimi dhe kategoritë morfologjike tek kundrina	117
2.2. Raporti i kundrinës me foljen	118
2.3. Sundimi (Rektion) i foljeve	121
2.3.1. Sundimi i rasës gjinore:	122
2.3.2. Sundimi i rasës dhanore:	123
2.3.3. Sundimi i rasës kallëzore:	123
2.4. Sundimi i parafjalëve:	124
2.5. Sundimi i kundrinës nga mbiemri:	125
2.6. Nënndarjet e kundrinës sipas kritereve semantike	128
3. Kundrina e rasës kallëzore	131
3.1. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e rasës kallëzore:	134
3.2. Nuanca semantike të kundrinës së rasës kallëzore	136
4. Kundrina e rasës dhanore	137
4.1. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e rasës dhanore:	142
4.2. Nuanca semantike të kundrinës së rasës dhanore	143
5. Kundrina me parafjalë	144
5.1. Vështrim i shkurtër historik i kundrinës me parafjalë	144
5.2. Kundrina me parafjalë që sundojnë rasën kallëzore dhe dhanore	145
5.3. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e me parafjalë:	150
6. Kundrina e rasës gjinore	151
6.1. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e rasës gjinore:	154
6.2. Nuancat semantike të kundrinës së rasës gjinore.	155
KREU V - KUNDRINA NË GJUHËN SHQIPE	157
1. Gjymtyrët e dyta të fjalisë dhe roli i tyre	157
1.1. Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta	158

1.2.Vështirësi në klasifikimin e kundrinës.	159
1.2.1.Kundrinë apo përcaktor?	160
1.2.2.Kundrinë apo rrethator?.....	162
2. Kundrina në gjuhën shqipe, vështrim i përgjithshëm.	163
2.1. Sundimi i kundrinës.....	168
2.1.1.Kundrina e drejtuar nga një emër.	168
2.1.2.Kundrina e drejtuar nga një mbiemër.	170
2.1.3.Kundrina e drejtuar nga një ndajfolje.	171
2.1.4.Kundrina e drejtuar nga një folje.....	172
3.Kundrina e drejtë.	172
3.1.Nuanca semantike të shprehura nga kundrina e drejtë.	174
3.1.1. Kundrina e drejtë e brendshme.....	174
3.1.2. Kundrina e drejtë e jashtme	176
3.2. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e drejtë.	180
4. Kundrina e zhdrejtë.	183
5.1. Nuanca semantike të shprehura nga kundrina e zhdrejtë pa parafjalë.....	186
5.2. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e zhdrejtë pa parafjalë..	189
6. Shenjimi i kundrinës së drejtë e të zhdrejtë pa parafjalë nga trajtat e shkurtra të përemrave vetorë.	192
6.1. Vështrim historik.	192
6.2. Formimi i trajtave të shkurtra të përemrit vetor si shenjues të kundrinës	197
6.3.1. Shenjimi i kundrinës së drejtë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.....	203
6.3.1.1. Mungesa e kundrinës së drejtë dhe mosshenjimi i saj me trajtë të shkurtër..	207
6.3.2. Shenjimi i kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor. 212	
6.3.2.1. Trajta e shkurtër e përemrit vetor si dhanore etike.	214
6.4. Shenjimi njëkohësisht i kundrinës së drejtë e të zhdrejtë me trajtë të shkurtër.	215
6.5. Eliminimi i kundrinës së drejtë e të zhdrejtë.	216
6.6. Vendi i trajtës së shkurtër në raport me foljen.....	217
7. Kundrina e zhdrejtë me parafjalë.....	219
7.1. Vështrim historik i kundrinës së zhdrejtë me parafjalë.	219
7.2. Nuancat semantike të shprehura nga kundrina e zhdrejtë me parafjalë.....	226
7.3. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e zhdrejtë me parafjalë.	230
KREU VI - PËRQASJE MES KUNDRINËS NË GJUHËN GJERMANE DHE ATË SHQIPE	232
1. Kundrina në të dyja gjuhët, vështrim i përgjithshëm.....	232

1.1. Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe kundrina e drejtë në gjuhën shqipe.	237
1.2. Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe kundrina e zhdrejtë në gjuhën shqipe.	242
1.3. Shenjimi i kundrës së drejtë e të zhdrejtë të gjuhës shqipe me trajta të shkurtra të përemrit vetor.	246
1.4. Kundrina me parafjalë	247
1.5. Kundrina e rasës gjinore në gjuhën gjermane.	252
PJESA E TRETË	254
KREU VII - RENDI I KUNDRINËS NË GJUHËN GJERMANE	254
1. Rendi i gjymtyrëve në fjalinë e thjeshtë dëftore.....	254
1.1. Korniza e fjalisë (Satzklammer)	254
1.1.1. Das Mittelfeld.....	256
1.1.2. Das Vorfeld	257
1.1.3. Das Nachfeld	257
1.2. Funkzioni stilistikor i rendit të gjymtyrëve.....	258
1.3. Funkzioni gramatikor i rendit të gjymtyrëve	259
2. Rendi i kundrinave në fjalinë e thjeshtë dëftore.	259
2.1. Rendi i kundrinës së rasës dhanore (Dativobjekt) dhe kallëzore (Akkusativobjekt) në fjalinë e thjeshtë dëftore.....	260
2.2. Rendi i kundrinës së rasës gjinore (Genitivobjekt) në fjalinë e thjeshtë dëftore. ..	261
2.3. Rendi i kundrinës me parafjalë në fjalinë e thjeshtë dëftore.	262
3. Përmbledhje e skemave të ndërtimit të fjalisë sipas Duden	263
KREU VIII – RENDI I KUNDRINËS NË GJUHËN SHQIPE	267
1. Rendi i fjalëve në gjuhën shqipe, vështrim historik.	267
2. Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe, Vështrim i përgjithshëm. 268	
3. Funkzioni kumtues i rendit të fjalëve në fjali.	270
3.1. Gjymtyrëzimi aktual.....	271
3.1.2. Theksi logjik.....	272
3.2. Mjete të tjera ndihmëse me karakter leksikor dhe gramatikor, trajtat e shkurtra.	275
4. Funkzioni stilistikor i rendit të fjalëve	278
5. Funkzioni gramatikor i rendit të fjalëve	278
6. Rendi i kundrinave në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe	282
6.1. Rendi i kundrinës së drejtë në fjalinë e thjeshtë dëftore.....	283
6.2. Rendi i kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë në fjalinë e thjeshtë dëftore	291
6.3. Rendi i kundrinës me parafjalë në fjalinë e thjeshtë dëftore	296

6.4.	Rendi në fjalinë e thjeshtë dëftore i kundrinës së drejtë dhe kundrinës së zhdrejtë. 297	
6.5.	Rendi në fjalinë e thjeshtë dëftore i kundrinës me parafjalë në raport me kundrinën e drejtë, dhe kundrinën e zhdrejtë.....	298
KREU IX - TRAJTIM PËRQASËS I RENDIT TË KUNDRINËS NË GJUHËN GJERMANE DHE ATË SHQIPE		299
Përfundime		302
Të përbashkëtat:		304
Ndryshimet:		310
Bibliografi		321
ANEKSI 1		336
Foljet me parafjalë në rasën dhanore		336
Foljet me parafjalë në rasën kallëzore.....		336
ANEKSI 2		337

PJESA E PARË

Hyrje

Sintaksa është struktura gramatikore e një gjuhe, e cila ka të bëjë me mënyrat se si bashkohen fjalët, në ligjërimin e lidhur, për të shprehur e transmetuar mendimet. Së bashku me morfologjinë ato përbëjnë gramatikën e një gjuhe. Nga ana tjetër, gramatika është një “mjet”, që përdoret për të përshkruar gjuhën. Gramatika mund ta përshkruajë gjuhën në mënyrë preskriptive, duke caktuar rregulla për përdorimin e saktë të saj duke u bazuar në një standard ose në mënyrë deskriptive, duke regjistruar mënyrën se si njerëzit përdorin gjuhën në formën e saj standarde dhe jo standarde. Por, ajo çka është më e rëndësishmja, është synimi i gramatikës për të caktuar rregullat, sipas të cilave mund të formohen një pafundësi fjalish në një gjuhë të caktuar.

Si në gjuhën gjermane dhe në atë shqipe, vihet re se, në gramatika të ndryshme, njësitë sintaksore të dallueshme janë fjalja e periudha, gjymtyrët e fjalisë, togfjalëshi. Fjalitë, përveç, kryefjalës e kallëzuesit në të shumtën e rasteve kanë dhe gjymtyrë të tjera, si kundrina, rrethanori dhe përcaktori, të cilat i përcaktojnë më tej ato, lidhen me to nga ana kuptimore e strukturore.

Gjatë zhvillimit të shkencave të gjuhësisë në shekujt e fundit, kanë lindur shumë teori gramatikore të cilat kërkojnë që në mënyra të ndryshme të ndërtojnë një skemë për kompleksitetin e ndërtimit të një gjuhe. Për këtë arsye kundrina paraqitet në modele të ndryshme gramatikore dhe në mënyra të ndryshme. Të gjitha teoritë sintaksore ndryshojnë:

1. në elementët sintaksorë bazë, si edhe metodat e përcaktimit të tyre
2. në karakterizimin e elementëve, të raporteve që qëndrojnë midis tyre dhe të funksioneve të tyre
3. në aspektet e ndryshme të fjalisë
4. si edhe në rolin që luan sintaksa në gramatikën e një gjuhe

Në dy krerët në vijim do pasqyrohet se si e kanë përdorur e trajtuar termin ‘kundrinë’ teori të ndryshme gramatikore. Gjithashtu paraqitja e përfaqësuesve të teorive përkatëse do shërbejë për të krijuar një ide më të qartë rreth kësaj çështje. Një klasifikim i qartë mes studiuesve të ndryshëm ose shkollave të ndryshme në shumë raste nuk është i mundur, pasi vërehet përdorimi i elementeve të ndryshëm të teorive mëparshme, të rimarra e të përpunuara më tej. Kjo shpesh çon dhe në një ndërthurje të teorive me njëra tjetrën. Këtë e gjejmë veçanërisht tek gramatika tradicionale dhe ajo e valencës dhe dependencës. Gjithashtu dhe gramatika e mëvonshme gjenerative merr ide nga strukturalizmi, ku vërehen përpjekje për të bashkuar në parime të kombinuara njësitë gjuhësore të përfutuara më anë të segmentimit dhe klasifikimit, për të përshkruar bagazhin gjuhësor njerëzor në përgjithësi. Gjatë hulumtimit vërehet gjithashtu se gramatika gjenerative vë në përdorim mjetet e gramatikës së valencës. Megjithë sa u tha më lart, ka dhe do të ketë gjithmonë teori të ndryshme gramatikore, të cilat

qëndrojnë pranë ose dhe përballë njëra tjetrës dhe megjithë mosdakortësitë mes tyre, të cilat janë përgjithësisht të rrafshit ideologjik gjuhësor, do të ketë gjithnjë dhe të përbashkëta. Të gjitha këto zhvillime në fushën e gramatikës në përgjithësi dhe sintaksës në veçanti, lidhen dhe me zhvillimin e shoqërisë.

Objekti i kësaj pjese të parë të punimit do të jetë paraqitja e një vëzhgimi historiko – kritik i kundrinës duke gjurmuar evoluimin e saj në gramatika të ndryshme të gjuhës gjermane dhe të asaj shqipe, me në fokus gramatikat dhe në disa raste kur kanë pasur ndikim të rëndësishëm dhe monografitë më kryesore në të dy gjuhët nga logjikat, tradicionalet e deri tek ato modernet si ato gjenerative të cilat përqendrohen kryesisht në sintaksën e gjuhës dhe jo në aspektet ndërvepruese komunikuese të përvetësimit gjuhësor dhe ato funksionaliste, të cilat përshkruhen si një qasje gjuhësore strukturore, funksionale dhe semantike e gjuhës së përdorur në kontekste të ndryshme. Gjithashtu rëndësi të veçantë për këtë pjesë përbën dhe kreu i tretë ku do të bëhet përqasja e tyre në të dyja gjuhët.

Për lehtësi studimi e krahasimi, gramatologjinë e gjuhës gjermane do e ndaj kronologjikisht në katër faza: Faza e parë do të fillojë me trajtimin kronologjik të kundrinës në gramatikën tradicionale ku bëjnë pjesë ato të hershme me drejtimin logjik, si dhe ato tradicionale të mëvonshme, do vazhdojë në fazën e dytë me gramatikën e orientuar nga përmbajtja, faza e tretë do përfshijë gramatikën e dependencës dhe valencës dhe mbyllet me teorinë gramatikore gjenerative në fazën e katërt.

Ndërsa për rastin gjuhës shqipe, ndarja do të përfshijë të gjitha gramatikat tradicionale në fazën e parë, të cilën si në rastin e gjuhës gjermane gjithashtu e kam ndarë në dy pjesë, faza e dytë e quajtur “gramatika e dependencës dhe valencës”, do të përfshijë gramatikat e shkruara pas kësaj faze, por që nuk ecin paralel me zhvillimet në gjuhësinë bashkohore, ndërsa faza e tretë e quajtur “gramatika gjenerative”, do të përfshijë sintaksat e hartuara së fundmi me orientim nga gjuhësia bashkohore gjenerative.

Qëllimi kryesor i punimit është nxjerrja në pah e arritjeve në lidhje me çështjen në fjalë, krahasimi si dhe evidentimi i problematikës, me qëllim hapjen e rrugës për studime të reja.

KREU I - KUNDRINA NË TEORITË E NDRYSHME GRAMATIKORE NË GJUHËN GJERMANE

1. Origjina e termit kundrinë.

Përsa i përket terminologjisë së gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën gjermane, duke shfletuar gramatika të ndryshme vërehet se ndeshen një mori termash të ndryshëm për të njëjtat gjymtyrë e madje në disa raste dhe kuptime të ndryshme për të njëjtin term. Kjo për shkak të teorive e këndvështrimeve të ndryshme gramatikore, të cilat na shfaqen me bollëk në gjuhën gjermane.

Termet, të cilët përshkruhen si tradicionalë dhe në ditët e sotme, janë bërë pjesë e logjikës dhe gjuhësisë në periudha të ndryshme. Termet ‘kryefjalë’ dhe ‘kallëzues’ e kanë origjinën e tyre nga logjika antike, nga Platoni e më pas Aristoteli (përkatësisht ‘onoma’ dhe ‘rhema’) dhe u rimorën e u përdorën më vonë nga Boethius, një filozof romak i fillimit të shekullit 6, duke u përkthyer në latinisht si ‘*subiectum*’ dhe ‘*praedicatum*’ “*Das Objekt (von lat. Obicere, ‘ entgegenwerfen, entgegensetzen’/ obiectum, entgegensetzt) steht dem Subjekt in der Philosophie wie auch in der Grammatik als Gegenstand des Wahrnehmens, Erkennens, Denkens und Handelns gegenüber./ Objekti/ kundrina, (nga latinishtja ‘obiectum’, pjesorja e ‘obicere’/ të vësh përballë), është kundrejt subjektit/ kryefjalës në filozofi si dhe në gramatikë objekt i perceptimit, njohjes, mendimit dhe veprimit.”¹*

Gjuha dhe shoqëria, historia e gjuhës dhe historia e njerëzimit janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Vlen të theksohet se gjuha dhe mendimi janë zhvilluar ndër shekuj paralelisht. “*Die Bezeichnungen Objekt, Copula und Attribut werden in der Scholastik eingeführt, und zwar in philosophischen und theologischen Zusammenhängen. So war z. B. das Objekt, Bezeichnung für denjenigen, auf den Gottes Handlung gerichtet war; man unterscheidet bei ‘amor dei’ (die Liebe Gottes) zwischen den genitivus subjektives, also ‘ die Liebe Gottes’ (zu den Menschen) und dem genitivus objektives (die Liebe zu Gott)./ Termet kundrinë dhe rrethanor u përdorën në periudhën e lëvizjes së Skolastikës në kontekst filozofik dhe teologjik. Kështu p.sh. kundrina përcaktonte atë të cilit i drejtohej shërbesa fetare; bëhet dallimi tek ‘amor dei’ (dashuria e Zotit) mes gjinore subjektive dmth ‘dashurisë së Zotit’ (për njerëzit) dhe gjinore objektive (dashuria për Zotin)”² Keto terma u përdorën deri në fillim të shekullit të 19, si një përzierje mes logjikës dhe semantikës. Sipas Bynting / Bergenholc, gjatë kësaj periudhe pati dhe një sërë termash të tjerë të përdorura në gramatika të ndryshme të kohës. Për kundrinën*

¹Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2012, f. 47

²Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenhäum, Weinheim 1995, f.71

p.sh.: *Zweckwort*/ fjalë që shpreh qëllimin, *Aneignungswort*/ fjalë që shpreh përshtatje, *Beifügung*/ shtojcë dhe *Zielwort*/ fjalë që shpreh synimin.³

Termet që përdoren dhe sot veçanërisht në gramatikat tradicionale si dhe ato me karakter didaktik shkollor, u përdorën në gjysmën e dytë të shekullit të 19 nga gjuhëtari Karl Fridrish Beker (Karl Friedrich Becker). Ai i kuptoi ato si terma logjik, por duke ju referuar gjuhës. Terminologjia e përdorur prej tij ndeshi në debate të shumta mes gjuhëtarëve të kohës, të cilët i cilësuan ato si joshkencore dhe të papërshtatshme. *“Becker hat die Begriffe Subjekt, Prädikat, Attribut und Objekt in den systematischen Zusammenhang gebracht, der auch heute gilt; beim Objekt hat er zwischen einem bestimmenden und einem ergänzendem unterschieden. Aus letzterem wurde im Laufe der Zeit die adverbelle Bestimmung bzw das Adverbial oder Adverbialglied./ Beker i vendosi termat kryefjalë, kallëzues, përcaktor dhe kundrinë në njëraport sistematik, i cili vlen dhe sot. Tek kundrina ai bëri dallimin mes kundrinës përcaktuese dhe asaj plotësuese. Kjo e fundit me kalimin e kohës u quajt rrethanor.”*⁴

Në gjuhën gjermane, përveç termit ‘Objekt’ për kundrinën, shpeshherë ndeshet dhe termi ‘Ergänzung’, i cili në gjuhën shqipe përkthehet plotës. Ky term siç do shihet në kreun në vijim, gjen përdorim të gjerë në gramatikën e valencës dhe dependencës. Ai ndeshet dhe në tekste të karakterit didaktik për mësimin e gjermanishtes si gjuhë e huaj, që bazohen në përshkrimet gramatikore të këtyre shkollave.

Përsa i përket klasifikimit të kundrinës, vërehet gjithashtu se përdorimi i termit kallëzues, në këto shkolla gramatikore, nuk është i njehsuar. Për ta ilustruar këtë po marr si shembull fjalinë:

Jürgen liest das Buch./ Jyrgei lexon librin.

ku kallëzuesi mund të lexohet në dy mënyra të ndryshme në bazë të këndvështrimit apo teorisë:

-Në rastin e parë, në ndarjen logjike të dy gjymtyrëve të fjalisë në kryefjalë dhe kallëzues, kallëzuesi përfshin dhe kundrinën. Në këtë rast pra do kishim skemën:

kryefjalë + kallëzues (= folje + kundrinë).

Në shembullin e mësipërm ‘Jyrgei’ do ishte kryefjala, ndërsa ‘lexon librin’ kallëzuesi. Vërehet se ky model ‘i vjetër’ është shumë i përafërt me gramatikën gjenerative të ditëve të sotme, ku një fjali përbëhet nga dy përbërës sintaksor (Konstituente): fraza emërore dhe fraza foljore, ku e para i referohet kryefjalës dhe e dyta kallëzuesit. Konkretisht në gramatikën gjenerative, ‘Jyrgei’ do cilësohej si frazë emërore, ndërsa

³Po aty

⁴Po aty

'lexon librin' si frazë foljore. Në frazën foljore mundet të përfshihet dhe një kundrinë, por jo domosdoshmërisht, ndërsa folja është e detyrueshme.

-Ndërsa në interpretimin e dytë, kallëzuesi shpreh vetëm foljen, dmth do të kishim skemën:

kryefjalë + kallëzues (= folje) + kundrinë.

Kjo mënyrë përputhet me gramatikën tradicionale dhe atë shkollore (Schulgrammatik) ku, kallëzuesi njehsohet zakonisht me foljen dhe ku nevojitet një gjymtyrë shtesë dmth kundrina. Fjalja në gramatikën tradicionale 'Jyrgen' do ishte kryefjala, 'lexon' do ishte kallëzuesi dhe 'librin' kundrina e drejtë.

Koncepti antik i dallimit logjik mes kryefjalës dhe kallëzuesit është rimarrë vazhdimisht ndër shekuj nga gjuhëtarë të ndryshëm të hapësirës gjermanofolëse. Gjurmë të saj gjejmë veçanërisht tek gramatika tradicionale, e cila prej saj huazoi dhe inventarin terminologjik. Mund të thuhet madje se gramatika tradicionale është "përgjegjëse" për faktin që termat kryefjalë, kallëzues e kundrinë i ndeshim ende sot. Më tej mund të thuhet se kjo gramatikë ka përcjellë më tej elemente të shkollave të ndryshme, të cilat u pranuan në kohë. Në kreun në vijim do përshkruhet gramatika tradicionale në hapësirën gjermanishtfolëse.

2.Gramatika tradicionale

2.1.Gramatika tradicionale e shekullit të 19-të dhe të 20-t

Gramatika e quajtur tradicionale në gjuhën gjermane nuk duhet parë si një teori homogjene gramatikore, përsa i përket rrafshit kohor dhe atij teorik. Ky term në gjuhën gjermane përdoret përgjithësisht ose në lidhje me aspektin kohor, dmth për teori gramatikore të një kohe të shkuar, për drejtime të së tashmes, të cilat marrin dhe zhvillojnë më tej ide tradicionale të mënyrës së përshkrimit gramatikor, ose i adresohet të gjitha drejtimeve gramatikore që nuk përfaqësojnë asnjë nga të ashtuquajturat teori të reja gramatikore si p.sh. ajo e dependencës, gjenerative etj..

Nga sa u tha më lart, në gjuhën gjermane është disa e vështirë të përcaktosh saktësisht gramatikën tradicionale. Vërehet madje se studiues të ndryshëm ndajnë mendime të ndryshme në lidhje me këtë, çka do të thotë se meqenëse kemi të bëjmë me një koncept kompleks ka edhe përcaktime të ndryshme të këtij termi, të kushtëzuara këto nga mënyra se si këndvështrohet gramatika tradicionale. Kadzadej shprehet se gramatika tradicionale është forma më e hershme e përdorur në gramatikën shkollore në Evropë, e zhvilluar në shekullin e 18, duke u bazuar tek logjika aristoteliane. Kriteret që ndjek p.sh. Kadzadej⁵ për përcaktimin e saj janë:

⁵Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f. 130

“a)Die stärker als andere in der sehr langen tradition der abendländischen Syntaxschreibung verhaftet ist, d.h. im Ansatz, Methode usw. deutlich in der Tradition wurzelt,

b)die eindeutig auf Resultatgrammatiken hin arbeitet und dabei Darstellungen des Gesamtsystems einer Einzelsprache anstrebt.

c)die dadurch stark die Praxis wirken will und wirkt und die bis heute am stärksten von allen einen präskriptiveren Zug aufweist, auch dies ganz im Sinne der langen grammatikographischen Tradition./

a)Që ka zënë rrënjë më të thella se të tjerat në traditën perëndimore të sintaksës, dmth. i ka dukshëm rrënjët më të thella në traditë, përsa i përket metologjisë.

b)e cila bazohet më shumë në grammatikat e rezultateve dhe përpiqet të na japë tablonë e plotë të të gjithë sistemit të një gjuhe të caktuar.

c)e cila influencon mjaft praktikën dhe ajo e cila ka tipare të forta preskriptive, dhe në kuptimin e traditës së gjatë grammatikore.”

Ndërsa sipas Ajshler/ Bynting, “*Unter der traditionellen Grammatik versteht man eine normative Regelgrammatik, mit eine der lateinischen grammatik entlehnten Nomenklatur und so der Vorwurf, mit einer Systematik, die ebenfalls von der lateinischen Grammatik auf andere Sprachen übertragen worden ist./* Me grammatikë tradicionale kuptojmë një grammatikë normative rregullash, e cila ka huazuar terminologjinë nga latinishtja, me një sistem i cili gjithashtu është marrë nga latinishtja dhe është zbatuar në gjuhët e tjera”⁶

Grammatikë tradicionale në gjuhësinë gjermane, në këtë punim, do të quhet kryesisht gjuhësia historike krahasuese të shekullit 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-t në hapësirën gjermanofolëse, si dhe grammatika të mëvonshme që bazohen tek ajo. Terminologjia e gjymtyrëve të fjalisë së kësaj grammatike është marrë nga antikiteti. Kjo terminologji është ruajtur mbi të gjitha në përshkrimin e grammatikës didaktike shkollore si dhe në variantet më të reja të grammatikës tradicionale. Vlen të përmendet tendenca e gjuhëtarëve të ndryshëm, të cilët pasi zhvillojnë një teori të re grammatikore për një fushë a çështje të caktuar, quajnë çdo teori të mëparshme që lidhet me çështjen në fjalë, tradicionale. Gjithashtu, në vijim do të përmendet dhe grammatika tradicionale e viteve të fundit në gjuhën gjermane, e cila sipas Kadzadej ka marrë impulse të forta nga grammatika e Hans Glincit dhe ajo e valencës e dependencës, duke e bërë kufizimin me këtë të fundit mjaft të vështirë e madje në disa raste thuhet të pamundur. Grammatika të tilla janë ajo e Brinkman (Brinkmann, 1971), Erben (1980; 1989), Schulc/ Grizbah (Schulz/ Griesbach, 1978), Ajshler/ Bynding (Eichler/ Bünting, 1989), Admoni (1989), Duden (1984), Helbig/ Buscha (Helbig/ Buscha, 1989), Grizbah (Griesbach, 1986), Galman/ Sita (Gallmann/Sitta, 1990), Shyler-Duden (Schüler – Duden, 1990), Kadzadej (2002).⁷

⁶Eichler, Wolfgang; Bünting, Karl- Dieter, *Deutsche Grammatik*, 6 Auflage, Beltz Athenhäum, Frankfurt 1996, f. 148

⁷Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f. 132

Më tej ajo shprehet se ndihet deri në ditët e sotme, influenca e së ashtëquajturës gramatikë e orientuar nga përmbajtja (Inhaltsbezogene Grammatik) me përfaqësues të tillë si Vajsergerber (Weisgerber), të cilët dominuan gjuhësinë gjermane të viteve të pasluftës së dytë botërore.

2.1.1. Vilhelm fon Humboldt (Wilhelm von Humboldt)

Në gjuhësinë gjermane të shekullit të 19-të, dimensionin historik i gjuhës përbënte fokusin e studimit të saj. E lidhur ngushtësisht me këto zhvillime është dhe filozofia e gjuhës së Vilhelm fon Humboldt, i cili e sheh gjuhën si një organizëm të gjallë në zhvillim, i cili nuk resht kurrë së ndryshuari.

Ai e përcakton më tej atë jo si një vepër (Ergon), por si një aktivitet (Energie). Gjuha dhe mendimi sipas Humboldt gjenden në një proces të pandërprerë varësie të ndërsjellë, i cili nuk mund të jetë i njëanshëm, ku gjuha influencon mendimin apo mendimi influencon gjuhën. Kjo lidhje e ngushtë mes gjuhës e mendimit e çon Humboldt në supozimin e një përputhshmërie më të gjerë mes gjuhës dhe aktivitetit intelektual” *Die Sprache ist das bildende Organ des Gedankens. Die intellektuelle Thätigkeit, durchaus geistig, durchaus innerlich und gewissermaßen spurlos vorübergehend, wird durch den Laut in der Rede äußerlich und wahrnehmbar für die Sinne. Sie und die Sprache sind daher eins und unzertrennlich voneinander./ Gjuha është organi i ndërtimit të mendimit. Aktiviteti intelektual, krejtësisht shpirtëror, krejtësisht i brendshëm dhe deri diku i përkohshëm, bëhet i perceptueshëm për shqisat me anë të tingullit gjatë ligjërit. Prandaj ai dhe gjuha janë një dhe të pandarë.”⁸*

Por, kjo do të thotë gjithashtu se njerëzit që flasin gjuhë të ndryshme, mendojnë ndryshe. Kjo madje çon në vlerësimin e gjuhëve ose e llojeve të gjuhëve. Një rëndësi e veçantë këtu i jepet sintaksës. Sipas Humboldt fjalja është shumë më e rëndësishme se fjalët në veçanti. Ai e sheh fleksionin si gjymtyrën lidhëse më të mirë mes mendimit dhe gjuhës. Gjuhë të ndryshme, sipas tij gjenden në stadi të ndryshme zhvillimi, ku fleksioni përbën stadin më të lartë. Më tej ai shprehet se gjuhët “më të mira” janë ato të familjes indogjermane pasi kanë fleksion, ndërsa shembulli “më ekstrem negativ” sipas tij është gjuha kineze, e cila ka një sintaksë të izoluar.⁹

Natyrisht nuk mund të biem dakort me këtë teori diskriminuese, ku gjuhë të caktuara shihen si superiore ndaj gjuhëve të tjera, apo ku disa gjuhë përcaktohen si primitive e si rrjedhojë popujt respektivë që i flasin këto gjuhë si të pacivilizuar.

2.1.2. Jakob Grim (Jakob Grimm)

⁸<http://www.zeno.org/Philosophie/M/Humboldt,+Wilhelm+von/Ueber+die+Verschiedenheiten+des+menschlichen+Sprachbaues/2.+Von+der+Natur+der+Sprache+und+ihrer+Beziehung+auf+den+Menschen+im>Allgemeinen>

⁹Po aty

Nga sa u tha më lart, gjatë shekullit të 19-të një vend qendror zë metoda historike krahasuese e gjuhëve. Mbizotëronte mendimi se vetëm në këtë mënyrë strukturat gjuhësore mund të përcaktoheshin qartë. Në lidhje me këtë Jakob Grim shkruan në parathënien e vëllimit të katërt të librit të tij “Gramatika gjermane”: *“Wer sich in untersuchungen über die deutsche sprache begibt, und darin aushält, wird mit freuden gewahren, wie das wesen und die geschichte unseres volkes in den eigenschaften und schicksalen unserer sprache sich abspiegeln. Die deutsche sprache ist nicht ohne schmuck, und birgt ihn oft, nicht ohne flecken und narben, und versteckt sie nie./* Kush i përkushtohet studimit të gjuhës gjermane, do të zbulojë se si pasqyrohet qenia dhe historia e popullit tonë tek karakteristikat e gjuhës sonë. Gjuha gjermane nuk është pa zbulime, dhe i fsheh shpesh ato, nuk është pa njolla e plagë, dhe nuk i fsheh kurrë ato.”¹⁰

Strukturat e veçanta të gjuhës gjermane sipas Grrimit e marrin shpjegimin nga historia e kombit. Përsa i përket analizës së fjalisë, gjuhëtarët gjermanë të shekullit të 19-të bazohen tek modeli antik, si në rastin e Grrimit i cili në parathënien e veprës së tij ndër të tjera shprehet se çdo mendim lidh një objekt me një përfytyrim dhe si pasojë çdo fjali duhet të ketë një kryefjalë dhe një kallëzues.¹¹

2.1.3.Karl Fridrish Beker (Karl Friedrich Becker)

Ndërsa përsa i përket emërtimit të terminologjisë së gjymtyrëve të fjalisë, pjesa më e madhe e të cilave përdoret ende sot, autorësia është e Karl Fridrish Beker (1775-1849), një bashkëkohës i Grrimit. Në 1827 ai botoi veprën “Organismus der Sprache”/ Organizmi i gjuhës, e cila u mirëprit e u përdor nga nxënësit e shkollave, pasi më në fund ata kishin në dorë një libër të karakterit normativ me rregulla të gjuhës në gjuhën gjermane, të cilin madje mund ta përdornin dhe në mësimin e gjuhës latine. Megjithëse vepra e Bekerit nuk përbën një gur kilometrik në gjuhësinë e gjuhës gjermane, ajo la mjaft gjurmë në gramatikën shkollore dhe në atë tradicionale. Sipas Bekerit në një fjali bashkohet diçka konkrete ekzistuese (një emër, kryefjala) me një veprim (një folje, kallëzuesi). Ashtu si Platoni dhe ai bën një analogji mes mendimit dhe gjuhës dhe e kupton fjalinë si një riprodhim të drejtpërdrejtë të mendimit. Beckeri përpiket ta shpjegojë sintaksën duke u nisur nga logjika. Sipas tij fjalia ndahet gjithmonë në kryefjalë dhe kallëzues.

“Becker hat die Begriffe Subjekt, Prädikat (enger Prädikatsbegriff), Attribut und Objekt in den syntaktischen Zusammenhang gebracht, der auch heute gilt; beim Objekt hat er zwischen einen bestimmenden und einem ergänzenden unterschieden. Aus letzterem wurde im laufe der Zeit die adverbialle Bestimmung bzw. Das Adverbial oder Adverbialglied./ Beker i vendosi termat kryefjalë, kallëzues, përcaktor dhe kundrinë

¹⁰Grimm, Jacob [1898]: *Deutsche Grammatik*. Bd. 4. Hg. von Gustav Roethe und Edward Schröder. – Hildesheim: Georg Olms (Documenta Linguistica. Quellen zur Geschichte der deutschen Sprache des 16.-19. Jahrhunderts.) 1967, f. 7

¹¹Po aty

kontekstin sintaksor, i cili është i vlefshëm dhe sot. Nga kjo e fundit u shkëput më vonë dhe rrethanori.”¹²

Gramatika tradicionale e gjymtyrëve të fjalisë, bazohet kryesisht tek gjuhëtari gjerman Karl Fridrish Beker. Më poshtë do shtjellohet më tej parimi i tij për gramatikën e fjalisë, e cila ka në rradhë të parë motivim didaktik. Ai bën dallimin mes formës gjuhësore të brendshme, logjike dhe asaj të jashtme, fonetike. Ai pra e ndan semantikën (formën e brendshme gjuhësore) nga morfologjia (forma e jashtme gjuhësore). Përsa i përket analizës së fjalisë, ai dallon tri raporte të ndryshme të fjalisë:

“*Prädikatives Satzverhältnis: Vögel singen/ Raporti kallëzuesor i fjalisë: zogjtë këndojnë*

Attributives Satzverhältnis: muntere Vögel/ Raporti përcaktor i fjalisë: zogjtë e shkathët

Objektives Satzverhältnis: singen ein Lied/ Raporti kundrinor i fjalisë: këndojnë një këngë”¹³

Raporti kallëzuesor i fjalisë sipas tij është ndërtimi bazë i çdo fjalie. Sipas Bekerit ekziston një ndërtim analog mes të menduarit dhe gjuhës. Në fillim të pjesës së dytë të veprës së tij “Gramatika e plotë e gjermanishtes”, ai shprehet se mendimet e shprehura me fjalë quhen fjali. Çdo mendim është një akt i shpirtit njerëzor, me anë të së cilit termi i një veprimtarie (kallëzuesi) lidhet me termin e një subjekti (kryefjala) duke formuar një njësi të vetme, ku veprimtaria shihet si një veprimtari e subjektit (kryefjalës). Këtë ai e ilustron si vijon:

Der Baum blühet/ Pema lulëzon

Der Hund ist toll./Qeni është i mrekullueshëm. ¹⁴

Pra fjalia sipas tij, shpreh dy llojet e vetme të perceptimeve, të cilat ekzistojnë në mendje: materien dhe veprimtarinë. Bekeri gjithashtu fut në lojë dhe konceptet filozofike të hapësirës e kohës.

Raporti kallëzuesor i fjalisë sipas Bekerit i shprehur në tabelën e mëposhtme:

Raum/ Hapësirë	Zeit/ Kohë
Sein/ të qenit	Tätigkeit/ Veprimtari
Subjekt/ Kryefjalë	Prädikat/ Kallëzues

¹²Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik, 3.Auflage, Beltz Athenhäum, Weinheim 1995, f. 71

¹³Haselbach, Gerhard: *Grammatik und Sprachstruktur. Karl Ferdinand Beckers Beitrag zur Allgemeinen Sprachwissenschaft in historischer und systematischer Sicht.* – Berlin: de Gruyter 1966, f.160

¹⁴Becker, Karl Ferdinand: *Ausführliche deutsche Grammatik als Kommentar der Schulgrammatik;* Frankfurt am Main 1836, f. 5

<i>Hans/ Hansi</i>	<i>trinkt./ pi.</i>
--------------------	---------------------

“Das Subjekt – der Begriff des Seins, von dem geurtheilt und gesprochen wird – und das Prädikat – der Begriff einer Thätigkeit, welche von dem Subjekte ausgesagt wird – sind die Faktoren eines jeden Satzes./ Kryefjala është termi i të qenit, për të cilën flitet e gjykohet dhe kallëzuesi është një veprimtari, së cilës i referohet kryefjala.”¹⁵

E rëndësishme për Bekerin është bashkimi në një njësi i subjektit dhe veprimtarisë ose kryefjalës dhe kallëzuesit, pasi raporti kallëzuesor në fjali sipas tij shpreh bashkimin dy termave në një mendim. Nga kjo del se fjalia është thelbi dhe zanafilla e gjuhës dhe nuk mund të jetë frut i renditjes së disa fjalëve të veçanta njëra pas tjetrës. Pra sipas tij, kryefjala dhe kallëzuesi, ashtu si subjekti dhe veprimtaria kanë formuar gjithmonë një njësi. Nga kjo njësi kanë dalë fjalët dhe jo anasjelltas.

Nga sa u tha më sipër, del qartë këndvështrimi i Bekerit. Për të kryefjala dhe kallëzuesi përbëjnë thelbin e çdo fjalie të saktë në aspektin gramatikor. Por për të bërë të mundur zgjerimin e fjalisë është i nevojshëm sipas tij ndër të tjera dhe raporti sintaksor. Në këtë rast ai paraqet raportin mes *“Tätigkeit und zu dem die Tätigkeit individualisierenden Sein“*. *Das Objekt steht somit der Tätigkeit gegenüber – auch Objektiv genannt./* „veprimtarisë dhe një qenie së cilës i referohet veprimtaria”. Në këtë mënyrë kundrina qëndron përballë veprimtarisë.”¹⁶ Më tej ai shprehet se nuk është e nevojshme të jetë gjithmonë një gjymtyrë e përbërë, por mund të jetë dhe thjesht një përemër, duke e ilustruar si vijon:

Sie gleicht **ih**r. (ihrer Mutter)/ Ajo i ngjan asaj. (nënës së saj)

Sipas tij raportet plotësuese ose përcaktuese në një fjali mund të jepen nëpërmjet formave të ndryshme të kundrinave:

“Kasus des Substantivs (ergänzende Beziehungen)

- *Präposition (Raumverhältnisse)*
- *Zeit- und kausale Verhältnisse*
- *Adverb (Verhältnis der Art und Weise)/*

Rasa e emrit (raporte plotësuese)

Parafjala (raporte hapësinore)

Raportet kohore dhe shkakore

Ndajfolje (raporte të mënyrës)”¹⁷

¹⁵ Becker, Karl Ferdinand: *Ausführliche deutsche Grammatik als Kommentar der Schulgrammatik*; Frankfurt am Main 1837, f.3

¹⁶ Po aty, f.110-111

¹⁷ Po aty, f.118

Dhe në veprën e tij të mëvonshme “Organism der Sprache”/ Organizmi i gjuhës, botuar në 1841, Bekeri i jep një vend të veçantë kallëzuesit. “*Der ganze Satz drückt die Einheit des Prädikates als des Hauptbegriffes und des Subjektes als des Beziehungsbegriffes aus; und man nennt dieses Beziehungsverhältnis das prädikative.*”/ E gjithë fjalia shpreh njësinë e kallëzuesit si term kryesor dhe të kryefjalës si term të raportit; dhe ky raport quhet kallëzuesor”¹⁸

Më tej ai shprehet se, „*Endlich entwickelt sich auch das Prädikat zu einem Satzverhältnisse, indem die Thätigkeit mit einem Sein als Objekt – das Verb mit einem regirten Substantiv – auf mancherlei Weise in Beziehung tritt.*”/ Më në fund dhe kallëzuesi po zhvillohet tek raportet e fjalisë, në të cilat veprimtaria me një të qenë si kundrinë- folja me një emër të sunduar prej saj, në njëfarë mënyre po hyjnë në raport me njëra tjetrën”¹⁹

Nga sa u tha më sipër del qartë se ai e vendos kallëzuesin në qendër të fjalisë dhe njeh termin kundrinë.

Bekeri shkruan për „objektiven Beziehungsformen“/ raportet objektore, në të cilat bëjnë pjesë “Kasus des Substantivs/ rasa e emrit”, “Substantiv mit einer Präposition/ emër me një parafjalë” dhe “Adverb/ ndajfolja”. Format e “Ergänzungen / plotësive” shprehen sipas tij me anë të rasës, parafjalës ose ndajfoljes. Ai bën dallimin mes plotësive të detyrueshëm dhe atyre fakultativ duke u nisur nga folja si thelbi i fjalisë. Kjo nuk është gjë tjetër në fakt veç ndryshimit mes kundrinës dhe rrethanorit, duke qenë se Bekeri i përfshin të dyja në një kategori, atë të “Ergänzungen”/ plotësia. Kundrinat, në ndryshim nga rrethanorët, ai i quan plotësia të detyrueshëm. Këtë ai e ilustron me anë të fjalisë:

Er trinkt Wein./ Ai pi verë.

Duke u nisur nga folja si thelbi i fjalisë ai argumenton se folja trinken në këtë rast kërkon një rrethanor (Angabe) të detyrueshëm të asaj që është pirë. Er trinkt./ Ai pi. Sipas tij do të ishte një fjali jo e saktë në aspektin gramatikor.²⁰

Teorinë e tij e kritikon Haselbah (Haselbach) i cili shprehet se, “*Das objektive Satzverhältnis allein ist nicht dazu fähig, einen vollständigen Satz auszudrücken. Es muss, genauso wie das „attributive Satzverhältnis“, immer auf das prädikative Satzverhältnis zurückgreifen, indem das Objekt (ein Lied) das im prädikativen Satzverhältnis enthaltene Prädikat (singen) „individualisiert“. Im attributiven Satzverhältnis hingegen „individualisiert“ das Attribut (muntere) das Subjekt (die Vögel).*”/ Vetëm marrëdhënia objektore nuk mjafton për të shprehur një fjali të plotë. Ashtu si raporti atributiv i fjalisë, asaj i duhet gjithnjë ti referohet raportit kallëzuesor,

¹⁸Becker, Karl Ferdinand: *Organism der Sprache*; Frankfurt am Main 1841, f. 230

¹⁹ Po aty

²⁰Becker, Karl Ferdinand: *Organism der Sprache*; Frankfurt am Main 1841, f. 313

ku kundrina (një këngë) “individualizon” kallëzuesin e përfshirë në raportin kallëzuesor të fjalisë. Ndërsa në të kundërt, në raportin përcaktor të fjalisë, përcaktori (të shkathët) “individualizon” kryefjalën (zogjtë).”²¹ Kjo do të thotë sipas tij se vetëm në marrëdhënien kallëzuesore të fjalisë përfshihen të dy gjymtyrët elementare të fjalisë (kryefjalë dhe kallëzues). Haselbahu gjithashtu konstaton se përsa i përket terminologjisë së përdorur nga Becker, ai fillimisht përdorte termin kallëzuesor (objektiv) për përcaktimin e gjymtyrës së fjalisë, term nga i cili hoqi dorë më vonë. Ndërsa kallëzues (objekt) ai quante mendimin e fjalisë. Pra rrafshi i mendimit dhe ai gjuhësor sipas Beckerit nuk ndahen dot qartësisht nga njëra tjetra. Haselbahu gjithashtu shprehet se tek Bekeri kemi të bëjmë me një konfuzion të kriterëve përcaktues të mendimit të fjalisë dhe të atyre të terminologjisë së gjymtyrëve të fjalisë.

Bekeri përpiqet gjithashtu të bëjë dallimin mes kundrinave dhe rrethanorëve, dmth mes gjymtyrëve të detyrueshme të fjalisë dhe atyre jo të detyrueshme (fakultativ/obligatorisch). Këtë dallim ai e bën brenda grupimit sipas tij të marrëdhënieve kundrinore të fjalisë. Kundrinat ai i dallon me anë të rasave gjinore, kallëzore, dhanore ndërsa rrethanorët i ndan në vendi, kohe, shkaku dhe mënyre.

Megjithë përdorimin e termit “Objektiv”/ kundrinë apo Substantiv mit einer Präposition/ emër me një parafjalë, në veprën “Organism” të Beckerit nuk figuron askund kundrina me parafjalë. Ai e rendit atë tek rrethanorët duke mos bërë ende një ndarje të qartë.

Haselbahu shprehet gjithashtu se Bekeri i përkufizon raportet e fjalisë si nga ana logjike dhe nga ajo gramatikore, çka tingëllon konfonduese. “*Trotz der (angestrebten) Trennung stehen die logische und die grammatische Form des Satzes „in innigem Zusammenhang“.*”/ Megjithë ndarjen e tyre, forma logjike dhe ajo gramatikore e fjalisë mbeten të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën.”²²

Është thënë dhe më lart se gjuhëtarët në përgjithësi i kundërshtuan tezat e Beckerit, pasi konstatuan disa mangësi në to. Sipas Busman, “*Diese Mängel kann man aus heutiger Sicht noch weiter ausführen: So bleiben z. B. die funktionalen Aspekte der Kommunikation unberücksichtigt, da die traditionelle Grammatik stark auf die Einordnung sprachlicher Elemente in Klassen fixiert ist.*”/ Këto mangësi vërehen ende në ditët e sotme. Kështu p.sh mbeten të papërfillura aspektet e komunikimit, dukeqenëse gramatika tradicionale është e përqendruar tek klasifikimi i elementëve gjuhësorë në kategori të veçanta.”²³ Kriteret e këtij klasifikimi si dhe përkufizimi i terminologjisë, bëhen sipas Busman pa një sistem arsyetimi të njehsuar. Rregullat e këtij modeli gramatik nuk janë të mjaftueshëm dhe madje pjesërisht intuitivë.

²¹Haselbach, Gerhard: *Grammatik und Sprachstruktur. Karl Ferdinand Beckers Beitrag zur Allgemeinen Sprachwissenschaft in historischer und systematischer Sicht.* – Berlin: de Gruyter, 1966, f.160

²²Po aty, f.165

²³Bußmann, Hadumod: *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart 1983, f. 339-340

Shpjegimet gramatikore janë shpesh një përzierje mes aspekteve sinkronike dhe atyre, çka u kritikua gjerësisht më vonë nga përfaqësuesit e strukturalizmit. Megjithatë vlen të ritheksohet se të gjitha modelet e reja gramatikore, bazohen tek të dhënat dhe përfundimet e gramatikës tradicionale.

2.1.4.Fridrish Blac (Friedrich Blatz)

Fridrish Blac, botoi në vitin 1885 dhe 1896 veprën e tij “Neuhochdeutsche Grammatik mit Berücksichtigung der historischen Entwicklung der deutschen Sprache” / Gramatikë e gjermanishtes së sotme dhe e zhvillimit historik të gjuhës gjermane”. Vëllimi i parë përbëhet nga hyrja, fonetika dhe morfologjia, ndërsa në vëllimin e dytë përshkruhet në mënyrë mjaft të detajuar sintaksa. Këtë gramatikë ai e hartoi për mësuesit e gjuhës gjermane, në mbështetje të orës së mësimit të gjuhës. Gramatika etij e lidhi mësimin e gjuhës me gjuhësinë historike krahasuese.

Vërehet se ndarja në gjymtyrë fjalie e kundrinës tek Blac bëhet në të njëjtën mënyrë si tek Beker. Ai dallon gjymtyrët e mëposhtme:

- Kallëzues
- Kryefjalë
- Kundrinë
- Rrethanor.

Risi përbën fakti se ai përcakton katër lloje kundrinash, të cilat i përcakton si gjymtyrë kryesore: kundrinë të rasës kallëzore, kundrinë të rasës dhanore, kundrinë të rasës gjinore dhe kundrinë me parafjalë. Në veprën e tij gjithashtu gjenden shpjegime të dallimit mes kundrinës e rrethanorit.

Tek fjalia e mëposhtme do shohim klasifikimin e gjymtyrëve të bërë prej tij:

Manfred liest im Wohnzimmer am Abend die Zeitung.

Manfredi lexon në mbrëmje gazetën në dhomën e ndenjjes.

Kryefjala: Manfred/ Manfredi

Kundrina e rasës kallëzore: die Zeitung/ gazetën

Kallëzuesi: liest/ lexon

Rrethanor vendi: im Wohnzimmer/ në dhomën e ndenjjes

Rrethanor kohe: am Abend/ në darkë.

Një dobësi të dukshme këtu përbën shumëllojshmëria e kriterëve, të cilat përdoren për përcaktimin e gjymtyrëve të fjalisë. Të njëjtin mendim ndajnë dhe gjuhëtarë të tjerë përse i përket mosnjehsimit të kriterëve klasifikuese. Kjo do të thotë se nuk duhet që një gjymtyrë e caktuar të identifikohet duke u nisur nga kriteret morfosintaksore, ndërsa

një tjetër duke u nisur nga ato kuptimore sintaksore, por duhet që për përcaktimin e gjymtyrëve të të njëjtit rang të përdoren kritere identifikuese të të njëjtit rrafsh, në mënyrë që për shembull për përcaktimin e gjymtyrëve të përdoren ose kritere morfo-sintaksore ose kuptimore- sintaksore. Kjo shihet qartë tek dallimi i paqartë mes rrethorëve dhe kundrinave:

Er schlief **die ganze Nacht**./ Ai fjeti gjithë natën.

Sipas një përcaktimi krejtësisht formal, dmth morfosintaksor të kundrinës, “gjatë gjithë natës” duhej të ishte kundrinë e rasës kallëzore, çka hidhet poshtë me anë të mjeteve të gramatikës tradicionale. Së pari me anë të zëvendësimit me një përemër:

Sie schlief ihn./ Ajo fjeti atë.

Dhe së dyti me anë të provës me pyetje analitike.:

Was schlief sie?/ Çfarë fjeti ajo?

Përcaktimi i gjymtyrëve tek Blac është i njëjtë si tek Beker, por risi tek vepra e Blac përbën fakti se ai është gjuhëtari i parë gjerman, i cili përdori i pari termin ‘präpositionalobjekt’/ kundrinë me parafjalë në gramatikën e tij. Në lidhje me këtë ai shprehet si vijon: „*Das Präpositionalobjekt. Manche Ergänzungen des Prädikats werden, statt durch einen unmittelbaren Kasus, durch einen Präpositionalkasus ausgedrückt (Präpositionalobjekt, Vorwortobjekt).*”/ Kundrina me parafjalë. Disa plotësa të kallëzuesit, në vend të shprehen thjesht me anë të rasës, shprehen me anë të rasës me parafjalë (kundrinë me parafjalë). Këtë ai e ilustron me shembujt në vijim²⁴:

Ich bitte nicht um mein Leben (=ich erbitte nicht mein Leben)./ Nuk lutem për jetën time.

Ich flehe dich um drei Tage Zeit./ Të përgjërohem për tri ditë kohë.

Der brave Mann denkt an sich selbst zuletzt./ Burri trim mendon në fund për veten.

Die Fluren dürsten nach erquickendem Tau./ Toka është e etur për vesën freskuese.

Wir sprechen von dem Nutzen der Geschichte (=besprechen den Nutzen)./ Ne flasim për dobinë e historisë.

Më tej ai shprehet se kundrina me parafjalë dallon nga rrethorori, nga fakti se ajo nuk shpreh marrëdhënie hapësinore, kohore, mënyre apo shkakore. Gjthashtu rrethorët i sheh si gjymtyrë fakultative.²⁵:

²⁴Blatz, Friedrich: *Neuhochdeutsche Grammatik mit Berücksichtigung der historischen Entwicklung der deutschen Sprache*. 3., völlig neubearbeitete Auflage 2. Bd.: Satzlehre (Syntax). –Karlsruhe 1896 (Nachdruck: Hildesheim) New York 1970, f.19

²⁵Po aty

Du fragest **nach den Riesen** (Objekt), du findest sie nicht mehr./ Ti pyete për gjigandët (kundrinë), ata nuk i gjen më.

Er starb **nach langem Leiden**(Adverb)./ Ai vdiq pas vuajteve të gjata. (rrethanor)

Bösewichte berufen sich **auf die Schlechtigkeit anderer Menschen**(Objekt)./ E keqja i ka rrënjët tek ligësia e njerëzve të tjerë. (kundrinë)

Wir sind **auf nächsten Sonntag** eingeladen (Adverb)./ Ne jemi ftuar të djelën e ardhshme. (rrethanor)

Gjithashtu ai shton se në rastin kur folja merr dy kundrina, një frymor dhe një send, në rastin kur kundrina që përcakton frymorin është në rasën kallëzore, kundrina që përcakton sendin është zakonisht në rasën gjinore, ose me parafjalë, më rrallë në rasën kallëzore.²⁶:

Man entledigte **mich der Bande**. / Më likujduan nga banda.

Wir erinnerten **den Vater an sein Versprechen**./ Ne i kujtuam babait premtimin e tij.

Lehre **mich Bescheidenheit!**/ Më mëso modestinë!

Ndërsa në rastin kur kundrina e rasës kallëzore përcakton një send, kundrina tjetër që përcakton frymor do jetë në rasën dhanore, ose me parafjalë.:

Gewährt **dem Freunde seine Bitte**./ Plotësojani shokut lutjen e tij.

Ich habe **einen Brief an meinen Vormund** geschrieben./ I kam shkruar një letër paraardhësit tim.

Në tabelën e mëposhtme do sjell një renditje të gjymtyrëve “klasike” të fjalisë në gjuhën gjermane, dmth ato të përdorura kryesisht në gramatikën tradicionale që u shqyrtua deri tani. Klasifikimi i gjymtyrëve të fjalisë tek kjo gramatikë bazohet tek logjika duke bashkuar motive formale dhe semantike. Kjo besoj të jetë dhe arsyeja pse kjo teori gramatikore në përgjithësi nuk është pranuar ose është përpunuar më tej nga përfaqësues të teorive të tjera sintaksore.

Gjymtyra	Përshkrimi	Kriteri
Kryefjala	Gjymtyrë në rasën emërore	formal

²⁶Po aty

Kallëzuesi	Folja	formal
Kundrina	<ul style="list-style-type: none"> • Kundrinë e rasës gjinore • Kundrinë e rasës dhanore • Kundrinë e rasës kallëzore • Kundrinë me parafjalë 	formal sintaksor
Rrethanori	<ul style="list-style-type: none"> • Rrethanor vendi • Rrethanor kohe • Rrethanor mënyre • Rrethanor shkaku 	semantik
Përcaktor		funksional

Kadzadej evidenton disa mangësi të kësaj teorie gramatikore. Sipas saj kjo teori nuk jep një përkufizim gjithpërfshirës të gjymtyrës së fjalisë, pasojë kjo e klasifikimit të panjehsuar që i bëhet gjymtyrëve, duke përdorur herë kriterin funksional gramatikor e herë atë semantik. Një pikë tjetër e dobët të kësaj teorie sipas saj përbën dhe përfshirja e përcaktorëve tek gjymtyrët e fjalisë, dukeqenëse ato janë pjesë të gjymtyrëve të fjalisë. Gjithashtu sipas saj kjo teori nuk është në gjendje të qartësojë p.sh., nëse në togefjalëshin “die alte Linde”/ Linda e vjetër, përcaktori është vetëm ‘alte’, apo ‘die alte’. Gjithashtu ajo ngre dhe problemin e dallimit mes kundrinës dhe rrethanorit duke u shprehur se kjo teori gramatikore nuk ka qenë në gjendje të bëjë një dallim të saktë mes tyre.²⁷

Në vijim, në rend kronologjik, do paraqes gramatikën tradicionale dhe atë shkollore të viteve të fundit me anë të shembujve konkretë.

2.2.Gramatika tradicionale e shekullit të 21

2.2.1.Dora Shulc/ Hans Grizbah (Dora Schulz/ Hans Griesbach)

Një gramatikë e rëndësishme është ajo e Schulc/ Grizbah me titull “Grammatik der deutschen Sprache”/ Gramatika e gjuhës gjermane, botuar në 1960 dhe e ribotuar 11 herë. Kjo është një gramatikë e cila i shërben atyre që dëshirojnë të thellojnë njohuritë e tyre në gjuhën gjermane qofshin të huaj apo jo. Kusht është që të kenë njohuri paraprake të mira të gjuhës gjermane. Fillimisht kundrinat në këtë gramatikë përmenden tek krerët ku trajtohen rasat dhe funksioni i tyre si morfema të veçanta. “*Der Akkusativ kennzeichnet bei transitiven Verben im Prädikat das ‘direkte’ Objekt; Frage:*

²⁷Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f. 16

wen? Bei Personen und was? Bei Sachen, Begriffen und Sachverhalten./ Kallëzorja shpreh në rastin e foljeve kalimtare në kallëzues kundrinën e drejtë; pyetja: kë? Për frymoret dhe kush? për sende.”²⁸ Në vijim ata bëjnë specifikimet gramatikore dmth morfologjike të rasës kallëzore siç janë llojet e foljeve që kërkojnë këtë rasë dhe parafjalët që kërkojnë këtë rasë etj.. Po kështu vijohet dhe me rasën dhanore e atë gjinore. Më pas në kreun ku trajtojnë parafjalët, përmendet gjithashtu kundrina me parafjalë.: *”Eine große Anzahl von Verben verlangt die Kennzeichnung des Objekts durch Präpositionen. Objekte, die mit solchen losen Morphemen gekennzeichnet sind, bezeichnet man als Präpositional Objekte./* Një numër i madh i foljeve kërkojnë përcaktimin e kundrinës me ndihmën e parafjalës. Kundrinat të cilat shoqërohen me morfema të tilla, quhen kundrina me parafjalë.”²⁹

Më tej ata i përkufizojnë kundrinat si: *“Objekt sind alle bei der Beschreibung eines Sachverhalts genannte Rollen, die nicht Subjekt sind. Die Anzahl der Objekte, entweder ein Objekt, oder zwei Objekte, wird von der Art und der Darstellungsweise eines Sachverhalts bestimmt. Welches Funktionskennzeichen das Objekt annimmt, hängt vom Geschehen ab und von dem Verb, das im Prädikat das Geschehen nennt./* Kundrina janë të gjitha rolet e përkufizimit të situatës që nuk janë kryefjalë. Numri i kundrinave, një, ose dy kundrina, përcaktohet nga ngjarja dhe nga folja që përcakton ngjarjen.”³⁰

Ata i ndajnë më tej kundrinat në katër lloje, duke i ilustruar me shembuj përkatës: kundrinë e rasës kallëzore, kundrinë e rasës dhanore, kundrinë e rasës gjinore dhe kundrinë me parafjalë. Gjithashtu për secilën kundrinë përcaktojnë pyetjen analitike me anë të së cilës identifikojnë kundrinën, përkatësisht ‘kë?’ dhe ‘çfarë?’ për kundrinën e rasës kallëzore, ‘kujt?’ për kundrinën e rasës dhanore, ‘i kujt?’ për atë të rasës gjinore dhe ‘kë?’ e shoqëruar me parafjalën përkatëse të përdorur për kundrinën me parafjalë.

Risi përbën fakti se mjetet morfologjike me anë të së cilave shprehet kundrina, ata i ndajnë jo si në gramatikat e tjera tradicionale, ku ndarja bëhet sipas rasës, por sipas anës kuptimore dmth. asaj çfarë shpreh kundrina, duke ilustruar me shembuj.

Sipas tyre personat shprehen në kundrinë me anë të emrave, përemrave, mbiemrave dhe foljeve. Bie në sy fakti se me mbiemra, ndajfolje dhe folje në këtë rast gjuhëtarët i referohen atyre të emëruar, megjithëse nuk e cilësojnë këtë fakt, çka mund të jetë konfunduese për lexuesin.:

Peter dankt seinem Vater **für das Geschenk.**/ Peteri falënderon babain për dhuratën.

Du machst **mir** Angst./ Ti më frikëson.

Kennst du **die Alte**?/ E njeh plakën?

Helft **den Verletzten.**/ Ndhmoni të plagosurin.

²⁸Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f.218:

²⁹Po aty, f 250

³⁰Po aty f. 336

Sendet shprehen në kundrinë me anë të emrave, përemrave dhe togfjalëshave.

Der Regen hat **der Ernte** sehr geschadet./ Shiu ka dëmtuar shumë të mbjellat.

Ich habe **es** mit interesse gelesen./ E lexova atë me interes.

Liebst du **Vergißmeinnicht**?/ Të pëlqen lulja mos më harro?

Termat shprehen me anë të emrave, përemrave, mbiemrave, ndajfoljeve.

Man muß **die Armut** bekämpfen./ Duhet luftuar varfëria.

Wir werden uns heute **über moderne Kunst** unterhalten, gestern haben wir **sie** ja bereits im Unterricht behandelt./ Sot do flasim për artin modern, dje e kemi trajtuar atë në orën e mësimi.

Wir suchen nur **das Gute** im Menschen./ Ne kërkohet vetëm të mirën tek njerëzit.

Glaubt er an seinem Erfolg? Er glaubt **daran**./ Beson ai tek suksesi i tij? Ai beson aty.

Ndërsa situatat shprehen në kundrinë me anë të emrave:

Wir warteten eine halbe Stunde auf **die Ankunft der Gäste**./ Ne pritëm një orë **mbërritjen e mysafirëve**.

Tek Schulz/ Griesbach ndeshim gjithashtu “*Geschehen sein werden im Objekt bezeichnet von Verben und infinitiv Konstruktionen*./ Ngjarjet shprehen në kundrinë me anë të foljeve dhe ndërtimeve me paskajore.”³¹

Peter lernt **schwimmen**./ Peteri mëson të notojë.

Në këtë rast si u pa tek shembulli më lart ata quajnë vërtet një pjesë të foljes kundrinë. Kjo bie ndesh me shumë gjuhëtarë të tjerë, të cilët në këtë rast ‘schwimmen’/ notoj do e quanin si plotës të foljes: ‘funktionsverbgefüge’. Në përgjithësi gjuhëtarët bien dakort që asnjë gjymtyrë tjetër e fjalisë përveç kallëzuesit nuk mund të shprehet me folje.

Der Arzt empfiehlt, **den Kranken sofort zu operieren**./ Mjeku rekomandon të operohet menjëherë i sëmurë.

2.2.2.Gerard Helbig (Gerhard Helbig)

Tek “Deutsche Grammatik”/ Gramatika e gjuhës gjermane, shkruar nga gjuhëtari gjerman Gerard Helbig, botuar në 1993, gramatikë e cila përfshin morfologjinë dhe sintaksën, ose siç i quan ai ‘Wort’/ fjala dhe ‘Satz’/ fjalia duke lënë jashtë fonetikën dhe leksikologjinë, gjejmë përkufizimin e mëposhtëm për kundrinën, të cilën e radhit tek gjymtyrët kryesore të fjalisë: “*Das Objekt ist eine Substantiv- oder Präpositionalgruppe, die obligatorisch oder fakultativ steht und vom Prädikat*

³¹Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f.339

abhängig ist, die morphologisch durch ein Substantiv im Akkusativ, Dativ, Genitiv oder durch Präposition + Substantiv oder durch entsprechendes substantivisches Pronomen repräsentiert wird./ Kundrina është një grup emëror ose parafjalor, i cili është i detyrueshëm ose fakultativ dhe varet nga kallëzuesi. Në aspektin morfologjik shprehet me një emër në rasën kallëzore, dhanore, gjinoreose me një parafjalë + emër, ose me anë të përemrit vetor përkatës.”³²

Më tej ai dallon katër lloje kundrinash: kundrina e rasës kallëzore, kundrina e rasës dhanore, kundrina e rasës gjinore dhe kundrina me parafjalë duke i ilustruar me shembujt përkatës.

Kundrina e rasës kallëzore sipas tij “...im Unterschied zu allen anderen Objekten- bei einer Passivtransformation zum Subjekt des Passivsatzes wird und bei eine Nominalisierung zum Genitivattribut (bei Pronomen zum Possesivpronomen) werden kann/ ...në ndryshim nga kundrinat e tjera bëhet kryefjalë në rastin e kthimit të fjalisë në pësore dhe kthehet në përcaktor të rasës gjinore në rastin e emërzimit të foljes”³³:

Er rezisiert **das Buch (es)**. / Ai redakton librin.

Das Buch (Es) wird von ihm rezisiert./ Libri (ai) redaktohet prej tij.

Das Rezesieren **des Buches (sein Rezesieren/ seine Rezesion)**/ Redaktimi i librit (redaktimi i tij/ redaktimi prej tij)

Ndërsa tri kundrinat e tjera sipas Helbig kthehen në përcaktorë parafjalorë.

Përveç kundrinave të sipërpërmendura të cilat varen nga folja, Helbig dallon dhe kundrinën që varet nga mbiemri, të cilat gjithashtu sipas tij mund të përfaqësohen nga emra ose përemra vetorë në rasën kallëzore, dhanore, gjinore ose me parafjalë.³⁴:

Die Ware ist **ihr Geld** wert./ Malli ia vlen.

Er ist **seinem Bruder** ähnlich./ Ai i ngjan vëllait të tij.

Er ist **seines Freundes** würdig./ Ai është i denjë për shokun.

Sie ist böse **auf den Lehrer**./ Ajo është e mërzitur me mësuesin.

Gjithashtu tek kreu për rrethanorët Helbig ngre çështjen e dallimit mes rrethanorëve dhe kundrinave, duke dhënë një sqarim shumë të qartë për lexuesin e duke e ilustruar me shembuj.

Një nënkre të veçantë Helbig i kushton të ashtëquajturave prej tij gjymtyrë të dyta, të cilat i ndan në dy lloje: në gjymtyrë të dyta të fjalisë dha në gjymtyrë të dyta të gjymtyrëve të veçanta. Gjymtyrë të dyta të fjalisë ai përkufizon: “*d.h. die nicht vom*

³²Helbig, Gerhard, Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss, 2. Aufl., München, 1993, f. 111

³³Po aty, f. 112

³⁴Po aty, f. 113

Prädikat des Satzes determiniert und nicht zum Grundstruktur gehören./ dmth që nuk varen nga kallëzuesi i fjalisë dhe nuk i përkasin strukturës bazë.”³⁵Ndër to ai përmend dhe lloje të ndryshme të dhanores së lirë (freier Dativ), që ai i cilëson jo si kundrina, megjithëse shprehen me emra në rasën dhanore:

Dhanorja komodi (Dativus commodi): Er trägt **seiner Mutter** das Gepäck./ Ai i mban bagazhin nënës së tij.

Dhanorja inkomodi (Dativus incomodi): Der Schlüssel fiel **dem Jungen** ins Wasser./ Çelësi i ra djalit në ujë.

Dhanorja e masës (Dativus des Maßstabs): Er arbeitet **dem Chef** zu langsam./ Për shefin ai punon shumë ngadalë.

Dhanorja etike (Ethischer Dativ): Falle **mir** nicht!/ Mos më bjer!

Tek gjymtyrët e dyta të fjalëve ai përmend dhe ‘...*der posesive Dativ, ein “freier” Dativ, der nicht- wie der Objektsdativ- vom Prädikat, sondern von anderen substantivischen Gliedern abhängt, der eine Person bezeichnet, zu der ein Körperteil gehört, der seine seits als Subjekt (Dem Kranken tat der Magen weh), als Objekt (Der Arzt operierte dem Kranken den Magen), oder als Adverbialbestimmung (Er sieht seinem Freund in die Augen) ausgedrückt ist./ ...dhanorja posesive, një dhanore e lirë, e cila ndryshe nga kundrina e rasës dhanore, nuk varet nga kallëzuesi, por varet nga gjymtyrë të tjera emërore. Ai përcakton një njeri, të cilit i përket një pjesë trupi, i cili shprehet me kryefjalë (Të sëmurit i dhimbte stomaku), me kundrinë (Mjeku i operoi stomakun të sëmurit), ose si rrethor (Ai e sheh në sy shokun e tij).’³⁶*

2.2.3.Elke Henschel/ Harald Veid (Elke Hentschel/ Harald Weydt)

Libri me titull ‘Handbuch der deutschen Grammatik/ Metodë e gramatikës gjermane’, me autorë Hentshel/Veid (Hentschel/Weydt), është një tekst mjaft interesant, i cili përveç një paraqitje sipas modelit tradicional të gramatikës së gjuhës gjermane, përfshin dhe një përmbledhje të teorive të ndryshme gramatikore. Teksti trajton morfologjinë dhe sintaksën.

Ata e përkufizojnë kundrinën si vijon: “ *Das Objekt steht dem Subjekt in der Philosophie, wie auch in der Grammatik als Gegenstand des Wahrnehmens, Erkennens, Denkens und Handelns gegenüber. Das grammatische Objekt bindet das direkte oder indirekte Ziel des im Verb ausgedrückten Vorgangs. Bei flektierenden Sprachen steht es in einem obliquen Kasus, der entweder vom Verb direkt, oder unter Zuhilfenahme einer Präposition regiert wird; im letzteren Fall spricht man von einem Präpositional Objekt./* Kundrina i qëndron përballë kryefjalës në filozofi si dhe në gramatikë si objekt i perceptimit, njohjes, mendimit dhe veprimit. Kundrina në gramatikë lidh synimin direkt ose indirekt të veprimit të shprehur nga folja. Tek gjuhët

³⁵Po aty, f. 115

³⁶Po aty

me fleksion qëndron në një rasë oblique, e cila drejtohet ose direkt nga folja, ose me ndihmën e një parafjale, në rastin e fundit kemi të bëjmë me kundrinë me parafjalë.”³⁷

Henshel/ Veid bëjnë klasifikimin e kundrinave sipas kritereve semantik si vijon³⁸:

1. ‘affiziertes Objekt’ / e cila pëson një ndryshim nga veprimi i shprehur nga folja.:

Sie streicht **die Fenster**./ Ajo lyen dritaret.

2. ‘effiziertes Objekt’, e cila është rezultat i veprimit të shprehur nga folja.:

Sie schreibt **einen Brief**./ Ajo shkruan një letër.

3. ‘direktes Objekt’/ kundrina drejtë, e cila preket direkt nga veprimi i foljes.:

Sie liest **das Buch**/ Ajo lexon librin.

Sipas tyre në gjuhën gjermane kundrina e drejtë përkon gjithmonë me kundrinën e rasës kallëzore.

4. ‘indirektes Objekt’/ kundrina e zhdrejtë, e cila preket tangent nga veprimi i shprehur nga folja. :

Sie liest **ihrer Schwester vor**./ Ajo i lexon motrës së saj.

Shpeshherë sipas tyre kundrinat e zhdrejta përkojnë me kundrinën e rasë dhanore.

5. ‘i ashtuquajturi ‘verkappte objekt’, nuk mund të përkufizohet si i tillë në aspektin sintaksor, por vetëm në atë semantik.:

Außer **eine Scheibe Brodt** habe ich heute noch nichts gegessen./ Përveç një fete bukë nuk kam ngrënë gjë tjetër sot.

Nga ana formale në këtë rast kemi të bëjmë me një përcaktor, por nga kuptimi rezulton se ‘një copë bukë’ gjithashtu ka lidhje me veprimin ‘ha’.

Më tej ata i klasifikojnë kundrinat sipas kriterit gramatikor të rasës³⁹, duke i ndarë në kundrinë të rasës kallëzore, kundrinë të rasës dhanore, kundrinë të rasës gjinore dhe kundrinë me parafjalë.

Klasifikimin e tyre ata e bëjnë nëpërmjet përemrit përkatës pyetës, dmth pyetjes analitike si dhe transformimit të fjalisë në fjali pësore. Gjithashtu rendisin dhe kategoritë morfologjike me të cilat mund të shprehen kundrinat përkatëse duke ilustruar me shembuj. Një nënkre të veçantë ata i kushtojnë dhe dallimit mes kundrinës dhe rrethanorit.

³⁷Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York 1990, f. 325

³⁸Po aty, f. 328

³⁹Po aty, f. 330- 339

Një nënkre tjetër në këtë tekst është dhe ai rreth të ashtëquajturave ‘Objekte des zweiten Grades/ kundrina të gradës së dytë’⁴⁰. Sipas tyre, këto kundrina nuk varen nga një folje, por nga një ndajfolje kallëzuese (prädikatives Adjektiv). Ata dallojnë më tej kundrina të gradës së dytë të rasës kallëzore, kundrina të gradës së dytë të rasës dhanore, kundrina të gradës së dytë të rasës gjinore dhe kundrina të gradës së dytë me parafjalë.:

Er ist **ihr** böse./ Ai u mërzi me atë.

Dieses Buch ist kein **Pfifferling** Wert./ Ky libër nuk vlen një grosh.

Er war **des Diebstahls** verdächtig./ Ai u akuzua për vjedhje.

Das Kind ist **auf Hilfe** angewiesen./ Fëmijës i është rekomanduar ndihmë.

2.2.4.Duden

Për shkak se gramatika tradicionale e viteve të fundit ka marrë impulse nga gramatika e Hans Glincit si dhe nga ajo e valencës dhe dependencës, tek Duden hasim shpesh përkufizimin e gjymtyrëve të fjalisë, të cilat plotësojnë kallëzuesin. “*Wesentlich vom Verb hängt ab, wieviele und welche weiteren Elemente im Satz vorkommen kommen und oft auch müssen.*”⁴¹Në gramatikën e Dudenit, ndiqet metoda operacionale funksionale e dallimit të gjymtyrëve të fjalisë, përfaqësues kryesor i së cilës është gjuhëtari zviceran Hans Glinz, i cili ka zhvilluar i pari provën e tingullit (Klangprobe), provën e spostimit (Verschiebeprobe), provën e zëvendësimit (Ersatzprobe), provën e eliminimit (Weglassprobe) dhe atë të transformimit (Umformungsprobe) për të identifikuar gjymtyrët e fjalisë. Kështu dhe tek Duden ato segmentohen në bazë të kriterit të spostimit dhe zëvendësimit, dhe klasifikohen më tej në bazë të kriterit morfologjik të rasës siç është rasti i kryefjalës e kundrinës, si dhe nëpërmjet kuptimit si në rastin e rrethanorëve. Gjithashtu një ndihmesë për dallimin e kundrinave përbën dhe pyetja analitike nëpërmjet përemrit përkatës pyetës. Kundrinat sipas Duden ndahen sipas kriterit morfologjik të rasës, në kundrinë të rasës kallëzore, kundrinë të rasës dhanore, kundrinë të rasës gjinore dhe kundrinë me parafjalë.

Veçanërisht gjatë ndalet tek kundrina me parafjalë. Aty sqarohet hollësisht dallimi mes kundrinës me parafjalë dhe gjymtyrëve të tjera me parafjalë që nuk janë kundrinë, çka sipas Duden realizohet në tre mënyra⁴²:

“1.Ein Präpositionalobjekt liegt vor, wo im Präpositionalgefüge vom Prädikat eine ganz bestimmte Präposition gefordert ist./ Parafjala është zakonisht e pazëvendësueshme, ose dhe nëse ajo mund të zëvendësohet me një parafjalë tjetër nuk kemi ndryshim të kuptimit.”:

⁴⁰Po aty. F. 339- 343

⁴¹Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich:

Dudenverlag 1994, f. 566

⁴²Po aty, f. 577- 579

Die Maschaften warteten **auf den Anpfiff**./ Skuadrat pritën fërshëllimën.

Der Lehrer berichtet **bei seiner Reise/ von seiner Reise**./ Mësuesi rrëfen rreth udhëtimit të tij/ për udhëtimin e tij.

“2.Präpositionalobjekte sind diejenigen Präpositionalgefüge, die beim Ersatz durch nicht im Kasus bestimmte Glieder nur Pronominaladverbien zulassen./ Kundrina me parafjalë janë ato plotësues (Präpositionalgefüge), të cilat gjatë zëvendësimit me anë të gjymtyrëve të pazgjedhueshme, mund të zëvendësohen vetëm me ndajfolje pronominale.”:

Die Manschaften warteten **auf den Anpfiff/ darauf**./ Skuadrat pritën fërshëllimën/ atë.

“3.Auf der gleichen Unterscheidungsgrundlage kann man auch unterschiedliche Hilfsfragen ansetzen: Das Präpositionalobjekt erfragt man mit einer Frage deren notwendiger Bestandteil die Präposition ist, die im Präpositionalobjekt steht./ Pyetje ndihmëse mund të përdoren në të njëjtën bazë dallimi. Për kundrinën me parafjalë përdorim një pyetje, pjesë e së cilës është parafjala që është pjesë e kundrinës me parafjalë.”:

Auf wenn/was warteten die Manschaften? – Die Manschaften warteten **auf den Anpfiff**./ Çfarë prisnin skuadrat? – Skuadrat prisnin fërshëllimën.

Tek Duden gjejmë dhe gjymtyrë të tjera në rasën kallëzore, të cilat nuk janë kundrina⁴³. P.sh. ‘Gleichsetzungsnominativ’, e cila është një gjymtyrë në rasën kallëzore, që varet nga kryefjala.

Ich nenne ihn **einen Lügner**./ Unë e quaj atë një gënjeshtar.

Një tjetër gjymtyrë në rasën kallëzore që nuk është kundrinë sipas Duden është kallëzorja absolute (Absoluter Akkusativ):

Neben ihm saß der dünnhaarige Pianist, **den Kopf im Nacken**, und lauschte.../ Pranë tij qëndronte ulur pianisti i hollë e flokëkuq, me kokën e mbështetur, dhe pëshpëriste...

Gjithashtu tek Duden gjendet dhe kallëzorja ndajfoljore (Adverbialakkusativ) dhe gjinorja ndajfoljore (Adverbialgenitiv) të cilat dallojnë nga kundrinat se nuk janë të zëvendësueshme me një përmër. Duden dallon dhe shtojcat ndajfoljore me parafjalw (Adverbiale Präpositionalgefüge), të cilat “...stehen in einem loserem Verhältnis zu den übrigen Elementen des Satzes, als die Präpositionalobjekte/ ...qëndrojnë në një raport më të lirë me elementet e tjerë të fjalisë, në krahasim me kundrinat me parafjalë”⁴⁴. Dallohen tri lloje shtojcash ndajfoljore me parafjalw: në rasën kallëzore, dhanore dhe gjinore.

⁴³Po aty, f. 579- 581

⁴⁴ Po aty f. 579

Duke marrë parasysh faktin se Duden është një gramatikë që i shërben kryesisht nxënësve që mësojnë gramatikën e gjuhës gjermane dhe jo studiuesve të mirëfilltë të fushës, mund të thuhet se klasifikimi i mësipërm është disi i komplikuar për ta.

Më tej tek Duden krahas interpretimit formal dhe të rolit që luajnë në fjali, vërehet dhe një përpjekje për të bërë interpretimin kuptimor të gjymtyrëve të fjalisë⁴⁵, ndër të tjera dhe kundrinës së drejtë, të zhdrejtë dhe asaj të rasës gjinore. Këtu do ndalem shkurtimisht, pasi më hollësisht do trajtohet në kreun pasardhës.

Në këtë këndvështrim sipas Duden kundrina e drejtë mund të përcaktojë njeri ose një send, e cila është e prekur nga veprimi. Në këtë rast e përkufizon më tej kundrinën e drejtë si ‘affizierten objekt’ ose ‘patients’:

Er lobt **den Schüler**./ Ai lëvdon nxënësin.

Si rezultat i ngjarjes apo veprimit i cili përcaktohet me anë të kallëzuesit, duke e quajtur ‘effizierter Objekt’:

Sie backt **den Kuchen**./ Ajo pjek kekun.

Duden e klasifikon më tej kundrinën drejtë si të brendshme, kundrinë që përcakton një sasi ose çmim, një gjendje, karakteristikë apo funksion të dikujt, një njeri apo gjendje psikologjike të tij, një ngjarje, të karakterizuar nga kallëzuesi, mbartësin e klasifikimit që përcakton ‘gleichsetzungsakkusativ’.

Ndërsa kundrina e zhdrejtë në rrafshin kuptimor klasifikohet si më poshtë;

Shpesh një person të cilit i referohet ngjarja.: Sie begegnet **ihm**./ Ajo takon atë.

Një pronar, ose marrës. Këtë lloj kundrinë e përcakton më tej si dhanorja posesive (possesive Dativ):

Das Buch gehört **mir**./ Libri më përket mua.

Dhanorja komodi (Dativus commodi) dhe dhanorja inkomodi (Dativus incommodi), një person në vendin e të cilit dhe për të cilin ndodh diçka që është në avantazh ose dizavantazh të tij:

Er trägt **den Koffer**./ Ai mban valixhen.

Sie hat **mir** den Teller zerbrochen./ Ajo më theu pjatën.

Dhanorja pertinente (Pertinenzdativ): Mir schmerzt **der Kopf**./ Mua më dhemb koka.

Dhanorja etike (Dativus ethicus): Das du **mir** nicht zu spät kommst./ Mos më hajde mua vonë.

⁴⁵Po aty, f. 585- 591

dhe Dhanorja finale (finale dativ), e cila shpesh zëvendësohet nga një shprehje parafjalore me parafjalën për.:

Er lebt nur **seine Arbeit**./ Ai jeton vetëm për punën.

Er lebt nur **für seine Arbeit**./ Ai jeton vetëm për punën.

Përsa i përket kundrinës së rasës gjinore, në rrafshin kuptimor tek Duden e gjejmë të klasifikuar si gjinorja e kimit (Genitivus criminis), duke qenë se kjo kundrinë e cila po përdoret gjithnjë e më rrallë në gjuhën gjermane, gjen ende përdorim kryesisht në gjuhën juridike.:

Er wird **des Mordes** beschuldigt./ Ai akuzohet për vrasje.

Bie në sy fakti se, kundrina me parafjalë tek Duden nuk shqyrtohet në rrafshin kuptimor.

2.2.5. Angelika Volenshtajn- Lajsten/ Aksel Hajlman/ Peter Shtepan/ Sten Vikner (Angelika Wöllenstein-Leisten/ Axel Heilmann/ Peter Stepan/ Sten Vikner)

Nga sa u pa më lart, në gramatikën tradicionale të gjuhës gjermane, por veçanërisht dhe në gramatikat me orientim didaktik, kundrina përcaktohet kryesisht si një gjymtyrë fjalie në rasën kallëzore dhe dhanore. Këtë fakt e ilustron disa shembuj të gramatikave të ditëve të sotme. Në veprën e tyre “*Deutsche Satzstruktur. Grundlagen der syntaktischen Analyse/ Struktura e fjalisë në gjuhën gjermane*”. Bazat e analizës sintaksore”, publikuar në 1997, gjuhëtarët Volenshtajn-Lajsten/ Hajlman/ Stepan/ Vikner i përkufizojnë gjymtyrët e fjalisë si më poshtë:

“Subjekt: Es trägt den *Nominativ*./ Kryefjala: gjymtyrë në rasën emërore.“

Akkusativobjekt/ direktes Objekt: Es trägt den *Akkusativ*./ Kundrina e rasës kallëzore/ kundrina e drejtë: gjymtyrë në rasën kallëzore.

Dativobjekt/ indirektes Objekt: Es trägt den *Dativ*./ Kundrina e rasës dhanore/ kundrina e zhdrejtë: gjymtyrë në rasën dhanore.⁴⁶

Këto përkufizime duken mjaft të cinguar dhe të pasakta. Bie në sy p.sh., se ata e njehsojnë kundrinën e rasës kallëzore me atë të drejtë, si dhe kundrinën e rasës dhanore me atë të zhdrejtë. Vlen të theksohet se këto karakteristika kaq të kufizuara të gjymtyrëve të fjalisë, tek dikush që mëson gjermanishten si gjuhë të huaj, mund të krijojnë përshtypjen e gabuar p.sh. se çdo frazë emërore në rasën kallëzore është një kundrinë e drejtë, apo se çdo frazë emërore në rasën dhanore është një kundrinë e zhdrejtë.

Ndërsa përsa i përket kundrinës së rasës dhanore, risi përbën fakti se ata, nënvizojnë rastet problematike të të ashtuquajturit “dhanore e lirë” duke e quajtur Dhanoren etike

⁴⁶Wöllenstein–Leisten, Angelika/ Heilmann, Axel/ Stepan, Peter/ Vikner, Sten, *Deutsche Satzstruktur. Grundlagen der syntaktischen Analyse*. Tübingen 1997, f. 35

(Dativus Ethicus) dhe dhanoren judikante (Dativus Iudicantis), kundrina të rasës dhanore dho jo si dhanore të lira, siç dhe janë trajtuar nga gjuhëtarët e tjerë që janë shqyrtuar deri tani.:

Schlaf **mir** nicht ein!/ Mos më fli gjumë mua!

Das ist **mir** zu laut./ Për mua është shumë zhurmë.⁴⁷

Ndërsa në një nënkre më vete trajton dativin e lirë, ku bëjnë pjesë llojet e tjera.

2.2.6. Karl- Ernst Zomerfeld/ Gynter Shtarke (Karl- Ernst Sommerfeld/ Günter Starke)

Ndërsa sipas Somerfeld/ Shtarke, në veprën e tyre “*Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache/ Hyrje në gramatikën e gjermanishtes së sotme*”, botuar në 1998, kundrina përkufizohet: “*Das Objekt ist ein Satzglied des Prädikatsverbandes, desen obliquer Kasus (Akkusativ, Dativ, selten Genitiv) oder präpositionaler Anschluß vom Prädikatslexem durch reksion determiniert wird./ Kundrina është një gjymtyrë, pjesë e lidhjes së kallëzuesit (Prädikatsverband), rasa e së cilës (kallëzore, dhanore, rrallë gjinore) ose parafjala përcaktohet me anë të sundimit.*”⁴⁸ Këtë ata e ilustronjë si më poshtë:

Der Gärtner (Subjekt) bindet (Prädikat) die Blumen. (Akkusativobjekt)

(Prädikatsverband/ lidhja kallëzuesore)

Kopshtari (kryefjalë) lidh (kallëzues) lulet. (kundrinë e rasës kallëzore)

(lidhja e kallëzuesit)

Der Sohn (Subjekt) dankt (prädikat) dem Vater. (Dativobjekt)

(Prädikatsverband)

Djali (kryefjalë) falënderon (kallëzues) Babain (kundrinë e rasës dhanore).

(lidhja e kallëzuesit)

“*In den vorliegenden Beispiele spezifizieren bzw. Modifizieren die Objekte die Semantik des Prädikatsausdrucks und bezeichnen einen Gegenstand oder Sachverhalt, auf den das Geschehen gerichtet oder an dem das Geschehen orientiert ist.*”/ Në shembujt e mësipërm, kundrinat modifikojnë semantikën e shprehjes së kallëzuesit dhe përcaktojnë një objekt ose një rrethanë, së cilës i drejtohet ngjarja ose nga e cila orientohet ngjarja.”⁴⁹

⁴⁷Po aty, f. 37

⁴⁸Sommerfeld, Karl- Ernst/ Starke, Günter: *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen 1998, f. 211

⁴⁹Po aty, f.213

2.2.7. Brikena Kadzadej

Tek “*Deutsche Syntax/ Sintaksa e gjuhës gjermane*” e Kadzadejt, botuar për herë të parë në 2002, libër ky që i dedikohet kryesisht studentëve të gjuhës gjermane, por dhe atyre që dëshirojnë të zgjerojnë njohuritë e tyre në gjuhën gjermane, gjejmë këtë përkufizim për kundrinën, i cili i referohet atij të bërë nga Grisbah: “*Objekt sind alle Glieder bei der Beschreibung eines Sachverhalts, die nicht Subjekt sind./ Kundrinë janë të gjitha gjymtyrët që përshkruajnë një situatë që nuk janë kryefjalë.*”⁵⁰

Kadzadej dallon katër lloje kundrinash: kundrina e rasës kallëzore, kundrina e rasës dhanore, kundrina e rasës gjinore dhe kundrina me parafjalë.

Klasifikimin e tyre, Kadzadej e bën me anë të përemrave pyetës përkatësisht ‘kë’ ose ‘çfarë’ për rasën kallëzore, ‘kujt’ për rasën dhanore, ‘i kujt’ për rasën gjinore dhe ‘parafjalë + kë/ kujt/ çfarë’ për kundrinën me parafjalë.

Gjithashtu Kadzadej bën dhe ndarjen semantike të kundrinave: “*Das Akkusativobjekt wird direktes Objekt genannt, weil die Handlung bzw. Das Geschehen es direkt betrifft. Das Dativobjekt wird auch indirektes Objekt genannt, weil die Handlung oder das Geschehen sich weniger direkt darauf beziehen./ Kundrina e rasës kallëzore quhet kundrinë e drejtë se veprimi, dmth ngjarja e prek direkt atë. Kundrina e rasës dhanore quhet dhe kundrinë e zhdrejtë se veprimi ose ngjarja nuk bien direkt mbi të.*”⁵¹

Më tej autorja jep një paraqitje të ilustruar me shembuj të kundrinave duke vënë dhe theksin tek problematika e identifikimit të tyre. Veçanërisht në rastin e kundrinës me parafjalë dhe rrethanorit duke pasqyruar hollësisht dallimet mes tyre. Dhe këtu do ndalem më gjatë në kreun në vijim rreth kundrinave.

2.2.8. Wilfrid Kyrshner (Wilfried Kürschner)

Ndërsa Kyrshner, në veprën e tij “*Grammatisches Kompendium/Gramatika e shkurtuar*”, botuar në vitin 2003 shprehet në lidhje me kundrinën në një nënkre të veçantë kushtuar saj, të quajtur „Përkufizim përmbledhës për kundrinën e rasës kallëzore, kundrinë e rasës dhanore, kundrinën e rasës gjinore dhe kundrinën me parafjalë.“, ku vihen re mjaft ngjashmëri me Volenshtajn- Leiste/ Hajlman/ Shtepan/ Vikner. Tek përshkrimi i kundrinës së rasës kallëzore ai është pak më i kujdeshëm, duke e përkufizuar “frazën emërore në rasën kallëzore” si një nga shumë “format tipike të shprehjes”. Por dhe ai vendos vijë barazimi mes kundrinës së rasës kallëzore dhe kundrinës së drejtë.: „*Das Akkusativobjekt wird auch als direktes Objekt bezeichnet*“./ Kundrina e rasës kallëzore përkufizohet dhe si kundrinë e drejtë.⁵² Si Volenstajn-Lajsten e të tjerë, ashtu dhe Kyrshner përsa i përket kundrinës së zhdrejtë, nënvizojnë rastet problematike të të ashtuquajturës dhanore e lirë. Sidomos tek dhanorja etike (Schlaf **mir** nicht ein! Mos më fli gjumë mua!) dhe tek dhanorja judikante (Das ist **mir**

⁵⁰Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f.48

⁵¹Po aty, f. 49

⁵²Kürschner, Wilfried: *Grammatisches Kompendium. Systematisches Verzeichnis grammatischer Grundbegriffe*. 4., ergänzte u. bearb. Aufl. – Tübingen / Basel: Francke (UTB1526) 2003, f. 177

zu laut./ Për mua është shumë zhurmë.)⁵³ Siç shihet statusi i kundrinës është mjaft i debatueshëm. Është pak konfundues fakti që këta gjuhëtarë dhanoren etike dhe atë judikante i trajtojnë tek kundrina e rasës dhanore, ndërsa dhanoren e lirë e trajtojnë më vete

Pra problemi kryesor i termave „Akkusativobjekt/ kundrinë e rasës kallëzore“, dhe „Dativobjekt/ kundrinë e kundrinë e rasës dhanore, në gjuhën gjermane, është fakti se këtu përzihen dy rrafshë me njëri tjetrin, ai morfologjik (rasa) dhe rrafshi i funksionit (gjymtyrë fjalie). Edhe pse shumica e kundrinave të drejta në gjuhën gjermane shprehen me një gjymtyrë në rasën kallëzore, siç do trajtohet më nga afër dhe në kreun e ardhshëm, ka dhe raste të dyshimta si p.sh në fjalinë e mëposhtme:

Ich helfe **dir**./ Unë të ndihmoj ty.⁵⁴

Së fundi tek Pitulainen, në studimin e saj me titull “*Zum Problem der Satzglieder in der deutschen Grammatik*” Rreth disa problemeve të gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën gjermane” gjendet një përmbledhje e pikave të dobëta të gramatikës tradicionale me të cilën bie përgjithësisht dakort:

Sipas saj, skema e gramatikës së gjuhës greke dhe latine i imponohet gjuhës e cila është objekt studimi. Gjithashtu sipas saj përzihen me njëra tjetrën aspektet diakronike me ato sinkronike, sidhe ekziston një varësi e fortë me logjikën klasike aristoteliane, veçanërisht tek analiza kryefjalë-kallëzues e fjalisë. Dhe aspektet formalo-strukturore dhe ato funksionale dhe të përmbajtjespërzihen me njëra tjetrën. Dominon mënyra preskriptive në vend të asaj plotësisht deskriptive. Së fundi ajo shprehet se teoria e gramatikës tradicionale, bazohet në rradhë të parë tek fleksioni dhe tek rrafshi gjuhësor. Kjo çon në një vëzhgim të izoluar të elementeve gjuhësore, në ndryshim me teoritë e reja gjuhësore ku qëndrojnë në plan të parë elementet gjuhësorë parë në një kontekst më të gjerë. Por Pitulainen thekson gjithashtu se gramatikës tradicionale i duhet njohur merita e ndërtimit të themeleve në shkencën e gjuhësisë.⁵⁵

3. Gramatika me orientim nga përmbajtja (Die inhaltsbezogene Grammatik)

3.1. Leo Vajsgerber (Leo Weisgerber)

Gramatika me orientim nga përmbajtja (Die inhaltsbezogene Grammatik), e njohur ndryshe dhe si hulumtim i përmbajtjes së gjuhës (Sprachinhaltsforschung), Neoromantika shkencore gjuhësore (sprachwissenschaftliche Neoromantik) ose përkufizimi energjik gjuhësor (energischer Sprachauffassung) e cila u zhvillua në vitet 50, ka karakter kryesisht filozofik gjuhësor. Themeluesi dhe përfaqësuesi më i rëndësishëm i kësaj teorie gramatikore, Leo Vajsgerber (Leo Weisgerber) si dhe përfaqësuesit e tjerë, Jost Trier (Jost Trier), Valter Porcig (Walter Porzig), Helmut

⁵³Po aty, 179

⁵⁴Pitulainen, Marja-Leena: *Zum Problem der Satzglieder in der deutschen Grammatik der Gegenwart*. – Jyväskylä: Universitat Jyväskylä (Studia philologica Jyväskyläensia 14) 1980, f. 23

⁵⁵Po aty, f.36-38.

Giper (Helmut Gipper) dhe Hening Brinkman (Hennig Brinkmann), influencuan me anë të saj veçanërisht mësimin e gjuhës gjermane në shkolla në vitet 50-60, si dhe gramatikat e Duden të kësaj kohe. Elemente të saj i gjejmë dhe sot në gramatika të ndryshme me orientim tradicional, si ajo e Duden, Dyrshajd (Dürscheid), Volenshtajn/ Lajste e të tjerë (Wollenstein/ Leiste), Kyrshner (Kürschner), Henshel/ Veid (Hentschel/ Weydt), etj..

Tezat e kësaj teorie gramatikore bazohen tek konceptimi i gjuhës i Vilhelm Humboldt, i cili siç është përmendur më sipër, mendonte se egzistonte një lidhje mes gjuhës dhe vendit, atdheut, historisë e zakoneve. Për këtë arsye Humboldi nuk mendonte se në qendër të studimeve gjuhësore duhet të ishte metoda historike krahasuese, por zbulimi i influencës së gjuhës tek të menduarit e njeriut. Kësaj teze ju bashkangjiti Vajsergerber dhe u përpoq që të zhvillonte një teori dhe një metodë, me anë të së cilës të ishte e mundur që në mënyrë shkencore të përcaktohej qënësia e gjuhës me anë të një projektimi formal. Pretendimet e deriatëhershme se gjuha ishte një mjet komunikimi apo një vegël e diskutimit, pasojë e të menduarit, ose rrjedhojë e shpirtit të njeriut, nuk i mjaftonin Vajsergerberit. Ai huazoi nga Humboldi tezën e tij për gjuhën si një fuqi e shpirtit dhe e zhvilloi atë më tej. Për këtë arsye Vajsergerberi e përkufizon punën e tij si një rinovim të vështrimit energjik të gjuhës. Ai shprehet, ” *...dass die Sprache eine gestaltende Tätigkeit des menschlichen Geistes (energeia) darstellt, eine wirkende Kraft, der eine bestimmte Weltansicht zugrundeliegt und nicht ein fertiges, abgeschlossenes Werk (ergon).* ”/ ...se gjuha paraqet një punë formëzuese të shpirtit të njeriut (energeia), një fuqi efektive, e cila bazohet në një këndvështrim të caktuar për botën, dhe jo një vepër të mbyllur (ergon).⁵⁶

“*Was Weisgerber vom Strukturalismus besonders unterscheidet, ist der zentrale Gedanke der „Sprachgemeinschaft“ als Schöpferin der sprachlichen Zwischenwelt; die Sprache (im Sinne von langue oder, in Weisgerbers Terminologie, „Muttersprache“)* wird - in deutlicher Anlehnung an Humboldt und die Tradition des sog. „sprachlichen Idealismus“ - als Ausdruck der Denk- und Anschauungsweise eines Volkes angesehen. Im Zentrum des Interesses steht die „innere Sprachform“, ein ebenfalls Humboldt zugeschriebener Begriff- als eben die „inhaltliche“ Gliederung, die geistige „Zwischenwelt“, die zwischen dem Menschen und der Wirklichkeit vermittelt, die durch die Sprache erfasst und gegliedert werden muss.“/ Ajo çka e dallon Vajsergerberin veçanërisht nga strukturalizmi është mendimi qëndror i “komunitetit gjuhësor” si krijues të botës së ndërmjetme gjuhësore; gjuha (në kuptimin e langue, ose “ gjuha e nënës” në terminologjinë e Vajsergerberit) duke u bazuar tek Humboldi dhe tradita e të ashtëquajturit “idealizëm gjuhësor”, shihet si një shprehje e të menduarit dhe këndvështrimit të një populli. Në fokus qëndron “forma e brendshme gjuhësore”, dhe ky një term i sajuar nga Humboldi, si dhe ndërtimi i “përmbajtjes”, “bota shpirtërore e

⁵⁶Hentschel, Elke;Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter1990, 399

ndërmjetme”, e cila bën lidhjen e njeriut me realitetin, që duhet të hartohet dhe ndërtohet nga gjuha.”⁵⁷

Gramatika me orientim nga përmbajtja, ka në vëmendje përmbajtjen e formave gjuhësore dhe influencën e tyre tek komuniteti gjuhësor si dhe raportet e tyre kulturore. Vajsgerberi duke zhvilluar më tej mendimet e Humboldt, krijon një instrument me anë të katër hapave të studimit të tij gjuhësor, për të analizuar jo vetëm anën formale të gjuhës, por dhe atë shpirtërore. Ai e sheh ndërtimin e gjuhës në këta katër hapa:

1. E folura
2. Inventari gjuhësor i gjithsecilit
3. Gjuha si pasuri kulturore e shoqërisë. Ky është dhe hapi më i rëndësishëm sipas tij.
4. Parimi i përgjithshëm njerëzor i gjuhës në kuptimin e aftësisë gjuhësore që karakterizon njerëzit. Dy hapat e parë i referohen aspektit statik të gjuhës, ndërsa dy hapat e fundit i referohen parimit dinamik (energjik) të kundërimit të gjuhës.

Fjalitë në këtë model gramatikor shihen si njësi me kuptim, në ndërtimin e së cilës janë vendosur modele të caktuara të përmbajtjes. Llojet e fjalive, p.sh. dëftore, pyetëse, etj., përcaktohen vetëm duke u nisur nga semantika dhe jo më nga forma. Funkzioni semantik i transmetimit të informacionit tek terminologjia profesionale, nuk ka pse të jetë përdorimi komunikativ i llojeve të fjalive. Realiteti, i cili transmetohet me anë të fjalive, duhet të zotërohet dhe të strukturoret me anë të fjalive, të cilat sipas përmbajtjes klasifikohen si ‘Zustands-, Vorgangs-, Tätigkeits- und Handlungssätze’/ fjali që shprehin gjendje, veprim.

Kjo duket qartë dhe në përshkrimin e gjymtyrëve të caktuara të fjalisë:

- kryefjala quhet vepruesi (Handelnder),
- kallëzuesi bërthama e thënies (Aussagekern),
- kundërinat plotësa të kuptimit (Sinnergänzungen).

Vajsgerber mbajti një qëndrim mjaft të qartë dhe empatik përsa i përket semantikës së rasës kallëzore. Sipas tij, disa folje me parashtesa, ‘-be’ p.sh., që marrin kundërinë të rasës kallëzore përbëjnë një shprehje të dehumanizimit modern, nëpërmjet të cilit njeriu degradon në një objekt. “*Im dativ ist der Mensch Mittelpunkt des Geschehens, wird er als Person zur Geltung gebracht, im Akkusativ wird er ‘erfasst’, wird er Gegenstand einer geistigen Machtausübung.*” Në rasën dhanore njeriu është në qendër të vëmendjes, shihet si person, në rasën kallëzore ai shihet si objekt i ushtrimit të pushtetit”⁵⁸. Në lidhje

⁵⁷Po aty, f. 400:

⁵⁸Bausewein, Karin: Akkusativobjekt, Akkusativobjektsätze und Objektsprädikate im Deutschen: Untersuchungen zu ihrer Syntax und semantic, Tübingen: Nimeyer 1990, f.12

me këtë Vajsgerber jep shembuj të çifteve foljore si: einem raten- einen beraten/ këshilloj dikë, einem etwas liefern- einen mit etwas beliefern/i dërgoj diçka dikujt.

Por ai gjithashtu sheh një sërë avantazhesh në rrafshin sintaksor, të kundrinë së rasës kallëzore, në krahasim me atë të rasës dhanore apo kundrinën me parafjalë. Në rastin e jemanden beliefern/ ti çosh dërgesën dikuj mund të evitohet përdorimi i një kundrine të dytë, si do ishte rasti p.sh. 'bei jemanden etwas liefern'/ ti dërgosh diçka dikujt. Gjithashtu personi i shprehur nga kundrina mund të kthehet në kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore:

Sie beliefert **den Kunden**./ Ajo i dërgon dërgesën klientit.

Sie liefert **dem Kunden**./ Ajo i dërgon klientit.

Der belieferte Kunde./ Klienti të cilit i ka shkuar dërgesa.

Nuk mund të themi: Der gelieferte Kunde./ Klienti i dërguar.

Der Kunde wurde beliefert./ Klientit iu dërgua dërgesa.

Nuk mund të themi: Der Kunde wurde geliefert./ Klienti u dërgua.⁵⁹

Vajsgerber kritikohet shpesh për faktin se, teoria e tij, se tendencat gjuhësore e kanë origjinën tek zhvillimet sociale të shoqërisë duke anashkuar arsyet gjuhësore, në këtë rast sintaksore, nuk shihet si e saktë. Ai p.sh. e shihte një person të përmendur në rasën dhanore si një person me integritet të pacënuar, ndërsa në rasën kallëzore sipas tij, ai është më i cënueshëm pasi bëhet më shumë objekt i veprimit.

3.2.Hans Glinz (Hans Glinz)

Megjithëse Hans Glinz nuk bën pjesë tek gramatikanët e mirëfilltë të gramatikës me orientim nga përmbajtja, tek përshkrimi i rasave gjenden mjaft elementë të kësaj teorie. Ai e përkufizon kryefjalën si njësi bazë (Grundgröße), duke qenë se ajo është e pranishme në pothuaj çdo fjali dhe përbën sipas tij pikën e nisjes për përshkrimin e situatës në fjali. Gjymtyrët e rasave të tjera janë sipas tij njësi pasuese (Folgegrößen) të saj, të cilat dallojnë nga njëra tjetra nëpërmjet semantikës së tyre. Glinzi e përkufizon kundrinën e rasës kallëzore mbi të gjitha si të kundërtën e asaj të rasës dhanore. "Der Akkusativ gibt seine Größe unmittelbar, heftiger, verpflichtender, umfassender als Ziel. Das im Dativ gefaßte Ziel erscheint freier, weniger direkt ergriffen, mehr beiläufig berührt. Es wird auch interessiert, aber nicht so direkt getroffen."/Rasa kallëzore e jep synimin në mënyrë të drejtpërdrejtë, më me forcë, më të përmbledhur. Synimi i shprehur nga rasa dhanore duket më i lirë, më pak direkt, i prekur më tangjent." Kundrina e rasës kallëzore përcakton njësinë e synuar (Zielgröße), e cila preket ose

⁵⁹Po aty

lidhet direkt me kryefjalën, ndërsa kundrinën e rasës dhanore e përkufizon si njësia e referuar (Zuwendgröße), e cila semantikisht nuk është e lidhur aq ngushtësisht me kryefjalën.

Ai nuk ndalet vetëm me interpretimin semantik të kundrinave, por përpiqet të bëjë interpretimin semantic të rasave në vetvete. Ai mbështet p.sh. idenë se kallëzorja në katër përdorimet e mëposhtme ka një kuptim të përbashkët bazë.:

Er berührte **den Baum**./ Ai preku pemën

Er kletterte **auf den Baum**./ Ai u ngjit në pemë.

Er arbeitet **den ganzen Tag**./ Ai punoi gjithë ditën.

Er ging auf und ab, **den Zettel in der Hand**./ Ai eci poshtë e lart me letrën në dorë.

Kuptimin e përbashkët ai e quan joeksplicit dhe e nënkupton vetëm me anë të semanticës në katër përdorimet e ndryshme. Kundrina e rasës kallëzore sipas tij përcakton diçka të sapo cekur, ose njësinë e synimit, kallëzorja në togfjalëshat parafjalorë është rasa e qëllimit ose synimit fillestar, gjithashtu dhe kallëzorja ndajfoljore, e cila paraqet një hapësirë kohore ose vendore e cila të çon drejt synimit ose qëllimit.

3.3. Angelika Linke/ Markus Nusbaumer/ Paul Linke Portman (Angelika Linke / Markus Nussbaumer/ Paul Linke Portmann)

In der inhaltsbezogenen Grammatik unterscheidet man direkte und indirekte Objekte. Das direkte Objekt steht in der Regel im Akkusativ und das indirekte im Dativ. Das Dativobjekt wird indirektes Objekt genannt, weil die Handlung bzw. oder das Geschehen sich weniger direkt darauf beziehen. Das Akkusativobjekt wird direktes Objekt genannt, weil die Handlung bzw. das Geschehen direkt es betrifft. Anders ausgedrückt bezeichnet das direkte Objekt die Zielgröße, das indirekte Objekt die Zuwendgröße. Im Deutschen unterscheidet sich das indirekte Objekt vom direkten Objekt dadurch, dass es bei Passivierung nicht um Subjekt wird./ Në gramatikën me orientim nga përmbajtja dallohen kundrina e drejtë dhe kundrina e zhdrejtë. Kundrina e drejtë është si rregull në rasën kallëzore dhe kundrina e zhdrejtë në rasën dhanore. Kundrina e rasës dhanore emërtohet kundrinë e zhdrejtë sepse e prek drejtpërsëdrejti veprimi dmth ngjarja. E thënë ndryshe, kundrina e drejtë shpreh njësinë e synuar dhe ajo e zhdrejtë objektin e referimit. Në gjuhën gjermane dallohet kundrina e zhdrejtë nga ajo e drejtë, sepse kjo e fundit bëhet kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore.”⁶⁰

⁶⁰Linke, Angelika/ Nussbaumer, Markus/ Portmann, Paul: Studienbuch Linguistik. 2. Auflage. Tübingen: Niemeyer 1994. f. 52- 53

Ich nehme **das Buch** (direktes Objekt) aus dem Regal./ Unë marr **librin** (kundrinë e drejtë) nga rafti.

Er liest **seiner Oma** (indirektes Objekt) aus dem Buch vor./ Ai i lexon **gjyshes së tij** (kundrinë e zhdrejtë) nga libri.

Në shembullin e parë, sipas tyre, 'libri' është kundrinë e drejtë, sepse është i përfshirë direkt në veprim. Ndërsa në rastin e dytë 'gjyshes së tij' është kundrinë e zhdrejtë, sepse nuk preket direkt nga veprimi.

3.4. Krista Dyrshajd (Christa Dürscheid)

Në veprën e saj, "*Syntax, Grundlagen und Theorien/ Sintaksa, bazat dhe teoritë*", botuar në 2007, Dyrshajd shprehet se kundrina e drejtë dhe ajo e zhdrejtë mbartin përkatësisht funksionin semantik të 'patients' dhe 'recipient'. Dyrshajd ngre gjithashtu çështjen e vështirësive të dallimit mes kundrinës së drejtë dhe asaj të zhdrejtë. Ajo rendit kriteret e mëposhtme për dallimin mes tyre:

1. Kriteri semantik: kundrina e drejtë shpreh njësinë tek e cila bie direkt veprimi i shprehur nga folja (patients), ndërsa kundrina e zhdrejtë shpreh njësinë tek e cila drejtohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë veprimi (rezipient).

2. Kriteri formal: kundrina e drejtë si rregull është në rasën kallëzore, ndërsa kundrina e zhdrejtë në rasën dhanore.

3. Kriteri topologjik: kundrina e drejtë është ajo njësi, e cila gjatë vendosjes së foljes në fund, qëndron pranë saj, ndërsa kundrina e zhdrejtë qëndron larg foljes.

4. Kriteri sintaksor: kundrina e drejtë kthehet në kryefjalë kur fjalia bëhet pësore, ndërsa në rastin e kundrinës së zhdrejtë nuk është e mundur një gjë e tillë.

Gjithashtu Dyrshajd shprehet se kundrina e drejtë qëndron në lidhje më të ngushtë sintaksore me foljen sesa kundrina e zhdrejtë.

Dyrshajd e përkufizon kundrinën si një pikësynim të veprimit foljor, e cila mbart rolin semantik të Patients, dmth. recipient. Këta terma i gjejmë dhe tek "*Grundriß der deutschen Grammatik/ Bazat e gramatikës gjermane*" i gjuhëtarit Peter Eisenberg, ku një vëmendje e tillë e veçantë i jepet kundrinës së zhdrejtë, duke qenë se shenjon një lidhje të ngushtë mes gramatikës dhe semantikës.

Vlen të theksohet se kjo teori, e cila nuk gjen më përdorim në ditët e sotme, u zhvillua vetëm në Gjermani, e madje dhe aty nuk gjeti mbështetje të gjerë duke hasur në kritika të shumta nga gjuhëtarë të ndryshëm. Koncepti i gramatikës së orientuar nga përmbajtja u modifikua disa herë nga vetë Vajsergerber si dhe nga nxënësit e kolegët e tij (W. Porzig, J. Trier, G. Ipsen, H. Gipper). Ky model u vu në qendër të kritikave nga gjuhëtarë të tjerë. Kritikë thelbësore i ka bërë kësaj teorie të ashtuquajtur prej tij 'idealiste' gjuhësore Gerard Helbig. Teoria e Vajsergerberit sipas tij "...steht zwischen einem phänomenologischen Ausgangspunkt und einem geistesgeschichtlichen Ausbau. Die

Sprache wird überbewertet, indem er über Humboldt noch hinausgeht und sie als 'Zwischenwelt' verselbständigt./...qëndron mes një pikënisjeje të fenomeneve logjike dhe ndërtimit natyror dhe shpirtëror. Gjuha mbivlerësohet, duke e tejkaluar Humboldtin dhe duke e parë atë si 'botë të ndërmjetme'."⁶¹

Dhe sipas Bynting (Bünting)⁶², dhe Busman (Bußmann)⁶³, ky model gramatikor lë hapësirë për kritika, pasi nga njëra anë këtu kemi problemin se për renditjen sistematike intuita nevojitet mbi kuptimin e fjalisë, çka rezulton pak efikase dhe e vërtetueshme për të tjera. Nga ana tjetër sipas tyre Vajserber nuk merret me aspektin e gjuhës si mjet komunikimi ose aspektet e lidhura me folësin, duke qenë se aftësia e të folurit është e ngërthyer në ndërgjegjjen e folësit dhe kjo prespektivë nuk duhet të mbetet e papërfillur."

4.Gramatika e valencës dhe dependencës

Siç është thënë mësipër, në gjuhën gjermane është e vështirë të bëhet një ndarje mes gramatikës tradicionale dhe asaj të dependencës, duke patur parasysh faktin se kjo e fundit e ka pikënisjen nga ajo tradicionale.

Gramatika e valencës dhe e dependencës është themeluar nga gjuhëtari francez Lusjen Tesnier (Lucien Tesnière) (1893-1954), vepra e të cilit "*Elements de syntaxe structurale/ Elementë të sintaksës strukturale*", u botua pas vdekjes së tij në vitin 1959. Në hapësirën gjermanofolëse, gramatika e dependencës e Tesnierit, u mor për bazë dhe u zhvillua më tej nga gjuhëtarët Erben (1958), Helbig/ Shenkel (1969), Engel (1977), Vater (1978) dhe Heringer (1993), të cilët janë përfaqësuesit kryesorë të kësaj teorie.

Sipas Henschel/ Veid "*Die dependenz- oder Abhängigkeitsgrammatik (von lateinischen dependere "abhängen", dependia "Abhängigkeit) versucht die innere Struktur eines Satzes zu erfassen, indem sie die Abhängigkeit der Satzglieder voneinander beschreibt./ Gramatika e dependencës ose e varësisë (nga latinishtja dependere "varet", dependia "varësi") përpiqet të studiojë strukturën e brendshme të fjalisë, duke përshkruar varësinë e gjymtyrëve të fjalisë nga njëra tjetra.*"⁶⁴

Sipas Kadzadej, "*Die Dependenzgrammatikbeschreibt die Beziehungen zwischen Elemente der Sätze einer Sprache als Abhängigkeiten; sie fasst den Satz als hierarchisch geordnetes Ganzes auf, das durch die Abhängigkeitsrelation determiniert ist.... Die Abhängigkeitsrelation als grundlegende, strukturelle Beziehung zwischen den Wörtern eines Satze, wird Konnexion genannt. Die Konnexion ordnet die Elemente hierarchisch zu eine Struktur, wobei das Verb als zentraler Knoten fungiert, von denen die Konnexionen ausgehen.*"/ Gramatika e dependencës përshkruan raportet mes elementëve të fjalive të një gjuhe si varësi; ajo e trajton fjalinë si një tërësi hierarkike,

⁶¹Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 5

⁶² Bünting, Karl Dieter: *Einführung in die Linguistik*, Athenäum: Fischer verlag, 1973, f. 151

⁶³Bußmann, Hadumod: *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart 1983, f. 440

⁶⁴Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 403

e cila përcaktohet nga raporti i varësisë....Raporti i varësisë, si një marrëdhënie bazë e strukturuar mes fjalëve të një fjalie, quhet koneksion (thënë shqip lidhje). Me anë të lidhjes elementët vendosen në një strukturë hierarkike, ku folja luan rolin e një njeje qendrore, nga e cila e kanë pikënisjen lidhjet.”⁶⁵

Bërthama e gramatikës së dependencës formohet nga e ashtëquajtura teori e valencës (termi ‘Valenz’/ valencë i sajuar nga Tesnieri, marrë nga fizika) ose e vlerës (‘Wertigkeit’/ vlerë, term ky i sajuar nga Heringer), e cila përshkruan varësinë e gjymtyrëve të para, ku folja, e cila konsiderohet si i vetmi element i pavarur i fjalisë, merret si njeje qendrore (noeud) e saj nga e cila varen elementet e tjerë ose ‘Aktantet’.

4.1.Aktantet dhe rrethanorët (Aktanten dhe Angaben)

Në gramatikën e dependencës gjymtyrët ndahen në aktante dhe angaben (rrethanorë). Në vijim do ndalem më gjatë tek të parat, duke qenë se përfaqësojnë dhe kundrinat.

Sipas Tesnierit, “*Die Aktanten sind Wesen oder Dinge, die auf irgendeine Art, sei es auch nur passiv, gewissermaßen als bloße Statisten, am Geschehen teilhaben*”./ Aktantet janë frymorë ose sende, të cilat marrin pjesë në mënyrë aktive ose pasive në ngjarje.”⁶⁶

Ndërsa rrethanorët i përshkruan si rrethana të kohës, vendit dhe mënyrës etj, në të cilat kryhet ngjarja. Ato shprehen me ndajfolje ose ekuivalente të tyre.

Por këtu kemi një pasaktësi ose paqartësi, në lidhje me faktin nëse dhe një emër mund të luante rolin e një ndajfolje, duke marrë shkas nga fjalia e mëposhtme:

Wir arbeiten den ganzen **Tag**./ Ne punojmë gjithë ditën.

Aktantet shprehen gjithmonë me emra ose ekuivalente të tyre, p.sh. përemra. Kundrinat dhe kryefjala konsiderohen si aktante të foljes. Në mënyrë që thënia të jetë e plotë nga ana kuptimore dhe fjalia të jetë e saktë nga ana gramatikore, folja në fjali krijon disa vende bosh (Leerstellen), të cilat duhet të zihen nga aktantet. Marrim për shembull foljen ‘niessen/ teshtij’ e cila krijon një vend bosh, atë të kryefjalës:

Peter niesst./ Peteri teshtin.

Ndërsa folja ‘hören’/ dëgjoj kërkon dy aktante:

Peter hört das Kind./ Peteri e dëgjon fëmijën.


Nga sa u pa dhe nga shembujt e mësipërm folje të tilla si “niessen/ teshtij” janë njëvalente dhe folje të tjera si “hören/ dëgjoj” janë dyvalente.

⁶⁵Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f. 166

⁶⁶Ramers, Karl Heinz: *Einführung in die Syntax*. 2. Aufl. – Paderborn: Wilhelm Fink (UTB 2174) 2007, f. 78


Ose marrim fjalinë: Anna gibt Daniel oft Nachhilfeunterricht./ Ana i jep shpesh Danielit mësim plotësues.

Në këtë shembull ‘Anna’ është aktanti i parë, ‘Nachhilfeunterricht’ i dyti dhe ‘Daniel’ i treti. Si rrethanor mund të merret ndajfolja ‘oft’. Fjalja do të kishte skemën e mëposhtme.:



Nga aktantet dhe nga rrethanorët mund të varen elementë të tjerë. Elementet, prej të cilëve varen elementë të tjerë quhen ‘Regentien’ (njëjës regens, term i marrë nga frëngjishtja ‘régissant’), ndërsa ata elementë që varen prej tyre quhen ‘dependens’ (përkthim i termit të sajuar nga Tesnieri ‘subordonné’). Një regens mund të ketë më shumë se një dependens. Gjithashtu vlen të theksohet se regens dhe dependens janë dy terma relativë duke qenë se një aktant ose një rrethanor mund të jetë njëkohësisht regens dhe dependens, siç do shihet në shembullin e mëposhtëm. :

Anna gibt ihrem Freund Daniel sehr oft kostenlosen Nachhilfeunterricht./ Ana i jep shumë shpesh mësim plotësues shokut të saj Daniel.



Vija e ndërprerë pasqyron të ashtëquajturën lidhje semantike (semantische konnexion), si një marrëdhënie varësie semantike.

Vërehet se te gjuhëtarë të ndryshëm gjermanë gjejnë një numër të ndryshëm plotësash (Ergänzungen). P.sh. tek Heringer 6 lloje, tek Erben 7 lloje dhe madje 11 lloje tek Engel. Vlen të sqarohet se bëhet fjalë për dy lloje plotësash të foljes: Aktantet, të cilat përkojnë

me kryefjalën dhe kundrinën e gramatikës tradicionale dhe rrethatorët (Angaben). Këta të fundit, në gramatikën tradicionale përcaktohen zakonisht si ‘Adverbialbestimmungen’. Pra përta i përket kundrinave në gramatikën e valencës dhe dependencës ato quhen plotës (Ergänzungen) dmth aktante. Të tre këta gjuhëtarë bien dakort se kundrinat, disa rrethatorë dhe kallëzuesorë, kur shprehen me emër bëjnë pjesë tek plotësat.

Plotësat, dmth kryefjala dhe kundrinat, shënohen me shkurtimin ‘E’ dhe me numrin përkatës që i është caktuar. Përta i përket numrit, vërehet se nuk është i njehsuar mes gjuhëtarëve, përveç kundrinës së rasës dhanore, cila shënohet tek të tre autorët e sipërpërmendur si E3. Kryefjala për shembull, përcaktohet nga Erben e Heringer si E1, ndërsa nga Engel si E0. Kundrina e rasës gjinore përcaktohet si E2 nga Engel dhe Erben dhe si E4 nga Heringer. Ndërsa kundrina e rasës kallëzore si E1 tek Engel, E4 tek Erben dhe E2 tek Heringer. Gjithashtu dhe rrethatorët dhe gjymtyrët e lira si p.sh kallëzorja absolute (absolute Akkusativ) dhe dhanoret e lira (freie Dative), autorët i klasifikojnë në mënyrë të ndryshme nga gramatika tradicionale. Kështu p.sh. Engel i përfshin dhanoret e lira, përkatësisht atë komodi të cilën ai e quan sympathicus, inkomodi, etike dhe pertinente, tek kategoria E3, pra në një kategori me kundrinën e zhdrejtë.

Por Bynding ka disa kritika në lidhje me këtë model, të cilat duken përgjithësisht të drejta. Ai shprehet se nga njëra anë është pjesërisht e vështirë të vendosësh rreth vlerës së foljes, duke qenë se vendimi rreth plotësive të detyrueshëm dhe atyre fakultativ bëhet shpesh me intuitë, duke ndeshur kështu në kufirin mes semantikës dhe sintaksës. Më tej struktura e paraqitjes së një fjalisë tregon vërtetë hierarkinë e gjymtyrëve të saj të fjalisë, por kjo paraqitje nuk mund të projektohet në një zinxhir linear fjalësh. Së fundi ai shton se gramatika e dependencës heq dorë nga modeli tradicional i funksioneve të gjymtyrëve të fjalisë, gjithashtu fjalinë dygjymtyrëshe (kallëzues – kryefjalë) si lloj bazë i të gjitha fjalive. Parimi bazë i strukturës së valencës së foljes nuk mjafton për të dekoduar plotësisht sintaksën. Më tej ai shton se gramatika funksionale dhe ajo gjenerative e kanë përshkruar më mirë këtë problem, para së gjithash në lidhje me fjalitë më komplekse.⁶⁷

4.2.Valenca

Sipas Bünding: “*Unter Valenz versteht man die Fähigkeit des Verbs bestimmte Leerstellen um sich herum zu eröffnen. Durch die Valenz des zentralen Verbs werden die Ergänzungen bzw. Aktanten in obligatorische (Objekte) und fakultative (Angaben) eingeteilt. In der Dependenzgrammatik wird das Verb als derjenige Teil angesehen, von dem alle andere Glieder des Satzes direkt oder indirekt abhängig sind. Die Teile des Satzes (Satzglieder), die dem Verb direkt untergeordnet sind, werden unterschiedslos Ergänzungen bzw. Aktanten genannt.*”/ Me valencë kuptojmë aftësinë e foljes, për të krijuar vende të caktuara bosh rreth saj. Me anë të valencës së foljes qendrore, plotësat, dmth aktantët ndahen në të detyrueshëm (kundrina) dhe fakultative

⁶⁷Bünding, Karl-Dieter: *Einführung in die Linguistik*. 15. Aufl., Frankfurt am main: Athenäums Studienbücher 1996, f. 164-165

(rrethanorë). Në gramatikën e dependencës folja shihet si ajo pjesë, nga e cila varen direkt ose indirekt të gjitha gjymtyrët e fjalisë. Gjymtyrët e fjalisë, të cilat janë në varësi direkte nga folja, do quhen pa dallim plotësa dmth aktante.”⁶⁸

Ndërsa tek Ernst gjejmë këtë përkufizim: “*Die Fähigkeiten von Verben, eine bestimmte Anzahl von Ergänzungen an sich zu binden, bezeichnet man als ‚Valenz‘, während ‚Dependenz‘ das hierarchische Abhängigkeitsverhältnis von Regens und Dependens bezeichnet.* / Aftësitë e foljeve, për të lidhur pas vetes një numër të caktuar plotësash, e përcaktojmë si valencë, ndërsa dependencë është raporti hierarkik i varësisë mes reagens dhe dependens.”⁶⁹

Gramatika e valencës (Valenzgrammatik) dhe gramatika e dependencës (Dependenzgrammatik) nuk janë sinonime, megjithëse shpeshherë termat përdoren si të tillë. Në të vërtetë në të dyja këto teori aftësinë për tu lidhur me fjalë të tjera nuk e ka vetëm folja, por dhe fjalë të tjera në fjali. Në rastin e këtij hulumtimi përbën interes vetëm valenca e foljeve.

4.3. Karl Hajnc Ramers (Karl Heinz Ramers)

Sipas Ramers⁷⁰, teza e Tesnierit do të thotë njëkohësisht dhe një shkëputje nga pretendimi me origjinë nga logjika antike se një fjali ndahet në dy pjesë të barazvlefshme kryefjalë- kallëzues. Më tej ai shprehet se në majë të hierarkisë qëndron folja, e cila përcakton se cilat lloje (këtë ai e quan valencë cilësore “qualitative Valenz”) dhe sa aktante (këtë e quan valencë sasiore “quantitative Valenz”) nevojiten, në mënyrë që një fjali të jetë e saktë nga ana gramatikore. Duke u bazuar tek Tensieri, në bazë të valencës sasiore kemi tri ndarjet e mëposhtme.

1. Aktanti i parë, i cili kryen veprimin
2. Aktanti i dytë, mbi të cilin bie veprimi
3. Aktanti i tretë, në dëm ose dobi të të cilit ndodh diçka.

Kjo ilustron me shembullin e mëposhtëm;

Erika schenkt **ihrer Schwester Blumen**. / Erika i dhuron lule motrës së saj.

(Akt. 1) (Akt. 2) (Akt. 3)

Aktanti i parë përfaqësohet nga një gjymtyrë në rasën emërore, i dyti nga një gjymtyrë në rasën kallëzore dhe i tretë nga një gjymtyrë në rasën dhanore, e thënë ndryshe i pari shpreh kryefjalën, i dyti kundrinën e drejtë dhe i tretë të zhdrejtën.

⁶⁸Po aty, f.137

⁶⁹Ernst, Peter: *Germanistische Sprachwissenschaft*. – Wien: Facultas 2004, f. 144

⁷⁰Ramers, Karl Heinz: *Einführung in die Syntax*. 2. Aufl. – Paderborn: Wilhelm Fink (UTB 2174)2007, f. 81-88

Ndërsa sipas numrit të aktanteve ose valencës cilësore Ramers thekson se Tesnieri dallon katër lloje foljesh:

1.folje zerovalente: schneien, regnen, donnern, nieseln, donnern./ bie borë, bie shi, bubullin

2.folje monovalente, jokalimtare): schlafen, gehen, lachen, hungern, rosten, erfrieren./ flej, shkoj, qesh, kam uri, ngrij.

3.folje dyvalente, kalimtare): schlagen, töten, lieben, helfen, widersprechen, gedenken./ godas, vras, dua, ndihmoj, kundërshtoj.

4.folje trivalente, kalimtare: geben, schenken, befehlen, sagen, überlassen, beschuldigen, berauben./ jap, dhuroj, ndihmoj, them, lë në dorë, bëj me faj, vjedh.

Duke u bazuar tek terminologjia tradicionale mund të thuhet se foljet njëvalentëshe kërkojnë një kryefjalë, foljet dyvalentëshe kërkojnë një kryefjalë dhe një kundrinë të drejtë, foljet trivalentëshe një kryefjalë, një kundrinë të drejtë dhe një kundrinë të zhdrejtë. Duhet theksuar se në rradhët e gjuhëtarëve të valencës egziston një mosdakortësi përsa i përket numrit maksimal të valencës së foljeve, konkretisht nëse një folje kufizohet me tre valenca apo mund të ketë një numër më të madh valencash, dmth nëse ka dhe folje, të cilat ofrojnë katër ose më shumë vende bosh. Madje dhe vetë Tesnieri nuk e përjashton faktin se mund të ekzistojnë dhe folje katërvalentëshe. Gjithashtu dhe gjuhëtarët Helbig/ Schenkel dhe Eisenberg supozojnë se në gjuhën gjermane mund të ketë folje të tilla. Eisenberg jep shembujt e mëposhtëm në lidhje me këtë:

Der Arzt antwortete mir auf den Brief, dass er kämme./ Mjeku mu përgjigj në letër, se do të vinte.

Uli bringt dem Vater die Mappe ins Büro./ Uli i sjell babait dosjen në zyrë.

Anna verkauft Rita das Auto./ Ana i shet Ritës makinën.


Ramers ilustron dhe një shembull të Heringer, i cili pohon se ekzistojnë dhe folje pesë valentëshe, p.sh.:

Karl einigt sich mit seinem Gegner in dieser Sache auf einen Vergleich./ Karli ra dakort me kundërshtarin e tij për këtë gjë me një krahasim.

Por sipas Ramers mbetet e paqartë çështja, në lidhje me këta shembuj nëse të gjithë dependentët e foljeve përkatëse janë aktante, apo mos ndoshta disa prej tyre janë rrethorë (p.sh. në letër, në zyrë).

Gjithsesi jam e mendimit se përsa i përket numrit të valencave të një folje, zgjidhja më e mirë me të cilën bien dakort dhe pjesa më e madhe e gjuhëtarëve është kufizimi në tri valenca, në përputhje me tre raportet kryefjalë, kundrinë e drejtë, kundrinë e zhdrejtë.

Siç u përmend dhe më lart dallohen dy lloje aktantesh: të detyrueshëm dhe fakultativ, si dhe rrethorë të lirë, të cilat janë gjithmonë fakultativ. Tek Duden⁷¹, në lidhje me këtë gjejmë paraqitjen e mëposhtme:



Për ta bërë më të kuptueshme po ilustroj me një shembull plotës të detyrueshëm dhe me një shembull tjetër rrethorë të cilët janë siç u shpreha më lart gjithmonë fakultativ.:

1. Thomas gibt **dem Jungen eine Schokolade**. / Tomasi i jep djalit një çokollatë.

Thomas gibt **dem Jungen**. / Tomasi i jep djalit.

Fjalja e dytë, ku është lënë jashtë kundrina, siç shihet është e paplotë dhe nuk bart asnjë kuptim.

Thomas gibt **dem Jungeneinmal** in der Woche **eine Schokolade**. / Tomasi i jep djalit një herë në javë një çokollatë.

Thomas gibt **dem Jungen eine Schokolade**. / Tomasi i jep djalit një çokollatë.

Në rastin e mësipërm shihet se dhe kur rrethorë lihet jashtë fjalja mbetet e plotë dhe me kuptim.

Siç do shihet dhe në shembullin e mëposhtëm, vështirësitë më të mëdha janë në rastin e aktanteve fakultative, të cilat zenë një vend bosh të foljes, por nuk janë të detyrueshme të përdoren në çdo rast.

Hans sprach **mit Sara über ihren Urlaub**. / Hansi foli me Sarën rreth pushimeve të saj.

Hans sprach **mit Sara**. / Hansi foli me Sarën.

Por Ramers vëren se në fjalitë e mëposhtme ka raste dyshimi duke ilustruar me shembujt e mëposhtëm:

Paul wohnt **in Stuttgart**. / Pauli banon në Shtuttgart.

⁷¹Duden. *Die Grammatik*. 7, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Leipzig, Dien, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 2006, f. 789

Paul wohnt./ Pauli banon.

Anna legt **den Brief in das Regal**./ Ana vendos zarfin në raft.

Anna legt **den Brief**./ Ana vendos zarfin.

Die Sitzung dauerte **drei Stunden**./ Mbledhja zgjati tre orë.

Die Sitzung dauerte./ Mbledhja zgjati.

“Obwohl die Orts- und Zeitangaben im ersen Beispiel, Umstände des Geschehens bezeichnen, also im semantischen Sinne Angaben binden, sind sie obligatorisch. Mit anderen Worten, das bei Tesniere primare semantische Kriterium und das funktionale Kriterium der Abgrenzung führen in den obigen Beispielen zu unterschiedlichen Ergebnissen. Die Orts- und Zeitangaben binden nämlich für die Verben ‘wohnen’, ‘legen’, und ‘dauern’ notwendige Ergänzungen, bei deren Fehlen die Verbbedeutungen unvollständig wären./ Megjithëse rrethantorët e vendit dhe të kohës në rastin e parë, paraqesin rrethanat e ngjarjes, pra janë rrethantorë në kuptimin semantik, ato janë të detyrueshëm. Me fjalë të tjera kriteri primar semantik i Tesnierit dhe kriteri i kufizimit, çojnë në shembujt e mësipërm në përfundime të ndryshme. Rrethantorët e vendit dhe të kohës formojnë për foljet ‘banoj’, ‘vendos’ dhe ‘zgjas’ plotësa të nevojshëm, pasi mungesa e tyre do çonte në një kuptim të cunguar të foljes.”⁷²

Sipas Engels dhe Ramers, gramatika e valencës nuk ka mundur të realizojë dot një ndarje të qartë mes aktanteve dhe rrethantorëve.

Duke e lidhur këtë thënie me kundrinën mund të thuhet se folja nga njëra anë përcakton numrin e kundrinave dhe nga ana tjetër funksionin e tyre semantik, dmth në çfarë forme morfosintaksore realizohen këto kundrina. Kundrinat shihen në këtë rast gjithmonë si aktante (= Ergänzungen) të detyrueshme.

4.4.Ulrich Engel (Ulrich Engel)

Tri gramatika të valencës relativisht modernë gjuhën gjermane, janë ajo e Engel botuar në 1994, e Heringer 1995 dhe Eroms botuar në vitin 2000. Siç u përmend më lart, Engel i ndan gjymtyrët e fjalisë në 11 plotësa⁷³ dhe rrethantorë (Angaben). Ai i qëndron tezës se plotësat e fjalisë mund të jenë të pranishëm ose vetëm në praninë e foljeve të caktuara, si p.sh plotësat e rasës kallëzore (Akkusativergänzungen), ose tek folje të caktuara janë të detyrueshme (p.sh. Situativangaben). Gjithashtu ai thekson se rrethantorët e fjalisë (Satzangaben) mund të shfaqen në fjali me çdo lloj folje.

Engel dallon katër lloje kundrinash, të cilat i përfshin në kategorinë e plotësive (Ergänzungen). Për kundrinat Engel përdor termat: plotës i rasës kallëzore (Akkusativergänzung). Këtu ai bën një lloj kufizimi duke u shprehur se jo të gjitha

⁷²Ramers, Karl Heinz: *Einführung in die Syntax*. 2. Aufl. – Paderborn: Wilhelm Fink (UTB 2174) 2007, f. 86

⁷³Engel, Ulrich: *Syntax der deutschen Gegenwartssprache*. 3., völlig neu bearb. Aufl. – Berlin: Erich Schmidt, 1994, f. 96-103

frazat e rasës kallëzore janë kundrina të drejta, si përshembull rasat ndajfoljore (die adverbialen Kasus). Ndërsa tek kundrina e rasës dhanore, të cilën e quan plotës të rasës dhanore (Dativergänzung), Engel përfshin dhe të shumëdebatuarat dhanore të lira. Kundrinën e rasës gjinore e quan plotës të rasës gjinore (Genitivergänzung), e cila sipas tij është pjesërisht e detyrueshme dhe pjesërisht fakultative. Plotës me parafjalë (Präpositivergänzung) është termi i përdorur prej tij për kundrinën me parafjalë.

4.5. Verner Eroms (Werner Eroms)

Gjithashtu dhe Verner Eroms⁷⁴, dallon ashtu si Engel 11 lloje plotësash, ndër të cilët dhe plotësin e rasës kallëzore (Akkusativergänzung), plotësin e rasës gjinore (Genitivergänzung), plotësin e rasës dhanore (Dativergänzung) dhe plotës me parafjalë (Präpositionalergänzung), të cilat përkojnë përkatësisht me katër kundrinat e gramatikës tradicionale.:

Ich habe **den Kanzler gesehen**. / Kam parë Kancelarin.

Er besichtigte ihn **des Meineids**. / Ai e akuzoi atë për dëshmi të rreme.

Er folgte **ihm**. / Ai e ndiqte atë.

Er hat ihn **mit diesen Argumenten** überzeugt. / Ai e bindi atë me këtë argument.

Sipas tij shfaqja e këtyre plotësave përcaktohet nga valenca e foljes. Për këtë arsye plotësat janë gjymtyrë të lidhura me valencën, të cilët vetëm tek elemente të caktuara mund të jenë kategori morfologjike.

4.6. Heringer

Një përfaqësues tjetër i gramatikës së valencës në gjuhën gjermane është Heringer me gramatikën e tij të botuar në vitin 1995. Ai e përkufizon kallëzuesin, dmth foljen sipas traditës së gramatikës së valencës “*als dasjenige Element, das „immer schon vorausgesetzt ist“, denn die „Verben verlangen nämlich gemäß ihrer Bedeutung bestimmte Ergänzungen“* / si elementin që është gjithmonë i paracaktuar, sepse foljet kërkojnë në bazë të kuptimit të tyre plotës të caktuar”⁷⁵. Plotësat që kërkon folja shprehet ai më tej janë kryefjala dhe kundrina. Ai gjithashtu përmend dhe plotësat jo të detyrueshëm, por pa i shtjelluar ato në mënyrë të detajuar. Heringer i përcakton plotësat në bazë të lakimit si vijon:

Kryefjala është sipas tij një plotës në rasën emërore, ndërsa kundrina e rasës kallëzore është një plotës në rasën kallëzore, ajo e rasës dhanore është një plotës në rasën dhanore dhe kundrina e rasës gjinore është plotës në rasën gjinore.

⁷⁴Eroms, Hans- Werner. *Syntax der deutschen Sprache*, Berlin/ New York: de Gruyter, 2000, f. 176-183

⁷⁵Heringer, Hans Jürgen: *Grammatik und Stil. Praktische Grammatik des Deutschen*. –Berlin: Cornelsen, 1995, f. 263

Tek kundrina e zhdrejtë Heringer dallon nga njëra anë kundrinën e brendshme dhe nga ana tjetër atë të jashtme⁷⁶:

Die Kinder verschmieren **das Bild**./ Fëmijët zhgarravisin pikturën.

Der Maler malt **das Bild**./ Piktori pikturon pikturën.

Vihet re se ai përfshin këtu dhe rrethanorët, duke e trajtuar rrethanorin e kohës si kundrinë:

Die Vorstellung dauerte **zwei Stunden**/ Prezantimi zgjati dy orë.

Gjithashtu dhe në fjalinë në vijim ai dallon një kundrinë të rasës dhanore, duke dalë në konkluzionin se në këtë fjali nuk kemi kryefjalë, por një kundrinë të rasës dhanore, çka e kthen kokëposhtë hierarkinë mes kryefjalës e kundrinave.:

Mir ist Angst geworden./ Më zuri frika.

4.7. Karin Pittner/ Judit Berman (Karin Pittner/ Judith Berman)

Sintaksa e Pitner/ Berman, ‘Deutsche syntax, ein Arbeitsbuch/ Sintaksa gjermane, një libër pune’ botuar në 2013, libër ky me karakter didaktik, për të gjithë ata nxënës e studentë që dëshërojnë të mësojnë gramatikën e gjuhës gjermane. Meqenëse është një tekst me karakter didaktik, në të tentohet të aplikohet gramatika e valencës, por e thjeshtëzuar dhe e ndërthurur dhe me elementë të gramatikës tradicionale. Ata i klasifikojnë gjymtyrët në bazë të provave të zëvendësimit me përemër vetor, provës së pyetjes përkatëse, provës së zhvendosjes dhe provës së ‘Vorfeld’/ paravendosjes në fjali, dmth nëse gjymtyrët mund të qëndrojnë vetëm para foljes. Gjymtyrët e fjalisë Pitner/ Berman i quajnë dhe funksione të fjalisë. Ata dallojnë katër gjymtyrë fjalie: kryefjalë, kundrinë, rrethanor dhe kallëzues.

Die Satzglieder nehmen diese Funktionen in Bezug auf das Voll- oder Kopulaverb des Satzes ein. Begriffe wie Subjekt, Objekt, Adverbial usw. sind also relationale Begriffe, eine NP ist nicht alleine Subjekt oder Objekt sondern immer in Bezug auf ein bestimmtes Verb./ Gjymtyrët e fjalisë marrin këto funksione në fjali në lidhje me foljen kryesore dhe atë ndihmëse. Termat si kryefjalë, kundrinë, rrethanor etj., janë kështu terma relativ, një frazë emërore nuk është vetëm kryefjalë ose kundrinë, por i referohet një folje të caktuar.’⁷⁷

Ndërsa sipas formës ata dallojnë katër kundrina⁷⁸: kundrina e rasës kallëzore, kundrina e rasës dhanore, kundrina e rasës gjinore dhe kundrina me parafjalë. Për kundrinat ata përdorin termin ‘objekt’, sipas terminologjisë tradicionale ose ‘ergänzung’ sipas terminologjisë së valencës dependencës.

⁷⁶Po aty, f.271

⁷⁷Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 35

⁷⁸Po aty, f. 36-40

Gjithashtu ata shprehen se rasa e kundrinave sundohet nga folja. Në rastin e kundrinave me parafjalë, parafjala sundohet nga folja.

Më tej ata shtjellojnë shkurtimisht kundrinat të ilustruara me shembuj. Në rastin e kundrinës me parafjalë, bëjnë dhe dallimin mes saj dhe rrethanorit.

Gjithashtu ata dallojnë dhe ‘Prädikativ/ kallëzuesorin’ si gjymtyrë të veçantë. Dallojnë tri lloje:

1.Subjektsprädikativ/ kallëzuesor i kryefjalës (Shfaqen të shoqëruara me foljet kopula dhe së bashku me to formojnë kallëzuesin.: Ich bin **müde**./ Unë jam i lodhur.)

2.Objektsprädikativ/ kallëzuesor i kundrinës (gjymtyrë që i referohen kundrinës: Sie nannte ihn **einen Idioten**./ Ajo e quajti atë idiot.)

3.Freie Prädikativ/ kallëzuesor i lirë (gjymtyrë që nuk varen nga folja, por nga kundrina ose kryefjala: Man hielt ihn **für ein Genie**./ E mbanin për gjeni.).

Më pas kundrinat trajtohen më nga afër në prizmin e gramatikës së dependencës e valencës duke u bazuar në modelin e Tesnierit dhe Engelsit. Ato futen në kategorinë e ‘Ergänzungen ose Komplemente’/ plotësive dhe si tek Tesniere numri i tyre varet nga valenca foljeve. Këto të fundit mund të jenë dy, tri ose katër valentëshe.

Nisur nga teoria e valencës Pitner/ Berman shqyrtojnë hollësisht dhe të ashtuquajturën dhanore të lirë, të cilën ata e diferencojnë nga kundrina. “*Das Dativobjekt ist im Stellenplan des Verbs festgelegt, wird also von der Valenz des Verbs gefordert. Kategorial realisiert ist das Dativ i..d.R durch eine NP im Dativ. Als freier Dativ wird die Funktion einer ebenfalls dativisch markierten NP bezeichnet, die aber im Gegensatz zum Dativobjekt nicht valenzgebunden ist.*”⁷⁹: Kundrina e rasës dhanore është e përcaktuar sipas vendit të foljes, dmth. varet nga valenca e foljes.Si rregull kundrina e rasës dhanore realizohet nga një frazë emërore në rasën dhanore. Si dhanore të lirë kemi gjithashtu një frazë emërore në rasën dhanore, e cila ndryshe nga kundrina e rasës dhanore, nuk varet nga valenca e foljes.”⁷⁹:

Er widmet **ihr** das Buch.(Dativobjekt)/ Ai i dedikon asaj librin. (kundrinë e rasës dhanore)

Er tanzt **ihr** zu schlecht. (Freier Dativ)/ Sipas saj ai vallëzon keq. (dhanore e lirë)

Dhanoren e lirë ata e ndajnë në pesë lloje:

1.dhanore komodi: Sie bügelt **mir** die Wäsche/ Ajo më hekuros mua rrobat.

2.dhanore inkomodi: Die Farbe ist **ihr** umgekippt./ Asaj ju rrëzua boja.

3.dhanore posesive: Sie schminkt **ihm** das Gesicht./ Ajo i lyen atij fytyrën.

⁷⁹Po aty, f. 54

4.dhanore iudikantis: Sie trinkt **ihm** zu viel./ Ajo pi shumë sipas tij.

5.dhanore etike: Du bist **mir** ja ein schöner Freund./ Ti je një shok i mirë për mua.

Me fjalitë e mësipërme ata realizojnë një sërë provash operacionale për të dalë në përfundimin:

“Interessanterweise verhalten sich der dativus commodi, incommodi und possessivus bezüglich dieser Tests wie dativobjekte. Sie sind vorfeldfähig, erfragbar und können durch beliebige semantisch kompatible Dativ- NPs realisiert werden. Die Tatsache, dass sie Subjekt des Rezipientenpassivs sein können und dass sie nicht zusammen mit einem weiteren Dativobjekt auftreten können, sind wichtige hinweise auf ihren Objektstatus”/ Është interesant fakti se dhanorja komodi, inkomodi dhe ajo posesive sillen si kundrina. Ato mund të vendosen në fillim të fjalisë, mund të përdoret pyetja analitike dhe mund të realizohen me anë të frazave emërore të ndryshme në dhanore. Rëndësi për statusin e tyre si kundrina luan dhe fakti se ato bëhen kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore dhe nuk mund të shoqërohen nga një kundrinë tjetër e rasës dhanore në fjali.”⁸⁰

Në rastin e dhanores judikantis sipas tyre kemi të bëjmë me rrethanor, ndërsa dhanorja etike nuk është as kundrinë as rrethanor, dmth nuk është gjymtyrë fjalie.

Së fundi mund të thuhet se shumë pak gramatika bazohen vetëm tek teoria e valencës. Shumica e gramatikave të ditëve të sotme frymëzohen nga gramatika klasike e valencës, siç mund të thuhet dhe për gramatikën gjenerative që do shohim në vijim.

5.Gramatika gjenerative

5.1. Noam Avram Çomski

Gramatika gjenerative transformative përbën një nga modelet më të rëndësishme të gramatikës moderne. Ajo u themelua nga Avram Noam Çomski (Avram Noam Chomsky) në mesin e viteve 50 me veprën e tij “Syntactic structures”, botuar në 1957, qëllimi i së cilës ishte të hartonte një gramatikë, e cila mund të gjeneronte të gjitha fjalitë e mundshme të një gjuhe, çka shpjegon origjinën e emërimit ‘gjenerative’. Në qendër të saj qëndron transformimi. Kjo është dhe arsyeja pse ky model gramatikor emërtohet si gramatikë gjenerative transformuese. Çomski e zhvilloi më tej teorinë e tij në veprën “Aspects of the theory of syntax”, botuar në 1965. Ai e formalizoi plotësisht përshkrimin e gjuhës me anë të formulave mjaft të komplikuar, të ngjashme me ato matematikore të algjebërës. Vetë Çomski në veprat e mëvonshme i jep emra të ndryshëm kësaj teorie si p.sh. Extended Standard Theory, Government and Binding, Principles and Parameters, Minimalist Program, Theoretical Linguistics.

Gramatika gjenerative tenton të sjellë një teori gjuhësore universale gjithëpërfshirëse. Ajo e sheh sintaksën si pjesën qendrore të sistemit gjuhësor, të shkëputur nga

⁸⁰Po aty, f. 57

rregullatorët e tjerë gjuhësor, veçanërisht nga semantika. Ndryshe nga gramatika deskriptive, e cila përpiqet ti përshkruajë fenomenet e gjuhës, gramatika gjenerative fokusohet kryesisht tek karakteristikat e nevojshme strukturore të gjuhëve natyrale. Këto struktura duhet të përcaktohen dhe të shprehen mundësisht në sa më pak rregulla. Gjuha shihet si pjesë e dijes njerëzore dhe si aftësi e njeriut për ta përdorur atë. Përveç gjenerimit të fjalive, çështja tjetër themelore e ngritur nga gjenerativistët është: ‘Si është e mundur që njeriu është në gjendje të mësojë në një kohë të shkurtër një sistem aq kompleks e të komplikuar, siç është gjuha?’. Përgjigjja e kësaj pyetje sipas tyre është se aftësia e njeriut për të folur, dmth për të formuar fjali të sakta gramatikore, bazohet në struktura konjiktive, të cilat janë të trashëguara gjenetiksht, duke krijuar kështu mundësinë e një gramatike universale. Kjo gramatikë universale përfshin parime të caktuara, të cilat janë të lindura dhe mundësojnë mësimin e një gjuhe. Detyra e kësaj teorie gramatikore është të hetojë këto parime elementare. Me anë të këtij qëndrimi ata distancohen nga bihejviorizmi, i cili merr për të mirëqenë faktin se njeriu vjen në jetë si “tabula rasa”, dmth pa aftësi të lindura, dhe në këtë mënyrë e mëson gjuhën me anë të imitimit të mjedisit të tij.

Çomski gjithashtu bën dallimin mes kompetencës dhe performancës (terma të sajuara prej tij). “*Von dieser Idee ausgehend unterscheidet Chomsky zwischen Kompetenz und Performanz. Dabei versteht er unter Kompetenz das Wissen eines Menschen um die Regeln seiner Sprache bzw. die „Fähigkeit, die unserem Sprachgebrauch zugrunde liegt. Die Kompetenz ist angeboren und kann auf der Basis von grammatischen Universalien erklärt werden. Unter Performanz dagegen versteht Chomsky die tatsächliche Verwendung dieser Sprache in realen Situationen und die Art und Weise, wie wir von der Kompetenz Gebrauch machen.* / Me kompetencë ai nënkupton njohuritë e njeriut për rregullat e gjuhës së tij, dmth aftësinë që qëndron në themel të përdorimit të gjuhës. Në të kundërt, me performancë ai nënkupton përdorimin e vërtetë të kësaj gjuhe në situata reale dhe mënyrën se si e vëmë në përdorim kompetencën.”⁸¹ Kjo tregon qartë se gramatika gjenerative është e lidhur ngushtë me njohjen, aspektin konjiktiv dhe zhvillimin e gjuhës.

Gramatika transformuese operon në të njëjtën fushë me gramatikën tradicionale, dukeqenëse të dyja përfaqësojnë idenë se kompetenca e një folësi për të shprehur mendimet e tij me anë të tingujve të vendosura në një tekst. Por në modelin gramatikor të Çomskit tekstin shihet si një rezultat i zbatimit të rregullave. Këto rregulla duhet të mbulojnë aspektin fonetik- fonologjik, morfologjik, sintaksor, si dhe atë semantik. Në vijim do shohim më nga afër aspektin sintaksor, çka përbën dhe interes për temën e punimit tonë.

Aspekti sintaksor në gramatikën gjenerative sipas Çomskit⁸² ndahet në dy pjesë: në pjesën e bazës dhe atë transformuese. Raportet themelore sintaksore të njëjësive

⁸¹Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 418

⁸²Chomsky Noam, *Strukturat sintaksore*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 2011

sintaksore, të ashtuquajturat struktura të thella krijohen në pjesën e bazës. Në pjesën transformuese krijohen strukturat sipërfaqësore, lidhjet e njësive gramatikore më të vogla. Këto janë ose të karakterit gramatikor (rasë, numër, gjini) ose të karakterit leksikor. Me anë të transformimeve elementet zëvendësohen, fshihen, zhvendosen, ose shtohen.”

Strukturat sipërfaqësore dhe strukturat e thella dallohen në aspektin empirik. Struktura sipërfaqësore e një fjalie interpretohet nga pjesa fonologjike, ndërsa struktura e thellë nga ajo semantike. Rezultati i bashkimit të të dyja pjesëve përbën përshkrimin e plotë gramatikor të fjalisë.

Për të mundësuar gjenerimin e fjalisë në gramatikën gjenerative, fillohet me përshkrimin e saktë të fjalisë në pjesën e bazës së fjalisë. Për të analizuar një fjali në gramatikën gjenerative nevojiten katër lloje simbolesh. Si fillim nevojitet një ‘S’ për fjalinë. Për përcaktimin e strukturës së konstituenteve (konstituentenstruktur) përdoren simbole , të cilat janë marrë nga kategoritë gramatikore të fjalëve në gramatikën tradicionale. ‘NP’ është simboli për sintagmën emërore, ‘VP’ për sintagmën foljore, ‘N’ për emrat, ‘Adj’ për mbiemrat etj.

“Die Kategorien der Namen werden bestimmt anhand ihrer Stellung im Baumgraph, dem Erzeugungsbaum. Sie stellen aber keine Funktionen dar, diese sind erst erkennbar an den Beziehungen zwischen Kategorialsymbol und Satzsymbol. Die dritte Symbolart steht für die lexikalischen Formative, die für die Lexeme stehen. Sie stehen in Kleinbuchstaben im Graph. Die vierte und letzte Symbolart sind Formelzeichen./ Llojet e fjalëve përcaktohen duke u bazuar në vendosjen e tyre në paraqitjen grafike të pemës gjeneruese (Baumgraph). Por ato nuk përfaqësojnë funksione të caktuara. Funksionet dallohen tek raportet mes simbolit të kategorisë dhe simbolit të fjalisë. Lloji i tretë i simboleve është për formën leksikore, që shpreh leksemat. Ato shënohen me shkronja të vogla në skemë. Simboli i katërt dhe i fundit janë formulat.”⁸³

Termi gramatikë gjenerative në ditët e sotme përdoret si një term përgjithësues për teori të ndryshme gramatikore, me anë të sistemit të rregullave të së cilave gjenerohen fjalitë e një gjuhe. Këto teori alternative, kanë lindur e janë zhvilluar me tej prej gramatikës gjenerative. Të tilla janë: skema x-bar (x- bar- Schema), lëvizja α (move α), teoria e rasës (Kasus Theorie) si dhe teoria teta (Theta Theorie). Këto teori të reja të gramatikës gjenerative, përpiqen të zëvendësojnë një tërësi rregullash mjaft komplekse me anë të një numri të vogël parimesh dhe modulesh. Ato vazhdojnë të ofrojnë një gramatikë universale, e cila mund të zbatohet tek të gjitha gjuhët.

Për gjuhën gjermane, ashtu si dhe për gjuhët e tjera, nuk egziston një teori e plotë gjenerative transformuese. *“Es gibt nur einerseits Ansätze, Grammatiken für sehr beschränkte und relativ einfache Sätze des Deutschen zu konstruieren und andererseits*

⁸³Bünting, Karl- Dieter: *Einführung in die Linguistik*. 15. Aufl., Frankfurt am main: Athenäums Studienbücher 1996, f. 174

generative Untersuchungen der deutschen Sprache. / Egzistojnë nga njëra anë projekte, gramatikash për ndërtimin e fjalive shumë të kufizuara dhe te thjeshta të gjuhës gjermane dhe nga ana tjetër analiza gjenerative të gjuhës gjermane.”⁸⁴

Shumë parime të gramatikës gjenerative kanë ndeshur në kritika nga gjuhëtarë të ndryshëm. Veçanërisht ideja kryesore e tyre se të gjithë njerëzit zotërojnë një gramatikë të lindur universale. Jam e mendimit se një gramatikë universale rrjedh nga fakti se gjuha kushtëzohet gjithmonë nga kushtet tona të jetesës dhe të gjithë njerëzit i nënshtrohen disa kushteve të njëjta jetese, kjo shpjegon p.sh. arsyen pse ekzistojnë fjalët ‘ha’ dhe ‘pi’ në të gjitha gjuhët. Ky fakt vlen dhe për strukturën gramatikore të një gjuhe, prandaj në të gjitha gjuhët egziston një kategori fjale (përgjithësisht një emër) për të përcaktuar të gjithë sendet. Gjithashtu, modeli i ofruar nga Çomski mendoj se nuk arriti dot të paraqiste sa duhet raportet e vërteta sintaksore të një gjuhe si dhe të jepte mjaftueshëm qartë kuptimin e fjalive. Fakti që lihet pas dore aspekti semantik gjatë analizimit të fjalive, bën që fjali pa kuptim të cilësohen si të sakta, nëse janë korrekte në aspektin gramatikor. Gjithashtu, karakteri i saj tejet shkencor e teorik e bëjnë të papërshtatshme gramatikën gjenerative për tu përdorur si tekst mësimor për mësimin e gjuhës. Mbi të gjitha ky model dështoi tek synimi i tij kryesor për të qenë një gramatikë universale për të gjitha gjuhët.

Gjuhëtari Christian Lehmann⁸⁵ në kritikën që i bën këtij modeli gramatikor shprehet ndër të tjera se ky model gramatikor sipas tij nuk ka arritur dot të përfshijësa duhet aspektet psikike/ konjiktive, sociale/ komunikative, kulturore dhe historike. Gjithashtu ai nuk mund ti bashkëngjitet teorive të tjera të cilat i kushtohen këtyre aspekteve. Më tej ai shton se një teori shkencore mund ta përmbledhë gjuhën vetëm nëse i jep një pozicion qendror semantikës dhe merr parasysh sistematikisht kushtet jashtëgjuhësore të procesit gjuhësor. Prandaj sipas tij gramatika gjenerative nuk ofron një teori të mjaftueshme për objektin e gjuhësisë së përgjithshme dhe deskriptive. Një tjetër problem sipas tij përbën fakti se ky model gjuhësor nuk mund të përdoret në gramatika për mësimin e gjuhës ose programe kompjuterike për përpunim gjuhësor. Gjithashtu ai nuk jep asnjë kontribut në problemin më emergjent me të cilin përballlet linguistika sot, i cili është dokumentimi i gjuhëve të vdekura.

Gramatika gjenerative bën një ndarje strikte të fjalisë në dy gjymtyrë, çka na kujton modelin aristotelian të fjalisë. Në fillimet e gramatikës gjenerative, në vitet 50, duke u bazuar te gramatika e strukturës së sintagmës (Phrasenstrukturgrammatik), një fjali S ndahet në dy pjesë në sintagmën emërore (Nominalphrase) NP dhe sintagmën foljore (Verbalphrase) VP. Np-ja dhe VP-ja nuk përshkruajnë një funksion, por janë të motivuara në aspektin leksikor: një NP ka një emër si kokë, ndërsa një VP ka një folje


⁸⁴Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 420

⁸⁵<https://www.christianlehmann.eu/termini/index.html>?https://www.christianlehmann.eu/termini/generative_grammatik.html

si kokë. Dy kategoritë e tjera leksikore në gramatikën gjenerative janë sintagmat mbiemërore (Adjektivphrasen) AP dhe sintagmat parafjalore (Präpositionalphrasen). Analiza në formë të thjeshtuar e fjalisë në gramatikën gjenerative paraqitet nga Ramers si vijon:

VP → V

Ana wäscht ihr Kleid./ Ana lan fustanin e saj.



Gramatika gjenerative jo vetëm që i huazoi termat ‘kryefjalë’ e ‘kundrinë’, por i dha atyre një vend qendror. Në fjalinë e mësipërme, ashtu si në gramatikën tradicionale ‘Ana’ është kryefjalë dhe ‘fustanin e saj’ kundrinë. Sipas gramatikës gjenerative, kjo skemë si rregull mundet të përshkruajë fjalitë në të gjitha gjuhët e botës. Në këtë model gramatikor gramatika paraqet shumatoren e të gjitha operacioneve të nevojshme për krijimin e fjalisë.

5.2. Teoria X-Bar

Teoria X-Bar, e cila u zhvillua më vonë, kishte si qëllim të mundësonte që me anë të skemës X-Bar të realizonte një përshkrim më të saktë të raporteve mes konstituentëve të veçanta, të cilat duhet të jenë të vlefshme për çdo sintagmë të veçantë. Tek Ramers⁸⁶ ndeshen dy parimet e mëposhtme të kësaj teorie, të cilat përbëjnë rëndësi të veçantë për punimin:

1. Kryefjala është VP- e jashtme dhe kundrina është VP- e brendshme: Çdo fjali duhet të përbëhet nga një NP dhe nga një VP, por meqënëse një VP nuk përmban detyrimisht një NP tjetër, por mund të përbëhet vetëm nga folja si në rastin e foljeve jokalistare,


⁸⁶Ramers, Karl Heinz: *Einführung in die Syntax*. 2. Aufl. – Paderborn: Wilhelm Fink (UTB 2174) 2007, f. 42- 54

por NP (në pozicionin specifikator të VP) duhet të jetë patjetër e plotësuar, si rrjedhojë çdo fjali jokalimtare duhet të përmbajë të paktën një kryefjalë dhe një kallëzues, dmth përkatësisht një sintagmë emërore NP dhe një sintagmë foljore VP. Ndërsa një fjali kalimtare, në mënyrë që të jetë e saktë në aspektin gramatikor kërkon dhe një kundrinë në këtë rast sintagmë emërore NP. Kjo do të thotë se për kundrina me anë të vendosjes së saj brenda VP-së ka një raport dhe më të ngushtë me foljen se kryefjala, e cila qëndron jashtë VP-së.


2.struktura e sintagmës gjenerative punon me operacione tërësisht binare. Një ndryshim i rëndësishëm me teorinë e valencës, në të cilën përdoren gjithashtu diagramat në formën e pemës (Baumdiagramme), qëndron në faktin se një nyje mund të ketë gjithmonë maksimumi dy cepa (Kanten). Në teorinë e valencës qëndron zakonisht folja në majë të strukturës së pemës dhe zotëron mbi një numër të caktuar dependentësh. Kjo do të thotë se një regens mund të ketë dhe më shumë se dy dependentë nën vete, duke qenë se ka në vartësi përveç aktanteve (kundrinave) dhe rrethanorët. Për ta bërë më të qartë ndryshimin mes një peme në teorinë e gramatikës së valencës dhe në atë gjenerative do i shtoj fjalisë një rrethanor:

Ana wäscht ihr Kleid in der Früh./ Ana lan fustanin e saj në mëngjes.

Në teorinë e valencës kjo paraqitet si më poshtë:



Ndërsa në skemën X-Bar të gramatikës gjenerative e njëjta fjali paraqitet si vijon:



V0 NP
wäscht *ihr Kleid*

Siç vihet re, rrethanori ‘në mëngjes’, në diagramin e gramatikës së valencës qëndron si një rrethanor i lirë direkt poshtë foljes (por nuk zë asnjë vend bosh ‘Leerstelle’ të hapur nga folja), ndërsa në diagramin e gramatikës gjenerative shtohet si AP tek V, duke u vendosur kështu në një shkallë tjetër hierarkie në krahasim me NP ‘fustanin’. AP është njëkohësisht nyje motër e V’ dhe dominohet nga V’, ndërsa NP ‘fustanin e saj’ në të kundërt dominohet gjithashtu nga V’, por është nyje motër me V0. NP-ja gjithashtu është komplement i kokës V0. Kjo do të thotë se vetëm NP-ja nëndahet nga koka, por jo AP. Ndarja në dy pjesë e V’ mbetet e pandryshuar, duke qenë se AP-ja praktikisht mund të shtohet apo të hiqet si adjunkt i V’-së. Në të kundërt, është e mundur gjithashtu që adjunktë të caktuara të shfaqen te V’. Komplementi është i detyrueshëm dhe kërkohet si plotës i nevojshëm nga koka, në këtë rast nga folja ‘laj’.

Kundrina në këndvështrimin e sintaksës gjenerative, përcaktohet si ‘komplement’/plotës i foljes (i kokës V0). Kjo kundrinë përkon me kundrinën e rasës dhanore në terminologjinë tradicionale. Duke iu kthyer edhe njëherë pikës se dytë mund të thuhet se për termat kundrinë e drejtë dhe kundrinë e zhdrejtë, nuk ka vend në gramatikën gjenerative, duke qenë se kundrina del si i vetmi plotës i kokës V0 (komplement), duke marrë kështu një status tjetër nga ai i së ashtëquajturës ‘kundrinë e zhdrejtë’, e cila trajtohet veçmas. Dhe vërtetë gjatë hulumtimit u vu re se statusi i kundrinës së zhdrejtë në këtë teori gramatikore, është i shumëdebatueshëm. Sipas Trask “*In der Generativen Grammatik wird nur das direkte Objekt als Objekt anerkannt, womit die*

Unterscheidung ‚direkt‘ und ‚indirekt‘ überflüssig wird und nur mehr von ‚Objekten‘ die Rede ist. Indirekte Objekte gelten demnach nicht als Objekte.’/ Në gramatikën gjenerative njihet vetëm kundrina e drejtë si kundrinë, çka e bën të panevojshëm ndryshimin mes kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë duke qenë se bëhet fjalë për kundrina në përgjithësi. Kundrina e zhdrejtë nuk egziston.”⁸⁷

Përdorimi i termit ‘kundrinë’ në gramatikën gjenerative nuk është i njehsuar, megjithëse vërehet se përgjithësisht përdoret termi ‘komplement’/ plotës i foljes. Ndërsa Ramers në veprën e tij ‘Hyrje në sintaksë’, megjithëse është një sintaksë me orientim gjenerativ, përdor termin ‘kundrinë e rasës kallëzore’ dhe ‘kundrinë e rasës dhanore’. Përdorimin e këtyre dy termave sipas Ramers e ndeshim dhe tek Grevendorf në veprën e tij ‘ Sintaksa minimaliste’.

Përmbledhtasi mund të thuhet se koncepti i ‘kryefjalës’ dhe ‘kundrinës’, panvarësisht termit të përdorur për to, luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në gramatikën gjenerative veçanërisht në lidhje me parimin e saj të universalitetit. Kjo e bën modelin e fjalisë së gramatikës gjenerative shumë të përafërt me atë të logjikës antike, ku ndarja “e vjetër” në kryefjalë dhe kallëzues pasqyrohet në dy sintagmat NP dhe VP. Gjuhëtari gjerman Welke (Welke) bën një paralelizëm mes raporteve sintaksore ndërmjet teorisë X-Bar dhe gjymtyrëve të fjalisë në analizën tradicionale të gjymtyrëve të fjalisë. Ai shprehet se “*Kopf‘, ‚Komplement‘, ‚Spezifikator‘ und ‚Adjunkt‘ im Großen und Ganzen ‚Prädikat‘ (= Verb), ‚Objekt‘, ‚Subjekt‘ und ‚Adverbialbestimmung‘ entsprechen*”/ ‘koka’, ‘plotësi’, ‘specifikuesi’ dhe ‘adjunkti’ përkojnë përkatësisht me ‘kallëzuesin’ (=folja), kundrinën, kryefjalën dhe rrethanorin.”⁸⁸

Terminologjinë e gjymtyrëve të fjalisë, e cila është ndeshur në teorinë e ndryshme të diskutuara në këtë kre po i paraqes përmbledhtas në tabelën në vijim:

Emërtimi i gjymtyrëve të fjalisë në teori të ndryshme gramatikore

Gramatika e logjikës së antikitetit (Platoni/ Aristoteli):	<i>Rhēma/ rema</i>	<i>ónoma/ onoma</i>	<i>Rhēma/ rema</i>	
Gramatika tradicionale:	Prädikat/kallëzues	Subjekt/ kryefjalë	Objekt/ kundrinë	Adverbiale Bestimmung/ rrethanor

⁸⁷Trask, Robert Lawrence: *Language and Linguistics. The Key Concepts*. 2. Aufl. Hg. von Peter Stockwell. – Routledge, London 2007, f. 116

⁸⁸Welke, Klaus, *Valenztheorie und Konstruktionsgrammatik*. (MS) – Erscheint in: *ZGL*2009/1, f. 3

Gramatika me orientim nga përmbajtja:	Prädikat/kallëzues	Subjekt/ kryefjalë	Objekt/ kundrinë	Adverbiale Bestimmung/ rrethor
Gramatika e dependencës dhe e valencës:	Valenzträger/ mbartës i valencës	Ergänzung/ plotës	Ergänzung/ plotës	Angabe/ rrethor
Gramatika gjenerative:	Kopf/ koka	Spezifikator/ specifikues	Komplement/ komplement	Adjunkt/ adjunkt

KREU II - KUNDRINA NË TEORITË E NDRYSHME GRAMATIKORE NË GJUHËN SHQIPE

Në traditën tonë gramatikore, kundrina përgjithësisht shihet si gjymtyrë e dytë e fjalisë. Dallimi i gjymtyrëve të dyta në gjuhësinë shqiptare bëhet në fillim të shekullit të XX, ndërsa i kundrinës bëhet për herë të parë nga Aleksandër Xhuvani⁸⁹ në sintaksën e parë shkollore të gjuhës shqipe, shkruar prej tij 1920, ku autori dallon kryefjalën, kallëzuesin, cilësorin, ndajstimin, kundrinën dhe rrethanorin. Në gjuhësinë shqiptare studimi i gjymtyrëve të fjalisë në përgjithësi, sidomos i të ashtuquajturave gjymtyrë të dyta si kategori sintaksore, nuk ka qenë objekt punimesh të posaçme të thelluara. Ato janë trajtuar kryesisht në tekstet shkollore të sintaksës së gjuhës shqipe. Duhet patur parasysh këtu se gjuha shqipe ka një traditë sintaksore relativisht të re, krahasuar p.sh. me gjuhën gjermane.

Gjithashtu vlen të thuhet se studimi i gjymtyrëve të dyta të fjalisë është një nga çështjet më me probleme e diskutime të sintaksës së gjuhës shqipe. Siç do shihet në këtë kre, mes sintaksologëve shqiptarë ka mospajtime në lidhje me përcaktimin, përkufizimin si dhe klasifikimin e tyre, veçanërisht për sa i përket përcaktimit të caqeve të shtrirjes së një gjymtyrë të dytë. Në pjesën e fundit të këtij kreu gjithashtu do vërehet se stadi i sotëm i studimeve në këtë fushë karakterizohet nga përpjekja për ta zhvilluar më tej teorinë tradicionale të gjymtyrëve të dyta, për të përshkruar me mënyra të reja formalo-gramatikore përbërjen e fjalisë. Por jam e mendimit se teoria e gjymtyrëve në përgjithësi mbetet mënyra më e volitshme dhe më e pranueshme për një fazë të parë të analizës së përbërjes së fjalisë.

Përnaska pohon se, me gjithë arritjet në studimin e gjymtyrëve të fjalisë në tekstet shkollore, si edhe në studimet sintaksore, ende nuk është përpunuar sa e si duhet koncepti gjuhësor për vetë gjymtyrët e fjalisë, për vëllimin, për numrin e tyre, për kufirin e tyre me fjalën, me togfjalëshin e me vetë fjalinë.⁹⁰

Gjithashtu vlen të theksohet se, në lidhje me teorinë e gjymtyrëve të dyta, dhe sidomos për kundrinat, për shkak të shumëllojshërisë së kundrimeve teorike që hasen në letërsinë shkencore të hulumtuar, nuk gjendet qartësia dhe rreptësia shkencore që pritet. Mund të thuhet se, më shumë se zgjidhje aty gjenden ide dhe mendime nxitëse që japin mundësi dhe hapin rrugë për hulumtime të mëtejshme të imta.

Në vijim pas shtjellimit të termit kundrinë, do merrem me trajtimin e kundrinës në gjuhën shqipe dhe evoluimin të saj në rrafshin historik, duke analizuar trajtimin teorik në këndvështrime të ndryshme gramatikore, që kanë gjetur zbatim nga

⁸⁹Xhuvani, Aleksandër, *Sintaksa shqip*, 'Pjes' e parë për klasët e ulta të shkollave të mesme,' Shtëpia botuese Luarasi, Tiranë 1920, f. 9-10

⁹⁰Përnaska, Remzi, *Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2000, f. 11

gjuhëtarëtëndryshëm në gjuhën shqipe, duke filluar me atë tradicionale e deri tek më bashkëkohoret.

1. Origjina e termit kundrinë

Termi kundrinë, siç u tha më sipër është krijuar për herë të parë nga gjuhëtari i shquar Aleksandër Xhuvani në vitin 1920. Është interesant fakti se me gjithë ndryshimet që ka pësuar gjatë rrugës ndër vite, është pikërisht ky term që gjen përdorimin më të gjerë dhe sot, duke qenë se përdoret në ‘Gramatikën 2, sintaksa’, të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e në mjaft studime e pjesën më të madhe të gramatikave të tjera që do trajtohen në vijim. Ndërsa termin e huazuar nga gjuha angleze apo gjermane “objekt” e hasim tek Kristaq Cipo, në veprën e tij Sintaksa botuar në vitin 1952.

Ndërsa Remzi Përnaska, i cili është ndër gjuhëtarët e gjuhës shqipe që është marrë më gjerësisht me kundrinën përdor termin ‘kundranë’, duke e përligjuar arsyen e kësaj zgjedhjeje me një arsyetim mjaft profesional, logjik e të detajuar si vijon:

“Pjesa më e madhe e skajeve gjuhësore të shqipëruara nga gjuhëtari ynë i shquar është e përshtatshme në vetvete sepse është me ndërlidhje nocionore. Por me skajin ‘kundrinë’, prishet bashkërendimi organik nga njëra anë me skajet ‘ndëfjalë’ sa ‘kryefjalë’ dhe nga ana tjetër me skajet ‘cilësor’ dhe ‘plotës’ që përdoret në të gjitha librat që janë shkruar për mësimin e gjuhës shqipe në shkollë.”⁹¹ Ai sqaron më tej se bashkërendimi organik do të prishet më vonë edhe nga autorë të tjerë, me këto skaje dhe me skaje të tjera.

Sipas Përnaskës, në mënyrë që të rivendosë bashkërendimin organik Selman Riza përdor termin vetjak ‘kundranë’. “Çiftit ‘kundrinë’/ ‘rrethanë’ që ka zënë rrënjë në traditën tonë sintaksore, ai i kundërvë vetjakun ‘kundranë’/ ‘rrethanë’, kurse çiftit tjetër ‘ndëfjalë’ sa ‘kryefjalë’/ ‘kundrinë’ i kundërvë vetjakun ‘ndënanë’/ ‘kundranë’. Skajet ‘ndënanë’, ‘kundranë’ dhe ‘rrethanë’ mbahen nga mjeshtri ynë edhe si skaje jashtëgjuhësore.”⁹² Përnaska rendit dhe disa arsye përse Selman Riza parapëlqen këto skaje të veta si më poshtë:

Brenda mundësive, korrelacioni nocionor duhet të pasqyrohet në materialin prapashtesor. Prandaj mund të thuhet ose ‘rrethinë’/ ‘kundrinë’, ose ‘rrethanë’/ ‘kundranë’. Termi ‘rrethinë’ i përket vetëm gjeografisë; prandaj edhe termi ‘kundrinë’ është për t’u specializuar në kuptimin po gjeografik të një hapësire natyrore që shtrihet përkundrejt soditësit. Krahas termit ‘rrethanë’, i cili sipas tij tashmë është konfirmuar përfundimisht edhe jashtë gjuhësisë, dhe në kundërshtim me termin ‘kundrinë’. cili ende sot e kësaj dite ka mbetur në fakt vetëm gramatikor, termi ‘kundranë’ ka më shumë gjasa se do të bëhet i përdorshëm edhe jashtë gramatikës.

⁹¹Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 21

⁹²Po aty

Riza shprehet gjithashtu se, “në të mirë të termit ‘kundranë’ do të fliste edhe mundësia për të ndërtuar bashkëpalësin e tij nocionor, mundësi kjo që nuk ekziston për terminin ‘kundrinë’, sepse prapashitesa –inë nuk do të mund të shërbente si temë e parafjalës n(d)ën, - dhe bashkëpalës ky, për të cilin kemi nevojë, sepse bartësi i vështruar objektivisht e për pasojë jashtëgjuhësisht, i një fenomeni nuk mund të quhet kënaqshëm me termin brendagjuhësor “kryefjalë.”⁹³

Ndërsa Përnaska shton se termi ‘rrethinë’, disi ndryshe nga ç’pohon Riza, mund të përdoret në gjuhësi për skajet gjuhësore si: ‘environment’ në gjuhën angleze, ‘environnement’ në gjuhën frënge dhe ‘Umgebung’ në gjuhën gjermane, etj.

“Gjithë duke ruajtur bashkërendimin nocionor, në skajet ‘ndënanë’, ‘kundranë’ dhe ‘rrethanë’ do t’i mbanim për skaje jashtëgjuhësore që mund të përdoren nga filozofia, logjika, psikologjia etj., kurse si skaje gjuhësore përkatëse do të parapëlqenim ‘nënanor’, ‘kundranor’ dhe ‘rrethanor’, të cilët, posë të mirash të tjera, bashkërendohen edhe me skajet ‘cilësor’, ‘përcaktor’ dhe ‘plotësor’.”⁹⁴

Në punim e tij Përnaska përdor termin ‘kundranor’, i cili është përdorur për herë të parë prej tij në një artikull, ku trajtohen çështje të kundrinës në gjuhën shqipe. Si u pa më sipër, ky term është krijuar në hullinë e arsytimit të Selman Rizës, i cili, për të ruajtur bashkërendimin organik në mikrosistemin e terminologjisë, përdor termat ‘ndënanë’ për kryefjalë dhe ‘kundranë’ për termin ‘kundrinë’. Në punimin e tij monografik kushtuar kundrinës së zhdrejtë me parafjalë, përdoret gjithashtu termi ‘nënanor’ për kryefjalën.

Megjithëse në përgjithësi bie dakort me arsyetimet e mësipërme të Rizës e Përnaskës në lidhje me termin në fjalë, në këtë punim siç kuptohet dhe nga titulli i punimit, kam vendosur të përdor termin kundrinë. Arsyeja që më shtyu në marrjen e këtij vendimi është krejtësisht e karakterit praktik dhe lidhet me faktin se ky term është më popullor duke marrë parasysh se është termi “zyrtar” që gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe, botuar nga Akademia e Shkencave, në librin Gramatika 2, Sintaksa, botuar gjithashtu nga Akademia e Shkencave si dhe në të gjitha tekstet shkollore. Një tjetër arsye është dhe fakti se ky është termi që haset më shpesh ndër vite, duke filluar nga Xhuvani, Sheperi, Rrota, Myderrizi, Cipo, Domi/ Hajvari, Prifti etj..

Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe të Akademisë së Shkencave: “Kundrinë, gjymtyrë e dytë e fjalisë, mbi të cilën bie veprimi i foljes që shërben si kallëzues.”⁹⁵

⁹³Riza, Selman, Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore, Tiranë 1994, f. 94

⁹⁴Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 22

⁹⁵Akademia e Shkencave të Shqipërisë, “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë 1980, f.

2. Gramatika tradicionale

2.1. Gramatika tradicionale e shekullit të 20-të

2.1.1. Sami Frashëri

Hulumtimin e gramatikave të gjuhës shqipe e nisa me Sami Frashërin, i cili është autori i parë shqiptar i një gramatike të gjuhës shqipe. Teksti i tij “Shkronjëtorja”, botuar në Bukuresht, në 1886, është një gramatikë logjike, që trajton vetëm morfologjinë e gjuhës shqipe. Ai trajton hollësisht kategorinë e emrit, përfshirë dhe sistemin rasor, që ai e quan “*Renjet e émerit*”, ku bën pjesë dhe “*denetorja*”, dhanorja e “*kalzoñetorja*” kallëzorja.

*“Renjet e émerit jane gaste: quañetorja, pjeletorja, denetorja, kalzoñetorja, pritetorja, mergoñetorja”*⁹⁶

Dhe parafjalët, të cilat ai i quan “*parje*” ose “*perparje*” i trajton shkurtimisht vetëm në aspektin morfologjik, duke na dhënë këtë përkufizim: “*Parjetë janë ca fjalë të papërkthyer, të cilat vihen përpara emrave, për t’i ngjitur ata me foljet, si: rri në shtëpi, vete me ty.*”⁹⁷ Ai jep në vijim edhe një listë parafjalësh. Ai vë në dukje se disa nga parafjalët e mësipërme, si: “*pranë-, përpara-, pas-, tej- etj.* kur përdoren vetëm janë mifolje si: rri pranë, shkoj tej, eja pas; Ndërsa kur vihe në përpara një emri janë parje, si: pranë shtëpisë, tej malit, pas murit.

2.2. Gramatika tradicionale e shekullit 21

2.2.1. Anton M. Xanoni

Në tekstin “Gramatika Shqyp” të Anton M. Xanonit, botuar në vitin 1909, duke u nisur nga ngjashmëritë në mënyrën e ndërtimit të tekstit, si dhe nga konceptet e trajtuara prej tij së bashku me përkufizimet përkatëse, vërehet se kemi të bëjmë me një gramatikë logjike, që ecën në gjurmët e asaj të A. Diskolit. Kjo gramatikë merret kryesisht me morfologjinë, duke i kushtuar vetëm tri faqe disa koncepteve bazë nga sintaksa.

Bie në sy se Xanoni përdor të njëjtin term përmbledhës për kundrinat, rrethorët dhe përcaktorët. “*Përkryesat janë fjalë qi vin me e kufinue ma mirë subjektin, verbin o atributin me t’cilltë janë përciellë e e mushin vështrimin e propozicionit.*”

Djali i urtë kaa me ken i dashtun gjithmoon prej t’tanve.

*...’i urtë’asht perkryesa e subjektit; gjithmoon a perkryesaa e verbit; prej t’tanve perkryesa e atributit.”*⁹⁸

⁹⁶ Frashëri, Sami: *Shkronjëtorja*, Bukuresht: Shtypshkronja e shoqërisë Dritë 1886, f. 9

⁹⁷ Frashëri, Sami: *Vepra V*, Prishtinë, 1979, f. 269

⁹⁸ Xanoni, Aleksandër, *Gramatika shqyp*, Shkodër: Shtypshkronja e Zojës Papërlyeme, 1909, f. 18

Më tej ai i ndan kundrinat në të drejta e të zhdrejta, përkatësisht “e ndreit” dhe e “lakone” dhe për herë të parë përdor dhe termin “objekt”, term ky mesa duket i huazuar prej tij nga ndonjë gjuhë tjetër e huaj.

Kundrinën ai e quan të drejtë ose “objekt” kur i përgjigjet sipas tij pyetjes: “ke” ose “Çka” e cila i drejtohet foljes. Këtë e ilustron dhe me shembullin në vijim:

“Krija breen drunin. drunin asht perkryesa e ndreit e verbit breen. Drunin asht perkryesa e ndreit e verbit breen.

Ndërsa kur i përgjigjet pyetjeve “Kuei?, Tcillit send?, I kuei?, I ç’farë sendit?, Me ke?, Me çka? Prei kuei?, Si?, Ku?, Kuer?, Pse o Për çka?” ai i quan të zhdrejta, “lakone:

“Gjaja shitet (ku?) n’pazaar. N’ pazar asht perkryesa e verbit shitet.”⁹⁹

Tek teksti i Xanonit gjejmë dhe një trajtim të shkurtër të parapfjalëve, të cilat ai i quan ‘paraprisa’ dhe i trajton vetëm në rrafshin morfologjik.

Siç shihet kjo është një ndarje mjaft e mangët dukeqenë se në kategorinë e dytë sipas tij, duke u bazuar tek larmia e pyetjeve ndihmëse përveç kundrinës së zhdrejtë bëjnë pjesë dhe rrethanorët dhe përcaktorët. Gjithsesi, megjithë mangësitë e pasaktësitë e vërejtura, ky mund të konsiderohet një hap i parë i rëndësishëm për sintaksën e gjuhës shqipe.

2.2.2. Aleksandër Xhuvani

Xhuvani, autor i së parës sintaksë shkollore të gjuhës shqipe, në veprën e tij “Sintaksa Shqip”, botuar në vitin 1920, e trajton kundrinën shkurtimisht në një kre të veçantë. Ai është i pari autor që dallon kryefjalën, kallëzuesin, cilësorin, ndajshimin, kundrinën dhe rrethanorin. Aty ai shpjegon ç’është kundrina si dhe e ndan atë në kundrinë të drejtë e të zhdrejtë, duke përdorur pyetjet përkatëse për ti dalluar ato. Gjithashtu janë dhënë dhe pjesët e ligjëratës me anë të së cilave shprehet kundrina. Vlen të theksohet se ky botim është i pasur me ushtrime në mënyrë që nxënësit të konkretizojnë pjesët teorike.

Në ndryshim nga studiuesit e tjerë ai na paraqet dhe një koncept të ri, atë që ai e quan “kundrinë e tërheqëme”.: *Si dihet, kundrina vihet në rasën kallëzore a dhanore, kur asht një mbiemën dëftuer i bashkuem me një emën. Kundrina në rasë rrjedhore quhet kundrin’ e tërheqëme, pse tërhiqet prej emnit që asht një plotësuer pjese në rasë rrjedhore. P.sh. :*

A ke ma këso karte (+ a ke ma kartë këso= nga kjo).

⁹⁹Po aty

Nuk kam pamë kësi njerëzish (nuk kam pamë njerëz kësish=prej këtyneve) ”¹⁰⁰

Siç shihet dhe ky kundrim gjuhësor nuk është i plotë. Ai le jashtë shqyrtimit kundrinën e zhdrejtë me parafjalë, si dhe rimarrjen e kundrinës me trajtë të shkurtër.

2.2.3. Ilia Dilo Sheperi

Sipas gjuhëtarit Ilia Dilo Sheperi në botimin e tij “Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe”, botuar në vitin 1927, e ndarë në katër pjesë, përkatësisht: fonologjia, morfologjia, etimologjia dhe sintaksa, kundrina ndahet në dy lloje¹⁰¹: ‘e drejte dhe e shdrejte’. Pra siç dhe vërehet ai le jashtë kundrimin gjuhësor kundrinën e zhdrejtë me parafjalë. Dhe tek Sheperi gjejmë përdorimin e termit ‘kundrinë’ të Xhuvanit.

Kundrina e drejtë sipas tij tregon personin ose gjënë mbi të cilën shkon për së drejti veprimi i kryefjalës; vihet në rasën kallëzore, dhe i përgjegjet pyetjes “kë?” ose “çë?”: P.sh. Lajmova mikun.; Shkrova letrën.”

Ndërsa kundrina e zhdrejtë tregon sipas Sheperit “personin ose gjënë mbi të cilën vepërimi i kryefjalës shkon tërthorazi; vihet në rasë dhënore dhe i përgjegjet pyetjes kujt? P.sh.: I shkrova mikut.”

Sheperi gjithashtu shprehet se foljet kalimtare apo siç i quan ai ‘vepërore transitive’ marrin kundrinë të drejtë, ose të zhdrejtë, ose të dyja njëherësh. Këtë ai e ilustron me shembujt në vijim: Shkrova letrë; i shkrova mikut; i shkrova një letrë mikut.

Ndërsa foljet jokalimtare apo sipas emërimit të tij “intransitive” marrin kundrinë të zhdrejtë, vetëm. P.sh.: i ndihmoj mikut; i bie qitharës.

Tek Sheperi gjejmë gjithashtu dhe të detajaur e të ilustruar me shembuj pjesët e ligjëratës me të cilat shprehet kundrina: me emër ose çdo fjalë që përdoret si emër.: P.sh. pashë djalin; lëndova të mirin; kam t’imin.

Ai më tej shton se kundrina e drejtë mund të shprehet dhe me fjali, duke e ilustruar si vijon.: Mësova që erdhi; dua të shkruaj; nuk e di se ku vate.

Kjo quhet ‘kundrinë me fjali të dytë’. Autori ka parë mirë se foljet kalimtare mund të marrin së bashku dhe kundrinë të drejtë dhe kundrinë me fjali të dytë. P.sh.: e lajmova mikun që do t’a vizitoj.

Shumë herë kryefjala e kundrinës me fjali të dytë sipas tij tërhiqet prej foljes së fjalisë së parë dhe vihet si kundrinë e drejtë e saj. P.sh.: Nuk e di Alin se ku ka vajtur = Nuk e di se ku ka vajtur Aliu.

¹⁰⁰Xhuvani, Aleksandër, *Sintaksa shqip*, ‘Pjes’ e parë për Klasët e ulta të shkollave të mesme,’ Shtëpia botuese Luarasi, Tiranë 1920, f. 10

¹⁰¹Sheperi, Ilia Dilo, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes*, (për shkollat e mesme), Shtëpia botuese Vlora, Vlorë, 1927, f. 145-148

Ai gjithashtu i ka kushtuar një kapitull të veçantë dhe trajtës së shkurtër, të cilën e quan ‘Pleonazma e kundrinave.’¹⁰²

Aty ai shprehet se foljet veprare bëhen kalimtare duke marrë përpara trajtat e shkurtra të përemrit vetor, si pleonazma të kundrinës që pason ose nënkuptohet. P.sh. shkruaj, e shkruaj: përgjigjem, i përgjigjem.

“Kundrin’ e shdrejtë e lyp kurdoherë dhënoren e shkurtër të përemërit vetor si pleonazmë të sajë, kurse e drejta zakonisht e merr vetëm kur është në një formë të shquarë. P.sh. i shkrovamikut; i shkrova një letrë; e shkrova letrën. (Po dhe “shkrova letrë, ose letrën” kur theksohet kundrina).

Kur është si kundrinë vet’ e parë dhe e dytë e përemrit vetor, vihet vetëm trajt’ m e shkurtër e tij, dhe vetëm kur theksohet, vihet dhe trajt’ e plotë. P.sh. më shkroi letrë; mua më shkroi (= mua dhe jo tjetër njeriu).”¹⁰³

Foljet që marrin së bashku dhe kundrinë të drejtë dhe të zhdrejtë sipas tij, i marrin dhe trajtat e shkurtra të tyre, të drejtën pas së zhdrejtës. Këtë ai e ilustron si vijon: i a shkruaj letrën mikut; u a shkrova letrat miqve; i a shkrova letrat mikut.

Urdhërorja afirmative i merr kundrinat e shkurtra dhe si prapashtime, të cilët në shumor vihen përpara prapashtimit –ni.

Ila D. Sheperi gjithashtu dallon për herë të parë dhe konceptin e kundrinës së brendshme. Ai shprehet se çdo folja mund të marrë si kundrinë një emër të prejardhur nga rrënja e saj ose me domethënje të rrënjës së saj. P.sh. punoj- punë; shkruaj- shkrim; fle- gjumë.

Sipas tij kjo kundrinë quhet: “kundrin e mbrendëshme, dhe vihet vetëm kur duhet të plotësohet me ndonjë farë plotësi. P.sh. Shkruaj shkrim të bukur; fle gjumë të qetë; ç’ punë punon? Kremtojmë kremtimin e Flamurit. Nga ndonjë herë mungon kundrin’ e mbrëndëshme, si e nënkuptueshme, dhe plotësi i sajë mbetet si kundrinë e këtyllë. P.sh. Ha mëngjezin (ha hamjen e mëngjezit); të hëngësja darsmët; festojmë Bajramin: heqim udhën.”¹⁰⁴

Por megjithatë mund të thuhet se ky kundrim gjuhësor nuk është i plotë dhe për faktin se ai nuk dallon dhe kundrinën e jashtme. Gjithashtu Sheperi nuk dallon kundrinën e zhdrejtë me parafjalë.

2.2.4. Justin Rrota

Justin Rrota në veprën e tij “Syntaksa e gjuhës Shqipe”, botuar në 1943, një vepër me vlerë jo vetëm në fushën e teksteve shkollore, por edhe të sintaksës në përgjithësi na jep një trajtim më të gjerë teorik e të pasur në shembuj ilustrues. Ky është një tekst i ngritur si nga ana shkencore, ashtu edhe metodike dhe që dallohet nga paraardhësit për

¹⁰² Po aty, f. 146

¹⁰³ Po aty f. 147

¹⁰⁴ Po aty

nivelin e lartë, duke e radhitur kështu Justin Rrotën në një ndër sintaktologët më të mirë shqiptarë të kohës.

Rrota e përcakton kundrinën si pjesë të dytë të fjalisë, bashkë me cilësorin (përcaktorin) e ndajfoljorin (rrethanorin). Ai e përkufizon kundrinën si më poshtë: “*Shumë folje e mbiemra kanë vetvetiu një kuptim të plotsuem; kështuqi s’kanë nevojë për kurrnji caktim tjetër. P.sh. Fëmija po flen*

Porse shumë folje e mbiemra lypin një caktim a plotësim për tu kuptua sa duehet. P.sh. Unë lëvdoj fjalën, të mendshmin, punën. ;Un mbaj fjalën, besën, një lopë. ’I lëshuem doret , zemret etj. – Çdo caktim pra, qi vjen për të plotsuem foljen a mbiemrin, thirret kundrinë.”¹⁰⁵

Siç shihet nga përkufizimi i mësipërm, Rrota ka dalluar drejtë se kundrina sundohet jo vetëm nga folje, por dhe nga mbiemra, çka përbën një risi.

Kundrina shprehet ai i përgjigjet pyetjes ‘*Ke?, Shka?, Kuj? Shkahit? ase për shka? Në shka? Mbas kuj?’* etj.

Kundrinë, sqaron më tej Rrota, mund të jetë një emër, përemër, ose çdo fjalë e marrë si emër në rasën II, III, IV, e VI ose me një parafjalë.

Si kundrinë mund të rrijë dhe folja në mënyrën paskajore

Gjithashtu ai rendit një sërë foljesh mbiemrash si psh. këndoj, shoh, ndiej, tres, humb, ha, kthej, i lodhun, i lirë, i zhgatruem, i mësuem etj, të cilat mund të përdoren me ose pa kundrinë.

Siç vërehet, Rrota për herë të parë e ndan kundrinën në katër lloje: kundrina në dhanore, kundrina në kallëzore, kundrina në rrjedhore dhe kundrina me parafjalë. Ai është i pari autor që përmend kundrinën me parafjalë.

Megjithëse Rrota preferon përdorimin e termave të lartpërmendur në përkufizimin e dhënë prej tij, ai pajtohet dhe me termin kundrinë e drejtë dhe e zhdrejtë, duke i përdorur të dyja: “*E shumta e foljeve lypë kundrinën në rasë IV. Kjo kundrinë difton sendin, mbi të cilin vret drejt për së drejti vepra e foljes; prandej kjo thirret kundrinë e drejtë, dhe i përgjigjet pyetjes ke? Shka?’*”¹⁰⁶

Më tej ai dallon kundrinën e drejtë nga një gjymtyrë tjetër në rasën kallëzore: “*Janë do folje, të cillat, posë kundrinës së drejtë, marrin edhe një kallxore tjetër- emën, mbiemën a pjesore- të shumtën në trajtën e paskajuem.*

Ketë kallxore të dytë e marrin sidomos njato folje, qi në trajtën pasuese lypin mbas vetes një fjalë plotësuese, për me përba kallxojen. Në trajtën pasuese të dyja këto fjalë

¹⁰⁵Rrota, Justin, *Syntaksa e gjuhës shqipe, për klasën II, III, IV. K.U. Të shkollave të mesme, Shtypshkronja Gjergj Fishta, Shkodër, 1943, f. 28*

¹⁰⁶Po aty, f. 29

*dalin rasa të para: d.m.th. njena si kryefjalë e tjetra si fjalë kallxojse. Kështu: Ju e kini ba Mihajlin krejt të marrë, sillet: Mihajli ashtu bam prej jush krejt si i marrë.*¹⁰⁷

Këto folje janë: baj, thirri, mbaj, zgjedhi, bie, qes, ve, kam, shoh, gjykoj, dëshmoj, etj. Këso dore.

Njësoj dhe për kundrinën e zhdrejtë, ai megjithëse preferon termin ‘kundrinë në dhanore’, në përkufizim pranon dhe atë e zhdrejtë.: “*Kundrina në dhanore i përgjegjë pyetjes kuj? e shenjon veten apo sendin, mbi të cillin vret vepra e foljes, jo drejt për së drejti, por tërthoras; prandej kjo thirret edhe kundrinë e zhdrejtë.*¹⁰⁸

Ndërsa kundrinën në rrjedhore ai e përkufizon si më poshtë: “*Kundrina në rrjedhore i përgjegjë pyetjes shkahir? Prej shkahir? Kuj? prej kuj?*”. Nisur nga fakti që përemrat pyetës në këtë rast shoqërohen dhe me parafjalë, na lë të kuptojmë se në fakt bëhet fjalë për kundrina të zhdrejta me parafjalë.”

Gjithashtu ai rendit në mënyrë të detajuar se me çfarë shprehet kundrina në kallëzore (e drejtë), ajo në dhanore (e zhdrejtë) si dhe ajo në rrjedhore.

Për herë të parë në një sintaksë të shqipes haset dhe kundrina me parafjalë ose siç e quan autori kundrina parafjalore, të cilën e përkufizon si më poshtë:

“Shpesh foljet, mbiemrat dhe ndajfoljet marrin për plotësim kuptimit një kundrinë emën, prim nga një parafjalë: prandej kjo thirret kundrinë parafjalore (ase objekt prepozicionar).

Ai gjithashtu dallon kundrinën me parafjalë nga rrethanori të cilin e quan ndajfoljor. Kjo përbën një risi, duke qenë se është një çështje mjaft e diskutuar nga gjuhëtarët deri në ditët e sotme.: *Nganjihërë asht vështirë të dahet, kur emnat me parafjalë janë kundrina e kur janë rrethanë foljesh (ndajfoljore). Përgjithësisht janë kundrina, kur folja pa këto nuk ka një kuptim të plotë; jo se kur pa to mund të kuptohet një gja për një tjetër. Mjesa janë ndajfoljorë kur e caktojnë veprën e foljes ma largtas, si mbas rrethanave të kohës, të mënyrës, të vendit e të shkakut. P.sh. Mbas shiut del dielli (ndajf.) Me u dhanun mbas këndimit (kundrinë). A mund të rri në fjalë tande? (kundrinë) Un rri në kopsht (ndajf) Pac veten në qafe (kundrinë) Shqipja fluturoi mbi re (ndajf).*¹⁰⁹

2.2.5. Osman Myderrizi

Gramatikën e Rrotës e ndoqi ajo e Osman Myderrizit e botuar vetëm një vit më pas, e quajtur “Gramatika e re e shqipes”, botuar në 1944. Duke qenë se ky tekst ishte konceptuar si pjesë e parë e një gramatike të gjuhës shqipe, në të trajtohen vetëm fonologjia e morfologjia, ndërsa sintaksës autori i ka kushtuar vetëm gjashtë faqe. Në këtë libër paraqiten pothuaj të gjitha konceptet e parashtruara nga Sheperi. Konceptet

¹⁰⁷Po aty, f. 30

¹⁰⁸Po aty, f. 31

¹⁰⁹Po aty f. 34

sintaksore në këtë vepër i gjejmë të parashtruara fare shkurtimisht e në mënyrë të përgjithshme.

Përsa i përket kundrinës autori në shprehet se “*Kundrinë quhet fjala mbi të cilën bie veprimi i predikatit foljor:*

Bujku punon arën.

Kundrinë sipas tij bahet emni, mbiemri, përemni, e çdo fjalë tjetër që përdoret si emën:

Shkrova detyrën.

Prindërit duenë t’urtën.

S’e pashë atë.

Nënvizova edhe-t.”¹¹⁰

Më tej Myderizi shprehetse kundrina vihet në rasën kallëzore të shquar e të pashquar pa parafjalë dhe gjendet me pyetjet ke? Çka?

Si kundrinëshprehet ai më tej mund të bëhet edhe folja në mënyrën paskajore dhe një fjali e tërë.:

Unë due **me punue.**

Dëshiroj që **ju të flisni.**

Kundrina marrin vetëm foljet veprare kalimtare.

Përveç mënyrës shumë të përmbledhur të paraqitjes së kundrinave, tek Myderrizi vërehen dhe pasaktësi në formulime si dhe mosndarjen e kundrinave në të drejta e të zhdrejta.

2.2.6. Kristaq Cipo

Në botimin e Kristaq Cipo, “Sintaksa”, botuar në Tiranë në vitin 1952, mund të thuhet se ai ndalet fare shkurtimisht tek kundrina të cilën e quan ‘objekt’ dhe e përfshin tek gjymtyrët kryesore të fjalisë. Ai e përshkruan atë më shumë në rrafshin semantik sesa të merret me funksionin sintaksor. Përkufizimi i tij i kundrinës është mjaft i përafërt më atë të Sheperit, duke e lidhur kundrinën me kryefjalën dhe jo me kallëzuesin. Megjithatë ai na jep një përkufizim të saj më të saktë se të mëparshmit. Panvarësisht se ai nuk e cilëson mund të thuhet se bëhet fjalë për kundrinën e drejtë:

“Objekti a kundrina është frymori a gjeja mbi të cilën bie veprimi i subjektit. Objekti mund të jetë një emër ose një pjesë tjetër e ligjëratës e substantivuar. Që të jetë objekti me të vërtetë i tillë, duhet të marrë pjesë në veprimin e subjektit, po të rrijë dorëjashtë.

¹¹⁰Myderrizi, Osman, *Gramatika e Re e shqipes*, për shkollat e mesme”, vëllimi I, fonologji e morfologji, shtypshkronja Gutenberg Tiranë 1944, f. 20

*Në thënça, për shëmbëll, o burra të luftojmë **analfabetizmin**, fjala **analfabetizmin** është një objekt sepse nuk merr pjesë në veprimin e luftës.”¹¹¹*

Mund të thuhet se sintaksa e Cipo edhe pse duket sikur ecën në gjurmët e asaj të Xhuvanit, paraqet mangësi më të mëdha. Kështu për shembull ai ka përfshirë në një kategori përcaktorin, rrethanorët dhe kundrinën e zhdrejtë, pa marrë parasysh faktin se kjo e fundit është gjymtyrë e domosdoshme në fjali dhe si e tillë qëndron një shkallë më lart, dhe pa marrë parasysh gjithashtu faktin se kundrinën në fillim e rendit në një grup me gjymtyrët kryesore. Një mangësi, apo pasaktësi tjetër të kësaj sintakse përbën dhe interpretimi i kundrinës së zhdrejtë me parafjalë si plotësa të vendit, kohës, mënyrës, shkakut, qëllimit, sasisë, masës e madje dhe si përcaktorë të cilësisë, lëndës etj.psh.:

Shkolla u ndërtua **nga fshatarët**. (plotës i agjentit a i vepruesit)

Mësuesit udhëtojnë **me makinë** çdo ditë. (plotës i mjetit)

Duhani është i dëmshëm **për shëndetin**. (plotës i dobisë dhe i dëmit)

Ajo shoqërohet **me shokët e shoqet e klasës**. (plotësi i shoqërimit)

Ai bën një ndarje ndryshe nga autorët e mëparshëm duke e ndarë kundrinën në dy lloje si më poshtë: “Objekti përfaqe ose i mbrëndëshëm- *Ndoth nganjëherë që objekti nuk është me të vërtetë i tillë, por duket sikur është, por duket sikur është. Dhe që nuk është me të vërtetë objekt duket me të parët, sepse nuk qa, nuk pranon veprimin e subjektit siç bëjnë tërë objektet e vërtetë. Objekti përfaqe dallohet nga objekti i vërtetë edhe nga një pikë tjetër sepse munt të zavendësohet rrall e tek edhe nga një shprehje të së njëjtës natyrë. Kështu p.sh. fjalia: *luftoi luftën mund të zavendësohet me këtë tjetrën: fitoi në luftë. Shumë herë objekti i mbrëndëshëm e ka të barabartë ose të afërt radikalën me foljen, d.m.th. mund të jetë objekt i mbrëndëshëm një emër foljor ose mund të ketë rrjedhur folja vetë nga objekti, si në këtë shëmbëll: *ku verove verën-o, ku folja veroj është një folje denominative, sepse ka dalë nga emri verë, ashtu edhe folja: luftoj a luftoj është një folje denominative se rrjeth nga substantivi: luftë.*”¹¹²**

2.2.7. Mahir Domi/ N. Hajvari

Në tekstin me autorë Mahir Domi e N. Hajvari “Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa”, botuar në vitin 1965, ndalen gjerësisht te kundrina. Ata e përshkruajnë kundrinën si “një gjymtyrë plotësonjëse të kallëzuesit mbi të cilën bie veprimi i kryefjalës” duke bërë arsyetimin e mëposhtëm:

¹¹¹Cipo, Kostaq, *Sintaksa*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1952, f. 63

¹¹²Po aty, f. 64

“Në qoftë se kryefjala kryen një veprim të shprehur me një folje kalimtare veprorë, shpesh herë ky veprim vete e bie mbi një objekt d.m.th mbi një frymor apo send. Në këtë rast emri i këtij frymori a sendi bëhet gjymtyrë plotësonjëse e kallëzuesit.”¹¹³

Fjalitë ata i ndajnë në:

a.të thjeshta (grupe kryefjalë – kallëzues):. Nxënësi mëson.; Petriti shkruan.

b.fjali të zgjeruara (me gjymtyrë plotësuese kundrinë): Nxënësi mëson **mësimet.**; Petriti i shkruan **babait.**

*“Kjo gjymtyrë plotësonjëse, d.m.th. emri i frymorit a sendit mbi të cilin bie veprimi që tregon folja, shpesh herë është e domosdoshme për kuptimin e grupit kryefjalë-kallëzues; p.sh. Petriti po ha (veprimi është i padrejtuar) Petriti po ha **mollën** (veprimi është i drejtuar); Petriti shkruan.(veprimi është i padrejtuar); Petriti i shkruan **nënës** (veprimi është i drejtuar).”¹¹⁴*

Më tej ata i ndajnë kundrinat në dy lloje, në kundrinë të drejtë, në rasën kallëzore pa parafjalë dhe kundrinë të zhdrejtë, në rasën dhanore “(doemos pa parafjalë)”. Ata i trajtojnë ato si në rrafshin semantik ashtu dhe përsa i përket funksionit të tyre sintaksor.

Kundrinën e drejtë e përkufizojnë si kundrina që vihet në rasën kallëzore pa parafjalë. Ajo u përgjigjet pyetjeve: Ç? Cilin? Cilën? Kë?. Gjithashtu theksojnë faktin se disa folje kalimtare marrin kundrinë.

Kundrina e drejtë sipas tyre shprehet me emër, përemër dhe çdo fjalë tjetër që përdoret si emër. Në tekst trajtohet gjithashtu në mënyrë të detajuar dhe e ilustruar me shembuj se me ç’pjesë të ligjëratës shprehet kundrina e drejtë: emër, përemër, mbiemër apo një pjesë të palakueshme, një grimcë a një tingull, të marrë si emra në thonjëza: P.sh. shkruaji mirë “**Ë**-të.

Ndërsa kundrinën e zhdrejtë e përkufizojnë si kundrina që vihet në rasën dhanore. Ajo sipas tyre u përgjigjet pyetjeve të kësaj rase: Kujt? Cilit? Cilës? Cilëve? Dhe kundrina e zhdrejtë shprehet me po ato pjesë të ligjëratës që shprehet kundrina e drejtë, d.m.th. me emër, përemër, mbiemër të kthyer në emër si dhe me çdo pjesë të palakueshme të marrë si emër, p.sh. veru pikën “i-ve”.

Një vend të veçantë tek ky tekst zë trajtimi i shenjimit të kundrinës me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, apo siç e quajnë autorët “përsëritja e kundrinave” e përkufizuar prej tyre si vijon:

“Kundrina përsëritet me trajtat e shkurtra të përemrit vetor përkatës. Ndërsa përsëritja e kundrinës së drejtë varet nga fjala me të cilën është shprehur kjo, përsëritja e

¹¹³Domi, Mahir; Hajvari, N: *Gramatika e gjuhës shqipe*, pjesa I për klasën VII të shkollës tetëvjeçare, botim i Institutit të studimeve dhe botimeve shko llore, shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1965, f. 47

¹¹⁴ Po aty, f. 48

kundrinës së zhdrejtë kryhet gjithmonë. Po të kemi si kundrinë një përemër vetor, shpesh herë përdorim vetëm trajtën e shkurtër.”¹¹⁵

Ata ilustrojnë me shembuj duke theksuar faktin se kundrina e drejtë nuk përsëritet në të gjitha rastet.:

Gjetëm vetëm **disa**.

Risi përbën dhe observimi mjaft i saktë se trajta e shkurtër e përemrit vetor që shenjon kundrinën e shprehur me përemër vetor, shpesh herë e bën të panevojshme trajtën e gjatë, prandaj kjo dhe hiqet.:

(**Neve**) **na** dhanë fletë lavdërimi.; (**Juve**) **ju** thanë fjalë të mira.

Gjithashtu autorët vënë në dukje dhe dukurinë e bashkimit të trajtave të shkurtra të përemrave vetorë. Ata shprehen se shpeshherë një folje qëllon që të ketë dy kundrina, një të drejtë dhe tjetër të zhdrejtë, duke i pasqyruar ato në një tabelë ilustruese. Ndër të tjera theksohet nga autorët se trajta e shkurtër e rasës dhanore vihet gjithmonë përpara trajtës së shkurtër të rasës kallëzore.

2.2.8. Stefan Prifti

Teksti universitar i Stefan Priftit, “Sintaksa e gjuhës shqipe”, botuar në Prishtinë vitin 1971, shënon një hap përpara në trajtimin e kundrinave. Në këtë tekst kundrina, term i përdorur dhe nga Prifti, gjen një trajtim më të gjerë e të hollësishëm se në tekstet e mëparshme. Megjithatë dhe në këtë tekst ashtu si në tekstet e mëparshme sintaksa shihet e lidhur ngushtë me logjikën. Siç shprehet ndër të tjera autori në përkufizimin e tij për sintaksën: “*Sintaksa është ajo pjesë e gramatikës, që na mëson rregullat e bashkimit të fjalëve në fjali dhe të fjalivet mes tyre, në pajtim me rregullat e përgjithshme të logjikës dhe me natyrën e veçantë të një gjuhe*”¹¹⁶

Një risi tjetër e këtij autori në këtë libër kemi dhe në aspektin terminologjik përdorimi i termit sintagmë, i cili është një term modern që i përket gjuhësisë moderne gjenerativiste. Termin sintagmë ai e përdor për të përkufizuar një grup fjalësh, në vend të termit togfjalësh, të përdorur rëndom në gjuhësinë tradicionale, por gjithsesi ai nuk e përpunon më tej përmbajtjen e tij.

Ndërsa kundrinën Prifti e përkufizon si vijon: “*Kundrina është gjymtyra e varur e fjalisë së zgjeruar, tregon sendin mi të cilin bie direkt ose tërthorazi veprimi i gjymtyrës nga ajo varet*”¹¹⁷. Duke u thelluar në përkufizimin e Priftit vërejmë se kundrina, shihet nga pikëpamja sintaksore si një gjymtyrë e dytë, e varur nga një tjetër; prandaj ai e quan dhe “pjesë plotësonjëse” ose “plotësor”. Gjithashtu nga përkufizimi, vihet në dukje se kundrina tregon sendin, mbi të cilin bie veprimi i gjymtyrës, nga e cila ajo varet. Ai e përkufizon më tej kundrinën duke e quajtur atë tregues jo vetëm sendesh, por edhe

¹¹⁵Po aty, f. 52

¹¹⁶Prifti, Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1972, f. 16

¹¹⁷Po aty, f. 104

raportesh midis dy a më shumë sendeve. Këto raporte që tregojnë kundrina ai i quan raporte kundrinore.

Më tej Prifti shtron pyetjen e përfshirjes ose jo të kundrinës në vathën e plotësorëve emërorë. Për të përlegur këtë fakt ai jep përkufizimin e mëposhtëm: “*Kundrina konsiderohet kështu, plotësor emëror, sepse, në raport me foljen kryesisht, ajo ose është një rezultat e vetë veprimit të foljes (p.sh. shkrova një letër, hapa një rrugë, etj.) si një transformim rrënjësor i realitetit objektiv, ose një objekt i krijuar i gatshëm që, në një mënyrë ose në një tjetër, pëson influencën e veprimit të një sendi të dytë mbi të. Ky pësim mund të jetë i madh ose më i vogël, sipas natyrës së veprimit p.sh. “Zjarri dogji vreshtat”;* Unë lexoj **gazetën**, etj.”¹¹⁸

Ai e shqyrton kundrinën si nga brendia pra ana semantike, ashtu dhe nga forma, apo aspekti gramatikor i saj. “*Përmbajtja kuptimore përcakton edhe përbërjen gramatikore të kundrinës. Me qenë se sendet në përgjithësi, ngjarjet, veprimet, idetë abstrakte etj. shprehen kryesisht me kategorinë nominale, prandaj kundrina, si pjesë e ligjëratës, është së pari një emër, pastaj një përemër, por edhe një mbiemër i substantivuar, një numëror dhe çdo kategori tjetër e ligjëratës e substantivuar. Natyra, pra, e kundrinës, është emërore. Në periudhë, kundrina mund të jetë një fjali e tërë.*”¹¹⁹

Një tjetër aspekt i kundrinës, i trajtuar nga Prifti është dhe ndarja që ai i bën kundrinës në kundrinë të brendshme dhe kundrinë të jashtme, të cilat ai i përkufizon si vijon: “*Foljet transitive mund të kenë si kundrinë ose një send që ekziston dhe mund të ekzistojë jashtë sferës së veprimit të kryefjalës, i pavarur nga ky veprim, ose një send që është rezultat i këtij veprimi dhe që ekziston ose paralelisht me veprimin e foljes, ose pas tij. Në rastin e parë kundrina quhet e jashtme, në të dytin quhet e brendëshme ose e rrjedhimit. P.sh. Nëna lan **teshat** e djalit. Berberi qethi **flokët**. Unë hëngra **një pastë shumë të këndëshme**, etj.”¹²⁰*

Më tej ai sqaron se kundrina e brendshme s’ mund të jetë në rasë tjetër veçse në rasën kallëzore, kurse kundrina e jashtme, kur nuk pranon e para veprimin e foljes, mund të jetë edhe në rasë dhanore, si kundrinë e dytë.

Tek Prifti gjejmë gjithashtu ndarjen e kundrinës në të drejtë dhe të zhdrejtë. Ai e bën këtë dallim duke u nisur nga pikëpamja e mënyrës së kalimit të veprimit mbi të. Kundrina sipas tij quhet e drejtë, kur veprimi bie direkt mbi të, dhe quhet e zhdrejtë kur veprimi kalon mbi të në mënyrë indirekte. Me fjalë të tjera kundrina e drejtë sipas tij e pranon e para veprimin e foljes, kurse e zhdrejta e pranon e dyta. Kundrina e drejtë vijon arsyetimin më tej ai, mund të jetë e brendshme ose e jashtme, kurse kundrina e zhdrejtë është gjithmonë e jashtme. Si rrjedhim kundrina e drejtë vihet gjithmonë në rasën kallëzore, kurse kundrina e zhdrejtë vihet gjithmonë në rasën dhanore, me përjashtime të pakta, kur kemi një kallëzore të dytë ose një fjali kundrinore.

¹¹⁸Po aty

¹¹⁹Po aty, f. 105

¹²⁰Po aty, f. 109

Një ndryshim tjetër të rëndësishëm të kundrinës së drejtë nga ajo e zhdrejtë, Prifti quan rastin kur kundrina e drejtë kthehet në kryefjalë, duke ndryshuar foljen veprorë në pësore, atëherë kundrina e zhdrejtë mbetet përsëri kundrinë dhe në rasën që ka patur ose si fjali e varur. P.sh. Mësuesi u shpjegoi **nxënësve** mësimin=. Mësimi i u shpjegua **nxënësve** nga mësuesi.

Një risi tjetër përbën dhe fakti se duke u nisur nga pohimi se rasa e kundrinës përcaktohet nga kuptimi i foljes, Prifti dallon foljet që marrin vetëm kundrinë të drejtë ose vetëm të zhdrejtë ose të dyja bashkë. Ai vëren se foljet që tregojnë një influencim direkt mbi një send, d.m.th. një veprim direkt i cili kufizohet vetëm në një send dhe e disponon atë në njërin ose tjetrën mënyrë, p.sh. Laj **duart**. Vadit **kopshtin**. Si dhe foljet që tregojnë rrjedhim të një veprimi, i cili vazhdon të qëndrojë edhe pasi veprimi pushon, p.sh. Shkrojtja **një roman**. Ndërtoj **një hotel**, ndërtohen me kallëzoren. Gjithashtu me kallëzoren si kundrinë të drejtë ndërtohen ato folje, veprimi i të cilave nga sendi i parë kalon në një të dytë, siç janë foljet: me dhanë, me kalie, folë, drejtue, tregue, vendosë, etj.

Ndërsa me dhanoren sipas Priftit ndërtohen foljet rregullisht në këto raste¹²¹:

Një grup foljesh pësore nga trajta dhe vetvetore ose indirekt kalimtare nga diateza, si: ndahem, shqitem, qepem, shqepem, shkëputem, shkulem, ngulem, ngjitem, zbritem, hidhem, vërtitem, vërsulem, sulem, turrem, avitem, sillem, afrohem, largohem, mbahem, hiqem, shitem, lavdërohem, futem, përvishem etj. P.sh. I turrem armikut.; I hidhem kalit.

Disa folje jokalmimtare, kur merren me kuptim transitiv indirekt si: shkoj, vij, qesh, vlej, etj., p.sh. Agimit s'i shkon kapella. Këshillat e tua na vlejnjë sa më shën.

Foljet jokalmimtare që e lënë pa shprehur kundrinën e drejtë dhe e cila as që mendohet tani nga ne, si: bie, sjell, pres, mbath, ngjesh, filloj, nis, bëj, etj.; P.sh. I bie portës. Ia mora këngës.

Folja jokalmimtare, 'me ardhë' kur bashkohet me ndonjë ndajfolje apo emër, të cilat shprehin gjendjen shpirtërore të kundrinës të shkaktuar nga veprimi ose nga një shkak çfarëdo, si p.sh. **Më** vjen mirë që të shoh të rritur e të gëzuar.

Disa folje njëvetore pësore, kur shprehet plotësori i vepronjësit, apo i shkakut si, jepet, duket, etj. P.sh. S'**më** jepet të flas si ti.

Disa folje jokalmimtare, që përdoren me kuptim veprimi kalimtar indirekt, si ngjan, vjen, rri, p.sh. **Më** ngjan sikur foli njeri.

Ndonjë folje denominastive, që mund të analizohet në një folje veprorë, si sjell, jap, dhe emrin përkatës si kundrinë në rasë kallëzore, si: (i) rëndohem (kujt), mërzhitem, ndihmoj, p.sh. **Mu** mërzhit dimri. S'**më** rëndohet puna.

¹²¹Po aty, f. 112

Një kre të veçantë Prifti i kushton dhe shenjimit të kundrinës me trajtë të shkurtër, ku ai vë në dukje në mënyrë të veçantë shenjimin e saj me trajtë të shkurtër të përemrit vetor njëjës ose shumës, dhe në rasën kallëzore apo dhanore, ose sipas tij edhe në të dyja, sipas natyrës së foljes.

Risi tjetër për këtë vepër përbëjnë dhe trajtimi i kundrinës së drejtuar nga një emër foljor, si dhe kundrina e drejtuar nga një mbiemër, si dukuri sintaksore të trajtuara për herë të parë prej tij në mënyrë të detajuar në një kre të veçantë, krahas kreut për kundrinën e drejtuar nga folje. Vihet re se ai le jashtë pa përmendur kundrinën e drejtuar nga një ndajfolje.

Me gjithë trajtimin e gjerë të kundrinës si dhe risive që sjell ky tekst, nuk bëhet një përshkrim i plotë i kundrinës. Veçanërisht bie në sy fakti se autori nuk përmend kundrinën e zhdrejtë me parafjalë.

Së fundi mund të thuhet se sintaksat me drejtim logjik, apo psikologjik, si dhe ato me drejtim formal karakterizohen në shumicën e rasteve nga moskuptimi i drejtë i raporteve midis gjuhës dhe mendimit, midis përmbajtjes dhe formës, duke i dhënë kështu zgjidhje të gabuara apo të pakënaqshme problemeve themelore të gjuhësisë, e në mënyrë të veçantë atyre sintaksore. Ato ose e njehsuan gjuhën me mendimin, kategoritë gramatikore me kategoritë logjike, formën me përmbajtjen, ose mbivlerësuan formën dhe e shkëputën atë nga përmbajtja. Kështu mund të thuhet se ato bënë një paraqitje të mangët e të njëanshme të fakteve sintaksore dhe nuk arritën në përgjithësi të japin një sqarim dhe interpretim të drejtë e të plotë të tyre.

2.2.9. Libri i gjuhës shqipe 3

Në tekstin “Libri i gjuhës shqipe 3”, botim i vitit 1985, i cili i drejtohet nxënësve të shkollës së mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja, vërehet një trajtim më i gjerë i kundrinës, krahasuar me tekset e mëparshme, si dhe më të strukturuar në aspektin didaktik. Në këtë tekst kundrina emërtohet si “kundrinor”.

Autorët bëjnë një ndarje të saktë ndërmjet kundrinës së drejtë e asaj të zhdrejtë, duke e çuar dhe një hap më tej e duke e ndarë kundrinën e zhdrejtë në kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinë të zhdrejtë me parafjalë si më poshtë vijon:

Kundrina trajtohet si gjymtyrë e dytë e fjalisë që varet zakonisht nga gjymtyrë të shprehura me folje dhe me mbiemra, me të cilët vihet në marrëdhënie objektore (kundrinore). Ajo u përgjigjet pyetjeve me përemra pyetës: Pushka ka ndihmuar (cilën?) **shkollën**, shkolla i ka ndriçuar (ç’?) **rrugën** pushkës.

Por ata shprehen se ka dhe kundrina që nuk tregojnë objektin e veprimit:

1. (Kujt?) **Mësuesit** i vjen mirë kur nxënësit i kryejnë si duhet detyrat.
2. Socializmi ndërtohet (nga se?) **nga duart** tërë kallo.

3. Në ato çaste të rënda komunisti Adem Reka ishte i ndërgjegjshëm, (për çfarë?) **për situatën** e ndërlikuar.

“Sipas kuptimit dhe sipas formës së shprehjes, kundrinori është i drejtë dhe i zhdrejtë. Kundrinori i drejtë shprehet me emër a përemër pa parafjalë në rasën kallëzore. Kundrinori i zhdrejtë del në dy forma:

a) me emër a përemër pa parafjalë në rasën dhanore;

b) me emër a përemër me parafjalë në të gjitha rasat ku përdoren ato.”¹²²

Gjithashtu kundrina e drejtë përcaktohet më tej si gjymtyrë e dytë që varet nga gjymtyrë të shprehura me folje veprorë dhe u përgjigjet pyetjeve: kë?, cilin?, Ç’? (Çfarë?).

Më tej në mënyrë të detajuar dhe të ilustruar me shembuj jepen dhe pjesët e ligjëratës me të cilat shprehet kundrina e drejtë: me emër në trajtë të pashquar, me emër në trajtë të shquar, me përemër ose me togfjalësh, kur mbi kundrinën bie theksi logjik (bën përjashtim kundrina e shprehur me përemër vetor në vetën I dhe II, i cili ndonëse mbi të bie theksi logjik, shoqërohet edhe nga trajta e shkurtër: - **Mua më** gëzoi qëndrimi yt.), vetëm me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, edhe me trajtë të shkurtër, edhe me emër të shquar, me përemër ose me togfjalësh, kur theksi logjik nuk bie mbi kundrinën e drejtë.

Autorët vënë në dukje dhe faktin se në ndërtimin jovepror, kundrina e drejtë mund të kthehet në kryefjalë: Kënga i kishte rrëmbyer **malësorët**. **Malësorët** i kishte rrëmbyer kënga.)

Më tej ata theksojnë se: *“në krahasim me kundrinorin e zhdrejtë (pa ose me parafjalë), kundrinori i drejtë e ka më të qartë kuptimin e objektit, sepse tregon objektin tek i cili kalon pandërmjetshëm veprimi, prandaj edhe është më i domosdoshëm për kuptimin dhe ndërtimin e fjalisë.”¹²³*

Përsa i përket kundrinës së zhdrejtë siç dhe u vu në dukje më lart ajo ndahet nga autorët në kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinë të zhdrejtë me parafjalë.

*Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë varet nga gjymtyrë të shprehura me folje të cdo diateze, kalimtare e jokalimtare, njëvetore e pavetore. Ai u përgjigjet pyetjeve: kujt?, cilin?. Atje (**kujt?**) **djaloshit** i ngjante vetja një shqipe krahëllirë. (**Cilës?**) **Asaj i** pëlqejnë shumë këngët popullore. S’i flitet kështu (**cilit?**) **shokut**.”¹²⁴*

Duke e përkufizuar më tej kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë, ata shprehen se ai shprehet: vetëm me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore, ku trajta e shkurtër shenjon kundrinën e zhdrejtë që nuk është e pranishme., me emër, me përemër në rasën

¹²²Libri i gjuhës shqipe 3, (Për shkollën e mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja), Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1985, f. 42

¹²³Po aty, f. 43

¹²⁴Po aty, f. 46

dhanore a me togfjalësh, edhe me trajtë të shkurtër të përemrit vetor në rasën dhanore. Gjithashtu sipas tyre kundrinë të zhdrejtë në dhanore mund të marrë edhe një emër foljor (me prapashtesën –je), sidomos në gjuhën librore. Gjithashtu ata theksojnë dhe faktin se disa folje mund të marrin edhe kundrinë të drejtë edhe kundrinë të zhdrejtë.

Në këtë tekst për herë të parë ndeshet një pasqyrim kaq i detajuar të kundrinës me parafjalë. Në përkufizimin e tyre për kundrinën e zhdrejtë me parafjalë, shprehen se u përgjigjet pyetjeve: nga kush?, nga se?, me kë?, me çfarë?, për kë?, për se?, pa kë?, për çfarë?, prej kujt? etj.. Ai varet si nga gjymtyrë të shprehura me folje, ashtu dhe nga gjymtyrë të shprehura me mbiemra: (Nëpërmjet kujt?) **Nëpërmjet punës** në prohim nxënësit edukohen me vetitë e klasës punëtore. Armiqtë nuk mundën ta mposhtnin një popull të etur (për çfarë?) **për dije dhe kulturë**.

Më tej përcaktohet se kundrina e zhdrejtë me parafjalë shprehet me emër, me përemër dhe me togfjalësh të shoqëruar me parafjalët ose me shprehjet parafjalore: nga, te a tek, me, pa, mbi, në, nën, për, prej, kundër, rreth, me anën (e), në kundërshtim me, në lidhje me, etj.

*“Ndërsa kur kundrinori i zhdrejtë me parafjalë varet nga një gjymtyrë e shprehur me mbiemër foljor, marrëdhëniet objektore janë po ato që vendosen kur në vend të mbiemrit vihet folje po me atë përbërje leksikore: kush i ka parë ato vise të bukura, ato male të veshura **me pisha, me bredha e me boriga** të larta, ai nuk i harron kurrë ato vise, viset e bukura dhe të dashura të Atdheut.”¹²⁵*

Më tej në tekst nënvizohet se kur mbiemri nuk është foljor, kundrina me parafjalë shënon sferën brenda së cilës kufizohet tipari: Ai ishte një burrë i paktë **nga shtati**, por i gjallë **nga lëvizjet**.; apo dhe vetën a sendin në lidhje me të cilin jepet tipari i mbiemrit: i shtrenjtë **për ne**, i ngjashëm **me shokët**.

2.2.10. Oda Buholc/ Vilfrid Fidler (Oda Bucholz/ Wilfried Fiedler)

Gramatika për shqipen e hartuar në gjuhën gjermane nga studiuesit gjermanë të gjuhës shqipe Oda Buchholz dhe Wilfried Fiedler, “Albanische Grammatik”, botuar në vitin 1987, shënon disa risi, veçanërisht në lëmin e sintaksës. Në të janë përfshirë dhe trajtuar gjerësisht në pesë pjesë të veçanta të gjitha disiplinat e gjuhësisë. Pjesa e pestë i kushtohet gramatikës, përkatësisht sintaksës. Për përgatitjen e kësaj sintakse autorët janë mbështetur në traditat e studimeve gramatikore për gjuhën gjermane, duke integruar dhe këndvështrime teorikisht të ndryshme të studimeve gjuhësore nga gramatika tradicionale, siç janë ato funksionale e strukturale apo deri tek ato të hershme gjenerative. Për sa i përket klasifikimit të gjymtyrëve të fjalisë, vërehet se autorët janë bazuar në gramatikat e gjuhës shqipe të kohës, duke ndjekur kryesisht kriteret e parimin tradicional të ndarjes së tyre. Gjithashtu ndryshe nga gramatikat e mëparshme në këtë gramatikë vëmë re se fillohet me trajtimin e foljes. Autorët e përligjin këtë fakt me rëndësinë sipas tyre të foljes në fjali duke e parë rolin e saj si thelbësor në fjali, dhe të

¹²⁵Po aty, f. 46

kuptuarit e sistemit verbal si element kyç për të kuptuar ndërtimin e fjalisë. Kjo duket qartë dhe në përkufizimin që ata japin në lidhje me kundrinën.

“Im Rahmen der Syntax ist das Verhältnis der Verben zum Objekt von besonderer Bedeutung. Unter diesem Aspekt unterscheidet man zunächst absolute (= Verben, die nicht durch ein Objekt ergänzt werden können) und relative Verben (= Verben, die durch ein Objekt ergänzt werden können oder müssen).”/Në kuadër të sintaksës raporti mes foljes dhe kundrinës ka një rëndësi të veçantë. Në këtë aspekt dallohen foljet absolute (+ folje, që nuk mund të plotësohen nga një kundrinë) dhe folje relative (= folje që mund ose duhet të plotësohen nga kundrina).”¹²⁶

Ndarja sipas tyre e foljeve në kalimtare dhe jokalistare bazohet në pozicionimin e veçantë të kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore.

Ata gjithashtu evidentojnë kthimin e kundrinës së drejtë në kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë aktive në pësore. Folje kalimtare ata quajnë ato folje, të cilat në mënyrë fakultative ose të detyruar plotësohen nga një sintagmë emërore (Nominalgruppe) në rasën kallëzore (= kundrinë e drejtë në fjalitë aktive), të cilat me anë të kthimit të fjalisë në pësore mund të kthehen në një sintagmë emërore në rasën emërore (+ kryefjalë në fjalinë pësore):

Profesori (i) qortoi studentët; Studentët u qortuan prej profesorit.

Ndërsa folje jokalistare sipas tyre janë të gjitha foljet e tjera, përkatësisht foljet absolute dhe foljet relative, të cilat plotësohen nga një kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë me parafjalë, foljet plotësi i të cilave është një plotës kallëzuesor (prädikativ) ose një rrethnor (Adverbialbestimmung), Foljet e mesme (mittelverben) që janë folje që plotësohen nga një strukturë emërore të rasës kallëzore, e cila nuk mund të transformohet në subjektin e një ndërtimi në pësore.:

Ky libër përmban këngë popullore. (Prej këtij libri) përmbahen këngë popullore.

Realizimin e kundrinës autorët e shohin gjithashtu dhe si reflektim të raportit mes foljes dhe kryefjalës, ku sipas tyre duhet patur parasysh:

a) Refleksiviteti: kur referentët e kryefjalës dhe kundrinës janë të njëjtë, vendi i kundrinës zihet nga përemri refleksiv. Në rasën kallëzore: Ai (e) mburri/ ata (e) mburrën veten. Ndërsa në rasën dhanore: I bën dëm vetes. Tek foljet kalimtare, forma aktive e plotësuar nga përemri refleksiv, mund të zëvendësohet nga forma pësore. Ai u mburr./ Ata u mburrën.

b) Reciprociteti: kur mes referetit të kryefjalës dhe kundrinës egziston një raport këmbimi që bën që rolet mes “” dhe “patients” të këmbehen reciprocikisht. Dmth, që agensi i pjesëmarrësit të shprehur nëpërmjet kundrinës (Patients, Adressat), të jetë i pranishëm në veprim në të njëjtën masë dhe ose të jenë të prekur njëllor nga veprimi,

¹²⁶Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 435

vendi i kundrinës zihet nga një përemër reciprok, p.sh. në rasën kallëzore: Ata (e) përqaftuan njëri tjetrin; në rasën dhanore: Ato i ngjajnë njëra tjetrës. Në rastin e disa foljeve kalimtare forma aktive e plotësuar me përemra reciprokë mund të zëvendësohet me formën pësore.: Ata u përqaftuan. Përemri reciprok në këtë rast mund të shfaqet dhe si fakultativ në trajtën e një togfjalëshi përemëror: Ata u përqaftuan.

c) Në kuadër të reciprocitetit qëndron dhe prania apo mungesa e kundrinës me parafjalë, përkatësisht ajo që realizohet me anë të një togfjalëshi emëror në rasën kallëzore, në rastin e disa foljeve të cilat kërkojnë një kryefjalë ose kundrinë logjike në numrin shumës. Kundrina me parafjalë është e detyrueshme në rastin e kryefjalës ose kundrinës në numrin njëjës.: Profesori/ ai bisedonte me një koleg. Ne krahasuam botimin e parë me të dytin. Kundrina me parafjalë nuk është e detyrueshme në rastin e kryefjalës ose kundrinës në numrin shumës.: Profesori e kolegu/ profesorët/ ata bisedonin. Ne krahasuam të dy botimet.¹²⁷

Më tej autorët dallojnë tre lloje kundrinash, kundrinë të drejtë, kundrinë të zhdrejtë dhe kundrinë të zhdrejtë me parafjalë. Ata vërejnë drejtë se të tria kundrinat gjatë emërzimit të foljes kthehen në përcaktorë. Vlen të theksohet se të tre llojet e kundrinave trajtohen shkurtimisht në këtë tekst, duke lënë jashtë fokusit ndër të tjera dhe pjesët e ligjëratës me të cilat shprehen ato.

Një nënkre i veçantë e i detajuar, i kushtohet shenjimit të kundrinës me trajtë të shkurtër, ku është trajtuar mjaft e detajuar kjo temë dhe është ilustruar me shembuj të shumëllojshëm.

Një risi në këtë tekst përbën dhe nënkreu rreth eliminimit të kundrinës, i cili trajtohet si një çështje e veçantë.

“Beide Objekte können eliminiert – in der Oberflächenstruktur des Albanischen weggelassen werden, wenn folgende Bedingungen erfüllt sind:

- 1) *Das Objekt wird durch ein Personal Pronomen (1./2./3. Person) repräsentiert;*
- 2) *das entsprechende Objektzeichen ist anwesend;*
- 3) *das Objekt wird nicht durch Emphase, Kontrast oder dergleichen besonders hervorgehoben.”*

Të dyja kundrinat mund të eliminohen- të lihen jashtë strukturës sipërfaqësore të gjuhës shqipe, nëse përmbushen këto kushte:

- 1) Kundrina përfaqësohet nga një përemër vetor (i rasës 1./2./3.)
- 2) Shenjuesi i kundrinës është i pranishëm;
- 3) Kundrina theksohet me anë të emfazës, kontrastit ose diçkaje të ngjashme.”¹²⁸

¹²⁷Po aty

¹²⁸Po aty, f. 446

Ndërsa mundësia e eliminimit të kundrinës së zhdrejtë me parafjalë përjashtohet nga autorët, çka nuk është plotësisht e saktë, siç do e shohim në tekste të mëvonshme.

2.2.11. Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa

Teksti “Gramatika e gjuhës shqipe, 2, Sintaksa”, i hartuar nga Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Istituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë në vitin 1989 dhe i ribotuar me disa përmirësime të vogla në vitin 2002, përbën një hap të madh përpara për shkencën e gjuhësisë shqiptare. Ai vazhdon të shërbejë dhe sot si tekst bazë për studiuesit, mësuesit dhe studentët e profilit të gjuhësisë. Ndonëse krerët e ndryshëm të kësaj gramatike janë hartuar nga rreth shtatë gjuhëtarë të ndryshëm, mund të thuhet se gjenden qëndrime teorike të njehsuara në të gjithë veprën. Kreu për kundrinën në këtë tekst është hartuar nga Remzi Përnaska. Në këtë tekst operohet me katër njësi sintaksore: fjalia, periudha, gjymtyra e fjalisë dhe togfjalëshi. Gjymtyra e fjalisë dhe togfjalëshi janë njësi sintaksore përbërëse të fjalisë së thjeshtë. Gjymtyrët e fjalisë mund të shprehen me një fjalë ose togfjalësh.

Kundrina shihet si gjymtyrë e dytë e fjalisë duke i kushtuar një kre të veçantë. “Kundrina është gjymtyra e fjalisë, që vihet në marrëdhënie objektore në kuptim të gjerë dhe që lidhet me lidhje nënrenditëse drejtimi me gjymtyrën prej së cilës varet.”¹²⁹

Zakonisht ajo shënon objektin e veprimit që shpreh folja:

Populli shqiptar po e ndërton me sukses **demokracinë**.

Pushka ka ndihmuar shkollën, shkolla i ka ndriçuar **rrugën** pushkës.

Por autori thekson se ka dhe kundrina që nuk tregojnë objektin e veprimit:

Punëtorit i vjen turp kur nuk e plotëson planin, kurse **ty** të dhembka gishti prandaj sorollatesh pa punë.

Poema “Bagëti e bujqësi” është shkruar nga **Naim Frashëri**.

Kundrina në këtë tekst ndahet në tre lloje: kundrinë e drejtë, e zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinë e zhdrejtë me parafjalë. Kjo ndarje është bërë duke u mbështetur në veçoritë gramatikore të shprehjes së gjymtyrëve, në format e lidhjes sintaksore ose në raportet semantike.

”Kundrina e drejtë shënon zakonisht objektin tek i cili kalon pandërmjetshëm veprimi i shprehur nga folja ose objektin që është rezultat i këtij veprimi.”¹³⁰

Punëtorët rishikonin **planet** e prodhimit dhe bënin **propozime** të guximshme.

I shkruan **një letër** të gjatë.

¹²⁹ Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Istituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe III, Sintaksa (I.sintaksa e fjalisë), (1989), ribotim Tiranë 2002, f. 253

¹³⁰ Po aty

Kundrina e drejtë gjithashtu shihet si e detyrueshme në fjalitë me folje kalimtare veprare.

Nismat e shumta kundër mbeturinave mesjetare që e poshtëronin gruan, që i ndrydhnin **personalitetin** dhe që e bënin të rëndë **jetën** e saj, duhen vlerësuar si shpërthim i një hovi të ri të kohës.

Gjithashtu, vijohet më tej, kundrinë të drejtë mund të marrin dhe format e pashtjelluara të foljes si dhe emrat prefoljorë asnjëanës.

Me të parë **Dekon** ai u ndal.

Nuk ngopesha së shikuari **misrin** nën ujë.

Kundrina e drejtë shihet si një gjymtyrë e dytë që vihet në rasën kallëzore:

Safeti e lexoi **broshurën** me etje të madhe.

“Një tjetër veçori dalluese është se kundrina e drejtë në ndryshim nga e zhdrejta mund të kthehet nga kundrinë e ndërtimeve veprare në kryefjalë të ndërtimeve joveprare.”¹³¹

Gëzimi i fitores shton **optimizmin** për fitore të reja.

Optimizmi për fitore të reja shtohet nga gëzimi i fitores.

Kundrina e drejtë, siç nënvizohet më tej në tekst, shprehet me emër zakonisht të shquar në rasën kallëzore, përmër të çdo lloji me përdorim emëror, me numëror me përdorim emëror, me një pjesë tjetër të emëruar të ligjëratës si dhe me togfjalësh.

Një veçori në këtë tekst, në krahasim me tekstet e mëparshme është dhe ndarja e kundrinës së drejtë në kundrinë të brendshme dhe kundrinë të jashtme. Kjo ndarje bëhet duke marrë parasysh lidhjen me veprimin e foljes.

Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë¹³², shihet si një kundrinë me përdorim më të gjerë dhe më e larmishme e heterogjene si nga ana kuptimore, ashtu dhe nga ana formalo-gramatikore.

“Ajo ndërtohet jo vetëm me folje kalimtare veprare, por edhe me folje jokalimtare veprare, gjithashtu dhe me folje të diatezës pësore ose vetvetore.”

Kurrë **populli** tonë si është trembur syri nga armiqtë, nga vështirësitë e pengesat.

Ajo shprehet me një gjymtyrë të dytë të rasës dhanore:

Kaq shumë i ra **ballit** me pëllëmbë, sa e ëma u çudit.

¹³¹Po aty, f. 250

¹³²Po aty, f. 256

Ajo mund të shprehet me emër, përemër, numëror a një pjesë tjetër të emëruar të ligjëratës.

Autori i tekstit thekson gjithashtu se kundrina e zhdrejtë shenjohet gjithmonë nga trajtat e shkurtra të përemrit vetor. Ajo ndërtohet përgjithësisht me folje të cilat mund të jetë kalimtare, ose jokalimtare, njëvetore ose pavetore.

U çoi bukë e djathë **partizanëve**.

Gripi **ia** shkurtoi jetën **plakut**.

Gjithashtu renditen dhe disa raste të veçanta kur kjo kundrinë nuk shenjohet nga trajtat e shkurtra.

Fenomenin gramatikor të shenjimit të kundrinave me trajta të shkurtra të përemrit vetor e gjejmë të shtjelluar shkurtimisht në vijim.

“Prania e kundrinës së drejtë e të zhdrejtë pa parafjalë shenjohet zakonisht nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, që vihet menjëherë para ose pas foljes, në kushte të caktuara edhe midis temës e mbaresës vetore të foljes.”¹³³

Më tej në tekst sqarohen dhe raste kur trajta e shkurtër është e pranishme edhe kur situata konkrete e ligjërit apo konteksti e bëjnë të panevojshme praninë e vetë kundrinës së drejtë e të zhdrejtë.

Gruaja **na** tregon për ato ditë të rënda të prillit para pushtimit.

Kështu e ëndërruan **Shqipërinë** bijtë më të mirë të popullit, kështu e ëndërruan Shqipërinë dëshmorët që e vaditën me gjakun e tyre.

Më tej autori rendit dhe rastin kur kundrina e drejtë nuk shenjohet me trajtën e shkurtër të përemrit vetor, duke e lidhur këtë fakt me kushtëzimin nga perspektiva funksionale e thënies duke u shprehur se: *“Kemi mospranim të trajtës së shkurtër të përemrit vetor, sa herë që kundrina e drejtë bart theksin e frazës, ose dhe theksin logjik të thënies”.*¹³⁴

Popullit tonë i është dashur të derdhë shumë **gjak** e shumë **djersë**.

Përsa i përket kundrinës së zhdrejtë me parafjalë¹³⁵ mund të themi se në tekstin në shqyrtim është trajtuar më gjerësisht se dy llojet e tjera të kundrinave. Këtë autorët e përligjin dhe me faktin se ajo ka një përdorim më të gjerë e të larmishëm se kundrina e zhdrejtë pa parafjalë. Sipas tyre ajo ngërdhen një shumëllojshmri edhe më të gjerë ndërtime, kuptimesh e përdorimesh.

¹³³Po aty, f. 258

¹³⁴Po aty, f. 259

¹³⁵Po aty, f. 260

Më tej autori thekson se kjo kundrinë mund të plotësojë një folje kalimtare veprorë, pësore ose mesore, por dhe një folje jokalimtare, një mbiemër, foljor ose jo foljor, përemër, numëror apo dhe një pjesë të emëruar të ligjëratës ose një togfjalësh.

Në vazhdim sqarohet se kundrina zhdrejtë me parafjalë ndërtohet me parafjalë e lokucione parafjalore nga më të ndryshmet, ku më të përdorurat janë: nga, te e tek, me, bashkë me, me anën e, në kundërshtim me, në lidhje me, në raport me, në krahasim me, për, pa, mbi, në, nën, nëpërmjet, kundër, kundrejt, ndaj.

Për pjesën më të madhe të parafjalëve të lartpërmendura jepen sqarime të mëtejshme duke ilustruar edhe me shembuj. Bie në sy trajtimi mjaft i detajuar i ndërtimeve kundrinore me parafjalën nga.

Gjithashtu vërehet se kundrina e zhdrejtë me parafjalë në këtë tekst është ndarë në kundrinë të zhdrejtë me parafjalë që përdoren në rasën kallëzore, siç janë kundrinat e ndërtuara me parafjalët: me, pa, për, mbi, në, nën dhe disa lokucione parafjalore, si dhe ato në rasën rrjedhore: nëpërmjet, kundrejt, ndaj, para e përpara, rreth, pas e mbas, drejt. Një pasaktësi vërehet në fillim kur përmenden kundrinat e zhdrejta që ndërtohen me parafjalët ‘nga’ dhe ‘te/tek’, për të cilat nuk përcaktohet se sundojnë rasën emërore. Një tjetër pasaktësi vërehet dhe në fund të këtij nënkreu, kur trajtohet kundrina e zhdrejtë e shprehur me shprehje parafjalore, ku nuk përmendet fakti i rëndësishëm se ato sundojnë rasën gjinore.

Në lidhje me trajtimin e kundrinave në këtë tekst mund të thuhet se, megjithëse në përgjithësi ato janë trajtuar në mënyrë të detajuar, vërehen dhe disa mangësi si p.sh mungesa e pyetjeve analitike, me anën e të cilave gjenden kundrinat e drejta e të zhdrejta. Duke pasur parasysh se ky është një tekst që ka përdorim të gjerë si tekst shkollor mendojmë se disa gjëra mund të ishin sqaruar pak më mirë apo dhe më thjeshtë, duke i bërë më të kuptueshme për studentët.

Gjithashtu dhe shenjimi i kundrinës me trajtë të shkurtër duke përbërë një element të veçantë gramatikor të gjuhës shqipe mendoj se mund të ishte trajtuar më gjerësisht në këtë tekst duke i kushtuar një nënkre të veçantë.

Megjithatë përse i përket tekstit në përgjithësi mund të thuhet se duke ju përmbajtur tezës së unitetit dialektik të gjuhës me mendimin, të formës me përmbajtjen, ky tekst nuk e shkëput gjuhën nga mendimi, as formën nga përmbajtja, por gjithashtu mund të thuhet se ai as nuk e njehson gjuhën me mendimin, sintaksën me logjikën, as formën me përmbajtjen. Kategoritë sintaksore shihen në tërësinë e aspekteve të tyre, si nga ana kuptimore dhe nga ana formale- strukturore, duke e parë pra formën e lidhur me përmbajtjen dhe përmbajtjen të lidhur me formën e saj të shprehjes, në mënyrë që të arrihet një përfytyrim sa më i plotë e saktë i fakteve sintaksore.

Vetë autorët e këtij teksti shprehen se *“duke patur parasysh përparësinë e përmbajtjes ndaj formës, funksionin e gjuhës si mjet marrëveshjeje midis njerëzve, si formë e realizimit, e shprehjes dhe e transmetimit të mendimit, element parësor në përcaktimet,*

*përkufizimet e klasifikimet kanë parë më të arsyeshme të merret përgjithësisht ana funksionale, po duke mos u lënë pa marrë parasysh edhe shprehja, ana formale strukturore, në atë masë dhe aty ku del e nevojshme.*¹³⁶

2.2.12. Remzi Përnaska

Në librin e tij “Kundranori me parafjalë”, botuar në Prishtinë në vitin 2000, i vetmi studim i mirëfilltë monografik në gjuhën shqipe në lidhje me kundrinën, gjuhëtari Remzi Përnaska sjell mjaft risi, madje duke nisur që nga termi ‘kundranor’ që ai përdor për kundrinën, si dhe një vështrim përmasës që ai jep për këtë gjymtyrë bazuar në çka është shkruar për të në gramatikat e mëparshme të gjuhës shqipe apo dhe në gjuhë të tjera të familjes indoevropiane, duke e ndërthurur me risi e këndvështrime të reja të sjella prej tij. Duhet theksuar se Përnaska është nga gjuhëtarët shqiptarë që është marrë më shumë me trajtimin e kundrinës. Ai është gjithashtu autor i kreut për kundrinën në shumë tekste shkollore si dhe bashkautor në tekstin e trajtuar më sipër “Gramatika 2, Sintaksa”, të Akademisë së Shkencave.

Risi tjetër për këtë vepër përbëjnë dhe trajtimi i kundrinës së drejtuar nga një emër foljor, kundrina e drejtuar nga një ndajfolje si dhe si dhe kundrina e drejtuar nga një mbiemër, si dukuri sintaksore të trajtuara për herë të parë prej tij në mënyrë të detajuar përkatësisht në krerë të veçantë, krahas kreut për kundrinën e drejtuar nga folje, të cilën më pas e ndan në të drejtë zhdrejtë. Këtë të fundit e ndan më tej në kundrinë të zhdrejtë të rasës dhanore ose të pritjes dhe kundrinë të zhdrejtë me parafjalë.

Në këtë punim Përnaska bazohet në analizën tradicionale të gjymtyrëve së fjalisë, e cila segmentimin e bën duke marrë parasysh fjalën si kategori leksiko- gramatikore, duke u mbështetur në bashkëveprimin e pjesëve të ligjëratës me gjymtyrët e fjalisë. Autori pasi i izoloi gjymtyrët e fjalisë gjatë segmentimit, i shqyrton ato në tri rrafshet: logjik, d.m.th. ku ka gjykim të paaktualizuar (S-P); gjymtyrëzim aktual (temë - remë); funksion sintaksor (kryefjalë, kallëzues, gjymtyrë të dyta). Të tri rrafshet e analizës janë në marrëdhënie të caktuara dhe hetimi i tyre, pa i përzier, ka ndihmuar, siç do të shihet, në analizën konkrete të kundrinave me parafjalë, sidomos në përcaktimin e funksioneve themelore e në gërshetimet e funksioneve të ndryshme.

Megjithatë, në disa raste në tekst gjejmë dhe vënie në zbatim të teknikave e ideve të reja të gjuhësisë së përgjithshme e për pasojë dhe trajtime jotradicionale. Ndër të tjera autori quan kundrina me parafjalë mjaft gjymtyrë që në gramatika të tjera mbahen për rrethana. Risi përbën dhe këndvështrimi i tij bashkëkohor përse i përket raporteve të gjymtyrëve mes tyre, si dhe kriteret e zbatuara prej tij për ndarjen e kundrinave në tre lloje.

Përnaska gjithashtu nuk e sheh bashkëveprimin e gjymtyrëve të fjalisë me fjalën si marrëdhënie njëstresëshe, ku secilës fjalë t’i gjendet një funksion, por si një

¹³⁶Po aty, f. 58

marrëdhënie të ndërlikuar shumështrësëshe, ku gjymtyrët segmentohen vërtetë sipas funksionit, por dhe sipas historisë së shfaqjes së tyre. Kjo është arsyeja sipas tij që disa bashkime fjalësh në këtë punim, ndryshe nga tradita, mbahen si një gjymtyrë e vetme e jo si dy a më shumë gjymtyrë.

Më konkretisht në këtë studim, autori kundërshton skemën tradicionale, ku bazuar në rolin gramatikor kryefjala shihet si gjymtyrë kryesore e fjalisë nga e cila varen dhe kallëzuesi:

Kryefjalë =>Folje- Kallëzues=>Kundrinë

Duke e modifikuar atë në:

Kryefjalë<=>Folje- Kallëzues<=>Kundrinë¹³⁷

Për këtë konceptim të ri ai bazohet në konceptin e quajtur “pjergull” në gjuhësinë e përgjithshme. Sipas këtij koncepti kryefjala dhe kundrina hyjnë në lidhje mes tyre nëpërmjet foljes, si në planin semantik ashtu dhe në atë sintaksor.

Ndryshe nga gramatikat tradicionale, Përnaska e sheh kundrinën si një gjymtyrë që në të shumtën e rasteve shpreh objektin e veprimit, por ai mendon se ky nuk është një tipar i mjaftueshëm përcaktues. Këtë ai e argumenton në vijim me aspektin idiomatik të gjuhës shqipe, ku vërehen gjymtyrë që megjithëse nuk shprehin kundrinën e veprimit, për nga roli gramatikor që luajnë në fjali renditen si kundrina:

E vërteta është se nuk ka **shpirt** të ndarë nga trupi.

Taqit s’i rrihej.

Atyre u rrëzëllinte **fytyra**.¹³⁸

Një tjetër argument i dhënë prej tij në lidhje me këtë është dhe fakti se objekti i pësimit në ndërtimet pësore shprehet nga vetë kryefjala:

Më tej jeta ime u rrokullis në banalitetin e pluhurosur të qytezës, përmes një monotonie gjumëndjellëse që prishej herë **nga druri** i Xhodës në shkollë, herë **nga druri** i babait në shtëpi, herë **nga druri** i të dyve bashkë.

Gjithashtu në lidhje me ndarjen e kundrinës në të drejtë e të zhdrejtë sipas kriterit gramatikor, ai thekson dhe faktin se në gramatikat e quajtura prej tij tradicionale, thuhet se vetëm foljet kalimtare janë të afta të marrin kundrinë, duke përjashtuar foljet e zhdrejta kalimtare. Ky pohim, bie ndesh me atë që gjendet në gramatikat e gjuhës shqipe në përgjithësi, ku kundrina e drejtë ndërtohet me emër, përemër etj. që shpreh objektin mbi të cilin bie drejtazi veprimi i shprehur nga folja, ndërsa kundrina e zhdrejtë

¹³⁷Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 23

¹³⁸Po aty, f. 25

shprehet me emër, përemër, etj. që shpreh objektin mbi të cilin bie zhdrejtazi veprimi i shprehur nga folja.

Përnaska ve në dukje gjithashtu se të njëjtat gjymtyrë fjalie mund ti gjejmë herë si kundrina të drejta e herë si të zhdrejta për të njëjtën mënyrë kalimi të veprimit.:

I ndihmoj **Agronin**.

I ndihmoj **Agronit**.

E lus **Agronin**.

I lutem **Agronit**.

Më tej Përnaska vëren se dhe përvoja i përket kriterit semantik, që shërben për të përcaktuar kundrinën e drejtë nga ajo e zhdrejtë, sipas kalimit të veprimit drejtazi ose zhdrejtazi mbi objektin nuk është gjithandej i vlefshëm për gjuhën shqipe.

Ai argumenton se “*në ndërtimet: ia marr këngës, ia jap vrapit, ia filloj punës, ia kris gazit etj., “trajta e shkurtër”¹³⁹ e përemrit vetor i është analizuar si kundranor i zhdrejtë, po ashtu si edhe kundranorët e zhdrejtë këngës, vrapit, punës, gazit, ndërsa a është analizuar si kundranor i drejtëgjithë duke shënuar të njëjtat kundrina (objekte) si edhe {i} ose emrat: këngës, punës, vrapit, gazit, qëllimit. Kundranori i zhdrejtë është, si të thuash, dy herë "i përsëritur": një herë nga "trajta e shkurtër e përemrit vetor në dhanore njëjës dhe së dyti nga "trajta e shkurtër e përemrit vetor në kallëzore njëjës. Nga të dyja, njëra: ose veprimi kalon në të dyja rastet drejtazi mbi kundranën ose veprimi kalon në të dyja rastet zhdrejtazi mbi kundranën.”¹⁴⁰*

Përnaska gjithashtu thekson se disa folje sundojnë në të njëjtën fjali dhe në të njëjtën kohë edhe një kundrinë të shprehur nga një fjalë në rasën dhanore (dhe në këtë rast shpreh një gjallesë, një qenie të gjallë) edhe një kundrinë të shprehur nga një fjalë në rasën kallëzore (dhe në këtë rast shpreh një send, një objekt). Këto folje, kur sundojnë vetëm njëherë nga këto kundrina atëherë kundrina e drejtë e shprehur nga një fjalë në rasën kallëzore shpreh përkundrazi një gjallesë, një qenie të gjallë.¹⁴¹ Kështu sipas tij, përftohen transformatat e mëposhtme:

Folje + Kundrinë e drejtë + Kundrinë e drejtë => Folje + Kundrinë e drejtë.:

Mësuesi ia fali **fajin nxënësit** ==> mësuesi e fali **nxënësin**.

dhe jo: Mësuesi i fali **nxënësit**.

me domethënie: Mësuesi e fal **nxënësin**, si ndodh në disa gjuhë të tjera.

¹³⁹thonjëzat përdoren për të treguar se autori përdor termat e traditës gramatikore, për të lehtësuar leximin e punimit, por ai nuk është i bindur se në këto raste kemi të bëjmë me përemra si kategori leksiko- gramatikore. Për më shumë shih kreun për trajtat e shkurtra

¹⁴⁰Po aty, f. 28

¹⁴¹Po aty, f. 29

Sipas tij ndarja me bazë semantike nuk është e gjithandej pertinente dhe se nuk duhet kurrsesi barazuar përmbajtja me formën në analizën e kundrinës, qoftë kjo e drejtë apo e zhdrejtë, ose thënë shkurt duhet të bazohemi më shumë mbi aksin idiomatik sesa atë semantik.

Përnaska më tej propozon ndarjen në kundrinëtë drejtë dhe të zhdrejtë duke u mbështetur mbi kriterin e mëposhtëm sintaksor:

“Kundranori i drejtë mund të kthehet në kryefjalë të ndërtimit pësor, kurse kundranori i zhdrejtë nuk është i aftë të kthehet në kryefjalë të ndërtimit pësor. Le të shtohet menjëherë që kundranori i zhdrejtë me parafjalë që shpreh vepruesin, bërësin e veprimit mund të rikthehet në kryefjalë të ndërtimit vepror.”¹⁴²

Kundrinën e drejtë, Përnaska e përkufizon si një gjymtyrë të domosdoshme për ndërtimin e asaj fjalie që ka për kallëzues një folje kalimtare në formën veprore dhe që shpreh kundrinën mbi të cilën kalon zakonisht drejtazi veprimi i shprehur nga vetë kjo folje. Kjo kundrinë e drejtë shprehet thuajse kryesisht me një emër zakonisht të shquar, një përemër, një pjesë të emëruar të ligjëratës në rasën kallëzore pa parafjalë.¹⁴³

Më tej ai specifikon se sipas kuptimit të foljes dhe emrit ose përemrit, etj., kundrina e drejtë mund të shprehë nuanca të ndryshme kundrinash "të jashtme" ose "të brendshme", në dallim nga kundrina e zhdrejtë në rasën dhanore, që shpreh vetëm nuanca kundrinash "të jashtme".

Përsa i përket pjesëve të ligjëratës me të cilat shprehen kundrina e drejtë, ajo sipas tij shprehet me emra, përemra dhe pjesë të tjera të emëruara të ligjëratës në rasën kallëzore pa parafjalë, *“në kushte të caktuara përndarjeje, mund të shprehet me një emër, përemër ose pjesë tjetër të substantivuar të ligjëratës në rasën rrjedhore: nuk kam ngrënë **kësi mollësh** asnjëherë. Ky ndërtim është trajtuar më parë edhe nga gramatikat e gjuhës shqipe; është trajtuar si partitiv. Në këto ndërtime, përemri dëftor ‘ky’, ‘kjo’ në rrjedhore funksionon si sinonim i përemri tjetër dëftori, ‘e tillë’.”¹⁴⁴*

Këso toke kemi ne këtej, o grizarak: të gjallit ia pi shpirtin, të vdekurin e ruan.

Papiruset e vjetra janë plot me **kësis** **brengash**.

Sigurisht keni dhe **asish fqinjësh** rreth të cilëve nuk lodheni të mendoni shumë.

¹⁴²Po aty, f. 30

¹⁴³Po aty, f. 53

¹⁴⁴Po aty, f. 31

Ai citon Shuteriqin, duke mbrojtur tezën e tij, i cili shprehet se: “*Veç këtyneve, mënyrë Mosdëftore, si e kanë quejtun gramatikanët, s'kemi përsëri; se gjuha jonë s'e ka një këso trajte foljore.*”¹⁴⁵

Ndërsa kundrinën e zhdrejtë ai e përkufizon si kundrinë, e cila zakonisht shpreh kundrinën që lidhet në një farë mënyre me kalimin e veprimit të shprehur nga folja, por ky kalim i veprimit mbi kundrinën nuk është i pandërmjetëm si te kundrina e drejtë.

Kundrina e zhdrejtë sipas Përnaskës shprehet me emra, përemra dhe pjesë të tjera të emëruara të ligjëratës në rasën dhanore, pa parafjalë, ose në rasa të tjera me parafjalë që sundojnë emëroren, gjinoren, kallëzoren, ose rrjedhoren. Siç shihet ky është një përkufizim i përgjithshëm për kundrinën e zhdrejtë në përgjithësi.

Më tej ai e ndan kundrinën e zhdrejtë në kundrinë të zhdrejtë të pritjes. Me një funksion të tillë sipas tij, kundrina e zhdrejtë në dhanore shpreh vetën që pret veprimin e foljes, domethënë vetën që nuk është kryefjalë, por kundrinë e veprimit të shprehur nga folja; për rrjedhojë ai mund të shprehë vetën të cilit i drejtohet a i adresohet veprimi, si edhe vetën e interesuar për veprimin e shprehur nga folja.

Kundrina me parafjalë sipas autorit nuk mund të jetë veçse kundrinë e zhdrejtë. E vetmja rasë në gjuhën shqipe që nuk sundohet nga parafjalë shton ai më tej është dhanorja.

Ai gjithashtu shprehet se kundrina e zhdrejtë me parafjalë është mjaft e larmishme në gjuhën shqipe, si për nga ndërtimi ashtu edhe për nga kuptimet e ndryshme të shumta që arrin të shprehë. Pjesa që vijon e punimit është një analizë e ndërtimeve dhe kuptimeve që shprehin kundrinat me parafjalë në shqipen e sotme.

Më tej ai e ndan kundrinën e zhdrejtë më parafjalë në kundrinë të zhdrejtë me parafjalë që sundojnë rasën emërore, kundrinë të zhdrejtë më parafjalë që sundojnë rasën kallëzore, kundrinë të zhdrejtë me parafjalë që sundojnë rasën gjinore si dhe kundrinë të zhdrejtë më parafjalë që sundojnë rasën rrjedhore. Ndarja bazohet në atë të bërë nga po ky autor në tekstin “Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaks”, botim i Akademisë së Shkencave. Kundrina e zhdrejtë me parafjalë është trajtuar më gjerësisht e në mënyrë më të detajuar nga autori në krahasim me dy kundrinat e tjera. Vlen të theksohet se pjesa teorike është e ilustruar më së miri në këtë studim më shembuj të shumëllojshëm duke e bërë më të kuptueshëm për lexuesin. Më hollësisht do ndalem në këtë tekst në kreun e pestë, i cili i kushtohet kundrinës në gjuhën shqipe.

3. Gramatika e dependencës dhe valencës

Në ditët tona kërkimet e studimet sintaksore jo vetëm nëpër botë, por dhe në vendin tonë, kanë marrë një gjallërim të veçantë. Vëmendje mjaft e madhe u është kushtuar

¹⁴⁵Po aty, cit. Shuteriqi, Dhimitër: "Mendime e vërejtje rreth grammatikës shqipe", Buletin i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1951, n. 2, f. 66.

veçanërisht problemeve teorike dhe metodave të analizës së fakteve përkatëse. Janë përpunuar dhe po përpunohen metoda e teori të reja, që shpeshherë i kundërvihen atyre të gjuhësisë klasike. Vërehen përpjekje të shumanshme për të përcaktuar mënyra të reja vështrimi e analiza të fakteve sintaksore, që lejojnë një paraqitje më të plotë, një depërtim më të thellë në natyrën e tyre, si dhe herë- herë një klasifikim më të saktë të tyre.

Koncepte klasike rishikohen dhe shpeshherë zëvendësohen me të tjera. Mund të thuhet se një pjesë e madhe e këtyre përpjekjeve karakterizohen nga synimi për analiza strukturore, thjesht formale, por nuk mungojnë edhe përpjekjet për t'i kombinuar ato me analizat semantike, kuptimore, për të parë kryesisht anën funksionale.

3.1. Mehmet Çeliku,

Tek libri i autorit Mehmet Çeliku, “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë), vështrim i ri teorik”, botuar në Tiranë në vitin 2012, gjejmë një trajtim të ri teorik të ndërtimeve sintaksore, të gjuhës shqipe siç i quan ai sintagmat, mbështetur tek sintaksa strukturaliste bashkëkohore, veçanërisht ajo e Tesnierit dhe e Çomskit, çka përbën një risi apo thënë ndryshe dhe modernizim për sintaksën e gjuhës shqipe. Autori ka ditur të ndërthurë mjeshhtërisht praktikën me teorinë, duke e bërë më të kuptueshëm librin për lexuesin. Ai ka ditur gjithashtu të ndërthurë mjaft mirë arritjet e sintaksës tradicionale me ato të teorive të reja të gjuhësisë. Koncepti i tij për përbërësin sintaksor dhe për frazën, përbën në thelb konceptin për sintagmën të gjuhësisë strukturaliste perëndimore, por që ai e zbaton nga këndvështrimi i tij. Ndër risitë e kësaj sintakse është dhe përdorimi i valencës së foljes për shpjegimin e ndërtimit të fjalisë, duke dalluar tre lloje caktuesorësh: forma e fjalës, përbërës plotësues dhe përbërës shtesorë. Vlen gjithashtu të theksohet se trajtat e shkurtra të përemrave vetorë autori i quan formante gramatikore që së bashku me foljen shprehin një përbërës sintaksor të thjeshtë, të krahasueshëm me caktuesorë të tjerë si nyjat, mbaresat, përemrat dëftorë etj., të cilat kanë si funksion të shënojnë kalimtarësinë e foljeve, vetën, elemente të tekstit, etj. Tjetër risi përbën dhe përqendrimi tek aspekti semantik i njësisve sintaksore, që mungon në sintaksën gjenerative, duke e parë fjalinë si thënie, si dhe vlerësimi i aspektit pragmatik të fjalisë, duke i dhënë rëndësi intonacionit si mjet aktualizimi i thënies. Kjo vepër sjell risi jo vetëm përsa i përket konceptimeve, por dhe terminologjisë duke futur terma të rinj si: përbërës, kryepërbërës, sinjali, caktuesor, plotësor, shtesor, etj.

Përsa i përket trajtimit të kundrinës, të cilën ai e quan ‘kundrinor’, në këtë libër autori na jep këtë përkufizimin: “*Kundrinori është gjymtyra e fjalisë, që plotëson a kufizon kuptimin e një foljeje, të një mbiemri a emri me natyrë foljore apo të një fjale që shpreh gjendje*”. Ai e sheh kundrinën si plotësor të foljes dhe i ndan ato në dy grupe përkatësisht kundrinë të drejtë dhe kundrinë të zhdrejtë. ¹⁴⁶

¹⁴⁶Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 161

Më tej autori e përkufizon kundrinën e drejtë si gjymtyrë të fjalisë që shprehet me emër, a përemër në rasën kallëzore pa parafjalë dhe tregon objektin e veprimit që ndikohet direkt nga veprimi i foljes.:

Mësuesja hap **dritaret** e klasës çdo mëngjes.

Besforti hapi **radion**.

Ata hëngrën **fiq**, ne **mollë**.

Këtë e kam takuar shpesh në Itali.

Ai shprehet më tej se kundrina e drejtë varet nga përbërës foljorë të shprehur me folje veprorë kalimtare. Çeliku e sheh kundrinën e drejtë si plotësor të domosdoshëm të këtyre foljeve. Por ai gjithashtu thekson se e njëjta folje në një kuptim është folje kalimtare dhe merr kundrinë të drejtë, në një kuptim tjetër është veprorë, por jo kalimtare, dhe në këtë rast nuk merr kundrinë të drejtë.:

Punoj tokën- veprorë kalimtare

Punoj shume- veprorë jo kalimtare

Qaj të vdekurin- veprorë kalimtare

Qaj gjithë natën- veprorë jokalimtare¹⁴⁷

Gjithashtu Çelikut vëren se ka dhe pak folje jo kalimtare që marrin “*kundrinorë të afërt semantikisht; në këto raste sipas tij “kundrinorët thjesht përsërisin kuptimin e foljes dhe quhen kundrinorë të afërt, të brendshëm, tautologjikë (që kanë lidhje kuptimore me foljen):*

Kënduan këngë.

Jeto jetën.

*Flinin gjumë kohë pa kohë.*¹⁴⁸

Në sintaksën e tij Çeliku shprehet se si kundrina e drejtë dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehet me emër të shquar, me emër të pashquar, me një përemër- emër, me një përbërës emëror të thjeshtë të zgjeruar.

Përsa i përket kundrinës së zhdrejtë ai dallon dy lloje, kundrinë të zhdrejtë të rasës dhanore dhe kundrinë të zhdrejtë me parafjalë. Kundrinën e zhdrejtë të dhanores, ai e sheh si një gjymtyrë që plotëson folje me kuptime e forma të ndryshme, folje veprorë, pësore e vetvetore, folje kalimtare dhe jokalimtare. Sipas tij ajo shënon një person a një send, i cili ndikohet nga veprimi i foljes kryesisht në kuptimin e përfshirjes; kjo do të

¹⁴⁷Po aty, f. 165

¹⁴⁸Po aty

thotë se personi a sendi që shënon kundrina e zhdrejtë nuk është objekt i drejtpërdrejtë i veprimit, por ndikohet prej tij, duke u përfshirë direkt në spektrin e veprimit.:

Ai leu **shtëpinë**.

Mësuesi i dhuroi një libër **nxënësit**.

Ca njerëzve u kishte dalë nami për mirë në fshat.

Kundrina e zhdrejtë sipas Çelikut përfshihet në çdo rast në veprimin e gjendjen e shprehur nga folja. Ai shënon shpesh një person i cili ndikohet nga veprimi i foljes, herë- herë në një mënyrë materiale, duke përjetuar si rrjedhim një gjendje të re. Për këto arsye ai e përcaton më tej kundrinën e zhdrejtë duke u shprehur se ajo luan rolin e plotësorit të foljes në fjali. Lënia jashtë e saj sipas tij, do e bënte fjalinë jo korrekte nga ana gramatikore.

Kjo lidhje e ngushtë dhe e domosdoshme semantike e kundrinës së zhdrejtë me foljen së cilës ajo i referohet, pasqyrohet sipas tij dhe nëpërmjet përdorimit të caktuesorit të kalimtarësisë, i cili shoqëron foljen në çdo rast.:

Burrit filluan t'i kërcëllinin **dhëmbët**.

Benit po i thahej **pështyma**.

Më në fund, iu afruan **zgjidhjes** së vërtetë.¹⁴⁹

Siç u pa më lart autori na ofron dhe një këndvështrim e përkufizim krejtësisht të ri për sa i përket trajtave të shkurtra. Sipas tij “ të ashtuquajturat ‘trajta të shkurtra të përemrave vetorë’ funksionojnë në gjuhë si caktuesorë të foljes, duke shenjuar në rradhë të parë, kalimtarësinë e foljes, si rrjedhim edhe kuptimin aktual të saj në thënien konkrete; ato shërbejnë edhe si mjete gramatikore referimi në tekst, duke shenjuar vetën e veprimit etj.. Ndërsa funksionin e vetë treguesit sipas tij trajtat e shkurtra e trashëgojnë nga origjina e tyre përemërore.”¹⁵⁰

Tek Çeliku gjithashtu shohim konceptin e kundrimin të kundrinës së zhdrejtë si një element themelor që ndërton nënmodele thëniesh të caktuara. Ai i ndan ato në dy grupe, përkatësisht në fjali që përmbajnë vetëm kundrinën e zhdrejtë.:

Vita i ngjante tmerrësisht **së ëmës**.

Dhe fjali që përmbajnë edhe kundrinor të drejtë edhe kundrinor të zhdrejtë:

Çdo javë i shkruan **letër familjes**.

Ai rrotullonte gotën me gishta dhe i kërkoi **djalit një cigare**.

¹⁴⁹ Po aty, f. 166

¹⁵⁰ Po aty, f. 168

Zonja Nermin po u thoshte **diçka shoqeve**.

Kundrina e zhdrejtë me parafjalë sipas Çelikut ndërtohet nga një parafjalë dhe nga një përbërës emëror a përemëror në rasën emërore, kallëzore, dhanore a rrjedhore dhe plotëson kuptimin e foljes. Parafjalët që marrin pjesë në ndërtimin e këtyre kundrinave autori i ndan në parafjalë të thjeshta, lokucione parafjalore emërore dhe parafjalë foljore. Më tej ai shprehet se kundrinat e zhdrejta me parafjalë plotësojnë folje me kuptime forma gramatikore të ndryshme, si folje kalimtare e jokalimtare, pësore e mesore, por edhe pjesë të tjera të ligjëratës.

Ai gjithashtu ngre dhe sqaron një çështje mjaft të rëndësishme në lidhje me marrëdhëniet kundrinore, atë të vështirësisë së dallimit të kundrinës me parafjalë nga rrethanori.: *“Në rastet kur PF kokë dhe parafjala është e njëjtë, për diferencimin e marrëdhënieve vjen në konsideratë PE, i vendosur në krahun e djathtë, nëse ky shpreh një njeri a send (jo frymor). Ai gjithashtu thekson se dallimi mund të bëhet dhe me anë të pyetjes me përemër apo ndajfolje, të cilat ndihmojnë në kapjen e informacionit.”*

Mjeku qëndronte pranë të sëmurit.

Mjeku qëndronte pranë shtratit.”¹⁵¹

Një tjetër risi për këtë vepër përbën dhe fakti se Çeliku dallon trembëdhjetë lloje të ndryshme marrëdhëniesh kundrinore të shprehura me anë të kundrinave të zhdrejta me parafjalë, në varësi të parafjalës së kundrinës përkatëse: mjetin e kryerjes së veprimit, marrëdhënie shoqërimi, marrëdhënie kundërshtie, vepruesin që kryen veprimin, marrëdhënie kufizimi, thjesht objektin e një veprimi, objektin mbi të cilin ushtrohet a shtrihet veprimi, nënlojin e një sendi a pjesën e një tërësie, pjesë të trupit a të një objekti, përbërësin e një sendi, marrëdhënie zëvendësimi, marrëdhënie përjashtimi. Nga sa u tha më sipër vërehet se ndryshe nga gjuhëtarët e tjerë që bëjnë ndarjen në katër lloje të kundrinave të zhdrejta me parafjalë, bazuar në aspektin gramatikor të rasës, Çeliku bën një ndarje thellësisht të karakterit semantik të kundrinave të zhdrejta me parafjalë.

4. Gramatika gjenerative

4.1. Flora Koleci, Giuseppina Turano

Libri “Hyrje në sintaksën gjenerative të gjuhës”, botim i vitit 2001, i autorëve Koleci e Turano, shënon një hap të madh përpara në fushën e sintaksës së gjuhës shqipe. Për herë të parë botohet një libër ku çështjet më thelbësore të sintaksës së gjuhës shqipe parashtrihen dhe trajtohen në kuadrin e modelit teorik të sintaksës gjenerative.

Një rëndësi e veçantë në libër i jepet valencës së foljes, e cila shërben dhe për ndarjen e elementeve të fjalisë në dy grupe duke përdorur parimin e domosdoshmërisë. *“Fjalët apo përbërësit që kërkohen nga folja, në varësi të valencës së saj quhen ‘argumente’, ndërsa elementet e tjera, prania e të cilëve është fakultative në frazë quhen adjunktë,*

¹⁵¹Po aty, f. 171

*elemente shitesë. Në kategorinë e argumenteve bëjnë pjesë dhe kundrinat. Argumentet autorët i ndajnë më tej në argumente të brendshëm dhe argumente të jashtëm.*¹⁵²

Ana dëgjon **muzikë**.

Sipas autorëve, ‘Ana’ është argument i jashtëm, ndërsa ‘muzikë’ është argument i brendshëm

*”Termet i brendshëm/ i jashtëm kanë të bëjnë me faktin që argumenti i brendshëm ndodhet brenda sintagmës foljore VP, ndërsa argumenti i jashtëm zë një pozicion në periferinë e kësaj sintagme.”*¹⁵³

Ndërsa për të parë dallimin mes dy argumenteve dhe rolin që luan argumenti i brendshëm ndaj atij të jashtëm autorët argumentojnë bazuar në shembujt e mëposhtëm:

Ana theu **xhamin/ gotën**.

Ana theu **qafën**.

Roli i argumentit të jashtëm ‘Ana’ sipas tyre, ndryshon në varësi të kuptimit që argumenti i brendshëm ‘xhamin/ gotën’ dhe ‘qafën’ u jep përkatësisht sintagmave foljore: theu xhamin/ gotën, theu qafën.

Në rastin e parë argumenti Ana është veprues dukeqënëse veprimi bie mbi ‘xhamin/ gotën’, ndërsa në rastin e dytë pasues pasi veprimi bie mbi vetë ‘Anën’.

Një kre të veçantë në këtë libër i kushtohet dhe rastit të fjalive po ndërtimeve me dy kundrina, një të drejtë dhe një të zhdrejtë (apo argumente të brendshëm, siç i quajnë autorët).

Ana i dha **librin Agimit**.


Më tej autorët bëjnë ndarjen e kundrinës në të drejtë e të zhdrejtë, ku argumentojnë se folja ‘dha’ e cila quhet prej tyre ditranzitive u shënon rolin tematik dy argumenteve të brendshme: “*kundrinori i drejtë i cili në gramatikën gjenerative emërtohet temë, angl. theme) dhe kundrinorit të zhdrejtë, që emërtohet qëllim (angl. goal).*”¹⁵⁴Struktura e saj paraqitet prej tyre si më poshtë:

Argumentet e brendshme sipas tyre, janë gjeneruar në pozicionin poshtë foljes. Në skemën e mësipërme, folja ‘dha’ ka shënuar më parë rolin tematik të temës ‘librin’ e më pas e gjithë sintagma është bashkuar me argumentin ‘Agimit’.


¹⁵²Koleci, Flora; Turano, Giuseppina: Hyrje në sintaksën gjenerative të gjuhës, Shblu, Tiranë 2011, f. 33

¹⁵³Po aty, f. 52


¹⁵⁴Po aty, f. 53



Më tej ato e rikompozojnë strukturën duke u bazuar dhe tek propozimi i gjuhëtarit Larson, i cili sugjeron që strukturat foljore të shënohen poshtë ndërtimeve ditranzitive si vijon:



Në vijim ato shprehen se folja ‘dha’, duhet të realizojë lidhjen me argumentin e jashtëm Ana, prandaj ajo lë pozicionin fillestar për tu ngritur në pozicionin kokë të sintagmës foljore, nga ku shënon rolin tematik të specifikuesit të kësaj sintagme si vijon:



Koleci/ Turano bëjnë gjithashtu dallimin mes kundrinave dhe rrethanorëve. Këta të fundit i quajnë adjunktë dhe janë sipas tyre element fakultativ, në ndryshim nga kundrinat, të cilat i quajnë argument dhe janë elementë të domosdoshëm. “*Lidhur me rolin e tyre në frazë, vëmë re që kundrinori i drejtë Tanin është i domosdoshëm për foljen, pra nuk mund të hiqet, ndërsa prania e dy sintagmave parafjalore, është fakultative, pasi ato japin një informacion shtesë jo të domosdoshëm për ndërtimin dhe kuptimin e frazës, nuk janë valenca të foljes, pra mund të mos jenë të shprehura.*”¹⁵⁵ Këtë ato e ilustronë me shembullin e mëposhtëm:


Beni takoi **Tanin në bibliotekë në mëngjes**.

Beni takoi **Tanin**.

Beni takoi **Tanin në bibliotekë**.

Beni takoi **Tanin në mëngjes**.

¹⁵⁵Po aty, f. 55



Një kre i veçantë i kushtohet teorisë X Bar, me anë të së cilës studiohet struktura e përbërësve. Kjo teori shihet si një teori universale, pasi sipas tyre, është e zbatueshme në të gjitha gjuhët e botës. Sipas kësaj teorie çdo përbërës është projektim i një koke, e cila përfaqëson elementin qendror të përbërësit duke i dhënë dhe emrin këtij të fundit. “Prandaj nëse një përbërës ka si kokë një emër ai do të emërtohet ‘Sintagmë emërore’, ‘NP’, nëse koka është një folje, emërtimi do të jetë ‘Sintagmë foljore’ ose ‘VP’; kur koka është një mbiemër, atëherë kemi ‘Sintagmë mbiemërore’, ose ‘AP’; nëse koka është parafjalë, do të quhet ‘Sintagmë parafjalore’ ose ‘PP’.”¹⁵⁶ Vërehet se shënimi i sintagmave me shkurtime është bërë mbi bazën e inicialeve të fjalëve përkatëse nga anglishtja, gjë që mund të jetë konfunduesë për studentin. Mendoj se do të ishte më e udhës që ato të ishin në gjuhën shqipe, siç i pamë në librin e sipërpërmendur të Çelikut.

Gjithashtu një kre më vete i kushtohet dhe trajtave të shkurtra të përemrit vetor, të cilët në këtë tekst quhen ‘klitik’, dhe ky term i huazuar nga anglishtja. Në kuadrin e gramatikës gjenerative trajtohet çështja e vendit që zënë ata në fjali, duke i ndarë sipas pozicionit të trajtës së shkurtër në lidhje me foljen në: ‘proklizë’ (parafoljor), ‘enklizë’ (në mes të foljes) dhe ‘endoklizë’ (pasfoljor).

¹⁵⁶Po aty, f. 36

KREU III - VËSHTRIM HISTORIK PËRQASËS I KUNDRINËS NË GRAMATIKAT E GJUHËS GJERMANE DHE ATË SHQIPE

Dallimi i kundrinës në të dyja gjuhët, veçanërisht atë shqipe, është bërë relativisht vonë. Teoria e tyre është përpunuar dalëngadalë në gjysmën e parë të shekullit XIX duke u plotësuar më pas pak nga pak, proces ky që vazhdon ende edhe në ditët e sotme.

Siç u pa qartë në kreun e parë e të dytë të këtij punimi, kategoria sintaksore e gjymtyrëve të tilla si kundrina e rrethanori, në përgjithësi dhe e kundrinës në veçanti është një ndër çështjet më problematike dhe të diskutueshme të gramatikës në të dyja gjuhët. U vërejt qartë se në përcaktimin, përkufizimin e klasifikimin e tyre ka pasur dhe ende ka qëndrime e këndvështrime të ndryshme, ku vërehen divergjenca herë më të mëdha e herë më të vogla. Përkufizimet jepen në mënyra të ndryshme, ndahen duke u mbështetur në kritere të ndryshme. Gjithashtu mospajtime të shumta vërehen veçanërisht përsa i përket shtrirjes, caqeve, emërimit dhe nëndarjes së kundrinave në gjuhën shqipe dhe atë gjermane. Kjo vjen si pasojë e mbështetjes së gjuhëtarëve të ndryshëm në metoda të ndryshme metodologjike, e veçorive e traditave, si dhe dalja e rasteve të shumta kalimtare e sinkretike. Pikëpamjet e studiuesve kanë sjellë e vazhdojnë të sjellin ndryshime të shumta në parashtrimin e kundrinave.

Vlen të theksohet se në të dyja gjuhët, në trajtimin e kundrinës, janë dalluar në rradhë të parë dy drejtime kryesore: i pari mbështetet në raportet e brendshme, në kuptimin, në funksionin, tjetri në mënyrën e shprehjes gramatikore. Secili prej këtyre drejtimeve shfaqet në një mori variantesh, në forma të ndryshme, herë të skajshme e herë shihet një përpjekje për kombinim të disa varianteve.

Në kohën kur në gjuhësi mbizotëronte drejtimi logjik gramatikor, i cili bazohej vetëm në raportet kuptimore, u krijua për herë të parë teoria e gjymtyrëve të tjera, nga ku dolën edhe tre emërtimet e tyre: përcaktor, kundrinë, rrethanor. Kundrina përkufizohej përgjithësisht si gjymtyra që shënon sendin zakonisht të lidhur pak a shumë me një veprim. Trajtimi logjik gramatikor njëjtësoi gjuhën me logjikën, duke mos përfillur thujtë fare veçoritë gjuhësore, mënyrën e shprehjes së raporteve sintaksore, duke i lënë kështu rrugë subjektivizmit dhe duke i hequr mundësinë analizës gramatikore për tu mbështetur në kritere të qëndrueshme e të qarta.

Gjithashtu mund të thuhet se, sintaksat me drejtim logjik, apo psikologjik, si dhe ato me drejtim formal karakterizohen në shumicën e rasteve nga moskuptimi i drejtë i raporteve midis gjuhës dhe mendimit, midis përmbajtjes dhe formës, duke i dhënë kështu zgjidhje të gabuara apo të pakënaqshme problemeve themelore të gjuhësisë, e në mënyrë të veçantë atyre sintaksore. Ato ose e njehsuan gjuhën me mendimin, kategoritë gramatikore me kategoritë logjike, formën me përmbajtjen, ose mbivlerësuan formën dhe e shkëputën atë nga përmbajtja. Kështu mund të thuhet se ato bënë një paraqitje të mangët e të njëanshme të fakteve sintaksore dhe nuk arritën në përgjithësi të japin një sqarim dhe interpretim të drejtë e të plotë të tyre.

Duke parë se kjo mënyrë trajtimi pati mungesat dhe të metat e saj, u pa e nevojshme për të kërkuar një përcaktim dhe klasifikim më të përpiktë të kundrinës. Mjaft prej këtyre përpjekjeve u lidhën me qëndrimin formal gramatikor, i cili i përcaktonte gjymtyrët sipas mënyrës së shprehjes morfologjike, ose të shfaqjes së lidhjes sintaksore të tyre. Kjo gjeti pasqyrim shpeshherë dhe në emërtimet e tyre. Por dhe ky drejtim pati të metat e tij. Ai bëri parësore formën, duke lënë jashtë studimit anën kuptimore, raportet e brendshme mes nocioneve të shprehura me anën e gjymtyrëve, duke mos i kushtuar thuajse fare vëmendje funksionit themelor të gjuhës, si realizim e shprehje e mendimit dhe mjet komunikimi mes njerëzve.

Të dyja këto drejtime dhe mënyra trajtimi karakterizohen nga një vështrim i njëanshëm, çka sjell shpesh një kuptim jo plotësisht të drejtë të raporteve mes formës dhe përmbajtjes, gjuhës dhe mendimit.

Në ditët e sotme në të dyja gjuhët janë shtuar kërkimet në fushën e sintaksës si në sferën gjermanishtfolëse, ashtu dhe në atë shqipfolëse. Vërehen përpjekje të ndryshme për të zgjidhur drejtë çështjet e përcaktimit dhe klasifikimit të kundrinave, duke ecur në drejtime të ndryshme, për të përmirësuar teoritë e mëparshme, ose për të gjetur rrugë e mënyra të reja vështrimi dhe interpretimi.

Gjithashtu në të dyja gjuhët, vërehen përpjekje të gjuhëtarëve të ndryshëm për ta zhvilluar më tej teorinë klasike të klasifikimit dhe përcaktimit të gjymtyrëve ku bën pjesë dhe kundrina, duke modifikuar dobësi, apo dhe mungesa të saj, në mënyrë që ti ofrohet një bazë më e qëndrueshme e të saktë të zgjidhjeve të ndryshme të kësaj çështjeje si nga ana sistematike, ashtu dhe nga ajo strukturore e të përbërjes së fjalisë në kuadrin e gjymtyrëve të dyta ose jashtë tyre. Në shumë nga këto teori përdoren simbole, për të shënuar gjymtyrët ose pjesët përbërëse të fjalisë, për të dhënë skemat strukturore të tyre përdoret gjerësisht dhe metoda e zëvendësimit të një mënyre shprehjeje me një tjetër.

Hartimi i gramatikave në përgjithësi dhe i sintaksës në veçanti në gjuhën gjermane daton shumë më herët se në gjuhën shqipe. Për këtë arsye kundrina si njësi gramatikore në gjuhën gjermane ndeshet në gramatikat e fillimit të shekullit 19, ndërsa në gjuhën shqipe një shekull më vonë, në fillim të shekullit XX. Përsa i përket termit të përdorur për kundrinën, vërehet se të në dyja gjuhët fillimisht janë përdorur terma të tjerë nga këta që ndeshen sot.

Kështu në gramatikën e gjuhës gjermane, kundrina deri në mesin e shekullit të XIX nga gjuhëtarë të ndryshëm u quajt ' fjalë që shpreh qëllimin (Zweckwort), fjalë që shpreh përshtatje (Aneignuswort), shtojcë (Beifügung) dhe fjalë që shpreh synimin (Zielwort). Më pas, në mesin e shekullit XIX, në gramatikën e gjuhës gjermane, gjejmë për herë të parë të përdorur termin nga Beker "Objekt". Ky term në gjuhën gjermane gjeti përdorim të gjerë veçanërisht në tekset shkollore, ku ndeshet dhe sot. Atë e ndeshim në të gjitha gramatikat me orientim tradicional si dhe ato që përfaqësojnë gramatikën me orientim

nga përmbajtja. Në gramatikat me orientim nga teoria e valencës dhe dependencës haset termi “Ergänzung”, i cili gjithashtu është një term i njehsuar në këto gramatika. Në gramatikën gjenerative të gjuhës gjermane kundrina quhet “komplement”.

Ndërsa në gjuhën shqipe në fillim të shekullit XX, kundrinën si njësi gramatikore, e ndeshim për herë të parë tek Xanoni, me termin “përkryesa” dhe “objekt”. Ky i fundit mesa duket i huazuar nga ndonjë gjuhë tjetër, është përdorur më vonë dhe nga Cipo. Një shekull më vonë, Xhuvani ishte i pari gjuhëtar që përdor termin që njohim dhe sot “kundrinë”. Këtë term e përdorin më vonë dhe gjuhëtarë të tjerë si Sheperi, Rrota, Myderizi, Prifti etj. Gjithashtu në gjuhën shqipe ndeshet dhe termi, “kundrinor” i përdorur në libra shkollorë të gramatikës së gjuhës shqipe si dhe nga Çeliku, në sintaksën e tij me orientim nga teoria e valencës dhe dependencës. Përnaska jep një tjetër term për kundrinën duke e quajtur “kundranor”, term ky i huazuar sipas tij nga Riza. Ndërsa në gramatikën gjenerative në gjuhën shqipe ndeshet me termin e huazuar nga anglishtja, “argument”.

Përsa i përket klasifikimit të mëtejshëm të kundrinës në gramatikën tradicionale, vihet re një ndryshim thelbësor mes dy gjuhëve. Në gjuhën gjermane mesa shihet përparësi i jepet aspektit gramatikor, ndërsa në gjuhën shqipe atij semantik. Kjo vërehet në terminologjinë e përdorur në të dyja gjuhët.

Kështu në gjuhën gjermane kundrina në gramatikën tradicionale, sipas kriterit formal gramatikor të rasës, në kundrinë të rasës kallëzore, kundrinë të rasës gjinore, kundrinë të rasës dhanore dhe kundrinë me parafjalë. Këtë ndarje e gjemë tek Schulz/ Grizbah, Helbig, Duden, Kadzadej, Henshel/ Veid, etj. Por ajo ndeshet dhe në gramatikën e Myderrizit dhe Rrotës në gjuhën shqipe, të cilët e ndajnë kundrinën në gjuhën shqipe në kundrinë të rasës kallëzore dhe kundrinë të rasës dhanore.

Ndërsa në gjuhën shqipe, kundrina ndahet përgjithësisht në bazë të aspektit semantik në të drejtë e të zhdrejtë. Këtë ndarje në gjuhën shqipe e vërejmë për herë të parë tek Xanoni, e më tej tek të gjithë gjuhëtarët e tjerë të gramatikës tradicionale të gjuhës shqipe si Xhuvani, Sheperi, Rrota, Myderrizi, Cipo, Prifti, Përnaska, etj.. Kjo ndarje vërehet dhe tek gramatika e Çelikut megjithëse kjo gramatikë, bazohet në teorinë e valencës. Por kjo ndarje përmendet dhe në disa gramatika tradicionale, të gjuhës gjermane, si p.sh. ajo e Henshel/ Veid, Kyrshner e Linke/ Nusbaumer/ Portman. Ky është gjithashtu dhe klasifikimi tipik i gramatikës me orientim nga përmbajtja në gjuhën gjermane e cila e ndan kundrinën në të drejtë e të zhdrejtë.

Një tjetër ndarje e kundrinës sipas aspektit semantik është dhe ajo në kundrinë e brendshme dhe e jashtme, të cilën e ndeshim rrallë në gjuhën gjermane, ndërsa në gjuhën shqipe u pa për herë të parë tek Sheperi e më tej tek Cipo, Prifti e Përnaska. Në gjuhën gjermane në gramatikat e hulumtuara për këtë punim u ndesh vetëm tek Henshel/ Veid.

Kundrina me parafjalë në të dyja gjuhët u dallua si gjymtyrë më vete shumë më vonë se kundrinat e tjera përkatësisht ato të rasës kallëzore, dhanore dhe gjinore në gjuhën gjermane dhe e drejta dhe e zhdrejta në gjuhën shqipe. Në gjuhën gjermane ishte Blatz në fund të shekullit XIX, i cili dalloi për herë të parë kundrinën me parafjalë, ndërsa në gjuhën shqipe ajo veçohet për herë të parë nga gjuhëtari Rrota, në mesin e shekullit XX. Dhe këtu bie në sy emërtimi në të dy gjuhët: në gjuhën gjermane kjo kundrinë quhet kundrinë me parafjalë, duke u bazuar vetëm në aspektin gramatikor, ndërsa në gjuhën shqipe, kundrinë e zhdrejtë me parafjalë, duke u bazuar në rradhë të parë në aspektin semantik.

Përsa i përket gramatikës tradicionale në të dyja gjuhët vihet re se fillimisht ajo ishte e lidhur ngushtë me logjikën. Ndërsa më vonë mund të flitet për një gramatikë të mirëfilltë tradicionale. Ndërsa në tekstet gramatikore të viteve të fundit të cilat bazohen tek gramatika tradicionale duke përdorur dhe terminologjinë e saj, vërehen veçanërisht në ato të gjuhës gjermane dhe elemente nga teori të tjera gramatikore të zhvilluara më vonë, prandaj përgjithësisht është e vështirë të bëhet një ndarje e qartë se kujt teorie i përkasin.

Një tjetër ndryshim në gramatikat e dy gjuhëve, që bie veçanërisht në sy është se gjuhëtarët e ndryshëm të gjuhës gjermane, veçanërisht ata të shekullit XIX dhe XX si Humboldi, Grimi, Bokeri, por dhe më vonë në gramatikën me orientim nga përmbajtja me përfaqësues kryesorë Vajsgerber e më tej ajo gjenerative të bazuara në teorinë e Çomskit etj., e shihnin gramatikën dhe i interpretonin faktet gjuhësore/ gramatikore të lidhura ngushtë me filozofinë dhe sociologjinë, duke përfshirë ndër të tjera dhe ndikimin e shoqërisë në gjuhësi. Gjithashtu metoda historike krahasuese e gjuhëve zinte vend qendror në gramatikat e gjuhës gjermane të shekullit XIX. Këto aspekte nuk shihen në gramatikat e gjuhës shqipe. Këto të fundit merren vetëm me aspektet gjuhësore gramatikore.

Gjithashtu vërehet se teorinë e ndryshme gramatikore nuk zhvillohen paralelisht në të njëjtin hark kohor në të dyja gjuhët. Vihet re se gramatikat e gjuhës gjermane në të njëjtin hark kohor janë më të 'përparuara', përsa i përket koncepteve dhe teorive të reja gramatikore. Madje teori të ndryshme, si psh. ajo e gramatikës me orientim nga përmbajtja nuk trajtohen fare në gjuhësinë shqiptare. Dhe përsa i përket teorive më të fundit si psh. ajo e valencës dhe dependencës dhe ajo gjenerative të trajtuara në këtë punim, vërehet se në gjuhën shqipe ato janë lëvruar shumë më vonë se në gjuhën gjermane dhe nga shumë pak gjuhëtarë. Konkretisht gjatë hulumtimit ndesha vetëm në gramatikën e Çelikut, e cila mund të thuhet se ka orientim nga gramatika e valencës dhe dependences dhe gjithashtu vetëm një gramatikë të mirëfilltë gjenerative, atë të Koleci/ Turano. U vërejt se në gjuhën shqipe ndryshe nga ajo gjermane dominon trajtimi tradicional i sintaksës. Ndërsa në gjuhën gjermane vërehet se përgjithësisht gjuhëtarët në vitet e fundit, bazohen tek gramatika e valencës dhe dependencës dhe veçanërisht tek ajo gjenerative. Për të dyja këto drejtime, në gjuhën gjermane, ekziston një numër i konsiderueshëm gramatikash si dhe punimesh të ndryshme.

PJESA E DYTË

KREU IV - KUNDRINA NË GJUHËN GJERMANE

1.Gjymtyrët e fjalisë

Termi sintaksë (syntaksis) vjen nga antikiteti greko- latin dhe ka kuptimin bashkëvënie apo bashkërenditje. Në gjuhësinë e sotme sintaksa shihet përgjithësisht si degë e gramatikës e cila studion ndërtimin dhe strukturën si dhe raportet sintaksore të fjalisë. Mënyra sesi kombinohen njësitë për të realizuar thënien përbën raportet sintaksore. Ky kombinim nuk duhet marrë thjesht si një bashkëvendosje e njësive me kuptim, por një lidhje varësie e ndërsjelltë mes tyre, e drejtuar nga rregulla që shprehin një kuptim të caktuar dhe që bëjnë që thënia të mos jetë një bashkim i çfarëdoshëm njësish kuptimore.¹⁵⁷

Fjalitë sipas Duden janë “*sprachliche Einheiten, die relativ selbständig und abgeschlossen sind. Sie bauen sich aus kleineren sprachlichen Einheiten auf, die ihrerseits auch schon einen gewissen Selbstständigkeitsgrad haben, Wörtern und gegliederte Wortgruppen./ njësi gjuhësore, të cilat janë relativisht të pavarur dhe të mbyllura. Ato formohen nga njësi më të vogla gjuhësore (fjalë dhe togfjalësha të strukturuar), të cilat gjithashtu kanë një lloj pavarësie.*” Tek këto njësi më të vogla bëjnë pjesë gjymtyrët e fjalisë.¹⁵⁸

Njësitë e fjalisë (Konstituenten) në gjuhën gjermane, sipas Helbig ndahen në njësi njëfunktionale (*einfunktionale Konstituenten*) dhe njësi shumëfunktionale (*mehrfunktionale Konstituenten*):

-*einfunktionale Konstituenten (die nur einen Platz in der Konstituentenstruktur einnehmen können)- z.B. das finite Verb, das nur als Prädikat fungieren kann;/* përbërës sintaksor njëfunktional (të cilat mund të zënë vetëm një vend në strukturën e njësive)- p.sh. folja e zgjedhur, e cila mund të jetë vetëm kallëzues;

-*mehrfunktionale Konstituenten (die mehrere Plätze in der Konstituentenstruktur einnehmen können)- z.B. die Substantivgruppe(die als Subjekt, als Objekt, als Prädikativ oder als Adverbiale fungieren kann) oder die Präpositionalgruppe (die als Adverb oder als Objekt, manchmal auch als Prädikativ fungieren kann)./ Përbërës sintaksor shumëfunktional (të cilat mund të zënë shumë vende të ndryshme në strukturën e njësive)- p.sh. kategoria e emrave (të cilët mund të jenë kryefjalë, kundrinë,kallëzuesor ose rrethator) ose grupi kategoria e parafjalëve (të cilat mund të jenë rrethator ose kundrinë, nganjëherë dhe kallëzuesor).”¹⁵⁹*

¹⁵⁷Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f. 7- 8

¹⁵⁸Duden. *Die Grammatik*. 4., völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich: Dudenverlag (Duden 4), 1995, f. 559

¹⁵⁹Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f 109

Sipas teorisë së gramatikës tradicionale në gjuhën gjermane, së cilës do i referohem në këtë kre, Kadzadej: “*Satzglieder sind relationale Größen, Mengen von Paaren, die ein bestimmtes Merkmal gemeinsam haben. Diese Paare bestehen aus dem jeweiligen Glied einerseits und dem ganzen Satz andererseits.*” Gjymtyrët e fjalisë janë njësi relative, mori çiftesh, të cilat kanë të përbashkët një karakteristikë të caktuar.¹⁶⁰ Çka do të thotë sipas saj, se një fjalë ose një togfjalësh përbëjnë një gjymtyrë fjalie për shkak të një raporti të caktuar, që kjo fjalë ose ky togfjalësh ka me të gjithë fjalinë. Në shumicën e rasteve një gjymtyrë fjalie përbëhet nga një fjalë.:

Das Buch ist grün./ Libri është jeshil.

Die Katze ist klein./ Macja është e vogël.

Përkufizimi i gjymtyrës së fjalisë nga gramatika tradicionale nisët nga kushtet që duhet të plotësojë ajo, pra provat që duhet të kalojë: provën e zëvendësimit (Ersatzprobe) dhe rendet e ndryshme në fjali (Verschiebeprobe). Nëse i plotëson këto dy kushte është gjymtyrë fjalie.

Në gjuhësinë tradicionale të gjuhës gjermane, sipas Helbig¹⁶¹, gjymtyrët e fjalisë ndahen si vijon:

1.në të ashtëquajturat gjymtyrë kryesore të fjalisë (primäre Satzglieder), të cilat përcaktohen nga kallëzuesi i fjalisë dhe janë pjesë e strukturës bazë të fjalisë, ku bëjnë pjesë kryefjala, kallëzuesi, kundrina dhe rrethanori. Përcaktori në gjuhën gjermane, nuk merret si gjymtyrë më vete, por si pjesë e gjymtyrëve të tjera, të cilat i përcakton më nga afër.

Gjithashtu gjymtyrët kryesore të fjalisë në gramatikën tradicionale të gjuhës gjermane ndahen në të zgjedhueshme/ të lakueshme (flektierbare) ose (Kasusbestimmte), ku bëjnë pjesë kryefjala dhe kallëzuesi dhe të palakueshme (unflektierbare) ose (Kasusunbestimmte), ku bën pjesë rrethanori.

2.gjymtyrë të dyta të fjalisë (sekundäre Satzglieder/ Satzglieder zweiter Ordnung), sipas tij janë ato gjymtyrë, të cilat nuk varen nga kallëzuesi i fjalisë dhe nuk i përkasin strukturës bazë.

Ai i ndan gjymtyrët e dyta më tej në:

a)gjymtyrë të dyta të fjalisë, ku bëjnë pjesë:

-emra në rasën dhanore. Ndër to ai përmend dhe lloje të ndryshme të dhanores së lirë (freie Dativ), që ai i cilëson jo si kundrina, megjithëse shprehen me emra në rasën dhanore:

¹⁶⁰Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f. 25

¹⁶¹Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 110-114

Dhanorja komodi (Dativus commodi): Er trägt **seiner Mutter** das Gepäck./ Ai i mban bagazhin nënës së tij.

Dhanorja inkomodi (Dativus incomodi): Der Schlüssel fiel **dem Jungen** ins Wasser./ Çelësi i ra djalit në ujë.

Dhanorja e masës (Dativus des Maßstabs): Er arbeitet **dem Chef** zu langsam./ Për shefin ai punon shumë ngadalë.

Dhanorja etike (Ethischer Dativ): Falle **mir** nicht!/ Mos më bjer!

-fjalë modale: Er hat uns **leider** nicht informiert./ Ai **fatkeqësisht** nuk na ka informuar.

-parafjalë + emër: Er trägt **für seine Mutter** das Gepäck./ Ai mban bagazhin për nënë e tij.

b)gjymtyrët e dyta të fjalëve të veçanta, ku ai përmend:

-përcaktorin kallëzuesor të kryefjalës: Er kommt **gesund** an./ Ai mbërriti i shëndetshëm.; ose të kallëzuesit: Er aß die Möhren **roh**./ Ai i hëngri të gjalla karrotat.

-dhanorja posesive, dhanore e lirë, e cila ndryshe nga dhanorja e kundrinës, nuk varet nga kallëzuesi, por varet nga gjymtyrë të tjera emërore. Ajo përcakton një njeri, të cilit i përket një pjesë trupi, i cili shprehet:

a)me kryefjalë: **Dem Kranken** tat **der Magenweh**./ Të sëmurit i dhimbte stomaku.;

b)me kundrinë: Der Arzt operierte **dem Kranken den Magen**./ Mjeku i operoi stomakun të sëmurit.;

c)ose si rrethanor: Er sieht **seinem Freund in die Augen**./ Ai e sheh në sy shokun e tij.

Gjithashtu në disa tekste tradicionale gramatikore, si p.sh. tek Helbig¹⁶²dhe Bynting/Bergenholtz¹⁶³ndeshet dhe ndarja në:

a.gjymtyrë të detyrueshme, ku bëjnë pjesë kallëzuesi, kryefjala, kundrinat, rrethanorë të caktuar, si dhe kallëzuesorë të caktuar. Klasifikimi i këtyre gjymtyrëve mund të bëhet me anë të provës së eliminimit, ku nëse pas eliminimit të gjymtyrëve të caktuar në fjali shihet nëse fjalia pa to ka kuptim, dmth se gjymtyrët e eliminuara nuk janë të detyrueshme. Në të kundërt nëse fjalia nuk ka kuptim pas eliminimit, gjymtyrët janë të detyrueshme.

Nisur nga interesi i temës së këtij punimi, fjalitë ilustruese në vijim kanë kryesisht në përbërjen e tyre kundrina të detyrueshme. :

¹⁶²Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 111

¹⁶³Bünting, Karl-Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum Lesen einer Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenäum, Weinheim 1995, f. 79

Sie überarbeitet **ihre Notizen**./Ajo redakton shënimet e saj.
Nuk qëndron: Sie überarbeitet./ Ajo përpunon
Sie gleicht **ihrer Schwester**./ Ajo i ngjan së ëmës.
Nuk qëndron: Sie gleicht./ Ajo i ngjan.
Sie gedachten **der Gefallenen**./ Ata kujtonin të rënët.
Nuk qëndron: Sie gedachten./ Ata kujtonin.
Wir beziehen uns **auf Ihren Brief**./ Ne i referohemi letrës suaj.
Nuk qëndron: Wir beziehen uns./ Ne i referohemi.

Ose rrethanori i detyrueshëm në shembullin e mëposhtëm:
Der Dorf liegt **an der Hügel**./ Fshati shtrihet mbi kodër.
Der Dorf liegt./ Fshati shtrihet.

Siç shihet fjalitë e mësipërme nuk kanë kuptim pa gjymtyrën e nënvizuar, dmth në këtë rast këto gjymtyrë janë të detyrueshme.

b.jo të detyrueshme, ku bëjnë pjesë, rrethorë dhe kallëzuesorë të caktuar.

Sie arbeitet **gern**./ Ajo punon me qejf.
Sie arbeitet./ Ajo punon.
Er schläft **viel**./ Ai fle shumë.
Er schläft./ Ai fle.

Fjalitë e mësipërme do të kishin kuptim dhe pa gjymtyrët e nënvizuara, çka do të thotë se ato nuk janë gjymtyrë të detyrueshme në këtë rast.

1.1.Klasifikimi i gjymtyrëve kryesore

Në gjuhësinë tradicionale kallëzuesi shihet si gjymtyra e cila kushtëzon ndërtimin e fjalisë dhe duke qenëse është e vetmja gjymtyrë që shprehet me anë të foljes, zakonisht nuk nevojiten prova të mëtejshme për ta identifikuar. Në raste dyshimi mund të bëhet pyetja analitike ‘çfarë ndodh?’. Ndërsa për të identifikuar gjymtyrët e tjera përdoren kryesisht dy metoda:

a)metoda analitike, e cila mundësohet me anë të pyetjeve ndihmëse, të cilat i drejtohen kallëzuesit (kallëzuesin e kemi identifikuar më parë si e vetmja njësi foljore në fjali si dhe me anë të pyetjes analitike ‘çfarë ndodh?’) rreth funksioneve të pjesëve të tjera të fjalisë. P.sh. pyetjet ‘kush?’ ose ‘çfarë?’ shërbejnë për të identifikuar kryefjalën; ‘kë?’ ose ‘çfarë?’ për të identifikuar kundrinën e rasës kallëzore, pyetja ‘kujt?’ për të identifikuar kundrinën e rasë dhanore, ‘i kujt?’ për të identifikuar kundrinën e rasës gjinore, ‘rreth çfarë?, për çfarë?, me cilin?’, etj për të identifikuar kundrinën me parafjalë dhe ‘kur?, ku?, kur?, si?, përse?’, etj për të identifikuar rrethorët.:

Die Lehrerin gibt dem Jungen das Buch./ Mësuesja i jep librin djalit.

Wer gibt dem Jungen das Buch?/ Kush i jep librin djalit? ('die Lehrerin'/ mësuesja = kryefjala)

Wem gibt die Lehrerin das Buch?/ Kujt i jep librin mësuesja? ('dem Jungen'/ djalit = kundrina e rasës dhanore)

Was gibt die Lehrerin dem Jungen?/ Çfarë i jep mësuesja djalit? ('das Buch'/ librin = kundrina e rasës kallëzore)

Kjo metodë gjen përdorim të gjerë në tekstet shkollore ose ato të mësimit të gjuhës së huaj. Kjo metodë kërkon gjithashtu të kuptuarit intuitiv paraprak të fjalisë, i cili përfshihet në formulimin e pyetjeve. Disa nga pyetjet orientohen tek raportet morfologjike, në këtë rast të rasës. Këtë e tregon dhe formulimi abstrakt i pyetjeve: 'kush?' ose 'çfarë?', 'kë?' ose 'çfarë?'. Në një fjali konkrete duhet zgjedhur përkatësisht njëra prej tyre.

b) për të bërë të mundur analizimin e fjalisë dhe klasifikimin e gjymtyrëve të tjera, më saktë gjymtyrëve jo foljore të saj, në gjuhësinë gjermane u krijua metoda operacionale nga Hans Glinc, e cila konsiston në prova të ndryshme: prova e tingullit, e zhvendosjes, e zëvendësimit, e transformimit dhe e eliminimit. Kjo mënyrë gjen ende dhe sot përdorim, veçanërisht në gramatikën tradicionale.

Helbig shprehet se sipas Glincit :*"Die Satzglieder ergeben sich nach formalen Kriterien der syntaktischen Oberflächenstruktur- aus der Verschiebeprobe; sie sind Stellungsglieder", d.h. "gegenseitig verschiebbare Elemente des Satzes", die auch allein vor dem finiten Verb im deutschen Hauptsatz (Aussagesatz) auftreten können, sind permutable Komplexe im Satz./*Gjymtyrët e fjalisë dallohen sipas kritereve formale të strukturës sipërfaqësore me anë të provës së zhvendosjes janë gjymtyrë pozicioni, dmth elemente të zhvendosshme të fjalisë, të cilat mund të qëndrojnë dhe vetëm përpara foljes së zgjedhurar në fjalinë kryesore në gjuhën gjermane (fjali dëftore), janë njësi të këmbyeshme në fjali."¹⁶⁴

Me anë të këtij koncepti të klasifikimit të gjymtyrëve bëhet i mundur dhe dallimi i këtyre të fundit nga pjesët e tjera të fjalisë të cilat nuk janë gjymtyrë më vete, si p.sh. përcaktori.

Der Zug fährt um 7 Uhr nach Bonn./ Treni niset në orën 7 për në Bon.

Um 7 Uhr fährt der Zug nach Bonn./ Në orën 7 niset treni për në Bon.

Nach Bonn fährt der Zug um 7 Uhr./ Për në Bon niset treni në orën 7.

Në tri fjalitë më lart, gjymtyrët që qëndrojnë para foljes së zgjedhurar vërtetohen të jenë gjymtyrë të fjalisë.

¹⁶⁴Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 107

Në gjurmët e Glinc ecën dhe Duden: “*Satzglieder sind die jenigen Wörter oder kleinsten in sich zusammengehörigen Wortgruppen, die sich nur geschlossen verschieben und insgesamt ersetzen lassen.*”/ Gjymtyrët e fjalisë janë ato fjalë, ose grupe të vogla fjalësh, të cilat zhvendosen ose zëvendësohen së bashku në mënyrë të mbyllur.¹⁶⁵:

Der Student schreibt die Klausur am 1. Februar./ Studenti do japë provimin në 1 shkurt.

Me anë të provës së zhvendosjes kemi:

Am 1. Februar schreibt der Student die Klausur./ Në 1 shkurt do japë studentin provimin.

Die Klausur schreibt der Student am 1. Februar./ Provimin do japë studentin në 1 shkurt.

Për të vërtetuar zhvendosjen e gjymtyrëve së bashku në mënyrë të mbyllur mund të bëjmë provën e zëvendësimit:

Er schreibt sie morgen./ Ai do e japë atë nesër.

Me anë të dy provave të mësipërme vërtetohet se ‘ai’, ‘provimin’ dhe ‘në 1 shkurt’ janë gjymtyrë fjalie

1.2. Vështirësi në përcaktimin e kundrinës

Kundrinat dhe rrethorët në gjuhën gjermane zakonisht shprehen me të njëjtën kategori gramatikore, dmth. parafjalë + emër, emër në rasën kallëzore, emër në rasën dhanore ose emër në rasën gjinore.

Si pasojë në disa raste mund të hasen vështirësi në kuptimin dhe interpretimin e fakteve konkrete gjuhësore, duke qenë se caqet mes këtyre kategorive të gjymtyrëve të fjalisë nuk janë gjithmonë qartësisht të dallueshme, duke çuar kështu në shfaqjen e rasteve të ndërmjetme apo sinkretike, ose në ato të asimetrisë mes përmbajtjes dhe formës. Ka kështu fakte gjuhësore që qëndrojnë mes kundrinave dhe rrethorëve si dhe mes kundrinave dhe gjymtyrëve të tjera të dorës së dytë, siç janë dhanoret e lira apo kallëzuesori kundrinor (Objektsprädikativ). Takimet si dhe gërshetimet kuptimore krijojnë nganjëherë vështirësi nga më të ndryshmet për të përcaktuar saktë gjymtyrën. Në të tilla raste përcaktimi i saj duhet bërë duke diktuar vlerat kuptimore e veçoritë gramatikore zotëruese.

Nga sa u tha më lart, në mënyrë që të kemi një përcaktim dhe klasifikim sa më të saktë të gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën gjermane, duhet të bazohemi si tek përmbajtja ashtu dhe tek forma, pra duhet të mbështetemi edhe në raportet kuptimore, dhe në veçoritë gramatikore. Duhet të vështrohet kështu, funksioni sintaksor e raportet kuptimore të gjymtyrës, shprehja e saj morfologjike dhe format e lidhjes gramatikore me gjymtyrën e plotësuar prej saj. Duhet të merren parasysh në raste të caktuara dhe shprehja morfologjike si dhe kuptimi leksikor i gjymtyrës së plotësuar, e po ashtu dhe i vetë gjymtyrës së dytë të dhënë. Në gjuhën gjermane vërejmë gjithashtu se në disa tradita

¹⁶⁵Duden. Die Grammatik. 4., völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich: Dudenverlag (Duden 4), 1995, f. 569

gramatikore ngushtohet rrethi i kundrinave, në të tjera, zgjerohet shumë. Për pasojë ka një numër gjymtyrësh që janë klasifikuar e klasifikohen edhe sot në mënyra të ndryshme nga gjuhëtarë të ndryshëm.

Në vijim, me anë të shembujve konkretë do përpiqem të qartësoj dallimin e kundrinave nga gjymtyrë të tjera, në dukje të përafërta:

1.2.1. Kundrinë apo rrethanor?

Rasti sinkretik më i përhapur është ai mes kundrinës dhe rrethanorit. Dallimet mes tyre janë të shprehura qartë në pjesën më të madhe të teksteve gramatikore, duke qenë se shpeshherë përbën objekt ngatërrimi. Kjo ndodh dhe për faktin se rrethanori ashtu si dhe kundrina shprehet ndër të tjera dhe me:

-emër në rasën kallëzore: Sie arbeitet **den ganzen Tag**./ Ajo punon gjithë ditën.

-emër në rasën gjinore: **Eines Abends** hat sie uns besucht./ Një natë ajo na vizitoi.

-emër + parafjalë: Sie geht **in die Stadt**./ Ajo shkon në qytet.

-Në rastin e kundrinës me parafjalë dhe rrethanorit të shoqëruar me parafjalë, që përbëjnë rastin sinkretik më të përhapur, dallimi mes tyre mund të bëhet semantikisht. Kundrina me parafjalë shpreh frymorë ose sende, ndërsa rrethanori shpreh vend dhe hapësirë, kohë dhe kohëzgjatje, si dhe mënyrë.:

Wir kommen **aus der Schule**./ Ne vijmë nga shkolla. (rrethanor)

Bei Regenwetter fahren wir mit dem Auto./ Në kohë me shi do udhëtojmë me makinë. (rrethanor)

Eines Tages hat er und besucht./ Një ditë na vizitoi. (rrethanor)

Die Autobahn wurde **durch einen Unfall** blockiert./ Autostrada u bllokua nga një aksident. (rrethanor)

Sie gibt **dem Jungen das Buch**./ Ajo i dha librin djalit. (kundrinë në rasën dhanore)

Ich gedenke **ihrer**./ Unë kujtoj atë. (kundrinë në rasën gjinore)

-Një mënyrë tjetër për të dalluar kundrinat me parafjalë nga rrethanorët e shoqëruar me parafjalë, është dhe ajo me anë të pyetjes analitike. Por sipas Bynting/ Bergenholc: *“Bei den analytischen Fragen gibt es Abgrenzungsschwierigkeiten zu den Objekten, besonders zu den präpositionalen. Das hängt damit zusammen, das es eine ganze Reihe von Verben mit Präpositionen gibt, die nominale Satzglieder fordern, z. B. bitten um, warten auf, sich erinnern an. Wenn diese nominalen Satzglieder Personen bezeichnen, kann eindeutig die Frage Präposition + wem oder wen gestellt werden; man hat dann eindeutig ein Präpositionales Objekt. Wenn es sich jedoch um nicht- personale Größen handelt, kann man entweder Präposition + was fragen oder aber ein Fragewort vom Typ woran oder worüber.”*/ Në rastin e pyetjes analitike ka vështirësi kufizimime

kundrinat, veçanërisht ato me parafjalë. Kjo ka lidhje me faktin se egzistojnë një sërë foljesh me parafjalë, të cilat kërkojnë gjymtyrë emërore, p.sh. lutem për diçka, pres dikë ose diçka, kujtoj dikë ose diçka. Kur këto gjymtyrë emërore përcaktojnë frymorë mund të bëhet pyetja me parafjalë + kë ose kujt; atëherë kemi të bëjmë padyshim më një kundrinë. Në rastin kur nuk bëhet fjalë për frymorë, mund të bëjmë pyetjen me parafjalë + çfarë ose pyetje të llojit ‘rreth çfarë’.”¹⁶⁶:

Der Torwart achtet **auf den gegnerischen Stürmer**. – auf wen? (Objekt)/ Portieri ka kujdes sulmuesin kundërshtar. – Kë? (kundrinë)

Der Stürmer achtet **auf den Ball**. – auf was? (Adverbialbestimmung)/ Portieri ka kujdes topin. – çfarë? (rrethanor)

Der Torwart spricht **mit dem Schiedsrichter**. – mit wem? (Objekt)/ Portieri flet me gjykatësin. – me kë? (kundrinë)

Der Torwart spricht **mit Händen und Füßen**. – womit? (Adverbialbestimmung)/ Portieri flet me këmbë e duar. (rrethanor)

-Kundrinat në gjuhën gjermane si rregull mund të zëvendësohen me emra të tjerë ose përemra, ndërsa rrethanorët mund të zëvendësohen me ndajfolje ose ndajfolje pronominale.:

Sie ißt **eine Birne**./ Ajo ha një dardhë. (kundrinë)

Sie ißt **sie**./ Ajo ha atë.

Sie ißt **den ganzen Tag**./ Ajo ha gjithë ditën. (rrethanor)

Sie ißt **heute/ täglich**./ Ajo ha sot/çdo ditë.

Sie wartet **auf den Jungen**./ Ajo pret djalin. (kundrinë)

Sie wartet **auf ihn**./ Ajo e pret atë.

Sie wartet **auf der Straße**./ Ajo pret në rrugë. (rrethanor)

Sie wartet **dort**./ Ajo pret atje.

Er berichtete **seinem Chef**./ Ai i raportoi shefit të tij. (kundrinë)

Er berichtete **ihm**./ Ai i raportoi atij.

Er berichtet **über seine Reise**./ Ai raportoi rreth udhëtimit. (rrethanor)

¹⁶⁶Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum Lesen einer Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenäum, Weinheim 1995, f. 81

Er berichtet **darüber**./ Ai raportoi rreth tij.

Die Mannschaften warteten **auf den Schiedsrichter**./ Skuadrat prisnin gjygtarin. (kundrinë)

Die Mannschaften warteten **auf ihn**./ Skuadrat prisnin atë.

Die Mannschaften warteten **auf den Anpfiff**./ Skuadrat prisnin fishkëllimën.

Die Mannschaften warteten **darauf**./ Skuadrat prisnin atë.

-Në rastin e kundrinës me parafjalë, parafjala sundohet nga folja, si pasojë pa një semantikë të dukshme. Kjo është dhe arsyeja pse në gjuhën gjermane tek kundrinat me parafjalë folja kërkon parafjalë të caktura, madje në shumicën e rasteve vetëm një parafjalë. Ndërsa tek rrethantorët e shoqëruar me parafjalë, kjo e fundit nuk sundohet nga folja, por përcakton semantikisht raportin me emrin e sunduar prej saj.:

Sie wartet **auf** den Vater. (kundrinë)/ Ajo pret të atin.

Sie wartet (**auf/ vor/ neben/ hinter**) dem Bahnhof. (rrethantor)/ Ajo pret (në/ para/ pranë/ mbrapa) stacionit të trenit.

Kundrinat me parafjalë, në bazë të rasës që kërkon parafjala, mund të jenë të rasës kallëzore ose dhanore. Kundrinë me parafjalë në rasën gjinore nuk ekziston në gjuhën gjermane.:

Sie klagen **auf Schadenersatz**./ Ata ngritën padi për dëmshpërblim. (kundrinë me parafjalë në rasën kallëzore.)

Er pochte **auf sein Recht**./ Ai kërkonte të drejtën e tij.(kundrinë me parafjalë në rasën kallëzore.)

Sie steht **zu ihrem Wort**./ Ajo e mban fjalën e saj. (kundrinë me parafjalë në rasën dhanore)

Sie begnügen sich **mit einem matten Protest**./ Ata u mjaftuan me një protestë të vakët. (kundrinë me parafjalë në rasën dhanore)

Ndërsa Duden shprehet në lidhje me rrethantorët e shoqëruar me parafjalë (Adverbiale Präpositionalgefüge) se: “*Auch bei den ‘adverbiale Präpositionalverbgefüge’ kann man nach dem Kasus, der durch die gliedinterne Präposition gefordert ist, unterscheiden.*:/ Dhe në rastin e rrethantorëve të shoqëruar me parafjalë, dallojmë rasta të ndryshme të kërkuara nga parafjala e gjymtyrës.”¹⁶⁷

¹⁶⁷Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 579

Rrethanor i shoqëruar me parafjalë në rasën kallëzore:

Sie kam nur **für kurze Zeit.**/ Ajo erdhi vetëm për kohë të shkurtër.

Rrethanor i shoqëruar me parafjalë në rasën dhanore:

Seit dem Essen sind vier Stunden Vergangenheit./ Që nga e ngrëna kanë kaluar katër orë.

Rrethanor i shoqëruar me parafjalë në rasën gjinore:

Das Spiel fiel **wegen des schlechten Wetters** aus./ Loja u anulua nga koha e keqe

Së fundi mund të thuhet se çështja e dallimit mes kundrinës dhe rrethanorit mbetet një objekt i shumëdebatuar dhe i cekur në pothuaj të gjitha gramatikat, panvarësisht cilës teori i përkasin ato. Sipas Welke: *“Zentral für alle Theorien ist die Differenz von Objekt und Adverbialbestimmung, von Komplement und Adjunkt, von Ergänzung und Angabe, von Argument und Modifikator. Die Unterscheidung von Objekt (Ich denke andich) und Adverbialbestimmung (Ich hänge das Bild an die Wand) ist problematisch. Es ist der Theorie nie gelungen, sie einwandfrei zu bestimmen und auseinanderzuhalten.“* / Themelore për të gjitha teoritë është dallimi mes kundrinës dhe rrethanorit, i komplementit dhe adjunktit, i plotësit nga rrethanori, i argumentit nga modifikatori. Dallimi i kundrinës (Unë mendoj për ty) nga rrethanori (Unë var pikturën në mur) është problematik. Teoritë gramatikore nuk kanë mundur deri më sot ti përcaktojnë qartësisht dhe ti ndajnë nga njëra tjetra.”¹⁶⁸

1.2.2. Kundrinë e rasës kallëzore apo kallëzuesor kundrinor (Objektsakkusativ/ Gleichsetzungsakkusativ/ Prädikatsakkusativ)?

Ashtu si kundrina e rasës kallëzore, kallëzuesori kundrinor (Gleichsetzungsakkusativ ose Gleichsetzungsakkusativ)¹⁶⁹ mund të shprehet me emër në rasën kallëzore që është i lidhur ngushtësisht me kundrinën e rasës kallëzore. Ndryshe nga kundrina, ky i fundit përgjithësisht nuk merret si gjymtyrë e fjalisë, por zakonisht si pjesë e kallëzuesit. Zakonisht ai shoqërohet në fjali me një emër tjetër në rasën kallëzore që është kundrinë.

Sipas Duden¹⁷⁰, e gjejmë kryesisht pas foljeve: nennen, heißen (transitiv), schelten, schimpfen, schmähen/ emërtoj, quaj (kur përdoret si folje kalimtare), qortoj, paralajmëroj.:

Sie nennt ihn **einen Lügner.** (kallëzuesor kundrinor) / Ajo e quan gënjeshtar.

Sie nannte ihn **einen Schlauberger.** (kallëzuesor kundrinor)/ Ajo e quante atë shumë të zgjuar.

¹⁶⁸Welke, Klaus, *Einführung in die Satzanalyse. Die Bestimmung der Satzglieder im Deutschen.*, de Gruyter Berlin / New York 2007, f. 23

¹⁶⁹Në disa gramatika ndeshet me emërtimin e parë, në disa të tjera me të dytin

¹⁷⁰Duden. *Die Grammatik.* 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 579- 580

1.2.3. Kundrinë e rasës kallëzore apo kallëzore ndajfoljore (Adverbialakkusativ)?

Ndër gjymtyrët e rasës kallëzore të fjalisë në gjuhën gjermane ka dhe të tilla që nuk janë kundrina. Sipas Duden¹⁷¹ ato nuk janë kundrina pasi nuk përmbushin kriterin e zëvendësimit me përemër.:

Er hat **den ganzen Haushalt den ganzen Sommer** allein besorgt./ Ai është kujdesur vetë për gjithë shtëpinë gjatë gjithë verës.

Kjo fjali përmban dy gjymtyrë në rasën kallëzore: ‘den ganzen Haushalt’/ gjithë shtëpinë dhe ‘den ganzen Sommer’/ gjithë verën. Vërehet se gjatë provës së zëvendësimit me përemër, ato reagojnë në mënyra të ndryshme.:

Mund të themi: Er hat **ihn** den ganzen Sommer allein besorgt./ Ai është kujdesur për të gjatë gjithë verës.

Por nuk mund të themi: Er hat den ganzen Haushalt **ihn** allein besorgt./ Ai është kujdesur për gjithë shtëpinë atë vetëm.

Sipas Duden¹⁷² gjithashtu dhe me anë të provës së kthimit të fjalisë në pësore dallohet qartë ndryshimi mes tyre.:

Mund të themi: Der ganze Haushalt wurde von ihm den ganzen Sommer allein besorgt./ E gjithë shtëpia u kujdes prej tij.

Por nuk mund të themi: Der ganze Sommer wurde von ihm den ganzen Haushalt allein besorgt./ E gjithë vera u kujdes prej tij të gjithë shtëpinë.

1.2.4. Kundrinë e rasës kallëzore apo kallëzore absolute (absoluter Akkusativ)?

Kallëzorja e lirë ose absolute është një gjymtyrë e cila në ndryshim nga kundrina e rasës kallëzore nuk varet nga kallëzuesi.:

Neben ihr saß der dünnhaarige Pianist, **den Kopf** im Nacken, und lauschte.../Pranë saj ishte ulur pianisti me flokë të hollë, me kokën e anuar, dhe pëshpëriste...(kallëzore absolute)

Daniel schläft **den ganzen Tag**./ Danieli fle gjithë ditën. (kallëzore absolute)

Daniel unterstützt **seine Schwester**./ Danieli mbeshtet motrën e tij.(kundrinë e rasës kallëzore)

Kallëzorja absolute zakonisht shpreh një shtrirje në kohë dhe më rrallë në hapësirë: den ganzen Monat/ gjithë muajin, jeden Donnerstag/ çdo të enjte, den lieben langen Tag/ gjatë gjithë ditës.¹⁷³

¹⁷¹ Po aty, f. 579

¹⁷² Po aty, f. 581

¹⁷³ Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 164

Die Straße führt erst **einen Kilometer** geradeaus, dann geht es einige hundert Meter in Serpentina weiter.../ Rruga është e drejtë në kilometrin e parë, pastaj vazhdon disa qindra metra rrëzë shpatit...

Shtrirja në kohë mund të jetë dhe e shkurtër:

Ich bin selbst erst **diesen Augenblick** heimgekommen./ Unë sapo erdha në këtë moment.

1.2.5. Kundrinë e rasës gjinore apo gjinore ndajfoljore (Adverbialgenitiv)?

Sipas Duden¹⁷⁴, gjinorja ndajfoljore është një gjymtyrë në rasën gjinore. Dallimi mes saj dhe kundrinës së rasës gjinore është se ajo nuk mund të zëvendësohet me përemër. Gjithashtu rasa e saj nuk përcaktohet nga një gjymtyrë tjetër e fjalisë. Bëhet fjalë më shumë për një gjinore të pavarur. Gjithashtu në ndryshim nga kundrina e rasës gjinore, gjinorja ndajfoljore mund të zëvendësohet nga gjymtyrë që nuk janë të përcaktuara nga rasa.:

Eines Abends begegnete sie mir zum ersten mal./ Një natë ajo më takoi për herë të parë. (gjinore ndajfoljore)

Dieser Tage traf ich sie wieder./ Këto ditë e takova atë prapë. (gjinore ndajfoljore)

Meines Erachtens lebt sie hier./ Sipas dijenisë sime ajo banon këtu. (gjinore ndajfoljore)

Sie gedachte **ihrer Großmutter**./ Ajo përkujtonte gjyshen e saj.(kundrinë e rasës gjinore)

1.2.6. Kundrinëe rasës dhanore apo dhanore e lirë (freierer Dativ)?

Duke qenë se në të dyja rastet, kemi të bëjmë me dy gjymtyrë të shprehura me emër në rasën dhanore dhe këto raste mund të përbëjnë objekt ngatërimi. Dallimi kryesor mes tyre është se kundrina e rasës dhanore është gjymtyrë kryesore e cila varet përgjithësisht nga folja dhe është e lidhur ngushtësisht me të, ndërsa dhanorja e lirë është gjymtyrë e cilësuar shpesh e dorës së dytë, e cila nuk është e lidhur ngushtësisht me foljen ose ndonjë gjymtyrë tjetër. Për këtë arsye ajo emërtohet si gjymtyrë ‘e lirë’.¹⁷⁵:

Christian schläft **seiner Mutter** zu viel./ Kristiani fle gjatë sipas nënës së tij. (dhanore e lirë).

Christian schenkt **seiner Schwester** einen Blumenstrauß./ Kristiani i dhuron një tufë më lule motrës së tij. (kundrinë e rasës dhanore/ kundrinë e zhdrejtë)

¹⁷⁴Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 580

¹⁷⁵Shih: Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langenscheidt Verlag Enzyklopädie, ribotim 200, f. 264 dhe Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 159

Christian hilft **seiner Schwester**./ Kristiani ndihmon motrën e tij. (kundrinë e rasës dhanore/ kundrinë e drejtë)

Bie në sy fakti se dhanoret e lira trajtohen në pothuaj të gjitha gramatikat e hulumtuara për këtë punim, panvarësisht se i përkasin teorive të ndryshme gramatikore. Por vërehet se ka një mosdakortësi në lidhje me statusin e tyre. Pjesa më e madhe gjuhëtarëve dhe gramatikave të shqyrtuar për këtë punim, i trajtojnë ato si gjymtyrë më vete të dorës së dytë. Psh. Dyrshajd i përcakton dhanoret e lira si gjymtyrë jokundrinore në rasën dhanore, të cilat përbëjnë një klasë më vete gjymtyrësh për të cilat nuk ka një përcaktim të caktuar funksioni.¹⁷⁶ Ndërsatë të tjerë si p.sh. Pittner/ Berman¹⁷⁷ dhe Helbig/ Buscha¹⁷⁸, janë të mendimit se dhanorja komodi, inkomodi dhe posesive mund të shihen si kundrina të rasës dhanore. Në këtë përfundim ata dalin pas një sërë provash operacionale të kryera me to. Por nga ana tjetër kundrina shihet si një gjymtyrë e kërkuar nga folja e cila lidhet ngushtësisht me të. Prandaj mund të thuhet se nuk ka gjithmonë kufij të përcaktuar qartë mes kundrinës së rasës dhanore dhe dhanores së lirë. Përgjithësisht dallohen pesë lloje dhanorësh të lira:

1)Dhanorja komodi (Dativus comodi) dhe dhanorja inkomodi (Dativus incommodi), terma të huazuara nga latinishtja, të cilët përkthehen 'dhanore e avantazhit' dhe 'dhanore e disavantazhit'. Dhanorja komodi mund të ndeshet dhe me termin dhanorja e simpatisë (dativus sympathicus). "*Bezeichnet eine Person zu deren Gunsten/ ungunsten etwas geschieht.*" / Përcakton një person, në dobi/ dëm të së cilit ndodh diçka."¹⁷⁹

Ana trägt **ihrer Mutter** das Gepäck./ Ana i mban bagazhet nënës së saj.(dhanore komodi)

Das Gepäck ist **ihr** umgekippt./ Bagazhet iu rrëzuan asaj. (dhanore inkomodi)

Ndërsa Henshel/ Veid e përkufizojnë si gjymtyrë e cila "*gibt unabhängig von der Rektion des Verbs die Person an, zu deren Nutzen oder Schaden sich die Handlung vollzieht.*" / përcakton pavarësisht reksionit të foljes personin në dobi ose dëm, të së cilit kryhet veprimi."¹⁸⁰ Këtë ata e argumentojnë duke marrë si shembull foljet: kochen/ gatuaj dhe waschen/ laj, të cilat janë folje që kërkojnë vetëm rasën kallëzore:

Sie hat Pasta gekocht./ Ajo gatoi makarona.

¹⁷⁶Dürscheid, Christa: *Syntax. Grundlagen und Theorien*. 4., überarbeitete und ergänzte Auflage. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht (=Studienbücher zur Linguistik, Band 3) 2007, f. 42

¹⁷⁷Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 57

¹⁷⁸Shih: Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München:Langescheidt Verlag Enzyklopädie, ribotim 200, f. 264

¹⁷⁹Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 55

¹⁸⁰Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 159

Er hat das Fahrrad gewaschen./ Ai lau biçikletën.

Panvarësisht këtij reksioni të foljes, këto fjali mund të zgjerohen me një dhanore të lirë, e cila, si do shihet në fjalitë në vijim, përcakton personin, në dobi të së cilit kryhet veprimi:

Er hat **Laura** das Fahrrad gewaschen./ Ai i lau asaj biçikletwn.(dhanore komodi)

Sie hat **ihm** Pasta gekocht./ Ajo i gatoi atij makarona. (dhanore komodi)

Në të kundërt në rastet e mëposhtme dhanorja inkomodi tregon personin në dëm të së cilit ndodh diçka:

Er hat **Laura** das Fahrrad zu Schrott gefahren./ Ai ia prishi biçikletën asaj. (dhanore inkomodi)

Die Pasta ist **ih**r zu Mus verkocht/ Makaronat iu zbutën shumë. (dhanore inkomodi)

Vihet re se dhanorja komodi/ inkomodi është një gjymtyrë fakultative, dmth dhe pa të fjalia do të kishte kuptim dhe do të ishte e saktë në aspektin gramatikor. Megjithatë semantikisht ajo i jep një nuancë tjetër kuptimit të fjalisë. Gjithashtu dhe një pjesë e kundrinave të rasës dhanore janë fakultative. Ashtu si kundrina e rasës dhanore, dhanorja e lirë shpreh personin mbi të cilin bie veprimi.:

Ana trägt **Nikol** das Gepäck./ Ana i mban bagazhet Nikolës.

Ana trägt das Gepäck./ Ana mban bagazhet.

Er hat **Laura** das Fahrrad zu Schrott gefahren./ Ai ia prishi biçikletën Laurës.

Er hat das Fahrrad zu Schrott gefahren./ Ai e prishi biçikletën.

Dhanorja komodi/ inkomodi nuk mund të qëndrojë në fjali së bashku me një kundrinë të rasës dhanore, pasi ato kanë funksione të njëjta sintaksore në fjali, dmth dhanorja komodi/ inkomodi luan rolin e kundrinës së rasës dhanore në fjali.

Nuk ka kuptim: Ana trägt **Nikol ihrer Schwester** das Gepäck./ Ana i mban bagazhet Nikolës motrës së saj.

Nuk ka kuptim: Er hat **Laura ihrer Mutter** das Fahrrad zu Schrott gefahren./ Ai i prishi asaj nënës së saj biçikletën.

Dhanorja komodi/inkomodi bëhet kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore. Kjo ështëgjithashtu një karakteristikë e kundrinave.:

Nikol bekommt das Gepäck getragen./ Nikolës i mbajnë bagazhet.

Laura wird das Fahrrad zu Schrott gefahren./ Laurës i priset biçikleta.

Ashtu si në rastin e kundrinës së rasës dhanore, dhe dhanoret komodi/ inkomodi mund ti identifikojmë me anë të pyetjes analitike me përemrin pyetës ‘wem?/ kujt?’, çka na bën të mendojmë se mund të kemi të bëjmë me një kundrinë të rasës dhanore.:

Wem trägt sie das Gepäck?/ Kujt ia mban ajo bagazhet?

Wem hat er das Fahrrad zu Schrott gefahren?/ Kujt ia prishi ai biçikletën?

Njëlloj si kundrina e rasës dhanore, dhanorja komodi/ inkomodi mund të zëvendësohet me përemër. Dhe kjo është një karakteristikë tjetër e kundrinave.

Sie hat **ihr** das Gepäck getragen./ Ajo i mbajti asaj bagazhet.

Er hat **ihr** das Fahrrad zu Schrott gefahren./ Ai i prishi asaj biçikletën.

Dhanoret komodi/ inkomodi mund të vendosen në fillim të fjalisë, karakteristikë kjo e gjymtyrëve të fjalisë dmth kundrinave.:

Ihr hat sie das Gepäck getragen./ Asaj ia mbajti ajo bagazhet.

Ihr hat er das Fahrrad zu Schrott gefahren./ Asaj ia prishi ai biçikletën.

Nisur nga rezultati i këtyre provave operacionale, vërehet se dhanoret komodi dhe inkomodi mund të shihet si kundrinë e rasës dhanore.

2)Dhanorja posesive (Dativus possessivus), term i huazuar nga latinishtja ‘possidere’ do të thotë posedoj, ndryshe quhet dhe dhanorja pertinente (Pertinenzdativ) nga latinishtja lat. ‘pertinere’ i përket. Dhanorja posesive zëvendëson përemrin pronor ose gjinoren posesive. Në rastin e pjesëve të trupit, në disa ndërtime të caktuara të gjuhës gjermane, dhanorja posesive, është e detyrueshme.”¹⁸¹:

Sie wäscht sich die Füße. (ihre Füße)/ Ajo lan këmbët. (këmbët e saj)

Er klopfte **ihr** freundschaftlich auf die Schulter. (meine Schulter)/ Ai i rrahu asaj miqësisht shpatullat. (shpatullat e saj)

Sie küsst **der Königin** die Hand. (ihre Hand)/ Ajo i puthi mbretëreshës dorën. (dorën e saj)

Sie möchte **ihm** nicht mehr in die Augen sehen (in seine Augen)/ Ajo nuk dëshiron ta shohë më në sy atë. (në sytë e tij)

Die Kollegen schüttelten **der Preisträgerin** die Hand. (die Hand der Preisträgerin)/ Kolegët i dhanë dorën fitueses. (dorën e fitueses)

¹⁸¹ Po aty, f. 161

Gjithashtu dhanorja posesive gjen përdorim dhe në rastin e sendeve ose rrobave vetjake.

Die Mutter putzt **ihrer Tochter** die Schuhe./ Nëna i pastron këpucët vajzës së saj.

Eva nimmt **ihrer Freund** die Hausschlüssel weg./ Eva i mori çelësat e shtëpisë shokut të saj.

Dhanorja posesive ka të njëjtat karakteristika si dhanorja komodi/inkomodi.:

a)ajo mund të vendoset në fillim të fjalisë:

Die Mutter wäscht **dem Kind** die Hände./ Nëna i lan fëmijës duart.

Dem Kind wäscht die Mutter die Hände./Fëmijës i lan duart nëna.

b)është gjymtyrë fakultative, dmth dhe pa të fjalia do të kishte kuptim dhe do të ishte e saktë në aspektin gramatikor. Megjithatë semantikisht ajo i jep një nuancë tjetër kuptimit të fjalisë. Përshkruan një raport pronësie.:

Die Mutter wäscht die Hände./ Nëna lan duart.

c)mund të gjedet me anë të pyetjes analitike:

Wem wäscht die Mutter die Hände?/ Kujt i lan nëna duart?

d)mund të bëhet kryefjalë e fjalisë në rastin e transformimit të fjalisë në pësore (Rezipientenpassiv):

Das Kind bekommt die Hände gewaschen./ Fëmijës i lahen duart.

e)gjithashtu ajo mund të zëvendësohet me një përemër vetor:

Die Mutter wäscht **ihm** die Hände./ Nëna i lan atij duart.

Nisur nga rezultati pozitiv i këtyre provave operacionale, shohim se dhanorja posesive, ashtu si dhanoret komodi dhe inkomodi mund të shihet si kundrinë e rasës dhanore.

Të njëjtin mendim ndajnë dhe Pittner/ Berman¹⁸² dhe Helbig/ Buscha¹⁸³. Gjithashtu sipas Eisenberg¹⁸⁴, dhanorja posesive shihet më shpesh në aspektin sintaksor si kundrinë në krahasim me dhanoren komodi/ inkomodi.

3)Dhanorja judikantis (dativus Iudicantis), term i huazuar nga latinishtja ‘iudicia’, që do të thotë gjykim. Kjo dhanore e lirë përcakton person që jep një gjykim mbi veprimin. Semantikisht ajo shpreh të njëjtin kuptim si shprehjet: ‘meines Erachtens’/ ‘sipas meje’ ose ‘meiner meinung nach’/ ‘për mendimin tim’. Gjithashtu ajo mund të zëvendësohet

¹⁸²Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 57

¹⁸³Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München:Langescheidt Verlag Enzyklopädie, ribotim 2007, f. 264

¹⁸⁴Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik*. Bd. 2: Der Satz. 3., durchges. Aufl. – Stuttgart, Weimar: Metzler, 2006b, f. 299

dhe me shprehjet parafjalore: ‘für meinen Geschmack’/ ‘për shijen time’, ose ‘wenn du mich fragst’/ nëse më pyet mua.:

Der Junge trinkt **ihr** zu viel Bier./Sipas sajdjali pi shumë birra.

Du schläfst **mir** zu viel./ Sipas meje ti fle gjatë.

Du gibst **mir** zu viel Geld aus!/ Sipas meje ti shpenzon shumë para.

Ashtu si dhanoret e tjera të lira, dhe dhanorja judikantis është gjymtyrë fakultative.:

Der Junge trinkt zu viel Bier./ Djali pi shumë birra.

Du schläfst zu viel./ Ti fle gjatë.

Du gibst zu viel Geld aus!/ Ti shpenzon shumë para.

Dhanorja judikantis nuk mund të kthehet në kryefjalë gjatë transformimit të fjalisë në pësore:

Nuk mund të themi: Ihr bekommt dem Jungen zu viel Bier getrunken./ Asaj djalit i pihet shumë birra.

Ajo mund të vendoset në fillim të fjalisë, si dhanoret e lira të tjera që u trajtuan më sipër.:

Ihr trinkt der Junge zu viel Bier./ Sipas saj djali pi shumë birra.

Mund të përdoret pyetja analitike për ta identifikuar:

Wem trinkt der Junge zu viel?=ihr./ Sipas kujt pi shumë djali?= asaj.

Mund të zëvendësohet me një përemër ose emër:

Der Junge trinkt **ihr/ der Mutter** zu viel Bier./ Djali pi sipas saj/ nënës shumë birra.

Mund të shfaqet së bashku me një kundrinë tjetër të rasës dhanore:

Der Junge hilft **mir der Mutter** zu wenig./ Sipas meje djali e ndihmon shumë pak nënën.

Sipas provave të mësipërme del se ashtu si dhanoret e tjera të lira që u trajtuan më sipër, dhanorja judikantis është gjymtyrë fakultative, mund të gjendet me anë të pyetjes analitike, mund të vendoset në fillim të fjalisë, mund të zëvendësohet me një përemër.

Ndryshimi është se dhanorja judikantis nuk mund të kthehet në kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore dhe se ajo mund të shfaqet së bashku me një kundrinë të rasës dhanore në fjali.

Pitner/ Berman¹⁸⁵ theksojnë gjithashtu se dhanorja judikantis shfaqet në fjali vetëm në prani të mbiemrit ose frazës ndajfoljore me ‘zu’/ shumë dhe ‘genug’/ mjaft.:

Er trinkt **ihr** zu schnell/ zu oft/ Sipas meje ai pi shumë shpejt/ shumë shpesh.

Nuk mund të themi: Er trinkt ihr./ Sipas saj ai pi.

Er trinkt schnell/ oft./ Ai pi shpejt/ shpesh.

Nuk mund të themi: Er trinkt mir schnell/oft./ Sipas meje ai pi shpejt/ shpesh.

Nga sa u tha më lart mund të dilet në përfundimin se dhanorja e lirë judikantis nuk mund të jetë kundrinë e rasës dhanore.

4)Dhanorja etike (dativus ethicus), term ky i cili e ka gjithashtu prejardhjen nga latinishtja ‘ethicus’ që do të thotë etik. Kjo dhanore e lirë, e cila përcakton personin mbi të cilin bie gjykimi ose parashikimi i veprimit të kryer. Atë e ndeshim shumë rrallë dhe kryesisht në fjali urdhërore ose dëshirore.

Du bist **mir** einer!/ Ç’më je një ti!

Dass du **mir** bloß nicht zu spät kommst./ Se mos më vjen me vonesë.

Dass du **mir** nicht viel Alkohol trinkst!/ Mos më pi mua shumë verë!

Du bist **uns** gerade der Rechte!/ Ti je për ne tamam personi i duhur!

Dass du **mir** dem Kellner nur nicht zu viel Trinkgeld gibst!/ Se mos mi jep shumë bakshish kamarierit.

Sipas Henshel/ Veid¹⁸⁶, ajo mund të zëvendësohet edhe me shprehjet ‘nach meinem Urteil’/ ‘sipas gjykimit tim’ ose ‘wenn es auf mich ankommt’/ ‘të jetë për mua’.::

Komm **mir** nicht zu spät!/ Mos më hajde vonë mua!

Nach meinem Urteil, darfst du auf keinen Fall zu spät ankommen./ Në gjykimin tim nuk duhet të vish vonë.

Wenn es auf mich ankommt darfst, du auf keinen Fall zu spät ankommen./ Të ishte për mua mos hajde vonë.

Dhanorja etike mund të shprehet dhe e shoqëruar nga një pjesëz modale, ose të shërbejë thjesht si një përforcues i një pjesëze modale. Në këto raste zakonisht fjalia ka nuanca ironike.:

¹⁸⁵Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 58

¹⁸⁶Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 162

Ihr seid **mir ja** gute Renner!/
Ju po që më jeni garues të zotë!
Komm **mir ja** nicht zu spat!/
Mos më hajde mua me vonesë!

Dhanorja etike dhe judikantis kanë mjaft të përbashkëta mes tyre, por dhe disa ndryshime. Ndryshe nga dhanorja judikantis, ajo etike nuk mund të vendoset në fillim të fjalisë, pasi fjalia nuk do të kishte kuptim:

Nuk mund të themi: Mir seid ihr ja gute Renner!/
Mua më jeni ju garues të mirë!
Nuk mund të themi: Mir komm nicht zu spat!/
Mua mos më hajde vonë!

Një tjetër ndryshim i dhanores judikante nga dhanorja etike është se kjo e fundit nuk mund të eliminohet nga fjalia. Nëse e bëjmë këtë, fjalia ose do të ndryshonte tërësisht kuptimin, psh. do eliminohej nuanca ironike, ose nuk do ishte më e saktë në aspektin gramatikor.:

Ihr seid gute Renner!/
Ju jeni garues të zotë!
Du bist einer!/
Ç'je një ti!

Gjithashtu në ndryshim nga dhanorja judikantis, ajo etike, mund të shprehet vetëm me anë të përemrit vetor kryesisht të vetës së parë njëjës ose shumës.¹⁸⁷:

Nuk do të kishte kuptim: Du bist **seiner Muttereiner**!/
Ti je një për nënën e tij!
Nuk do të kishte kuptim: Du bist **deiner Frau einer**!/
Ti je një për gruan e tij!

Ndërsa në rastin e dhanores judikantis është i mundur zëvendësimi me emra dhe përemra të ndryshëm:

Sie schläft **mir** zu viel./ Sipas meje ajo fle shumë.
Sie schläft **ihrem Mann** zu viel./ Sipas bashkëshortit të saj ajo fle shumë.
Ich trinke **ihr** zu viel Alkohol./ Sipas saj unë pi shumë alkool
Ich trinke **meinem Arzt** zu viel Alkohol./ Sipas mjekut tim unë pi shumë alkool.

Dhanorja etike ashtu si ajo judikantis nuk mund të gjendet me anë të pyetjes analitike 'kujt?':

Nuk mund të themi: Wem bist du einer?/
Kujt je një ti?

Ajo mund të shfaqet në fjali e shoqëruar nga një kundrinë e rasës dhanore.:

Hilf **mir ja dem Vater** beim Rauftragen./ Ma dihm babain për të ngjitur gjërat lart.

Ajo gjithashtu nuk mund të bëhet kryefjalë gjatë transformimit të fjalisë në pësore.

¹⁸⁷ Po aty

Nga sa u tha më sipër dhanorja etike ashtu si ajo judikantis, nuk mund të jenë kundrina të rasës dhanore. Kjo nënvizon dhe një herë faktin se thjesht aspekti morfosintaksor i rasës nuk mjafton për të përcaktuar funksionin e gjymtyrëve në fjali.

Më poshtë do paraqiten në formë tabelare përmbledhtazi përfundimet e provave operacionale sipas Pittner/ Berman¹⁸⁸:

Prova	Commodi / komodi	Incommodi / inkomodi	Possessivus / posesive	Iudicantis / Judikante	Ethicus / etike
Vorfeldtest/ Prova e vendosjes në fillim të fjalisë	+	+	+	+	-
Weglastest/ e eleminimit	+	+	+	+	+
Erfragbarkeit/ e pyetjes analitike	+	+	+	+	-
Kategoriale Realisierung/ e realizimit kategorial	-	-	-	-	+
Zusätzliches Dativobjekt/ e kundrinës së rasës dhanore shtesë	-	-	-	+	+
Subjekt beim Rezipientenpassiv / kryefjalë gjatë transformimit të fjalisë në pësore	+	+	+	-	-

2. Kundrina në gjuhën gjermane, vështrim i përgjithshëm

Nga sa u tha në kreun e parë të këtij punimi termi kundrinë u përdor deri në fillim të shekullit të XIX në kontekstin filozofik dhe teologjik, si një përzierje mes logjikës e

¹⁸⁸Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 57

semantikës. Përdorimi i tij në gramatikën e gjuhës gjermane i dedikohet Bekerit në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, i cili i vendosi termat kryefjalë, kallëzues e përcaktor dhe kundrinë në kontekstin sintaksor, i cili vlen dhe sot. Por Bekerit përfshiu tek kundrinat dhe rrethanorët, duke i quajtur ata kundrinë plotësuese.

Vlen të theksohet fakti se kundrina në gjuhën gjermane përcaktohet si gjymtyrë kryesore e fjalisë. Përkufizimet e mëvonshme të saj të bëra nga gjuhëtarë të ndryshëm, megjithëse në dukje të ndryshme në varësi të këndvështrimit e fokusit përkatës të secilit, kanë pika të përbashkëta. Nga sa duket, nisur nga koncepti antik për kundrinën si objekt, duke përfshirë dhe aspektin semantik të saj, Henshel/ Veid e përkufizojnë kundrinën si vijon: *“Das Objekt steht dem Subjekt in der Philosophie, wie auch in der Grammatik als Gegenstand des Wahrnehmens, Erkennens, Denkens und Handelns gegenüber. Das grammatische Objekt bindet das direkte oder indirekte Ziel des im Verb ausgedrückten Vorgangs. Bei flektierenden Sprachen steht es in einem obliquen Kasus, der entweder vom Verb direkt, oder unter Zuhilfenahme einer Präposition regiert wird; im letzteren Fall spricht man von einem Präpositional Objekt./ Kundrina i qëndron përballë kryefjalës në filozofi si dhe në gramatikë si objekt i perceptimit, njohjes, mendimit dhe veprimit. Kundrina gramatike lidh synimin direkt ose indirekt të veprimit të shprehur nga folja. Tek gjuhët me lakim qëndron në një rasë oblique, e cila drejtohet ose direkt nga folja, ose me ndihmën e një parafjale, në rastin e fundit kemi të bëjmë me kundrinë me parafjalë.”*¹⁸⁹

Një përkufizim disi të ndryshëm gjejmë tek Helbig: *“Das Objekt ist eine Substantiv – oder Präpositionalgruppe, die obligatorisch oder fakultativ steht und vom Prädikat abhängig ist, die morphologisch durch ein Substantiv (im Akkusativ, Dativ, genitiv oder durch Präposition + Substantiv) oder durch ein entsprechendes substantivisches Pronomen repräsentiert wird./ Kundrina është një emër ose togfjalësh parafjalor, i cili është i detyrueshëm ose fakultativ dhe varet nga folja, i cili në rrafshin morfologjik përfaqësohet nga një emër (në rasën kallëzore, gjinore, dhanore ose me anë të një parafjale + emër) ose me anë të një përemri vetor.”*¹⁹⁰

Një përkufizim të ngjashëm japin Sommerfeld/ Starke: *“Das Objekt ist ein Satzglied des Prädikatsverbandes, dessen obliquen Kasus (Akkusativ, Dativ, selten Genitiv) oder präpositionaler Anschluß vom Prädikatslexem durch reksion determiniert wird./ Kundrina është një gjymtyrë, pjesë e lidhjes së kallëzuesit (Prädikatsverband), rasa e së cilit (kallëzore, dhanore, rrallë gjinore) ose parafjala përcaktohet me anë të reksionit.”*¹⁹¹

¹⁸⁹Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 325

¹⁹⁰Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 112

¹⁹¹Sommerfeld, Karl- Ernst/ Starke, Günter: *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen 1998, f. 211

Ndërsa Kazadej e përkufizon atë në mënyrë të përgjithshme: “Objekt sind alle bei der Beschreibung eines Sachverhalts genannten Rollen, die nicht Subjekt sind./ Kundrinë janë të gjitha funksionet që përshkruajnë një situatë që nuk janë kryefjalë.”¹⁹²

Sipas Shulc/ Grizbah: “Objekt sind alle bei der Beschreibung eines Sachverhalts genannte Rollen, die nicht Subjekt sind. Die Anzahl der Objekte, entweder ein Objekt, oder zwei Objekte, wird von der Art und der Darstellungsweise eines Sachverhalts bestimmt. Welches Funktionskennzeichen das Objekt annimmt, hängt vom Geschehen ab und von dem Verb, das im Prädikat das Geschehen nennt./ Kundrina janë të gjitha rolet e përshkrimit të situatës që nuk janë kryefjalë. Numri i kundrinave, një, ose dy kundrina, përcaktohet nga ngjarja dhe nga folja që përcakton ngjarjen.”¹⁹³

Megjithë larminë e përkufizimeve, të gjithë gjuhëtarët bien dakort me faktin se në gjuhën gjermane dallohen katër lloje kundrinash: kundrina e rasës kallëzore, kundrina e rasës dhanore, kundrina e rasës gjinore dhe kundrina me parafjalë. Kundrinat në gjuhën gjermane shprehen zakonisht me një emër, togfjalësh ose përemër.

1.Kundrina e rasës kallëzore, e cila është kundrina që ndeshet më shpesh në gjuhën gjermane, shprehet zakonisht me një emër ose përemër në rasën kallëzore, togfjalësh, më rrallë me pjesë të emëruara të ligjëratës, korrelatin ‘es’, fjali të nënrenditur. Në ndryshim nga tre kundrinat e tjera ajo bëhet kryefjalë në rastin e transformimit të fjalisë në pësore. Gjithashtu në rastin e emëzimit të foljes së fjalisë kjo kundrinë bëhet përcaktor i rasës gjinore (Genitivattribut).

Sie rezensiert **das Buch (es)**./ Ajo redakton librin (atë).

Das Buch (Es) wird von ihr resensiert./ Libri (ai) redaktohet.

Das Rezensieren **des Buches (ihr Rezensiren/ ihre Rezension)**/ Redaktimi i librit (redaktimi i tij/ redaktimi i tij)

2.Kundrina e rasës dhanore shprehet zakonisht me një emër apo përemër në rasën dhanore ose togfjalësh. Ajo mbetet e pandryshuar gjatë kthimit të fjalisë në pësore. Ndërsa gjatë emëzimit të foljes ajo bëhet përcaktor (Präpositionalattribut).

Sie hilft **ihrem Vater (ihm)**./ Ajo ndihmon të atin e saj (atë).

Ihrem Vater (Ihm) wird geholfen./ Të atit të saj i ndihmohet (atij).

Die Hilfe **für ihren Vater (ihn)**./ Ndhma për të atin e saj (atë).

3.Kundrina e rasës gjinore e cila shprehet zakonisht me emër apo përemër në rasën gjinore ose togfjalësh ndeshet shumë rrallë në gjuhën e sotme gjermane. Ajo gjithashtu mbetet e pandryshuar gjatë kthimit të fjalisë në pësore. Ndërsa gjatë emëzimit të foljes

¹⁹²Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f. 47

¹⁹³Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f. 336

së fjalisë ajo bëhet përcaktor parafjalor, i cili mund të shndërrohet në një kundrinë me parafjalë:

Die Bevölkerung gedachte **der Opfer (ihrer)**. / Populli përkujtonte **viktimat (ato)**.

Der Opfer (Ihrer) wurde gedacht. / Viktimat u përkujtuan.

Das Gedenken **an die Opfer (an sie)** / Përkujtimi i viktimave (i tyre)

Er erinnerte sich **seines Freundes (seiner)**. / Ai kujtonte shokun e tij (atë).

Er erinnert sich **an seinen Freund (an ihn)**. / Ai kujtohej për shokun e tij (për të).

4. Kundrina me parafjalë shprehet zakonisht me një emër apo përemër, ose togfjalësh të shoqëruar me parafjalë. Ajo gjithashtu nuk ndryshon gjatë kthimit të fjalisë në pësore. Gjatë emëzimit të foljes së fjalisë ajo bëhet përcaktor parafjalor, i cili mund të shndërrohet në një kundrinë rase.:

Sie sorgt **für die Schwester (für sie)**. / Ajo shqetësohet për motrën.

Für die Schwester (für sie) wird (von ihr) gesorgt. / Për motrën shqetësohet ajo.

Ihre Sorge **für die Schwester (für sie)** / Shqetësimi i saj për motrën (për të)

2.1. Kuptimi dhe kategoritë morfologjike tek kundrina

Përsa i përket mjeteve morfologjike me anë të të cilave shprehet kundrina në gjuhën gjermane, nisur nga aspekti kuptimor dhe jo ai rasor sipas Schulc/ Grizbah¹⁹⁴ kemi klasifikimin në vijim:

1. Sipas tyre personat shprehen në kundrinë me anë të emrave, përemrave, si dhe mbiemrave dhe foljeve të emëruara.:

Peter dankt seinem Vater **für das Geschenk**. / Peteri falënderon babain për dhuratën.

Du machst **mir** Angst. / Ti më frikëson.

Kennst du **die Alte**? / E njeh plakën?

Helft **den Verletzten**. / Ndhmoni të plagosurin.

2. Sendet shprehen në kundrinë me anë të emrave, përemrave dhe grupeve sintaksore.

Der Regen hat **der Ernte** sehr geschadet. / Shiu ka dëmtuar shumë të mbjellat.

Ich habe **es** mit Interesse gelesen. / E lexova atë me interes.

Liebst du **Vergißmeinnicht**? / Të pëlqen lulja mos më harro?

¹⁹⁴Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, 338-339

3. Termat shprehen me anë të emrave, përemrave, ose mbiemra të emëruar dhe ndajfolje.

Man muß **die Armut** bekämpfen./ Duhet luftuar varfëria.

Wir werden uns heute über moderne Kunst unterhalten, gestern haben wir **sie** ja bereits im Unterricht behandelt./ Sot do bisedojmë për artin modern, dhe e kemi trajtuar atë në orën e mësimi.

Wir suchen nur **das Gute** im Menschen./ Ne kërkojmë vetëm të mirën tek njerëzit.

Glaubt er an seinem Erfolg? Er glaubt **daran**/ Beson ai tek suksesi i tij? Ai beson në të.

4. Rrethanat shprehen në kundrinë me anë të emrave, korrelativit 'es', ose përshkruhen me anë të fjalive të nënrenditura:

Wir warteten eine halbe Stunde auf **die Ankunft der Gäste**./ Ne pritëm një orë **mbërritjen e mysafirëve**.

Wir haben **es** schon seit dem Tag, an dem er aus dem Krankenhaus entlassen wurde, erwartet, daß er vom Amt zurücktreten wird./ Ne e kemi pritur dorëheqjen e tij që ditën që doli nga spitali.

Der Arzt empfiehlt, **daß der Kranke sofort operiert wird**./ Mjeku sugjeron që i sëmuri të operohet menjëherë.

Ich weiß nicht, **ob wir morgen einen Ausflug machen können**./ Nuk e di nëse mund të bëjmë nesër një ekskursion.

2.2. Raporti i kundrinës me foljen

Në bazë të raportit të kundrinës me foljen këto të fundit i ndajmë në kalimtare dhe jokalistare. Në gjuhën gjermane kundrinat e rasës kallëzore zakonisht hasen me folje të caktuara kalimtare. Sipas Helbig/ Buscha, ndarja e foljeve në kalimtare dhe jokalistare bazohet në raportin e foljes me kundrinën e rasës kallëzore dhe me rolin e veçantë që luan kundrina e rasës kallëzore. Kjo del qartë dhe në përkufizimin e tyre për foljet kalimtare: *“Transitive Verben sind solche Verben, bei denen ein Akkusativobjekt stehen kann, das bei der Passivtransformation zum Subjektsnominativ wird: besuchen, senden, verweisen, erwarten, anregen, etc.”*/ Folje kalimtare janë ato folje tek të cilat mund të përdoret kundrina e rasës kallëzore, e cila gjatë kthimit të fjalisë në pësore kthehet në kryefjalë: vizitoj, dërgoj, udhëzoj, pres, nxis etj.¹⁹⁵

Ata shprehen më tej¹⁹⁶ se folje kalimtare quhen gjithashtu ato folje, në fjali ku mungon kundrina e rasës kallëzore e cila mund të transformohet në kryefjalë. Në këtë rast folja përdoret si jokalistare. E rëndësishme në këtë rast nuk është nëse folja është prezente

¹⁹⁵ Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langenscheidt Verlag Enzyklopädie, 1991, f. 53

¹⁹⁶ По аты, f. 53-57

në fjali, por ekzistenca e mundësisë që ajo të jetë e pranishme. Sipas këtij pohimi, foljet në fjalitë në vijim janë kalimtare:

Sie prüft **ihre Studenten**./ Ajo teston studentët e saj.

Sie prüft jetzt./ Ajo po teston tani. (në këtë rast në rrafshin kuptimor, kemi përdorim jokalmimar të foljes kalimtare)

Sie ißt **einen Apfel**./ Ajo ha një mollë.

Sie ißt jetzt./ Ajo ha tani. (dhe në këtë rast kemi përdorim jokalmimar të foljes kalimtare 'essen/ ha')

Gjithashtu sipas tyre, foljet të cilat marrin një kundrinë të rasës kallëzore, e cila nuk mund të bëhet kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore, nuk bëjnë pjesë tek foljet kalimtare. Ato nuk janë as kalimtare, as jokalmimar, por ata i emërtojnë si 'Mittelverben'/ folje të mesme ose pseudo kalimtare. Folje të tilla si: 'behalten'/ mbaj', 'bekommen'/ marr, 'erhalten'/ marr, 'es gibt'/ ka, 'enthaltēn'/ ruaj, 'umfassen'/ përfshij, nuk e lejojnë fare kthimin e fjalisë në pësore. :

Der Koffer enthält **zwei Anzüge**.

Zwei Anzüge werden von dem Koffer enthalten./ Dy kostume u përmbajtën nga valixhja. (në këtë rast siç shihet, kthimi i fjalisë në pësore nuk është i mundur, pasi fjalia nuk do të kishte kuptim)

Ndërsa tek foljet jokalmimar bëjnë pjesë:

1. foljet e ashtëquajtura absolute, të cilat gjatë përdorimit në fjali nuk pranojnë gjymtyrë tjetër përveç kryefjalës:

Die Blume blüht./ Lulja lulëzon.

Die Sonne scheint./ Dielli shkëlqen.

2. Si dhe foljet e ashtëquajtura relative, të cilat pranojnë dhe gjymtyrë të tjera në fjali, në mënyrë që fjalia të plotësohet në aspektin gramatikor. Këto gjymtyrë mund të jenë kundrina ose rrethana. Më konkretisht në rastin e foljeve relative kalimtare ose pseudokalimtare, gjymtyra tjetër është kundrinë e rasës kallëzore, ndërsa në rastin e foljeve relative jokalmimar, gjymtyra tjetër mund të jetë një kundrinë e rasës dhanore, gjinore ose me parafjalë:

Sie half **ihrem Freund**./ Ajo ndihmoi shokun e saj.

Wir gedenken **seines Todestages**./ Ne kujtojmë ditën e tij të vdekjes.

Wir warten **auf unseren Freund**./ Ne presim shokun tonë.

Sie hofft **auf eine Verbesserung seines Gesundheitszustandes**./ Ajo shpreson një përmirësim të gjendjes së tij shëndetësore.

ose një rrethanor:

Die Stadt liegt **an der Hügel**./ Qyteti shtrihet në kodër.

Er wohnt **in einer kleinen Stadt**./ Ai jeton në një qytet të vogël.

Nga sa u tha më sipër, mund të dilet në përfundimin se foljet absolute janë gjithmonë jokalmimtare, por jo të gjitha foljet jokalmimtare janë absolute. Gjithashtu të gjitha foljet kalimtare janë relative, por jo të gjitha foljet relative janë kalimtare. Tek foljet relative bëjnë pjesë të gjitha foljet kalimtare dhe disa folje jokalmimtare.¹⁹⁷:

Foljet që marrin kundrinë të rasës kallëzore	Kalimtare	Relative
Foljet që marrin kundrinë të rasës kallëzore (që nuk kthehet në kryefjalë)	folje të mesme	Relative
Folje që marrin kundrinë të rasës dhanore ose gjinore	Jokalmimtare	Relative
Foljet që marrin kundrinë me parafjalë	Jokalmimtare	Relative
Folje që marrin rrethanor të lidhur ngushtësisht me foljen	Jokalmimtare	Relative
Foljet që nuk marrin asnjë gjymtyrë tjetër përveç kryefjalë	Jokalmimtare	Absolute

Egzistojnë disa folje kalimtare, të cilat përdoren si folje jokalmimtare:

Der Bäcker bäckt heute **Kuchen**./ Bukëpjeksi pjek sot kek.

Der Bäcker bäckt heute./ Bukëpjeksi pjek sot.

Në rastin e mësipërm bëhet fjalë për kundrina të rasës kallëzore, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me foljen, por mund të nënkuptohen nga konteksti ose situata dhe si pasojë mund të mos jetë e nevojshme prania e tyre në fjali.

¹⁹⁷Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 26

Në raste shumë të rralla, në gjuhën letrare gjejmë dhe folje jokalimtare, të cilat përdoren si folje kalimtare:

Die Glocke tönt **einen traurigen Gesang**./ Këmbana ka një tingull të trishtuar.

“ *Da der transitive Gebrauch intransitiver Verben äußerst begrenzt ist, bedarf es oft der Transivierung intransitiver Verben mit Hilfe von Präfixen/ Duke qenë se përdorimi i foljeve kalimtare si jokalimtare është shumë i kufizuar, shpesh nevojitet vendosja e parashitesave foljes për ta mundësuar këtë.*”¹⁹⁸:

Sie wartet auf **den Freund**./ Ai pret shokun

Sie erwartet **den Freund**./ Ai pret shokun.

Sie antwortete auf **die Frage**./ Ajo iu përgjigj pyetjes.

Sie beantwortete **die Frage**./ Ajo iu përgjigj pyetjes.

Në shumë raste e njëjta folje mund të përdoret dhe si kalimtare edhe si jokalimtare:

Der Bäcker bäckt **frisches Brot**./ Bukëpjeksi pjek bukë të freskët.

Das Brot bäckt./ Buka piqet.

Die Mutter brach **das Eis**./ Nëna solli bukën.

Das Eis brach./ Akulli u thye.

Die Köchin kocht **die Suppe**./ Guzhinierja gatuan supën

Die Suppe kocht./ Supa zien.

2.3. Sundimi (Rektion) i foljeve

Në gjuhën gjermane egzistojnë një sërë foljesh, të cilat kërkojnë vetëm rasi të caktuara. Kështu, p.sh. folje si: achten/ kujdesem, bedienen/ shërbej, begrüßen/ përshëndes, brauchen/ nevojitet, drucken/ shtyp, essen/ ha, finden/ gjej, erkennen/ njoh, etj kërkojnë rasën kallëzore. Ndërsa foljet helfen/ ndihmoj, fehlen/ mungoj, folgen/ ndjek, gefallen/ pëlqej, etj. kërkojnë rasën dhanore. Egzistojnë dhe folje si: abnehmen/ bie në peshë, bestellen/ porosis, erlauben/ lejoj, geben/ jap, të cilat pranojnë dy rasi, si atë kallëzore dhe atë dhanore. Gjithashtu ka dhe folje, të cilat kërkojnë rasën gjinore si: anklagen/ padis, beschuldigen/ bëj me faj, bezichtigen/ vizitoj, versichern/ siguroj, etj.. Kjo veçori gramatikore në gjuhën gjermane quhet sundimi i foljes dhe përbën një aspekt mjaft të rëndësishëm të gjuhës gjermane, duke theksuar edhe një herë lidhjen e ngushtë që kanë kundrinat me kallëzuesin, kushtëzohen prej tij gjë që nuk e kemi tek rrethanorët. Vlen gjithashtu të theksohet se në të gjitha gramatikat didaktike paraqiten si lista foljesh. Në

¹⁹⁸Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München:Langescheidt Verlag Enzyklopädie, 1991, f. 55

lidhje me këtë çështje, në këtë nënkre jam bazuar kryesisht tek gramatika e Helbig/Busha¹⁹⁹, të cilët e trajtojnë mjaft hollësisht këtë temë.

Sundimi i foljeve luan një rëndësi të veçantë në sintaksën e gjuhës gjermane. Fjala ‘Rektion’/ sundim është e huazuar nga latinishtja: ‘regere’ e cila përkthehet sundoj. Kjo veçori gramatikore lidhet ngushtësisht dhe me kundrinën.”*Rektion ist die Fähigkeit der Verben, ein von ihnen abhängiges Substantiv (oder Pronomen) in einem bestimmten Kasus (Akkusativ, Dativ, Genitiv, Präpositionalgruppe) zu fordern. Die von der Rektion des Verbs geforderten Kasus heißen casus obliqui (=abhaengige Kasus).*/ Sundim është aftësia e foljeve për të kërkuar një rasë të caktuar (Kallëzore, dhanore, gjinore , togefjalësh parafjalor) nga emri ose përemri i varur prej tyre. Rasat e kërkuara nga sundimi i foljeve quhen casus obliqui (rasa të varura).”²⁰⁰

Disa folje në gjuhën gjermane mund të sundojnë njëkohësisht dy rasa të ndryshme pranë njëra tjetrës, ndërsa disa folje të tjera mund të sundojnë në mënyrë të alternuar një ose më shumë rasa, çka lidhet shpesh me ndryshim të kuptimit. Gjithashtu foljet mund të sundojnë dhe një ose më shumë parafjalë të caktuara. Përveç foljeve, në gjuhën gjermane dhe të gjitha parafjalët sundojnë një ose më shumë rasa të caktuara. Gjithashtu, dhe mbiemrat, parafjalët dhe më rrallë emrat mund të sundojnë një rasë të caktuar.

2.3.1.Sundimi i rasës gjinore:

Foljet që sundojnë vetëm rasën gjinore janë të pakta në numër. Ato përdoren shumë rrallë në ditët e sotme, në gjuhën e folur, p. sh.: gedenken/ përkujtoj, ermangeln/ mungon, bedürfen/ nevojitet:

Wir gedenken **der Toten** des Zweiten Weltkriegs./ Ne përkujtojmë të vrarët e luftës së dytë botërore.

Die Studenten ermangelten **der Selbsterkenntnis**./ Studentëve i mungonte vetëbesimi.

Das Betreten des Parks bedarf **einer Erlaubnis**./ Për hyrjen në park nevojitet një leje.

b)Sundimi i rasës gjinore dhe kallëzore. Në gjuhën gjermane, përveç sundimit vetëm të rasës gjinore, ka dhe raste, megjithëse mjaft të rralla, të foljeve që sundojnë në mënyrë të kombinuar rasën gjinore dhe atë kallëzore, p.sh. beschuldigen/ fajësoj, anklagen/ akuzoj, verdächtigen/ dyshoj:

Man beschuldigt **sie der Steuerhinterziehung**./ E fajësonin për fshehje taksash.

Man klagt **sie des Betrugs** an./ Atë e akuzonin për mashtrim.

Man verdächtigt **sie des Mordes**./ Dyshohej për vrasje.

¹⁹⁹Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München:Langescheidt Verlag Enzyklopädie, 1991, f. 53/ 64

²⁰⁰Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 27

Në gjuhën gjermane nuk egzistojnë kombinime të sundimit të rasës gjinore dhe dhanore, apo gjinore dhe parafjalë.

2.3.2.Sundimi i rasës dhanore:

Foljet që sundojnë rasën dhanore janë më të shumta në numër se ato që sundojnë rasën gjinore. Në gjuhën gjermane përveç foljeve që sundojnë vetëm rasën dhanore egzistojnë dhe folje që sundojnë rasën dhanore dhe kallëzore si dhe rasën dhanore dhe parafjalë.

a)Folje që sundojnë vetëm rasën dhanore: ähneln/ ngjaj, fehlen/ mungoj,schaden/ dëmtoj :

Meine kleine Schwester ähnel **meiner Großmutter**./ Motra ime e vogel i ngjan gjyshes sime.

Meine Freunde fehlen **mir**./ Shokët e mi më mungojnë.

Rauchen schadet **der Gesundheit**./ Duhani dëmton shëndetin.

b)Folje që sundojnë rasën dhanore dhe kallëzore: bringen/ sjell, leihen/ jap hua, sagen/ them.

Der Postbote bringt **mir das Paket von meinen Großeltern**./ Postieri më solli pakon e gjyshërve të mij.

Mein Vater leit **mir sein Fahrrad**./ Babai im më jep hua biçikletën.

Er habe **ihr seine Meinung** gesagt./ Ai i tha asaj mendimin e tij.

c)Folje që sundojnë rasën dhanore dhe parafjalë:danken für/ falënderoj për, gratulieren zu/ uroj për, helfen bei/ ndihmoj:

Ich danke **dir für die Einladung**./ Të falënderoj për ftesën.

Wir gratulieren **dir zum Geburtstag**./ Në të urojmë për ditëlindje.

Meine Mutter hilft **meiner Schwester bei den Hausaufgaben**./ Nëna ime ndihmon motrën me detyrat e shtëpisë.

2.3.3.Sundimi i rasës kallëzore:

Foljet që sundojnë rasën kallëzore janë më të shumtat në numër. Përveç foljeve që sundojnë vetëm rasën kallëzore, në gjuhën gjermane ka dhe folje që sundojnë në mënyrë të kombinuar rasën kallëzore dhe gjinore, kallëzore dhe dhanore (këto dy të fundit u sqaruan më sipër), kallëzore dhe parafjalë e madje egzistojnë dhe disa folje që mund të sundojnë dy rase kallëzore së bashku. Në vijim për ilustrim do rendis një pjesë të tyre:

a)Folje që sundojnë vetëm rasën kallëzore si p.sh. austauschen/ këmbej, bezahlen/ paguaj, heiraten/ martohem:

Sie tauschen ihre **Telefonnummern** aus./ Ata këmbejnë numrat e telefonit.

Er bezahlt nicht **viel Miete**./ Ai nuk paguan qera të lartë.

Er heiratet **seine Freundin**./ Ai martohet me shoqen e tij.

b)Folje që sundojnë rasën të dyfishtë kallëzore, si p.sh. lehren/ jap mësim, nennen/ quaj, kosten/ kushton:

Der Lehrer lehrt **uns das Einmaleins**./ Mësuesi na mëson tabelën e shumëzimit.

Das hat **mich** nur **ein müdes Lächeln** gekostet./ Kjo më kushtoi mua vetëm një buzëqeshje të lodhur.

Warum nennst du **ihn einen Esel**?/ Përse e quan atë gomar?

c)Folje që sundojnë rasën kallëzore dhe parafjalë: hinweisen (jemanden auf etwas)/ të udhëzosh (dikë rreth diçkaje), bitten (jemanden um etwas)/ ti lutesh (dikujt për diçka), beschützen (jemanden vor etwas)/ të mbrosh (dikë nga diçka):

Ich habe **ihn auf die Hindernisse** hingewiesen./ E udhëzoza atë rreth pengesave.

Er hat **sie um Verständniss** gebetten./ Ai i kërkoi asaj mirëkuptim.

Die Ente beschützte **ihre Küken vor der Kälte**./ Rosa mbronte të vegjlit e saj nga i ftohti.

2.4.Sundimi i parafjalëve:

“Außer Verben, die eine Präpositionalrektion mit anderen Rektionen verbinden, gibt es auch solche, die ausschließlich Präpositionalrektion aufweisen. Unter diesen kann man diejenigen, die nur ein bestimmte Präposition zulassen, von solche unterscheiden, bei denen alternativ verschiedene Präpositionen stehen können; Schließlich kommen auch Verben vor, die mehr als eine Präpositionalrektion aufweisen./ Përveç foljeve, që sundojnë parafjalë në lidhje me rasia të tjera, egzistojnë dhe folje që sundojnë vetëm parafjalë. Ndër to dallohen foljet që sundojnë vetëm një parafjalë të caktuar dhe ato që sundojnë në mënyrë të alternuar parafjalë të ndryshme. Së fundi vijnë foljet që sundojnë më shumë se një parafjalë.”²⁰¹:

a) Sundimi i një parafjale: warten auf/ pres, eintreten für/ luftoj për, folgen aus/ pasojë e:

Die Studenten warten **auf die S-Bahn**./ Studentët presin tramvajin.

Er tritt **für die Rechte** der Studenten ein./ Ai lufton për të drejtat e studentëve.

Diese spezifische Änderungen folgen **aus dem Klimawandel**./ Këto ndryshime specifike janë pasojë e ndryshimeve klimaterike.

²⁰¹Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 52

b) Sundimi në mënyrë të alternuar i dy parafjalëve: leiden an/ unter/ vuaj nga, reden mit/ über/ flas me/ për, kämpfen um/ für/ luftoj për:

Er leidet an Kopfschmerzen./ Ai vuan nga dhimbja e kokës.

Er leidet unter der Last des Gewalt und Terrors./ Ai vuan nga pesha e dhunës dhe terrorit.

Sie reden mit unserem Lehrer./ Ata flasin me mësuesin tonë rreth ekskursionit.

Sie reden über den Ausflug./ Ata flasin rreth ekskursionit.

Sie kämpfen um den ersten Platz./ Dy garues luftojnë për vendin e parë.

Sie kämpfen für den Frieden./ Ata luftojnë për paqen.

c) Sundimi i më shumë se një parafjale njëkohësisht: sich rächen (an jemanden für etwas)/ të hakmerresh (për dikë, për diçka), sich schämen (vor jemanden für etwas)/ të turpërohesh (prej dikujt, për diçka), sich bedanken (bei jemandem für etwas)/ të falënderosh (dikë për diçka):

Sie wollten sich **an sie rächen für die Respektlosigkeit.**/ Ata donin të hakmerreshin ndaj saj për mungesën e respektit.

Sie schämte sich vor ihren Freunden für sein Benehmen./ Asaj i vinte turp nga shokët për sjelljen e tij.

Der Lehrer bedankte sich bei den Studenten für die Aufmerksamkeit./ Mësuesi i falënderoi studentët për vëmendjen.

2.5. Sundimi i kundrinës nga mbiemri:

Mbiemrat në gjuhën gjermane mund ti ndeshim në të gjitha funksionet e mundshme sintaksore. Ata mund të jenë gjymtyrë fjalie ose përcaktor, gjithashtu mund të gjenden dhe në kallëzues duke përshkruar një ngjarje. Në këtë rast ata marrin të gjithë karakteristikat e kallëzuesit.²⁰²:

Die Fabrik Mauern sind **vom Rauch geschwärzt.**/ Muret e fabrikës u nxinë nga tymi.

Im Unterricht verbessert der Lehrer die Fehler./ Në mësim mësuesi korrigjon gabimet.

Er schlägt **ihn tot.**/ Ai e rreh për vdekje.

Mbiemrat në gjuhën gjermane mund të sundojnë rasa të ndryshme. Pjesa më e madhe e mbiemrave sundon rasën dhanore. Mbiemrat sundojnë zakonisht vetëm një rasë të caktuar. Sundim të dy rasave njëkohësisht kemi në raste shumë të rralla, si p.sh në rastin

²⁰²Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f. 144-145

e mbiemrit schuldig/ borxhli, i cili sundon dhe rasën dhanore dhe atë kallëzore.²⁰³ (lista e plotë e mbiemrave që sundojnë rasi të caktuara në aneks):

Sie war **ihm** noch **einen Kinobesuch** schuldig./ Ajo i detyrohej atij dhe një vajtje në kinema.

“Man kann zwischen einer festen und einer schwankenden Reaktion beim Adjektiv unterscheiden. Eine feste Reaktion liegt dann vor, wenn das Adjektiv immer einen bestimmten Kasus regiert. Dabei kann es sich um den Genetiv, den Dativ, den Akkusativ oder um einen präpositionalen Kasus handeln./ Dallohet sundimi i qëndrueshëm dhe sundimi i lëkundur i mbiemrit. Me sundim të qëndrueshëm kemi të bëjmë në rastin kur mbiemri sundon gjithmonë një kundrinë rasë të caktuar. Në këtë rast bëhet fjalë për rasën gjinore, dhanore, kallëzore, ose një rasë të shoqëruar me parafjalë.”²⁰⁴

Mbiemrat gjithashtu mund të sundojnë dhe kundrinën, dmth kundrina në këtë rast nuk varet nga folja, por nga një mbiemër. Tek disa tekste gramatikore, si ajo e si Henschel/ Veid²⁰⁵ e Duden²⁰⁶, gjuhëtarë të ndryshëm, këtë lloj kundrinë e përcaktojnë si kundrinë të dorës së dytë (Objekt zweiten Grades), ndërsa Helbig/ Buscha²⁰⁷ e quajnë kundrinë e kallëzuesorit (Objekt zum Prädikativ):

Kundrinë e rasës kallëzore e sunduar nga mbiemri:

Wir sind **dieser Arbeit** gewöhnt./ Ne jemi mësuar me këtë punë.

Endlich ist sie **ihn** los./ Më në fund ajo e hoqi qafe atë.

Das ist **keinen Pfifferling** wert./ Kjo nuk vlen një grosh.

Ich bin **den Unsinn** satt./ Më ka ardhur në majë të hundës ky budallallëk.

Kundrinë e rasës dhanore e sunduar nga mbiemri:

Die Tochter ist **dem Vater** ähnlich./ Vajza i ngjan të atit.

Diese Sache ist **mir** recht./ Mua më shkon kjo gjë për shtat.

Du bist **mir** willkommen./ Ti je i mirëpritur

Das ist **mir** egal./ Kjo nuk më intereson.

²⁰³Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 193

²⁰⁴Po aty, f. 194

²⁰⁵Po aty, f. 339

²⁰⁶Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 605

²⁰⁷Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den

Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langenscheidt Verlag Enzyklopädie, 1991, f. 288

Er war **ihr** behilflich./ Ai e ndihmoi atë.

Kundrinë e rasës gjinore e sundur nga mbiemër:

Er ist **des Diebstahls** verdächtig./ Ai akuzohet për vjedhje.

Ich bin **meiner Sache** sicher./ I di mirë punët e mia.

Er wurde **seines Lebens** nicht mehr **froh**./ Ai nuk iu gëzua më jetës.

Er war sich **des Problems** nicht bewusst./ Ai nuk ishte i ndërgjegjshëm për problemin.

Kundrinë me parafjalë e sunduar nga mbiemër:

Die Mutter ist **um ihren Sohn** besorgt./ Nëna është e shqetësuar për djalin e saj.

Der Lehrer ist **mit seinen Schülern** zufrieden./ Mësuesi është i kënaqur me nxënësit e tij.

Er war besessen von **der Technologie**./ Ai ishte i fiksuar pas teknologjisë.

Kundrina me parafjalë e sunduar nga mbiemër, e cila është kundrina e cila sundohet më shpesh nga mbiemër.:

Er ist **für solche Fragen** zuständig./ Ai është personi përgjegjës për këto pyetje.

Der Student war wie **von einer fixen Idee** besessen./ Studenti ishte si i obsesionuar nga një ide fikse.

Sie ist **zu allem** imstande./ Ajo është në gjendje të bëjë gjithshka.

Er ist böse **auf mich**./ Ai është i inatosur me mua.

Er ist **bei allen** beliebt./ Atë e duan të gjithë.

Nga i njëjti mbiemër mund të varen në mënyrë të alternuar dy rasa ose parafjalë të ndryshme.²⁰⁸ Henshel/Veidi emërtojnë këta mbiemra si mbiemra të lëkundur.²⁰⁹:

Mbiemri dankbar/ mirënjohës. Prej tij varet kundrina e rasës dhanore kur përcakton një person, ose prej tij varet kundrina e me parafjalën **für**/ për, kur përcakton një send):

Ich bin **ihr** dankbar./ I jam mirënjohëse asaj.

Ich bin **für das Geschenk** dankbar./ Jam mirënjohëse për dhuratën. (prej tij varet kundrina e rasës dhanore, përcakton një person)

²⁰⁸Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f. 145

²⁰⁹Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 195

Mbiemri gewöhnt/ i mësuar. Prej tij mund të varet kundrina e rasës kallëzore, ose ajo me parafjalën **an**/ me:

Wir sind **diese Arbeit gewöhnt**./ Ne jemi mësuar me këtë punë.

Wir sind **an diese Arbeit gewöhnt**./ Ne jemi mësuar me këtë punë.

Mbiemri gleich/e rëndësishme. Prej tij mund të varet kundrina e rasës dhanore ose kundrina parafjalën **für**/për:

Mir ist es gleich, ob ich auf diesem Platz sitze oder auf einem anderen./ Për mua nuk ka rëndësi nëse ulem në këtë vend apo në një tjetër.

Für mich ist es gleich ob er das tut oder nicht./ Për mua nuk ka rëndësi nëse ai e bën këtë gjë apo jo.

Mbiemri nützlich/ i dobishëm. Prej tij mund të varet kundrina e rasës dhanore ose me kundrina parafjalën **für**/ për:

Seine Arbeit ist **allen nützlich**./ Puna e tij është e dobishme për të gjithë.

Seine Arbeit ist **für alle nützlich**./ Puna e tij është e dobishme për të gjithë.

Mbiemri fähig/ i aftë. Prej tij mund të varet kundrina e rasës gjinore, ose kundrina me parafjalën **zu**:

Er ist **einer solchen Gemeinheit nicht fähig**./ Ai nuk është i aftë të bëjë keq.

Er ist **zur Leitung dieses Geschäftes nicht fähig**./ Ai nuk është i aftë të drejtojë këtë biznes.

2.6. Nënndarjet e kundrinës sipas kritereve semantike

Në gjuhën gjermane, përveç nënndarjes së kundrinës sipas rasës dhe reksionit të parafjalës, kemi dhe nënndarjen sipas kritereve semantike. Kundrinat në gjuhën gjermane ndahen sipas kritereve semantike në kundrinë të drejtë e të zhdrejtë, ‘affizierte’ dhe ‘effizierte’ objekt, si dhe ‘innere Objekt’/ kundrinë e brendshme. Në vijim do trajtohen në mënyrë të detajuar duke i ilustruar me shembuj këto nëndarje.

-Në disa tekste gramatikore të gjuhës gjermane përmendet dhe ndarja: kundrinë e drejtë (direktes Objekt’) dhe kundrinë e zhdrejtë (indirektes Objekt). Henshel/Veid shprehet se në lidhje me to se kundrina e drejtë preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga veprimi i foljes. Në përkufizimin e kundrinës së drejtë ndërthuren kriteret semantike (të prekurit në mënyrë të drejtpërdrejtë) me ato sintaksore (raporti i ngushtë sintaksor me foljen). Ata e njehsojnë kundrinën e drejtë me kundrinën e rasës kallëzore.²¹⁰ Gjithashtu dhe

²¹⁰Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 328

Volenshajn – Lajsten²¹¹ e te tjerë, Kyrshner²¹², Bynding / Bergenholc²¹³, Pitner/ Berman²¹⁴ në klasifikimin semantik që ata i bëjnë kundrinave, e njehsojnë kundrinën e rasës kallëzore me kundrinën e drejtë. Por edhe pse shumica e kundrinave të drejta në gjuhën gjermane shprehen me një gjymtyrë në rasën kallëzore, ka dhe raste të dyshimta si p.sh në fjalinë e mëposhtme:

Ich helfe **dir**./ Unë të ndihmoj ty.

Gjithashtu tek Helbig/ Buscha²¹⁵ e Pittner/ Bermann²¹⁶, në ndarjen që i bëhet kundrinës së drejtë sipas roleve tematike të funksioneve semantike, ajo klasifikohet si ‘Patien’s’ .:

Er liest **das Buch**./ Ai lexon librin.

Sie isst **das Brodt**./ Ajo ha bukën.

-Ndërsa kundrina e zhdrejtë (indirektes Objekt) sipas Henschel/ Veid²¹⁷, Bynding/ Bergenholc²¹⁸, Pitner/ Berman²¹⁹ preket në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga veprimi i shprehur nga folja. Tek Helbig/ Buscha²²⁰ e Pitner/ Berman²²¹, ajo cilësohet dhe si ‘Rezipient’ në bazë të klasifikimit që i bëhet sipas roleve tematike.:

Sie liest **ihrer Schwester** vor./ Ajo i lexon motrës së saj.

Sie gibt **ihr** das Brot./ Ajo i jep asaj bukën.

Ndryshe nga Bynding /Bergenholc²²² e Pitner/ Berman²²³, të cilët e njehsojnë kundrinën e rasës dhanore me kundrinën e zhdrejtë, Henschel/ Veid²²⁴ shtrojnë çështjen nëse

²¹¹Wöllenstein–Leisten, Angelika/ Heilmann, Axel/ Stepan, Peter/ Vikner, *Deutsche Satzstruktur. Grundlagen der syntaktischen Analyse*. Tübingen 1997, f. 35

²¹²Kürschner, Wilfried: *Grammatisches Compendium. Systematisches Verzeichnis grammatischer Grundbegriffe*. 4., ergänzte u. bearb. Aufl. – Tübingen / Basel: Francke (UTB1526) 2003, f. 179

²¹³Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenhäum, Weinheim 1995, f. 79

²¹⁴Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 36-37

²¹⁵Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den

Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langescheidt Verlag Enzyklopädie, 1991, f. 559-603

²¹⁶ Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 59

²¹⁷Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 328

²¹⁸Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenhäum, Weinheim 1995, f. 79

²¹⁹Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 36- 38

²²⁰Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den

Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langescheidt Verlag Enzyklopädie, 1991, f. 559-603

²²¹Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 59

²²²Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenhäum, Weinheim 1995, f. 79

²²³Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 36- 37

²²⁴Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 328

përveç kundrinës së rasës dhanore, mund të jenë kundrina të zhdrejta dhe disa kundrina të rasës gjinore si dhe kundrina me parafjalë. Këtë mendim ndan dhe Eisenberg.²²⁵

Eva überführt ihn **des Mordes**./ Eva e akuzon atë për vrasje. (kundrinë e rasës gjinore)

Eva legt das Buch **auf den Tisch**./ Eva vendos librin mbi tavolinë. (kundrinë me parafjalë)

Vendimi sipas tyre varet nëse kundrina e zhdrejtë shihet si kategori semantike apo sintaksore dhe më tej mënyra se si përkufizohen këto kategori në veçanti. Gjithsesi kjo çështje mbetet ende e hapur.

- Kundrina e ndikimit (affiziertes Objekt), term ky i huazuar nga latinishtja ‘afficere’/ antun/ ndikon. Objekti i përcaktuar nga kundrina në këtë rast pëson një ndryshim me anë të veprimit të shprehur nga folja. Gjithashtu vërehet se objekti i përcaktuar nga kundrina egziston që më parë, panvarësisht veprimit të shprehur nga folja.²²⁶:

Nina liest **ein Buch**./ Nina lexon një libër.

-Kundrina e shkakut (effiziertes Objekt), term i huazuar nga latinishtja ‘efficere’/ ‘bewirken’/ shkaktoj. Në këtë rast objekti i përcaktuar nga kundrina egziston në sajë të veprimit të kryer nga folja, dmth është rezultat i veprimit të shprehur prej saj.²²⁷:

Nina schreibt **einen Brief**./ Nina shkruan një letër.

-Kundrina e brendshme (inneres Objekt) e quajtur ndryshe dhe ‘kognates Objekt’/ kundrina e përkueshmërisë, nga latinishtja ‘cognatus’/ e përkueshme, përsërit në formë emërore atë çka është shprehur nga folja. Kundrina dhe folja në këtë rast kanë të njëjtën rrënjë fjalëformuese, ose rrënjë fjalëformues të lidhura ngushtësisht semantikisht mes tyre.²²⁸:

Er träumt **einen seltsamen Traum**./ Ai ëndërron një ëndërr të çuditshme.

Ich sprang **den Sprung** meines Lebens./ Unë kërcëva kërcimin e jetës.

Er schläft **den Schlaf** des Gerechten./ Ai fle gjumin e të drejtës.

Sie kämpft **den Kampf** ihres Lebens./ Ajo po lufton luftën e jetës.

Er geht **den schwersten Gang** seines Lebens./ Ai hedh hapin më të vështirë të jetës.

Er ist einen **schrecklichen Tod** gestorben./ Ai vdiq nga një vdekje e tmerrshme.

²²⁵Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik*, Stuttgart: Metzler, 1989, f. 90

²²⁶Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 328

²²⁷Po aty

²²⁸Po aty

3. Kundrina e rasës kallëzore

Sipas Henschel/ Veid, fjala ‘Akkusativ/ kallëzore’ në gjuhën gjermane e ka prejardhjen nga folja latine ‘accusare’/ akuzoj. Në fakt këtu bëhet fjalë për një përkthim të gabuar të fjalës ‘aitiatike’, e cila do të thotë rasia e shkaktarit (Verursachungsfall) dhe jo rasia e akuzuesit (Anlagefall), që romaku Remium Palaemon bëri gjatë përkthimit prej tij nga greqishtja të gramatikës së Dionysios Thrax. Vlen të theksohet se ky përcaktim i gabuar i termit i ka qëndruar kohës. Për shkak të renditjes së saj në paradigmen e rasave, rasia kallëzore ndryshe emërtohet dhe si ‘4. Fall/ rasia e katërt’ ose ‘Wen-Fall/ rasia e kë’, për shkak të pyetjes analitike “wer?/‘kë?’, që përdoret për ta identifikuar si rasë.²²⁹

“Er ist ursprünglich der Kasus der Ausdehnung und der Richtung, der das Ziel, das “direkte Objekt” einer Handlung angibt. Diese Bedeutung ist bei der rektion der Lokalen Präpositionen noch deutlich zu erkennen: auf die Frage “wohin?” muss der Akkusativ stehen. Als Kasus, der das direkte Ziel angibt ist der Akkusativ der wichtigste Objektkasus beim Verb: eben der Kasus des “direkten Objektes”./ Ajo është rasia e shtrirjes dhe e drejtimit, e cila jep synimin, objektin e drejtëpërdrejtë të një veprimi. Ky kuptim dallohet fare qartë tek reksioni i parafjalëve të vendit: kur pyetja analitike është ‘për ku?’, kemi të bëjmë me rasën kallëzore. Duke qenë se është rasia, e cila jep synimin e drejtëpërdrejtë të një veprimi, ajo përbën rasën më të rëndësishme në lidhje me foljen.”²³⁰

Kundrina e rasës kallëzore është kundrina që haset më shpesh jo vetëm në gjuhën gjermane, por edhe në shumë gjuhë të tjera indoevropiane. Kjo është dhe arsyeja pse e nisa me këtë kundrinë. Në gramatikën tradicionale, nëpërgjithësi ajo përkufizohet si gjymtyra e cila përcakton objektin, i cili pëson direkt veprimin e shprehur me anë të foljes. Ajo përcakton zakonisht një send, më rrallë një frymor.

Ich vermisse **dich**./ Më mungon

Ich glaube dir **das** nicht./ Nuk ta besoj këtë.

Ich gebe der Wohnung **einen neuen Anstrich**./ Unë i jap një bojë banesës.

Ich schreibe **ein Lied**./ Unë shkruaj një këngë.

Er streiche **eine Wand** mit Farbe an./ Ai lyen murin me bojë.

Në gjuhën gjermane kundrina e rasës kallëzore shprehet me anë të një gjymtyre në rasën kallëzore. Duke qenë një gjymtyrë në rasën kallëzore mund të gjendet me anë të pyetjes analitike ‘kë?’ për frymorët ose ‘çfarë?’ për sendet.

Ich liebe **dich**./ Unë të dua ty.

Wen liebe ich?= dich/ Kë dua unë?=ty

²²⁹Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 163

²³⁰По аты

Sie gibt mir **das Buch**./ Ajo më jep mua librin
Was gibt sie mir?= das Buch/ Çfarë më jep ajo mua?=librin

Një mënyrë tjetër për të bërë të mundur klasifikimin e saj është me anë të provës së zëvendësimit.:

Sie hat **das Schiff** nicht erreicht./ Ajo nuk e arriti anijen.

Was hat sie nicht erreicht?/ Çfarë nuk arriti ajo?

Sie hat **den Kollegen** nicht erreicht./ Ajo nuk e arriti kolegun.

Sie hat **ihn** nicht erreicht./ Ajo nuk e arriti atë.

Wen hat sie nicht erreicht? Kë nuk arriti ajo?

Në gramatikën me orientim nga përmbajtja të gjuhës gjermane (inhaltsbezogenegrammatik), por dhe në gramatika të tjera tradicionale që janë përmendur më sipër, shpesh ajo quhet kundrinë e drejtë, duke qenë se përfaqëson objektin e prekur direkt nga një veprim ose një ndodhi.

Një tipar i rëndësishëm sintaksor i kundrinës së rasës kallëzore në gjuhën gjermane është se zakonisht kur fjalia kthehet në pësore kundrina kthehet në kryefjalë.

Sie öffnet **das Fenster**./ Ajo hap dritaren.

Das Fenster wird geöffnet./ Dritarja u hap.

Alle lobten **ihn**./ Të gjithë e lëvdonin atë.

Er wurde von allen gelobt./ Ai u lëvdua nga të gjithë.

Kundrina e rasës kallëzore varet zakonisht nga folja. Por egzistojnë dhe raste të rralla kur ajo varet nga një mbiemër. Henshel/ Veid e emërtojnë kundrinën e rasës kallëzore në këtë rast si kundrinë të dorës së dytë:: “*Außer den Verben können Akkusative auch als sog. Objekte zweitens Grades von Adjektiven abhängig sein. Ein Adjektiv, das Akkusativreaktion aufweist, ist beispielsweise ‘schuldig’*”/ Përveç foljeve, kundrinat e rasës kallëzore, në këtë rast të ashtuquajtura kundrina të dorë së dytë, mund të jenë të varura nga një mbiemër, p.sh. mbiemri ‘borxhli’.²³¹:

Er ist mir noch **einen ganzen Monatslohn** schuldig./ Ai më ka akoma borxh rrogën e një muaji.

Die Aussicht auf dem Gipfel ist **den Aufstieg** wert./ Pamja në majë bën që t’ia vlejë ngjitja.

²³¹Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 164

Ich bin **den Ärger leid**./ Më vjen keq për shqetësimin.

Kundrina e rasës kallëzore siç është shtjelluar në mënyrë të detajuar më parë, varet zakonisht nga folje relative kalimtare, ose më rrallë nga folje relative të mesme, të ashtuquajtura pseudo- kalimtare:

Sie **besucht ihren Bruder**./ Ajo takon të vëllanë.

Er hat **den Koffer behalten**./ Ai e mbajti valixhen.

Gjithashtu, siç është shtjelluar më hollësisht në një nga nënkrerët më sipër, në gjuhën gjermane egziston një listë foljesh të cilat kërkojnë vetëm rasën kallëzore. Një numër i vogël foljesh pranon dy rasa: dhanore dhe kallëzore, kallëzore dhe gjinore, si dhe rasën kallëzore dhe parafjalë. Në gjuhën gjermane ka dhe folje që mund të marrin kundrinë të dyfishtë të rasës kallëzore. Në këtë rast, kundrina që shpreh frymor vendoset përpara asaj që shpreh send.:

Er **bezahlt viel Miete**./ Ai paguan qera të lartë.

Man **klagt sie des Betrugsan**./ Atë e akuzojnë për mashtrim

Er **habe ihr seine Meinung** gesagt./ Ai i tha asaj mendimin e tij.

Er **hat sie um Verständniss** gebetten./ Ai i kërkoi asaj mirëkuptim.

Der Lehrer **lehrt uns das Einmaleins**./ Mësuesi na mëson tabelën e shumëzimit.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane mund të ndeshet së bashku me një kundrinë të rasës dhanore apo një kundrinë me parafjalë:

Wir haben **ihnen das beste Zeugnis** ausgestellt./ I përgatitëm atyre dëftesën më të mirë të mundshme.

Man vermochte **ihn mit begütigen Wörtern** zu beruhigen./ U përpoqën ta qetësonin me fjalë ngushëlluese.

Gjithashtu një kundrinë e rasës kallëzore mund të kombinohet edhe me një kundrinë të rasës gjinore:

Ich versichere **Sie meines uneingeschrenkten Vertrauens**./ I sigurova ata se kisha besim të plotë.

Në gjuhën gjermane ka gjithashtu raste ku në të njëjtën fjali mund të hasen dy kundrina të rasës kallëzore. Në këtë rast bëhet fjalë për kundrina të rasës kallëzore të dyfishta që hasen vetëm të shoqëruara nga disa folje të caktuara: fragen, kosten, lernen/ pyes, kushtoj, mësoj.:

Deine Unversichtigkeit wird **dir** doch **das Leben** kosten./ Pakujdesia jote do të të kushtojë jetën.

3.1. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e rasës kallëzore:

Në aspektin morfologjik, të gjitha pjesët e ligjëratës dhe togfjalëshat që shfaqen si kryefjalë mund të kryejnë funksionin e kundrinës së rasës kallëzore, meqë pjesët e ligjëratës mund të kryejnë funksione të ndryshme në fjali. Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane mund të shprehet me:

-Emra:

Gestern habe ich **Daniel** getroffen./ Dje takova Danielin.

-Togfjalësh të përbërë nga emra të zgjeruar nga përcaktorë

Ich kann **deinen alten Schaukelstuhl** nicht ausstehen./ Unë nuk e pëlqej karrigen tënde të vjetër lëkundëse.

-Përemra:

a)përemra pronor:

Sie kennt **ihn** gut./ Ajo e njeh mirë atë.

b)Përemra refleksiv. Sipas Schulc/ Grizbah, përemri refleksiv tek pjesa më e madhe e foljeve refleksive, është e ashtuquajtura prej tyre kundrinë funksionale e rasës kallëzore.²³² *„Funktionsobjekte sind auch das reflexivpronomen und die reflexiv gebrauchten Personalpronomen, wenn im Prädikat ein verb steht, das ohne dieses Pronomen nicht gebraucht werden kann, wenn sich der Wortinhalt nicht ändern soll. Diese Funktionsobjekte sind bei Einsatz dieser Verben unentbehrliche Strukturteile des Satzes./ Kundrina funksionale janë gjithashtu përemrat refleksiv dhe përemrat e përdorur si refleksiv, në rastin kur folja e kallëzuesit nuk mund të përdoret pa këtë përemër, në rast se nuk duhet të ndryshojë përmbajtja e fjalisë. Këto kundrina funksionale janë në rastin e përdorimit të këtyre foljeve, pjesë strukturore të domosdoshme të fjalisë.“*²³³

Ich freue **mich** über dein Geschenk./ Unë gëzohem për dhuratën tënde.

Er ärgert **sich** über seinen Fehler./ Ai inatohet për gabimin e tij.

*“Diese reflexive Pronomen drücken weder die Identität mit einer anderen im Satz genannten Rolle aus, noch sind sie reciprok zu verstehen./ Këta përemra nuk shprehin as identitetin e një roli tjetër të përmendur në fjali, dhe as nuk kuptohen si reciprokë.”*²³⁴.

Die Mutter wäscht sich. – Die Mutter wäscht das Kind./ Nëna lahet.- Nëna lan fëmijën.

²³²Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f. 219

²³³Po aty, f. 336

²³⁴Po aty

Die Jungen schlagen sich (gegenseitig).- Die Jungen schlagen den Hund./ Djemtë rrihen. (me njëri-tjetrin).- Djemtë rrahin qenin

-Numërorë:

Von meinen neuen Kollegen kenne ich erst **ein Drittel**./ Nga kolegu im i ri njoh vetëm çerekun.

-Paskajore të zgjeruar

Ich habe vor, **ihm gründlich die Meinung zu sagen**./ E kam në plan t'ia them hapur mendimin tim.

Er lernt, **ein Dokument zu sichern**./ Ai mëson, të ruajë një dokument.

-Korrelati “es”²³⁵:

Ich hasse **es**, dass du ständig zu spät kommst./ E urrej faktin që vjen përherë me vonesë.

Korrelatin “es” mund ta ndeshim në paskajoret e zgjeruar por dhe në fjalitë e nënrenditura. Në të dyja rastet ai është shumë i rrallë dhe e hasim në disa folje të veçanta që shprehin një gjendje emocionale, si p.sh: hassen, sich ekeln, bedauern, mögen, bevorzugen/ urrej, ndjej neveri, më vjen keq, dua, parapëlqej.

Korrelati ‘es’ si kundrinë ndeshet në disa forma, p.sh. si kundrinë formale, jofunksionale dhe jokuptimore e rasës kallëzore ku luan rolin e ‘Platzhalter’ për fjalitë e nënrenditura:

Ich bedauere (**es**) sehr, Ihnen enttäuschen zu müssen./ Më vjen shumë keq, që më duhet t’Ju zhgënjëj.

Sie begreift (**es**) nicht, dass er sie verlassen hat./ Ajo nuk e kupton, që ai e ka braktisur.

Si kundrinë formale në shprehje fikse. (festen Wendungen):

Ich hatte **es** eilig./ Unë e kisha me nxitim.

Sie haben **es** im Leben sehr weit gebracht./ Ata kanë ecur shumë në jetë.

-Mbiemra të emëruar:

Ich trage am liebsten **Rot**./ Unë preferoj të kuqen.

-Paskajore të emëruar me ose pa nyje:

Sie verabscheut **das ewige Kochen und Putzen**./ Ajo e urren gatimin dhe pastrimin e përhershëm.

Er wiederholte das **bereits Gesagte**./ Ai përsëriti të sapothënë

-Fjali të nënrenditur:

²³⁵ ‘Korrelati’, në gramatikën e gjuhës gjermane, është një fjalë që i referohet një fjale tjetër nga ana gramatikore ose kuptimore

Wen ihr eingeladen habt, müsst ihr auch empfangen./ Nëse keni ftuar, duhet dhe të prisni

Er lernt, **wie er ein Dokument sichern muss**./ Ai mëson, si duhet ruajtur njëdokument.

Sie erfuhr, **dass das Flugzeug Verspätung hatte**./ Ajo mori vesh se treni do të vonohej.

Për shkak të funksionit në fjali, këto fjali quhen fjali kundrinore (Objektsätze).

-Ligjëratë të drejtë:

Sie sagte: **Ich komme gleich**./ Ajo tha: Vij menjëherë.

3.2. Nuanca semantike të kundrinës së rasës kallëzore

Sa më ngushtësisht e lidhur me kallëzuesin të jetë gjymtyra e fjalisë, aq më i vështirë bëhet interpretim kuptimor i tyre. Egziston një lidhje e ngushtë mes kuptimit të foljes dhe vlerës së saj kuptimore dhe gjymtyrëve që varen nga ajo. Prandaj dhe kundrinat e rasës kallëzore nuk kanë kuptim të njehsuar. Te Duden²³⁶ gjejmë ndarjet e mëposhtme të kundrinës nisur nga interpretimi kuptimor i saj:

1. Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane përcakton më shpesh një send sesa një frymor. Në kuptimin më të gjerë të saj ajo përcakton një “objekt”, domethënë një frymor ose send që preket nga një veprim ose mbi të cilin bie veprimi. Në këtë rast flitet për ‘affiziertes Objekt’ ose ‘Patiens’. Mënyra e prekjes nga veprimi mund të jetë shumë e ndryshme, në varësi të llojit të veprimit. E rëndësishme sipas Duden në këtë rast është se personi ose sendi i shprehur në kundrinën e rasës kallëzore, ekziston pavarësisht veprimit të shprehur nga folja.:

Er repariert **das Auto**./ Ai rregullon makinën.

Sie backt **den Fisch**./ Ajo pjek peshkun.

Er lobt **den Schüler**./ Ai lëvdon nxënësin.

2. Rezultati i një ngjarje, një veprimtarie ose një veprimi, i cili jepet nga kallëzuesi; në këtë rast kemi të bëjmë me një ‘effizierten objekt’:

Sie schreibt **einen Brief**./ Ajo shkruan një letër.

Sie backt **den Kuchen**./ Ajo bën kekun.

Sie bauen **ein Haus**./ Ata ndërtojnë një shtëpi.

²³⁶Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 589- 590

3.Një ngjarje, rrjedha e së cilës karakterizohet nga folja e kallëzuesit:

Er leistet **Hilfe**./ Ai ndihmon.

Sie gibt **Unterricht**./ Ajo jep mësim.

4. Një frymor, për të cilin dëshmohet diçka rreth gjendjes së tij trupore dhe shpirtërore:

Es friert **mich**./ Kam ftohtë.

Es drängt **mich**./ Më preokupon.

5.Kuptimin e një shprehjeje foljore. Këtë kundrinë sipas Duden e ndeshim me folje jokalimtare. Në këtë rast bëhet fjalë për një kundrinë të brendshme.:

Er starb **einen leichten Tod**./ Ai pati një vdekje të lehtë.

6.Përcaktimin e sasisë ose çmimit:

Der Kontainer enthält **50 Liter**./ Fuçia përmban 50 litra.

Das Buch kostet **30 Euro**./ Libri kushton 30 euro.

7.Atë çka zotëron dikush.

Sie besitzt **einen Wohnwagen**. Ajo ka një rulot.

Sie hat **eine Boutique**./ Ajo ka një butik.

8.Një gjendje, një veçori ose një funksion, që ka dikush:

Wir haben **Angst**./ Ne kemi frikë.

Er hat **einen kräftigen Griff**./ Ai ka një shtrëngim të fuqishëm.

Er hatte **keinen Beruf**./ Ai nuk ka një profesion.

9.Mbartësin e një klasifikimi, i cili përbëhet nga ‘Gleichsetzungsakkusativ’”

Er nennt ihn **einen Feigling**./ Ai e quan burracak.

4. Kundrina e rasës dhanore

Fjala Dativ/ dhanore e ka origjinën nga ‘dare’/ jap nga latinishtja. Rasa dhanore renditet e treta ndër rasat e gjuhës gjermane, për këtë arsye ndryshe quhet dhe ‘3. Fall’ rasa e tretë ose ‘Wem-Fall’/ rasa e kujt’, për shkak të përemrit pyetës të përdorur për ta identifikuar me anë të pyetjes analitike. Dhanorja në të shkuarën përcaktonte një person të përfshirë në veprim, i cili nuk përbën synimin e vërtetë të veprimit, por në interes ose

dëm të së cilit kryhet veprimi. Kjo marrëdhënie sipas tyre del qartë në rastin e foljes geben/ jap.²³⁷:

Sie gab das Buch **ihrer Freundin**./ Ajo ia dha librin shoqes së saj.

Në këtë rast, kundrina e rasës kallëzore ‘das Buch’ i nënshtrohet një transaksioni, në të cilin përveç kryefjalës (Ajo), është e përfshirë dhe një person tjetër (shoqja e saj). Vlen të theksohet se ky funksion i dhanores në ditët e sotme, nuk perceptohet më në këtë mënyrë në shumicën e rasteve, por egziston ende veçanërisht në rastin e të ashtuquajturave dhanore të lira.

“Die Stelle des Dativobjekts ist regulär durch ein Glied im Dativ besetzt. Der Kasus ist den Flexionsformen ablesbar und wird durch Proben leicht zu bestimmen./ Kundrina e rasës dhanore shprehet me një gjymtyrë në rasën kallëzore. Rasa dallohet lehtësisht dhe mund të përcaktohet gjithashtu lehtësisht përmes provave.”²³⁸:

Das gehört **der Lehrerin**./ Kjo i përket mësueses.

Das gehört **dem Lehrer**./ Kjo i përket mësuesit.

Das gehört **ihm**./ Kjo i përket atij.

Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane në ndryshim nga ajo e rasës kallëzore, përcakton më shpesh një frymor sesa një send. Personi i përcaktuar prej saj është zakonisht mjaft i përfshirë në ngjarje, shpesh përcaktohet si marrësi (Empfänger):

Wir gratulieren **dir** zum Geburtstag./ Ne të urojmë për ditëlindje.

Der Meister erklärt **dem Lehrling** die Maschine./ Mjeshtri i shpjegon praktikantit makinerinë.

Der Lehrer droht **dem nachlässigen Schüler**./ Mësuesi kërcënon nxënësin indiferent.

Der Richter glaubte **dem Angeklagten**./ Gjykatësi e besonte të akuzuarin.

Das Geld gehört **dem Finder**./ Paratë i përkasin atij që i gjen.

Der Dieb entwischte **der Polizei**./ Hajduti i shpëtoi policisë.

Sipas Schulc/ Grizbah, kundrina e rasës dhanore përcakton një send ose abstrakt, përgjithësisht në rastet kur varet nga folje, të cilat shprehin një ngjarje ose gjendje.²³⁹:

Der Fahrer wich **der Verkehrskontrolle** aus./ Shoferi i bëri bisht kontrollit.

²³⁷Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 158

²³⁸Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 577

²³⁹Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, 221

Gehorchen sollte man **einem Befehl** nicht unkritisch./ Urdhrit nuk duhet ti bindemi pa bërë kritikë.

Sie diene **der Liebe**./ Ajo i shërbente dashurisë.

Wir weichen **der Gewalt**./ Ne iu shmangëm dhunës.

Rauchen schadet **der Gesundheit**./ Duhani dëmton shëndetin.

Der Preis nähert sich **dem neuen Hoch** an./ Çmimi po i afrohet shifrave maksimale.

Die Kinder lauschten **dem Gesang der Vogel**./ Fëmijët përgjonin këngën e zogjve.

Pyetja analitike e përdorur për kundrinën e rasës dhanore është: wem?/ kujt?.

Sie hilft **ihrem Vater**./ Ajo ndihmon të atin.

Wem hilft sie?= ihrem Vater/Kë ndihmon ajo?= të atin.

Das Buch gefällt **Anna**./ Libri i pëlqen Anës.

Wem gefällt das Buch?=Anna./ Kujt i pëlqen libri?= Anës

Ich verzeihe **dir**./ Unë të fal ty.

Wem verzeihe ich? Dir./ Kë fal unë? =ty

Në pjesën më të madhe të gramatikave tradicionale të hulumtuara për këtë punim ndeshet pohimi se gjatë kthimit të fjalisë në pësore, kundrina e rasës dhanore si rregull nuk pëson asnjë ndryshim.:

Er hilft **seinem Freund**./ Ai ndihmon shokun e tij.

Seinem Freund wird geholfen./ Shokut të tij i jepet ndihmë.

“Es gibt jedoch eine Form der Passivierung, durch die auch das Dativobjekt zum Subjekt werden kann, nämlich das mit Hilfe von kriegen oder bekommen gebildete „Rezipientenpassiv“./ Por ekziston një formë e kthimit të fjalisë në pësore, gjatë sëcilës kundrina e rasës dhanore kthehet në kryefjalë, bëhet fjalë për pësoren e cila realizohet me ndihmën e foljeve marr.”²⁴⁰.

Er hat **ihr** ein Buch geschenkt./ Ai i dhuroi një libër asaj.

Sie bekam von ihm ein Buch geschenkt./ Ajo mori prej tij një libër dhuratë.

Kundrina e rasës dhanore kthehet në përcaktor gjatë emëzimit të foljes së fjalisë:

Er hilft **seinem Freund**./ Ai ndihmon shokun e tij.

²⁴⁰Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 37

Die Hilfe für seinen Freund./ Ndhima për shokun e tij.

Kundrina e rasës dhanore përcaktohet në disa gramatika tradicionale dhe si kundrinë e zhdrejtë. Ajo varet zakonisht nga folje relative jokalimtare. Por, përveç foljeve si: helfen/ ndihmoj, zuhören/ dëgjoj ose widersprechen/ kundërshtoj, të cilat lidhen vetëm me kundrina të rasës dhanore, në gjuhën gjermane egzistojnë dhe mjaft folje kalimtare si: geben/ jap, raten/ këshilloj, anvertrauen/ besoj, etj., të cilat përveç kundrinës së rasës kallëzore kërkojnë dhe kundrinë të rasës dhanore.²⁴¹

Ich kann **dir** auf jeden Fall helfen./ Patjetër mund të të ndihmoj ty.

Ich höre dem Vorleser aufmerksam zu./ Dëgjoj me vëmendje ligjëruesin

Ich wollte **ihr** nicht widersprechen./ Nuk desha ta kundërshtoj.

Ich gebe dir einen Hinweis für die Lösung./ Do të të jap një ndihmë për zgjidhjen.

Ich rate dir deine Mutter zuzuhören./ Të këshilloj tëdëgjosh nënën tënde.

Ich werde **dir ihr Geheimnis** anvertrauen./ Do të të besoj sekretin e saj.

Përveç se të shoqëruar me kundrinë të rasës kallëzore, kundrinën e rasës dhanore mund ta ndeshim në fjali dhe të shoqëruar nga një kundrinë me parafjalë, p.sh. në rastet kur varet nga foljet: fehlen an/ mungoj, danken für/ falënderoj apo antworten auf/ përgjigjem.:

Es fehlt ihr an Geld./ Asaj i mungojnë paratë.

Ich danke dir für das tolle Geschenk./ Të falënderoj për dhuratën e bukur.

Sie antwortete ihr auf Anrufbeantworter./ Ajo iu përgjigj në sekretarinë telefonike.

Kundrina e rasës dhanore është zakonisht e detyrueshme në rastin kur varet nga folje, të cilat sundojnë vetëm rasën dhanore, ndërsa në rastet kur varet nga folje, të cilat sundojnë dhe rasa të tjera, ajo mund të jetë e detyrueshme si p.sh. në rastin e foljes geben/ jap, ose fakultative si p.sh. në rastin e foljeve rüberbringen/ sjell, ose überliefern/ transportoj.:

Ich gebe dir das Buch./ Unë të jap ty librin.

Nuk do kishte kuptim: Ich gebe./ Unë të jap.

Ich bringe dir die Bücher rüber./ Unë te sjell ty librat.

Ich bringe die Bücher rüber./ Unë sjell librat.

Ich überliefere dir die Bücher./ Unë transportoj librat e tu.

²⁴¹Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006

Ich überliefere **die Bücher**./ Unë transportoj librat.

Në raste të rralla kundrina e rasës dhanore mund të varet dhe nga një mbiemër.:

Sie sieht **ihrer Mutter** ähnlich./ Ajo i ngjan nënës së saj.

Er ist **seiner Frau** treu./ Ai i qëndron besik gruas së tij.

Në gjuhën gjermane ndeshen dhe gjymtyrët e ashtëquajtura dhanore të lira. *”Eine besonders enge Verbindung von Grammatik und Semantik zeichnet den Dativ als Kasusobjekt aus. Seine Rektionsbindung wird häufig als eingeschränkt angesehen und deshalb spricht man vom freiem Dativ. Die Grenzen zwischen Dativobjekt und freiem Dativ sind gelegentlich fließend und auch die verschiedenen Grammatiken sind sich in der Einteilung nicht einig. Prinzipiell gilt, dass ein Dativ nur dann als Objekt aufgefasst werden kann, wenn er vom Verb verlangt wird und nicht einen freien Zusatz zu beliebigen Verben bindet.* Një lidhje veçanërisht e fortë mes gramatikës dhe semantikës përcakton kundrinën e rasës dhanore. Lidhja e saj me reksionin shihet shpesh si e kufizuar, prandaj në këtë rast flitet për dhanore të lirë. Kufijtë mes kundrinës së rasës dhanore dhe dhanores së lirë nganjëherë nuk janë të përcaktuara qartë dhe madje dhe gramatika të ndryshme nuk janë të një mendimi për sa i përket ndarjes së tyre. Në parim, një gjymtyrë e rasës dhanore mund të përkufizohet si kundrinë, vetëm në rastin kur kërkohet nga folja, dhe jo kur shërben si një shtojcë e lirë e foljes.”²⁴²

Ashtu si është trajtuar hollësisht në një nënkre më sipër, dallojmë pesë llojë dhanorësh të lira:

Dhanorja komodi: Eva wollte **dem Hund** eine Hütte bauen lassen./Eva do ndërtojë një kolibe për qenin.

Dhanorja inkomodi: **Mir** ist eine Vase runtergefallen./ Mua më ra vazoja.

Dhanorja posesive: Er klopfte **ihr** freundschaftlich auf die Schulter./ Ai i rrahu asaj me dashamirësi shpatullat.

Dhanorja etike: Komm **mir** nicht zu spät./ Mos më hajde vonë.

Dhanorja judikantis: Der Moderator ist mir zu nervös. Moderatorin më duket shumë nervoz.

Në përgjithësi, gjuhëtarë të ndryshëm, si p.sh. Helbig/ Buscha²⁴³ Pittner/ Berman²⁴⁴, tre të parat i përcaktojnë si kundrina. Por dhe këtu vërehen mosdakortësi mes gjuhëtarëve. Dyrshajd p.sh. i quan dhanoret e lira si gjymtyrë në rasën dhanore që nuk janë kundrina,

²⁴²Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 335- 341

²⁴³Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langenscheidt Verlag Enzyklopädie, 2007, f. 264

²⁴⁴Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004, f. 55- 59

të cilat paraqesin një kategori më vete gjymtyrësh fjalie, për të cilat nuk ka një përcaktim funksional.”²⁴⁵Ndërsa Duden²⁴⁶ i përfshin ato në të njëjtën kategori me kundrinat.

4.1. Pjesët e ligjëratës më të cilat mund të shprehet kundrina e rasës dhanore:

Kundrina e rasës dhanore mund të shprehet me emër, përemër, togfjalësh, më rrallë me forma të emëruara apo fjali relative. “*Die Funktion des Dativobjekts kann nur durch Substantive oder ihre Pro-Formen übernommen werden. Erweiterte Infinitive oder Nebensätze kommen mit Ausnahme seltener Fälle von Relativsätzen ohne Beziehungswort nicht als Dativobjekt vor, und alle anderen Wortarten müssen, wenn sie als Dativobjekt verwendet werden sollen, substantiviert (und damit in die Klasse der Substantive überführt) werden.* / Funksioni i kundrinës së rasës dhanore mund të shprehet vetëm me emra ose përemra. Përveç rasteve shumë të rralla, ajo nuk mund të shprehet me paskajore të zgjeruara ose fjali të varura, dhe të gjitha kategoritë e tjera gramatikore, në rastin kur këto të fundit shprehin kundrinën e rasës dhanore janë të emëruara dhe bëjnë pjesë në kategorinë e emrave.”²⁴⁷

-Emër:

Ich schließe mich **dem Antrag** an./ Unë i bashkangjitem kërkesës.

-Përemër:

Sie hilft **ihm**./ Ajo e ndihmon atë.

-Togfjalësh:

David winkt **seinem Nachbarn**./ Davidi përshëndet komshiun e tij.

- Fjali të nënrenditur:

a)Fjali relative pa adresant (relativsatz ohne Bezugswort):

Erzähl das, **wem** du willst./ Tregojta kujt të duash këtë.

b)Fjali të nënrenditur me daß (daß Sätze): “*Auch ‘daß’ Sätze mit dem Demonstrativum ‘dem’ als Korrelat werden gewöhnlich vermieden, sind aber gelegentlich möglich; sie lassen sich jedoch ebensogut als Attribute zu ‘dem’ wie als Objektsätze mit Korrelat interpretieren.* / Dhe fjalitë me ‘që’ me përemrin ‘të cilit’ si korrelat zakonisht evitohen,

²⁴⁵Dürscheid, Christa: *Syntax. Grundlagen und Theorien*. 4., überarbeitete und ergänzte Auflage. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht (=Studienbücher zur Linguistik, Band 3) 2007, f. 42

²⁴⁶Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 590- 591

²⁴⁷Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006, f 51

por nganjëherë janë të mundura; megjithatë ato mund të interpretohen dhe si përcaktorë të përemrit ‘të cilit’ ose si fjali kundrinore me korrelat.”²⁴⁸:

Ich kann **dem** nichts abgewinnen, **daß wir die Abstimmung verschieben sollen**./ Nuk fitojmë asgjë, nëse e shtyjmë votimin.

-Pjesë të emëruara të ligjëratës:

a) paskajore e emëruar:

Er stimmte **dem bereits Gesagten** im wesentlichen zu./ Ai konfirmoi pjesën më të madhe të asaj çka u tha.

b) mbiemër i emëruar:

Ich kann **diesem Rot** nicht abgewinnen./ Nuk mund ta realizoj këtë ngjyrë të kuqe.

4.2. Nuanca semantike të kundrinës së rasës dhanore

“*Das Dativobjekt gilt generell als sogenannte indirektes Objekt, weil hier vorwiegend jemand oder etwas genannt wird, dem sich seine Tätigkeit oder Handlung eher mittelbar zuwendet.*./ Kundrina e rasës dhanore përgjithësisht e quajtur kundrinë e zhdrejtë, sepse zakonisht përcakton dikë ose diçka, të cilit i drejtohet veprimi kryesisht në mënyrë të tërthortë.”²⁴⁹

Der Polizeibeamte antwortet **dem Fremden**./ Polici i përgjigjet të huajit.

Në vijim bazuar tek Duden²⁵⁰, gjejmë një ndarje më të detajuar të nuancave semantike të shprehura prej saj.:

a) në kuptimin e përgjithshëm, pikë referimi ose shpeshherë një person referimi (Bezugsperson) për një ngjarje:

Es dient **seiner Gesundheit**./ I shërben shëndetit të tij.

Das nützt **dem Kind**./ Kjo i shërben fëmijës.

b) një person që zotëron diçka ose marrësin e diçkaje, por dhe personin, të cilit i mungon prona. Ndryshe quhet dhanorja posesive.

Die Brille gehört **mir**./ Syzet më përkasin mua.

Die Brille ist **mir** eigen./ Syzet janë të miat.

²⁴⁸Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 335

²⁴⁹Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 590

²⁵⁰По aty, f. 590-591

c) një person, në vend të së cilit dhe në dobi ose dëm të dikujt ndodh diçka, e quajtur ndryshe dhe dhanorja komodi/ inkomodi.:

Sie trägt **ih**r das Gepäck./ Ajo i mban asaj bagazhet.

Sie hat **ih**r das Gepäck umgekippt./ Ajo ia rrëzoi asaj bagazhet.

d) një frymor ose send, nga tërësia e së cilit, i referohemi vetëm një pjese.:

Er fur **dem LKW** in die Seite./Ai iu afrua me makinë pjesës anësore të kamionit.

Er putzt **mir** die Schuhe./ Ai më pastron këpucët.

e)qëllimin e veprimit:

Er lebt nur **seiner Arbeit**./ Ai jeton vetëm prej punës së tij.

5.Kundrina me parafjalë

5.1.Vështrim i shkurtër historik i kundrinës me parafjalë

Parafjalët e gjuhës gjermane janë të palakueshme dhe nuk mund të qëndrojnë vetëm si gjymtyrë fjalie. Funkzioni i tyre është të lidhin fjalë (zakonisht emra ose përemra) ose togfjalësha mes tyre. Termi 'Präposition/ parafjalë' vjen nga latinishtja 'praepositio' dhe në gjuhën gjermane përkthehet i paravendosur. Në gramatikën shkollore mund të ndeshen dhe me termin 'Verhältniswörter' ose 'Vorwörter', në disa gramatika dhe si 'Fallfügeteile', 'Lagewörter' apo 'Fügewörter'. Megjithë morinë e termave, në pjesën më të madhe të teksteve të hulumtuar për këtë punim, përdorim më të gjerë gjen termi i huazuar nga latinishtja 'Präposition/ parafjalë'.

Gjatë hulumtimit të bërë për kapitullin e parë të këtij punimi, në gramatikat e gjuhës gjermane të shekullit të XX, u vu re se termi kundrinë me parafjalë nuk ekziston. Natyrisht që kundrinat me parafjalë ekzistonin që në atë kohë, por gjuhëtarët e kësaj periudhe nuk arritën ti dallonin ato dhe ti ndanin nga gjymtyrët e tjera. Një pjesë prej tyre pranojnë se parafjalët sundojnë një rasë të caktuar gjinore, dhanore, kallëzore ose dhanore dhe kallëzore, por i rendisin tek rrethatorët duke mos e bërë dot dallimin mes tyre.

Bekeri ishte i pari gjuhëtar i cili shprehet se raporti në fjali mund të jepet dhe me anë të një kundrine, ai e quan atë dhe objektiv me anë të një një parafjale. Por dhe ai nuk bën dot dallimin mes kundrinës me parafjalë dhe rrethatorëve, duke i futur në të njëjtën kategori.

Friedrich Bauer përmend në gramatikën e tij të ashtëquajturit sipas tij 'Verhältnisobjekte' (bëhet fjalë për kundrinën me parafjalë), të cilat i përmend tek kreu i kundrinës. Ai gjithashtu është i pari që cek dallimin mes një 'Verhältnisobjekt' dhe

rrethanorit. Ai është gjuhëtari i parë gjerman, që e dalloi kundrinën me parafjalë nga gjymtyrët e tjera dhe i dha asaj një vend të veçantë.

Por termin e përdorur dhe sot në gramatikën tradicionale ‘Präpositionalobjekt’/ kundrinë me parafjalë e gjejmë për herë të parë shumë vite më vonë, tek Friedrich Blac. Ai gjithashtu bën një ndarje të qartë mes kundrinës me parafjalë dhe rrethanorit.

Nga kjo del qartë se zhvillimi i gramatikës është një proces i ngadaltë ndër shekuj, dmth procesi i krijimit të një fenomeni gramatikor, deri në pranimin dhe emërtimin e saktë të tij ndodh në një hark të gjatë kohor.

5.2. Kundrina me parafjalë që sundojnë rasën kallëzore dhe dhanore

Në gjuhën gjermane, sipas rasës që përcaktohet nga parafjala dallohen kundrina me parafjalë në rasën kallëzore dhe në rasën dhanore.²⁵¹

Er interessiert sich **für die deutsche Sprache**./ Ai interesohet për gjuhën gjermane.

Er pochte **auf sein Recht**./ Ai kërkonte të drejtën e tij.

Sie klagen **auf Schadenersatz**./ Ata ngritën padit për dëmshpërblim.

Er erkundigt sich **nach dem Bewerbungsverfahren**./ Ai interesohet për procedurën e aplikimit.

Sie steht **zu ihrem Wort**./ Ajo i qëndron fjalës së saj.

Sie begnügen sich **mit einem matten Protest**./ Ata u mjaftuan me një protestë të vakët.

“Beim Präpositionalobjekt handelt es sich um ein substantivisches oder Pronominales Satzglied mit Präposition. Dabei ist die Präposition zwar Bestandteil des Satzgliedes, aber was für eine Präposition zu stehen hat, wird von dem Wort bestimmt, von dem das Präpositionalobjekt abhängig ist./ Në rastin e kundrinës me parafjalë bëhet fjalë për një gjymtyrë emërore ose përemërore të fjalisë me një parafjalë. Parafjala është pjesë e gjymtyrës së fjalisë, por parafjala përcaktohet nga fjala nga e cila varet kundrina me parafjalë.”²⁵²

Wir hoffen **auf bessere Zeiten**./ Ne shpresojmë për kohë më të mira.

Sie dachte **an sein Versprechen**./ Ajo mendoi për premtimin e tij.

Kundrina me parafjalë përbëhet si rregull nga një parafjalë me një emër, përemër ose togfjalësh.:

²⁵¹Shih aneksin në fund të punimit

²⁵²Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 577

Sie hatte Angst **vor Fremden**./Ajo kishte frikë nga të huajt.

Sie hatte Angst **vor ihnen**./ Ajo kishte frikë prej tyre.

Sie dachten **an die schönen Winterferien im Schwarzwald**./ Ato mendonin për pushimet e bukura në pyllin e zi.

Ndryshe nga llojet e tjera të kundrinave, te kundrina me parafjalë folja nuk përcakton një rasë, por një parafjalë të caktuar. Në këtë rast parafjala ka një funksion të ngjashëm me atë të rasës, d.m.th kundrina me parafjalë pasohet nga eptimi i një rase të caktuar që nuk varet direkt nga folja, por jepet me ndihmën e një parafjale. Kjo parafjalë nuk mund të zgjidhet, por është e lidhur ngushtë me foljen.:

Denken an etwas/ jemanden/ të mendosh për diçka/ dikë

achten auf etwas/ jemanden/ të kujdesesh për diçka/ dikë

Angst haben vor etwas/ jemandem/ të kesh frikë nga diçka/ dikush

sich fürchten vor etwas/ jemandem/ të trembesh nga diçka/ dikush

Një numër i vogël foljesh në gjuhën gjermane lejojnë zgjedhjen mes dy parafjalëve.:

Klaus schimpft **auf Hans**./ Klaus i qorton Hansin.

Klaus schimpft **über Hans**./ Klaus i ankohet për Hansin.

“ *Eine große Anzahl von Verben verlangt die Kennzeichnung des Objekts durch Präpositionen. Objekte die mit solchen losen Morphemen gekennzeichnet sind, bezeichnet man als Präpositionalobjekte.*./ Një numër i madh foljesh e kërkojnë kundrinën me parafjalë. Kundrinat, të cilat përcaktohen nga morfema të tilla të lira quhen kundrina me parafjalë.”²⁵³:

Ich warte **auf meinen Freund**./ Unë pres shokun.

Wir rechnen **mit deinem Besuch**./ Ne presim vizitën tënde.

Er lebt **von Handel**./ Ai jeton nga tregëtia.

Sie leidet **an schwerem Astma**./ Ajo vuan nga një azëm e rëndë.

Ihr lacht **über mich**./ Ju qeshni me mua.

Sie siegten **über den Feind**./ Ata triumfuan mbi armikun.

Ashtu si kundrina e rasës dhanore dhe ajo e rasës gjinore, gjatë kthimit të fjalisë në pësore, kundrina me parafjalë nuk pëson asnjë ndryshim.:

Man wartete **auf die ausländischen Gäste**./ Presim për miqtë e huaj.

Auf die ausländischen Gäste wurde gewartet./ Për miqtë e huaj u prit.

²⁵³Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 243

Në rastin e emëzimit të foljes së fjalisë kundrina me parafjalë mund të kthehet në përcaktor me parafjalë.:

Die Regierung hofft **auf bessere Beziehungen**/ Qeveria shpreson për marrëdhënie më të mira.

Die Hoffnung der Regierung auf bessere Beziehungen./ Shpresa e qeverisë për marrëdhënie më të mira.

Kundrinat me parafjalë nuk mund të gjenden vetëm me anë të një përemri pyetës si kundrinat e tjera. Parafjala e përcaktuar nga folja haset ose si fjalë më vete ose si pjesë e një togfjalëshi përemëror në pyetjet që drejtojmë për të përcaktuar kundrinën me parafjalë. Në rastet kur emri i kundrinës me parafjalë përcakton një frymor, pyetja bëhet me anë të parafjalës e ndjekur nga përemri pyetës ‘wen?/ kë?’ apo ‘wem?/ kujt?’ në varësi të rasës së përcaktuar nga parafjala:

Er hat Angst **vor Fremden**./ Ai ka frikë nga të huajt.

Vor wem hat er Angst?/ Nga kush ka frikë ai?

Er denkt **an seine Freunde**./ Ai mendon për shokët e tij.

An wen denkt er?/ Për kë mendon ai?

Në rastet kur emri i kundrinës me parafjalë përcakton një send apo abstrakt, pyetja bëhet me anën e një ndajfolje pronominale:

Er hat Angst **vor der Dunkelheit**./ Ai ka frikë nga errësira.

Wovor hat er Angst?/ Nga se ka frikë ai?

Er denkt **an die Winterferien**./ Ai mendon për pushimet e dimrit.

Woran denkt er?/ Për çfarë mendon ai?

Shpesh fjalitë e nënrenditura apo ato me paskajore mund të zëvendesohen me kundrinën me parafjalë. Në këto raste parafjala e kërkuar nga folja eliminohet:

Er hat Angst, **seinen Fehler zuzugeben**.(= Er hat Angst **vor dem Zugeben** seines Fehlers)

Ai ka frikë të pranojë gabimin e tij./ Ai ka frikë nga pranimi i gabimit të tij.

Wir zweifeln, **ob dies die richtige Lösung ist**.(= Wir zweifeln **an der Richtigkeit** dieser Lösung).

Ne dyshojmë, nëse kjo është zgjidhja e saktë./ Ne dyshojmë në saktësinë e zgjidhjes.

Nganjëherë kundrina me parafjalë mund të transformohet në një kundrinë rase.:

Er schreibt **an seinem Vater**./ Ai i shkruan babait.

Er schreibt **seinem Vater**./ Ai i shkruan babit. (kundrinë e rasës dhanore)

Sie erinnert sich **an der Befreiung**. Asaj i kujtohet çlirimi.

Sie erinnert sich **der Befreiung**./ Asaj i kujtohet çlirimi. (kundrinë e rasës gjinore)

Gjithashtu shpeshherë kundrina me parafjalë zëvendëson dhe kundrinën tashmë në zhdukje të gjinorës.:

Er vergewisserte sich (**davon**), dass alle Türen geschlossen waren/ Ai u sigurova që të gjithë dyert ishin të mbyllura. (sich von etwas vergewissern/ të sigurohesh për diçka, në vend të, sich einer Sache vergewissern/ të sigurohesh për një gjë)

Ich schämte mich (**dafür**), ihn nicht wiedererkannt zu haben./ Më erdhi turp, që nuk e njoha. ('sich für etwas schämen'/ të të vijë turp për diçka, në vend të, 'sich einer Sache schämen'/ të të vijë turp nga një gjë).

Në raste mjaft të rralla kundrina me parafjalë, mund të drejtohet nga një mbiemër.:

Wir sind **auf eure Mithilfe angewiesen**./ Na nevojitet ndihma juaj.

Er war **an sein Gelübde gebunden**./ Ai ishte i lidhur pas premtimeve të veta.

“Ebenso verlangen eine Reihe von Adjektiven als Modalergänzung ein Präpositionalobjekt. Diese Präpositionalobjekte können manchmal auch nachgestellt werden./ Gjithashtu një sërë mbiemrash si rrethorë mënyre kërkojnë një kundrinë me parafjalë. Këto kundrina me parafjalë nganjëherë mund të vendosen mbrapa.”²⁵⁴:

Ich bin **über den Erfolg froh**./ Jam i lumtur për suksesin.

Sie ist **auf schwere Arbeit gefaßt**./ Ajo është e prerë për punë të vështirë.

Er ist **frei von Sorgen**./ Ai nuk ka halle.

Sie sind **stolz auf ihre Schönheit**./ Ato janë krenare për bukurinë e tyre.

Kundrinat me parafjalë mund të shfaqen në fjali të vetme, ose bashkë me kundrina të rasës dhanore, kallëzore, apo kundrina të tjera me parafjalë:

Der Reisende dankt **dem Schaffner für seine Hilfe**./ Udhëtari falënderon faktorinon për ndihmën e tij.

Er erkundigte sich **nach dem Namen der Stadt**./ Ai u interesua për emrin e qytetit.

Der Einheimische warnt **den Bergsteiger vor dem Unwetter**./ Vendasi i paralajmëron alpinistët për kohën e keqe.

Er beschwert sich **bei den Nachbarn über den Lärm**./ Ai ankohet tek komshinjtë për zhurmën.

“Verschiedene Präpositionen als Objektszeichen signalisieren verschiedene Verbinhalte./ Parafjalë të ndryshme kur përdoren si kundrina sinjalizojnë nuanca të ndryshme kuptimore të foljeve.”²⁵⁵:

²⁵⁴Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f. 244

²⁵⁵По аты

Die Kinder freuen sich **über das schöne Wetter**./ Fëmijët gëzohen për kohën e bukur.
Kuptimi në këtë rast është: Sot është kohë e bukur.

Die Kinder freuen sich **auf die Ferien**./ Fëmijët i gëzohen pushimeve.

Kuptimi në këtë rast është: Ata i presin me gezim pushimet e ardhshme.

Er hat **über seine Reise** gesprochen./ Ai foli rreth udhëtimit të tij.

Kuptimi në këtë rast është: Ai tregoi me hollësi rreth udhëtimit të tij.

Er hat **von seine Reise** gesprochen./ Ai foli për udhëtimin e tij.

Kuptimi në këtë rast është: Ai tregoi se ka bërë ose do të bëjë një udhëtim.

Nuk është gjithmonë e lehtë të dallosh nëse bëhet fjalë për një kundrinë me parafjalë, pasi jo të gjitha gjymtyrët e fjalisë që shoqërohen me parafjalë janë kundrina. Ato shpesh mund të ngatërrohen me rrethatorët. Kjo çështje është trajtuar në mënyrë të detajuar në një nga nënkrerët e mëparshëm.

Ndryshimi kryesor është se kundrina me parafjalë është e lidhur ngushtësisht me foljen. Përsa i përket anës semantike rrethatorët shprehin vendin, kohën, mënyrën apo shkakun e një ngjarje. Pyetjet për të përcaktuar rrethatorin janë: wo?/ ku?, wann?/ kur?, wie?/ si?, weswegen?/ pse?. Ato nuk shoqërohen nga parafjala si në rastin e kundrinës. Në rastin kur kemi të bëjmë me kundrinë, parafjala nuk mund të zëvendësohet me një parafjalë tjetër (përveç rastit të foljeve që marrin më shumë se një parafjalë), ndërsa në rastin kur kemi të bëjmë me rrethator mund të përdoren parafjalë të ndryshme. Pra parafjala tek kundrina me parafjalë është e pazëvendësueshme dhe e kushtëzuar nga folja. Kjo e fundit mund të jenë të lidhura ngushtë me një apo më shumë parafjalë.

Er wartet **auf den Freund**./ Ai pret shokun e tij. (Auf wen wartet er?/ Kë pret ai?
Shokun= Kundrinë)

Er wartet **auf/ vor/ neben/ hinter dem Bahnhof**./ Ai pret në/ para/ pranë/pas stacionit të trenit. (Wo wartet er?/ Ku pret ai? = rrethator vendi)

Sie bittet dich **um deine Uhr**./ Ajo të lutet ty për orën tënde. (Auf was bittet sie dich?/
Për çfarë të lutet ajo ty? Për orën= kundrinë)

Sie kommt **um ein Uhr**./ Ajo do të vijë në orën një. (Wann kommt sie?/ Kur vjen ajo?
Në orën një= rrethator kohe)

Megjithatë kjo mbetet ende një temë “e nxehtë” në gramatikën e gjuhës gjermane. Vlen të theksohet se ndryshimin mes kundrinave me parafjalë dhe rrethatorëve e ndeshim tek të gjitha veprat gramatikore bashkëkohore, pavarësisht teorisë gramatikore apo këndvështrimit që ato përfaqësojnë. Dallimi mes kundrinave me parafjalë dhe rrethatorëve është problematik dhe në mësimin e gjuhës së huaj dhe ceket gjithashtu dhe nga pjesa më e madhe e metodave bashkëkohore.

Ndërsa sipas Shulc/ Grizbah mjaft i lehtë dhe joproblematik është dallimi i kundrinës me parafjalë nga pjesëza e foljes (Verbzusatz). Këtë ata e ilustrojnë si vijon²⁵⁶:

Die Betrüger wollen ihn **um sein Geld bringen**./ Mashtruesit duan të arrijnë tek paratë e tij. (kundrinë me parafjalë)

Die Räuber wollen ihn **umbringen**./ Hajdutët duan ta vrasin. (Pjesë e foljes)

Er gewohnt sich **an das Klima**./ Ai është mësuar me klimën. (Kundrinë me parafjalë)

Er **gewöhnt sich** das Rauchen **an**. (Pjesë e foljes)

Die Kinder hören **auf ihre Eltern**./ Fëmijët dëgjojnë prindërit. (Kundrinë me parafjalë)

Der Regen **hört auf**./ Shiu pushon. (Pjesë e foljes)

Er strebt **nach Reichtum**./ Ai synon pasuri. (Kundrinë me parafjalë)

Er **strebt** seinem Meister **an**./ Ai synon të arrijë mjeshttrin e tij. (Pjesë e foljes)

5.3. Pjesët e ligjëratës më të cilat mund të shprehet kundrina e me parafjalë:

-Me emër shoqëruar me parafjalë:

Er hatte Angst **vor Fremden**./ Ai kishte frikë nga të huajt.

-Togfjalësh me parafjalë:

Wir dachten **an die schönen Sommerferien im Schwarzwald**./ Ne mendonim për pushimet e bukura verore në Zhvarcvald.

-Përemër shoqëruar me parafjalë:

Er hatte Angst **vor ihnen**./Ai kishte frikë prej tyre.

Në rastet kur emri i kundrinës me parafjalë përcakton një frymor, ai mund të zëvendësohet me një përemër vetor:

Er hat Angst **vor Fremden**./ Ai ka frikë nga të huajt.

Er hat Angst **vor ihnen**./ Ai ka frikë nga ata.

Ndërsa në rastet kur i referohet një sendi apo abstrakti emri i kundrinës me parafjalë mund të zëvendësohet me një ndajfolje përemërore (Pronominaladverb):

Er hat Angst **vor der Dunkelheit**./ Ai ka frikë nga errësira.

²⁵⁶Po aty

Er hat Angst **davor**./ Ai ka frikë prej saj.

-Fjali të nënrenditur

Në rastet kur fjalia e nënrenditur mbart funksionin e një kundrine me parafjalë, ajo mund të përfaqësohet me anë të një ndajfolje pronominale **da (r)** në fjalinë kryesore, i cili luan rolin e korrelatit. Në varësi të foljes, korrelati mund të jetë i detyrueshëm ose fakultativ.:

Sie zweifelt (**daran**), dass er die Wahrheit sagt./ Ajo dyshon se ai nuk thotë të vërtetën. Er war (**damit**) einverstanden, früher wegzufahren./ Ai ishte dakort të ikte më herët. Ich ärgere mich (**darüber**), dass ich den Bus verpasst habe./ U inatosa për faktin se humba autobuzin.

Die Studenten hatten sich **damit** abgefunden, dass sie es nie schaffen würden./ Studentët janë mësuar me idenë që nuk do e arrijnë kurrë atë gjë.

Wir reden **darüber**, wie wir das Problem lösen sollen./ Ne bisedojmë se si mund ta zgjidhim problemin.

Sie beharrt **darauf**, ihren Sohn jede Woche sehen zu dürfen./ Ajo pretendon të lejohet ta shohë djalin e saj çdo javë.

6. Kundrina e rasës gjinore

Kundrina e rasës gjinore shprehet me anë të një gjymtyre në rasën gjinore. ‘Genitiv’/ gjinore vjen nga fjala latine ‘generis’ që do të thotë gjini ose prejardhje. Për shkak të radhitjes tradicionale të rasave ajo quhet dhe ‘2. Fall/ rasa e dytë’ ose për shkak të pyetjes analitike që përdoret për ta identifikuar quhet dhe ‘Wes- Fall/ rasa e kujt’.²⁵⁷ Arsyeja pse po e trajtoj në fund të këtij kreu është se, ajo përdoret mjaft rrallë në gjuhën e sotme gjermane.:

Man verwies ihn **des Landes**./ Atë e përzunë nga toka.

Ich erinnere mich **ihrer**./ Më kujtohet ajo.

“Wie stark der Geniv auch in der jüngeren Geschichte des Deutschen an Verbreitung verloren hat, zeigt ein Blick in die Grammatik von Friedrich Blatz (Ende des 19. Jahrhundert) die eine Liste von fast 160 Genitivverben enthält. Wenn man den Bestand des 19. Jahrhundert mit dem von heute vergleicht, dann zeigt sich, dass es ein Teil dieser Verben einfach verschwunden ist. Einige von diesen Verben sind zum Akkusativ z.B. vergessen, entbehren, brauchen und andere zum Präpositionalobjekt z.B. warten auf, achten auf, hoffen auf./ Një vështrim në gramatikën e Fridrich Blac (fundi i shekullit të XIX, e cila përmban një listë prej 160 foljesh, tregon sa shumë terren ka humbur gjinorja në historinë e kohëve të fundit të gjuhës gjermane. Nëse e krahasojmë listën e shekullit XIX me ditët e sotme, vërehet se një pjesë e këtyre foljeve thjesht janë

²⁵⁷Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 153

zhdukur. Disa prej tyre janë kthyer në folje që kërkojnë kundrinë të rasës kallëzore, p.sh. harroj, duroj, nevojitet, ndërsa disa të tjera kundrinë me parafjalë, p.sh. pres për, kujdesem për, shpresoj për.”²⁵⁸

Dyrshajd shprehet gjithashtu se gjinorja si kundrinë rase ndeshet gjithnjë e më rrallë, duke qenë se tendenca e zhvillimit të gjuhës gjermane po shkon drejt sistemit me tre rase. Për këtë në hierarkinë e rasës sipas saj gjinorja zë vendin e fundit.²⁵⁹ Në gjuhën e folur në Gjermani ajo përdoret mjaft rrallë. Ndërsa vërehet se në Austri, në Gjermaninë jugore dhe në Zvicër ajo nuk përdoret fare në gjuhën e folur, duke qenë se folësit kanë tendencë për të mos i përdorur foljet që sundojnë rasën gjinore.

Në ditët e sotme egzistojnë vetëm rreth 50 folje të cilat sundojnë rasën gjinore.”...*dazu kommen noch einige Adjektive z.B. ‘des Wartens überdrüssig sein’ und komplexe Prädikate mit substantivischen Kern. Zahlreiche Genitivverben sind heute nicht mehr frei verwendbar, sondern kommen fast nur in festen Wendungen vor wie z.B. ‘eines Amtes walten’, ‘der Ruhe pflegen’./...atyre i shtohen dhe disa mbiemra, p.sh. ‘të ka ardhur pritja në majë të hundës’ dhe kallëzues të përbërë me bërthamë të emëruar. Shumë prej foljeve që sundojnë rasën gjinore nuk janë fakultative, por ndeshen pothuaj vetëm në shprehje të ngurta si psh. ‘të bësh detyrën’; ‘të bësh pushim’”.²⁶⁰*

Die Kunden waren **des Wartens überdrüssig**./ Klientëve u kush ardhur pritja në majë të hundës.

Da fand sich kein Richter, der **seines Amtes walten** wollte./ Nuk u gjet një gjykatës, që të donte të bënte detyrën.

Man konnte sie nicht erreichen nur wenn sie untätig waren, oder **der Ruhe pflegten**./ Nuk mund ti gjeje vetëm kur nuk punonin ose kur bënin pushim.

Kundrina e rasës gjinore gjendet me anë të pyetjes analitike ‘wessen?/ i kujt?’:

Ich gedenke **ihrer**. Wessen gedenkst du?= ihrer/Unë përkujtoj atë. Kë përkujton ti?= atë.

Er beschuldigt mich **des Diebstahls**./ Wessen beschuldigt er?= mich./ Ai më akuzon mua për vjedhje. Kë akuzon ai?= mua.

Ajo nuk pëson asnjë ndryshim gjatë kthimit të fjalisë në pësore.:

Die Bevölkerung gedachte **der Befreiungskämpfer**./ Populli përkujtonte luftëtarët e lirisë.

²⁵⁸Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik*. Bd. 2: Der Satz. 3., durchges. Aufl. – Stuttgart, Weimar: Metzler, 2006b, f. 300

²⁵⁹Dürscheid, Christa: *Die verbalen Kasus des Deutschen. Untersuchungen zur Syntax, Semantik und Perspektive*. – Berlin, New York: de Gruyter (studia linguistica germanica 53), 1999, f. 34- 36

²⁶⁰Po aty

Der Befreiungskämpfer wurde gedacht./ U përkujtuan luftëtarët e lirisë.

Kundrina e rasës gjinore mund të shfaqet e vetme në fjali në rastin kur sundohet nga foljet ‘gedenken, bedürfen, entraten, harren’/ ‘përkujtoj, nevojitet, pres’ si dhe nga folje refleksive.

Ich harre **seiner**./ Unë pres atë.

Unsere Abteilung kann sich seiner Tradition rühmen./ Departamenti ynë shquhet për traditë.

Ajo mund të shfaqet dhe së bashku me një kundrinë të rasës kallëzore. Në këtë rast kundrina kallëzore i referohet një frymori, ndërsa ajo e rasës gjinore një sendi.:

Der Richter beschuldigte **den Angeklagten des Diebstahls**./ Gjykatësi e shpalli të akuzuarin fajtor për vjedhje.

“An Stelle von früher üblichen Genitivobjekten finden sich in der heutigen deutschen Gegenwartsprache das Akkusativobjekt (der Akkusativ konnte sich nur auf Kosten des Genivs ausbreiten) und besonders das Präpositionalobjekt.”/ Në vend të kundrinave të hershme të rasës gjinore, në gjuhën e sotme gjermane ndeshen shpesh kundrina të rasës kallëzore (kallëzorja mundi të përhapet vetëm në kurriz të gjinores) dhe veçanërisht kundrina me parafjalë.²⁶¹:

Uns ermangelt **der Übung**. → Uns ermangelt **die Übung**./ Ne na mungon praktika.

Er bedarf **des Trostes**. → Er bedarf **den Trost**./ Ai duhet ngushëlluar.

Er entbehrt **der Hilfe**. → Er entbehrt **die Hilfe**./ Atij nuk i duhet ndihma.

Er erinnert sich **seines Freudes**. → Er erinnert sich **an seinen Freund**./ Atij i kujtohet shoku i tij.

Ich schäme mich **seines Verhaltens**. → Ich schäme mich **über sein Verhalten**./ Mua më vjen turp nga sjellja e tij.

Er erinnert sich **seines Freundes**. → Er erinnert sich **an seinem Freund**./ Atij i kujtohet shoku i tij.

Er beschuldigte sie **des Mordes**. → Er gab ihr die Schuld **an das Mord**/ Ai e akuzoi atë për vrasje.

Ashtu si kundrina e rasës dhanore dhe ajo me parafjalë, dhe kundrina e rasës gjinore kthehet në përcaktor në rastin e emëzimit të foljes së fjalisë.:

²⁶¹Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, 610

Sie erinnern sich **des Befreiungstages**./ Ata kujtojnë ditën e çlirimit.

Ihre Erinnerung **an den Befreiungstag**./ Kujtimi i tyre i ditës së çlirimit.

Ashtu si tre kundrinat e tjera, kundrina e rasës gjinore përveç se nga folja, mund sundohet dhe nga një mbiemër.:

Er ist **dieser Tat** nicht fähig./ Ai nuk mund ta bëjë këtë gjë.

Sie ist sich **seiner Unterstützung** sicher./ Ajo është e sigurtë për mbështetjen e tij.

Ich bin mir **desen** bewusst./ E kam të qartë këtë.

Er ist **des Lesens** nicht kundig./ Ai nuk ja thotë për lexim.

Sie ist **der Tat** verdächtig./ Ajo dyshohet të ketë kryer krimin.

Er war **ihrer** nicht würdig./ Ai nuk ishte i denjë për të.

6.1.Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e rasës gjinore:

-Emër në rasën gjinore:

Der Dieb bemächtigte sich **des Geldes**./ Hajduti mori lekët.

Der junge Erwachsene war **des Autofahrens** mächtig./ I riu ishte në gjendje ti jepte makinës.

-Përemër në rasën gjinore:

Ich erinnere mich **seiner**./ Më kujtohet ai.

Wir gedenken **ihrer**./ Ne përkujtojmë ata.

-Togfjalësh:

Ich gedenke **der schönen Zeit** mit dir./ Unë kujtoj kohën e bukur që kalova me ty.

Er bemächtigte sich **des gesamten Bargeldes**./ Ai mori të gjitha paratë.

Pjesë të emëruara të ligjëratës:

Man bezichtigte ihn **des Verrats**./ Ai u akuzua për tradhëti

Das Unfallopfer bedarf **der Hilfe**./ Viktima e aksidentit ka nevojë për ndihmë.

-Fjali e nënrenditur

Ich gedenke, **wessen ich will**./ Unë përkujtoj kë të dua.

a)Fjali relative

Ich erinnerte mich, **dass ich noch etwas einkaufen musste.**/ U kujtova se duhej të blija dhe diçka.

-b)Paskajore të zgjeruar:

Ich erinnere mich, **ihn gesehen zu haben.**/ Më kujtohet që e kam parë.

Er bezichtigte sie dessen, **ihre Ideale verraten zu haben.**/ Ajo e akuzoi atë se kishte harruar idealet e saj.

“Im Unterschied zu den Dativobjekten werden Relativsätze ohne Beziehungswort bei Genitivobjekten gewöhnlich vermieden./Në ndryshim nga kundrinat e rasës dhanore, fjalitë relative pa fjalë referuese (Beziehungswort) zakonisht evitohen.²⁶²:

Sie entsann sich mühelos, **wessen** sie wollte./ Ajo kujtonte pa mundim çdo njeri që dëshironte.

Më tej ata shprehën se në rastin e kundrinës së rasës gjinore preferohen fjalitë relative me përemrin dëftor ‘dessen’ si korrelat, si dhe fjali të tjera të nënrenditura dhe paskajore të zgjeruara (erweiterte Infinitive).²⁶³:

Sie entsann sich dessen, **was er ihr gesagt hatte.**/ Asaj iu kujtua ajo që i kishte thënë ai.

Sie entsann sich dessen, **daß er noch zu kommen beabsichtigte.**/ Ajo harroi se ai kishte ndër mend të vinte.

Sie bezichtigte ihn dessen, **seine Ideale verraten zu haben.**/ Ai e akuzoi atë se kishte harruar idealet e tij.

Foljet entsinnen/ harroj dhe bezichtigen/ akuzoj, kanë sundim të dyfishtë. Ato mund të sundojnë dhe fjali të nënrenditura, si dhe paskajore të zgjeruara si kundrina të drejta. Në këtë rast nuk nevojitet korrelati në fjalinë kryesore.:

Sie konnte sich nicht entsinnen, **wann sie ihn zuletzt gesehen hatte.**/ Asaj nuk i kujtohej kur e kishte parë atë për herë të fundit.

Sie bezichtigte ihn, **seine Ideale verraten zu haben.**/ Ajo e akuzoi atë se kishte tradhtuar idealet e tij.

6.2. Nuancat semantike të kundrinës së rasës gjinore.

Kundrinën e rasës gjinore e ndeshim kryesisht:

- në stilin arkaik letrar:

²⁶²Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 336

²⁶³Po aty

Man beklagte ihn **des Verrates**./ Atë e akuzuan për tradhti.

Sie konnte sich **seiner** nicht entsinnen./ Ajo nuk e mbante mend atë.

-në disa shprehje të ngurta (feste Wendungen)

Wir hatten nicht so einen hohen Anspruch an das Hotel, wurden daher **eines Besseren belehrt**./ Ne nuk kishim shumë pritshmëri të larta për hotelin, kështu që u surprizuam pozitivisht.

Er belehrte sie **des Tanzen**./ Ai i mësoi asaj të vallëzonte.

Sie erfreut sich **besten Gesundheit**./ Ajo gëzon shëndet të plotë.

- ndërtime refleksive (Reflexivkonstruktionen):

Er bediente sich **ihrer Kontakte**, um eine Machtposition zu erlangen./ Ai shfrytëzoi njohjet e saj për tu ngritur në detyrë.

Du hast dich **eines guten Stils** befleißigt/ Ti je kujdesur për të patur një pamje të kuruar.

-në gjuhën juridike, kryesisht tek disa folje që përveç rasës kallëzore sundojnë dhe gjinoren. Në këtë rast bëhet fjalë për të ashtëquajturin gjinore e krimi (genitivus criminis)²⁶⁴:

Sie werden **des Mordes** beschuldigt/ Ata akuzohen për vrasje

Er wurde gestern **eines Verbrechers** überführt./ Ai u akuzua dje për një krim

Nga paraqitja e kundrinave në gjuhën gjermane në këtë kre shihet se të katër kundrinat e gjuhës gjermane përveç ndryshimeve, kanë dhe mjaft të përbashkëta mes tyre.

Në kreun në vijim do shqyrtohen në mënyrë të hollësishme kundrinat në gjuhën shqipe duke evidentuar dhe aty të përbashkëtat dhe ndryshimet mes tyre.

²⁶⁴Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994, f. 591

KREU V - KUNDRINA NË GJUHËN SHQIPE

1. Gjymtyrët e dyta të fjalisë dhe roli i tyre.

Sipas funksioneve që përmbushin, duke u nisur nga kriteret strukturore e kuptimore që ato përmbushin, në gjuhën shqipe dallohen dy lloje gjymtyrësh:

1. Gjymtyrë kryesore të fjalisë ku bëjnë pjesë kryefjala e kallëzuesi, të cilat shihen si qendra të fjalisë, lidhja mes të cilave përbën dhe bërthamën e saj.

2. Përveç gjymtyrëve kryesore që janë kryefjala dhe kallëzuesi, në të shumtën e rasteve, fjalitë kanë edhe gjymtyrë të tjera. *“Gjymtyrët që plotësojnë gjymtyrët kryesore, i përcaktojnë më tej ato, lidhen me to nga ana kuptimore dhe strukturore, quhen gjymtyrë të dyta. Ato bëjnë që mendimi i shprehur në fjali të përcaktohet më nga afër, të shtjellohet me më shumë hollësi, me informacion më të pasur, shpeshherë më të plotë.”*²⁶⁵

Vlen të theksohet se emërtimi ‘gjymtyrë kryesore’ dhe ‘gjymtyrë e dytë’ nuk ka të bëjë me peshën që ato kanë në kuptimin e dhënë, por me rolin (funksionin) që ato luajnë në organizimin e fjalisë. *Kryefjala dhe kallëzuesi quhen gjymtyrë kryesore, se janë bërthama organizuese e fjalisë, përcaktojnë ndërtimin e kësaj njësie sintaksore dhe lidhjet sintaksore që vendosen në të, kurse gjymtyrët e dyta quhen kështu jo se shprehin gjithnjë të dhëna të dorës së dytë, por se janë të varura nga gjymtyrë të tjera, shërbejnë për të plotësuar a për të sqaruar më shumë kuptimin e tyre.”*²⁶⁶

Gjymtyrët e dyta mund t’i gjejmë në të gjitha llojet e fjalive, madje dhe në ato njëkryegjymtyrëshe apo dhe në fjali të paplota. Megjithatë ato, mund të mos jenë të domosdoshme në një fjali, pavarësisht faktit se ato mund të japin informacione që e pasurojnë përmbajtjen e fjalisë. Mungesa e tyre përgjithësisht nuk do e bënte të paplotë kuptimin e fjalisë.:

Fëmijët luajtën **një copë herë** me njëri – tjetrin.

Një motorr i fuqishëm kërciste **vazhdimisht**.

Por në disa raste gjymtyrët e dyta mund të jenë shprehëse të një elementi të rëndësishëm të thënies. Në këtë rast ato mund të jenë të domosdoshme po aq sa dhe një gjymtyrë kryesore.:

Kur erdhe, o **Martin**? Mbrëmë erdhe, o **Martin**?

Në dy fjalitë e mësipërme, pyetja bëhet për kohën e ardhjes së Martinit dhe jo thjesht për ardhjen e tij. Elementi kryesor i kumtimit është rrethanori i kohës i shprehur me ndajfoljet pyetëse ‘kur’ dhe ‘mbrëmë’.

²⁶⁵ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 203

²⁶⁶ Po aty

Gjithashtu kemi dhe raste kur nga pikëpamja kuptimore dhe strukturore, gjymtyrët e dyta hyjnë në minimumin e domosdoshëm të përbërjes së fjalisë. Siç është rasti i *“kundrinës së drejtë me folje të diatezës veprorë, veçanërisht kur gjymtyra e dytë jep përmbajtjen e foljes kallëzues, kundrinën e drejtë që shënon bartësin e një gjendjeje psikike e fiziologjike, raste të tjera të veçanta të kësaj kundrine ose gjymtyrë të tjera”*.²⁶⁷:

Gjatë diskutimit tunde **këmbën**.

Nëse do të hiqnim gjymtyrën e dytë, ‘këmbën’, fjalia do ishte e paplotë nga ana strukturore dhe do mbetej pezull nga ana kuptimore. E njëjta gjë vlen dhe për fjalitë në vijim.:

Përmendi **motrën**.

Më hahet.

Merret **me politikë**.

I ishte futur **punës**.

I ngjante së **ëmës**.

1.1.Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta.

Gjymtyrët e dyta janë në raporte varësie me gjymtyrët të cilave i referohen, si nga ana strukturore, ashtu dhe nga ana kuptimore. Këto raporte sintaksore bëjnë përcaktimin e funksioneve të ndryshme të gjymtyrëve të dyta dhe njëkohësisht i dallojnë ato në kategori të ndryshme.

Në raport me gjymtyrët që plotësohen prej tyre, gjymtyrët e dyta lidhen me to me anë të lidhjes së përshtatjes, së plotë apo të pjesshme = përcaktori; lidhjes së drejtimit, të drejtëpërdrejtë a parafjalor = kundrina; ose me anë të bashkimit të thjeshtë, apo pranëvënies = rrethanori. *“Drejtimit quhet lidhja sintaksore nënrenditëse në të cilën përdorimi i formave rasore, me ose pa parafjalë, të fjalës së drejtuar, është i kushtëzuar nga kuptimi gramatikor ose leksiko-gramatikor i fjalës drejtuese.”*²⁶⁸

*“Përcaktimi i mënyrës përkatëse të lidhjes varet nga funksioni i gjymtyrës së dytë, pra nga lloji i raporteve sintaksore të shprehura nëpërmjet saj, nga natyra gramatikore, e kësaj gjymtyre ose e gjymtyrës së përcaktuar nga ajo, ndonjëherë dhe nga semantika e përcaktuar e njëjës, apo e tjetrës.”*²⁶⁹

²⁶⁷ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 204

²⁶⁸ Prifti, Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1972, f. 50

²⁶⁹ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 207

Në mënyrë që të kemi një përcaktim dhe klasifikim sa më të saktë të gjymtyrëve të dyta, duhet të bazohemi si tek përmbajtja ashtu dhe tek forma, pra duhet të mbështetemi edhe në raportet kuptimore, dhe në veçoritë gramatikore, duke u nisur nga të parat. Duhet të vështrohet kështu, funksioni sintaksor e raportet kuptimore të gjymtyrës, shprehja e saj morfologjike dhe format e lidhjes gramatikore me gjymtyrën e plotësuar prej saj. Duhet të merren parasysh në raste të caktuara dhe shprehja morfologjike si dhe kuptimi leksikor i gjymtyrës së plotësuar, e po ashtu dhe i vetë gjymtyrës së dytë të dhënë.

Në gjuhën shqipe, gjymtyrët e dyta ndahen në tri kategori të mëdha: përcaktorë, kundrina dhe rrethorë. Në bazë të kriterëve të ndryshme gramatikore dhe semantike, secila nga këto tre kategori u nënshtrohet nëndarjeve të ndryshme. Ky klasifikim na jep në përgjithësi mundësinë e një përshkrimi të saktë të përbërjes së strukturës së fjalisë dhe të raporteve të shprehura në kuadrin e saj.

Gjithsesi vlen të theksohet se në disa raste mund të hasen vështirësi në kuptimin dhe interpretimin e fakteve konkrete gjuhësore, duke qenë se caqet mes këtyre tri kategorive të mëdha të gjymtyrëve të dyta nuk janë gjithmonë qartësisht të dallueshme. Takimet si dhe gërshetimet kuptimore krijojnë herë herë vështirësi nga më të ndryshmet për të përcaktuar saktë gjymtyrën. Në të tilla raste siç do shihet në vijim, përcaktimi i saj duhet bërë duke diktuar vlerat kuptimore e veçoritë gramatikore zotëruese.

1.2.Vështirësi në klasifikimin e kundrinës.

Në gjuhën shqipe, gjatë përcaktimit dhe klasifikimit të materialit konkret gjuhësor, dalin shpeshherë mjaft vështirësi dhe probleme, të cilat lidhen me zbatimin e kriterëve të klasifikimit të gjymtyrëve të dyta, të përmendura në fillim të këtij kreu. Kjo vërehet veçanërisht në rastet e ndërmjetme apo sinkretike, ose në ato të asimetrisë mes formës dhe përmbajtjes. Ka kështu fakte gjuhësore që qëndrojnë mes tri katetogrive të mëdha të gjymtyrëve të dyta, kundrinave dhe rrethorëve si dhe kundrinave dhe përcaktorëve. Në disa tradita gramatikore ngushtohet rrethi i kundrinave, në të tjera, zgjerohet shumë. Për pasojë ka një numër gjymtyrësh të dyta që janë klasifikuare klasifikohen edhe sot në mënyra të ndryshme.

Për të patur një klasifikim sa më të saktë të tyre, në rradhë të parë duhen parë funksionet, raportet kuptimore që shprehen nëpërmjet gjymtyrës në fjalë. *“Analiza e gjymtyrëve të dyta duhet të synojë të zbulojë mirë raportet në mes elementeve përbërëse të fjalisë dhe me këtë të bëjë që të kuptohet sa më mirë përmbajtja dhe struktura e kësaj njësie sintaksore; ajo duhet t’i shërbejë zhvillimit të ligjërit të shkruar e të folur, kulturës gjuhësore, përdorimit të drejtë të fjalëve e të ndërtimeve, njohjes së mendimit. Gjithashtu duhen marrë parasysh dhe veçoritë gramatikore, të cilat nganjëherë mund të jenë përcaktuese për të bërë klasifikimin e gjymtyrës.”*²⁷⁰ Në vijim do trajtohen disa raste sinkretike mes kundrinës dhe përcaktorëve, si dhe mes kundrinës e rrethorëve.

²⁷⁰Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, 217

1.2.1.Kundrinë apo përcaktor?

Të shumta janë rastet e ndërmjetme mes kundrinave dhe përcaktorëve. Në shembujt e mëposhtëm emrat foljorë, emri plotësues i rasës gjinore dhe më rrallë rrjedhore, mund të shprehë raporte kundrinore. Gjymtyra e dytë në këtë rast nuk do merret si kundrinë por si përcaktor, meqenëse gëzon të gjitha veçoritë gramatikore të përcaktorit, dhe raportet që ajo shpreh nuk janë thjesht kundrinore, por përcaktore- kundrinore.:

Pjesëmarrja aktive e **vajzave** në pasurimin e **kulturës** është shenjë e emancipimit të **shoqërisë**.

I diskutueshëm është dhe rasti i gjymtyrës së dytë me parafjalët ‘për’ dhe ‘në’, që i referohen mbiemrave dhe shënojnë kufizim, fushë të shtrirjes së nocionit të shënuar nga fjala e sqaruar, si: i aftë, i ditur, i dobishëm, i përshtatshëm, i zoti, etj. Nga disa ato merren si kundrina të zhdrejta e nga të tjerë si përcaktorë.²⁷¹:

Ndeshja ishte e vlefshme **për kupën Uefa**.

Sara ishte e dalluar **në letërsi**.

Ajo doli e aftë **për shërbimin social**.

Kjo kohë ishte shumë e përshtatshme **për korrijen e grurit**.

Një tjetër rast i ndërmjetëm mes përcaktorit dhe kundrinës së zhdrejtë është dhe gjymtyra e shprehur me emër me parafjalën **me**, e cila shënon atë çka përmban sendi i shënuar prej fjalës së plotësuar, në rastin kur ka kuptim konkret ose mbizotëron një kuptim të tillë. Këto raste anojnë më shumë nga funksioni sintaksor kundrinor.:

Më sill një gotë **me ujë**.

Hëngri një pjatë **me supë**.

Ngarkoi dy thasë **me patate**.

Gjymtyra e shprehur me një emër konkret me parafjalën **me**, e cila i referohet një emri prejfoljor dhe shënon sendin që del i lidhur me veprimin e shënuar prej këtij emri, mund të merret si kundrinë e zhdrejtë me parafjalë.:

Ishte e nevojshme njohja paraprake **me tekstin**.

Duhet bërë krahasim **me origjinalin**.

Takimi **me prindërit** ishte i përmallshëm.

²⁷¹Po aty

*“Po këtë funksion kemi dhe në rastin kur emri i plotësuar nuk është prejfoljor, por i bashkëlidhur me një folje të së njëjtës rrënjë, sidomos me emra të ndërtuar me parafjalën ‘për’ ose ‘mbi’, të cilët shënojnë thënie, veprimtari mendore, ndjesi”.*²⁷²:

Referati **për probleme** të letërsisë së vjetër shqipe u dëgjua me vëmendje të madhe.

Projekti i tij **për hidrocentralet** gjeti miratim.

U lexua së pari raporti **për gjendjen** financiare.

Dëshira **për liri** i çonte në këmbë luftëtarët.

Përnaska shprehet se *“Kundranori i zhdrejtë me parafjalë për emra foljorë u përgjigjet pyetjeve të ndërtuara me përemra pyetës të prirë nga parafjalë. Fjala është përgjithësisht për kundranorë të zhdrejtë me parafjalë që shprehin veprues, mjet, shoqëruar, objektin të cilit i afrohem ose i largohemi, etj.”*²⁷³

Nxjerrja e naftës **me mjete** moderne kushton më lirë.

Siç shihet nga shembulli i mësipërm, domethënia e kundrinës shfaqet qartë, veçanërisht kur emri foljor shoqërohet nga një përcaktor i shprehur zakonisht me një emër në rasën gjinore që shpreh kundrinën e veprimit, si ndodh me gjymtyrën ‘e naftës’ në shembullin pararendës.

Por sipas tij, në këto ndërtime, emri i sunduar prej parafjalës mund të shprehë gjithashtu edhe një përcaktor të emrit, ndaj duhet bërë dallimi me kundrinën e zhdrejtë me parafjalë. Më tej Përnaska shton se, raste të ndërmjetme por me mbisundim të marrëdhënieve kundrinore kemi kur midis gjymtyrëve të fjalisë vendosen marrëdhënie të përmbajtësit me të përmbajturin, për shembull: pjatë me supë, thes me arra, dokument me të dhëna konkrete, shportë me lule, fuçi me djathë, kacek me gjizë, kavanoz me ullinj, vozë me verë, etj.²⁷⁴

Rast kalimtar kemi edhe kur midis gjymtyrëve të fjalisë vendosen marrëdhënie të bashkimit, të lidhjes: mish me patate, mish me oriz, bukë me gjalpë, etj.

Të tilla sipas tij janë edhe ndërtimet: emër foljor ose abstrakt + parafjala (‘mbi’, ‘para’, ‘për’, etj.) + emër ose përemër, p.sh.: druajtja para profesorit, fitorja mbi armiqtë, puna për hartimin e teksteve, parësia mbi të tjerët, përgjegjësia për drejtimin e punimeve, frika para provimit, etj.

Të interpretueshme janë ndërtimet që kanë si fjalë kryesore një emër të prejardhur prej foljeve: them, shpreh, shpall dhe si fjalë të varur një emër të prirë nga parafjala ‘për’, për disa ato shprehin kundrinë dhe janë kundranorë, për të tjerë tipar dhe janë

²⁷²Po aty 218

²⁷³Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 46

²⁷⁴Po aty

përcaktorë: raport për përparimin, njoftim për bisedimet, arsyetim për dobinë e investimeve, ëndërra për të ardhmen, tregim për heronjtë.

1.2.2.Kundrinë apo rrethanor?

Egzistojnë dhe disa rastetë ndërmjetme mes kundrinave dhe rrethanorëve. “Gjymtyrë të njëjta nga ndërtimi e shprehja, të afërta dhe për nga kuptimi i përgjithshëm sintaksor, mund të merren ose merren herë si kundrina e herë si rrethanorë ose lejohet interpretimi i tyre i dyfishtë, duke luajtur rol përcaktues në këtë kontekst, por në ndonjë rast edhe kuptimi leksikor i gjymtyrës në fjalë a i gjymtyrës të sqaruar prej saj, ose edhe kushte të tjera.”²⁷⁵

Kundrina e zhdrejtë me parafjalëpër shembull mund të ketë takime, ose të gërshetohet me ngjyime rrethanore qëllimore, shkakore dhe kushtore, të cilat në disa raste mund të bëhen edhe zotëruese.:

Po përgatitet **për provimet** e janarit.

Do gëzohesha **nga ardhja** jote.

Një rast të ndërmjetëm vijohet më tej, kemi dhe në rastin e gjymtyrëve që shënojnë mjet, shoqërim e bashkim, plotësi a mungesë, objekt të thëni a të menduari etj. Siç do shohim në shembujt në vijim nuk kemi rrethana, por raporte kundrinore. Kundrinat me parafjalë në këta shembuj, në traditën tonë gramatikore, deri në vitet '60, merreshin si rrethanorë.:

Kamionët e kishin bërë fshatin duman **me pluhurin** që ngrinin.

Tok me çetën luftuan edhe shumë fshatarë.

Qerrja ishte ngarkuar **me thasë e arka**.

Ai më foli **për diçka** tjetër.

Këtë çështje e kanë trajtuar dhe Fidler/ Buhholc, në gramatikën e tyre të gjuhës shqipe, në kreun për kundrinën me parafjalë. Aty ata përcaktojnë dhe disa kritere për të bërë të mundur dallimin mes kundrinës së zhdrejtë me parafjalë dhe rrethanorëve.

“Das Präpositionalobjekt kann – im Gegensatz zur adverbialen Präpositionalgruppe – nicht durch ein Adverb ersetzt werden./ “Kundrina e zhdrejtë me parafjalë, në dallim nga togfjalëshi parafjalor ndajfoljor, nuk mund të zëvendësohet me një ndajfolje.”²⁷⁶

Më tej ata shtojnë se në ndryshim nga rastet kur kemi të bëjmë me rrethanor, në rastet kur kemi kundrinë të zhdrejtë me parafjalë, në përgjithësi parafjala nuk bart një kuptim të veçantë në vetvete.

²⁷⁵Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 219

²⁷⁶Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 438

Një tjetër kriter sipas tyre është dhe fakti se parafjalët në rastin e rrethatorëve në të dyja gjuhët zakonisht bartin një “kuptim fillestar (Grundbedeutung)” që përputhet në rrafshin leksikor.:

Llamba ndodhet (**në tavolinë, mbi tavolinë, pranë tavolinës, përpara tavolinës**).

Ndërsa në rastin e kundrinës së zhdrejtë me parafjalë pothuajse asnjëherë nuk përputhen.²⁷⁷:

Agimi (eglendiset **me natyrën**, kapet **pas gjërave të vogla**, mendon **për shokët**, merr pjesë **në konferencë**)

Gjithsesi mund të thuhet se megjithëse egzistojnë disa kritere dalluese, në disa raste kemi të bëjmë me gjymtyrë të diskutueshme, ku është e vështirë të përcaktohet saktësisht nëse bëhet fjalë për kundrinë të zhdrejtë me parafjalë apo rrethator.

2. Kundrina në gjuhën shqipe, vështrim i përgjithshëm.

Në kreun e dytë u vu re se në disa nga gramatikat të gjuhëtarëve shqiptarë si Xhuvani, Sheperi, Prifti, në gjuhën shqipe deri në vitet '70, kundrina në gjuhën shqipe përkufizohet përgjithësisht si fjala që tregon personin apo sendin mbi të cilin kalon veprimi i foljes.

Megjithatë në këto vite vërehen dhe disa përkufizime më të sakta në disa tekste shkollore si, psh., të Domi/ Hajvarit: "Kundrinë e drejtë quhet fjala që plotëson kuptimin e kallëzuesit foljor dhe tregon njerinë, kafshën a sendin, mbi të cilin bie drejt për drejt veprimi që kryen kryefjala"; "Kundrinë të zhdrejtë quajmë fjalën që tregon njerinë, kafshën a gjënë, ku tërthorazi vete e mbaron veprimi i shprehur prej foljes, d.m.th. cakun drejt të cilit shkon veprimi i fjalisë". "Kundrinë e drejtë quhet ajo fjalë që tregon frymorin a sendin mbi të cilin bie drejtpërsëdrejti veprimi i shprehur prej foljes"; "Kundrinë e zhdrejtë quhet fjala që tregon një njeri, një kafshë ose një gjë mbi të cilën bie veprimi i foljes, por jo drejtpërdrejt."²⁷⁸

Por nga ana tjetër, kundrina njehsohet me objektin "mbi të cilin bie a kalon veprimi i foljes". Ky tipar semantik që i është dhënë tradicionalisht kundrinës në gjuhën shqipe, ka të bëjë me një kategori të madhe të kundrinave, por nuk do të thotë patjetër se të gjithë kundrinat shprehin vetëm këtë gjë. "*Edhe në analizat e zakonshme tradicionale pranohen si kundrina gjymtyrë si këto që po nënvizohen më poshtë: 'Në hënë nuk ka jetë', 'Atij i qeshi fytyra', etj., ku kundrinat nuk shprehin kundrinën e veprimit. Ndër dy gjëra njëra duhet të pranohet si e drejtë, si e vërtetë: ose gjymtyrët e nënvizuara më sipër janë kundranorë po nuk shprehin kundranën e veprimit, ose ato nuk janë*

²⁷⁷Po aty

²⁷⁸Domi, Mahir; Hajvari, N: *Gramatika e gjuhës shqipe*, pjesa I për klasën VII të shkollës tetëvjeçare, botim i Institutit të studimeve dhe botimeve shkollore, shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1965, f. 48-49

kundranorë sepse nuk shprehin kundranën e veprimit. Deri më sot, është pranuar vetëm zgjidhja e parë. Me sa dimë, askush nuk ka pohuar se gjymtyrë të tilla kanë funksion tjetër, nuk janë kundranorë.

Pra, në më të shumtën e rasteve, kundranori shpreh objektin e veprimit, por ky tipar nuk është i mjaftueshëm për t'i renditur gjymtyrët e fjalisë ndër kundranorë.”²⁷⁹

Së pari, sipas Përnaskës ka gjymtyrë që nuk shprehin kundrinën e veprimit, por që renditen si kundrina për nga roli gramatikor që luajnë në fjali. Në këtë mënyrë del qartë dhe aspekti idiomatik i çdo gjuhe, pra edhe i gjuhës shqipe:

E vërteta është se nuk ka **shpirt** të ndarë nga trupi.

Tanit s'irrihej.

Atyre u rrëzëllinte fytyra.

Së dyti, Përnaska thekson se objekti i veprimit, në ndërtimet pësore, shprehet nga vetë kryefjala:

Më tej jeta ime u rrokullis në banalitetin e pluhurosur qytezës, përmes një monotonie gjumëndjellëse që prishej herë **nga druri** i Xhodës në shkollë, herë **nga druri** i babait në shtëpi, herë **nga druri** i të dyve bashkë.

Gjithashtu në gramatikat e gjuhës shqipe përgjithësisht pranohet që kundrina e drejtë ndërtohet me një emër, përemër, etj. që shpreh objektin mbi të cilin bie drejtazi veprimi i shprehur nga folja, kurse kundrina e zhdrejtë ndërtohet me një emër, përemër, etj. që shpreh objektin mbi të cilin bie zhdrejtazi veprimi i shprehur nga folja.

Kjo ndarje e kundrinës, sipas mënyrës së kalimit të veprimit të foljes mbi objekt vihet re dhe në shumë gramatika të hershme të gjuhës shqipe. Ndërsa kundrina me parafjalë është pranuar vetëm në një gramatikë të Justin Rrotës të botuar para çlirimit, dhe në atë të Menella Totonit dhe të tjerë më 1970 dhe të Remzi Përnaskës dhe të tjerë të botuar më 1973. Gjithashtu Mahir Domi dhe Spiro Floqi flasin për të në shkrimet e tyre.

Por sipas Përnaskës kriteri semantik që shërben për të dalluar kundrinën e drejtë nga kundrina e zhdrejtë sipas kalimit të veprimit drejtazi ose zhdrejtazi mbi objektin nuk është gjithandej i vlefshëm, së paku për shqipen. Në gjuhën shqipe ka dhe kundrina, që për të njëjtën mënyrë kalimi të veprimit dalin si do të dilte kundrina gjegjëse, madje

²⁷⁹Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 24

herë si të drejta dhe herë si të zhdrejta. Kjo duket sipas Përnaskës, ndër të tjera, nga analiza e disa strukturave tepër të përdorura në gjuhën shqipe.²⁸⁰:

E ndihmoj **Dritanin**.

I ndihmoj **Dritanit**.

*"**Ja marr këngës, ia filloj punës, ia jap vrapit, ia kris gazit, ia arrij qëllimit, etj.** Në këto ndërtime thjesht shqipe, trajta e shkurtë e përemrit vetor{**i**} është analizuar si kundranor i zhdrejtë, po ashtu si edhe kundranorët e zhdrejtë **këngës, punës, vrapit, gazit, qëllimit**, kurse {**a**} është analizuar si kundranor i drejtë gjithë duke shënuar të njëjtat kundrana (objekte) si edhe {**i**} ose emrat: **këngës, punës, vrapit, gazit, qëllimit**. Kundranori i zhdrejtë është, si të thuash, dy herë "i përsëritur": një herë nga "trajta e shkurtë e përemrit vetor në dhanore njëjës" dhe së dyti nga "trajta e shkurtë e përemrit vetor në kallëzore njëjës". Nga të dyja, njëra: ose veprimi kalon në të dyja rastet drejtazi mbi kundranën ose veprimi kalon në të dyja rastet zhdrejtazi mbi kundranën."²⁸¹*

Por kur na detyron hapur nevoja..., atëherë ne nuk do të ndalemi përpara se t'ia arrijmë **qëllimit** të dëshiruar...duke përbuzur çdo farë pagjumësie dhe djerse sipas fjalës së famshme të poetit: "Puna mposht çdo gjë."

"Iso, more, iso!",- thirra dhe ia mora **asaj** të ftujkës.

Çufoja buzëqeshi dhe ia nisi **punës**.

Kur gjendej vetëm te mulliri, Kristoforidhi ia thoshte **ndonjë kënge** të vjetër.

Sipas Çelikut të tre llojet e kundrinave në shqip ndajnë disa tipare të përbashkëta, “ : *semantikisht ato lidhen drejtpërdrejt a indirekt me veprimin e foljes, duke plotësuar a kufizuar kuptimin e saj; disa shënojnë objektin e veprimit, disa thjesht përfshirësin në një veprim; kundrinorët vihen në marrëdhëniekundrinore me fjalën nga varen dhe lidhen me të me lidhje nënrenditëse drejtimi. Lidhja gramatikore e drejtimit është lidhja tipike në rastin e kundrinorëve. E përgjithshmeja e përbashkët është lidhja dyshe veprim + send, konkretisht: ose veprim + send si objekt të tij; ose veprim + send që kryen veprimin; veprim + send si përjetues të veprimit; veprim + send si të ndikuar nga veprimi; veprim + send si të lidhur në një farë mënyre me veprimin etj.* ”²⁸²

Disa folje në gjuhën shqipe sundojnë në të njëjtën fjali dhe në të njëjtën kohë edhe një kundrinë të shprehur nga një fjalë në rasën dhanore (dhe në këtë rast shpreh një gjallesë, një qenie të gjallë) edhe një kundrinë të shprehur nga një fjalë në rasën kallëzore (dhe

²⁸⁰Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 28

²⁸¹Po aty

²⁸²Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 163

në këtë rast shpreh një send, një objekt). Këto folje, kur sundojnë vetëm njërin nga këto kundrina, atëherë kundrina e drejtë e shprehur nga një fjalë në rasën kallëzore shpreh përkundrazi një gjallesë, një qenie të gjallë.

Mësuesi ia fali **gabimin studentit**.

Mësuesi e fali **studentin**.

Gjithashtu në rastet kur folja sundon dy kundrina njëri është zakonisht i drejtë dhe tjetri i zhdrejtë. Shumë rrallë mund të gjenden dy kundrina të drejta ose dy kundrina të zhdrejta. Në këtë rastin e fundit, dhanorja e parë është etike. Në rastin kur folja merr dy kundrina të drejta, njëri prej tyre duhet të shprehet me një fjali të varur kundrinore, si psh. Në rastin e foljes 'lejoj':

Nuk të lejoj të flasësh kështu.

Këto na lejojnë të pohojmë se...,

Më lejoni të ngre edhe një çështje tjetër.

Si përfundim mund të thuhet se: "*Kundrinë është gjymtyra e fjalisë që vihet në marrëdhënie objektore në kuptim të gjerë dhe që lidhet me lidhje nënrenditëse drejtimi me gjymtyrën prej së cilës varet.*"²⁸³

Sipas kumtimit dhe formës së shprehjes, kundrinat në gjuhën shqipe, në planin sintaksor, i ndajmë në kundrinë të drejtë dhe kundrinë të zhdrejtë. Kundrina e zhdrejtë është ndahet më tej në: kundrinë e zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinë e zhdrejtë me parafjalë.

Kundrina e drejtë është gjymtyrë e domosdoshme për vetë ndërtimin e fjalisë. Ajo është e vendosur në rasën kallëzore dhe shpreh zakonisht kundrinën mbi të cilën bie drejtazi veprimi i shprehur nga folja.

I dhashë **librin**.

Ndërsa kundrina e zhdrejtë e shprehur me një gjymtyrë në rasën dhanore zakonisht shpreh kundrinën mbi të cilën kalon zhdrejtazi veprimi i shprehur nga folja.

Ia dhashë **nxënësit**.

Në gjuhën shqipe kundrina e drejtë shpreh zakonisht një objekt, një send, ndërsa kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shpreh një qenie të gjallë, një njeri. Kjo vihet re dhe në rastin kur kemi në një fjali në të njëjtën kohë dy kundrina, dhe të drejtë dhe të zhdrejtë

²⁸³Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 250

pa parafjalë, kundrina e drejtë shërben për të shprehur send dhe kundrina e zhdrejtë pa parafjalë për të shprehur qenie të gjallë.

I dhashë **librin nxënësit**.

Një nga tiparet kryesor dallues mes kundrinës së drejtë e asaj të zhdrejtë pa parafjalë është ai i rasës. Kundrina e drejtë si rregull, vihet gjithmonë në rasën kallëzore, kurse e zhdrejta pa parafjalë në rasën dhanore. Ndërsa kundrina e zhdrejtë me parafjalë ka tipar kryesor dallues parafjalën ose lokucionin parafjalor që e paraprin.

Një tipar tjetër mjaft i rëndësishëm i kundrinave dhe në gjuhën shqipe është se në rastin kur kur nga një kundrinë e ndërtimeve veprorë mund të kthehet në kryefjalë të ndërtimeve pësore, kundrina është e drejtë.

Gëzimi i fitores shton **optimizmin** për fitore të reja.

Optimizmi për fitore të reja shtohet nga gëzimi i fitores.

Në rastet kur ky kthim nuk realizohet kundrina është e zhdrejtë pa parafjalë. Ndërsa kundrina e zhdrejtë me parafjalë, që shpreh vepruesin apo bërësin e veprimit, mund të kthehet në kryefjalë në ndërtimet pësore.

Kundrina e drejtë shprehet zakonisht me emra, përemra dhe pjesë të tjera të emëruara të ligjëratës në rasën kallëzore pa parafjalë.

Por kundrina e drejtë, në raste të caktuara, mund të shprehet me një emër, përemër ose pjesë tjetër të emëruar të ligjëratës në rasën rrjedhore: nuk kam ngrënë **kësi dardhash** asnjëherë.

Përnaska thekson se ky ndërtim është trajtuar më parë edhe nga gramatikat e gjuhës shqipe; është trajtuar si partitiv.²⁸⁴ “Në këto ndërtime, përemri dëftor ‘ky,kjo’ në rrjedhore funksionon si sinonim i përemri tjetër dëftor ‘i, e tillë’.”²⁸⁵

Këso toke kemi ne këtej, o grizarak: të gjallit ia pi shpirtin, të vdekurin e ruan.

Papiruset e vjetra janë plot me **kësisht brengash**.

Sigurisht keni dhe **asish fqinjësh** rreth të cilëve nuk lodheni të mendoni shumë.

Veç këtyneve, mënyrë mosdëftore, si e kanë quejtun gramatikanët, s'kemi përsëri; se gjuha jonë s'e ka **një këso trajte** foljore.

Ndërsa kundrina e zhdrejtë shprehet me emra, përemra dhe pjesë të tjera të emëruara të ligjëratës në rasën dhanore, pa parafjalë, ose në raste të tjera me parafjalë që sundojnë

²⁸⁴Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 31

²⁸⁵Domi, Mahir: *Gramatika e gjuhës shqipe. Sintaksa*. Tiranë 1957, f.29

emëroren, gjinoren, kallëzoren, ose rrjedhoren. Vlen gjithashtu të theksohet se e vetmja rasë në gjuhën shqipe që nuk sundohet nga parafjalë është rasa dhanore.

2.1.Sundimi i kundrinës.

Kundrina në gjuhën shqipe mund të drejtohet nga një emër foljor, mbiemër, ndajfolje, ose folje. Më poshtë do të shtjellohen të katërta rastet duke i ilustruar me shembuj. Gjymtyra e cila drejton kundrinën do të nënvizohet për lehtësi kuptimi.

2.1.1.Kundrina e drejtuar nga një emër.

Emri foljor në gjuhën shqipe “është i aftë të marrë një kundrinë të drejtë ose të zhdrejtë.Mes emrave foljorë vetëm emrat foljorë asnjans mund të marrin kundrinë të drejtë.”²⁸⁶

Ma resh në afro një vit me radhë me romuze e me të kthyer **kokën** mënjanë kur më shihnin.

Nënë Dhoksa...me një buzëqeshje të lehtë që shprehte edhe adhurimin e saj, edhe një farë të kërkuari **ndjesë**, i nguli, sytë shkrintarit.

Bile ia patën nisur me të hapur **kanale**, ia patën filluar me të pjekur **qyngje**, ia patën zënë me të afruar **gurë**.

Dhend, sikundër u pa, është larg nga të shënuarit **delen** qumështore.

Këto ndërtime i ndeshim kryesisht nëndërtime frazeologjike. Përnaska vëren se ato po përdoren gjithnjë e më pak, si në gjuhën e folur ashtu edhe në atë të shkruar, dhe po zëvendësohen nga format e gjinore me funksion përcaktori.

Në këto ndërtime sipas tij, kundrina e drejtë e shprehur me një emër a përemër në rasën kallëzore pa parafjalë del kryesisht për emra foljorë asnjans në rrjedhore të pashquar, pas foljesh që shënojnë fundin e veprimit të shprehur nga folja ose shkaku. Kundrina e drejtë për emra foljorë asnjans nuk shprehet dhe nuk shenjohet me trajta të shkurta të përemrit vetor.²⁸⁷

As Adili s'po ngopej dot atë mëngjes së shikuari **këtë fushë** të gjerë.

Sa mbaroi së preri **drutë**, u derdhën partizanët nga mali dhe filloi përleshja.

Tollumbi i zaptuar nga demonstruesit pushoi së hedhuri **ujë**.

²⁸⁶Demiraj, Shaban, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970, f.234-235

²⁸⁷Përnaska, Remzi, *Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2000, f. 45

Drekën e hëngrën vonë, si mbaroi edhe xha Metja së gdhenduri **hunjtë**.

Asimi herë shikonte mua me bisht të syrit, herë hidhte sytë nga Xhezua që s'kish mbaruar akoma së kënduari **shpalljen** e Ministrisë së Bujqësisë.

Përnaska gjithashtu thekson se kundrina e drejtë, mund të dalë edhe për disa emra jofoljorë, në tipe të caktuar fjalish "nxitëse", si pasojë e ndryshimeve që pëson fjalia.:

Kujdes këmbësorët!

Amanet djalin!

*"Kundrina e drejtë nuk mund të dalë për emrat foljorë të gjinisë mashkullore ose femërore të formuar me anë të prapashtesave-im dhe-je."*²⁸⁸

Kundrinat e zhdrejta pa parafjalëtë shprehur me emra ose përemra në rasën dhanore, vijnë zakonisht për emra foljorë të gjinisë femërore të formuar me prapashtesën-je. Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë e drejtuar nga një emër foljor në gjininë femërore nuk mund të shprehet ose shenjohetme trajta të shkurta të përemrave vetorë.:

Qëllimi i kësaj vepre ishte shpëtimi dhe dhënia **brezave** që vijnë, i fjalëve e i teksteve shqipe.

Vendimi për dorëzimin e pjesës bizantine të bazës **Perandorisë Turke** u shpall me dekret të veçantë në të dy kryeqytetet mbretërore: Kostandinopol dhe Brusë.

Kjo sipas ndodh Përnaskës *"në kushte të përcaktuara mirë: emri foljor me prapashtesën-je ndiqet nga një përcaktor i shprehur me një emër ose përemër etj. në gjinore. Ky ndërtim është ndikim gjuhësh të huaja. Po të kthehet togfjalëshi emëror:emër foljor me prapashtesën-je+ përcaktor në gjinorenë togfjalësh foljor, emri foljor kthehet në folje tranzitive, kurse përcaktori në gjinore kthehet në kundranor të drejtë."*²⁸⁹

Qëllimi i kësaj vepre ishte t'i shpëtonte dhe t'ua jepte brezave që vijnë **fjalët** dhe **tekstet** shqipe.

Si pasojë e ndryshimeve që pëson fjalia, kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të dalë edhe për emra jofoljorë në disa lloje të caktuara fjalish nxitëse ose thirrmore.:

-Vdekje fashizmit! - tha ai.

U çirret zëri së thëni: "Luftë Partisë Komuniste, luftë grekut e serbit".

²⁸⁸Totoni, Menella: Ndërtimet me emra foljorë prapashtesorë, Gjuha jonë, 1982, nr.1, f.63.

²⁸⁹Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 46

Në mëngjes u dha urdhëri: Luftë armikut!

Vdekje **fashizmit** – liri popullit!

Lavdi të përjetshme **dëshmorëve!**

Nder punës!

Emrat foljorë asnjans nuk mund të marrin kundrinë të zhdrejtë në rasën dhanore.

Ndërsa në rastin e kundrinës së zhdrejtë me parafjalë. Ata takohen për emrat foljorë e të tri gjinive. Statistikat që janë bërë për këtë rast tregojnë se kundranorët e zhdrejtë me parafjalë dalin më shpesh për emrat foljorë mashkullorë ose femërorë, sesa për emra foljorë asnjans, të cilët po përdoren gjithnjë e më pak.

Kundrina e zhdrejtë me parafjalë për emra foljorë, në shqipen e sotme letrare, përgjithësisht ruan po atë parafjalë që sundon vetë folja prej nga vijjnë këta emra.

Në rastin e emrave foljorë, ajo u përgjigjet pyetjeve të ndërtuara me përemra pyetës të prirë nga parafjalë. Fjala është përgjithësisht për kundrina të zhdrejta me parafjalë që shprehin veprues, mjet, shoqërues, objektin të cilit i afrohemi ose i largohemi, etj.²⁹⁰

Nxjerrja e naftës **me mjete** moderne kushton më lirë.

Siç shihet nga shembulli i mësipërm, domethënia e kundrinës shfaqet qartë, veçanërisht kur emri foljor shoqërohet nga një përcaktor i shprehur zakonisht me një emër në rasën gjinore që shpreh kundrinën e veprimit, si ndodh me gjymtyrën ‘e naftës’ në shembullin pararendës.

Në këto ndërtime, emri i sunduar prej parafjalës mund të shprehë gjithashtu edhe një përcaktor të emrit, ndaj duhet bërë dallimi me kundrinën e zhdrejtë me parafjalë, çështje kjo e diskutuar më lart.

2.1.2. Kundrina e drejtuar nga një mbiemër.

“Mbiemri, qoftë ky foljor ose jo, mund të marrë kundrinor. Ky kundrinor, gjithë duke shprehur qartë kundranën, përcakton ose kufizon tiparin e shprehur nga mbiemri. Funkcioni i tyre është të shprehin personin ose kundrinën në lidhje me tiparin e shprehur nga mbiemri.”²⁹¹

Mund të thuhet se marrëdhëniet që vendosen mes mbiemrit dhe kundrinës së vet janë të përafërta me ato që vendosen mes foljes që ka të njëjtën domethënie leksikore dhe

²⁹⁰Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 47

²⁹¹Floqi, Spiro, *Togfjalëshat mbiemërorë në shqipen e sotme letrare*, 1, Studime filologjike, 1981, N. 2, ff. 63-87

kundrinës së vet. Këto marrëdhënie sipas Përnaskës zakonisht vendosen kur mbiemri është prejfoljor dhe ruan po atë parafjalë.²⁹²

Vërehet gjithashtu se kundrina e drejtuar nga mbiemër në gjuhën shqipe është në çdo rast kundrinë e zhdrejtë me parafjalë.

Kush i ka parë ato vise të bukura..., ato male të veshura me pisha, me bredha e me boriga të larta...ai nuk i harron kurrë ato vise, viset e bukura dhe të dashura.

Kur iu afrua fortesës, dërgoi përpara të nipin, Hamzë Kastriotin si sekretar të tij, që ta lajmëronte kumandarin e kështjellës që arrinte për së shpejti, urdhëruar prej Sulltan Muratit II të merrte kumandën e saj.

Përnaska më tej shton se “*si rregull nuk krahasohen marrëdhëniet që vendosen midis mbiemrit kur ai nuk është foljor dhe kundranorit të vet me ato që vendosen midis foljes ose mbiemrit prejfoljor dhe kundranorit të vet. Kundranori i mbiemrit jofoljor mund të shprehë nuanca kuptimore nga më të ndryshmet. Në këto raste, kundranori mund të shprehë, p.sh., sferën, caqet, kufijtë e shtrirjes së tiparit të shprehur nga mbiemri: i guximshëm dhe i matur në veprime, i zoti në matematikë, i talentuar për muzikë, i përshtatshëm për mësim, etj.; ai mund të shprehë gjithashtu personin ose sendin në lidhje me të cilët jepet tipari i shprehur nga mbiemri: i shtrenjtë për ne, i ngjashëm ose i njëllojtë me shokët, etj.”²⁹³*

Që nga viti 1933 punonte pranë zotit Bakalli...një burrë i leshtë nga sjellja, po shumë i frikshëm në punët politike.

Pastaj Faik Konica merr lapsin dhe shkruan se "Prometheu" i Eskilit, një libër dymijë e katërqind vjetësh i vjetër nga mosha, por nga mendimi aq i ri sa të na duket sikur u shkrua dje"

2.1.3.Kundrina e drejtuar nga një ndajfolje.

Sipas Përnaskës disa kategori ndajfoljesh cilësore ose ndajfoljore, po ashtu si mbiemrat, mund të marrin kundrinë që shpreh personin ose sendin në lidhje me të cilin jepet tipari karakteristik i shprehur nga ndajfolja. Në disa raste sipas tij ndajfolja e ndjekur nga parafjala shkojnë drejt kthimit në shprehje parafjalore.²⁹⁴

Në mbledhjet e ndryshme që bëhen në fshat gratë kanë filluar të marrin pjesë baraz me burrat.

Tani ai gjendej thajse ngjitur me të.

²⁹²Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 49

²⁹³Po aty

²⁹⁴Po aty, f. 51

Dukej sikur ai hotel ishte ndërtuar **enkas për njerëz** që duan të jenë vetëm për vetëm me mendimet e tyre.

Tinëzish nga nënë Diella e nga Trina, ajo hapte arkën e rrobave dhe, midis ndërresave, gjente fyellin e tij.

2.1.4. Kundrina e drejtuar nga një folje.

Kundrinë merr kryesisht një gjymtyrë e shprehur me folje ose me lokucion foljor. Kjo është kundrina më e përdorur e më tipike.²⁹⁵ Për këtë arsye ajo do të shtjellojet më hollësisht në vijim. Kjo kundrinë mund të jetë e drejtë, e zhdrejtë pa parafjalë, ose e zhdrejtë me parafjalë. Sipas Përnaskës, kundrina e drejtuar nga një folje është kundrina që e ka dhe e ruan më pastër funksionin kundrinor, ku ai veçon kundrinën e drejtë si kundrinën që e ka më të qartë se dy llojet e tjera këtë funksion.²⁹⁶

Ne nuk e humbasim **vigjilencën**.

Armikut nuk i zihet besë.

Ajo kishte dëgjuar shumë **për Drinin**.

3. Kundrina e drejtë.

Përgjithësisht kundrina që ndeshim më shpesh në gjuhën shqipe shënon objektin që shpreh folja dhe përcaktohet si kundrinë e drejtë:

Pushka ka ndihmuar **shkollën**, shkolla i ka ndriçuar **rrugën** pushkës.

Por kemi dhe kundrina, që nuk tregojnë objektin e veprimit.:

Poema “Bagëti e bujqësi” është shkruar nga **Naim Frashëri**.

Sipas përkufizimit të sintaksës shqipe “*kundrina e drejtë shënon zakonisht objektin tek i cili kalon pandërmjetshëm veprimi i shprehur nga folja ose objektin që është rezultat i këtij veprimi.*” Ajo vihet në rasën kallëzore pa parafjalë. Në gjuhën shqipe kundrina e drejtë të gjendet me anë të pyetjes: “*kë?*”, “*cilin?*”, “*cilën?*”, “*çfarë?*”.²⁹⁷:

Punëtorët rishikonin **planet** e prodhimit dhe bënin propozime të guximshme.

I shkruan **një letër** të gjatë.

Ndërsa sipas Përnaskës “*Kundranori i drejtë është gjymtyrë e domosdoshme për ndërtimin e asaj fjalie që ka për kallëzues një folje kalimtare në formën veprare dhe që*

²⁹⁵ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f.252

²⁹⁶ Përnaska, Remzi, *Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2000, f. 52

²⁹⁷ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 253

shpreh kundranën mbi të cilën kalon zakonisht drejtazi veprimi i shprehur nga vetë kjo folje. Ky kundranor i drejtë shprehet thujse kryesisht me një emër zakonisht të shquar, një përemër, një pjesë të substantivuar të ligjëratës në rasën kallëzore pa parafjalë.”²⁹⁸

Karakteristikë e kundrinës së drejtë në gjuhën shqipe është kthimi i saj në kryefjalë, kur folja që plotëson ajo shndërrohet në pësore.

Reforma e re arsimore ka hapur **perspektiva të mëdha** për zhvillimin e arsimit.

Perspektiva të mëdha për zhvillimin e arsimit janë hapur nga reforma e re arsimore.

Si u pa më lart nëpërkufizimin e Përnaskës, kundrina e drejtë mund të shprehet vetëm me folje kalimtare veprare. Ajo është përgjithësisht një gjymtyrë e domosdoshme për fjalitë me një folje të tillë. Këtë pohim e gjejmë dhe tek Çeliku, i cili gjithashtu shprehet se kundrina e drejtë “*është plotësor i domosdoshëm i këtyre foljeve*”. *Foljet veprare tregojnë që kryefjala vepron, ndërsa quhen veprare kalimtare kur tregojnë se veprimi i kryefjalës, bie mbi një send apo person, si psh.: punoj (tokën), botoj (një libër), laj (fëmijën), etj.*”²⁹⁹

Nismat e shumta kundër mbeturinave mesjetare, që e poshtëronin gruan, që i ndrydhnin **personalitetin** dhe që e bënin të rëndë **jetën** e saj, duhen vlerësuar si shpërthim i një hovi të ri të kohës.

Sipas Çelikut kemi dhe rastin e foljeve veprare, që janë jokalimtare, të cilat nuk kanë nevojë të plotësohen nga kundrina e drejtë, duke qenë se veprimi i tyre mbetet tek kryefjala pa rënë mbi një send tjetër.: vrapoj (në rrugë), bie (nga pema), eci (në këmbë) etj.

Dhe disa folje kalimtare, në rastet kur përdoren si jokalimtare nuk marrin kundrinë të drejtë. Bëhet fjalë për folje të cilat shprehin thjesht veprim të kryefjalës si veprim të përgjithshëm. Të tilla folje janë p.sh. folja ‘punoj’ ose folja ‘qaj’, të cilat në një rast mund të jenë folje veprare kalimtare dhe marrin kundrinë të drejtë, ndërsa në një rast tjetër mund të jenë veprare jokalimtare dhe nuk marrin kundrinë.³⁰⁰

Punoj **arën**.

Ajo punon shumë.

Qaj **provimin**.

Qaj gjithë ditën.

²⁹⁸Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000

²⁹⁹Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012

³⁰⁰Po aty

Kundrinë të drejtë mund të marrin dhe format e pashtjelluara si p.sh.: për të punuar, me të parë, e një të parë, duke parë dhe pa parë.:

Një të parë **atë**, sakaq dhe studentët e tjerë filluan të lëviznin.

Me të parë **Bekon**, ai u ndal.

Gjithashtu siç e është trajtuar më sipër, kundrinë të drejtë përveç foljeve, mund të marrin edhe emrat prefoljorë asnjëanës të rasës rrjedhore që vijnë pas foljesh që tregojnë mbarim, pushim a vijim veprimi ose që shënojnë një shkak.

Nuk ngopesha së shikuari **peshqit** nën ujë.

Tollumbaci i kapur nga demonstruesit pushoi së hedhuri **ujë**.

Kundrina e drejtë në gjuhën shqipe mund të haset e vetme në fjali ose bashkë me një kundrinë të zhdrejtë pa apo me parafjalë. p.sh.:

Hansi s'ia honepste **emrin e tij**.

Mësuesit linin kokën **për të**, e thërrisnin në emër dhe e nxitnin **me të gjitha mënyrat**.

Ç'është e vërteta, thellë në vete ai s'u besonte edhe aq **shpjegimeve të Hansit** dhe e ndiente mirëfilli që ky i kushtonte më pak se **gjysmën e rëndësisë** që i jepte ai vetë **kësaj shëtitjeje me shokun**.

Në lidhje me vendin e saj në fjali do e shohim hollësisht në një kre të veçantë, i cili trajton rendin e kundrinave në fjali në gjuhën shqipe.

3.1.Nuanca semantike të shprehura nga kundrina e drejtë.

Në aspektin semantik si në gjermanisht ashtu edhe në shqip, dallojmë dy lloje kundrinash të drejta: kundrina e drejtë e brendshme dhe kundrina e drejtë e jashtme, ndryshe nga kundrina e zhdrejtë, e cila shpreh vetëm nuanca kundrinash "të jashtme".

Kundrina e brendshme shpreh objekt që përftohet nga veprimi i foljes, që zbulon përmbajtjen e tij, që krijohet në procesin e veprimit e që tretet në kryerjen e tij.

Ndërsa kundrina e jashtme shpreh një kundrinë që gjallon pavarësisht nga realizimi a kryerja e veprimit të shprehur nga folja, që gjallon jashtë këtij veprimi.

3.1.1. Kundrina e drejtë e brendshme

Kundrina e brendshme shpreh kundrinë që nuk gjallon para veprimit të shprehur nga folja dhe pa atë veprim të shprehur prej saj. Ajo *“shpreh kundranën që krijohet, sajohet, përftohet, që zhduket, tretet ose preket, ndysohet vetëm pjesërisht, si rezultat i veprimit*

të vetë foljes. Ky lloj kundranori mund të shënojë kundranën e ngjizur, e përftuar, e sajuar si rezultat i veprimit të foljes:”³⁰¹

Prodhoj makineri, ndërtoj banesa, hap kanale, këndoj këngë, dëgjoj muzikë, pikturoj kuadro, qep pantallona etj.

Në gjuhën e përditshme është mjaft i kufizuar numri i foljeve jokalimtare që marrin këtë lloj kundrine të drejtë, si p.sh: fle, jetoj, flas, veroj, luftoj, ëndërroj. Nganjëherë në gjuhën letrare artistike përdoren edhe folje të tjera.³⁰²

Një rast tjetër i kundrinës së brendshme sipas Përnaskës është dhe ai i kur kundrina e drejtë mund të shprehë një kundrinë që zhduket, shpërbëhet, tretet, shkrihet, shkatërrohet, transformohet ose që ndryshohet krejtësisht nga veprimi i foljes:

Hedh në erë **një shkëmb**, **shkatërroj një qytet**, **shkrij hekur**, **shuaj zjarrin**, **bluaj misrin**, **thyej syzet**, **djeg shaminë**, **vras insektet**, **zhduk mushkonjat**, **ha ushqimin**, etj.

Kundrinë të brendshme mund të shprehë dhe kundrina, të cilën veprimi i shprehur prej foljes e ndyshon vetëm pjesërisht:

Qeth flokët, **zdrukthoj një dërrasë**, **grasatoj rrotat** e një biçiklete, **përkul shufrën**, **mpreh lapsin**, **pres kallëpet**, etj.

Vlen të theksohet se, folja ka në këto raste kuptim të veprimit konkret, edhe emri ka gjithashtu kuptimin e një emri konkret. Emri mund të shprehë edhe frymor.:

Edhe **zezakun** nëna e ka lindur.

Përnaska gjithashtu thekson se “*kundranori i drejtë që shpreh kundranë të brendshme mund të shprehë kundranën që zbulon përmbajtjen e veprimit të foljes. Ky kundranor nuk shpreh rezultatit material të veprimit meqë ajo çka krijohet gjatë veprimit zhduket, tretet gjatë realizimit të veprimit të shprehur nga folja. Emri, përemri, etj. në rasën kallëzore pa parafjalë zakonisht nuk shpreh as qënie të gjalla, as kundrana materiale. Kjo kundranë përdoret për folje të perceptimit.*”³⁰³:

Këndoj një këngë, **dëgjoj radion**, **shoh shfaqje të bukura**, **mbaj fjalën**, etj.

Të përafërta me kundrinat që shprehin kundrinën e vetë përmbajtjes së veprimit të foljes mund të konsiderohen kundrinat e brendshme me karakter tautologjik, të ndërtuara me

³⁰¹Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 53

³⁰²Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 254

³⁰³Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 53

folje jokalimtare. Ato shprehen me emra me kuptim të njëjtë leksikor me foljen që plotësojnë, dhe që nuk shënojnë si rezultat të aksionit një kundrinë materiale. Këto kundrina tautologjike dallojnë nga kundrinat që shënojnë rezultatin e veprimit të shprehur nga folja sepse shprehin gjendjen në të cilën ndodhet kryefjala, gjendje e cila në të vërtetë nuk kërkon kundrinë, dhe shpesh shoqërohen nga një përcaktor. **Togfjalëshifolje + emër në rasën kallëzore pa parafjalë** funksionon pothuaj si një folje e vetme, por shpesh me një nuancë ngulmimi.:

Fle gjumë, veroj verën, luftoj luftën, jetoj jetën, ëndërroj ëndrra, mendoj mendimin, etj.

Lufton luftën dhe fiton.

Ato dukeshin sikur po flinin gjumin e rëndë të natës.

Motoja e punës sime krijuese është të jetoj jetën si gjithë njerëzit.

Kujtoj kujtimet më të mira.

Ky ndërtim gjithashtu gjen përdorim të gjerë dhe në këngët dhe tregimet popullore:

Mori lulja e Limit - o, ku verove verën – o?

Paska dalë e bardha dritë, Atllarët krushqit i shillojnë, kanë nisë **kangën** p'e këndojnë, kanë nisë kualt e po i lodrojnë.

Nata a shkue, hana s'ka dalë, Muji, **i andërr e ki andrrue**: andërr paka hangelën tuj pjellë.

Durimin s'e duroj dot, nat' e dit' qaj me lot.

3.1.2. Kundrina e drejtë e jashtme

Kundrina e drejtë e jashtme shpreh një objekt që ekziston pavarësisht nga veprimi i foljes, por që i nënshtrohet këtij veprimi.³⁰⁴ Kjo kundrinë mund të ketë funksione të ndryshme, të cilat i gjejmë të trajtuara veçanërisht tek Përnaska³⁰⁵, i cili dallon katër funksione kryesore të saj:

³⁰⁴Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 254

³⁰⁵Përnaska, Remzi, *Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2000, f. 53, 55-57

1). Sipas tij ajo shpreh kundrinën e veprimit të jashtëm pas foljesh që shprehin veprime fizike mbi kundrinën ose pas foljesh veprimi fizik i të cilave nuk prek kundrinën e dhënë, por që shkaktojnë dallime në marrëdhëniet e kësaj kundrine me të tjera.:

a)Ajo mund të shprehë kundrina mbi të cilat bien veprime të jashtme mekanike, dhe mund të përfqësojë një qenie të gjallë ose send: tund malet, përqafoj prindërit, ngrej të plagosurit, lëviz shkëmbinjtë, etj.

b)Gjithashtu mund të shprehë një kundrinë pa ndërmjetësinë e drejtpërdrejtë të veprimit mekanik të shprehur nga folja, i cili shkakton dallime në situatë, në funksione dhe në marrëdhëniet e kësaj kundrine me kundrina të tjera: blej, shes, ndërroj, këmbej, zgjedh, kërkoj (mallin), etj.

c)Disa nga këto kundrina që dalin për një kategori të caktuar foljesh, përveç funksionit themelor të kundrinës së jashtme të veprimit të shprehur nga folja, japin edhe kuptimet shtesë të mjetit, të veglës dhe disa marrëdhënie hapësirore. Për shembull, pas foljeve: hap, lëviz, tund, nxjerr, lëkund, luaj, etj., kundrina ka, përveç kuptimit themelor të kundrinës së veprimit, një domethënie instrumentale.:

- Ç'ma tund ashtu **dorën**?

E përqeshi duke nxjerrë **gjuhën**.

Buzëqeshi dhelëvizi **kokën** për t'i përshëndetur.

d)Pas disa foljeve kalimtare, kundrina e veprimit të jashtëm mund të shprehet nga fjalë me kuptim vendi. Këto janë folje me kuptim afrimi si: arrij, mbërrij, afroj, ngjit, zë, kap, etj., folje me kuptim largimi si: mënjanoj, shmang, lë, largoj, etj. si dhe folje të një objekti: kaloj (rrugën, lumin, kanalën, fshatin); hedh (lumin, kanalën, hendekun); përshkoj (botën, vendin); ndjek ose vazhdoj (rrugën), etj.

I lashë **ata** dhe erdha të marr vegla.

2.Përnaska gjithashtu dallon se në rastin kur këto kundrina shprehin kundrinën e perceptimit në qoftë se drejtohen nga folje ligjërimi ose pasoje psikologjike, që shprehin veprime të cilat, pasi pasqyrohen në vetëdije, ndikojnë mbi kundrinën. Ai dallon disa nënllaje të kësaj kundrine si vijon.:

a) Kundrina e perceptimit, e cila sundohet nga foljet: thërras, tregoj, pyes, lus, uroj, këshilloj, urdhëroj, etj. shpreh personin të cilit i drejtohet fjala.

Do pyes **vajzën**, - i foli me të butë.

E luta **Teutën** të rrinte.

Ata i thërriste Mëmëdheu.

Përshtëndes **miqtë** gjermanë.

Këshilloni **studentët**.

Urdhëroj **kompaninë**.

b)Kundrina mund të shfaqet dhe për folje veprimi fizik i të cilave nuk prek kundrinën, por që ndikojnë psikologjikisht, si: tremb, kërcënoj, gënjej, mashtroj, vë në lojë, tall, kujtoj dikë për diçka, mësoj dikë, frymëzoj dikë, etj.

Mos **i tall shokët** se ata të venë në lojë.

Ekujtojadis a herë në ditë**Aleksin** se duhej të mëson te.

Shoqëria na mëson **të gjithëve** si të mendojmë, të punojmë e të jetojmë.

3.Më tej Përnaska dallon dhe "Kundranorët e drejtë që shprehin kundranë të jashtme perceptimi, tregojnë kundranë që nuk pranon ndikimin aktiv të nënanës, por që është kundranë e perceptimit ndijimor d.m.th. kundranë, së cilës i drejtohet veprimi psikik i nënanës:

*Dëgjomë mua!, Vë re lëvizjet, E sheh tabelën?, E ndjej ngrohtësirën, E ndjek me sy, E pashë me sytë e mi, Nuhaserën, Dëgjoj zërin e....*³⁰⁶

Si mund të vërehet edhe nga shembujt, kundrina që shpreh perceptim ndijimor vjen për folje që shprehin veprime të organeve ndijimore, të shikimit, të dëgjimit, të nuhatjes, të të prekurit.

*"Kundranori që shpreh perceptim pas foljesh sinjoh,di,kuptoj,harroj, etj. mund të shprehë gjithashtu një kundranë të një veprimi të mëparshëm psikik, të kujtesës, të ndijimeve dhe të vullnetit të nënanës së veprimit. Folje të tjera shprehin gjithashtu qëndrimin e nënanës ndaj kundranës së perceptimit, sidomos kur kundranorët shoqërohen nga një përcaktor: kërkoj, dua, fal, urrej, dëshiroj, parapëlqej, dashuroj, besoj, ndjej, më vjen keq për të. E njëjta gjë ndodh me foljet kauzative: zëmëroj, inatos, hidhëroj, emocionoj, zgjoj, tërboj, xhindos, etj. Po ashtu edhe me foljet: kam, numëroj, quaj, llogaris, konsideroj, etj."*³⁰⁷

Gjithashtu ai shton se pas foljeve që shprehin zotërim si: kam, zotëroj, posedoj, ose drejtim si: drejtoj, dirigjoj, udhëheq, komandoj, manovroj, ngas, mbroj, marr nën

³⁰⁶Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 57

³⁰⁷Po aty

mbrojtje, përkrah, marr me qira, etj., kundrina e drejtë shpreh kundrinë të nënrenditur, të sunduar.

Disa nga këto folje thekson Përnaska shprehin qëndrimin pasiv të kryefjalës ndaj kundrinës: kam, zotëroj, marr me qira, etj., ndërsa disa të tjera shprehin qëndrimin aktiv të kryefjalës ndaj kundrinës si: drejtoj, komandoj, heq përhundësh, etj., me kusht që këto veprime të mos jenë të vazhdueshme, të zakonshme për atë që vepron, por të jenë të veçanta, konkrete.:

Shtabi komandon me radio **trupat** në parakalim.

Atë e heq për hunde gruaja.

4. Kundrina e drejtë, për një numër të kufizuar foljesh me domethënie të caktuar leksikore, shpreh kryefjalën e perceptimit si në ndërtimet pavetore ashtu edhe në ndërtimet vetore.

Mozën e ka goditur në kokë sëmundja.

Mua më kruan përbrenda.

Shenjimi i kundrinës së drejtë me trajtë të shkurtër

Në lidhje me shenjimin e kundrinës së drejtë me trajtë të shkurtër do shprehem në vijim fare shkurtimisht, pasi kjo çështje do trajtohet në mënyrë të detajuar në një nënkre të veçantë në fund të këtij kreu, duke qenë se është një dukuri mjaft e veçantë e gjuhës shqipe, që ngjall interes. Në gjuhën gjermane kjo dukuri nuk ekziston.

Kundrina e drejtë mund të shoqërohet me trajtë të shkurtër në disa raste. Kjo do të thotë se mund të shprehet nga një trajtë e shkurtër në rasën kallëzore, dukuri e cila si u shpreha më lart nuk ndodh në gjuhën gjermane.³⁰⁸:

*Sot takova **Erën**.*

*Sot e takova **Erën**.*

Trajta e shkurtër e kallëzores përdoret përgjithësisht në rastet kur :

- Kundrina e drejtë i përket temës por nuk mban theksin kryesor të fjalisë.
- Kur emri bërthamë i frazës emërore është një përemër dëftor i vetës së tretë që shpreh një frymor apo një send, të cilat janë të njohura për shkaqe konstitutive dhe kontekstuale.

Rrethanat e përdorimit të kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër varen më së shumti nga veçoritë gramatikore të kundrinës dhe nga kushtet e procesit të

³⁰⁸Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 437

komunikimit, veçanërisht nga lidhjet me kontekstin. Këto vërehen mbi të gjitha në lidhjen e ngushtë midis kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër, ndarjes temë-remë dhe intonacionit.

Nga ana tjetër një veçori që nuk ndodh në gjuhën gjermane është se kundrina e drejtë në raste të veçanta mund edhe të eliminohet. Në shembullin e mëposhtëm kundrina e drejtë jepet vetëm me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.³⁰⁹

Sot e takova atë.

Sot e takova.

3.2. Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e drejtë.

Kundrina e drejtë mund të shprehet me një fjalë të vetme e cila mund të jetë një emër, përemër, numëror me përdorim emëror, një pjesëtë emërzuar të ligjëratës, ose me një togfjalësh apo një fjali të tërë.

1. Në rastet kur kundrina e drejtëshprehet me një fjalë të vetme, ajo vendoset në rasën kallëzore pa parafjalë. Në këtë rast ajo shprehet nga pjesët e mëposhtme të ligjëratës::

- Emër të shquar ose të pashquar në rasën kallëzore:

Ajo hapi **çantën**.

Bleu **kafe e sheqer**.

- Përemër të cdo lloji (vetor, vetvetor, dëftor, pronor, lidhor, pyetës, i pacaktuar) me përdorim emëror:

Ai më pyeti **mua**.

Ai u përpoq të mblidhte **veten**.

Këtë s'ma ke thënë.

Ke stilograf? Ai nxorri **të tijin**.

Dje takoi një shok, **të cilin** nuk e kishte takuar prej kohësh.

Kë donte të qëllonte?

I kishim ftuar **të gjithë** në shfaqje.

- Numëror me përdorim emëror:

³⁰⁹Po aty, f. 440

Pesa e shumëzuar me dy jep **dhjetë**.

- Me një pjesë të emëruar të ligjëratës:
- Koha e rrëfen **të drejtën**
- Të gjithë ia donin **të mirën**.

Qyteti ynë mezi i pranonte **të ardhurit**.

I uruan **mirëseardhjen**.

Dhe lëshonte një **mjau** të fortë.

2. Kundrina e drejtë mund të shprehet me një togfjalësh, i cili mund të jetë, frazeologjik ose i lirë.

“Togfjalëshi është njësia sintaksore strukturore e përfutur gjatë ligjëritimit nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose më shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes, që tregon marrëdhënie midis sendeve, dukurive, proceseve e tipareve. Fjalët që mund të bashkohen dhe te formojnë togfjalësha, janë emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet, ndajfoljet. Fjalët shërbyese, parafjalët, lidhëzat, janë krahas formave të fjalëve mjete për bashkimin e fjalëve kuptimplota në togfjalësha.”³¹⁰

Gjithsesi mund të thuhet se nuk ka mendim të njëjtë në lidhje me shtrirjen dhe raportet e vendosura në togfjalëshat sintaksorë. Shumica e gjuhëtarëve pranojnë togfjalëshat me raporte nënrenditëse, duke përjashtuar kështu bashkimet me raporte bashkërenditëse, të cilat i përkasin teorisë së gjymtyrëve homogjene të fjalisë, p.sh. drekë e darkë, mollë e dardhë, etj.

Mund të thuhet se pothuaj të gjithë gjuhëtarët e gjuhës shqipe e pranojnë që togfjalëshi frazeologjik shpreh një gjymtyrë të vetme, por nuk ndajnë të njëjtin qëndrim për togfjalëshat e lirë. Disa mendojnë se secila fjalë e ka aftësinë të shprehë një gjymtyrë.

“Kundrinat e shprehura me togfjalësh mund të jenë tipash e ndërtimesh të ndryshme, po gjithnjë me një emër, përemër ose pjesë tjetër të emëruara të ligjëratës si gjymtyrë bosht, e cila e vetme nuk mund të përmbushë rolin e kundrinës.”³¹¹

Përnaska shprehet se “ka togfjalësha gjymtyra kryesore e të cilëve nuk mund të funksionojë si gjymtyrë më vete e fjalisë. Analiza përndarëse e provon më së miri këtë

³¹⁰Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Istituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe III, Sintaksa (I.sintaksa e fjalisë), (1989), ribotim Tiranë 2002, f. 81.- 82
³¹¹По aty, f. 252

gjë. Kështu, fjalia: Shumëkush e ka provuar **atë ndjesi** të veçantë që shkakton dita e parë e plazhit. ka si kundranor të drejtë "atë ndjesi", dhe jo "ndjesi" sepse fjalia: Shumëkush e ka provuar **ndjesi** të veçantë që shkakton dita e parë e plazhit., nuk është e thënshme, është ndërtuar keq, thënë ndryshe nuk është ndërtuar sipas rregullave të gjuhës shqipe. Vetëm togfjalëshi fjala e nënrenditur e të cilit ka peshën semantike, funksionon si një gjymtyrë e vetme e fjalisë."³¹² Më poshtë do paraqes ndërtimet më të përdorura:

- Togfjalëshi emër + emër.:

Dhalli të hap oreksin dhe mund të hash **një çyrek bukë** e s'ke të ngopur.

- Togfjalëshi përemër + emër:

Kohët e fundit po e vinte re më shpesh **këtë të metë**.

- Togfjalëshi mbiemër + emër:

Gori shqiptonte të **njëjtat fjalë**.

- Togfjalëshi përemër + përemër:

Dhe pastaj menjëherë e zuri frika se mos ai i kërkonte të përsëriste **ndonjë nga ato lodrat** e dikurshme foshnjarake që atij i pëlqenin aq shumë.

- Togfjalëshi numëror + përemër

Plagosi shtatë dhe vetëm **tre syresh** i zuri rob .

- Togfjalëshi numëror + emër:

Armiqtë patën veç të plagosurve rreth **njëmijë të vrarë**.

Kundrina mund të shprehet dhe me një togfjalësh më pak të lirë se ata që sapo u përmendëm më sipër. Në këto raste bëhet fjalë për emërtime institucionesh apo formula të tjera të ngjashme.:

Ajo thoshte se e kishte këmbyer **Fakultetin e informatikës** me arkitekturën.

Ai fshatar është, po **dy para mend** në kokë i ka.

³¹²Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 37

Ai citoi **një fjalë të urtë**.

3. Kundrina e drejtë mund të shprehet “*edhe me një fjali të tërë, me kusht që ajo të jetë “e substantivuar” kontekstualisht.*”³¹³:

Na premtuan **se do të botohet**.

Misri hamullor nuk mbillet **me një “ka kohë”**.

E mbylli bisedën **me një “duhet ruajtur shume”**

4. Kundrina e zhdrejtë.

Kundrina e zhdrejtë është mjaft e larmishme si në rrafshin formalo- gramatikor, ashtu dhe në atë kuptimor, duke përfshirë një gamë të gjerë ndërtimesh e kuptimesh.

Ajo shprehet me forma të emrit, përemrit ose ndonjë pjesë të emëruar të ligjëratës në rasën dhanore pa parafjalë, ose në emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore me parafjalë ose shprehje parafjalore. Përgjithësisht shpreh kundrinën që lidhet në një farë mënyre me kalimin e veprimit të shprehur nga folja, por në ndryshim nga kundrina e drejtë, ky kalim i veprimit mbi kundrinën nuk është i pandërmjetëm.

Kundrina e zhdrejtë ndërtohet si me folje kalimtare veprare ashtu edhe me folje jokalimtare veprare. Gjithashtu ajo ndërtohet dhe me folje të diatezës pësore ose vetvetore.

Kundrina e zhdrejtë del në dy forma, kundrinë e zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinë e zhdrejtë me parafjalë. Në krahasim me kundrinën e drejtë, kundrina e zhdrejtë në përgjithësi dhe veçanërisht ajo e zhdrejtë me parafjalë është më pak e lidhur me fjalën që ajo plotëson. Përgjithësisht mund të thuhet se deri në një farë mase kundrina e zhdrejtë pa parafjalë ka ndryshime kuptimore me atë me parafjalë. “*Herë- herë nuk ka një kufij të prerë në përdorimin midis kundrinës së drejtë e të zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinës së zhdrejtë me parafjalë; ndonjëherë kemi sinonimi e mundësi kthimi nga një mënyrëshprehjeje në mënyrën tjetër.*”³¹⁴:

E besoj atë.

I besoj atij.

E ndihmoj shoqen.

I ndihmoj shoqes.

Takoj Artanin.

Takohem me Artanin.

³¹³Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 43

³¹⁴Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Istituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe III, Sintaksa (I. sintaksa e fjalisë), (1989), ribotim Tiranë 2002, f. 256

Asaj i sillej mirë.

Me të sillej mirë.

I ngjan të atit.

Ngjan me të atin.

5. Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë

Kundrina e zhdrejtë e shprehur me emra, përemra, ose një pjesë të emëruar të ligjëratës në rasën dhanore, “*mund të shprehë, nga njëra anë, sipas kuptimit të foljes dhe nga ana tjetër sipas kuptimit të emrit ose përemrit që shpreh kundranorin, nuanca të ndryshme semantike.*”³¹⁵

Si u vu re nga përkufizimi më lart kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shprehet me të njëjtat pjesë të ligjëratës si kundrina e drejtë. Gjithashtu vlen të theksohet se në ndryshim nga kundrina e drejtë, kundrina e zhdrejtë pa parafjalë nuk shpreh kundrinë të brendshme, duke qenë se ndërtohet zakonisht me folje dhe shpreh objekt të jashtëm.³¹⁶

Me një funksion të tillë, sipas Përnaskës kundrina e zhdrejtë në rasën dhanore shpreh vetën që pret veprimin e foljes, domethënë vetën që nuk është kryefjalë, por kundrinë e veprimit të shprehur nga folja. Si pasojë ajo mund të shprehë vetën së cilës i drejtohet apo i adresohet veprimi, si dhe vetën e interesuar për veprimin e shprehur nga folja.³¹⁷

Çeliku, thekson se “*Kundrinori i rasës dhanore përfshihet në çdo rast në veprimin a gjendjen e shprehur nga folja. Ai shënon shpesh një person i cili ndikohet nga veprimi i foljes, herë- herë në një mënyrë materiale duke përjetuar si rrjedhim një gjendje të re. Kundrinori i zhdrejtë është element themelor që ndërton nënmodele thëniesh të caktuara.*” Çeliku më tej nënvizon se duke qenë se kundrina e zhdrejtë luan rolin e plotësorit në fjali, lënia jashtë e saj do ta bënte fjalinë jogramatikore.³¹⁸

Përsa i përket foljes me të cilën ndërtohet kundrina e zhdrejtë pa parafjalë, mund të thuhet se ajo mund të jetë e çdo diateze, mund të jetë njëvetore, pavetore, kalimtare ose jokalimtare.

U çoi bukë **të dënuarve**.

Sëmundja ia shkurtoi jetën **plakës**.

I ra **flautit**.

³¹⁵Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 60

³¹⁶Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe III, Sintaksa (I. sintaksa e fjalisë), (1989), ribotim Tiranë 2002, f. 256

³¹⁷Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 60

³¹⁸Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 166

Atij i shfaqej si nëpër ëndërr fytyra e **nënës**.

Nuk i flihej **asaj**.

Gjithashtu si është përmendur në fillim të këtij kreu, kundrina e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe mund të drejtohet dhe nga një emër foljor.:

Qëllimi i kësaj vepre është shpëtimi dhe dhënia **brezave** që do të vijnë.

Dhënia e tokës **fshatarëve** ngjalli te ata dëshirën dhe interesin për shfrytëzim më të mirë të saj.

“Kundrina e zhdrejtë mund të përdoret edhe me një pjesore.:

*U përurua obelisku kushtuar **pionierëve** të arsimit, të shkollës dhe të gjuhës shqipe.*

Në parrulla, thënie të thukëta, tituj, në fjali të paplota, ku nënkuptohet një folje, sidomos në fjali nxitëse- thirrmore, del herë- herë një kundrinë e zhdrejtë në dhanore.”³¹⁹:

Lavdi të përjetshme **dëshmorëve** të kombit.

Vdekje **fashizmit**, liri **popullit**.

Nder **punës**.

Më shumë premtime **popullit**.

Këngë **nënës**.

Kundrinën e zhdrejtë pa parafjalëme folje kalimtare veprorë mund ta gjejmë në një fjali bashkë me një kundrinë të drejtë, ku kjo e fundit shpreh një send ndërsa kundrina e zhdrejtë frymor.:

I dhashë **librin nxënësit**.

Çdo muaj i dërgon **kartolinë familjes**.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm mes kundrinës së drejtë dhe asaj të zhdrejtë pa parafjalë është fakti se kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shenjohet gjithmonë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor. Ky përdorim i detyruar i trajtës së shkurtër, e cila shoqëron

³¹⁹Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 257

në çdo rast foljen, dëshmon më së miri “*lidhjen e ngushtë dhe të domosdoshme të kundrinorit të rasës dhanore me foljen, së cilës i referohet.*”³²⁰

Tanit po i thahej pështyma.

Vajzës i pëlqeu jeta e fshatit.

Njëlloj si kundrina e drejtë dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë mund të eliminohet në raste të caktuara.:

Vajza i ngjan asaj.

Vajza i ngjan.

Ndryshe nga kundrina e drejtë, kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mbetet e pandryshuar gjatë kthimit të fjalisë në pësore.³²¹:

Fqinjët u ndihmuan **të plagosurve.**

Të plagosurve iu ndihmua (prej fqinjëve).

5.1. Nuanca semantike të shprehura nga kundrina e zhdrejtë pa parafjalë.

Sipas kuptimit të foljes dhe emrit ose përemrit që shpreh kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë, kjo e fundit mund të shprehë ngjyrimë të ndryshme semantike. Përnaska këto kundrina i quan “kundrinë e zhdrejtë e pritjes”. Bazuar tek Përnaska³²² të gjitha këto nuanca do përmenden duke u ilustruar me shembuj në vijim.:

1. Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shënon zakonisht pritësin dhe mund të shprehë vetën së cilës i drejtohet veprimi, vetën së cilës i lihet apo i jepet diçka, vetën së cilës i kumtohet apo i shpallet diçka, vetën që ka të bëjë me diçka ose vetën së cilës i shkaktohet diçka:

Kundrina e zhdrejtë në dhanore, që shpreh vetën së cilës i lihet a i jepet diçka nga kryefjala vepruese, si rregull, sundohet nga folje kalimtare si: shpie, sjell, jap, çoj, dërgoj, postoj, kaloj, etj. që shprehin veprime të kundrinës ndaj vetës që i pret.

Ia dhashë librin Verës

U çoj ujë dhe bukë ushtarëve.

³²⁰Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 167

³²¹Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 437

³²²Përnaska, Remzi, *Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2000, f. 60- 61

U solli **mysafirëve** mezetë, gjellët dhe frutat.

Këta librado t'ia dërgojmë **mësueses** për 7 marsin.

I lashë të holla **nënës**.

Gjithashtu sipas Përnaskës edhe pas disa foljeve jokalimtare që kanë të bëjnë si me qënie të gjalla ashtu edhe me sende, konkretë ose abstrakte, si: mbes, bie, qëllon, takon, rastis, hyj, vij, etj.. Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehë vetën së cilës i jepet ose i kalohet diçka. Në këtë rast, kundrina e shprehur nga emri ose përemri në rasën dhanore nuk është kundrinë e veprimit të foljes por kryefjalë logjike e veprimit të shprehur nga folja jokalimtare.

Asaj i mbeti turpi.

Më qëlloi **mua** kjo punë.

Më ra **mua** të sulmoj i pari.

Vajzës i hynë drithmat.

Më tej Përnaska thekson se pas foljesh jokalimtare si: vij, shkoj, ose vetvetore si: ndeshem, përplasem, afrohem, që shprehin një veprim të përgjithshëm, mund të vijë një kundrina e zhdrejtë pa parafjalë kur veprimet janë të brendshme, domethënë kur ato tregojnë mendime, dëshira, etj. që i lindin një njeriu.:

Atij i shkoi mendja.

Asaj i ka ardhur një mendim.

Zakonisht kështu ndodh edhe kur folja shpreh dy veta, njëra që pret, që merr, tjetra që vepron, që jep. Veprimi theksohet më shumë në këto raste sesa kundrina që pret, që merr:

Kur **i** shkon **Shqiptarit** miku në shtëpi, e pret me bujari.

Mësuesit tonë **i** vijnë shpesh miq nga fshati.

2.Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë, e cila shpreh vetën që vëmë në dijeni, që e informojmë ose vetën me të cilën komunikojmë, si rregull. Përnaska shprehet se kjo kundrinë ”*vjen për folje që shprehin veprime të ndjera nga veta së cilës i drejtohen, si:them,shkruaj,shpall,njoftoj,porosis,lejoj,tregoj,shkel syrin,bëj me kokë,bëj shenjë, etj.*

Në qoftë se kundranori i zhdrejtë në dhanore shpreh vetën së cilës i drejtohet informacioni, kundranori i drejtë që mund ta shoqërojë shpreh përmbajtjen e këtij informacioni.”³²³:

Thuaja **Skënderit** mendimin tim.

U tregonte **nxënësve** kujtime nga fëmijëria.

Gjithashtu Përnaska shprehet se kundrina e zhdrejtëpa parafjalë që shpreh vetën së cilës i drejtohet informacioni, më së shpeshti vjen për folje jokalimtare ose vetvetore, kryefjala e së cilave shpreh kundrinën e veprimit, kurse kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shpreh vetën së cilës i kumtohet diçka.:

U fola **seminaristëve** për organizimin e mirë të orës së mësimi.

M'u lutën t'iu tregoja **seminaristëve** për psikologjinë e fëmijës.

3. Në rastin e përdorimit të foljeve ndihmoj, shërbej, pengoj, ngatërroj, dëmtoj, shkaktoj, shpie, marr, furnizoj, bëj, siguroj, etj., falë veprimit të shprehur prej tyre, kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shpreh vetën në dëm ose në dobi të së cilës kryefjala kryen veprimin. Nëse kundrina e drejtë është e pranishme, në këtë rast ajo shpreh rezultatin e këtyre veprimeve.:

Ua bëj këto ndere **miqve** nga mirënjohja.

Usollët shërbime të vyera **studentëve** kur u dhuroat këta fjalorë.

Gjithashtu, kjo kundrinë mund të drejtohet dhe nga folje, që shprehin veprim që synon një pjesë të kundrinës.

I shtëngoju dorën **asaj**.

I shkundu dorën **shoqes**.

Ia përvesha mëngët **bashkëshortes** sime.

Ia zuri gojën **oratorit**.

Artanit i dhembin sytë kur lexon shtrirë.

Netës iu rrit djali dhe iu bë për ushtar.

³²³Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 61

Asaj ia lexova mendimin pa hapur gojën.

4. Pas disa foljesh jokalimtare ose vetvetore kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shpreh vetën së cilës, si rezultat i veprimit të shprehur nga folja, i shkëputet apo i largohet diçka, ose përkundrazi i afrohet apo ngjitet diçka.:

Të gjorës vajzë i ikën paratë.

Luanit i largohen gjithë kafshët e tjera.

Nuk i ndaheshin **armikut**.

Iu afrua **qytetit**.

Që t'u largohej **këtyre andrrallave**, ajo u përpoq ta kalonte kohën me punë.

5. Kundrina e zhdrejtë në rasën dhanore për folje kalimtare mund të shprehë vetën për të cilën është përfutur kundrina e veprimit:

Fëmijëve u përgatisni ushtrime sipas moshës dhe aftësive.

T' **iu** mprehim mendimin **brezave** të ardhshëm.

5.2.Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e zhdrejtë pa parafjalë.

Kundrina e zhdrejtëpa parafjalë ashtu si kundrina e drejtë mund të shprehet me një fjalë të vetme e cila mund të jetë një emër, përemër, numëror me përdorim emëror, një pjesë të emërzuar të ligjëratës, ose me një togfjalësh apo një fjali të tërë.

1. Në rastet kur kundrina e zhdrejtë shprehet me një fjalë të vetme, ajo vendoset në rasën dhanore pa parafjalë. Në këtë rast ajo shprehet nga pjesët e mëposhtme të ligjëratës:

- Emër të shquar ose të pashquar në rasën kallëzore:

Djalit i erdhi shumë keq.

Vetëm **një qytetari i** ka buzëqeshur fati.

- Përemër të çdo lloji (vetor, vetvetor, dëftor, pronor, lidhor, pyetës, i pacaktuar) me përdorim emëror:

Asaj i edhi rëndë nga pyetja.

Çudi si u punon mendja **disave**.

Ai kurrë nuk i kishte folur **kujt** asnjë fjalë.

Zana nuk deshi të më përgjigjej **mua**.

Këtyre u ka hije flamuri.

- Numëror me përdorim emëror:

U kish ngrirë buzëqeshja **të dyve**.

- Me një pjesë të emëruar të ligjërates:

Loti i njomi **të voglës** faqen në atë shtrëngim dhëmbsurie.

Ai u drejtua nga dera për ti paraprirë **së keqes**.

2.Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehet me një togfjalësh, i cili mund të jetë, frazeologjik ose i lirë.

Më poshtë do ilustrohen me shembuj ndërtimet më të përdorura:

- Togfjalëshi emër + emër.:

E njëjta përgjigje iu dha **shumicës së studentëve**.

- Togfjalëshi përemër + emër:

Këtij njeriu t'i besoni për çdo gjë.

- Togfjalëshi mbiemër + emër:

Do i vijë në ndihmë edhe **së shkretës Afërditë**.

- Togfjalëshi përemër + përemër:

- **Gjithkujt prej nesh**, qysh në fëmijëri, i ka rënë rasti të shikojë ylberin..

- Togfjalëshi numëror + përemër

Nga gjithë ata të ardhur vetëm **dy prej tyre** nuk i zinte besë. .

- Togfjalëshi numëror + emër:

Homazhet iu bënë **pesëqind të vrarëve**.

Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehet dhe me një togfjalësh më pak të lirë se ata që sapo u përmendën më sipër. Në këto raste bëhet fjalë për emërtime institucionesh apo formula të tjera të ngjashme.:

Ai pohonte se e ia kishte drejtuar kërkesën **Fakultetit juridik**.

Mësuesi iu referua **një fjale të urtë**.

3. Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehet edhe me një fjali të tërë, me kusht që ajo të jetë e emëruar kontekstualisht.:

Kush ha hudhra, i vjen era.

Shenjimi i kundrinës së zhdrejtëpa parafjalë me trajtë të shkurtër

Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe shenjohe në çdo rast nga trajta e shkurtër e përemrit vetor: *”e cila vihet menjëherë para ose pas foljes, në kushte të caktuara edhe midis temës e mbaresës vetore të foljes.”*³²⁴:

Të dy miqtë **i shtrënguan dorën njëri-tjetrit**.

Afrojuni **derës**.

Në rastin e kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë, trajta e shkurtër e përemrit vetor është e pranishme edhe kur situata konkrete e ligjërimit ose konteksti e bëjnë të panevojshme praninë e vetë kundrinës së zhdrejtë.:

Vajza **na** tregoi për ditët e bukura të kaluara në mal.

Kur dëgjova kërcitjen e degëve, rreziku **m’u** duk më pranë.

Teksa e shoh **më** mbushet zemra me gëzim.

I këndon violina në duar.

Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të shenjohe nga trajtat e shkurtra të përemrave vetorë të të tri vetave, si në njëjës dhe në shumës.:

Mua më thirrën të parën.

Ty të erdhi lajmi.

³²⁴Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 257

Vajzës i rridhnin lotët rrëke.

Neve na erdhi për shtat vendimi.

Juve juthirrën papritur në sallë.

Atyre u erdhi për të qeshur nga fjalët e saj.

Shenjimin e kundrinës me trajtë të shkurtër do e trajtoj në vijim në mënyrë më të detajuar.

6. Shenjimi i kundrinës së drejtë e të zhdrejtë pa parafjalë nga trajtat e shkurtra të përemrave vetorë.

6.1. Vështrim historik.

Dukuria sintaksore e shenjimit të kundrinës së drejtë e të zhdrejtë pa parafjalë me anë të trajtave të shkurtra të përemrave vetorë, të quajtura ndryshe dhe forma të patheksuara përemërore, e cila është përhapur ku më shumë e ku më pak në të gjitha gjuhët ballkanike, është vështruar në përgjithësi si një ballkanizëm. Si rrjedhim, edhe kësaj dukurie sintaksore të gjuhëve ballkanike i është kushtuar vëmendje në pothuaj të gjitha veprat për ato gjuhë, duke tërhequr vëmendjen e ballkanistëve dhe të studiuesve të gjuhëve të veçanta ballkanike kryesisht gjatë shekullit XX dhe veçanërisht gjatë këtyre dyzet viteve të fundit. Ata, në përgjithësi, janë përpjekur jo vetëm të përshkruajnë kushtet sintaksore të shfaqjes së kësaj dukurie, por edhe të shpjegojnë rrethanat e përhapjes së saj në gjuhët e ndryshme ballkanike.

Nga këto studime të botuara tashmë është bërë e qartë se shenjimi i kundrinave është përftuar në gjuhën shqipe, rumune, bullgare, maqedonase dhe greke, por vërehet se ajo ndeshet edhe në disa dialekte serbe dhe kroate. Por një zhvillim më të madh kjo dukuri sintaksore ka marrë sidomos në gjuhën shqipe dhe atë maqedonase.

Këtë dukuri në gjuhën shqipe e paraqiti për herë të parë Da Leçe në gramatikën e tij të vitit 1716 duke i quajtur trajtat e shkurtra pjesëza “particele”. Ndërsa gjuhëtari i parë që është marrë më gjerësisht me këtë dukuri sintaksore duke e trajtuar atë si një dukuri të gjuhëve ballkanike dhe më konkretisht asaj shqipe, rumanishte, bullgarishte, maqedonishte dhe greqishte, ka qenë Mikloshiçi në vitin 1861. Ndërsa vërehet se janë trajtuar më vonë dhe nga gjuhëtarët Myderrizi e Cipo. Ky i fundit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë duke i kushtuar një nënkre dhe duke i pasqyruar dhe në një tabelë trajtat e shkurtra të përemrit vetor që shenjojnë kundrinën.³²⁵

³²⁵Përnaska, Remzi, "A janë përemra ‘trajtat e shkurtra të përemrave vetorë’ në shqipen e sotme?", *Studime filologjike*, 1982, 4, ff. 199-212.

Nga studiuesit e huaj që janë marrë me shenjimin e kundrinës me trajta të shkurtra të përemrit vetor do veçoja Oda Buholc, e cila në vitin 1977 ka mbrojtur dizertacionin me titull “Zur verdoppelung der Objekte im Albanischen/ Dyfishimi i kundrinave në gjuhën shqipe”. Ajo është gjithashtu bashkëautore bashkë me Vilfrid Fidler e tekstit “Albanische Grammatik/ Gramatika e shqipes” botuar në vitin 1987, tekst në të cilin ajo ka hartuar pjesën e sintaksës dhe ku i ka kushtuar një kapitull të veçantë e mjaft të detajuar trajtimit të shenjimit të kundrinës me trajtë të shkurtër si dhe autore e shumë studimeve të tjera në fushën e sintaksës. Vepra e saj sjell mjaft risi për gramatikën e gjuhës shqipe duke dhënë kështu një kontribut mjaft të çmuar në këtë fushë.

Vërehet se studiues të ndryshëm përdorin terma të ndryshëm në lidhje me dukurinë në fjalë, siç janë: **shenjimi i kundrinës** tek Sintaksa II, botim i Akademisë së shkencave, **rimarrja e kundrinës** tek Demiraj, apo **Objektsverdoppelung/ dyfishimi i kundrinës** tek Buholc/Fidler. Gjithashtu dhe për termin **trajta e shkurtër e përemrit vetor** si term përgjithësues duke qenë se e hasim në shumicën e gramatikave të gjuhës shqipe, por gjejmë dhe terma analog të tij si **Objektszeichen/ shenjuesi i kundrinës** tek Buholc/Fidler, **formante gramatikore** tek Çeliku, apo **format e patheksuara të përemrit vetor** tek Demiraj.

Në lidhje me kundrinat mund të thuhet se një nga dukuritë më të rëndësishme në gjuhën shqipe, e përfutur gjatë evolucionit historik të saj është shenjimi i saj me trajtë të shkurtër të përemrit vetor: “*d.m.th. të shprehurit e kundrinave dyherësh, nëpërmjet një forme përemërore të theksuar, një forme emërore, një togfjalëshi, a një fjalie të tërë, si dhe nëpërmjet një forme të patheksuar të përemrit vetor.*”³²⁶

Përsa i përket evolucionit të saj historik, të cilin e gjejmë të detajuar në dy veprat e Demiraj, përkatësisht “Gramatika historike e gjuhës shqipe” dhe “Gjuhësia Ballkanike”, mund të arrihet në përfundimin se “*kundërvënia e krijuar në të shprehurit e kundrinave të drejta e të zhdrejta në shqipen e dokumentuar përfaqëson evolucionin e mëtejshëm të një dukurie sintaksore, që kishte nisur të shfaqej qysh në periudhën parashkrimore të kësaj gjuhe. Po të kemi parasysh se dukuria në shqyrtim paraqitet si një zhvillim i barabartë si tek Buzuku ashtu edhe tek autori më i vjetër i arbëreshëve të italisë, Matrënga (1592), atëherë zanafilla e saj duhet kërkuar, të paktën, qysh disa shekuj para shekullit XVI të e.r.*”³²⁷

Më tej ai shprehet se para se të zinte fill kjo dukuri sintaksore, në gjuhën shqipe kundërvënia *remë ~ temë* në të shprehurit e kundrinave realizohej nëpërmjet formave të theksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para, apo nëpërmjet një emri a togfjalëshi emëror etj., përkatësisht nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë për të tri vetat. Këto të fundit në një fazë edhe më të hershme kanë pasur një përbërje fonetike më të plotë. Por pikërisht për arsye të theksimit të tyre gjithnjë e më të dobët ato kanë pësuar prej kohësh reduktime të mëdha fonetike.

³²⁶Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f 584

³²⁷Demiraj, Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Shtëpia botuese Fokus, Shkup 2004, f. 91

“Të krahasohen p.sh. *më me mua/mue < +m-n, ti me ty ; u (sot ju) me ju; na, me sa duket, në këtë paraqitje fonetike del më e re; për sqarime të mëtejshme historike.*”³²⁸ Demiraj gjithashtu nxjerr në pah si faktorin kryesor, që i ka dhënë shkas shenjimit të kundrinave të shprehura nëpërmjet përemrave vetorë të dy vetave të para, synimin e folësit për të vënë në dukje sa më shumë këtu gjymtyrën plotësuese kryesore të kallëzuesit, kur ajo përbënte gjënë e re të kumtimit, remën.

Demiraj vë në dukje gjithashtu gjatë studimit të veprave të autorëve tanë të vjetër, në lidhje me këtë dukuri se shenjimi, përkatësisht mosshenjimi i kundrinës së drejtë të shprehur nëpërmjet përemrave vetorë të dy vetave të para tek ata kushtëzohet, në vija të përgjithshme, nga po ato rregullsi, që veprojnë në shqipen e sotme. “Një rregullsi e tillë bie në sy sidomos në veprat e Budit. Rastet e të shprehurit të kundrinës së drejtë në funksionin e *remës* vetëm me anë të formës së theksuar të përemrave vetorë të dy vetave të para tek ata janë të kufizuara, sidomos tek Budi.:

Tek *Buzuku*: a)... mbë emënit tat *muo më* shelbo...; ti *nş na* defendo...; u *t të të* lëvdonj...; u *juve* tue u pasunë ndë zemërë... etj.

a) Zotynë *t ruon*...; ...armatisi *ju*... etj. c) Përse ti *më* nxore n gjithë së këqiashit ...; ...përse aj *na* vizitoi... E ata qi u munduonë, ma mos u mundonjën... etj.

Tek *Budi*: a) *muo* laj-*më* a largo-*më*...; ...qi *nş na* ngushëlloi... etj.

b) Gjithëkush po thërret *t*, etj.

c) Veçë ti me *më* ndimuom ...; ... e me *na* lëshuom anci senxhiri..., etj.”³²⁹

Përsa i përket shenjimit të kundrinës së zhdrejtë me trajta të shkurtra të përemrit vetor, Demiraj vë re se tek autorët shqiptarë të shekujve XVI-XVII, sidomos tek *Buzuku* (1555), ajo nuk paraqitet si një dukuri e përgjithësuar. “Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë tek ata ndeshet më shumë, kur ajo shprehet nëpërmjet përemrave vetorë të dy vetave të para.”:

“a) (Pa rimarrje): U gjegjshë një za n qiellat qi *muo* tha. T të kloffsha dhanë e *tkloffsha* vum përpara... e *at*« dha të bekuomit. ... ti qi trajtove *farësë* umane... etj. (*Buzuku*). Kloftë bërë *mua*...; pr«r *neve* s«të e tu...; të japsh këshill të mirë të *tjerëvet* ... etj. (*Matrënga*).

b) (Me rimarrje): E *muo m* ep fuqi...; *t t* u nfaltë...; e *i* tha engjëlli *asaj*...; e *bamirëvet* tinëve u jep jetënë e amëshuome... etj. (*Buzuku*). Çë të keq *i* bën mëkata... *mëkatëtorit*? ... e nga *njij i* jep hirrë... etj. (*Matrënga*).”³³⁰

Ndërsa përsa i përket rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet përemrave vetorë të vetës së tretë, faktori kryesor qëi ka dhënë shkas në zanafillë do të ketë qenë dëshira

³²⁸Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f 456

³²⁹Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f. 585

³³⁰Demiraj, Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Shtëpia botuese Fokus, Shkup 2004, f. 91

e folësit për ta konkretizuar e për ta përcaktuar më mirë përmbajtjen kuptimore të atyre përemrave, të cilët kanë një kuptim shumë të pacaktuar.

Edhe përsa i përket shenjimit, përkatësisht mosshenjimit të kundrinës së drejtë nëpërmjet trajtave të shkurtra të vetës së tretë apo sipas Demiraj formave të patheksuara të përemrave vetorë të vetës së tretë, sipas tij ashtu si në rastin e dy vetave të para, në shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë, në vija të përgjithshme, kushtëzohet nga po ato rregullsi, që u vunë në dukje për shqipen e sotme.:

“a) pa rimarrje: Një nieri pat dy bij...; ... muo më ndiglo oratënë teme...: Defendo popullinë tand... (Buzuku).

b) me rimarrje:... e dësh«r kish bar këtë e t« me e nginjunë...; ...e të begatë të i lëshoi pa gjç... (Buzuku);... e ke me e grishunë emënitë e t« Jezu. U e di se aj të ngjalletë... (Buzuku).”³³¹

Në të dyja rastet e përmendura më sipër kemi të bëjmë me një nga shfaqjet e prirjes relativisht të hershme të gjuhës shqipe për një përdorim ridondant të mjeteve gjuhësore.

“Prania e kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë pa parafjalë shenjohet zakonisht nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, që vihet menjëherë para ose pas foljes, në kushte të caktuara edhe midis temës e mbaresës vetore të foljes.”³³²

Si përfundim mund të thuhet se duke qenë se shenjimi apo rimarrja e kundrinave të shprehura nëpërmjet trajtave të shkurtra të përemrave vetorë të dy vetave të para është përfutur në kushte sintaksore të ndryshme nga ato të rimarrjes së trajtës së shkurtër të vetës së tretë, vetvetiu lind pyetja nëse këto dy dukuri janë përfutur në mënyrë të pavarur dhe në kohë të ndryshme, apo janë përfutur në të njëjtën kohë si shfaqje të një faktori të përbashkët. Në rastin e parë do të duhej të përcaktohej edhe se cila nga këto dy dukuri është më e hershme dhe nëse ka ushtruar ndonjë ndikim në shfaqjen e dukurisë tjetër. Në lidhje me këtë Demiraj shprehet se sqarimi i këtyre pyetjeve bëhet mjaft i vështirë duke u nisur nga mungesa e një dokumentimi shkrimor më të hershëm të gjuhës shqipe.

Megjithatë, duke u mbështetur në të dhënat e shqipes së dokumentuar, Studiuesi Demiraj është përpjekur ti japë përgjigje këtyre pyetjeve si vijon.:

“Ka mjaft të ngjarë që këto dy dukuri të mos kenë zënë fill në të njëjtën kohë. Por cila prej tyre është përfutur më parë, kjo është shumë e vështirë të përcaktohet me saktësi. Po të nisemi nga përgjithësimi më i hershëm i rimarrjes së kundrinave të shprehura nëpërmjet vektorëve të dy vetave të para, gjë që ka shërbyer si një mjet ridondance për të vënë në dukje sa më shumë remën, atëherë mund të anohet -natyrisht me rezervë- nga mendimi që pikërisht këtu është shfaqur më parë kjo dukuri. Në një rast të tillë do

³³¹Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f. 593

³³²Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002

*të pranohej gjithashtu edhe një farë ndikimi mbi rimarrjen e kundrinave të shprehura me anë të vetorëve të vetës së tretë.*³³³

Përsa i përket stadi të tanishëm të hulumtimit në këtë fushë për çështjen në fjalë ka qëndrime të ndryshme, siç vërehet në tekstin e Mehmet Çelikut, i cili pohon se trajtat e shkurtra nuk janë kundrina dhe as nuk rimarin kundrinën në fjali. Ai i përcakton ato si ‘formante gramatikore’ të domosdoshme, të ngjashëm me mbaresat e foljeve, me nyjet jo shquese të emrave etj.: “*Kalimi në fjalë- forma gramatikore mbështetet edhe në faktin se ato shfaqen të reduktuara, shpesh të bashkuara me formante të tjera foljore dhe pozicionohen detyrimisht para foljes, në disa raste edhe në trup të saj.*”³³⁴ Ai mendon se ato përfshihen në kategorinë e caktuesorëve. Ai e argumenton këtë qëndrim të tijin ndër të tjera me faktin se ato gjejnë përdorim të detyrueshëm pranë foljeve kalimtare.

*“Trajatat e shkurtra të përemrave vetorë, duke shenjuar kalimtarësinë e foljes, janë shprehëse të kuptimit aktual të foljes në thënien konkrete.”*³³⁵ Trajatat e shkurtra të përemrave sipas autorit luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin semantik të foljes dhe për përdorimin e saj në thënie. Ai nuk i sheh ato si fjalë emërtuese, por sipas tij ato në çdo rast formojnë një përbërës sintaksor së bashku me foljen, së cilës zakonisht i paraprijnë, duke mos funksionuar më vete si kundrinorë. Gjithshtu sipas tij “*trajta e shkurtër së bashku me foljen kalimtare do të merren si përbërës i vetëm jo vetëm kur trajta e shkurtër shoqëron rasën dhanore, por edhe kur shoqëron rasën kallëzore, qoftë e detyrueshme, qoftë fakultative.*”³³⁶

Një këndvështrim disi të ndryshëm, por që përbën mjaft interes gjejmë dhe tek Përnaska³³⁷, Ai nuk i sheh trajtat e shkurtra të përemrave vetorë as si përemra e as si fjalë. “*E po nuk qenë fjalë mbeten të jenë pjesë fjale.*”³³⁸ Duke marrë parasysh faktin se trajtat e shkurtra gjenden gjithmonë para ose pas rrënjës së foljes ai i sheh ato si të pashkëputshme nga folja. Ky fakt sipas tij lë shteg për një trajtim të zgjedhimit të foljes në gjuhën shqipe, jo vetëm si subjektor, por edhe objektor sui generis.

Në këtë kumtesë Përnaska radhit dhe disa këndvështrime të ngjashme në lidhje me këtë temë të gjuhëtarit B. Bokshi, i cili gjithashtu i sheh trajtat e shkurtra të pashkëputshme nga folja, disa argumente të të cilit ai i përdor për të vërtetuar tezën e tij.

Madje ai vëren se një mendim të ngjashëm ka shprehur dhe Osman Myderizi, i cili shprehet se trajtat e patheksuara të përemrave vetorë të mos trajtohen veçmas foljes, po të trajtohen si afikse të foljes, madje i shkruan me vizë ndarëse, kur janë pas foljes.

³³³Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986

³³⁴Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 168

³³⁵Po aty, f. 169

³³⁶Po aty, f. 29

³³⁷Përnaska, Remzi: *Bashkësia e të ashtuquajturave trajta të shkurtrëra të përemrave vetorë dhe zgjedhimi nënanor- kundrinor (subjektor- objektor) sui generis në gjuhën e sotme shqipe*. Konferencë shkencore: *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë 2012, f. 403- 406

³³⁸Po aty, f. 403

Më tej Përnaska na njeh dhe mendimin e Selman Rizës, i cili sipas tij: ka vërejtur me të drejtë se në sintagmatikë të ashtuquajturat trajta të shkurtra të përemrave vetorë sillen ndaj trajtave të plota gjegjëse (kundrinor), po ashtu si mbaresat e foljeve ndaj përemrave me funksion kryefjale. Kjo sipas tij na jep skemën: Kryefjalë (1) + (2) Folje+ Kundrinor(2). Nga këtu autori del në konkluzionin se sipas tij ky është një argument i mjaftueshëm që të ashtuquajturat sipas tij trajta të shkurtra të përemrave vetorë të mos shihen si përemra vetorë, por si mbaresa vetore të kundrinës te folja.³³⁹

Një mendim të kundërt me këndvështrimet e studiuesve të sipërpërmendur e gjejmë tek Demiraj, i cili i del në mbrojtje tezës "tradicionale" duke i parë trajtat e shkurtra si të veçuara nga folja e duke pranuar rimarrjen e tyre.: "*Me gjithë gramatikalizimin e plotë apo të pjesshëm të tyre format e patheksuara të përemrave vetorë nuk e kanë humbur identitetin e tyre morfologjik. Edhe kur përdoren për të rimarrë ose për të anticipuar kundrinat, ato janë morfologjikisht të veçueshme nga folja, me të cilën formojnë një njësi të vetme fonetike. Kjo del më qartë në rastin e formave të patheksuara të përemrit vetor të vetës së tretë në rasën kallëzore.*"³⁴⁰ Në këtë rast ai i sheh trajtat e shkurtra si përsëritëse të kundrinës së drejtë, vetëm kur ajo përfaqëson të njohurën e kumtimit, në të kundërt ato nuk gjejnë përdorim. Kjo kundërvënie sipas tij dëshmon se trajtat e shkurtra të përemrit vetor luajnë në këtë rast një rol funksional të caktuar.

Një trajtim krejtësisht të ndryshëm të trajtave të shkurtra të përemrit vetor gjejmë tek Koleci/ Turano. Autorët e trajtojnë çështjen në kuadër të gramatikës gjenerative, ku një vend të rëndësishëm zë përcaktimi i vendit, pozicionit të gjenerimit të tyre në frazë. 'Klitikalizimin' apo shenjimin e kundrinës autorët e trajtojnë bazuar në teorinë e gjuhëtarit gjenerativist Kayne të lëvizjes (move). Ndërsa më tej sintagmën klitike e trajtojnë bazuar në modelin e Sportiche, sipas të cilit klitikët janë koka reflektive që projektojnë një sintagmë klitike. CIP (Clitic Phrase). Ndërsa sipas pozicionimit të trajtës së shkurtër para, në mes apo pas në lidhje me foljen autorët bëjnë ndarjen përkatësisht në proklizë, enklizë dhe endoklizë.³⁴¹

Gjithsesi mund të thuhet se kjo çështje mbetet e hapur dhe ka ende shumë për të diskutuar, prandaj dhe në këtë punim pavarësisht opinioneve të ndryshme, jam mbështetur tek trajtimi i çështjes në fjalë në gramatikën tradicionale, parë nga i njëjti këndvështrim siç trajtohet dhe në tekstet shkolllore.

6.2. Formimi i trajtave të shkurtra të përemrit vetor si shenjues të kundrinës

Shenjuesit e kundrinave kanë origjinë përemërore duke qenë trajta të shkurtra të përemrit vetor.

³³⁹ Po aty, f. 406

³⁴⁰ Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f. 601

³⁴¹ Koleci, Flora; Turano, Giuseppina: *Hyrje në sintaksën gjenerative të gjuhës*, Shblu, Tiranë 2011, f.84-90

Siç vërehet në tabelën e mëposhtme veta e parë dhe e dytë njëjës është e njëjtë për të dyja rasat, si atë kallëzore dhe atë dhanore.

	Veta 1.	Veta 2.	Veta 3.
Njëjës	më (dhanore/kallëzore)	të (dhanore/kallëzore)	i (dhanore) e (kallëzore)
Shumës	na (dhanore/kallëzore)	ju (dhanore/kallëzore)	u (dhanore) i (kallëzore)

Ju të vetës së dytë shumës së rasës kallëzore dhe dhanore mund ta ndeshet dhe në formën **u**. Gjithashtu dhe **u** të vetës së tretë të rasës dhanore mund ta hasim në formën **i** dhe **ju**. Të dyja rastet e sipërpërmendura mund të hasen në ligjërimin popullor, por nuk janë pjesë e normës së shkruar letrare të gjuhës shqipe.

Kombinime të trajtave të shkurtra të përemrit vetor si shenjues të kundrinës:

Studuesja e gjuhës shqipe Oda Buholc e ndan në tre grupime formimin e shenjuesve të kundrinës me anë të trajtave të shkurtra si vijon³⁴²:

1. Kështu në rastin e parë kur shfaqen njëkohësisht si shenjuesi i rasës kallëzore, ashtu dhe ai i rasës dhanore, vërehet se shenjuesi i rasës dhanore e paraprin atë të kallëzores. Përse i përket shenjuesit të rasës kallëzore mund të shqyrtojmë vetëm **e** dhe **i** të vetës së tretë njëjës. “Bei der Kombination ergeben sich z.T. phonetische Veränderungen durch Krasis (**ma, ta**), Krasis Analogie (**jua, ua, ia**) und *ë*- Eliminierungen (**m’i, t’i**)./ Gjatë kombinimit kemi pjesërisht ndryshime fonetike me anë të Krasis³⁴³ (**ma, ta**), analogjia e Krasit (**jua, ua, ia**) dhe eliminimi i *ë*-së (**m’i, t’i**).

	Sh.k.zh.	Më	të	Na	ju	I	u
Sh. k.d.	e	ma	ta	na e	jua	ia	ua
	i	m’i	t’i	na i	jua	ia	ua

Në formë të prapavendosur kemi variantin ja: Jepja! Jepjani!.

³⁴²Buchholz, Oda, *Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen*, Linguistische Studien, 34, Reihe A. Arbeitsberichte, Berlin, 1977, f. 178

³⁴³Shkrirje e dy zanoreve në një

2.Kombinime të shenjuesit të kundrinës së zhdrejtë si dhanore etike me shenjues të tjerë:

	Sh. k.zh.: i/u	Sh.k. d.:e/i	Sh.k.zh/Sh.k. d.: ia/iu
Sh.k.zh	më m'i m'u	ma m'i na e na i	m'ia m'ua na ia na ua
	na na i na u		

3.Kombinime të shenjuesve të kundrinës me pjesëza:

“Die OZ kommen häufig mit anderen unbetonten Elementen zusammen vor, u.a. mit der Partikel **të** (konjunktivzeichen in verschiedenen Tempus- Modus formen des Verbs, sowie Bestandteil einiger infiniter Formen) und dem Nichtaktivzeichen **u**, dabei ergeben sich z.. T. Phonetische Veränderungen durch Krasis und **ë**- Eliminierung./ Shenjuesit e kundrinës hasen shpesh të shoqëruar nga elementë të tjerë të patheksuar, ndër të tjera me pjesëza (elementë që shërbejnë për formimin e kohëve dhe mënyrave të ndryshme të foljes, si dhe pjesë përbërëse të disa formave të pjesores), dhe me shenjën jo aktive **u**, ndodhin pjesërisht dhe ndryshime fonetike me anë të krasis dhe eliminim të ë-së.”³⁴⁴

të= Sh.k.zh./Sh.k. d: + më = të më, + na = të na, +të = të të, + ju = t’ju, + i = t’i + u = t’u, + e = ta

të + Sh.k.zh/ Sh.k.d: + ma = të ma, + m’i + të m’i, + na e= të na e, + na i = të na i, + ta = të ta, + t’i = të t’i, + jua = t’jua, + ua = t’ua, + ia = t’ia

Sh.k.zh. + u: më + u = m’u, të + u = t’u, i + u = iu/ ju, u + u = iu/ju, na + u = na u, ju + u = ju u

Ju na del në pozicion të prapavendosur: afroju/ afrojuni portës! Ndërsa në pozicion të paravendosur kemi **iu**: iu afrua derës. Më hollësisht kjo çështje do trajtohet në vijim.

Shenjimi i kundrinave me trajta të shkurtra të përemrit vetor, vështrim i përgjithshëm

“Die Objektsverdoppelung (so in der Balkanologie eingebürgerte Bezeichnung) ist eine syntaktische Erscheinung, die morphologisch ihren Niederschlag in der Setzung eines Objektzeichens bei dem Verb das das Objekt regiert, findet. Die Objektzeichen reflektieren bestimmte grammatische Merkmale des Objekts- die des Kasus: die Objektzeichen erscheinen im Akkusativ als Reflex des direkten Objekts, im Dativ als Reflex des indirekten Objekts- sowie die Merkmale des Numerus und der Person./

³⁴⁴Po aty, f. 450

Shenjimi i kundrinës (përcaktim i përdorur rëndom në Ballkanologji) është një dukuri sintaksore e cila në rafshin morfologjik shprehet me anë të vendosjes së një shenjuesi pranë foljes që lidhet me kundrinën. Shenjuesit e kundrinës reflektojnë disa karakteristika të caktuara të kundrinës, atë të rasës (shenjuesit e kundrinës dalin në rasën kallëzore si reflektim i kundrinës së drejtë, dhe në rasën dhanore si reflektim i kundrinës së zhdrejtë) si dhe karakteristika të numrit dhe gjinisë.”³⁴⁵

Siç duket qartë në tabelën pak më poshtë këto karakteristika përcaktojnë dhe formën e trajtave të shkurtra të përemrit vetor, të cilat shenjojnë kundrinën e drejtë e të zhdrejtë pa parafjalë.

Tek Sintaksa gjejmë përkufizim e mëposhtëm.: ”*Prania e kundrinës së drejtë, dhe të zhdrejtë pa parafjalë shenjohet zakonisht nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, që vihet menjëherë para ose pas foljes, në kushte të caktuara edhe midis temës e mbaresës vetore të foljes.*

Më konkretisht prania e kundrinës së drejtë të shprehur me emër, përemër a togfjalësh zakonisht shenjohet me anë të trajtës së shkurtër të përemrit vetor të vetës së parë e të dytë njëjës e shumës në rasën kallëzore”³⁴⁶:

Ajo **më** thirri **mua** për ndihmë.

E dorëzova **letrën**.

Tani mund t’i hapni **librat**.

Ajoi shkëputi të gjitha **lidhjet** me të kaluarën.

Aii edukonte **nxënësit** e saj me dashurinë për atdheun.

Siç do shohim dhe në nënkreun pasardhës, vetëm në kushte të caktuara ligjërimore prania e kundrinës së drejtë nuk shenjohet nga trajta e shkurtër e përemrit vetor.

Ndërsa prania e kundrinës të zhdrejtë pa parafjalë shenjohet në çdo situatë ligjërimore me anë të trajtës së shkurtër të përemrit vetor.:

Ne do t’i shërbejmë me nder **atdheut**.

Të dy mjekët **i** shtrënguan dorën **njëri tjetrit**.

Këtij i këndon kitara në duar.

³⁴⁵Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 439

³⁴⁶Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 258

Trajta e shkurtër e përemrit vetor është e pranishme edhe kur situata konkrete e ligjërit ose konteksti e bëjnë të panevojshme praninë e vetë kundrinës së zhdrejtë.:

Djali **na** tregon për ato ditë të bukura të kaluara gjatë pushimit.

Kur dëgjova kërcitjen e degëve, rreziku **m'u** duk më pranë.

Teksa e shoh **më** mbushet zemra me gëzim.

Format e trajtave të shkurtra të përemrit vetor, të cilat shenjojnë kundrinën e drejtë e të zhdrejtë pa parafjalë:

D)

Veta	Rasa	Numri njëjës		Numri shumës	
		Trajta e plotë	Trajta eshkurtër	Trajta e plotë	Trajta e shkurtër
Veta I	Emërore	unë	-	ne	
	Dhanore	mua	më	-	
	Kallëzore	mua	më	neve	na
	Rrjedhore	meje	-	ne	na
				nesh	-
Veta II	Emërore	Ti	-	ju	-
	Dhanore	ty	të	juve	ju
	Kallëzore	ty	të	ju	ju
	Rrjedhore	teje	-	jush	-
Veta III Gjinia femërore	Emërore	ajo	-	ato	-
	Dhanore	asaj	i	atyre	u
	Kallëzore	atë	e	ato	i
	Rrjedhore	asaj	-	atyre	-
Veta III Gjinia mashkullore	Emërore	ai	-	ata	-
	Dhanore	atij	i	atyre	u
	Kallëzore	atë	e	ata	i
	Rrjedhore	atij	i	atyre	-

II)

Trajta e shkurtër e kundrinës së zhdrejtë + Trajta e shkurtër e kundrinës së zhdrejtë +
trajta e shkurtër e kundrinës së drejtë në trajta e shkurtër e kundrinës së drejtë në
numrin njëjës numrin shumës

më + e = ma

më + i = m'i

të + e = ta

të + i = t'i

i + e = ia

i + i = ia

na + e = na e

na + i = na i

ju + e = jua

ju + i = jua

u + e = ua

u + i = ua

6.3.1. Shenjimi i kundrinës së drejtë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.

Shenjimi i kundrinës së drejtë varet kryesisht nga cilësitë gramatikore të kundrinës së drejtë dhe raportet kontekstuale. *“Sie äußern sich vor allem in dem engen Zusammenhang zwischen der Objektsverdoppelung und der Thema- Rhema Gliederung und den damit verbundenen Akzentregularitäten./* Ato shprehen veçanërisht në lidhjen e ngushtë mes shenjimit të kundrinës dhe raportit temë – remë si dhe rregullat e përdorimit të theksit që lidhen me të.”³⁴⁷

Sipas Demiraj, në gjuhën shqipe rimarrja e kundrinës së drejtë është bërë një dukuri e përgjithësuar, kur ajo shprehet me anë të formave të theksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para, pavarësisht nga topika e tyre para apo pas foljes kallëzues. Në këtë përdorim kundrina e drejtë përfaqëson remën e kumtimit. Kurse në rolin e temës së kumtimit në këtë rast ajo shprehet rregullisht vetëm nëpërmjet formave të patheksuara të përemrave vetorë të dy vetave të para në rasën kallëzore: më, të, na, ju (dikur u).³⁴⁸

Më merr (a merr**më**) edhe **mua**.

Unë **të** thirra **ty** dhe jo **atë**.

Nëna **më** (**të**) do, prandaj **më** (**të**) qorton.

Gjyshja **më** mori **mua** përdore.

Është turp për ne kur **të** shohim **ty** kështu.

Unë **ju** njoh **ju** prej kohësh.

³⁴⁷Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 440

³⁴⁸Demiraj, Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Shtëpia botuese Fokus, Shkup 2004, f. 90

Veprimtaria e Presidentit **na** intereson **ne** më shumë.

Ndryshe qëndron puna, kur kundrina e drejtë shprehet me fjalë të tjera (përveç përemrave vetorë të dy vetave të para). Në këtë rast, kur ajo përfaqëson temën e kumtimit, atëherë shprehet ose vetëm nëpërmjet formës së patheksuar të përemrit vetor të vetës së tretë, njëjës apo shumës (**e,i**), ose njëkohësisht edhe me formën e plotë të saj, që mund të jetë një emër, një togfjalësh emëror a një fjali e nënrenditur, apo një përemër çfarëdo (përfshijtur vetorët e dy vetave të para).

Sipas Demiraj duhej që, në bazë të këtij rregulli, edhe kur shprehet nëpërmjet përemrit lidhor **që**, kundrina e drejtë të shenjohej rregullisht me anë të trajtës së shkurtër të rasës kallëzore (**e**, përkatësisht **i**). Por një gjë e tillë nuk ndodh gjithmonë. Në raste të tilla kundrina e drejtë shenjohej, kur fjalia e nënrenditur lidhore ka funksion sqarues, dhe nuk shenjohej, kur kjo ka funksion faktues.:

a) Ishte edhe një fotograf, **që** e kishte zënë dimri aty pa mbaruar punë.

Shtrengoi trikon, **që** e kishte hedhur krahëve.

b) S'është gjë ajo **që** thua.

Martini hante i kërrusur mbi tepsinë, **që** kishte përpara.

Kundrina e drejtë shenjohej me trajtë të shkurtër gjithashtu dhe në rastet kur shprehet me përemër vetor të vetës së tretë, i cili i referohet personave apo çështjeve të caktuara të njohura, të përmendura më parë në kontekst, si dhe me përemrin dëftor **ky** në kontekst anaforik, si dhe përemrat **të gjithë**, **të tërë**.³⁴⁹:

Mbylle **dritaren**.

Tani mund t'i hapni **fletoret**.

Ai **i** shkëputi të gjitha **lidhjet** me të kaluarën.

Ajo **i** edukonte **nxënësit** e saj me dashurinë për shkencën.

Derën e dhomës mos e hap. Unë po **e** mbyll **atë**.

E vetmja gjë që mund të bëja ka qenë përgatitja e disa tezave të shkruara. Unë **i** lexova **ato** shumë ngadalë dhe dy herë.

Qëndronte me orë të tëra para veprave të piktorit duke **i** adhuruar **këto**.

Unë s'e ul **veten** aq shumë.

Hajduti në këtë mënyrë **e** zbuloi **veten**.

Kecat u fshehën, mirëpo ujku **i** gjeti **të gjithë**.

³⁴⁹Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 441

Sillmë, pe, gjilpërë, gërshërë... Keci ia solli **të gjitha**.

Gjithashtu “*edhe kundrina e drejtë, e cila shprehet me emër, e veçanërisht me përemër të vetës së tretë, ose kuptimisht të vetës së tretë, duke bartur theksin e frazës apo theksin logjik, mund të shenjohet në ligjërimin e gjallë popullor e ndonjëherë edhe në atë shkrimor, me anë të trajtës së shkurtër të përemrit vetor.*”³⁵⁰

Le të **ma** heqin **mishtë**, **mishtë** le të **ma** heqin, le të m’i thyejnë **eshtrat**, **eshtrat** le të m’i thyejnë, por dashurinë për ty kurrë kurrë s’do të **ma** thyejnë.

Kundrina e drejtë shenjohet gjithashtu nga trajta e shkurtër dhe në rastin kur ajo shprehet me një emër të shquar, i cili i referohet një fakti të njohur më parë ose me anë të përemrit dëftor **ky** në funksion anaforik. Emri i shquar me anë të të cilit është shprehur kundrina e drejtë në këtë rast mund të jetë i shoqëruar dhe nga një numëror rreshtor ose një përemër dëftor.

Ditë për ditë peshkatari merrte grepin, shkonte në breg, e hidhte **grepin** në det, dhe priste.

Nën gurin e përroit ka një bretkoce; po ta vrasin **bretkocën** menjëherë vera do të nisë të burojë.

Pas pak doli përsëri dhe hodhi në bar topin e artë. E bija e mbretit u gëzua shumë kur e pa **lodrën** e dashur.

Kali hovi jashtë i gëzuar. Kur e panë prijësi me trimat e tij **këtë kalë të bukur** donin ta zinin.

Kënga e partizanit të vogël i shpreh mirë **këto ide**.

Lëshoi një psherëtimë të hidhur sa jehoi gjithë pllaja. **Këtë psherëtimë** e dëgjoji edhe vetë prijësi.

Kur u err, na kthehentë shtatë xhuxhat. Kur borbardha i pa **të shtatë xhuxhat**, u tremb shumë.

Kjo kishte shtatë keca. Një ditë prej ditësh dhia i mblodhi **të shtatë kecat**.....

Nënë e bir i gjeti fjetur.

„Das *Objektszeichen im Akkusativ tritt auf, wenn außer dem direkten Objekt ein prädikatives Satzglied anwesend ist, das das Rhema bildet. Das gilt unabhängig davon, ob das direkte Objekt durch eine determinierte Nominalgruppe, einen Nebensatz oder Verbalkonstruktion.*./ Trajta e shkurtër në rasën kallëzore, është e pranishme në rastet

³⁵⁰Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 260

kur përveç kundrinës së drejtë, kemi dhe një gjymtyrë kallëzuesore, e cila formon remën.³⁵¹:

Bashkëkohësit e quanin **Aleksandër Moisiun** artist të jashtëzakonshëm.

Kryetari e konsideron si detyrë të rëndësishme, **që niveli i kulturës të ngrihet më shpejt/ të kujdeset për problemet e të rinjve.**

Gjithashtu, ata shprehen se në rastet kur kundrina e drejtë përfaqësohet me anë të një fjalie të nënrenditur, kemi të pranishme trajtën e shkurtër dhe në rast se situata e shprehur në fjalinë e nënrenditur, është e njohur duke qenë temë.:

Unë e dija se do të vonohet.

Të gjithë e kuptuan **se është gënjeshtar.**

Por vërehen dhe raste kur kundrina drejtë shënjohe nga trajta e shkurtër edhe pse shprehet me anë të një grupi emëror të papërcaktuar. Sipas Buholc/Fidler, bëhet fjalë veçanërisht për rastet kur „*in denen die Klassenzuordnung der (nicht näher spezifizierten) Referenten aufgrund konstitutiver oder kontekstueiler Bedingungen seitens des Senders beim Empfänger als bekannt vorausgesetzt werden kann- die betreffenden Referenten als Thema der Äußerung gewählt, um die Mitteilung darüber in den Vordergrund zu rücken und zum Rhema zu machen. (in den folgenden Beispielen wird die mögliche Position des Hauptakzents angegeben).* referenti (i cili nuk specifikohet nga afër), për shkak të kushteve konstitutive dhe kontekstore nga ana e dërguesit, mund të jetë i njohur paraprakisht nga marrësi, referentët përkatës janë tema e thënies, në mënyrë që ta vendosin në plan të dytë informacionin duke e bërë remë (në shembujt e mëposhtëm do jepet pozicioni mundshëm i theksit kryesor të fjalisë).³⁵²:

Vetëm sot mora vendim dhe po t' **a dërgoj një fotografi.**

S'të them dot sepse, po nuk jam dakort. Mjafton.- Domethënë e ké **një arsye.**

Ç' frikë pata unë mos i hidhje ndonjë fjalë..... **Një përgjigje e dónte ama.**

Midis atij togu letrash ai vetëm **një letër e hoqi mënjánë.**

Do t'**a kesh një hall.**

Çdo punë ty ta kanë bërë të tjerët.

Çdo gjë e duan gáti.

Një reagim të tillë nuk e kishte pritur kurrë.

Kur situata e ligjërimit e bën të panevojshëm edhe përdorimin e formës së plotë të kundrinës së drejtë, atëherë në këtë funksion përdoret vetëm forma përemërore e

³⁵¹Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 442

³⁵²Po aty

patheksuar e vetës së tretë. Por, duke qenë se kjo formë e patheksuar e rasës kallëzore (ndryshe nga ato të dy vetave të para) kuptimisht është shumë e pacaktuar, në mjaft raste ndihet nevoja që kuptimi i saj të konkretizohet nëpërmjet përdorimit të formës së plotë të kundrinës, që ajo përfaqëson.:

-**E** ke lexuar **romanin** e ri? – **E** kam lexuar.

- Kush **ta** tha **këtë**? – **Ma** tha Agimi.

Unë **e** njoh **personin**, për të cilin po më flet.

Unë **i** kam në rregull **detyrat**, që po na kërkoni.

Anasjelltas, kur kundrina e drejtë (e shprehur jo nëpërmjet vetorëve të dy vetave të para) përfaqëson remëne kumtimit, atëherë ajo nuk shenjohe nëpërmjet formës së patheksuar të rasës kallëzore (**e,i**). Në lidhje me këtë do shprehem më konkretisht në nënkreun pasardhës.

Kundrina e paravendosur :

Ngatërresa të mëdha ka nxjerrë fshati juaj.

Diçka fshihte kjo buzëqeshje.

Pikërisht **këtë** thotë edhe babai.

Kundrina e prapavendosur:

Ke thënë tamam **mendimin**, që kam edhe unë.

Ne këtëzja nuk kemi **hise** në gjënë e Perëndisë.

6.3.1.1.Mungesa e kundrinës së drejtë dhe mosshenjimi i saj me trajtë të shkurtër.

Ka raste kur kundrina e drejtë mungon, megjithëse është një gjymtyrë e detyrueshme.:

Sonte ne kishim lënë një takim me ju.

A nuk ju (**a**) tha kryetari?

Ishte e qartë: kryetari (**e**) kishte harruar.

Ajo u plagos, por shokëve s'u(**a**) tregoi.

Në rastet e mësipërme kundrina e drejtë nuk reflektohet as nga shenjimi i saj me trajtë të shkurtër, panvarësisht se i referohet një informacioni të njohur nga konteksti për marrësin dhe folësin. Megjithëse në këtë rast ajo dhe mund të vendoset:

jua tha, e kishte harruar, s'ua tregoi.

Mungesa e kundrinës në rastet e mësipërme, ndodh në rastet kur interesi kryesor i folësit bie tek veprimi i përcaktuar nga folja, duke e bërë kështu të parëndësishëm informacionin që përçon kundrina.:

Nuk deshi t'ï thoshte.

Mos (i) trego.

“Das direkte Objekt kann auch dann unausgedruckt bleiben, wenn diesen Referent nicht näher spezifiziert ist bzw. werden soll./ Kundrina e drejtë mund të mos shprehet, në rastet kur referenti që ajo përcakton nuk është e nevojshme të specifikohet”. Po të shohim shembujt e mëposhtëm, vërejmë se fjalitë mund të interpretohen në dy mënyra të ndryshme.:

Mbase nuk kanë.

Interpretim 1: Ndoshta nuk e kanë (atë).

Interpretim 2: Ndoshta nuk kanë asgjë.

Shembujt e mësipërm kanë lidhje me ndërtimet me folje, :“bei denen das direkte Objekt ein fakultativer Aktant ist, hier wird jedoch die Realisierung des Aktantes durch die Setzung/ Nichtsetzung des OZa differenziert- das OZa erscheint nicht, wenn der nichtspezifizierte Referent gar nicht ausgedruckt wird/ tek të cilat kundrina e drejtë është një aktant fakultativ, gjithsesi ndryshon realizimi i aktantit me shenjimin ose jo të kundrinës së drejtë me anë të trajtës së shkurtër, duke bërë që kjo e fundit të mos jetë e pranishme kur mungon kundrina”³⁵³:

Drini po lexon.

Në rastin kur në këtë ndërtim do ishte e pranishme kundrina e drejtë, ajo do reflektonte një fakt të njohur nga folësi.:

Drini po e lexon (gazetën, letrën etj.).

Vërehet se edhe kur situata konkrete e ligjëritimit ose konteksti e bëjnë të panevojshme praninë e vetë kundrinës së drejtë, trajta e shkurtër e përemrit vetor është e pranishme.:

A e kuptove shpjegimin? Po, e kuptova.

Populli dënoi zakonet e këqia, dhe i shkeli me këmbë.

“Als Reflex eines unbestimmt persönlichen Patiens, der nicht durch eine NGakk ausgedrückt wird, kann das OZa të (Merkmale: Akk,2. Ps. Sg) auftreten./” Si reflektim i një recipienti të papërcaktuar, i cili nuk mund të shprehet me anë të një sintagme emërore në rasën kallëzore, mund të ndeshim trajtën e shkurtër të.

³⁵³Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 448

Etimologjia që të jepet për gërhas nuk **të** bind.

*“Hier kann **ty** ‘dich’ nicht als Objekt eingesetzt werden (**të** dient nicht als Vertreter eines eliminierten Objekts, sondern lediglich als Indikator der Verb- Objekt-Beziehung)./ Në këtë rast **ty** nuk mund të vendoset si kundrinë (**të** nuk shërben si përfaqësues i kundrinës së eleminuar, por si indikator i raportit folje- kundrinë).”³⁵⁴*

Më poshtë do shtjellohen duke u ilustruar me shembuj rastet kur kundrina e drejtë nuk shenjohej nga trajta e shkurtër.

“Prania e kundrinës së drejtë siç u pohua më lart mund të shenjohej edhe me mungesën e trajtës së shkurtër të përemrit vetor të vetës së tretë.” Mungesa e përdorimit të saj kushtëzohet nga prespektiva funksionale e thënies; kur kundrina e drejtë bart theksin e frazës, ose dhe theksin logjik të thënies, kemi mungesë të pranisë së trajtës së shkurtër të përemrit vetor. “Kundrina e drejtë që bart të renë shprehet zakonisht me emër të pashquar, por ky mund të jetë edhe i shquar. Kundrina e drejtë që bart të renë është gjymtyra mbi të cilën bie theksi i fjales dhe ai logjik.”³⁵⁵

Atij **i** është dashur të derdhë shumë **mund** e shumë **djersë**.

Mendja ka mundur armiq më të fortë e jo më të mos mundë **shkusit** dhe **dhendurët** pleq.

Ky pohim përforcohet madje duke u shtjelluar më tej si vijon dhe nga Buholz/Fidler, të cilët shprehen se kur kundrina e drejtë është remë e kumtimit apo pjesë e saj, trajta e shkurtër nuk vendoset.³⁵⁶

-Kundrina e drejtë shprehet me një togfjalësh, i cili i fut në një kontekst të ri referentët.

-Sintagma emërore mund të jetë e papërcaktuar- me një emër të pashquar në bërthamën e saj:

Shko shpejt në shtëpi dhe sillmë **pe**, gërshërë dhe gjilpërë!

Sot bleva **një tapet të bukur**.

Atje shesin **një libër të ri të Kongolit**.

Ajo përsëriste **çdo tingull**.

Mësuesja kritikoi **disa nxënës**.

Na thuaj **ca shembuj**.

³⁵⁴Po aty

³⁵⁵Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 259

³⁵⁶Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 443

Në fillim lexonte **çdo roman që i binte në dorë.**

- Sintagma emërore mund të jetë e përcaktuar. Përcaktimi nuk kushtëzohet nga informacioni i njohur: bërthama e sintagmës emërore lidh një emër në formë të shquar, ose një përemër të përcaktuar. Këtu bëhet fjalë ndër të tjera për përemrin dëftor *ai* para përcaktorëve.:

Kolombi zbuloi **Amerikën.**

Dallëndyshet përcillnin **diellin madhështor.**

Nesër do të vizitojmë **uzinën.**

Ajo nxorri **shaminë** e fshiu **fytyrën.**

Danieli shpejtoi **hapin.**

Dje pashë **filmin “Beni ecën vetë”.**

Për zgjidhjen e kësaj çështje duhet të mobilizoni **të gjitha rezervat.**

Pjesëmarrësit kritikuan **ata të kryesisë.**

Me jep **atë të bardhën!**

Do të ftojme **ata që merren më këto probleme.**

Gjithashtu kemi mungesë të trajtës së shkurtër kur kundrina e drejtë shprehet me një sintagmë emërore në rasën kallëzore që përfshin përemrin dëftor *ky* në funksion kataforik.³⁵⁷:

Sot do të trajtojmë **këto**: tendencat e zhvillimit të leksikut, roli i fjalëformimit për pasurimin e tij,.... .

Nxënësit të parë i bëj **këtë pyetje**: Cili është parimi i vërtetimit të teoremës?

Mungesë të vendosjes së trajtës së shkurtërsipas tyr, kemi dhe kur kundrina e drejtë shprehet me anë të një fjalie të nënrenditur ose një ndërtimi foljor, kur situata e shprehur nuk është e njohur as paraprakisht.:

A do të më tregojnë mua zanat **se ku e kanë fuqinë?**

Ai vendosi **të marrë masa të rrepta kundër tyre.**

Gjithashtu trajta e shkurtër mungon kur kundrina e drejtë shprehet me anë të një tofjalëshi në rasën kallëzore, në vetën e tretë (që mund të jetë i përbërë nga emra ose përemra, që theksohet me anë të emfazës apo kontrastit.³⁵⁸:

³⁵⁷Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 443

³⁵⁸Po aty

Ajo ka botuar **dy romane**.

Në mbledhje kritikuan veçanërisht **vartësit**.

Më thanë pikërisht **atë që s'më duhet**.

Këtë desha, **këtë** dua.

Babai i dha Mozës një ftua e një mollë, por vajza hëngri vetëm **ftoin**.

Ne kishim pritur **Arbenin** dhe jo Dritanin.

Do të marr **këtë** se tjetra s'më pëlqen.

Ti kërkon të ngresh **veten** e të ulësh **të tjerët**.

Gjithashtu trajta e shkurtër nuk e shenjon kundrinën e drejtë kur kjo e fundit shprehet me anë të një përemri të pacaktuar, panvarësisht faktit nëse ai bart theksin e fjalës.:

Në punë nuk gjeti **asnjeri**.

Kë po kërkon?

Cilët do të marrësh?

Kam blerë **diçka**.

A takove **dikë**?

Nuk pashë **njeri**.

Ndonjëherë, kemi dhe raste veçanërisht në gjuhën popullore ku hasim dhe ndërtime të tjera ku vërehet mosprania e trajtës së shkurtër. Në këto raste bëhet fjalë për ndërtime jo normative:

Ai thirri **mua** e jo ty.

Ne ftuam vetëm **ju**.

Trajta e shkurtër nuk është e detyrueshme sipas Çelikut, para foljeve që plotësohen nga kundina të drejta dhe në këtë rast zakonisht nuk përdoret, megjithatë herë- herë ajo shtrihet analogjikisht, duke përbërë një përdorim fakultativ.³⁵⁹:

Qytetarët e Kosovës (**e**) kanë fituar të drejtën e sovranitetit.

Qytetarët e Kosovës (**e**) meritojnë pavarësinë.

³⁵⁹Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 171

6.3.2. Shenjimi i kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.

Në gjuhën shqipe trajtat e shkurtra të përemrave vetorë të të tri vetave, si në njëjës dhe në shumës janë gjithnjë të pranishme sa herë që në një fjali ka një kundrinë të zhdrejtë, e cila plotëson kallëzuesin e shprehur me anë të një foljeje.

“Në këtë funksion format e patheksuara të të tria vetave janë të vetëmjaftueshme, në rast se përmbajtja e tyre kuptimore del e qartë nga konteksti apo nga situata e ligjërit dhe në rast se folësi nuk e ndjen nevojën për ta vënë në dukje e për ta theksuar në mënyrë të spikatur kundrinën e zhdrejtë.

Shenjimi i kundrinës së zhdrejtë, është përgjithësuar në gjuhën shqipe, jo vetëm kur shprehet me përemra vetorë të dy vetave të para, por edhe kur shprehet me anë të një përemri vetor të vetës së tretë, ose të një përemri tjetër çfarëdo, ose nëpërmjet një emri a një togfjalëshi emëror.”³⁶⁰

Në rastin dy vetave të para shenjimi i kundrinës së zhdrejtë bëhet vetëm për arsye emfaze e në këtë rast mund të nxirret përfundimi se për qëllimin e kumtimit do të mjaftonte edhe vetëm forma e theksuar. Mirëpo një përdorim i tipit të mëposhtëm në shqipen e sotme nuk ndeshet gjëkund:

Ai tha mua (ty, neve, juve).

Ndërsa trajtat e shkurtra të vetës së tretë të rasës dhanore, në gjuhën shqipe siç u vu në dukje pak më sipër janë të pamungueshme edhe atëherë kur kundrina e zhdrejtë duhet shprehur patjetër nëpërmjet një emri, përemri a togfjalëshi. Këtu është fjala për ato raste kur as konteksti, as situata e ligjërit nuk do të lejonte të dilte e qartë brendia kuptimore e kundrinës së zhdrejtë, në qoftëse kjo do të shprehej vetëm me anë të një forme të patheksuar përemërore.³⁶¹

E thënë ndryshe, të shprehurit e kundrinës së zhdrejtë me anë të një emri, përemri a togfjalëshi, përgjithësisht bëhet për qartësi të kumtimit, e jo për arsye emfaze siç u tha më lart se ndodh me përemrat vetorë të dy vetave të para.

Sidoqoftë në përfundim Demiraj e quan të një karakteri ridondand rimarrjen e kundrinës së zhdrejtë me anë të një forme të patheksuar të përemrit vetor të vetës së parë, dytë e tretë njëjës apo shumës. Një përdorim të tillë ridondand në shqipen e sotme ai e përcakton si të pamënjanueshëm.

“Kundrina e zhdrejtë në shqipen e sotme rimerret pavarësisht nga topika e saj para apo pas foljes kallëzues. Në këtë përdorim ajo përfaqëson remën e kumtimit, kur shprehet nëpërmjet përemrave vetorë të dy vetave të para.”³⁶²

³⁶⁰Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f. 58

³⁶¹Po aty, f. 585

³⁶²Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f.91

Po të flas **ty** (e jo atij).

Ty po të flas.

M'i jep **mua** ato (dhe jo atij).

Mua mos **m'i** thuaj ato gjëra.

Më tej Demiraj ve në dukje se kur shprehet me anë përemrash të tjerë, ose me anë të një emri a të një togfjalëshi, shenjimi i kundrinës së zhdrejtë në shqipen e sotme bëhet jo vetëm kur përfaqëson remën, por edhe kur përfaqëson temën e kumtimit.:

Këtë libër jep-**j**-a vetëm **Anës**... (remë).

Anës i thamë, por nuk pati mundësi të vinte (temë).

Në funksionin e temës ajo mund të shprehet edhe vetëm me anë të formave të patheksuara të përemrit vetor të vetës së tretë në rasën dhanore, ashtu siç ndodh edhe me vetorët e dy vetave të para:

- **Të** tha gjë? - Jo, s'**më** tha gjë.

- A **i** dhe përgjigje (mësuesit)? – **I** dhashë.

- A **u** dhe për të ngrënë (fëmijëve)? – **U** dhashë. etj

Një pohim në thelb të ngjashëm në lidhje me këtë çështje gjejmë dhe tek Buholz/ Fidler. Sipas tyre “*Das OZd wird stets obligatorisch gesetzt, d.h. bei jedem Verb, das durch ein Dativ Objekt ergänzt wird, muß ein OZd auftreten, unabhängig davon, ob das Objekt Thema oder Rhema des Satzes ist bzw. zum Thema- oder Rhemabereich gehört, ob es durch eine determinierte oder indeterminierte NG repräsentiert wird, ob das Kernnomen der NG ein Pronomen oder Substantiv ist, ob es für die 1., 2., oder 3. Person markiert ist.*:/ Shenjuesi i kundrinës së dhanores vendoset gjithmonë me detyrim, dmth. tek të gjitha foljet, që marrin kundrinë të zhdrejtë duhet të ketë një shenjues të kundrinës rasës dhanore pamvarësisht faktit nëse kundrina është temë ose remë e fjalisë, apo nëse përfaqësohet nga një togfjalësh të përcaktuar ose të papërcaktuar, apo nëse fjala kryesore e togfjalëshit është shprehur me përemër apo emër, apo nëse i referohet vetës së 1., 2., apo 3.”³⁶³:

I dhashë sqarime **një nxënësi**.

U kam dërguarkartolina **dy shokëve**.

Këtyre duhet t'**u** ndihmoni.

Më vonë dot'**i futemi kësaj pune**

³⁶³Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 445

Me siguri do t'i pëlqejë **dikujt**.

Ajo s'i ndihmon **askujt**.

Shkolla i siguron **njeriut** punën.

Drita i ngjan shumë **atij**.

Ky teatër ndoshta do t'ju pëlqejë **juve**.

Ty s'të ka hije të sillesh kështu.

Fliste me zë të lartë për t'i dhënë zemër **vetes**.

Kënga **u** pëlqeu tërë **spektatorëve**.

Fjalitë që kanë një kundrinë të zhdrejtë, por ajo nuk shenjohej me trajtë të shkurtër nuk janë gramatikisht të sakta:

Dhashë shpjegime **një nxënësi**.

Ana ngjan shumë **atij**.

Në fjalitë eliptike pa praninë e foljes kemi dhe mungesën të shënjesit të kundrinës së zhdrejtë. Siç mund të shihet dhe në shembujt e mëposhtëm se trajta e shkurtër e përemrit vetor nuk përdoret, kjo pra për shkak se këtu folja mungon.:

Lavdi punës!

Vdekje fashizmit!

6.3.2.1. Trajta e shkurtër e përemrit vetor si dhanore etike.

Në raste të caktuara, prania e një trajte të shkurtër të përemrit vetor të vetës së parë ose të dytë, është vetëm mjet i përdorur për qëllime stilistikore, për t'i dhënë më gjallëri ligjërimin nëpërmjet lidhjes së veprimit me subjektet e tjerë; është dhanorja e quajtur nga disa studiues "dhanore etike". Ajo gjen përdorim zakonisht në gjuhën popullore dhe në letërsinë artistike.³⁶⁴³⁶⁵:

M't' ia futi një shuplakë syve.

Ç'm'u lëshuan tatëpjetë keto rrëke të egra.

Ato shporta me zymbyla e bathra e ç'të **më** doje e lanë me gojë hapur.

Korbi në një degë **na** kishte qëndruar dhe një copë djathë e kishte kafshuar.

³⁶⁴Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002

³⁶⁵Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012

Dhanorja etike mund të shprehet vetëm me anë të një shenjuesi të kundrinës së zhdrejtë. Ajo nuk mund të shprehet me anë të njëtogfjalëshi.³⁶⁶:

Maskara edhe hajdut **më** qenke bërë?

Një e karakteristikë tjetër e dhanores etike është se ajo në fjali vendoset përpara kundrinës së zhdrejtë dhe gjithashtu para kombinimeve me trajtë të shkurtër të kundrinës së drejtë e të zhdrejtë.:

Të **m'i** ndihmosh **motrës** sa më shumë.

Të **m'u** bësh të fala.

Të mos (**m'ia/m'ua**) prishni **qejfin**.

6.4. Shenjimi njëkohësisht i kundrinës së drejtë e të zhdrejtë me trajtë të shkurtër.

Nisur nga fakti se kundrina e zhdrejtë shenjohej gjithmonë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, nëse në një fjali gjejmë njëkohësisht një kundrinë të drejtë e një të zhdrejtë, kemi gjithmonë të pranishëm një shenjues të kundrinës së zhdrejtë.:

Desha t'i tregoj **mysafirrit** {një muze të ri/ disa kuriozitete}.

Nëse edhe kundrina e drejtë i përmbush kriteret për shenjimin e saj me një trajtë të shkurtër, atëherë kemi praninë e dy shenjues të kundrinave, një shenjues të kundrinës në rasën dhanore dhe një në rasën kallëzore:

Sot **ia** tregova **mysafirrit** {muzeun e ri/ gjithë kuriozitetet}.

Desha t'i tregoj **mysafirrit** {një muze të ri/ disa kuriozitete}.

Studiuesit Buholz/ Fidler dallojnë dhe shenjuesin e kundrinës së zhdrejtë e të drejtë, të cilët mund të përdoren dhe në të ashtëquajturën prej tyre formë pleonastike (pleonastisch) në fjali, të cilat kanë një folje e cila nuk plotësohet as nga kundrina e drejtë e as nga ajo e zhdrejtë. “Diese Erscheinung tritt u.a. bei shpie, çon, mban, nis und pëlçet auf. “/ Këtë dukuri e gjejmë ndër të tjera tek foljet shpie, çon, mban, nis dhe pëlçet”³⁶⁷:

Si **ia** shpini me verën?

Si **ia** çoni andej?

Ia {shpiem/ çojmë} mire.

Ia mbajti për Vlorë.

Ia mbajtën majtas.

³⁶⁶Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 447

³⁶⁷Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 444

Gjithashtu këtë dukuri e gjejmë kryesisht në gjuhën e folur të dialektit geg të përdorur në Kosovë:

Tash për mue **ia** nisën halle të tjera.

Ia plasi një shi i papritun.

6.5. Eliminimi i kundrinës së drejtë e të zhdrejtë.

Të dyja kundrinat mund të eliminohen në strukturën sipërfaqësore të gjuhës shqipe, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (1) Kundrina përfaqësohet nga një përemër vetor në vetën e 1./2./3.
- (2) Ështëi pranishëm shenjuesi përkatës i kundrinës. Këtu përjashtohet ndër të tjera eliminimi i kundrinës së zhdrejtë me parafjalë.
- (3) Kundrina nuk theksohet në mënyrë të veçantë me anë të emfazës, kontrastit ose të tjerave.³⁶⁸

Duke eliminuar kundrinën nuk kemi humbje të madhe të informacionit. Nga njëra anë kundrina përfaqësohet nga shenjuesi i kundrinës apo trajta e shkurtër e përemrit vetor, e cila reflekton dhe përputhet me kundrinën përkatëse në rasë, numër dhe vetë”. Kushtet për shenjimin e kundrinës janë të atilla që në rastet kur ajo mungon, është gjithmonë i pranishëm shenjuesi i saj apo trajta e shkurtër. Nga ana tjetër eliminimi i kundrinës bazohet tek specifika e përemrit vetor.

Gjithashtu duke studiuar këtë dukuri mund thuhet se eliminimi i kundrinës, përgjithësisht është një transformim jo i detyrueshëm. Zakonisht ndërtimet pa kundrinë, që përmbajnë vetëm trajtë të shquar, nuk janë ndërtime të izoluara. Ato janë në një tekst ose kontekst të caktuar, ku informacioni i nevojshëm është dhënë me anë të plotësimi të kushteve kontekstuale apo konstitutive.

Më poshtë disa shembuj të eliminimit të kundrinës së zhdrejtë:

Koncerti i pëlqeu (**asaj/ atij**).

Vëllai s’**të** ngjan fare.

Na doli bukur.

Si **ju** duket libri?

Teatri s’ **u** pëlqeu.

Ndërsa shembujt e mëposhtëm ilustrojnë eliminimin e kundrinës së drejtë:

Mësuesi **më** përshëndeti (**mua**).

Para shkollës **i** takova (**ata/ato**).

³⁶⁸ Po aty, f. 446

Të gjithë **na** ndihmuan (**neve**).

Na mashtroi.

Unë s' **të** marr në punë.

Ju detyrohemi shumë.

E dëgjova me ëndje.

Ndërtimet me trajtën e shkurtër në veten e tretë nuk gjejnë përdorim të shpeshtë në gjuhën shqipe pasi ato nuk japin informacion rreth gjinisë së kundrinës së eliminuar.³⁶⁹:

Koncerti **i** pëlqeu (**asaj/ atij**).

Para shkollësi takova (**ata/ ato**).

Gjithashtu dhe tek ndërtimet e llojit në vijim, nuk dallohet qartë numri i kundrinës së eliminuar.

Ua mori(**atë/ ato**).

Ndërsa për rastin e fjalive që kanë kundrinë të drejtë dhe të zhdrejtë, mund të eliminohet njëra prej tyre, ose në disa raste dhe të dyja:

Ua tha (**atë/ ato**) atyre.

Ua tha **atyre**.

Ua tha **atë/ato**.

Ua tha.

Mund të thuhet se vërehet se ndërtimet si në fjalinë parë shihen si ndërtime artificiale në gjuhën shqipe dhe përgjithësisht evitohen. Dhe fjalitë me ndërtim si në rastin e fjalisë së dytë e të tretë hasen rrallë në ligjërim. Në shumicën e rasteve eliminohen të dyja kundrinat, si në rastin e fjalisë së fundit.

6.6.Vendi i trajtës së shkurtër në raport me foljen.

Vendit në fjali të trajtave të shkurtra i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë Buholc/ Fidler në gramatikën e tyre të gjuhës shqipe. Ata i ndajnë ato bazuar në vendosjen para apo pas foljes në të prapavendosura dhe të paravendosura. Sipas tyre në fjalitë dëftore si dhe në fjalitë urdhërore mohuese trajtat e shkurtra i gjejmë të shkruara veç, në formë e paravendosur, dmth janë të vendosura para foljes kallëzues qoftë ky i thjeshtë apo i

³⁶⁹Po aty, f. 447

përbërë. Siç shihet autorët e shohin topikën e trajtave të shkurtra të lidhur ngushtë me foljen. Kjo ilustron prej tyre si më poshtë³⁷⁰:

Trajta e shkurtër + Folje finite: **e** mori, **i** ndihmoi, **ia** dha;

Trajta e shkurtër + folje finite + folje infinite: **e** ka marrë, **i** ka ndihmuar, **ia** ka dhënë;

Pjesëza (t) + trajta e shkurtër + folje finite: s'**e** merr, s'**i** ndihmon, s'**ia** jep, mos **e** merr, mos **i** ndihmo, mos **ia** jep, do **ta** marrë, do t'**i** ndihmojë, do t'**ia** japë, s'do **ta** marrë, s'do t'**i** ndihmojë, s'do t'**ia** japë;

Pjesëza (t) + trajta e shkurtër + folje finite + folje infinite: do **ta** këtë marrë, do t'**i** këtë ndihmuar, do t'**ia** këtë dhënë, s'do **ta** këtë marrë, s'do t'**i** këtë ndihmuar, s'do t'**ia** këtë dhënë.

Pjesëza (t) + trajta e shkurtër + folje infinite: për **ta** marrë, për t'**i** ndihmuar, për t'**ia** dhënë, për të mos **e** marrë, për të mos **i** ndihmuar, për të mos **ia** dhënë

Ndërsa për rastin e fjalive urdhërore jo mohuese, rendi i trajtës së shkurtër varet jo vetëm nga karakteristikat morfo-sintaksore të tyre, por edhe nga aspekti fonetik i trajtës së shkurtër dhe nga veta e foljes. Bëhet fjalë sipas tyre për trajtat e shkurtra **e**, **i**, **ia**, **u**, **ua**, **më**, **ma**, **m'i**, **na**, **na i**, duke qenë se trajtat e shkurtra të vetës së dytë nuk gjejnë përdorim në rastin e fjalive urdhërore. Në këto lloj fjalish trajtat e shkurtra që shenjojnë kundrinën mund të gjenden dhe në formë të prapavendosur, dmth si prapashtesë e foljes: merr- e- ni = merreni.

Në lidhje me këtë Buholz/ Fidler përcaktojnë rregullat e mëposhtme³⁷¹:

1) **na e**, **na**, janë krejtësisht të paravendosura, pavarësisht nëse folja është në njëjës ose në shumës.:

Na e/ na i sill; **na e/ na i sillni**;

2) Në rastin e: **e**, **i**, **ia** autorët dallojnë dy raste. Në rastin e parë **i** dhe **ia** marrin kryesisht pozicion të prapavendosur kur përdoren me folje në numrin njëjës: merre, ndihmo**ji**, jep**ja**. Ndërsa në rastin e dytë kur folja është në shumës, mund të përdoren si të paravendosura ose të prapavendosura: merren**i**, ndihmoj**ini**, jepjan**i**, ia jepn**i**.

3) **më**, **ma**, **m'i**, **u**, **ua**: këto trajta të shkurtra sipas tyre mund të jenë të prapavendosura ose të paravendosura kur përdoren me folje në numrin njëjës apo shumës, ku tek **ua** dhe **m'i** me folje në shumës dominon prokliza (Proklize):

³⁷⁰Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 451

³⁷¹Po aty

Shpëtomë/ më shpëto, shpëtomëni/ më shpëtoni, ndihmona/ na ndihmo, ndihmonani/ na ndihmoni, thuaju/ u thuaj të mos vonohen, thuajua/ ua thuaj, jepuani/ ua jepni, mbushma/ ma mbush, kthemani/ ma ktheni, lyemi/ m'i lyej, kthemini/ mi ktheni

7. Kundrina e zhdrejtë me parafjalë.

7.1. Vështrim historik i kundrinës së zhdrejtë me parafjalë.

Termi “parafjalë” dhe në gjuhën shqipe, ndeshet qysh në lashtësi, nisur kjo nga nevoja për krijimin e një mjeti gjuhësor që ndihmon për të shprehur marrëdhëniet sintaksore të emrit në fjali. Parafjala konsiderohej si një fjalëz shërbyese e cila vendosej para një emri apo një përemri. Në disa gjuhë indoevropiane parafjalët mund t’i gjejmë dhe të prapavendosura, por gjuhët që përbëjnë objektin e krahasimit të këtij punimi, gjuha shqipe dhe ajo gjermane, e kanë të paravendosur. “*Parafjalët vendosen rregullisht para një emri a përemri në një rasë të caktuar, për të shprehur lidhjet e tij sintaksore, përkatësisht me një gjymtyrë tjetër të shprehur nga një emër. Në rastin e parë togu parafjalë+emër kryen një funksion ndajfoljor (adverbal), ndërsa në rastin e dytë kryen një funksion ndajemëror (adnominal)*”.³⁷² Lindja e klasës së parafjalëve kushtëzohet, si çdo dukuri, nga disa faktorë, të cilët mund të veprojnë të veçuar, por shpesh edhe në bashkëveprim reciprok.

Parafjalët në familjen e gjuhëve indoevropiane, janë përftuar në një fazë të caktuar të zhvillimit të kësaj familjeje gjuhësh. Ato janë përftuar qysh në një fazë të hershme parahistorike, për çka dëshmon prania e tyre në të gjitha gjuhët indoevropiane, përfshirë këtu edhe ato që kanë një dokumentim shkrimor relativisht shumë të hershëm, si indishtja e vjetër, greqishtja e vjetër, latinishtja etj. Krijimi i kësaj klase fjalësh, që kanë ardhur duke luajtur një rol gjithnjë e më të madh në të shprehurit e lidhjeve sintaksore të emrit (dhe të përemrit) në fjali, është bërë i nevojshëm nga pamjaftueshmëria e formave rasore të emrit për të shprehur të gjitha nuancat e raporteve të tij sintaksore. Si rrjedhim, në një fazë të dhënë të zhvillimit të popujve që flisnin gjuhë a dialekt indoevropian, u ndje nevoja për një mjet të ri plotësues të sistemit rasor për t’i dhënë këtij mundësi të shprehte sa më mirë e sa më qartë funksionet më të ndryshme të emrit në fjali.³⁷³

Parafjalët i ndeshim për herë të parë në gjuhën greke, me emërtimin ‘prothesiss’, që do të thotë e vendosur përpara, term ky i përdorur për herë të parë nga gramatikani grek, Dionis Trakasi (170-190 p.e.s). Më pas ky term u kthye në ‘praeposito’ në gjuhën latine dhe vazhdon të ruhet sot në shumë gjuhë.

Në gjuhën shqipe ky term u përkthye për herë të parë nga Sami Frashëri me fjalën ‘parje’ ose ‘përparje’ në gramatikën e tij të vitit 1886. Në këtë gramatikë ai na jep këtë përkufizim për parafjalën: “*Parjetë janë ca fjalë të papërkthyer, të cilat vihen përpara emrave, për t’i ngjitur ata me foljet, si: rri në shtëpi, vete me ty.*” Ai jep edhe një listë

³⁷²Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, f. 625

³⁷³Po aty

parafjalësh. Gjithashtu autori vë në dukje se disa nga parafjalët e mësipërme, si: *pranë-, përpara-, pas-, tej- etj* “... kur përdoren vetëm janë mifolje si: *rri pranë, shkoj tej, eja pas; kur vihenë përpara një emëri janë parje, si: pranë shtëpisë, tej malit, pas murit.*”³⁷⁴

Ndërsa tek Xanoni në gramatikën e tij të vitit 1909 e ndeshim me termin ‘parapris’. Në kongresin e Lushnjës në 1920 u caktua termi ‘parafjalë’, që përdorim dhe sot. Parafjalët trajtohen dhe nga Ilia Dilo Sheperi, në gramatikën e tij të vitit 1927, por vetëm në aspektin morfologjik.

Vlen të theksohet se në rrafshin morfologjik parafjala është përmendur nga të gjithë gjuhëtarët në veprat e tyre në vitet në vijim.

Gjithashtu dhe Akademiku Shaban Demiraj³⁷⁵ e trajton parafjalën në një kre të veçantë të titulluar “Rreth parafjalëve”. Aty flitet edhe për përfitim historik të parafjalëve të vjetra, që kanë analoget e tyre edhe në gjuhë të tjera indoevropiane si: **në, për** etj.

Më gjerësisht në aspektin morfologjik, parafjala është trajtuar nga ana teorike në tekstin e hartuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë³⁷⁶. Në këtë tekst bëhet klasifikimi sipas prejardhjes, strukturës morfologjike, kriterit sintaksor si dhe janë dhënë kuptimet kryesore të tyre.

Gjithashtu për parafjalën janë bërë dhe disa punime shkencore, ku spikat ai i Xhuvanit³⁷⁷. Mund të thuhet se Xhuvani hodhi themelet për studimin e parafjalës si kategori leksiko-gramatikore. Një tjetër punim shkencor është dhe ai i Mahir Domit³⁷⁸. Në këtë punim ai i interpreton drejt ndërtimet me parafjalë emërore duke i vështruar ato me emrin e papërcaktuar “shprehje”, si dhe ka trajtuar përdorimin e parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene.

Mehmet Çeliku³⁷⁹ është një tjetër gjuhëtar, i cili i ka kushtuar disa studime parafjalëve. Në studimin e tij mbi parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe, janë trajtuar kryesisht parafjalët me origjinë emërore, kalimi i emrave nga një pjesë e veçantë e ligjëratës në një tjetër. Çeliku³⁸⁰ i ka trajtuar gjithashtu dhe lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare. Gjithashtu Mehmet Çeliku³⁸¹ ka trajtuar dhe disa parafjalë

³⁷⁴ Frashëri, Sami: *Shkronjëtorja*, Bukuresht: Shtypshkronja e shoqërisë Dritë 1886

³⁷⁵ Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, 1166 f

³⁷⁶ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Morfologjia, Tiranë, 1995, 452 f

³⁷⁷ Xhuvanit, Aleksandër, “*Parafjalët*”, Studime Filologjike, Tiranë 1964, I

³⁷⁸ Domi Mahir: Përdorimi i parafjalëve përpara gjymtyrëve homogjene. *Gjuha jone*, 2, 1988, f. 5-15..

³⁷⁹ Çeliku, Mehmet, *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe*, Studime filologjike, 1972, 1, ff. 85-109.

³⁸⁰ Çeliku, Mehmet, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe*, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, Tiranë, 1975

³⁸¹ Çeliku, Mehmet, Parafjalët foljore dhe disa çështje të formësimit të tyre”, botuar fillimisht në “Gjuha jonë”, nr. 4, 1990

me origjinë foljore nga pjesorja e foljes. Këto parafjalë përbëjnë një numër të kufizuar si: *lidhur me, ngjitur me, drejtuar nga, nisur nga*.

Ndërsa përsa i përket aspektit sintaksor të parafjalës, është Justin Rrota, autori, i cili për herë të parë e trajton parafjalën dhe në rrafshin sintaksor. Ai është i pari autor që përmend kundrinën me parafjalë ose siç e quan autori kundrina parafjalore, të cilën e përkufizon si më poshtë:

“Shpesh foljet, mbiemrat dhe ndajfoljet marrin për plotësim kuptimit një kundrinë emën, prim nga një parafjalë: prandej kjo thirret kundrinë parafjalore (ase objekt prepozicionar).”³⁸²

Ai gjithashtu dallon kundrinën me parafjalë nga rrethanori të cilin e quan ndajfoljor. Kjo përbën një risi, duke qenë se është një çështje mjaft e diskutuar nga gjuhëtarët deri në ditët e sotme.: *“Nganjihërë asht vështirë të dahet, kur emnat me parafjalë janë kundrina e kur janë rrethanë foljesh (ndajfoljore). Përgjithësisht janë kundrina, kur folja pa këto nuk ka një kuptim të plotë; jose kur pa to mund të kuptohet një gja për një tjetrë. Mjesa janë ndajfoljorë kur e caktojn veprën e foljes ma largtas, si mbas rrethanave të kohës, të mënyrës, të vendit e të shkakut. P.sh. Mbas shiut del dielli (ndajf.) Me u dhanun mbas këndimit (kundrinë). A mund të rri në fjalë tande? (kundrinë) Un rri në kopsht (ndajf) Paç veten në qafë (kundrinë) Shqipja fluturoi mbi re (ndajf).”³⁸³*

Ndërsa tek Kostaq Cipo³⁸⁴, në botimin e tij të vitit 1952 vërehet një mangësi, apo pasaktësi në lidhje me interpretimin e kundrinës së zhdrejtë me parafjalë si plotësa të vendit, kohës, mënyrës, shkakut, qëllimit, sasisë, masës e madje dhe si përcaktorë të cilësisë, lëndës etj.

Po ashtu dhe në tekstin me autor Domi/ Hajvari³⁸⁵ i vitit 1965 vërehet se megjithëse autorët ndalen gjerësisht te kundrinat, ata nuk e përmendin kundrinën me parafjalë.

Pas viteve 80, kundrinën e zhdrejtë me parafjalë e gjejmë të trajtuar në të gjitha gramatikat e gjuhës shqipe si dhe tekstet shkollore, si p.sh në tekstin Libri i gjuhës shqipe 3, Për shkollën e mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja, botuar në Tiranë në vitin 1985, ku ndeshim për herë të parë një trajtim teorik të detajuar dhe të saktë të kundrinës me parafjalë. Gjithashtu kundrinën me parafjalë e gjejmë të trajtuar dhe në tekste të mëvonshme ku do veçoja gramatikën Bucholz/ Fiedler, Albanische Grammatik, botim i vitit 1987, apo tekstin e Gramatikës së Gjuhës Shqipe, II, (Sintaksa), Tiranë, 1996, ku e gjejmë të trajtuar edhe më gjerësisht. Dhe Mehmet Çeliku

³⁸²Syntaksa e gjuhës Shqipe, për klasën II, III, IV.K. U. Të shkollave të mesme, Shtypshkronja Gjergj Fishta, Shkodër 1943, f. 34

³⁸³Po aty

³⁸⁴Cipo, Kostaq, *Sintaksa*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1952

³⁸⁵Domi, Mahir; Hajvari, N: *Gramatika e gjuhës shqipe*, pjesa I për klasën VII të shkollës tetëvjeçare, botim i Institutit të studimeve dhe botimeve shkollore, shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1965

në veprën e tij “Sintaksë e gjuhës shqipe”, botim i vitit 2012, i kushton një vëmendje të veçantë kundrinës me parafjalë.

Gjuhëtari i gjuhës shqipe që është marrë më gjerësisht me trajtimin e kundrinës në përgjithësi dhe asaj me parafjalë në veçanti, është Remzi Përnaska, i cili i ka kushtuar dhe një monografi me titull “Kundranori me Parafjalë”, botuar në Prishtinë në vitin 2007, ku gjejmë mjaft risi. Vlen të theksohet se Përnaska është dhe autor i kreut mbi kundrinën në disa tekste shkollore si dhe në tekstin Sintaksa të Akademisë së Shkencave. Gjithashtu Përnaska është dhe autor i disa punimeve në lidhje me kundrinat, botuar kryesisht në revistën shkencore Studime filologjike.

Në krahasim me kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë, kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe ka një përdorim më të gjerë. “*Ajo mund të plotësojë një folje kalimtare ose jokalimtare, në formën veprorë ose joveprorë, një mbiemër foljor ose jofoljor, një përemër, një numëror, një pjesë tjetër të emëruar të ligjëratës, ose një togfjalësh. Kundrina e zhdrejtë me parafjalë ndërtohet nga parafjalë e lokucione parafjalore nga më të ndryshmet. Ndër më të përdorurat janë: nga, te e tek, me, bashkë me, me anën (e), në kundërshtim me, në lidhje me, në raport me, në krahasim me, për, pa, mbi, në, nën, nëpërmjet, kundër, kundrejt, ndaj*”³⁸⁶

Hans Hanseni ishte nxënës i shkëlqyer dhe, veç kësaj, edhe një shok gazmor, që i hipte kalit, merrej **me gjimnastikë**, notonte si peshk dhe gëzonte simpatinë e të gjithëve.

Drutë e transportuar **nga të rinjtë** ishin sistemuar mirë.

Vrima e hapur **me majën e thikës** nuk kishte as formën, as madhësinë e duhur.

Ai është i talentuar **për pikturë**.

U nda **nga shoqet** me lot në sy.

Përgjegjësia kryesore rëndonte **mbi ta**.

Diçka bisedonte **për të**.

Një tjetër përkufizim mjaft të saktë dhe të detajuar për kundrinën në fjalë gjejmë dhe tek Çeliku, sipas të cilit, “*Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë shprehet me përbërës emëror të paraprirë nga një parafjalë dhe plotëson kuptimin e foljes, duke treguar mjetin e kryerjes së veprimit, vepruesin, shoqëruesin, si dhe ngjyrimë të tjera të shumta, si largim, ndarje, kufizim etj.*”³⁸⁷

³⁸⁶Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 260

³⁸⁷Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 163

Në dallim nga llojet e tjera të kundrinave, te kundrina e zhdrejtë me parafjalë folja nuk varet nga një rasë e caktuar, por nga një parafjalë e caktuar. Në këtë rast parafjala ka funksion të ngjashëm me rasën. Kjo do të thotë se tek kundrina e zhdrejtë me parafjalë eptimi i rasës nuk jepet përmes foljes, por përmes parafjalës. sipas rasës që kërkon parafjala në gjuhën shqipe dallojmë katër lloje:

1. kundrinë të zhdrejtë me parafjalë që sundojnë rasën emërore:

Gjuha shqipe është e vetmja gjuhë indoevropiane që ka parafjalë që sundojnë rasën emërore. “Në gjuhën shqipe rasi emërore sundohet vetëm nga dy parafjalë: **nga** e **te(k)**, me variantet e tyre fonomorfologjike. Emri pas parafjalëve që sundojnë rasën emërore, kur nuk është i shoqëruar nga ndonjë përcaktor; vihet zakonisht në trajtën e shquar; kur është i shoqëruar nga ndonjë përcaktor, mund të vihet edhe në trajtën e pashquar. Nga ana tjetër, parafjala **nga** dhe **te(k)** nuk sundojnë ndonjë rasë tjetër veç emërores.”³⁸⁸

Kemi me vete **nga një valixhe, nga një krevat portativ dhe nga një dyshek.**

Ata kërkonin me këmbëngulje **nga studentët** zbatimin me përpikmëri të udhëzimeve.

Ne do të shkonim **tek ato** mysafirë për dy javë.

U avit **te tryeza** dhe shikoi vajzën.

2. Kundrina e zhdrejtë me shprehje parafjalore që sundojnë rasën gjinore:

Mund të thuhet se kundrina me shprehje parafjalore që sundojnë rasën gjinore është studiuar fare pak në gjuhën shqipe. Vetëm tek Përnaska gjejmë një shtjellim të detajuar të kësaj kundrine. Sipas tij kundrina e zhdrejtë me shprehje parafjalore që sundojnë rasën gjinore, shprehet me parafjalët **me anën, me anë, në vend, në sajë, në dobi, në të mirë, në leverdi, në dëm, në kurriz, në funksion, më përjashtëm, në mes, për hir, në emër, në këmbim, në drejtim, me ndihmë.**³⁸⁹ Gjithsesi dhe studimi i tij përse i përket kundrinës së zhdrejtë me shprehje parafjalore, që sundojnë rasën gjinore, siç shprehet ai vetë nuk është shterues, duke qenë se ekzistojnë dhe mjaft shprehje të tjera parafjalore që sundojnë rasën gjinore që janë lënë jashtë ose nuk janë trajtuar në mënyrë të detajuar nëpunimin e tij, për shkak se nuk janë dhënë në gramatika.

Natyrisht që në netët e mia të pagjuma përpiqem të mbrohem **me anë dialogësh** apo **fjalimesh** të përfytyruara përpara turmës njerëzore.

Si do të ishin ato nëse **në vend të letrës** së vajit dritaret do të ishin me qelq.

³⁸⁸Përnaska, Remzi, Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe, Prishtinë 2000, f. 66

³⁸⁹Po aty, f. 169-174

I pa me qetësi, një nga një, dhe, **me përjashtim të njërës** që e kaloi në të vlefshme, të tjerat i la aty ku ishin.

Ndërkohë shtetet fqinje, me tutorë të hershëm e të fuqishëm, kanë shënuar vetëm rritje të kufijve të tyre **në dëm të trojeve** shqiptare.

3.kundrinë e zhdrejtë me parafjalë dhe shprehje parafjalore që sundojnë rasën kallëzore: Kundrina e zhdrejtë me parafjalë që sundojnë rasën kallëzore është nga kundrinat me parafjalë më të përdorura. Kjo kundrinë e zhdrejtë paraprihet nga parafjalët **me, mbi, për, pa, në, nën, ndër, nëpër**, si dhe shprehjet parafjalore **bashkë me, së bashku me, tok me, në kundërshtim me, në bashkëveprim me, në krahasim me, në lidhje me, lidhur me, në pajtim me, në përshtatje me, në raport me, paralelisht me, paralel me**, etj.³⁹⁰Dhe këtë kundrinë e ka trajtuar mjaft imtësisht vetëm Përnaska.

Ai bëri **me dorë** një shenjë të papërcaktuar.

Atij iu duk se faji kryesor rëndonte **mbi të**.

Unë **bashkë me ta** ula kokën si fajtor.

Në kundërshtim me shumicën, madje **në kundërshtim me vetveten** e disa viteve më parë, kohët e fundit aimendontese truri njerëzor ishte zhvilluar më shumë se ç'duhej.

Çdo send, çdo ngjarje, çdo veprim, të kujtdoqoftë, e vlerësoja **në raport me të**.

4.kundrinë e zhdrejtë me parafjalë në rasën rrjedhore.

Parafjalët që sundojnë rasën rrjedhore janë më të shumta në numër se ato që sundojnë rasat e tjera. Por, megjithëse më të shumta në numër këto kundrina përdoren më rrallë. Një kundrinë e zhdrejtë me parafjalë në rrjedhore shfaqet me këto parafjalë: **prej, përmes, nëpërmjet, kundër, kundrejt, përkundrejt, krah, përkrah, karshi, ndaj, pranë, para, përpara, rreth, pas, mbas, përballë, drejt**.³⁹¹

Sepse, siç qëllon nganjëherë me njeriun që, pasi ka thënë një rrenë të vogël të padëmshme, në vend që të tërhiqet **prej saj** në kohën e duhur, thellohet edhe më shumë, duke e pasuar me rrena të tjera të vogla, ashtu dhe unë kujtoja se mund të shkëputesha nga kjo histori e mërzitshme, duke sajuar ca gjëra të paqena, që, në vend që të më çlironin **prej trillimit** të parë, më zhytën thellë e më thellë në të.

³⁹⁰Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 262- 267

³⁹¹Po aty, 267- 268

Përmes velit të lotëve Hasan Kamberi shihte atë vajzë shqiptare që recitonte në skenë vjershën e mallëngjyeshme të Vaso Pashës dhe në sfond flamurin e madh të Shqipërisë, që skuqte si zjarr i kuq.

Atij iu shtua një farë zemërimi **kundrejt vetes** që ra aq poshtë duke kryer një vepër të tillë.

Ti, **ndaj këtij**, je sa një gurneckë vetë.

Vërehet se vetëm në rasën dhanore nuk ka kundrinë me parafjalë në gjuhën shqipe.

Kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe mund të gjendet me ndihmën e përemrave pyetëstë shoqëruar me parafjalë, sepse kur drejtojmë pyetjen për gjetjen e kundrinës së zhdrejtë me parafjalë hasim edhe parafjalën e kërkuar nga folja: Për kë? Me kë? Me çfarë?.

Kundrina e zhdrejtë me parafjalë mund të shfaqen në fjali ose si kundrinë e vetme ose bashkë me një kundrinë të drejtë ose të zhdrejtë pa parafjalë apo kundrina të tjera të zhdrejta me parafjalë:

Ajo ishte një ndërtesë e vjetër, e ngritur **me gurë e qerpiç**.

Djali fshiu sytë **me mëngën e xhaketës**.

Asaj i vinte keq për **Benin**.

Luftoi **kundër Turqisë për çlirimin e Shqipërisë**.

Ashtu si kundrina e zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe si rregull nuk ndryshon gjatë kthimit të fjalisë në pësore:

Punëtorët shtruan oborrin **me pllaka**.

Oborri u shtrua **me pllaka** prej punëtorëve.

Por ky rregull sipas Çelikut ka një përjashtim.: “*Vetëm kundrinori i zhdrejtë me parafjalën nga i fjalive pësore, që tregon vepruesin, mund të kthehet në kryefjalë në fjalitë veprore.*”³⁹²:

Shkolla u ndërtua **nga fshatarët**.

Fshatarët ndërtuan shkollën.

³⁹²Po aty

Gjithashtu kundrina e zhdrejtë me parafjalë, gjatë emërzimit të foljes së fjalisë, mund të kthehet në përcaktor parafjalor, zakonisht pa ndryshuar formën dhe me të njëjtën parafjalë.:

Rinia lufton **për paqe**.

Lufta e rinisë **për paqe**.

Është gjithashtu e mundur që kundrina e zhdrejtë me parafjalë të zëvendësohet nga:
- një kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë pa parafjalë.:

Takoj **me dekanin**.

Takoj **dekanin**.

-një kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë të shenjuar te folja nga trajta e shkurtër e përemrit vetor.

Para se të shkojë **te Goni**, duhej të vijë **tek unë**

Para se t'i shkojë **Gonit**, duhej të më vijë **mua**

E ka treguar me kohë shqiptari frikën **nga pushka**, apo jo?

E ka treguar me kohë shqiptari në **ia** ka frikën **pushkës**, apo jo?

-një kundrinë tjetër me parafjalë:

Mori zemër nga kjo zbutje e pandehur e Grizarakes, dhe me një guxim po aq të papritur, e zuri **nga krahu** dhe nuk e la të shkonte.

Mori zemër nga kjo zbutje e pandehur e Grizarakes, dhe me një guxim po aq të papritur, e zuri **për krahu** dhe nuk e la të shkonte.

Pasi kontrolloi listë prezencën, ai mendoi ta fillonte **nga Vera**.

Pasi kontrolloi listë prezencën, ai mendoi ta fillonte **me Verën**.

Në ndryshim me kundrinën e drejtë dhe të zhdrejtë, kundrina e zhdrejtë me parafjalë nuk shenjohej me trajtë të shkurtër.³⁹³

7.2. Nuancat semantike të shprehura nga kundrina e zhdrejtë me parafjalë.

“Marrëdhëniet kundrinore janë shumë të gjera; në kuadrin e marrëdhënieve kundrinore përfshihen kuptime e ngjyime kuptimore nga më të ndryshmet, të cilat realizohen nëpërmjet semantikës së përbërësit foljor kokë, të parafjalës dhe të

³⁹³Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 439

*përbërësit emëror të nënrenditur parafjalor. Disa nga këto kuptime a ngjyime kuptimore janë të qarta, lehtësisht të kapshme.*³⁹⁴

Çeliku dallon trembëdhjetë nuanca të ndryshme semantike, apo siç i quan ai lloje të ndryshme marrëdhënesh kundrinore të shprehura me anë të kundrinave të zhdrejta me parafjalë, në varësi të parafjalës së kundrinës përkatëse: mjetin e kryerjes së veprimit, marrëdhënie shoqërimi, marrëdhënie largimi, afrimi a drejtimi, marrëdhënie kundërshtie, vepruesin që kryen veprimin, marrëdhënie kufizimi, thjesht objektin e një veprimi, objektin mbi të cilin ushtrohet a shtrihet veprimi, nënlojin e një sendi a pjesën e një tërësie, pjesë të trupit a të një objekti, përbërësin e një sendi, marrëdhënie zëvendësimi, marrëdhënie përjashtimi. Bazuar në këtë klasifikim të tij, do i paraqes në vijim në mënyrë më të detajuar.

1. Kundrinat e zhdrejta me anë të parafjalëve **me, me anë, nëpërmjet, falë**, mund të shprehin mjetin e kryerjes së veprimit të foljes:

Kishin arritur **me trenin e fundit** pas mesnate.

Letrën ia dërguan **me anë të korrierit**.

Dritat shumëngjyrëshe hynin të prera rripa rripa **nëpërmjet grilave**.

Mirëpo viti kish qëlluar i mbarë **falë të madhit Zot**.

Ndërsa mungesa e mjetit shprehet me parafjalën pa:

Qeniet e gjalla nuk rrojnë dot **pa ujë**.

2. Kundrinat e zhdrejta me parafjalët **me, bashkë me** mund të shprehin marrëdhënie shoqërimi:

Ecte **me të vëllanë** mes shtigjesh e stërkash.

Ndërkaq ajo ndezi bishtukun me vajguri dhe **bashkë me vëllanë e gjyshin** zbritën shkallët.

3. Kundrinat e zhdrejta me parafjalët **nga, prej, me, te, pas, përbri, drejtmund** tëshprehin marrëdhënie largimi, afrimi a drejtimi:

Erdhi koha të çliroheshin **nga njëri- tjetri**.

³⁹⁴Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 172

Janë larguar **nga njëri tjetri** dhe janë afruar **me njëri tjetrin** disa herë në jetë.

Filloi ti hidhte hapat automatikisht **përbri saj**.

Ata shkuan **drejt vdekjes** me ballin lart e shikimin përpara.

Më në fund mbërritëm **te ti**.

4. Kundrinat e zhdrejta me parafjalët **kundër, në kundërshtim me** mund të shprehin marrëdhënie kundërshtie:

Në këtë spital jeta do të luftojë **kundër vdekjes**, drita **kundër errësirës**, e mira **kundër së keqes**.

Në **kundërshtim me pamjen** e bukur nga afër, kullat dukeshin më të zymta.

5. Kundrina e zhdrejtë me parafjalët **nga** mund të shprehin vepruesin që kryen veprimin:

Në atë universitet kurset e anglishtes jepeshin **nga mësues anglezë** e ato të italishtes **nga italianë**.

6. Kundrinat e zhdrejta me parafjalët **për, me, në lidhje me, lidhur me, përsa i përket** mund të shprehin marrëdhënie kufizimi:

Lidhur me shpikjen tuaj, është e vërtetë se bëri përshtypje.

Opozita nuk ka dallime me mazhorancën **në lidhje me reformën në drejtësi**.

Ashtu si më parë ai kish mbajtur të njëjtin qëndrim **përsa i përket ndërtimit të urës**.

Mbaj mend që asaj nuk ia kalonte njeri **për lexim, aritmetikë dhe bukurshkrim**.

I mësuar **me punë**, nuk i rrinin duart asnjë minutë.

7. Kundrinate zhdrejta me parafjalët **për, mbi, nga, te**, mund të shprehin thjesht objektin e një veprimi:

Diskuatuan gjerë e gjatë **për poezinë**.

Botoi një artikull **mbi shkollat private**.

Për mbrojtjen e hapësirave të gjelbërta qeveria kërkoi më shumë vëmendje **nga pushteti vendor**.

Fjalët e saj ndikuan jashtëzakonisht **te e bija**.

8.Kundrinat e zhdrejtë me parafjalët **me, mbi, nga, kundër** mund të shprehin objektin mbi të cilin ushtrohet a shtrihet veprimi, gjë që sjell ndryshime të tilla, si: dëm, dobi, përshtatje, etj.:

Mbi fshatarët rëndonte varfëria.

Artistët ishin të mbytur **nga emocionet** e jashtëzakonshme.

Shishja ishte e mbushur plot e përplot **me verë**.

Kundër demonstruesve u lëshuan qindra policë.

9.Kundrina e zhdrejtë me parafjalën **nga** mund të shprehin nënlojin e një sendi a pjesën e një tërësie:

Ha **nga kjo gjellë**.

Merr **nga këto mollë**.

10.Kundrinat e zhdrejta me parafjalët **nga** dhe **për** mund të shprehin pjesë të trupit a të një objekti:

E kapi **për krahu** dhe vazhduan rrugën.

E tërhoqi demin **nga brirët**.

11.Kundrinat e zhdrejtame parafjalën **nga** mund të shprehin përbërësin e një sendi:

Betonarmeja përftohet **nga çimentoja, hekuri dhe uji**.

12.Kundrinat e zhdrejta me parafjalët **në vend, në këmbë, për** mund të shprehin marrëdhënie zëvendësimi:

Domethënë, eshtrat e ushtarëve tanë, do t'u ndahen familjeve të një populli tjetër **në vend të njerëzve të tyre**, - thirri gjenerali.

Në ceremoni mori pjesë çifti i ri, **në këmbë** të pleqve.

Mbajti leksione në universitet një muaj **për** Profesorin e nderuar që ndodhej me shërbim jashtështetit.

13.Kundrinat e zhdrejta me parafjalët **përveç** dhe **me përjashtim** mund të shprehin marrëdhënie përjashtimi:

Përveç nënës, të gjithë qeshën.

Ato të dyja flisnin tani dy e nga dy me zë monoton, **me përjashtim të Kako Pinës dhe nuses së Nazos**.

7.3.Pjesët e ligjëratës me të cilat mund të shprehet kundrina e zhdrejtë me parafjalë.

Kundrina e zhdrejtë me parafjalë mund të shprehet nga një fjalë e vetme e cila mund të jetë një emër, përemër, numëror me përdorim emëror, një pjesë të emërzuar të ligjëratës, në rasën emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore të paraprirë nga një parafjalë a lokucion parafjalor, si dhe përmes fjalive të nënrenditura.

Në rastet kur kundrina e zhdrejtë shprehet nga një fjalë e vetme, e paraprirë nga një parafjalë a lokucion parafjalor ajo mund të shprehet me pjesët e mëposhtme të ligjëratës:

- Me një parafjalë + emër të shquar ose të pashquar në rasën kallëzore:

Ai u kthye i çuditur **nga djali** që po i dëgjonte duke luajtur me thërrimet e bukës.

Mos na trego **për gjërat** që kanë humbur këtu e nje vit më parë.

- Me një parafjalë + përemër të çdo lloji (vetor, vetvetor, dëftor, pronor, lidhor, pyetës, i pacaktuar) me përdorim emëror:

Gjithmonë ka qenë gati të sakrifikohej, por nuk ka kërkuar kurrë diçka **për vete**.

Me kë je zënë?-pyeti Nazja.

Askujt si kish rënë ndër mend **për mua**.

Inatin e kishte **më të gjithë**.

Folëm e folëm, po më shumë për punët e të tjerëve sesa **për tonat**.

Kur zbardhi dita, patën rastin të shohin më mirë armikun **me të cilin** do të mateshin.

- Me një parafjalë + pjesë të emërzuar të ligjëratës:

Brengosej **për të vetët.**

E gjithë ajo bisedë bëhej **për të mirën e tij.**

Kundrina e zhdrejtë me parafjalë e shprehur me togfjalësh:

Është mbuluar vetëm **me një gisht suva.**

Me mace e me minj m'i nxirrni përjashta!

Pisk e kemi **me këto të shkreta para.**

Kundrina e zhdrejtë me parafjalë e shprehur me fjali të nënrenditur:

E gjeti Rizanë **tek merrej me rregullimin e traktorit.**

E mbylli bisedën **me një “duhet ruajtur shumë”.**

KREU VI - PËRQASJE MES KUNDRINËS NË GJUHËN GJERMANE DHE ATË SHQIPE

1. Kundrina në të dyja gjuhët, vështrim i përgjithshëm.

Kundrina në gramatikën tradicionale të gjuhës gjermane konsiderohet si gjymtyrë kryesore e fjalisë. Në këtë mënyrë, kundrinës në gjuhën gjermane i jepet një rëndësi e veçantë, duke e vendosur në një rang me kryefjalën dhe kallëzuesin. Ndërsa në gramatikën tradicionale të gjuhës shqipe, gjymtyrë kryesore të fjalisë konsiderohen vetëm kryefjala dhe kallëzuesi, që shihen si baza e fjalisë³⁹⁵. Kundrina së bashku me rrethanorin dhe përcaktorin, konsiderohen si gjymtyrë të dyta. Kundrina merret si gjymtyra e dytë më e rëndësishme, duke qenë se shihet shpeshherë si e domosdoshme për kuptimin dhe plotësimin strukturor të fjalisë. Emërtimin gjymtyrë të dyta në gjuhën shqipe e kanë jo për peshën që ato kanë në kuptimin e dhënë, por për shkak të të rolit që ato luajnë në organizimin e fjalisë, duke qenë se janë të varura nga gjymtyrë të tjera, të cilat i plotësojnë dhe përcaktojnë më nga afër.³⁹⁶ Në gjuhën gjermane gjymtyrë të dyta konsiderohen gjymtyrët që nuk përcaktohen nga kallëzuesi dhe nuk i përkasin strukturës bazë së fjalisë. Tek gjymtyrët e dyta në gjuhën gjermane bëjnë pjesë disa emra në rasën dhanore, ndër to disa dhanore të lira, si dhe përcaktori kallëzuesor. Përcaktori në gjuhën gjermane nuk konsiderohet si në gjuhën shqipe si gjymtyrë më vete, por si pjesë e gjymtyrës që përcakton më nga afër.

Në të dyja gjuhët, veçanërisht në tekstet shkollore ose ato të mësimi të gjuhës së huaj, për identifikimin e gjymtyrëve të fjalisë në përgjithësi e kundrinës në veçanti gjen përdorim metoda analitike, me anë të pyetjes që i drejtohet kallëzuesit. Kjo metodë kërkon gjithashtu të kuptuarit intuitiv paraprak të fjalisë, i cili përfshihet në formulimin e pyetjeve. Këto pyetje orientohen tek raportet morfologjike, në këtë rast, të rasës. Këtë e tregon dhe formulimi abstrakt i pyetjeve: ‘wer/ kush?’, ‘was/ çfarë?’, ‘wen/ kë?’, ‘wem/ kujt’, ‘wessen/ i kujt’. Në një fjali konkrete duhet zgjedhur përkatësisht njëra prej tyre.

Ndërsa, tipike për përcaktimin e gjymtyrëve të fjalisë në gramatikën tradicionale në gjuhën gjermane, janë provat e frymëzuara nga Glinci, ku dy më të rëndësishmet konsiderohen prova e zëvendësimit (Ersatzprobe) dhe ajo e spostimit (Verschiebprobe). Po t’i plotësojë këto dy kushte gjymtyra është gjymtyrë fjalie.

Një temë e shumëpërfolur në pothuaj të gjitha tekstet gramatikore, në të dyja gjuhët përbën dhe vështirësia në klasifikimin e kundrinës. Në disa raste mund të hasen vështirësi në kuptimin dhe interpretimin e fakteve konkrete gjuhësore, duke qenë se caqet mes këtyre kategorive të gjymtyrëve të fjalisë nuk janë gjithmonë qartësisht të dallueshme, duke çuar kështu në shfaqjen e raste të ndërmjetme apo sinkretike, ose në ato të asimetrisë mes përmbajtjes dhe formës.

³⁹⁵Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 165

³⁹⁶Po aty, f. 203

Ka kështu në të dyja gjuhët, fakte gjuhësore që qëndrojnë mes kundrinave dhe rrethanorëve. Në gjuhën shqipe janë të shumta rastet e ndërmjetme mes kundrinës e përcaktorit. Ndërsa në gjuhën gjermane mund të shfaqen vështirësi në disa raste dhe në dallimin mes kundrinave dhe gjymtyrëve të tjera të dorës së dytë, siç janë dhanoret e lira (freie Dative) apo kallëzuesori kundrinor (Objektsprädikativ).

Takimet si dhe gërshetimet kuptimore krijojnë nganjëherë vështirësi nga më të ndryshmet për të përcaktuar saktë gjymtyrën. Në të tilla raste përcaktimi i saj duhet bërë duke diktuar vlerat kuptimore e veçoritë gramatikore zotëruese.

Nga sa u tha më lart, në mënyrë që të kemi një përcaktim dhe klasifikim sa më të saktë të gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën gjermane, duhet të bazohemi si tek përmbajtja ashtu dhe tek forma, pra duhet të mbështetemi edhe në raportet kuptimore, dhe në veçoritë gramatikore. Duhet të vështrohet kështu, funksioni sintaksor e raportet kuptimore të gjymtyrës, shprehja e saj morfologjike dhe format e lidhjes gramatikore me gjymtyrën e plotësuar prej saj. Duhet të merren parasysh në raste të caktuara dhe shprehja morfologjike si dhe kuptimi leksikor i gjymtyrës së plotësuar, e po ashtu dhe i vetë gjymtyrës së dytë të dhënë. Në gjuhën gjermane vërehet gjithashtu se në disa tradita gramatikore ngushtohet rrethi i kundrinave, në të tjera, zgjerohet shumë. Për pasojë ka një numër gjymtyrësh që janë klasifikuar e klasifikohen edhe sot në mënyra të ndryshme nga gjuhëtarë të ndryshëm.

Në disa gramatika të gjuhës gjermane kundrina mund të jetë e detyrueshme ose fakultative. Nga shembujt në vijim vërehet se e njëjta gjë vlen dhe për gjuhën shqipe.:

Sie gleich **ihrer Schwester**./ Ajo ngjan **me të motrën**.

Në rastin e mësipërm kundrina është e detyrueshme duke qenë se vetëm: ‘Sie gleich./ Ajo ngjan’ nuk ka kuptim.

Er singt./ Ai këndon.

Er singt **ein Lied**./ Ai këndon **një këngë**.

Ndërsa në shembullin e mësipërm vërehet se kundrina është fakultative. Fjalja në të dyja rastet ka kuptim.

Gjithashtu ndryshime vërehen dhe në mënyrën e përkufizimit të kundrinës në të dyja gjuhët. Kështu për gjuhën gjermane në tekste të ndryshme gramatikore, të bazuara në gramatikën tradicionale ajo përkufizohet si vijon:

Sipas fjalorit njëgjuhësh Wahrig kundrina në gjuhën gjermane, përkufizohet si pjesë e fjalisë, e cila është një plotës emëror i kallëzuesit, marrë nga latinishtja ‘obiectum’, pjesorja e shkuar e ‘obicere’ “të vendosësh përballë”.³⁹⁷

³⁹⁷Wahrig, *Deutsches Wörterbuch*, München 2006, f.1086

Në leksikon e shkencës së gjuhësisë nga Busman jepet një tjetër shpjegim për termin 'kundrinë, i cili përcaktohet si termi i përmbledhur për shumë funksione sintaksore në gjuhët si gjermanishtja, anglishtja, që në varësi të llojit të gjuhës ndonjëherë dallohet ana morfologjike (nëpërmjet rasës obliquus) ose nga pozicioni (nëpërmjet pozicionimit të kryefjalës) dhe sipas rregullit karakterizon vetën ose rrethanën, me të cilën lidhet veprimi (përcaktuar nga folja).³⁹⁸

Sipas Shulc/ Griesbah, kundrina janë të gjitha rolet e përshkrimit të situatës që nuk janë kryefjalë. Situata = Ngjarje/ gjendje + rolet. Numri i kundrinave, një, ose dy kundrina, përcaktohet nga ngjarja dhe nga folja që përcakton ngjarjen.³⁹⁹

Sipas Helbig, kundrina është një grup emëror ose parafjalor, i cili është i detyrueshëm ose fakultativ dhe varet nga kallëzuesi. Në aspektin morfologjik shprehet me një emër në rasën kallëzore, dhanore, gjinore ose me një parafjalë + emër, ose me anë të përemrit vetor përkatës.⁴⁰⁰

Sipas Henshel Veidt, kundrina i qëndron përballë kryefjalës në filozofi si dhe në gramatikë si objekt i perceptimit, njohjes, mendimit dhe veprimit. Kundrina në gramatikë lidh synimin direkt ose indirekt të veprimit të shprehur nga folja. Tek gjuhët me fleksion qëndron në një rasë oblique, e cila drejtohet ose direkt nga folja, ose me ndihmën e një parafjale, në rastin e fundit kemi të bëjmë me kundrinë me parafjalë.⁴⁰¹

Sipas Zomerfeld/ Shtarke, kundrina është një gjymtyrë, pjesë e lidhjes së kallëzuesit (Prädikatsverband), rasa e së cilës (kallëzore, dhanore, rrallë gjinore) ose parafjala përcaktohet me anë të sundimit (Reksion).⁴⁰²

Ndërsa në tekste të ndryshme gramatikore të gjuhës shqipe, bazuar në të njëjtën teori gramatikore, gjejmë përkufizimet e mëposhtme:

Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe të Akademisë së Shkencave, kundrina është gjymtyrë e dytë e fjalisë, mbi të cilën bie veprimi i foljes që shërben si kallëzues.⁴⁰³

Sipas sintaksës së gjuhës shqipe të Akademisë së shkencave, kundrinat janë gjymtyrë të dyta me të cilat shprehen raporte objektore në mes një veprimi a tipari dhe objektit

³⁹⁸Bußmann., H „Lexikon der Sprachwissenschaft" Stuttgart 1983, f. 540-541

³⁹⁹Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f.336

⁴⁰⁰Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f 111

⁴⁰¹Hentschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f. 325

⁴⁰²Sommerfeld, Karl- Ernst/ Starke, Günter: *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen 1998, f. 211

⁴⁰³Akademia e Shkencave të Shqipërisë, "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë 1980

të tij, zakonisht ndërmjet një emri a një fjale tjetër emërore, të lidhur me drejtim me një folje a mbiemër. Më së shumti ato shënojnë objektin e veprimit që shpreh folja.⁴⁰⁴

Tek Prifti, ajo përkufizohet si gjymtyra e varur e fjalisë së zgjeruar, tregon sendin mbi të cilin bie direkt ose tërthorazi veprimi i gjymtyrës nga e cila varet.⁴⁰⁵

Sipas Gjuha shqipe 3 kundrina trajtohet si gjymtyrë e dytë e fjalisë që varet zakonisht nga gjymtyrë të shprehura me folje dhe me mbiemra, me të cilat vihet në marrëdhënie objektore (kundrinore).

Klasifikimi dhe përkufizimi i kundrinës si u nënvizua më sipër në gjuhën gjermane ashtu dhe në atë shqipe varet nga faktorë morfologjik dhe semantikë. Por duke u nisur dhe nga përcaktimi kundrinë e rasës kallëzore (Akkusatiobjekt), kundrinë e rasës dhanore (Dativobjekt) dhe kundrinë e rasës gjinore, (Genitivobjekt), rezulton se në gjuhën gjermane dominon më shumë faktori gramatikor morfologjik, ndërsa në gjuhën shqipe kundrinë e drejtë dhe e zhdrejtë, dominon më shumë ai semantik.

Në lidhje me këtë mund të thuhet se përkufizimi që i bëhet zakonisht në gjuhën shqipe nisur nga aspekti semantik, si gjymtyra e cila shpreh objektin e veprimit, nuk është tipar i mjaftueshëm për t'i klasifikuar gjymtyrët e fjalisë si kundrina. Ai ka të bëjë me një kategori të madhe të kundrinave, por nuk do të thotë patjetër se të gjithë kundrinat shprehin vetëm këtë gjë. Këtë e gjejmë të argumentuar më së miri tek Përnaska, i cili shprehet se “*edhe në analizat e zakonshme tradicionale pranohen si kundrina gjymtyrë si këto që po nënvizohen më poshtë: ‘Në hënë nuk ka jetë’, ‘Atij i qeshi fytyra’, etj., ku kundrinat nuk shprehin kundrinën e veprimit.*”⁴⁰⁶

Ai shton gjithashtu se ka gjymtyrë që nuk shprehin kundrinën e veprimit, por që renditen si kundrina për nga roli gramatikor që luajnë në fjali:

Tanit s'i rrihej.

Atyre u rrëzëllinte fytyra.

Së dyti, Përnaska thekson se objekti i veprimit, në ndërtimet pësore, shprehet nga vetë kryefjala.:

Më tej jeta ime u rrokullis në banalitetin e pluhurosur qytezës, përmes një monotonie gjumëndjellëse që prishej herë **nga druri** i Xhodës në shkollë, herë **nga drurii** babait në shtëpi, herë **nga druri** i të dyve bashkë.

⁴⁰⁴Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 209

⁴⁰⁵Prifti, Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1972, f. 109

⁴⁰⁶Përnaska, Remzi, *Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2000, f. 24

Gjithashtu në gramatikat e gjuhës shqipe përgjithësisht pranohet që kundrina e drejtë ndërtohet me një emër, përemër, etj. që shpreh objektin mbi të cilin bie drejtazi veprimi i shprehur nga folja, kurse kundrina e zhdrejtë ndërtohet me një emër, përemër, etj. që shpreh objektin mbi të cilin bie zhdrejtazi veprimi i shprehur nga folja. Por kriteri semantik që shërben për të dalluar kundrinën e drejtë nga kundrina e zhdrejtë sipas kalimit të veprimit drejtazi ose zhdrejtazi mbi objektin nuk është gjithandej i vlefshëm, së paku për shqipen. Në gjuhën shqipe ka dhe kundrina, që për të njëjtën mënyrë kalimi të veprimit dalin si do të dilte kundrina gjegjëse, madje herë si të drejta dhe herë si të zhdrejta. Kjo duket sipas Përnaskës, ndër të tjera, nga analiza e disa strukturave tepër të përdorura në gjuhën shqipe.:

E ndihmoj **Dritanin**.

I ndihmoj **Dritanit**.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane, ashtu si dhe kundrina e drejtë në atë shqipe, shpreh zakonisht një objekt, një send, ndërsa kundrina e rasës dhanore dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë shpreh zakonisht një qenie të gjallë, një njeri. Kjo vihet re dhe në rastin kur kemi në një fjali në të njëjtën kohë dy kundrina, dhe të rasës kallëzore dhe dhanore ose të drejtë dhe të zhdrejtë pa parafjalë, përdoret kundrina e drejtë për të shprehur send dhe kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë për të shprehur qenie të gjallë.

Ich gab **dem Schüler das Buch**./ I dhashë **librin nxënësit**.

Në gjuhën gjermane kemi dhe fenomenin gramatikor të sundimit (Reksion) të foljeve, pra që folje të caktuara kërkojnë një rasë të caktuar. Shumica e foljeve në gjuhën gjermane sundojnë rasën kallëzore, por ka dhe folje që sundojnë rasën dhanore ose gjinore, si dhe folje që sundojnë dy rase, zakonisht atë kallëzore ose dhanore. Gjithashtu ka dhe parafjalë që bashkë me folje të caktuara kërkojnë një rasë të caktuar.

Kundrina në të dyja gjuhët sundohet zakonisht nga folje e më rrallë nga mbiemra. Në ndryshim nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe, në raste të rralla, kundrina mund të sundohet dhe nga një emër ose ndajfolje

Sipas kriterit morfologjik dallojmë katër llojet e mëposhtme të kundrinave:

1. kundrina e rasës kallëzore (Akkusativobjekt), e cila shprehet me një emër a fjalë emërore të rasës kallëzore;
2. kundrina e rasës dhanore (Dativobjekt), e cila shprehet me një emër a fjalë emërore të rasës dhanore;
3. kundrina e rasës gjinore (Genitivobjekt), e cila shprehet me një emër a fjalë emërore të rasës gjinore. Kjo kundrinë në ditët e sotme po zëvendësohet me atë më parafjalë,

por që gjen ende përdorim në stilin letrar. Kundrina e rasës gjinore në gjuhën shqipe, ndryshe nga ajo gjermane nuk është e pranishme;

4. kundrina me parafjalë (Präpositionalobjekt), e cila shprehet me një me një emër a fjalë emërore shoqëruar nga një parafjalë, a lokucion parafjalor.

Ndërsa në gjuhën shqipe, bazuar në aspektin semantik, dallohen tri llojet e mëposhtme të kundrinave:

1. Kundrina e drejtë, e cila shprehet me një emër a fjalë emërore të rasës kallëzore mbi të cilën kalon drejtazi veprimi i foljes;

2. Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë, e cila shprehet me një emër, a fjalë emërore të rasës dhanore, mbi të cilën kalon zhdrejtazi veprimi i foljes;

3. Kundrina e zhdrejtë me parafjalë, e cila shprehet me një parafjalë, a lokucione parafjalore, mbi të cilën kalon zhdrejtazi veprimi i foljes.

1.1. Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe kundrina e drejtë në gjuhën shqipe.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe kundrina e drejtë në gjuhën shqipe, është kundrina që haset më shpesh në të dyja gjuhët.

Ashtu si kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe kundrina e drejtë në gjuhën shqipe, shprehen me anë të një gjymtyre në rasën kallëzore. Duke qenë një gjymtyrë në rasën kallëzore, në të dyja gjuhët mund të gjendet me pyetjen “wen/ kë?” për frymorët dhe “was/ çfarë?” për sendet. Në gjuhën shqipe, mund të gjendet dhe me pyetjet “cilin?”, “cilën?”.

Në gramatikën me orientim nga përmbajtja si dhe në disa tekste gramatikore⁴⁰⁷ të gjuhës gjermane, në klasifikimin semantik që i bëhet kundrinave, kundrina e rasës kallëzore klasifikohet dhe si kundrinë e drejtë e madje në disa raste njehsohet me të, duke qenë se përkufizohet si gjymtyra, e cila përfaqëson zakonisht objektin e prekur direkt nga një veprim ose një ndodhi, dmth nga veprimi i foljes. Në përkufizimin e kundrinës së drejtë në të dyja gjuhët ndërthuren kriteret semantike (të prekurit në mënyrë të drejtpërdrejtë) me ato sintaksore (raporti i ngushtë sintaksor me foljen):

Er liest **das Buch**./ Ai lexon **librin**.

Sie ißt **das Brodt**./ Ajo ha **bukën**.

Por në gjuhën gjermane, kundrina e drejtë në raste të rralla mund të shprehet dhe me anë të një gjymtyre në rasën dhanore:

⁴⁰⁷Hentschel/ Weydtn, f. 328; Bynting/ Bergenholz, f. 79; Pittner/ bermann, f. 36; Duden, f. 590

Ich helfe **dir**./ Unë të ndihmoj ty.

Në të dyja gjuhët ato shprehin përgjithësisht të njëjtat nuanca semantike, si p.sh: një frymor ose send që preket nga një veprim ose mbi të cilin bie veprimi, një frymor, për të cilin dëshmohet diçka rreth gjendjes së tij trupore dhe shpirtërore, kuptimin e një shprehjeje foljore, atë çka zotëron dikush, një gjendje, një veçori ose një funksion, që ka dikush etj..

Gjithashtu, në rrafshin semantik, në gjuhën gjermane bëhet dhe dallimi ndërmjet kundrinës së brendshme dhe asaj të shkakut, të cilat përkojnë respektivisht me kundrinën me karakter tautologjik dhe kundrinën e brendshme në gjuhën shqipe dhe asaj të ndikimit në gjuhën gjermane, e cila përkon me kundrinën e jashtme në gjuhën shqipe.

Kundrina e brendshme në gjuhën gjermane apo kundrina me karakter tautologjik në gjuhën shqipe, përsërit në formë emërore atë çka është shprehur nga folja. Kundrina dhe folja në këtë rast kanë të njëjtën rrënjë fjalëformuese, ose rrënjë fjalëformuese të lidhura ngushtësisht semantikisht mes tyre.

Sie kämpft **den Kampf** ihres Lebens./ Ajo po lufton **luftën** e jetës.

Er träumt **einen seltsamen Traum**./ Ai ëndërron **një ëndërr** të çuditshme.

Kundrina e shkakut në gjuhën gjermane përkon me kundrinën e brendshme në gjuhën shqipe. Në këtë rast objekti i përcaktuar nga kundrina egziston në sajë të veprimit të kryer nga folja, dmth është rezultat i veprimit të shprehur prej saj.:

Nina schreibt **einen Brief**./ Nina shkruan **një letër**.

Er malt **einen Bild**./ Ai pikturon **një pikturë**.

Kundrina rasës kallëzore e ashtuquajtur e ndikimit sipas funksionit semantik në gjuhën gjermane, përkon me kundrinën e jashtme në gjuhën shqipe. Objekti i përcaktuar nga kundrina në këtë rast pëson një ndryshim me anë të veprimit të shprehur nga folja. Gjithashtu vërehet se objekti i përcaktuar nga kundrina egziston që më parë, panvarësisht veprimit të shprehur nga folja.

Ich streiche **die Tür**./ Unë lyej **derën**.

Nina liest **ein Buch**./ Nina lexon një libër

Karakteristikë e kundrinës së rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe e asaj të drejtë në atë shqipe është kthimi i saj në kryefjalë, kur folja që plotëson ajo shndërrohet në pësore.:

Die neue Bildungsreform hat **große Perspektiven** für die Entwicklung des Bildungswesens eröffnet./ Reforma e re arsimore ka hapur **prespektiva të mëdha** për zhvillimin e arsimit.

Große Perspektiven sind für die Entwicklung des Bildungswesens durch die neue Bildungsreform eröffnet worden./ **Perspektiva të mëdha** për zhvillimin e arsimit janë hapur nga reforma e re arsimore.

Sie öffnet **das Fenster**. **Das Fenster** wird geöffnet./ Ajo hap **dritaren**. **Dritarja** u hap.

Gjithashtu, si kundrina e drejtë në gjuhën shqipe dhe ajo e rasës kallëzore në gjuhën gjermane, bëhet përcaktor i rasës gjinore (Genitivattribut) në rastin e emëzimit të foljes së fjalisë.:

Sie rezensiert **das Buch**.; das Rezensieren **des Buches**./ Ajo redakton **librin**.; Redaktimi **i librit**.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe ajo e drejtë në gjuhën shqipe, zakonisht sundohet nga folje. Ashtu si kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane, dhe ajo e drejtë në atë shqipe shpesh hasen me folje të caktuara kalimtare. Në gjuhën shqipe janë zakonisht folje kalimtare veprorë. Vetëm në raste të rralla të kundrinës së drejtë të brendshme kemi folje jokalimtare. Në gjuhën gjermane janë zakonisht folje kalimtare relative përveç rasteve të rralla kur kundrina e rasës kallëzore nuk kthehet në kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore, folja është e mesme relative ose ndryshe quhet pseudo- kalimtare. Në gjuhën gjermane egziston një listë foljesh të cilat kërkojnë vetëm rasën kallëzore. Një numër i vogël foljesh i pranon të dyja rasat, si atë dhanore dhe kallëzore. Një numër i vogël foljesh pranon dy rasa: dhanore dhe kallëzore, kallëzore dhe gjinore, si dhe rasën kallëzore dhe parafjalë. Në gjuhën gjermane ka dhe folje që mund të marrin kundrinë të dyfishtë të rasës kallëzore. Në këtë rast, kundrina që shpreh frymor vendoset përpara asaj që shpreh send.:

Er bezahlt **viel Miete**./ Ai paguan qera të lartë.

Man klagt **sie des Betrugs** an./ Atë e akuzuan për mashtrim.

Në gjuhën gjermane kundrina e rasës kallëzore, në raste të rralla mund të sundohet nga mbiemra, ndërsa kundrina e drejtë në gjuhën shqipe mund të sundohet nga emra.:

Der Tisch ist **einen meter breit**./ Tavalina është një metër e gjerë.

Dhend, sikundër u pa, është larg nga të shënuarit **delen** qumështore.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe ajo e drejtë në gjuhën shqipe, përcakton më shpesh një send sesa një frymor.

Er repariert **das Auto**./ Ai rregullon **makinë**.

Sie schreibt **einen Brief**./ Ajo shkruan **një letër**.

Er lobt **den Schüler**./ Ai lëvdon nxënësin.

Në ndryshim nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe, kundrina e drejtë mund të shoqërohet me trajtë të shkurtër në disa raste. Kjo do të thotë se mund të shprehet nga një trajtë e shkurtër në rasën kallëzore, dukuri e cila në gjuhën gjermane nuk egziston.

Trajta e shkurtër që shenjon kundrinën e drejtë shfaqet përgjithësisht në rastet kur:

- Kundrina e drejtë i përket temës por nuk mban theksin kryesor të fjalisë.
- Kur emri bërthamë i grupit emëror është një përemër dëftor i vetës së tretë që shpreh një frymor apo një send, të cilat janë të njohura për shkaqe konstitutive dhe kontekstuale.

Sipas Buholc/ Fidler rrethanat e përdorimit të kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër varen më së shumti nga veçoritë gramatikore të kundrinës dhe nga kushtet e procesit të komunikimit, veçanërisht nga lidhjet me kontekstin. Këto vërehen mbi të gjitha në lidhjen e ngushtë midis kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër, ndarjes temë-remë dhe intonacionit.⁴⁰⁸

Nga ana tjetër një veçori që nuk ndodh në gjuhën gjermane, është se kundrina e drejtë në raste të veçanta mund edhe të eliminohet. Në shembullin e mëposhtëm kundrina e drejtë jepet vetëm me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.

Sot e takova **atë**.

Sot e takova.

Në të dyja gjuhët, përkatësisht kundrina e rasës kallëzore dhe kundrina e drejtë mund të hasen së bashku me një kundrinë të rasës dhanore ose të zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe.:

Wir haben **ihnen das beste Zeugnis** ausgestellt./ I përgatitëm **atyre dëftesën** më të mirë të mundshme.

Gjithashtu në të dyja gjuhët, mund të ndeshet dhe së bashku me një kundrinë me parafjalë në gjuhën gjermane ose kundrinë të zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe.:

Man vermochte **ihn mit begütigen Wörtern** zu beruhigen./ U përpoqën **ta** qetësonin (**atë**) me fjalë ngushëlluese.

Në gjuhën gjermane ashtu si dhe në atë shqipe, ka gjithashtu raste ku në të njëjtën fjali mund të hasen përkatësisht dy kundrina të rasës kallëzore ose dy kundrina të drejta. Në rastin e gjuhës shqipe njëra kundrinë e drejtë shenjohej nga trajta e shkurtër përemrit vetor.

Warrum nennst du **mich einen Essel**?/ Përse më quan ti **mua gomar**?

⁴⁰⁸Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 440

Në ndryshim nga gjuha shqipe, një kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane mund të kombinohet edhe me një kundrinë të rasës gjinore:

Ich versichere **sie meines uneingeschrenkten Vertrauens.**/ I sigurova **ata** se kisha besim të plotë.

Në të dyja gjuhët në aspektin morfologjik, të gjitha pjesët e ligjëratës dhe togfjalëshat që shfaqen si kryefjalë mund të kryejnë funksionin e kundrinës së rasës kallëzore ose atë të drejtë në gjuhën shqipe, meqë pjesët e ligjëratës mund të kryejnë funksione të ndryshme në fjali. Si në gjuhën gjermane dhe atë shqipe ajo mund të shprehet me:

- Emra (në rasën kallëzore):

Gestern habe ich **Daniel** getroffen./ Dje takova **Danielin**.

- Togfjalësh:

Ich kann **deinen alten Schaukelstuhl** nicht ausstehen./ Unë nuk e pëlqej **karrigen tënde të vjetër lëkundëse**.

Er wiederholte **die gleichen Wörter.**/ Ai përsëriste **të njëjtat fjalë**.

- Përemra. Në rastin e gjuhës gjermane mund të shprehet me përemra vetor dhe reflektiv, ndërsa në gjuhën shqipe mund të shprehet me të gjithë llojet e përemrave.

Sie kennt **ihn** gut./ Ajo e njeh mirë **atë**.

- Numërorë

Von meinen neuen Kollegen kenne ich erst **ein Drittel.**/ Nga kolegu im i ri njoh vetëm **një të tretën**.

Pesa e shumëzuar me dy jep **dhjetë.**/ Fünf mal zwei ergibt Zehn.

Ich habe vor, **ihm gründlich die Meinung zu sagen.**/ E kam në plan t'ia them hapurmendimin tim.

- Pjesë të emëruara të ligjëratës:

Ich trage am liebsten **Rot.**/ Unë preferoj **të kuqen**.

- Ndërtime foljore. Në rastin e gjuhës gjermane janë zakonisht paskajore të zgjeruara:

Ich habe vor, **ihm gründlich die Meinung zu sagen.**/ E kam në plan t'ia them hapurmendimin tim.

Na premtuan **ta botojnë.**/ Sie versprachen uns, **es zu veröffentlichen.**

- Fjali të nënrenditur:

Sie erfuhr, **dass das Flugzeug Verspätung hatte.**/ Ajo mori vesh se **treni do të vonohej.**

Për shkak të funksionit në fjali, këto fjali quhen **fjali kundrinore** (Objektsätze).

- Ligjëratë të drejtë:

Sie sagte: **Ich komme gleich.**/ Ajo tha: **Vij menjëherë.**

- Në ndryshim nga gjuha shqipe, në gjuhën gjermane, kundrinën e rasës kallëzore mund ta ndeshim të shprehur me korrelatin “es”(faktin që):

Ich hasse **es**, dass du ständig zu spät kommst./ E urrej faktin që vjen përherë me vonesë.

Korrelatin ‘es’ mund ta ndeshim në paskajoret e zgjeruar por dhe në fjalitë e nënrenditura. Në të dyja rastet korrelati është shumë i rrallë dhe ndeshet në disa folje të veçanta që shprehin një gjendje emocionale, si p.sh: urrej, ndjej neveri, më vjen keq, dua, parapëlqej, etj..

1.2.Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe kundrina e zhdrejtë në gjuhën shqipe.

Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe kundrina e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, shprehen me gjymtyrë në rasën dhanore. Duke qenë një gjymtyrë në rasën dhanore, në të dyja gjuhët mund të gjendet me pyetjen “wem?/kujt?”.

Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, përcakton më shpesh një frymor sesa një send. Në rastet kur përcakton një send ose abstrakt (Sachverhalt), varet përgjithësisht nga folje, të cilat shprehin një ngjarje ose gjendje.:

Der Meister erklärt **dem Lehrling** die Maschine./ Mjeshtri i shpjegon praktikantit makinerinë.

Das Geld gehört **dem Finder.**/ Paratë i përkasin atij që i gjen.

Sie diente **der Liebe.**/ Ajo i shërbente dashurisë.

Wir weichen **der Gewalt.**/ Ne iu shmangëm dhunës.

Në gramatikën me orientim nga përmbajtja si dhe në disa tekste gramatikore⁴⁰⁹ të gjuhës gjermane përmendet dhe ndarja semantike: ‘direktes Objekt’/ kundrinë e drejtë dhe ‘indirektes Objekt’/ kundrinë e zhdrejtë. Në ndryshim nga kundrina e drejtë, kundrina e zhdrejtë sipas tyre preket në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga veprimi i shprehur nga folja.:

⁴⁰⁹Hentschel/ Weydtn, f. 328; Bynting/ Bergenholz, f. 79; Pittner/ Bermann, f. 36; Duden, f. 590

Sie liest **ihrer Schwester** vor./ Ajo i lexon motrës së saj.

Sie gibt **ihr** das Brot./ Ajo i jep asaj bukën.

Ndryshe nga Bynding /Bergenholtz e Pitner/ Berman, të cilët e njehsojnë kundrinën e rasës dhanore me kundrinën e zhdrejtë, Henshel/ Veid shtrojnë çështjen nëse përveç kundrinës së rasës dhanore, mund të jenë kundrina të zhdrejta dhe disa kundrina të rasës gjinore dhe kundrina me parafjalë. Këtë mendim ndan dhe Eisenberg⁴¹⁰.

Eva überführt ihn **des Mordes**./ Eva e akuzon atë për vrasje.

Eva legt das Buch **auf den Tisch**./ Eva vendos librin mbi tavolinë.

Vendimi sipas tyre varet nëse kundrina e zhdrejtë shihet si kategori semantike apo sintaksore dhe më tej mënyra se si përkufizohen këto kategori në veçanti. Gjithsesi kjo çështje mbetet ende e hapur.

Këtu shihet qartë një ndryshim me kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë të gjuhës shqipe, e cila shprehet gjithmonë me një gjymtyrë në rasën dhanore. Një ndryshim tjetër është dhe ndarja e kundrinës së zhdrejtë në gjuhën shqipe, në kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinë të zhdrejtë me parafjalë.

Gjithashtu semantikisht, kundrina e rasës dhanore dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë shprehin përgjithësisht të njëjtat ngjyrime, si p.sh. vetën në dëm ose në dobi të së cilës kryefjala kryen veprimin (e quajtur dhanore e lirë komodi/ inkomodi në gjuhën gjermane), shënon zakonisht pritësin dhe mund të shprehë vetën së cilës i drejtohet veprimi (Dhanore e lirë posesive në gjuhën gjermane), vetën së cilës i lihet apo i jepet diçka, vetën së cilës i kumtohet apo i shpallet diçka, vetën që ka të bëjë me diçka ose vetën së cilës i shkaktohet diçka, një frymor ose send, nga tërësia e së cilit, i referohemi vetëm një pjese, vetën që vëmë në dijeni, që e informojmë ose vetën me të cilën komunikojmë, etj..

Në të dyja gjuhët ajo shpreh zakonisht objekt të jashtëm, d.m.th. objekt që egziston pavarësisht veprimit.

Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane si dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, sundohet zakonisht nga folje. Foljet të cilat sundojnë kundrinën e rasës kallëzore në gjuhën gjermane zakonisht janë jokallimtare relative. në gjuhën gjermane egzistojnë dhe mjaft folje kalimtare si: geben/ jap, raten/ këshilloj, anvertrauen/ besoj, etj., të cilat përveç kundrinës së rasës kallëzore kërkojnë dhe kundrinë të rasës dhanore. Gjithashtu dhe foljet që sundojnë kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe pa parafjalë në gjuhën shqipe mund të jetë e çdo diateze, kalimtare ose jokallimtare.

⁴¹⁰Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik*, Stuttgart: Metzler, 1989, f. 90

Ich kann **dir** auf jeden Fall helfen./ Patjetër mund të të ndihmoj ty.

Ich gebe **dir einen Hinweis** für die Lösung./ Do të të jap një ndihmë për zgjidhjen.

Në ndryshim nga njëra tjetra, kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane mund të sundohet dhe nga një mbiemër, ndërsa ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe mund të sundohet nga një emër.:

Er war **ihr** behilflich/ Ai e ndihmoi atë.

Qëllimi i kësaj vepre ishte shpëtimi dhe dhënia brezave që vijnë, i fjalëve e i teksteve shqipe.

Ashtu si kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, zakonisht nuk pësojnë asnjë ndryshim gjatë kthimit të fjalisë në pësore.:

Er hilft **seinem Freund**./ Ai ndihmon shokun e tij.; **Seinem Freund** wird geholfen./ Shoku i tij u ndihmua.

Shokët u ndihmuan **të plagosurve**.; **Të plagosurve** iu ndihmua (prej shokëve).

Përjashtim këtu bën rasti i një forme të kthimit në pësore, gjatë së cilës kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane kthehet në kryefjalë. Bëhet fjalë për ‘Rezipientenpassiv’, i cili kryhet me ndihmën e foljes bekomen/ marr.

Er hat **ihr** ein Buch geschenkt./ Ai i dhuroi asaj një libër.

Sie bekam von ihm ein Buch geschenkt./ Ajo mori prej tij një libër dhuratë.

Gjithashtu si kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane, dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, kthehet në përcaktor parafjalor (Präpositionalattribut) gjatë emërzimit të foljes së fjalisë.:

Er hilft **seinem Freund**./ Ai ndihmon shokun e tij.

Die Hilfe **für seinem Freund**./ Ndihma për shokun e tij.

Shokët u ndihmuan **të plagosurve**.; Ndihma e shokëve **për të plagosurit**.

Njëlloj si kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe atë të zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, mund ta ndeshim në një fjali përkatësisht bashkë me një kundrinë të rasës kallëzore dhe/ ose kundrinë me parafjalë si dhëkundrinë të drejtë, ku kjo e fundit shpreh një send ndërsa kundrina e zhdrejtë frymor dhe/ ose kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë.:

Ich gebe **dir einen Hinweis für die Lösung**./ Do të të jap ty një ndihmë për zgjidhjen.

Së mirës hapi gjithmonë **derën, së ligës bjeri me shqelm/** Dem Guten öffnet man immer die Tür, dem Bösen versetzt man mit einem Tritt.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm mes kundrinës së rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe asaj të zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, është dhe është fakti se kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shenjohe gjithmonë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor. Ky përdorim i detyruar i trajtës së shkurtër, e cila shoqëron në çdo rast foljen, dëshmon më së miri *“lidhjen e ngushtë dhe të domosdoshme të kundrinorit të rasës dhanore me foljen, së cilës i referohet.”*⁴¹¹

Tanit po i thahej pështyma.

Vajzës i pëlqeu jeta e fshatit.

Gjithashtu në ndryshim nga gjuha gjermane, njëlloj si kundrina e drejtë dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, mund të eliminohet në raste të caktuara. Dhe në këtë rast kemi shenjimin e saj me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.:

Tana **i** ngjante **asaj**.

Tana **i** ngjan.

Në të dyja gjuhët kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe shprehen me të njëjtat pjesë të ligjëratës (në rasën dhanore):

- Emër në rasën dhanore:
Ich schließe mich **dem Antrag** an./ Unë i bashkangjitem **kërkesës**.
- Përemër. Në gjuhën shqipe kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehet me të gjithë llojet e përemrave, ndërsa kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane mund të shprehet vetëm me përemra vetorë.:
Es war **ihr** übel./ **Asaj** i përzihej.
- Togfjalësh:
David winkt **seinem Nachbarn**./ Davidi përshëndet komshiun e tij
Ne do t'i ishim futur akoma më thellë **ligjit filozofik të luftës së të kundërtave**.
- Pjesë të emëruara të ligjëratës:
Ich kann **diesem Rot** nicht abgewinnen./ Nuk mund ta realizoj këtë ngjyrë të kuqe.
Loti i njomi **të voglës** faqen në atë shtrëngim dhëmbsurie.
- Fjali të nënrenditur. Në rastin e kundrinës së rasës dhanore në gjuhën gjermane bëhet fjalë për fjali relative pa adresant (Relativsatz ohne Bezugswort):

⁴¹¹Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 167

Erzähl das, **wem** du willst./ Tregoja kujt të duash këtë.

1.3. Shenjimi i kundrës së drejtë e të zhdrejtë të gjuhës shqipe me trajta të shkurtra të përemrit vetor.

Në ndryshim nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe kemi dukurinë e shenjimit të kundrinës me trajta të shkurtra të përemrit vetor.

Shenjimi i kundrinës, është një dukuri sintaksore e cila në rafshin morfologjik shprehet me anë të vendosjes së një shenjuesi pranë foljes që lidhet me kundrinën. Shenjuesit e kundrinës reflektojnë disa karakteristika të caktuara të kundrinës, atë të rasës (shënjuesit e kundrinës dalin në rasën kallëzore si reflektim i kundrinës së drejtë, dhe në rasën dhanore si reflektim i kundrinës së zhdrejtë) si dhe karakteristika të numrit dhe gjinisë. Prania e kundrinës së drejtë, dhe të zhdrejtë pa parafjalë shenjohe zakonisht nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, që vihet menjëherë para ose pas foljes, në kushte të caktuara edhe midis temës e mbaresës vetore të foljes.

Më konkretisht prania e kundrinës së drejtë të shprehur me emër, përemër a togfjalësh zakonisht shenjohe me anë të trajtës së shkurtër të përemrit vetor të vetës së parë e të dytë njëjës e shumës në rasën kallëzore”:

Ajo **më** thirri **mua** për ndihmë.

E dorëzova **letrën**.

Tani mund t’i hapni **librat**.

Ajo **i** shkëputi të gjitha **lidhjet** me të kaluarën.

Ai **i** edukonte **nxënësit** e saj me dashurinë për atdheun.

Vetëm në kushte të caktuara ligjërimore prania e kundrinës së drejtë nuk shenjohe nga trajta e shkurtër e përemrit vetor.

S’është gjë ajo që thua.

Martini hante i kërrusur mbi tepsinë, që kishte përpara.

Ndërsa prania e kundrinës të zhdrejtë pa parafjalë shenjohe në çdo situatë ligjërimore me anë të trajtës së shkurtër të përemrit vetor:

Ne do t’i shërbejmë me nder **atdheut**.

Të dy mjekët **i** shtrënguan dorën **njëri tjetrit**.

Këtij i këndon kitara në duar.

Trajta e shkurtër e përemrit vetor është e pranishme edhe kur situata konkrete e ligjërimimit ose konteksti e bëjnë të panevojshme praninë e vetë kundrinës së drejtë e asaj të zhdrejtë.:

Gjyshja **më** mori përdore.

Është turp për ne kur **të** shohim kështu.

Unë **ju** njoh prej kohësh.

Djali **na** tregon për ato ditë të bukura të kaluara gjatë pushimit.

Kur dëgjova kërcitjen e degëve, rreziku **m'u** duk më pranë.

Teksa e shoh **më** mbushet zemra me gëzim.

Ndonjëherë prania e një trajte të shkurtër të përemrit vetor të vetës së parë ose të dytë, është vetëm mjet i përdorur për qëllime stilistike, për t'i dhënë më gjallëri ligjërimin nëpërmjet lidhjes së veprimit me subjektet e tjerë; është dhanorja e quajtur nga disa studiues "dhanore etike". Ajo gjen përdorim zakonisht në gjuhën popullore dhe në letërsinë artistike.

M't' ia futi një shuplakë syve.

Ç'm'u lëshuan tatëpjetë keto rrëke të egra.

Ato shporta me zymbyla e bathra e ç'të **më** doje e lanë me gojë hapur.

Nëse në një fjali gjejmë njëkohësisht një kundrinë të drejtë e një të zhdrejtë, kemi gjithmonë të pranishëm një shenjues të kundrinës të rasës dhanore:

Desha t'i tregoj **mysafirrit** {një muze të ri/ disa kuriozitetet}

Por nëse edhe kundrina e drejtë i përmbush kriteret për shenjimin e saj me një trajtë të shkurtër, atëherë kemi praninë njëkohësisht të dy shenjuesve të kundrinave, një shenjues të kundrinës në rasën dhanore dhe një në rasën kallëzore.:

Sot **ia** tregova **mysafirrit** {muzeun e ri/ gjithë kuriozitetet}.

Desha t'i tregoj **mysafirrit** {një muze të ri/ disa kuriozitetet}.

1.4.Kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane dhe kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe.

Ndryshe nga llojet e tjera të kundrinave, si në rastin fjalive me kundrinë me parafjalë në gjuhën gjermane, ashtu edhe në rastin e fjalive me kundrinë të zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe, folja nuk përcakton një rasë por një parafjalë të caktuar. Në këtë rast parafjala ka një funksion të ngjashëm me atë të rasës, dmth kundrina me parafjalë apo ajo e zhdrejtë me parafjalë pasohet nga eptimi i një rase të caktuar, që nuk varet direkt nga folja, por jepet me ndihmën e një parafjale.

Ndryshimi mes dy gjuhëve është se në gjuhën gjermane këtë parafjalë nuk mund ta zgjedhim, por është e lidhur direkt me foljen ose mbiemrin në raste të rralla, p.sh. **denken an** etwas/ jemanden/ të mendosh për diçka/ dikë; **achten auf** etwas/ jemanden/

të kujdesesh për diçka/ dikë; **Angst haben vor** etwas/ jemandem/ të kesh frikë nga diçka/ dikush; **sich fürchten vor** etwas/ jemandem/ të trembesh nga diçka/ dikush

Gjithashtu, një numër i vogël foljesh në gjuhën gjermane lejojnë zgjedhjen mes dy apo më shumë parafjalëve. Kështu p.sh. foljet sprechen, schimpfen, rufen, wohnen, etj.. Duke u nisur nga funksioni që ato luajnë në fjali, kemi të bëjmë me kundrinore me parafjalë dhe pikërisht kjo parafjalë e pazëvendësueshme dhe e kushtëzuar nga folja bën dallimin mes kundrinorit me parafjalë dhe rrethanorit. (Er wohnt mit ihr./ Ai jeton me të. Er wohnt in Berlin. Ai jeton në Berlin.):

Sie spricht mit dem Lehrer über das Buch./ Ajo flet me mësuesin rreth librit.

Klaus schimpft **auf Hans**./ Klaus i qorton Hansin.

Klaus schimpft **über Hans**./ Klaus i ankohet për Hansin.

Në gjuhën gjermane dallojmë kundrina me parafjalë të cilat kërkojnë rasën kallëzore apo atë dhanore:

Er interessiert sich **für die deutsche Sprache**./ Ai interesohet për gjuhën gjermane.

Er erkundigt sich **nach dem Bewerbungsverfahren**./ Ai interesohet për procedurën e aplikimit.

Ndërsa në gjuhën shqipe dallojmë kundrinë të zhdrejtë me parafjalë ose shprehje parafjalore në rasën emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore. Vlen të theksohet se gjuha shqipe është e vetmja gjuhë indoevropiane që sundon parafjalë në rasën emërore.:

Mori zemër nga kjo zbutje e pandehur e Grizarakes, dhe me një guxim po aq të papritur, e zuri nga krahu dhe nuk e la të shkonte.

Me anën e shtypit, Ismeti besoi t'u dalë zot popullit e të drejtave të tija.

Unë kam shumë qejf të shkoj **me ty** në kinema.

E treta, ëndrrat e rreme, domethënë ato që s'janë parë vërtet, por që janë stisur **nga njerëzit** për arsye karrierizmi, ose të sajuara **prej gënjeshtarëve** të maniakëve dhe **provokatorëve**.

Kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane sundohet nga folje jokalmtare relative, ndërsa ajo e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe plotëson një folje kalimtare ose jokalmtare, në formën veprorë ose joveprorë.

Në të dyja gjuhët në raste shumë të rralla, kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane si dhe ajo e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe mund të drejtohet nga një mbiemër.:

Wir sind **auf eure Mithilfe angewiesen**./ Na nevojitet ndihma juaj.

Që nga viti 1993 punonte pranë zotit Bakalli... një burrë i leshtë nga sjellja, por shumë i frikshëm në punët politike.

Në ndryshim nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe kundrina e zhdrejtë me parafjalë në raste të rralla mund të drejtohet nga një emër prejfoljor ose nga një ndajfolje.:

Nxjerrja e naftës **me mjete** moderne kushton lirë.

Tani ai gjendej thuajse ngjitur me të.

Në të dyja gjuhët kundrina me parafjalë dhe ajo e zhdrejtë me parafjalë gjenden me anë të përemrave pyetës të shoqëruar me parafjalën përkatëse: “Për kë? Me kë? Me çfarë?” në gjuhën shqipe dhe ‘wen/ kë’ apo ‘wem/ kujt’ në rastet kur emri i kundrinës me parafjalë përcakton një frymor në gjuhën gjermane.

Në ndryshim nga gjuha shqipe, në gjuhën gjermane, në rastin kur emri i kundrinës me parafjalë përcakton një send apo abstrakt, pyetja bëhet me anën e një ndajfolje pronominale.:

Er hat Angst **vor der Dunkelheit**./ Ai ka frikë nga errësira.

Wovor hat er Angst?/ Nga se ka frikë ai?

Er denkt **an die Winterferien**./ Ai mendon për pushimet e dimrit.

Woran denkt er?/ Për çfarë mendon ai?

Në të dyja gjuhët këto kundrina mund të shprehen me:

- Emër të shoqëruar me parafjalë:
Sie dachten an die Ferien./ Ata mendonin për pushimet.
- Përemër të shoqëruar me parafjalë:
Er hatte Angst **vor ihnen**./ Ai kishte frikë **prej tyre**.
- Pjesë të emëruar të ligjëratës:
Er hat Angst **vor dem Zugeben** seines Fehlers/ Ai kishte frikë të pranonte gabimin e tij.
E gjithë ajo bisedë bëhej **për të mirën e tij**.
- Togfjalësh të shoqëruar me parafjalë:
Wir dachten **an die schönen Sommerferien im Schwarzwald**./ Ne mendonim për pushimet e bukura verore në Zhvarcvald.
Është mbuluar vetëm **me një gisht suva**.
- Fjali të nënrenditur:
E gjeti Rizanë **tek merrej me rregullimin e traktorit**.

- Në rastin kur kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane shprehet me një fjali të nënrenditur ose ndërtim paskajore, parafjala e kërkuar nga folja zhduket. Në këtë rast kemi te bëjmë me fjali kundrinore (Objektsätze):

Sie hat Angst, **ihren Fehler zuzugeben.** (= Sie hat Angst vor dem Zugeben ihres Fehlers.)

Ajo ka frikë të pranojë gabimin e saj. (= Ajo ka frikë nga pranimi i gabimit të saj.)

Wir zweifeln, **ob dies die Richtige Lösung ist.** (= Wir zweifeln an die Richtigkeit dieser Lösung.)

Ne dyshojmë, nëse kjo është zgjidhja e duhur. (= Ne dyshojmë në saktësinë e kësaj zgjidhjeje.)

Në rastet e sipërpërmendura, kemi shpesh praninë e korrelatit të shprehur me ndajfolje pronominale **da(r)**, i cili sipas rastit mund të jetë i detyrueshëm ose fakultativ.:

Sie hat Angst **davor**, ihren Fehler zuzugeben./ Ajo ka frikë të pranojë gabimin e saj.

Wir zweifeln **daran**, ob dies die Richtige Lösung ist./ Ne dyshojmë, nëse kjo është zgjidhja e duhur.

Në gjuhën gjermane, në rastin kur emri i kundrinës me parafjalë i referohet një sendi apo abstrakti emri i kundrinës me parafjalë mund të zëvendësohet me një 'Pronominaladverb'/ndajfolje përemërore, ndërsa në gjuhën shqipe zëvendësohet nga përemri vetor.:

Er hat Angst **vor der Dunkelheit.**/ Ai ka frikë nga errësira.

Er hat Angst **davor.**/ Ai ka frikë prej saj.

Kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane, ashtu si kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe, mund të kthehen në përcaktorë gjatë emëzimit të foljes së fjalisë.:

Die Jugend kämpft **für den Frieden.**/ Rinia lufton **për paqe.**

Der Kampf der Jugend für den Frieden./ Lufta e rinisë për paqe.

Ashtu si kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane dhe kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe, qëndron si rregull e pandryshuar gjatë shndërrimit të fjalisë në pësore.:

Man wartete **auf die ausländischen Gäste.**/ Presim miqtë e huaj.

Auf die ausländischen Gäste wurde gewartet./ Miqtë e huaj u pritën.

Punëtorët shtruan oborrin **me pllaka.**

Oborri u shtrua **me pllaka** prej punëtorëve.

Por në gjuhën shqipe, ky rregull sipas Çelikut ka një përjashtim. “*Vetëm kundrinori i zhdrejtë me parafjalën nga i fjalive pësore, që tregon vepruesin, mund të kthehet në kryefjalë në fjalitë veprore:*

Shkolla u ndërtua nga fshatarët.

Fshatarët ndërtuan shkollën.”⁴¹²

Gjithashtu në të dyja gjuhët ato mund të shfaqen në fjali e vetme, apo bashkë me kundrina të tjera:

- kundrinë të rasës kallëzore me kundrinë të drejtë:
Der Reisende dankt **dem Schaffner für seine Hilfe.**/ Udhëtari falënderon faktorinon për ndihmën e tij.
Ajo ishte një ndërtesë e vjetër, e ngritur **me gurë e qerpiç.**
- kundrinë të rasës dhanore me kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë:
Er erkundrigte sich **nach dem Namen der Stadt.**/ Ai u interesua për emrin e qytetit.
Djali fshiu sytë **me mëngën e xhaketës.**
- kundrinë me parafjalë me kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë:
Er beschwert sich **bei den Nachbarn über den Lärm.**/ Ai ankohet tek komshinjtë për zhurmën.
Luftoi **kundër Turqisë për çlirimin e Shqipërisë.**

Në të dyja gjuhët është gjithashtu e mundur që kundrina me parafjalë ose ajo e zhdrejtë me parafjalë të zëvendësohen përkatësisht nga një kundrinë rase (kallëzore, dhanore ose gjinore) në gjuhën gjermane dhe anasjelltas si dhe nga një kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Er schreibt **an einem Buch.**/ Ai shkruan një libër. (kundrinë e rasës kallëzore)

Er schreibt **ein Buch.**/ Ai shkruan një libër.

Er schreibt **an seinem Vater.**/ Ai i shkruan babait.

Er schreibt **seinem Vater.**/ Ai i shkruan babit. (kundrinë e rasës dhanore)

Sie erinnert sich **an der Befreiung.** Asaj i kujtohet çlirimi.

Sie erinnert sich **der Befreiung.**/ Asaj i kujtohet çlirimi. (kundrinë e rasës gjinore)

E ka treguar me kohë shqiptari frikën **nga pushka**, apo jo?

E ka treguar me kohë shqiptari në ia ka frikën **pushkës**, apo jo?

Takoj **me dekanin.**

Takoj **dekanin.**

⁴¹²Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012, f. 163

Në të dyja gjuhët, kundrina me parafjalë dhe kundrina e zhdrejtë me parafjalë mund të ngatërrohet lehtësisht me rrethanorin. Dallimi kryesor në identifikimin e kundrinës në këtë rast mes dy gjuhëve është se në gjuhën gjermane kundrina me parafjalë është e lidhur ngushtësisht me foljen.

1.5.Kundrina e rasës gjinore në gjuhën gjermane.

Në gjuhën gjermane në ndryshim nga gjuha shqipe egziston dhe kundrina e rasës gjinore. Kjo kundrinë shprehet me anë të njëemri, përemri, togfjalëshi, pjesë të tjera të emëruara të ligjëratësnë rasën gjinore, ose fjali të nënrenditur. Ajo gjendet me anë të pyetjes analitike ‘wessen?’/ kujt?.

Man verwiess ihn **des Landes**./ Atë e përzunë nga toka.

Ich erinnere mich **ihrer**./ Më kujtohet ajo.

Ich gedenke **der schönen Zeit** mit dir./ Unë kujtoj kohën e bukur që kalova me ty.

Man bezichtigte ihn **des Verrats**./ Ai u akuzua për tradhëti

Ich gedenke, **wessen ich will**./ Unë përkujtoj kë të dua

Në ditët e sotme kjo kundrinë gjen përdorim mjaft të rrallë. Ajo sundohet nga folje jokalimtare relative. Atë mund ta ndeshim në stilin arkaik letrar, në gjuhën juridike, disa shprehje të ngurta si dhe në disa ndërtime refleksive.

Sie konnte sich **seiner** nicht entsinnen./ Ajo nuk e mbante mend atë.

Er wurde gestern **eines Verbrechers** überführt./ Ai u akuzua dje për një krim

Sie erfreut sich **bester Gesundheit**./ Ajo gëzon shëndet të plotë.

Du hast dich **eines guten Stils** befließigt./ Ti je kujdesur për të patur një pamje të kuruar.

Ajo zëvendësohet shpesh nga kundrina e rasës kallëzore ose ajo me parafjalë.:

Uns ermangelt **der Übung**. → Uns ermangelt **die Übung**./ Ne na mungon praktika.

Er bedarf **des Trostes**. → Er bedarf **den Trost**./ Ai duhet ngushëlluar.

Er erinnert sich **seines Freudes**. → Er erinnert sich **an seinen Freund**./ Atij i kujtohet shoku i tij.

Ich schäme mich **seines Verhaltens**. → Ich schäme mich **über sein Verhalten**./ Mua më vjen turp nga sjellja e tij.

Kundrina e rasës gjinore nuk pëson asnjë ndryshim gjatë kthimit të fjalisë në pësore.

Die Bevölkerung gedachte **der Befreiungskämpfer**./ Populli përkujtonte luftëtarët e lirisë.

Der Befreiungskämpfer wurde gedacht./ Përkujtoheshin luftëtarët e lirisë.

Në rastin e emëzimit të foljes së fjalisë, kundrina e rasës gjinore kthehet në përcaktor parafjalor.

Sie erinnern sich **des Befreiungstages**./ Ata kujtojnë ditën e çlirimit.

Ihre Erinnerung **an den Befreiungstag**./ Kujtimi i tyre i ditës së çlirimit.

Shpeshherë, kundrina e rasës gjinore mund të transformohet në një kundrinë me parafjalë.:

Er erinnert sich **seines Freundes**./ Ai kujton shokun e tij.

Er erinnert sich **an seinen Freund**./ Ai kujton shokun e tij.

Ashtu si tri kundrinat e tjera të gjuhës gjermane, kundrina e rasës gjinore përveç se nga folja, mund sundohet dhe nga një mbiemër:

Sie ist sich **seiner Unterstützung** sicher./ Ajo është e sigurtë për mbështetjen e tij.

Ich bin mir **desen** bewusst./ E kam të qartë këtë gjë.

Ajo mund të shfaqet dhe së bashku me një kundrinë të rasës kallëzore. Në këtë rast kundrina e rasës kallëzore i referohet një frymori, ndërsa ajo e rasës gjinore një sendi.:

Der Richter beschuldigte **den Angeklagten** **den Diebstahl**./ Gjykatësi e shpalli të akuzuarin fajtor për vjedhje.

PJESA E TRETË

KREU VII - RENDI I KUNDRINËS NË GJUHËN GJERMANE

1. Rendi i gjymtyrëve në fjalinë e thjeshtë dëftore.

Rendi i gjymtyrëve është një nga mjetet më të rëndësishëm të formësimit të fjalisë. Ai kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm dhe kryen në fjali disa funksione. Kriter bazë për renditjen e gjymtyrëve në fjali në gjuhën gjermane dhe atë shqipe është kryesisht vlera e përmbajtjes së informacionit që duam të përcjellim. Ashtu si në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe megjithëse rendi i gjymtyrëve në fjali është kryesisht i lirë, pra gjymtyrët mund të qëndrojnë në pozicione të ndryshme në fjali, ekzistojnë dhe disa rregulla dhe gjithashtu disa përjashtime.

1.1.Korniza e fjalisë (Satzklammer)

Gjuha gjermane dallon rrënjësisht nga gjuhët e tjera indoevropiane përse i përket mënyrës së ndërtimit të fjalisë dhe rendit të gjymtyrëve në fjali. Kështu karakteristike për gjuhën gjermane është ndarja në dy pjesë e kallëzuesit të përbërë, dhe përfshirja e pothuaj të gjitha gjymtyrëve të tjera të fjalisë ndërmjet pjesës së parë (P1) dhe pjesës së dytë (P2) apo pjesëve të tjera (Pn) të kallëzuesit. Këto pjesë të kallëzuesit përbëjnë dhe skeletin e fjalisë gjermane. Me pozicionet e tyre të përcaktuara P1, P2, ato formojnë tri fusha karakteristike për gjuhën gjermane në të cilat gjejnë vend gjymtyrët e fjalisë (Vorfeld, Mittelfeld/Satzfeld, Nachfeld). Kjo ndarje e kallëzuesit dhe përcaktimi i rendit të tij quhet ndryshe dhe korniza e fjalisë (Satzrahmen).

Vorfeld

Mittelfeld/Satzfeld

Nachfeld

----- P1 ----- P2 -----

Gjuhëtari i parë gjerman që bëri këtë përcaktim duke e ndarë fjalinë në tre fusha, që përdoret ende sot, ishte Erich Drach në vitin 1934 në librin e tij “Grundgedanken der deutschen Satzlehre”. Ai shprehet ndër të tjera se⁴¹³ “*das Verbum finitum ist der standfeste Angelpunkt, um den herum der Satz sich aufbaut und aufgliedert.*”/ Folja finite është pika kryesore rreth së cilës formohet dhe ndërtohet fjalia.

Folja finite së bashku me pjesën infinite të kallëzuesit ose pjesëzën e kallëzuesit, formojnë së bashku kallëzuesin e përbërë.

Në ndryshim nga pjesa infinite, pjesa finite e kallëzuesit është e pandryshueshme. Ajo nuk përcaktohet nga veta, numri, koha dhe mënyra. Pjesa finite e foljes mund të jetë paskajorja e foljes, Particip I dhe II si dhe sich.:

⁴¹³ Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenäum, Weinheim 1995, f. 98.

Er muss morgen arbeiten. (Infinitiv)/ Ai duhet të punojë nesër.

Das ist für Sie entscheidend. (partizip I)/ Kjo është vendimtare për Ju.

Sie haben das Haus verkauft.(Partizip II)/ Ata e shitën shtëpinë.

Sie weigert sich. (sich)/ Ajo kundërshton.

Sipas Helbig⁴¹⁴ , formimi i kornizës së fjalisë kufizohet nga sa u tha më lart me anë të kallëzuesit të përbërë, por në raste të caktuara dhe me anë të gjymtyrëve të tjera:

-Partizip II dhe paskajore:

Sie **wurde** gestern von ihren Brüdern im Krankenhaus **besucht**./ Ajo u vizitua dje në spital nga vëllezërit e saj.

-Paskajore në rastin e foljeve modale:

Sie **scheint** das Buch schon lange zu **kennen**./ Ajo duket se e njeh librin prej kohësh.

-Pjesë të ndashme foljesh:

Sie **bereitet** sich im Urlaub auf die mündliche Prüfung **vor**./ Ajo përgatitet gjatë pushimeve për provimin me gojë.

-Kallëzuesorë emërorë dhe ndajfoljorë:

Sie **wird** wegen ihrer mangelhaften Leistungen nicht **Klavierspilerin**./ Ajo nuk mund të bëhet pianiste për shkak të rezultateve të dobëta.

-Ndajfolje dhe togfjalësh me parafjalë si shprehës drejtimi në rastin e foljeve me ndryshim vendndodhje:

Sie **kommt** wegen ihrer vielen Reisen nur noch selten **im Kino**./ Për shkak të udhëtimeve të shumta ajo shkon rrallë në kinema.

-Pjesëza mohuese nicht:

Sie **besuchte** ihre Grossmutter trotz der Einladung **nicht**./ Ajo nuk e vizitonte gjyshen e saj megjithë ftesën.

-Togfjalësha emërorë si pjesë të Funktionsverbgefügen:

⁴¹⁴ Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f.117.

Sie **stellen** die richtigkeit ihrer Thesen durch das experiment **unter Beweis**./ Ata vërtetojnë saktësinë e tezës së tyre me anë të eksperimentit.

1.1.1. Das Mittelfeld

Në Mittelfeld janë të renditura pothuajse të gjitha gjymtyrët e fjalisë përfshirë dhe kundrinat:

Sie hat **ihrer Freundin das Buch** gegeben./Ajo i dha shoqes së saj librin.

Mein Vater hat **mir** zum Geburtstag **ein Fahrrad** geschenkt./ Babai me dhuroi një biçikletë për ditëlindje.

Në bazë të vlerës së informacionit dhe më konkretisht intonacionit, Heinz Griesbach⁴¹⁵ dallon dhe rendit 12 pozicione ku vendosen gjymtyrët në Mittelfeld, apo siç e quan ai Satzfeld. Ai i ndan ato si vijon.:

1. *”Auf den festen Stellplätzen 1,2,3 stehen in der angegebenen Reihenfolge Personalpronomen, wenn sie Subjekt (s), Akkusativobjekt (oa) und Dativobjekt (od) sind; das unbestimmte pronomen “man” besetzt ebenfalls den Stellplatz 1./ Në pozicionet e ngulitura 1,2,3 vendosen në rendin e dhënë përemrat vetorë, në rastin kur janë kryefjalë, kundrinë e drejtë, kundrinë e drejtë dhe kundrinë e zhdrejtë.:*

2. *Auf den stellplätzen 4, 6, 7 stehen in der angegebenen Reihenfolge Subjekt (S), Dativobjekt (Od) und Akkusativobjekt (Oa)./ Në pozicionet 4,6,7 vendosen në rendin e dhënë kryefjala, kundrina e drejtë dhe kundrina e zhdrejtë.:*

3*Auf demm Stellplatz 5 stehen die Angaben (A)./ Në pozicionin 5 vendosen rrethatorët.:*

4.*Die Satzglieder in den offenen Stellplätze 8, 9, 10 hinüberwechseln, wenn sie einen höheren Mitteilungswert erhalten und im Informationsbereich herausgehoben werden sollen./ Gjymtyrët e fjalisë të vendosura në pozicionet e hapura 8, 9, 10 këmbëjnë vendet me njëra tjetrën në rastet kur përmbajnë një vlerë informacioni më të madhe dhe duhet të theksohen në zonën e informacionit.*

5. *Auf den festen Stellplätzen 11, 12 stehen in der angegebenen Reihenfolge das Präpositionalobjekt (Op/ pronominal: op), das Genitivobjekt (Og) und Prädikatsergänzungen (E) jeder Art./ Në pozicionet e ngulitura 11, 12 vendosen në rendin e dhënë kundrina me parafjalë, kundrina e rasës gjinore dhe plotësit kallëzuesor të çdo lloji.”*

⁴¹⁵ Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f. 82-84.

Ai gjithashtu thekson se asnjeherë nuk mund të zihen të gjitha pozicionet njëkohësisht, por vetëm disa prej tyre. Numrat e vendosur prej tij shërbejnë si rregullator i renditjes së gjymtyrëve mes njëra tjetrës.

1.1.2. Das Vorfeld

Në rastet kur folja finite (finite Verb) ndodhet në pozicionin e dytë, gjithçka ndodhet para saj përbën Vorfeld. Në Vorfeld në shumicën e rasteve vendoset kryefjala, çka përbën dhe skemën bazë të fjalisë dëftore.

Hans hat gestern für seine Freundin ein Geschenk ausgesucht./ Hansi kerkoi dje një dhuratë për shoqen e tij.

Por në Vorfeld mund të vendoset si rregull çdo gjymtyrë e fjalisë përveç kallëzuesit. Dhe kundrinat pra mund të gjenden në Vorfeld në raste të caktuara kryesisht për arsye theksimi. Kjo ndodh kur kundrina mbart një informacion të cilin duam ta theksojmë në mënyrë të veçantë:

Für seine Freundin hat Hans gestern ein Geschenk ausgesucht./ Për shoqen e tij Hansi kërkoj një dhuratë dje.

Gestern hat Hans für seine Freundin ein Geschenk ausgesucht./ Dje kërkoj Hansi një dhuratë për shoqen e tij.

Ein Geschenk hat Hans gestern für seine Freundin ausgesucht./ Një dhuratë kërkoj Hansi dje për shoqen e tij.

Në Vorfeld mund të vendoset dhe një fjali e nënrenditur.:

Als sie gestern Abend nach Hause kam, setzte sie sich zu Tisch./ Kur u kthye mbrëmë në darkë në shtëpi, ajo u ul në tavolinë.

1.1.3. Das Nachfeld

“Das Nachfeld besteht aus den nicht finiten teilen eines mehrgliedrigen Satzgliedes (Infinitiveverbformen und Verbzusätze). In Sätzen mit nur einen Verb, dem finitem Verb, gibt es also keinen Nachfeld. Im Sätzen mit Nachfeld hat man eine verbale Satzklammer./ Nachfeld përbëhet nga pjesët jo finite të një gjymtyrë fjalie të përbërë. (format foljore paskajore dhe pjesëzat e foljes. Në fjalitë që kanë vetëm një folje, atë kryesore nuk ka Nachfeld. Në fjalitë me Nachfeld kemi të bëjmë me një kornizë fjalie.”⁴¹⁶

⁴¹⁶ Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenhäum, Weinheim 1995, f. 100

rema tema

Në rastet kur duam ta theksojmë veçanërisht remën mund të themi:

Ihrer Schwester hat Maria *ein Geschenk* gemacht./ Motrës së saj i bëri Maria një dhuratë.

tema rema

1.3.Funksioni gramatikor i rendit të gjymtyrëve

Kriteri gramatikor, si p.sh. ai morfologjik apo sintaksor luajnë një rol të rëndësishëm për të renditur gjymtyrët veçanërisht në Mittelfeld, pasi forma shërben në përcaktimin e vlerës së informacionit. Sipas kriterit morfologjik, mw konkretisht renditja është: gjymtyrë të shprehura me përemra pronor dhe reflektiv– gjymtyrë të shprehura me emra të shquar dhe përemra dëftor dhe pronor – gjymtyrë të shprehura me emra të pashquar si dhe përemra të papërcaktuar.

Gjithashtu bazuar në faktorë morfologjikë kemi dhe këmbimin e vendit mes kundrinës së drejtë dhe asaj të zhdrejtë në varësi se me çfarë shprehen me emër apo përemër.:

Sie gibt dem Schüler das Buch./ Ajo i jep nxënësit librin.

Sie gibt es Ihm./ Ajo ia jep atë atij.

Faktorët sintaksorë luajnë rol veçanërisht në pozicionin e kallëzuesit. P.sh. në fjalitë dëftore kallëzuesi vendoset në pozicionin e dytë, në fjali pyetëse në vendin e parë, ndërsa në fjalitë e nënrenditura në pozicionin e fundit. Në rastin e kallëzuesit të përbërë formohet korniza e fjalisë.:

Er trifft seine Frau./ Ai takon gruan e tij. (fjali dëftore)

Kommt er?/ Do vijë ai? (fjali pyetëse)

Er kommt, weil er sie sehen will./ Ai vjen se dëshiron të shohë atë. (fjali e nënrenditur)

Sie hat ihn gestern nicht gesehen./ Ajo nuk e pa atë dje (korniza e fjalisë)

2. Rendi i kundrinave në fjalinë e thjeshtë dëftore.

Përsa i përket kundrinave renditja bazë dhe më e përhapur e tyre është: kundrina e dhanores para kundrinës së kallëzores (kundrinat e dhanores shprehin zakonisht persona, duke përbërë kështu zakonisht temën, ndërsa të kallëzores sende, remën), kundrina e kallëzores para kundrinës së gjinores dhe gjithmonë pas kundrinave të rasave vendoset kundrina me parafjalë. Por siç do shihet më poshtë ka dhe përjashtime.

2.1.Rendi i kundrinës së rasës dhanore (Dativobjekt) dhe kallëzore (Akkusativobjekt) në fjalinë e thjeshtë dëftore.

Kundrina e rasës kallëzore dhe dhanore në gjuhën gjermane kanë një skemë rendi dhe raport më të fiksuar se gjymtyrët e tjera të fjalisë, për vetë faktin se ka rregulla të përcaktuara se kur vendoset kundrina e rasës dhanore para asaj të rasës kallëzore. Pra siç do trajtohet më hollësisht në vijim, duke u nisur nga fakti që ekzistojnë rregulla për renditjen e grupit të kundrinave, mund të themi se rendi i tyre është i fiksuar. Këto rregulla janë të lidhura me pjesën e ligjëratës me të cilën shprehen kundrinat. Pra ndryshe është skema e rendit të kundrinave të shprehura me emër, me emër e përemër apo me përemra. Skema që gjen përdorim më të gjerë është:

Kryefjalë + kundrinë në rasën dhanore + kundrinë në rasën kallëzore

Gestern schenkte die Lehrerin dem Jungen das Geschichtsbuch./ Dje mësuesja i dhuroi djalit librin e historisë.

Në raste të rralla nëse duam të theksojmë kundrinën e kallëzores ajo mund të vendoset para kundrinës së dhanores:

Kryefjalë + kundrinë në rasën kallëzore+ kundrinë në rasën dhanore

Gestern schenkte die Lehrerin das Geschichtsbuch dem Jungen./ Dje i dhuroi mësuesja librin e historisë djalit.

Kundrina e rasës dhanore mund të vendoset dhe para kryefjalës kur duam ta theksojmë remën, pra në rendin:

Kundrinë në rasën dhanore+ kryefjalë + kundrinë në rasën kallëzore.

Gestern schenkte dem Jungen die Lehrerin das Geschichtsbuch./ Dje i dhuroi djalit mësuesja librin e historisë.

Ky rend vlen gjithashtu dhe për rastin kur kundrina në rasën dhanore është shprehur me përemër:

Gestern schenkte ihm die Lehrerin das Geschichtsbuch./ Dje i dhuroi atij mësuesja librin e historisë.

Rol pra në renditjen e kundrinave luan se me çfarë pjese të ligjëratës ato shprehen.

Në rastin kur kundrina e rasës kallëzore shprehet me përemër kemi rendin:

Kryefjalë + kundrinë në rasën kallëzore + kundrinë në rasën dhanore

Gestern schenkte die Lehrerin es dem Jungen./ Dje ia dhuroi mësuesja atë djalit.

I njëjti rend vlen dhe kur të dy këto kundrina shprehen me përemër:

Gestern schenkte die Lehrerin es ihm./ Dje ia dhuroi mësuesja atë atij.

Në rastin kur kundrina e rasës kallëzore është e shprehur me një emër të pashquar ajo vendoset gjithmonë pas kundrinës së rasës dhanore:

Er zeigt dem Freund ein Bild./ Ai i tregon shokut një foto.

Në raste të rralla gjejmë përdorim dy kundrina të rasës kallëzore në një fjali. Zakonisht në këtë rast kundrina që shpreh persona vendoset para asaj që shpreh sende, pra rendi temë- remë.

Sie lehrt ihre Schüler das kleine Einmaleins./ Ajo i mëson nxënësve të saj tabelën e shumëzimit.

2.2.Rendi i kundrinës së rasës gjinore (Genitivobjekt) në fjalinë e thjeshtë dëftore.

Si rregull në gjuhën gjermane vlen sa më ngushtesisht e lidhur të jetë një gjymtyrë fjalie me foljen, aq më në fund të fjalisë vendoset dhe aq më e rëndësishme është për nga kumtimi. Për këtë arsye kundrinat e rases gjinore, e cila siç u tha më lart nuk ekziston në shqip dhe ajo me parafjalë vendosen gjithmonë në fund të fjalisë përpara pjesës së dytë të foljes P2. Kundrinat e gjinore janë të lidhura ngushtesisht me foljen pasi ato kërkojnë vetëm rasën gjinore. (*bedürfen, ermangeln, gedenken, harren, pflegen (nur poetisch: der Ruhe pflegen), spotten, sich bedienen, sich besinnen, sich erfreuen (auch: sich freuen), sich erinnern, sich rühmen.*)

Rendi i kundrinës së rasës gjinore në gjuhën gjermane është gjithmonë:

Kryefjalë + kundrinë në rasën gjinore

Sie gedenken der Freunde./ Ata kujtojnë shokët.

Sie erinnert sich ihres letzten Urlaubs./ Asaj i kujtohen pushimet e fundit.

Er erfreut sich bester Gesundheit./ Ai gëzon shëndet të plotë.

Ich bediene mich des Genitivs./ Unë përdor genitivin.

Në gjuhën gjermane ekzistojnë dhe disa folje (të cilat gjejnë përdorim në gjuhën e ligjore: *verdächtigen, anklagen, beschuldigen, bezichtigen, überführen; aber auch jemanden einer Sache berauben, entheben, verweisen.*) që marrin gjymtyrë dhe në rasën gjinore dhe kallëzore.

Në këtë rast kemi renditjen: kryefjalë + kundrinë në rasën kallëzore + kundrinë në rasën gjinore:

*Man klagt **ihn des Meineids** an./ Au i akuzua për dëshmi të rreme.*

*Er bezichtigt **ihn der Unehrlichkeit**./ Ai e akuzoi atë për mungesë sinqeriteti.*

*Man verdächtigte **den Zeugen der Lüge**./ Dëshmitari dyshohej se gënjente.*

2.3. Rendi i kundrinës me parafjalë në fjalinë e thjeshtë dëftore.

Përsa i përket kundrinave renditja bazë dhe më e përhapur e tyre është: kundrina e dhanores para kundrinës së kallëzores (kundrinat e dhanores shprehin zakonisht persona duke përbërë kështu zakonisht temën, ndërsa të kallëzores sende, remën), kundrina e kallëzores para kundrinës së gjinores dhe gjithmonë pas kundrinave të rasave vendoset kundrina me parafjalë.

Kundrinat me parafjalë në gjuhën gjermane zakonisht vendosen në fund të fjalisë, para pjesës së dytë të kallëzuesit P2, pamvarësisht nga vlera e informacionit që ato përçojnë, në rendin:

*Sie wartet **auf Klaus**./ Ajo pret Klausin.*

Kundrinat e rasës dhanore dhe kallëzore vendosen gjithmonë para atyre me parafjalë:

*Er dankt **dem Schüler für seine Hilfe**./ Ai falënderon nxënësin për ndihmën e tij.*

*Er fragt **den Verkehrspolizisten nach dem Hotel**./ Ai pyeti policin rrugor për hotelin.*

Nëse në një fjali kemi dy kundrina me parafjalë si rregull kundrina me parafjalë në rasën dhanore vendoset para asaj me parafjalënë rasën kallëzore:

*Wir haben uns **bei dem Beamtenschiff nach der Ankunft des Zuges** erkundigt./ Ne pyetëm nëpunësin rreth mbërritjes së trenit.*

Kur kundrina me parafjalë është shprehur me ndajfolje pronominale (darüber, damit, etj.) për arsye theksimi ajo mund të vendoset në fillim të fjalisë (Vorfeld) para kryefjalës:

***Darüber** haben wir uns schon lange gewundert./ Kemi kohë që çuditemi për këtë.*

***Damit** habe ich mich leider niemals beschäftigt./ Me këtë gjë nuk jam marrë fatkeqësisht kurrë.*

Kundrinat me parafjalë në gjuhën gjermane zakonisht vendosen në fund të fjalisë, para pjesës së dytë të kallëzuesit P2, pamvarësisht nga vlera e informacionit që ato përçojnë, në rendin:

Kryefjalë + kundrinë me parafjalë

*Sie wartet **auf Klaus.**/ Ajo pret Klausin.*

Në kombinimin kundrinë e rasës kallëzore me kundrinë me parafjalë rendi është:

Kryefjalë + kundrinë në rasën kallëzore + kundrinë me parafjalë

*Er fragt **den Verkehrspolizisten nach dem Hotel.** /Ai pyet policët rrugor për rrugën për në hotel.*

Ndërsa kur kemi dy kundrina me parafjalë rendi është:

Kryefjalë + kundrinë me parafjalë në rasën dhanore + kundrinë me parafjalë

*Wir haben uns **bei dem Beamtenach der Ankunft des Zuges** erkundigt./Ne pyetëm nëpunësin rreth orarit të mbërritjes së trenit.*

Kur kundrina me parafjalë është shprehur me përemër parafjalor (darüber, damit, etj.) për arsye theksimi ajo mund të vendoset në fillim të fjalës (Vorfeld) para kryefjalës:

Kundrinë me parafjalë + kryefjalë

***Darüber** haben wir uns schon lange gewundert./ Kjo gjë na ka habitur gjithmonë.*

***Damit** habe ich mich leider niemals beschäftigt./ Fatkeqësisht nuk jam marrë asnjëherë me këtë gjë.*

3. Përmbledhje e skemave të ndërtimit të fjalisë sipas Duden⁴¹⁷

1. Kryefjalë + kallëzues

Die Rosen blühen./ Trëndafilat çelin.

2. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore

Der Gärtner bindet die Blumen./ Kopshtari lidh lulet.

3. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës dhanore

Der Sohn dankte dem Vater./ Djali falënderon të atin.

4. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës gjinore

⁴¹⁷Duden-Grammatik, 5. Aufl. Mannheim 1995, S. 1205, Kap. 2.5.4.

Die Angehörigen gedachten der Toten./ Familjarët përkujtonin të vdekurit.

5. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë me parafjalë

Der Arzt achtet auf die Meßwerte./ Mjeku ka kujdes vlerat e matura.

6. Kryefjalë + kallëzues + Gleichsetzungsnominativ

Der Wirt ist mein Freund./ I zoti i lokalit është miku im.

7. Kryefjalë + kallëzues + rrethanas vendi

Das Buch liegt auf dem Tisch./ Libri ndodhet mbi tryezë.

8. Kryefjalë + kallëzues + rrethanas kohe

Die Beratung dauerte zwei Stunden./ Këshillimi zgjati dy orë.

9. Kryefjalë + kallëzues + rrethanas mënyre

Die Rose ist schön./ Trëndafili është i bukur.

10. Kryefjalë + kallëzues + rrethanas qëllimi

Das Verbrechen geschah aus Eifersucht./ Krimi ndodhi nga xhelozia.

11. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës dhanore + kundrinë e rasës kallëzore

Der Junge schenkt seiner Mutter Blumen./ Djali i dhuron lule nënës.

12. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + kundrinë e rasës gjinore

Der Richter beschuldigt den Angeklagten des Diebstahls./ Gjykatësi e fajësoi për vjedhje të akuzuarin.

13. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + kundrinë me parafjalë

Er verriet ihn an seine Feinde./ Ai e spiunoi atë tek armiqtë e tij.

14. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + kundrinë me parafjalë

Ich hänge das Bild an die Wand./ Unë var pikturën në mur.

15. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + rrethanas kohe

Der Vorsitzende verlegte die Sitzung in die Abendstunden./ Kryetari e shtyu mbledhjen për në darkë.

16. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + rrethanor vendi

Der Maler streicht die Wand weiß./ Bojaxhiu e lyen murin me të bardhë.

17. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + kundrinë me parafjalë

Er handelt niederträchtig an ihm./ Ai sillet keq me të.

18. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + rrethanor vendi

Es geht lustig zu auf der Festwiese./ Ai shkon me gëzim në lëndinë ku bëhet festa.

19. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + Gleichsetzungsakkusativ

Der Nachbar nennt mich einen Lügner./ Komshiu më quan gënjeshtar.

20. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + kundrinë e rasës kallëzore

Sie lehrt mich die französische Sprache./ Ajo më mëson mua gjuhën franceze.

21. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës dhanore + kundrinë me parafjalë

Ich rate dir zum Nachgeben./ Të këshilloj të dorëzohesh.

22. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës dhanore + rrethanor mënyre

Es geht mir schlecht./ Nuk ndihem mirë.

23. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë me parafjalë + kundrinë me parafjalë

Der Reisende sprach zu den Kindern über Afrika./ Udhëtari u foli fëmijëve në Afrikë.

24. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + kundrinë me parafjalë (2. Grades)

Das ist den Aufwand wert./ Ia vlen mundimi.

25. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + kundrinë e rasës dhanore (2. Grades)

Ich bin diesem Mann fremd./ Nuk e njoh këtë njeri.

26. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + kundrinë e rasës gjinore (2. Grades)

Er ist des Diebstahls schuldig./ Ai është fajtor për vjedhje.

27. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + kundrinë me parafjalë (2. Grades)

Der Laborant war mit den Ergebnissen zufrieden./ Laboranti ishte i kënaqur me rezultatet.

28. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + kundrinë e rasës dhanore (2.Grades) + kundrinë me parafjalë (2.Grades)/

Seine Frau ist mir an Ausdauer überlegen./ Sipas meje gruaja e tij nuk reziston.

29. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + rrethanor vendi (2. Grades)

Die Firma ist in München ansässig./ Firma e ka selinë në Mynih.

30. Kryefjalë + kallëzues + rrethanor mënyre + rrethanor mënyre (2. Grades)

Der Spalt ist einen Fuß breit./ E çara është një këmbë e gjerë.

31. Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e rasës kallëzore + rrethanor vendi + rrethanor vendi (2. Grades)

Er wirft den Ball 70m weit./ Ai e hedh topin në largësinë 70m .

32. Kryefjalë + kallëzues + dhanore pertinente

Dem Kind blutet die Hand./ Fëmijës i del gjak nga dora.

33. Kryefjalë + kallëzues + dhanore pertinente + kundrinë e rasës kallëzore

Er streichelt ihr die Wangen./ Ai i përkëdhel asaj faqet.

34. Kryefjalë + kallëzues + dhanore pertinente + kundrinë e rasës kallëzore + rrethanor mënyre

Der Friseur färbt der Kundin die Haare./ Parukieri i lyen klientes flokët.

35. Kryefjalë + kallëzues + dhanore pertinente + rrethanor vendi

Ich klopfe ihm auf die Schulter./ I rrah atij shpatullat

36. Kryefjalë + kallëzues + dhanore pertinente + kundrinë e rasës kallëzore + rrethanor vendi

Er legt ihm die Hand auf die Schulter./ Ai i vendos atij dorën mbi sup.

KREU VIII – RENDI I KUNDRINËS NË GJUHËN SHQIPE

Një nga mjetet më të rëndësishme të formimit të fjalisë është rendi i fjalëve dhe gjymtyrëve, i cili kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm dhe kryen disa funksione në fjali. Nga gjithë gjuhëtarët që janë marrë me këtë çështje është rënë në përgjithësi dakort se rendi i gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën shqipe është i lirë. Çdo gjymtyrë mund të zërë vende të ndryshme në fjali, pa e ndryshuar funksionin e saj sintaksor. “Megjithatë, kjo “liri” e vendosjes së gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën shqipe duhet kuptuar në mënyrë relative, po të kihet parasysh se funksioni themelor i rendit të gjymtyrëve edhe për shqipen është funksioni kumtues, shprehja e përbërësve të gjymtyrëzimit aktual të fjalisë.”⁴¹⁸

Në këtë kre do të shohim se si paraqitet dhe nga se kushtëzohet rendi i gjymtyrëve në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe në përgjithësi e i kundrinës në veçanti.

1. Rendi i fjalëve në gjuhën shqipe, vështrim historik.

Për sa i përket rendit të fjalëve në gjuhën shqipe mund të thuhet se nuk i është kushtuar ndonjë vëmendje e veçantë. Çështje të veçanta që kanë lidhje me këtë çështje janë trajtuar shkurtimisht në sintaksa të ndryshme të gjuhës shqipe. Mund të thuhet se për këtë çështje mungojnë punime të thelluara. I pari që e përmend shkurtimisht çështjen në fjalë është Sheperi në 1927 i cili në veprën e tij shprehet se normalisht kryefjala zë vendin e parë në fjali, e ndjekur nga folja dhe më pas vendoset kundrina ose rrethanori.⁴¹⁹ Gjithashtu fare shkurtimisht kjo çështje është cekur dhe nga Xhuvani në 1935 dhe Cipo në 1952. Në të gjitha këto sintaksa vihet në dukje se rendi i fjalëve në gjuhën shqipe është i lirë dhe se ai mund të jetë i drejtë dhe i zhdrejtë. Gjithashtu në disa nga këto sintaksa janë bërë dhe përpjekje për të vënë në dukje rastet kur rendi i fjalëve kryen funksion stilistikor e gramatikor (pa përmendur këta terma), si dhe për ta lidhur rendin e fjalës me theksin logjik.

Pas viteve 50 kemi disa punime të paraqitura kryesisht në revista shkencore nga Floqi, Rrushi, Demiraj, Përnaska të cilat trajtojnë kryesisht çështje të veçuara që lidhen me rendin e fjalëve kryesisht në fjalinë dëftore. Vlen të theksohet se Floqi është gjuhëtari i parë që e trajton këtë çështje në kuadër të prespektivës së gramatikës funksionale të fjalisë. Trajtimi më i gjerë i rendit të fjalëve për herë të parë bëhet në kreun përkatës, hartuar në 1976 për veprën “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, III (Sintaksa). Në këtë vepër për herë të parë rendi i fjalëve shihet i lidhur ngushtë me funksionin e tij themelor, shprehjen e përbërësve të gjymtyrëzimit aktual të fjalisë. Në këtë kapitull trajtohen gjithahstu edhe funksioni stilistikor i rendit të fjalëve si dhe fare shkurtimisht funksioni kumtues, dhe në përputhje me të, rendi i gjymtyrëve të veçanta të fjalisë përcaktohet me faktin se bëjnë pjesë në temën apo në remën e thënies. Por

⁴¹⁸Rushi, Thoma: Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore, SF 1, 1983, f. 71.

⁴¹⁹Sheperi, Ilia Dilo, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes*, (për shkollat e mesme), Shtëpia botuese Vlora, Vlorë, 1927, f. 178

duhet thënë se dhe në këtë kapitull kjo çështje trajtohet në vazhden e trajtimit tradicional, ku rendi i gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë shihet i shkëputur nga strukturat ku ato bëjnë pjesë. Kështu flitet për rendin e kryefjalës, kallëzuesit, kundrinës, etj. Në tekstin “ Libri i gjuhës shqipe 2, për shkollat e mesme”, në kapitullin përkatës, përveç vështrimit të rendit të fjalëve lidhur me gjymtyrëzimin aktual të fjalisë bëhen përpjekje për ta studiuar këtë rend në struktura sintaksore të plota. Kështu psh., flitet për “ rendin e fjalëve në fjali me kryefjalë dhe kallëzues, në fjali me kryefjalë- kallëzues-kallëzuesor” etj. Gjithashtu këtu shihen dhe rastet kur rendi i fjalëve luan rol shprehës emocional.⁴²⁰(M. Totoni, Libri i gjuhës shqipe 2, për shkollat e mesme, Tiranë 1978, f.66-80)

Në vitet 80 kemi botimin e veprës Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë 1982, ku megjithëse rendit të fjalëve në fjalinë dëftore i është kushtuar një kapitull i veçantë, mund të themi se vazhdon trajtimi tradicional i çështjes. Rendi i fjalëve në fjali vazhdon të shihet si i lirë.

Gjuhëtari që është marrë më shumë e më gjerësisht me çështjen e rendit të fjalëve në gjuhën shqipe është Thoma Rrushi. Në punimin e tij ‘Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore’, botuar në vitin 1983. Ai e trajton këtë çështje nga këndvështrimi i analizës së gramatikës funksionale të fjalisë. Në këtë punim autori na jep një analizë të thelluar të çështjes duke trajtuar gjerësisht të tri funksionet e rendit të fjalëve, të ilustruar me shembuj. Në kapituj të veçantë trajtohen dhe rendi i kundrinës së drejtë dhe rendi i kundrinës së zhdrejtë në fjali. Megjithatë dhe në këtë punim gjymtyrët e ndryshme të fjalisë shihen të izoluar brenda kufijve të kontekstit të fjalisë e jo më gjerë. Gjithsesi mund të themi se ai mbron i pari tezën se rendi i fjalëve në fjali në gjuhën shqipe nuk mund të jetë plotësisht i lirë.

Një kapitull të veçantë për rendin e fjalëve kemi dhe në veprën e albanologëve gjerman Oda Bucholz dhe Wielfried Fiedler Albanische Grammatik, botuar në Leipzig në vitin 1987. Dhe këta dy gjuhëtarë pranojnë pohimin se rendi i fjalëve në gjuhën shqipe është përgjithësisht i lirë.

2. Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe, Vështrim i përgjithshëm.

“Termi rend i fjalëve, aktualisht përdoret me dy kuptime: së pari, me të kuptohet vendosja e gjymtyrëve të fjalisë ndaj njëra tjetrës (me këtë kuptim do të ishte më drejt të përdorej termi rend i gjymtyrëve të fjalisë); së dyti me të kuptohet vendosja drejtvizore e fjalëve brenda gjymtyrëvetë fjalisë. Në këtë rast mund të flitej për rend të fjalëve në togfjalësh.”⁴²¹

⁴²⁰Totoni, Menella: Libri i gjuhës shqipe 2, për shkollat e mesme, Tiranë 1978, f. 66-80

⁴²¹Rrushi, Thoma: Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe, Tiranë 1983, f. 4.

Gjithashtu dhe Përnaska bën dallimin mes rendit të fjalës dhe rendit të gjymtyrës, duke e përcaktuar këtë të fundit të lidhur ngushtë me prespektivën funksionale, me gjymtyrimin aktual.⁴²²

Një dallim mes rendit të fjalëve dhe rendit të gjymtyrëve e gjejmë të argumentuar dhe tek “Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa II”, ku argumentohet se: ‘Jo të gjitha fjalët që hyjnë në përbërje të fjalisë, janë gjymtyrë të saj, por mjaft prej tyre kanë një rend të caktuar.’ Veçanërisht i dukshëm është roli i rendit në ndërtimet ku mungojnë mjetet e tjera të shprehjes së raporteve sintaksore, siç është p.sh rasti i lidhjes së ndajfoljes me një fjali tjetër kuptimplotë.⁴²³

Në gjuhët që nuk kanë një sistem të zhvilluar eptimi kemi rend kryesisht të ngulitur të gjymtyrëve apo topikë, i cili luan një rol mjaft të rëndësishëm pasi shërben për të bërë dallimin e funksionit të tyre në fjali, thënë më saktë vendi i një fjale përcakton rolin e saj sintaksor. Ndërsa me rend përgjithësisht të lirë kemi të bëjmë në rastin e gjuhëve si shqipja ku kemi një sistem mjaft të pasur trajtash morfologjike dhe një përdorim të gjerë të parafjalëve, që e plotësojnë atë.

Rendi i gjymtyrëve në fjali në gjuhën shqipe mund të kryejë funksione të ndryshme kumtesore, stilistikore dhe gramatikore, të cilat përgjithësisht ndërthuren me njëra tjetrën.

Dhe për gjuhën shqipe, si në rastin e gjuhës gjermane, funksion themelor i rendit të gjymtyrëve është funksioni kumtues që lidhet me shprehjen e përbërësve të gjymtyrëzimit aktual të fjalisë. “Çdo fjali e dhënë (thënie) përmban një informacion të caktuar, pjesa më e rëndësishme e të cilit është informacioni aktual. Pikërisht këtë informacion, që përcaktohet nga qëllimi i thënies lidhet me situatën dhe kontekstin, që folësi synon t’ia kumtojë bashkëbiseduesit. Po të kemi parasysh marrëdhëniet folës bashkëbisedues, gjymtyrëzimi aktual mund të përcaktohet, nga njëra anë, si organizim i fjalisë për të transmetuar informacionin aktual dhe, nga ana tjetër, si shqyrtim i fjalisë nga pikëpamja e informacionit aktual që përmban ajo.”⁴²⁴

Gjymtyrëzimi aktual dallon në shumicën e rasteve dy pjesë përbërëse: atë për të cilën bëhet kumtimi (tema) dhe atë që kumtohet për temën (rema). Tema e kumtimit, pikënisja e tij shënon zakonisht diçka të njohur për dëgjuesin dhe për këtë të njohur kumtohet diçka e panjohur, diçka e re e shënuar nga rema.

⁴²²Përnaska, Remzi, "Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1979, 1, ff. 155-159

⁴²³Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 71

⁴²⁴Po aty, f. 413

Duke pasur parasysh vendosjen e gjymtyrëve të fjalisë ndaj njëra tjetrës dhe vendosjen e përbërësve të gjymtyrëzimit aktual ndaj njëri tjetrit, duhen dalluar për secilin rast dy lloje rendesh të gjymtyrëve:

a) Rendi i drejtë (kryefjalë + kallëzues, kallëzues + kundrinë, kallëzues + rrethanor)

Pellgu i mbushur me ujë shkëlqente.; Catitë me pllaka guri prisnin borën.

Rendi i anasjelltë (kallëzues + kryefjalë, Kundrinë + kallëzues etj.)

Po afronte ora.; Këtë e tregojnë veshjet popullore.

b) Rendi neutral (temë + remë)

Ibrahimi ato vargje të këngës i dinte.; Gramatika të shqipes hartoi edhe De Rada.

Rendi emfatik afektiv (remë + temë).;

Të gjithë e pohonin këtë.;; Dy djem kishte plaku.

Funksioni dytësor i rendit të gjymtyrëve në gjuhën shqipe është funksioni stilistikor, shprehës emocional, të cilin e gjejmë të shprehur përmes rendit remë + temë dhe shërben për të shprehur theksimin emfatik të remës.

Ndërsa funksioni i fundit, por jo më pak i rëndësishëm i rendit të gjymtyrëve në gjuhën shqipe, është ai gramatikor, i cili shërben për të përcaktuar funksionet e ndryshme sintaksore të gjymtyrëve të fjalisë. Me anën e këtij funksioni psh. Mund të dallohet në disa raste kryefjala nga kundrina e drejtë, kryefjala nga gjymtyra emërore e kallëzuesit etj.⁴²⁵

3. Funksioni kumtues i rendit të fjalëve në fjali.

1. Funksioni kumtues, siç u theksua më sipër “është funksioni themelor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe, lidhet me gjymtyrëzimin aktual të fjalisë. Ai është një nga mjetet kryesore që shpreh komponentët e këtij gjymtyrëzimi”⁴²⁶

Çdo fjali nëpërmjet strukturës së saj leksiko- sintaksore jep një informacion të caktuar për një fakt të realitetit objektiv. I gjithë ky informacion nuk është njëlloj i rëndësishëm për folësin dh bashkëbiseduesin. Një pjesë e tij është e njohur, është e dhënë nga konteksti dhe situata e ligjëritimit. Për ta e rëndësishme, aktuale është ajo pjesë e këtij

⁴²⁵Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 414-415

⁴²⁶Floqi, Spiro: Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme, SF. 1969

informacioni, të cilën folësi synon t'ia transmetojë si të re bashkëbiseduesit. Kjo përbën thelbin e një kumtimi të dhënë. Pa këtë fjalë s'do të kishte kuptim.⁴²⁷

3.1. Gjymtyrëzimi aktual.

Transmetimi i informacionit aktual bëhet nëpërmjet gjymtyrëzimit aktual të fjalisë. Ky gjymtyrëzim lidhet me fjalinë si thënie, me përmbajtjen konkrete të saj dhe mund të përkufizohet duke patur parasysh dy aspekte, thënien në tërësi dhe analizën e saj. Nga njëra anë gjymtyrëzimi aktual mund të përkufizohet si organizim i fjalisë për transmetimin e informacionit aktual të saj, nga ana tjetër, si analizë e fjalisë nga pikëpamja e qëllimit kumtues (informacionit aktual) që përmban ajo.

Një përkufizim të ngjashëm në lidhje me këtë gjejmë dhe tek Sintaksa, f. 115: Ky zberthim, gjymtyrëzim mbështetet në mjete të ndryshme: leksikore, leksiko-gramatikore dhe intonacionore, dhe ka të bëjë me ngarkesën kuptimore, komunikative të fjalisë.

Teoria e gjymtyrëzimit aktual u formulua nga gjuhëtari çek Matezius në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, dhe u thellua më tej nga gjuhëtarë të tjerë veçanërisht çekë. Prej tij u mor dhe termi gjymtyrëzim aktual. Ajo përmendet dhe gjen zbatim në gjuhësinë tonë në punimet e gjuhëtarëve Spiro Filloqi, Remzi Përnaska, Thoma Rrushi, Oda Buchholz dhe Wielfried Fiedler e Minella Totoni.

1.2. Nga pikëpamja e gjymtyrëzimit aktual të saj, çdo thënie ndahet në dy komponentë: tema dhe rema. Vlen të theksohet se këta dy komponentë emërtohen në mënyra të ndryshme në punime të ndryshme rreth kësaj teme, si e dhëna, e reja, baza dhe bërthama e thënies, kryefjalë logjike dhe kallëzues psikologjik, kryefjalë psikologjike dhe kallëzues psikologjik, etj. Në këtë punim zgjedhëm të përdorim termat temë dhe remë, duke qenëse janë më të përdorurit në literaturën gjuhësore, veçanërisht të gjuhës shqipe.

3.1.1. Tema dhe rema.

Sipas Rrushit, "Tema është ajo pjesë e thënies që është e njohur, e dhënë ose e nënkuptuar dhe i shërben folësit si piknisje për të dhënë informacionin aktual, që përbën qëllimin e thënies."⁴²⁸ Përbërja e temës sipas tij kushtëzohet nga konstituata në dy aspekte. Aspekti i parë parë është se në përbërje të temës nuk mund të hyjë asgjë që nuk nuk përmbahet në konstatuaten e dhënë. Ndërsa aspekti i dytë është se jo të gjithë elementet e dhëna nga konstituata hyjnë në përbërje të temës, por vetëm ato që lidhen me detyrën kumtesore të thënies, me përmbajtjen konkrete të remës.

Gjithashtu Rrushi thekson se tema mund të jetë e thjeshtë ose e përbërë nëvarësi nga numri i gjymtyrëve të fjalisë që bëjnë pjesë në të. Tema është e thjeshtë kur këtë

⁴²⁷Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 25

⁴²⁸Po aty, f. 26

funksion e kryen vetëm një gjymtyrë e fjalisë që lidhet drejtpërdrejt me foljen kallëzues ose vete kjo e fundit. Ndërsa kur në këtë funksion del folja kallëzues së bashku me një gjymtyrë tjetër që lidhet ngushtë me të, tema është e përbërë.:

Makina u nis.

Liqeni do të përmbytë edhe fshatra.

Tema mund të përbëhet edhe nga disa elemente, gjymtyrë të fjalisë që nuk lidhen drejtpërsëdrejti mes tyre. Nga këta rolin kryesor e luan ai që është më aktual, e mund të flitet kështu për një shkallëzim të temave, temë e parë, e dytë, e tretë etj. P.sh.

Zefi ato vargje të Naimit i dinte.

Ndërsa rema është ajo pjesë e thënies që shënon të renë, qëllimin e thënies, që në një mënyrë ose një tjetër kumton diçka për objektin e shënuar nga tema. Rema mbart gjithmonë theksin logjik.

Mund të thuhet se po ashtu si tema dhe rema mund të jetë e thjeshtë ose e përbërë. Është e thjeshtë kur përbëhet prej një gjymtyrë të fjalisë, prej foljes kallëzues, ose një gjymtyrë që lidhet drejtpërdrejt me të. P.sh.: Atë njeri e ka njohur edhe unë.

Rema është e përbërë, kur shprehet nga folja kallëzues dhe një gjymtyrë tjetër e fjalisë që lidhet drejtpërdrejt me të.:

Asaj këto fjalë digjinin shumë.⁴²⁹

3.1.2. Theksi logjik

Në nivelin e gjymtyrëzimit aktual të fjalisë, rendi i fjalëve luan rol kuptim dallues, shërben për të dalluar temën nga rema. Gjymtyra apo gjymtyrët e fjalisë që përbëjnë temën vendosen në fillim të saj; gjymtyra apo gjymtyrët që përbëjnë remën vendosen në fund. Kështu psh. Në thëniet stilistikisht neutrale, me theks logjik në fund të fjalisë, paravendosja e kryefjalës dhe pasvendosja e kallëzuesit tregojnë përkatësisht se kryefjala është temë e thënies dhe kallëzuesi është remë e thënies.⁴³⁰

Sipas Priftit theksi logjik është një theks i lëvizshëm, i cilivihet në rrokjen e theksuar të asaj fjale, që ne duam t'i theksojmë kuptimin.⁴³¹

Ne studentët do ta ndërtojmë liqenin artificial të kryeqytetit tonë të dashur. Ose

⁴²⁹Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 26-27

⁴³⁰Po aty, f. 28

⁴³¹Prifti, Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1972

Ne studentët *do ta ndërtojmë* liqenin artifivial të kryeqytetit tonë të dashur.

Por theksi logjik mund të bjerë edhe mbi një fjali të tërë në një periudhë.:

Shteti ju jep bursë që të mësoni, dhe jo që të mbeteni në klasë.

“Funksioni kumtues i rendit të fjalëve duhet parë i lidhur ngushtë me vendin e theksit logjik, si një mjet i veçantë theksimi që përdoret në fjali vetëm më funksione të caktuara kumtuese e shprehëse emocionale. Në thëniet me rend neutral theksi logjik me theksin frazor përputhen.”⁴³²

Këtë pohim e gjejmë dhe tek Prifti i cili shprehet se Theksi logjik mund të përputhet me theksin e fjalisë, por edhe mund të mos përputhet. Theksi logjik është një theks i diferencuar, kurse theksi i fjalisë është theksi që e përmbyll atë. Sipas tij në gjuhën shqipe ky i fundit ndodhet zakonisht në fund të fjalisë.:

Mësuesi na tregoi sot se si u kthye në Krujë *Skënderbeu*.

Më tej Prifti shprehet se theksi logjik influencon renditjen e gjymtyrëve në fjali duke bërë shpesh që fjala apo grupi i fjalëve të theksuara logjikisht të dalë në fillim të fjalisë.⁴³³

Ndërsa tek sintaksa përkufizimin për theksin logjik e gjejmë tek kreu i mjeteve intenacionore, të cilat përdoren për shprehjen e raporteve dhe shprehjeve sintaksore së bashku me mjete të tjera, dhe i referohen kryesisht gjuhës së folur. Me theks kuptohet përgjithësisht shqiptimi i një rrokjeje, i një fjale a i një fjalie me një ton më të fuqishëm, me një intensitet më të madh se rrokjet, fjalët ose fjalitë e tjera të të njëjtës tërësi për ta vënë atë në dukje, ndërsa me theksin logjik shqiptohet më fuqishëm e njëkohësisht me një ton më të lartë, gjymtyra që kërkohet të vihet në pah. Ai mund të veprojë vetëm, ose njëkohësisht me topikën. Në rastin e dytë fjala e theksuar vendoset në krye të fjalisë. Ai shihet si veçanërisht i ndjeshëm tek fjalitë pyetëse, sidomos në fjalitë pyetëse në të cilat mungon fjala pyetëse, duke tërhequr vëmendjen mbi elementin e thënies, për të cilin bëhet pyetja dhe në këtë mënyrë orienton për përgjigjen që pritet.⁴³⁴

Moj bijë, **ti** kërkove leje në mëngjes për të pritur trenin që vjen nga Tirana? -Po, unë.

Të gjithë **mirë** ishin? - pyeti ajo.

⁴³²Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 413

⁴³³Prifti, Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1972, f. 31

⁴³⁴Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 74

Artani **aty** është?

Verën po kërkoni?

Ndërsa përsa i përket fjalisë dëftore vërehet se në të shumtën e herës nuk ka një theksim të ndjeshëm logjik. Por mund të thuhet se edhe aty mund të theksohet një gjymtyrë, e çfarëdoshme, në rastet kur kërkohet të zbulohet qartazi një element i kumtimit, në kundërvënien a në dallim me elemente të tjera analoge të mundshme.:

Erdhi **Beni** (e jo një tjetër) mbrëmë.

Erdhi Beni mbrëmë.

Beni erdhi **mbrëmë**. (dhe jo herë tjetër)

Rushin e sheh rendin e fjalëve dhe theksin logjik si mjete që marrin pjesë së bashku në realizimin e thënies dhe shprehjen e gjymtyrëzimit aktual të saj. Rendi i fjalëve luan rol kryesor në shprehjen e këtij gjymtyrëzimi në ligjërimin aktual, kur theksi logjik përputhet me theksin frazor. Në ligjërimin joneutral, kur theksin logjik e bart një gjymtyrë në mes ose në fund të fjalisë, rolin kryesor e luan theksi logjik, i cili mbetet gjithnjë tregues i remës, ndërsa rendi i fjalëve kryen funksion shprehës emocional. Në funksionin të cilin po shqyrtojmë rendi i fjalëve dhe theksi logjik zëvendësojnë njëri tjetrin. Në qoftëse ndryshon njëri prej tyre dhe tjetri mbetet i pandryshuar, ndryshon edhe gjymtyrëzimi aktual i thënies; por gjymtyrëzimi aktual mbetet po ai, në qoftë se ndryshojnë në të njëjtën kohë rendi i fjalëve dhe vendi i theksit logjik.⁴³⁵:

Otello do tëshkojë në Vlorë., ku rema e thënies në Vlorë shënohet me rend fjalësh dhe me theks logjik.

Kur ndryshojmë rendin e fjalëve, por jo vendin e theksit. P.sh në rastin: Në Vlorë do tëshkojë Otello., ndryshon edhe gjymtyrëzimi aktual i fjalisë, remë e thënies është Otello.

Po kështu ndodh edhe kur ndryshojmë vendin e theksit logjik:, nga fundi në fillim të fjalisë:

Otello do tëshkojë në Vlorë.

Gjymtyrëzimi aktual mbetet po ai, kur i bëjmë të dyja ndryshimet njëkohësisht.:

⁴³⁵Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 29

Në Vlorë do të shkojë Otello.

Dalja në plan të parë, si shprehës i gjymtyrëzimit aktual, e njërit apo e tjetrit mjet lidhet dhe me faktorë të tjerë. Kështu në ligjërimin me shkrim luan rol kryesor rendi i fjalëve, pra ndeshet më shpesh rendi neutral. Në ligjërimin me gojë rritet roli i theksit logjik dhe ndeshen më shumë rastet me rend shprehës emocional. Po ashtu, roli i rendit të fjalëve dhe i theksit logjik kushtëzohet edhe nga stili i ligjërimin: në stilin e bisedës rritet roli i theksit logjik, ndersa në stilin shkencor rritet roli i rendit të fjalëve.

Ndryshimi i vendit të theksit logjik mund të sjellë ndryshime në vendosjen e komponentëve të gjymtyrëzimit aktual të fjalisë. Raste të tilla janë p.sh.:

Thënia mund të fillojë me remën. Në këtë rast tema e humb tiparin e saj si pikënisje e thënies.:

Vetëm hotele nuk më zuri syri.

Tema dhe rema e përbërë mund të ndahen:

Këtëvetëm ne e dimë. Ka edhe kjo historinë e vet

Vlen gjithashtu të theksohet se theksi logjik është veçanërisht i ndryshëm në fjalitë e ndryshme thirrmore, sidomos në fjalitë dëftore thirrmore lidhur më shumë me fjalën mbi të cilën bie pesha ngashërimore ose kumtuese.⁴³⁶:

Këtu është vrasësi, **këtu**!

Gjithçka ndryshon!

Po **çfarë** nuk bën njeriu kur është i pirë!

Unë ta ha?

Oh, **sa mirë** bëtë që erdhët, moj bijë!

Askush të mos qëllojë!

3.2. Mjete të tjera ndihmëse me karakter leksikor dhe gramatikor, trajtat e shkurtra.

Nga sa u tha më sipër mjetet kryesore të shprehjes së gjymtyrëzimit aktual të fjalisë janë rendi i fjalëve dhe theksi logjik. Por në gjuhën shqipe egzistojnë dhe mjete të tjera,

⁴³⁶Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 74

ndihmëse me karakter leksikor e gramatikor, të cilat përgjithësisht mund të vënë në dukje njërin apo tjetrin komponent të gjymtyrëzimit aktual dhe u vijnë kështu në ndihmë mjeteve të sipërpërmendura. Tek mjetet ndihmëse në gjuhën shqipe bëjnë pjesë: pjesëzat e ndryshme, trajtat e emrit, përemrat, trajtat e shkurtra të kallëzores. Duke qenë se këto të fundit lidhen me objektin e këtij punimi do trajtohen më hollësisht në vijim.

Trajtat e shkurtra

Në gjuhën shqipe, si një mjet i veçantë që ndihmon në përcaktimin e temës dhe të remës, është dhe përdorimi apo mospërdorimi i trajtave të shkurtra të kallëzores, shenjimi apo mosshenjimi i kundrinës së drejtë me këtë trajtë. Kjo, siç do të shohim më poshtë, nuk lidhet vetëm me njërin nga këta komponentë, por ndihmon njëkohësisht për përcaktimin e të dyve. “Këtu kemi parasysht fjalitë ku kundrina e drejtë shprehet me emër, togfjalësh emëror ose përemër të vetës së tretë. Kundrina e papërsëritur me trajtë të shkurtër mban theksin logjik dhe është remë e thënies ose pjesë e saj, kundrina e përsëritur me trajtë të shkurtër nuk theksohet dhe është temë e thënies ose pjesë e saj.”⁴³⁷ Pra si përfundim mund të thuhet se prania apo mosprania e trajtës së shkurtër shënon përkatësisht tematizimin ose rematizimin e kundrinës së drejtë.

Kjo çështje është trajtuar nga disa gjuhëtarë të gjuhës shqipe. I pari që ka vënë re lidhjen mes pranisë dhe mospranisë së trajtës së shkurtër dhe përkatësisht shenjimit apo mosshenjimit të kundrinës së drejtë është gjuhëtari Ilia Dilo Sheperi i cili shprehet si më poshtë: “Kundrina e drejtë e lyp kurdoherë dhanoren e shkurtër të përemrit vetor si pleonazmë të saj, kurse e drejta zakonisht e merr vetëm kur është në formë të shquar. P.sh.: i shkrova mikut; shkrova një letër; e shkrova letrën. (Po dhe shkrova letër ose letrën, kur theksohet kundrina.)”⁴³⁸

Gjithashtu kjo çështje është trajtuar dhe nga Shaban Demiraj, i cili shprehet se: “Kundrina e drejtë e shprehur me anë të një emri, një togfjalëshi, a një fjalie të nënrenditur, përsëritet nga një formë e patheksuar përemërore e vetës së tretë vetëm atëherë kur theksi logjik i fjalisë, përkatësisht i fraza, nuk bie mbi të dhe nuk përsëritet kur ajo bart theksin logjik të fjalisë” Këtë dukuri Demiraj e lidh me gjymtyrëzimin aktual të fjalisë duke shkruar se “Ky theksim i spikatur i kundrinës së drejtë. është i kuptueshëm, po të kihet parasysht se ajo në këtë rast përfaqëson objektin e kumtimit (për remën) që folësi kërkon t’i njoftojë bashkëbiseduesit.”⁴³⁹

Remzi Përnaska⁴⁴⁰ dhe Menella Totoni⁴⁴¹ gjithashtu e përmendin në punimet e tyre dhe lidhjen mes përsëritjes apo mospërsëritjes së kundrinës së drejtë me theksimin.

⁴³⁷ Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983

⁴³⁸ Sheperi.I.D. *Gramatika e gjuhës shqipe sidomos e toskërishtes*, Vlorë 1927, f.154

⁴³⁹ Demiraj, Shaban: *Sistemi i Lakimit në gjuhën shqipe*, Tiranë 1975, f.129

⁴⁴⁰ Përnaska, Remzi: *Gramatika e gjuhës shqipe, 2. Për shkollën e mesme pedagogjike*, 1975, f.105

⁴⁴¹ Totoni, Menella, Bubani, L., Dako, N , Bobrati, S: *Libri i gjuhës shqipe për klasën VII*, Tiranë 1971, f.48

1.4.1.Th.Rr. f 34: Siç pohon dhe Thoma Rrushi, përgjithësisht përsëritja apo mospërsëritja e kundrinës së drejtë me trajtë të shkurtër, tregon se ajo është temë, përkatësisht remë e thënies. Por ka edhe raste kur ky funksion kumtues i trajtës së shkurtër të rasës kallëzore në gjuhën shqipe neutralizohet. Kjo ndodh kur njëri nga komponentët e gjymtyrëzimit aktual, sidomos rema përcaktohet me ndihmën e mjeteve të tjera me karakter leksikor, leksiko- gramatikor e gramatikor. Sipas tij përdorimi apo mos përdorimi i trajtës së shkurtër e humb këtë funksion kumtues në rastet e mëposhtme:

-Kur kemi të bëjmë me togfjalësha foljorë frazeologjikë, gjymtyra e dytë e të cilëve vetëm formalisht paraqitet si një kundrinë e drejtë.:

Ia njoh kokën unë atij.

-Kur krahas dublimit me trajtë të shkurtër, kundrina e drejtë shoqërohet edhe me pjeseza përforcuese, të cilat janë treguese të remës. P.sh.:

I di unë edhe zakonet, edhe ligjet.

-Kur në rolin e kundrinës së drejtë dalin përemrat *të gjithë, të tërë* dhe numërorët më kuptim përmbledhës. Kjo kundrinë del gjithmonë e përsëritur dhe gjithnjë mban theksin logjik, dmth. Është remë e thënies, në qoftë se fjalia nuk ka gjymtyrë të tjera të dyta.:

Nuk i di të gjitha ti...

Sipas Rrushit, rol analog me përdorimin apo mos përdorimin e trajtave të shkurtra, luan edhe përdorimi apo mospërdorimi i kundrinës së drejtë e të zhdrejtë, të shprehur me trajta të plota të përemrave vetorë të vetës së parë dhe të dytë. Lidhja e përdorimit apo mospërdorimit të këtyre formave me theksimin, përkatësisht mostheksimin e kundrinave është vënë re nga Shaban Demiraj në Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe dhe zhvilluar më tej nga Thoma Rrushi i cili shprehet se “ Prania e domosdoshme e trajtës së plotë të përemrit është tregues i rolit të saj si remë e mëvetësishme e thënies, ndërsa mosprania e saj tregon se remë e thënies është kallëzuesi ose ndonjë gjymtyrë tjetër e fjalisë”⁴⁴²:

Ajo mua më ka ngjarë.

Sipas tij në qoftëse në fjalinë e mësipërme nuk do të ishte e pranishme trajta e plotë e përemrit mua, remë e thënies mund të ishte një nga gjymtyrët e tjera, kryefjala ose kallëzuesi.

⁴⁴² Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 35

Një rol të tillë luajnë për gjuhën shqipe dhe format e rasës emërore të përemrave vetorë të vetës së parë dhe të dytë. Kështu përemrat unë, ti, ne, ju, janë të domosdoshëm si kryefjalë të fjalisë, kur kryejnë funksionin e remës së mëvetësishme të thënies.:

Përgjigjen do ta jap unë vetë.

4. Funksioni stilistikor i rendit të fjalëve

Funksion dytësor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe është funksioni stilistikor, shprehës emocional, që realizohet nëpërmjet rendit remë + temë, për të shprehur theksimin emfatik të remës. Në këtë rast kemi të bëjmë me vendosje të anasjelltë të komponentëve të gjymtyrëzimit aktual, ku rendi i fjalëve nuk shërben më për dallimin e tyre, por kryen funksion shprehës emocional.⁴⁴³ Mund të thuhet se për këtë funksion të rendit të fjalëve në gjuhën shqipe është shkruar pak. Sipas Menella Totonit, i cili e ka trajtuar gjerësisht këtë funksion të rendit të fjalëve vihet në dukje se rendi i gjymtyrëve është mjet i rëndësishëm stilistik. Në këtë vepër analizohen dhe variantet e ndryshme shprehëse emocionale të rendit të fjalëve për strukturat që merren në shqyrtim.⁴⁴⁴

Trajtimi më i gjerë i këtij funksioni bëhet në tekstin e Thoma Rrushit. Sipas tij funksioni stilistikor, shprehës emocional vihet re në ligjërimin joneutral, me theks logjik në mes ose në fillim të fjalisë. Në këtë rast rendi i fjalëve nuk ka funksion kuptimdallues në rrafshin e gjymtyrëzimit aktual të fjalisë për të dalluar temën dhe remën dukeqenëse ato ndryshojnë vendet. Prej këtyre të fundit vetëm rema mbart theksin llogjik. “Në këto raste kemi të bëjmë me variante stilistikore, shprehëse emocionale të rendit të fjalëve, të cilat dallohen nga variantet stilistikisht neutrale, që u përgjigjen, jo nga përmbajtja (tema dhe rema janë po ato), por nga struktura intonacionore e thënies.”⁴⁴⁵ Kështu, për fjalinë : Pika shiu binin edhe mbi kopertinën e librit tim., variant stilistikisht neutral është: Pika shiu binin edhe mbi kopertinën e librit tim., ndërsa variant stilistikor, shprehës emocional është: Edhe mbi kopertinën e librit tim binin pika shiu. Siç shihet në variantin stilistikor tema dhe rema kanë të njëjtën përmbajtje, por ndërrojnë vendet. Krahas intonacionit, karakteri shprehës emocional i rendit të fjalëve përforcohet dhe me mjete të tjera ndihmëse si: pjesëza, përemra, trajtat e shkurtra, etj.

5. Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve

Jo pa rëndësi për rendin e fjalëve në gjuhën shqipe është dhe faktori gramatikor, me të cilin lidhet funksioni gramatikor i rendit të fjalëve. Është fjala këtu për rastet kur rendi i fjalëve ndihmon për të përcaktuar funksionin sintaksor të gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Në këtë rast mund të flitet dhe për rend të ngulitur të fjalëve. Në punimet për rendin e fjalëve në përgjithësi, dhe në kapitujt përkatës të teksteve të sintaksës ky funksion i rendit të fjalëve në fjali ose nuk përmendet fare, ose jepet aty këtu ndonjë

⁴⁴³ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f.413- 414

⁴⁴⁴ Ttoni, Menella: *Libri i gjuhës shqipe 2*, për shkollat e mesme, Tiranë 1978, f.66-80

⁴⁴⁵ Rrushit, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe*, fq. 38

pohim i veçantë për gjymtyrë të caktuara. Të trajtuar më gjerësisht e gjejmë në veprën e cituar më sipër të Thoma Rrushit, ku këtij funksioni i kushtohet një kapitull i veçantë.

Kështu sipas Rrushit⁴⁴⁶, rastet kur rendi i fjalëve në fjali në gjuhën shqipe mund të ndihmojë për të dalluar funksionet e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë i ndajmë në dy grupe:

Rendi i fjalëve mund të shërbejë për të përcaktuar funksionet e dy gjymtyrëve që shprehen me forma të njëjta gramatikore, të cilat në parim mund të kryejnë dy funksione. Kështu me ndihmën e rendit të fjalëve mund të dallohet kryefjala nga kundrina e drejtë.

Ky rol i rendit të fjalëve vihet re dhe në gjuhë të tjera duke u konsideruar si më tipiku në këtë aspekt. Duke u konsideruar i tillë ai është vënë re e përmendur në punime të ndryshme dhe nga gjuhëtarët shqiptarë. Kështu p.sh. sipas prof. Mair Domi, i cili ndër të tjera shkruan “ Mund të luajë ndonjë rol rendi i një gjymtyre, atëherë kur kryefjala në emërore del në një formë identike me kundrinën e drejtë në kallëzore njëjës tëpashquar dhe shumë të shquar... Në të tilla raste kryefjala e paravendosur nuk mund të ndryshojë vend pa shkaktuar keqkuptime. Pozicioni orienton atëherë për funksionin.⁴⁴⁷ Gjithashtu dhe gjuhëtarë të tjerë si Spiro Floqi i cili ka punuar kapitullin e rendit të fjalëve në librin Gramatika 2, Sintaksa, botim i akademisë së shkencave.etj. e kanë përmendur në punimet e tyre këtë rol të rendit të fjalëve duke dhënë pohime të përgjithshme lidhur me këtë, por pa hyrë në hollësi.

Trajtim më të hollësishëm ky rol gjen vetëm në monografinë e përmendur më sipër të Thoma Rrushit.⁴⁴⁸ Sipas tij, rastet e homonimisë formale të shprehjes së kryefjalës dhe të kundrinës së drejtë janë të shumta. Mjafton të kujtojmë se nga katër forma që ka secila prej rasave emërore dhe kallëzore, tri janë të përbashkëta. Ato dallohen qartë vetëm në njëjës in e shquar. në qoftëse në të gjitha këto raste, për të përcaktuar funksionet e formave homonime, do të na vinte në ndihmë vetëm topika e tyre, atëherë funksioni sintaksor i rendit të fjalëve nuk do të ishte aq pa rëndësi. Në shumicën dërrmuese të rasteve, funksioni i dy formave të njëjta, përkatësisht si kryefjalë dhe si kundrinë e drejtë, përcaktohet me ndihmën e treguesve të tjerë me karakter gramatikor e kontekstual. Rrushi rendit tre tregues si vijon:

Së pari, për të përcaktuar funksionet ndihmon kuptimi konkret leksikor i emrave me forma të njëjta, me të cilët shprehen gjymtyrët. Pavarësisht nga topika, njëri prej tyre mund të shënojë vetëm vepruesin, pra është kryefjalë e fjalisë; tjetri mund të shënojë

⁴⁴⁶ Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 10

⁴⁴⁷ Domi, Mahir: *Çështje të përgjithshme të sintaksës*, SF 1980, 3, f 12.

⁴⁴⁸ Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 11-14

vetëm objektin e veprimit, pra është kundrinë e drejtë.: *Kooperativistët po shfrytëzojnë burimet e tjera. Themelet e shtëpisë mund ti shkulin vetëm tërmetet dhe luftërat.*

Në shembujt e mësipërm, emrat e nënvizuar, në sajë të kuptimit të tyre, pavarësisht nga vendi që zënë në fjali kanë gjithmonë një funksion sintaksor. Kështu emrat ‘kooperativistët’ dhe ‘tërmetet’ janë kryefjalë të fjalive përkatëse, ndërsa emrat ‘burimet’ dhe ‘themelet’ janë kundrina të drejta.

I lidhur ngushtë me kuptimin e emrave duhet parë dhe kuptimi i foljes kallëzues. Kështu në fjalinë: *Skudërkomandantët numëruan ushtarët.*, gjymtyrët e nënvizuara, pavarësisht nga rendi i tyre mund të interpretohen funksionalisht vetëm në mënyrë të njëanshme, përkatësisht kryefjalë dhe kundrinë e drejtë. Por nuk mund të thuhet po kjo gjë nëqoftë se zëvendësojmë foljen numëruan me fojen takuan. Atëherë, të dy emrat e nënvizuar më sipër mund ti kryejnë të dy funksionet, , edhe të kryefjalës, edhe të kundrinës së drejtë. Le ti shohim të dy variantet: *Skudërkomandantët takuan ushtarët.*; *Ushtarët takuan skudërkomandantët.* Në të dy rastet, për të përcaktuar funksionet e formave të nënvizuara na vjen në ndihmë rendi i tyre. Emri që vendoset para foljes, është në funksionin e kryefjalës, emri që vendoset pas foljes është në funksionin e kundrinës së drejtë.

Së dyti, funksioni i dy formave sinkretike del qartë dhe nga prania e disa treguesve gramatikorë, siç janë:

-Mbaresat e foljeve kallëzues, që pasqyrojnë përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën, kur njëra nga format është në njëjës të pashquar dhe tjetra në shumës. Në këtë rast kryefjalë është ai emër me të cilin përshtatet kallëzuesi, ndërsa emri tjetër është kundrinë e drejtë. Kështu p.sh. në fjalinë: *Vetëm një dëshirë titanike për jetën mund të lindë përfytyrime të tilla.*, emri në njëjës me të cilin përshtatet kallëzuesi është kryefjalë, emri në shumës është kundrinë e drejtë. Po në këtë fjali, nëqoftëse e vendosim foljen në numrin shumës: *Vetëm një dëshirë titanike për jetën mund të lindin përfytyrime të tilla.*, gjymtyrët e nënvizuara ndërrojnë funksionet pavarësisht nga rendi i tyre.

-Përsëritja e domosdoshme me trajtë të shkurtër, kur emri i vendosur para kallëzuesit është kundrinë e drejtë. P.sh. në fjalinë: *Regjimentet tuaja po i çarmatosin forcat naziste.*

Së treti, për të përcaktuar funksionet e formave homonime mund të ndihmojë dhe konteksti, konkretisht fjalia paraardhëse ose ajo pasardhëse. Kështu në periudhat: *Xhandarët që ishin aty, shikonin autoritetet, prisnin urdhër.* dhe: *Disa fëmijë filluan të ndiqnin ushtarët, kur bënë qitje.*, funksionet e emrave të nënvizuar, përkatësisht *xhandarët* dhe *disa fëmije* si kryefjalë dhe *autoritetet* e *ushtarët* si kundrina të drejta, përcaktohen kryesisht me ndihmën e kontekstit, të strukturave që pasojnë fjalitë ku bëjnë pjesë këto gjymtyrë, përkatësisht *prisnin urdhër* dhe *kur bënë qitje*.

Kur tregues si këta që u përshkruan më sipër, mungojnë, mjeti i vetëm që na vjen në ndihmë është rendi i ngulitur i gjymtyrëve, gjymtyra që vendoset para kallëzuesit është kryefjalë, gjymtyra që vendoset pas kallëzuesit është kundrinë e drejtë. P.sh.: *Partizanët i vështronin ata me kureshtje. Nganjëherë kokrrizat e imta të plehut kimik i ngatërronin pleqtë.; Të qeshurat mbytën hungërimat e qenve.; Shpeshherë fëmijët i njohin prindërit kur është vonë.; Ç'është kjo kështu! Mendimet ngatërrojnë ndjenjat, apo ndjenjat mendimet?*

Në shembujt e mësipërm, fjalët e nënvizuara në forma homonime, në parim mund ti kryejnë barabar të dyja funksionet, të kryefjalës dhe të kundrinës së drejtë. Ndërkaq, në fjalitë e dhëna, ato përdoren vetëm në njërin nga këto funksione. Ligjëruesit i duhet t'ia bëjë të qartë dëgjuesit e sidomos lexuesit, cila gjymtyrë shënon vepruesin dhe cila objektin e veprimit, sepse përndryshe kumtimi nuk do të ishte i qartë. Do të ishte pa kuptim që ai t'ia linte këtë për ta zgjidhur bashkëbiseduesit apo lexuesit. I vetmi mjet që mund të ndihmojë është vendosja e gjymtyrëve me rend të drejtë të ngulitur. Atë gjymtyrë që ai e mendon si kryefjalë e vendos përpara foljes, atë që e mendon si kundrinë të drejtë e vendos pas.

Gjithashtu sipas Rrushit⁴⁴⁹, rendi i fjalëve në fjali mund të ndihmojë dhe për të dalluar funksionin aktual të një gjymtyre që ka mundësi të kryejë dy funksione. Gjymtyra në fjalë, në një fjali të dhënë, ka mundësi të varet nga dy gjymtyrë me natyrë të ndryshme leksiko- gramatikore, kryesisht nga një gjymtyrë emërore dhe një foljore. Nga vendi i saj ndaj këtyre gjymtyrëve përcaktohet dhe lidhja aktuale vetëm me njërin nga dy gjymtyrët, gjë që kushtëzon dhe funksionin e saj sintaksor.

Sipas vendit që zë në fjali, ai dallon përcaktorin pa përshtatje nga kundrina me parafjalë.

Ky funksion i rendit të fjalëve vihet re në ato raste, kur një gjymtyrë e shprehur me emër me parafjalë, që shënon objekt, ka mundësi të lidhet në fjalinë e dhënë me dy gjymtyrë të ndryshme, një emërore dhe një foljore. Për të përcaktuar funksionin e saj na ndihmon topika. E vendosur drejtpërdrejt pas gjymtyrës emërore ajo merret, kryesisht si përcaktor pa përshtatje; në gjithë pozicionet e tjera të mundshme, në plan të parë del lidhja me foljen dhe gjymtyra në fjalë do të merret si kundrinë. P.sh.:

Tana thurte për Mirin çorape me lule. Tana thurte çorape me lule për Mirin. Për çdo të ardhur në fshat lajmin e jepte patjetër Senka. Lajmin e parë për çdo të ardhur në fshat e jepte patjetër Senka.

Duhet thënë se në ligjërimin me gojë, rol të rëndësishëm luan në këtë rast intonacioni. Që gjymtyra e dhënë të jetë në funksionin e përcaktorit pa përshtatje, duhet që ajo së bashku me fjalën e përcaktuar, të ligjërohen si një sintagmë e vetme pa pauzë midis

⁴⁴⁹ Rrushit, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 19-24

tyre. Përndryshe edhe në pozicion të drejtpërdrejtë pas emrit ajo do të merret si kundrinë me parafjalë.

Rendi i fjalëve shprehet më tej Rrushi ndihmon për të dalluar kundrinën me parafjalë që varet nga folja prej kundrinës me parafjalë që varet nga mbiemri.

Ky rol i rendit të fjalëve vihet re rrallë, vetëm në rast se një emër me parafjalë kryen funksionin e kundrinës, në një fjali të dhënë, ka mundësi të lidhet edhe me foljen, edhe me një gjymtyrë mbiemërore. Në pozicion të drejtpërdrejtë pas mbiemrit, ajo merret si kundrinë që varet ky i fundit. Në çdo pozicion tjetër do të merret si kundrinë që varet nga folja, ose që plotëson fjalinë në tërësi.:

Shumë prej tyre për Kristinën ishin emra njerëzish të panjohur.

Shumë prej tyre ishin emra njerëzish të panjohur për Kristinën.

Nga sa u tha më lart mund të arrihet në përfundimin se funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe nuk duhet nënvleftësuar. Rol të rëndësishëm luan ky funksion vecanërisht në ligjerimin me shkrim, ku mungojnë treguesit e elementeve intonacionarë, të cilët do të mund të ndihmonin për të përcaktuar funksionet e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë.

Në përfundim mund të thuhet se ndryshimi i vendit të gjymtyrëve kushtëzohet dhe nga lidhjet që vendosin ato në fjali. Jo të gjitha variantet teorikisht të mundshme të rendit të fjalëve janë normale për një fjali të dhënë. Kjo vihet re sidomos në rastet kur në fjali ka gjymtyrë të shkallës së dytë të cilat edhe kur kanë rend të lirë nuk mund të largohen nga gjymtyra që plotësojnë, por vendosen vetëm pranë saj. Keshtu p.sh. në fjalinë: Njeriu qenka më i fortë se guri, ku gjymtyrët e fjalisë mund të vendosen në 6 variante të mundshme, por për arsytet që përmendëm, nuk janë normale variantet në vijim: Njeriu qenka se guri më i fortë; Se guri qenka njeriu më i fortë; Guri se njeriu qenka më i fortë; Qenka se njeriu guri më i fortë, etj. Këto vendosje do të sillnin keqinterpretim funksional të gjymtyrëve të caktuara.

Pra nga sa u tha më lart, mund të thuhet se rendi i fjalëve në fjali në gjuhën shqipe nuk mund të jetë plotësisht i lirë.

6. Rendi i kundrinave në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe

Në vijim do të bëjmë një analizë të modeleve të fjalisë së thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe sipas varianteve të rendit të kundrinave dhe tipave kumtues aktual që realizohen me to.

Duhet theksuar se në mënyrë që të përcaktohen saktësisht përbërësit e gjymtyrëzimit aktual, krahas rendit të fjalëve dhe vendit të theksit logjik, duhet marrë parasysh dhe

konteksti. Për këtë arsye nëse do jetë e nevojshme, shembujt mund të shoqërohen dhe me një kontekst minimum të domosdoshëm të vendosur në kllapa.

Ndërsa për përcaktimin e temës dhe të remës përdoret metoda e pyetjeve, sipas së cilës gjymtyrët e fjalisë që përfshihen në pyetjen që i bëhet thënies, janë temë e saj, ndërsa gjymtyrët që dalin si përgjigje e pyetjes, janë temë e thënies. Do përdoret pyetja e plotë dhe pyetja e pjesshme. Në thëniet, të cilat i përgjigjen pyetjes së plotë, informacioni aktual përbën pjesën më të madhe të përmbajtjes së tyre, ato kanë remë të përbërë. Në thëniet, që i përgjigjen pyetjes së pjesshme, informacioni aktual përbën vetëm një pjesë të përmbajtjes së tyre, ato kanë remë të thjeshtë.

Për ndërtimin e skemave do të përdoren këto simbole të gjymtyrëve të fjalisë: S- kryefjala, P- kallëzuesi, O1- kundrina e drejtë, O2 – Kundrina e zhdrejtë, Op – kundrina e zhdrejtë me parafjalë. Kemi zgjedhur shkurtime të njëjta me të gjuhës angleze dhe gjermane për lehtësi studimi, pasi fjalët kryefjalë, kallëzues dhe kundrinë në gjuhën shqipe, fillojnë të treja me shkronjën k, çka do i bënte ato të padallueshme nga njëra tjetra. Tema dhe rema do të shënohen përkatësisht me t dhe r.

Struktura e kundrinës me parafjalë është lënë jashtë analizës së detajuar, duke qenë se ajo vihen re përgjithësisht të njëjtë variante të rendit të gjymtyrëve dhe tipa kumtues aktual si dhe te struktura me kundrinë të zhdrejtë.

6.1.Rendi i kundrinës së drejtë në fjalinë e thjeshtë dëftore

I.Në gjuhën shqipe rendi kryefjalë + kallëzues + kundrinë e drejtë është në disa raste i detyrueshëm për arsye thjesht formalo- gramatikore, për të treguar funksionin e kundrinës, kur emri që e shpreh nga trajta nuk dallohet nëse është në emërore a në kallëzore (pa parafjalë). Në këtë rast është rendi i fjalëve që na tregojnë funksionin sintaksor: Kryefjala prin, pastaj vjen kallëzuesi dhe pas këtij kundrina e drejtë. Nga pikëpamja kumtuese, ky rend është në përgjithësi rend i drejtë, stilistikisht neutral. Kundrina e drejtë në gjuhën shqipe zakonisht mban theksin logjik dhe është remë e mëvetësishme ose pjesë e remës së përbërë. Në këtë rast kundrina është shprehur me një emër me nyje joshquese, pa nyje, me një togfjalësh ose me një emër të shquar dhe nuk shenjohej me trajtë të shkurtër. Por si do shohim në rastet e mëposhtme ka dhe raste kur kundrina është remë ose pjesë e saj. Për këtë model sintaksor jam bazuar tek Rrushi⁴⁵⁰ dhe Buholc/ Fidler⁴⁵¹, të cilët dallojnë pesë lloje tipash kumtues aktual.:

1)Kryefjala është remë e thënies, ndërsa kallëzuesi me kundrinën përbëjnë remën. Në këtë rast kemi të bëjmë me rend të drejtë neutral me theks logjik jo shumë të spikatur mbi kundrinën. Kundrina e drejtë në këtë rast nuk shenjohej nga trajta e shkurër e përemrit vetor.

⁴⁵⁰ Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 53-74

⁴⁵¹ Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 541-544

Zana mbylli **rubinetin** e gazit.

Ca kalimtarë po shikonin **reklamat** e kinemave.

2) kryefjala me kallëzuesin janë temë e thënies, ndërsa kundrina e drejtë është remë. Theksi logjik në këtë rast bie mbi kundrinën, e cila përgjithësisht shoqërohet me pjesëza përforcuese dalluese. Dhe në këtë rast kundrina e drejtë nuk shenjohej me trajtë të shkurtër.:

Ai kishte **edhe kullota, edhe bagëti, edhe baxho**.

(Jo, jo, mos e ngatërro bagëtinë kryetar se je çoban.) Çobani s'ngatërron as **bagëtinë**.

3) në këtë rast kallëzuesi është remë e thënies, ndërsa kryefjala dhe kundrina e drejtë, të njohura nga konteksti përbëjnë temën. Kundrina e drejtë në këtë rast shenjohej me trajtë të shkurtër.

Mbledhja e Lajthizës do ta hutojë **Sali Protopapën**.

Ai e kishte harruar **Vitën**.

4) kallëzuesi është temë e thënies në këtë rast, ndërsa kryefjala dhe kallëzuesi, të cilat lidhen ngushtësisht nga ana kuptimore mes tyre, formojnë remën e përbërë. Theksi logjik bie mbi kallëzuesin. Kundrina e drejtë është dhënë nga konteksti dhe shenjohej me trajtë të shkurtër. Kemi të bëjmë me rend shprehës emocional.

(Po këtë dimër atje s'kishte çobanë). Lufta i kishte trembur **çobanët**.

5) Kryefjala mbi të cilën bie dhe theksi logjik është remë e thënies. Kallëzuesi me kundrinën e drejtë, të dhënë nga konstituata shume e përcaktuar, formojnë remën e përbërë. Kundrina e drejtë përgjithësisht shenjohej me trajtë të shkurtër. Dhe në këtë rast kemi rend shprehës emocional.:

Të gjithë e thoshin **këtë**.

Një hije armiqësore ia vrenjti **vetullat**.

II. Rendi Kryefjalë + kundrinë e drejtë + kallëzues. Ky rend, i cili në fakt është variant stilistikor i rendit Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e drejtë, gjen më pak përdorim dhe është karakteristik për stilin tregimtar. Ai gjendet veçanërisht në prozën popullore. Shprehet përgjithësisht me emra të përveçëm, përemra vetorë dhe togfjalësha emërorë. Pesë tipat kumtues aktualë që realizohen me të, siç do shihen më poshtë janë mjaft të larmishëm.:

1)Rend neutral ku theksi logjik bie mbi kallëzuesin. Kryefjala dhe kundrina e drejtë, të cilat njihen nga konteksti formojnë temën, ndërsa kallëzuesi remën e thënies. Prania e trajtës së shkurtër është një tregues i theksimit të kallëzuesit dhe i shquarsisë dhe njëkohësisht i mostheksimit të kundrinës së drejtë. Rrushi gjithashtu thekson se këto fjali ndahen në tre akte ligjërimi me anë të dy pauzave, ku pauza e dytë ndan temën nga rema:

Zefi **ato vargje** të Naimit i dinte.

Kjo gjë **babanë** e kishte mërzitur.

2) rend neutral, ku nga konteksti është dhënë vetëm kryefjala, e cila është temë e thënies. Ndërsa kallëzuesi dhe kundrina e drejtë janë remë e thënies. Theksi logjik mund të bjerë mbi kundrinën ose kallëzuesin, sidomos kur ky i fundit shoqërohet me pjesëza mohuese. Kundrina e drejtë nuk shenjohej me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.

Ne **këtë udhë** do të ndjekim.

Unë **çudira** nuk pres.

3)rend shprehës emocional me theks logjik mbi kundrinën e drejtë e cila është remë e thënies dhe nuk shenjohej me trajtë të shkurtër. Nga konteksti janë dhënë kryefjala dhe kallëzuesi, të cilët formojnë temën e përbërë. Kundrina e drejtë shprehët kryesisht me emër në trajtën e pashquar. Në rastin kur ajo shprehet me emër të shquar shoqërohet me pjesëza dalluese.:

(Ju e keni në dorë e jo bajraktari.) Bajraktari **një pushkë** ka.

(Osmani tokë s'ka, veç një skërkë majë malit....) Osmani **morra** ka.

Unë **veç namin** i kam dëgjuar.

4)Rend joneutral me ngarkesëtë theksuar shprehëse emocionale. Kryefjala është remë e thënies dhe mbart theksin logjik, ndërsa kundrina dhe kallëzuesi, të cilët janë të njohur nga konteksti formojnë së bashku temën e përbërë. Vlen të theksohet se kryefjala shoqërohet me pjesëza përforcuese. Kundrina e drejtë, megjithëse është pjesë e temës së përbërë, nuk përsëritet më trajtë të shkurtër. Kjo ndodh për shkak se kallëzuesi ndodhet në fund të fjalisë si dhe për shkak të pjesëzave përforcuese. Nëse kundrina do ishte e shenjuar me trajtë të shkurtër në këtë rast, atëherë theksi logjik do binte mbi kallëzuesi, çka nuk do ishte normale. Gjatë ligjërimin, një paizë e ndjeshme ndan temën nga rema.:

Edhe Vali **këtë punë** po bënte.

Edhe Araniti **diçka** kish dëgjuar.

Ja dhe hëna **atë vezullim** po jepte.

5)Rend neutral me theks logjik mbi kallëzuesin. Kundrina e drejtë është remë e thënies, ndërsa kryefjala dhe kallëzuesi formojnë remën. Ky është një rend që haset shumë rrallë në gjuhën shqipe. Ligjërimi bëhet me dy pauza të ndjeshme, të cilat e veçojnë temën. Në këtë rast kundrina e drejtë shenjohehet nga trajta e shkurtër e përemrit vetor.:

Vajzat **atë** e pëlqenin.

Fëmijët **atë** e donin.

III.Rendi Kundrinë e drejtë + kryefjalë + kallëzues. Sipas Rrushit ky është një rend qëndështet rrallë në gjuhën shqipe, me shumë gjasa për shkak të vendosjes larg njëritjetrit të kallëzuesit dhe kundrinës së drejtë.

1)rend neutral, ku theksi logjik bie mbi kallëzuesin. Kallëzuesi është remë e thënies, ndërsa kryefjala dhe kundrina e drejtë, të cilat janë të njohura nga konteksti dhe kanë shkallë të lartë shquarsie formojnë temën. Kundrina e drejtë shenjohehet me trajtë të shkurtër. Rrushi nënvizon se ky është tipi më i përdorur në këtë rend të gjymtyrëve. Ligjërimi bëhet me dy pauza, njëra midis dy temave dhe tjetra midis temës së dytë dhe remës.:

Këtë përvojë pozitive ata e dinë.

Këtë urdhër ai duhej ta zbatonte.

2)Rend neutral me theks logjik mbi kryefjalën. Nga konteksti është dhënë vetëm kundrina e drejtë, e cila është temë e thënies dhe shenjohehet me trajtë të shkurtër.Kryefjala dhe kallëzuesi, të cilët së bashku formojnë remën e përbërë, kushtëzojnë në aspektin semantik njëri tjetrin dhe ligjërohen si një sintagmë e vetme. Gjatë ligjërimin realizohet vetëm një pauzë që ndan temën nga rema.:

Ata edhe deti s'i lan.

Të gjitha aktivitetet unë i bëj.

Këto të fundit pleqtë e moçëm i mbajnë mend.

3)Rend shprehës emocional, ku theksi i fjalisë bie në mes të fjalisë mbi kryefjalën, e cila është remë e thënies dhe shoqërohet me pjesëza dalluese përforcuese dhe mohuese. Kundrina e drejtë, e cila shenjohehet me trajtë të shkurtër formojnë së bashku me kallëzuesin temën e përbërë. Si kundrina, ashtu dhe kallëzuesi janë të lidhura kuptimisht me njëra tjetrën dhe të njohura nga konteksti.

Këtë as vetë Vaska nuk e kuptoi dot.

Këtë vetëm ne e dimë.

Hallvën edhe pleqtë e hanë.

4)Rend shprehës emocional, me theks logjik mbi kundrinën e drejtë, e cila është remë e thënies dhe shenjohe me trajtë të shkurtër, por siç thekson Rrushi, konteksti i dhënë dhe dhe prania e pjesëzave dalluese e përforcuese pranë kundrinës e neutralizojnë funksionin e trajtës së shkurtër si mjet i shprehjes sëkomponentëve të gjymtyrëzimit aktual. Kryefjala dhe kallëzuesi janë të njohura nga konteksti dhe përbëjnë temën e përbërë. Gjatë ligjëritimit realizohet vetëm një pauzë që ndan remën nga tema.:

Vetëm një gjë s'arrinte ta shpjegonte dot.

(Spathinj të i bëra unë). **Edhe letrat** unë i bëra.

5)rend neutral me theks logjik mbi kallëzuesin, i cili lidhet ngushtë kuptimisht me kundrinën e drejtë dhe së bashku formojnë remën. Kundrina e drejtë në këtë rast nuk shenjohe me trajtë të shkurtër. Kryefjala është temë e thënies. Gjatë ligjëritimit të fjalisë kemi dy pauza që shërbejnë për të veçuar temën.

Kandil i zoti i shtëpisë nuk na kishte ndezur.

Djalë nëna nuk kishte parë.

IV. Rendi kundrinë e drejtë + kallëzues + kryefjalë është rend i anasjelltë për të dyja gjymtyrët emërore, kryefjalën dhe kundrinën e drejtë. Sipas Rrushit ky është rend që gjen përdorim të gjerë në gjuhën shqipe dhe renditet pas rendit Kryefjalë + kallëzues + kundrinë e drejtë për nga shpeshësia. Ashtu si me të mëparshmit dhe më këtë rend realizohen pesë tipa kumtues aktual.

1)rend neutral, ku kundrina e drejtë, e cila është dhënë nga konteksti është temë e thënies dhe shenjohe me trajtë të shkurtër. Kryefjala dhe kallëzuesi, të cilët lidhen ngushtë semantikisht me njëri tjetrin formojnë remën e përbërë. Rrushi f. 61: nënvizon në këtë rast se veprimin e kryer nga folja mund ta kryejnë vetëm një numër i kufizuar subjektësh ndër të cilët është edhe ai i shprehur nga kryefjala. Gjatë ligjëritimit kemi një pauzë të ndjeshme, e cila shërben për të ndarë temën nga rema.:

Dhomën e mbështolli errësira.

Arianin e rriti ky pushtet.

Misrin dhe bukën i bëjnë njerëzit.

Rrushi gjithashtu thekson se f.61: në disa raste kryefjala e shprehur me një emër me shkallë të lartë shquarësie, mund të shoqërohet edhe me fjalë përforcuese, përemra të

pacaktuar ose vetvetorë, gjëqë tregon qartë se kryefjala theksohet e është pjesë e remës dhe shmang dyanshmërinë në interpretim. Siç do vërehet nga dy shembujt e mëposhtëm, nëse kryefjalët ‘fshati’ dhe ‘zoti Fisnik’ nuk do të shoqëroheshin përkatësisht nga fjalët tërë dhe vetë, mund të ligjerohen dhe jashtë theksit si temë e thënies.:

Këtë punë e di gjithë fshati.

Të gjithë situatën e di vetëm zoti Fisnik.

2)Rend neutral me temë të përbërë nga kundrina e drejtë dhe kallëzuesi, të cilët lidhen ngushtë semantikisht dhe janë të njohur nga konteksti. Kundrina e drejtë në këtë rast shenjohej nga trajta e shkurtër. Kryefjala mbi të cilën bie theksi logjik përbën temën. Pauza që ndan temën nga rema në ligjerim nuk është e ndjeshme. Gjithahstu dhe ky është një tip mjaft i përdorur.

Fajin e patën ëndrrat dhe hamendjet e mia.

Fuqinë e kanë vajzat.

Në shumicën e rasteve sipas Rrushit, kryefjala shoqërohet edhe me pjesëza përforcuese e dalluese apo dhe fjalë të tjera që kryejnë funksion të ngjashëm me to.:

Një shtegtim kaq të gjatë e bëjnë vetëm zogjtë.

Gramatika të shqipes hartoi edhe De Rada..

Përgjigjen do ta jap unë vetë.

3)rend shprehës emocional me theks logjik mbi kallëzuesin, i cili është remë e thënies dhe mund të shoqërohet në këtë rast edhe më pjesëza modale. Kundrina e drejtë shenjohej me trajtë të shkurtër dhe së bashku me kryefjalën formojnë temën e thënies. Si kundrina e drejtë, ashtu dhe kryefjala janë dhënë nga konteksti. Ky tip ndeshet rralë dhe kushtëzohet nga konteksti i përcaktuar. Gjatë ligjërimit bëhen dy pauza jo shumë të ndjeshme, të cilat veçojnë remën midis temës së parë dhe temës së dytë.

Meçe Dinon sikur e nevríkoste ajo heshtje.

Kaq gjë e kuptonte Moza.

Këtë e di xha Iljazi.

4)rend shprehës emocional me theks mbi kundrinën e drejtë., e cila është remë e thënies dhe shprehet kryesisht me emra të pashquar e përemra dëftorë dhe nuk shenjohej nga trajta e shkurtër. Në shumicën e rasteve kundrina e drejtë shoqërohet dhe nga pjesëzat

dalluese vetëm, pikërisht, etj..Kallëzuesi dhe kryefjala janë dhënë nga konteksti dhe përbëjnë temën e thënies. Gjanë ligjërimin tema ndahet nga rema me anë të një pauze të ndjeshme.:

Ngatërresa të mëdha ka nxjerrë qyteti juaj.

Këtë kuptim ka artikulli.

Vetëm hotele nuk më zuri syri.

Pikërisht këtë thotë edhe mami.

5)rend shprehës emocional me theks mbi kallëzuesin. Kryefjala,e cila është e njohur nga konteksti është temë e thënies, ndërsa kundrina e drejtë, e cila nuk përsëritet me trajtë të shkurtër, së bashku me kallëzuesin formojnë remën e përbërë të thënies. Theksojmë se ky tip ndeshet mjaft rrallë. Ligjërohet me një pauzë, që ndan temën nga rema.

(Buzëqeshja e saj Sarës nuk i pëlqeu.) Diçka fshihte kjo buzëqeshje.

(Po ti, Sulo, a i pyete vajzat? - Sus, more.) Vajzat do pyes unë?

V.Rendi kallëzues + kryefjalë + kundrinë e drejtë është një rend që haset pak në gjuhën shqipe. Dhe për të ekzistojnë katër tipe kumtues aktual.

1)rend neutral me theks logjik mbi kundrinën e drejtë, që së bashku me kallëzuesin formojnë remën e përbërë. Kryefjala, e cila është dhënë nga konteksti është temë e thënies. Kundrina e drejtë në këtë rast nuk shenjohet nga trajta e shkurtër. Rrushi gjithahtu thekson se tip është karakteristikë e stilit tregues dhe mbështetet në prozen popullore. Ligjërohet me dy pauza jo shumë të ndjeshme, që veçojnë temën.

Ka edhe kjo **historinë e vet**.

Gjeti ustai **ustanë**.

Kam edhe unë **gjysmë porosie**.

2)rend neutral me theks logjik në fund të fjalisë mbi kundrinën e drejtë, e cila është remë e thënies dhe nuk shenjohet më trajtë të shkurtër dhe shoqërohet me pjesëzën dhe. Kallëzuesi me kryefjalën formojnë temën e përbërë.:

Kishte Dila dhe **një motër** më të madhe....

3)rend shprehës emocional me theks logjik në mes të fjalisë mbi kryefjalën. Kallëzuesi dhe kryefjala formojnë remën e përbërë dhe kushtëzojnë semantikisht njëri tjetrin.

Kundrina e drejtë, e cila është dhënë nga konteksti është temë e thënies dhe shenjohe me trajtë të shkurtër. Gjatë ligjërimit tema dhe reza ndahen nga një pauzë e ndjeshme.:

E bren krimbi i madh **Baton**.

I zuri pleqëria **këta**.

4)rend shprehës emocional me theks logjik mbi kundrinën e drejtë, e cila së bashku me kallëzuesin janë të njohura nga konteksti dhe formojnë temën e përbërë. Kryefjala, e cila ka shkallë të lartë shquarsie dhe mund të shoqërohet me pjesëza, është remë e thënies. Kundrina e drejtë në këtë rast lidhet ngushtë me kallëzuesin dhe shenjohe me trajtë të shkurtër. Ligjërohet me dy pauza, që shërbejnë për të veçuar remën, nga të cilat ndihet qartë vetëm e dyta.:

E bëjnë plot njerëz **këtë pyetje**.

Pra duhej ta shihte edhe ai **këtë punë**.

E kam stisur unë **atë lule**.

VI.Kallëzues + kundrinë e drejtë + kryefjalë është rend me të cilin realizohen katër tipa kumtues aktual.:

1)rend neutral me theks logjik mbi kryefjalën, e cila së bashku me kallëzuesin janë të lidhur ngushtë me tyre dhe formojnë remën e përbërë. Kundrina e drejtë është temë e futur midis remës së përbërë dhe shenjohe me trajtë të shkurtër.:

(S'të njoha fare.) Ta paska zënë **fytyrën** hija e shtambës.

2)rend neutral me theks mbi kryefjalën, e cila mund të shoqërohet dhe me pjesëza përforcuese dhe është remë e thënies. Paraprirë nga një kontekst mjaft i përcaktuar ku janë dhënë kryefjala dhe kundrina që formojnë temën e përbërë. Kundrina dhe në këtë rast shenjohe me trajtë të shkurtër. Ligjërohet me një pauzë të dallueshme, që ndan temën nga reza.:

(Në krahun e majtë... brezaret zgjaten.) I zgjat **ato** rinia.

E ka pasur **fajin** fara.

Ka **kufijtë** e saj edhe shakaja.

3)rend shprehës emocional me theks në mes të fjalisë, mbi kundrinën e drejtë, e cila së bashku me kallëzuesin formojnë remën e përbërë. Nga konteksti njihet vetëm kryefjala e cila dallohet nga një shkallë e lartë shquarsie dhe është temë e thënies. Kallëzuesi përgjithësisht përfaqësohet nga folja kam, që ka nevojë kuptimisht për kundrinën e

drejtë. Kundrina e drejtë në këtë rast nuk shenjohej me trajtë të shkurtër. Dhe ky tip ka një pauzë gjatë të dallueshme mirë ligjëritimit.:

Vërtet, kanë **të drejtë** shokët.

Ka **diçka të pazakontë** kjo mbrëmje.

Qeveris **fshatin** djali.

4)rend shprehës emocional me theks në fillim të fjalisë mbi kallëzuesin, i cili është remë e foljes. Nga konteksti janë dhënë kryefjala dhe kundrina e drejtë, e shenjuar me trajtë të shkurtër. Kallëzuesi dhe kundrina e drejtë formojnë së bashku temën e përbërë të thënies.:

Nuk e kishte dashur **këtë** ai.

(Kërkon konçesione.) I dhanë konçesione Zogu dhe banda e tij.

6.2. Rendi i kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë në fjalinë e thjeshtë dëftore

Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe ka një rend të përafërt me kundrinën e drejtë në fjalinë dëftore. Sipas Buchholz/ Fiedler⁴⁵² ajo mund të përfaqësojë temën ose remën. Karakteristike e saj është fakti se ajo shenjohej gjithmonë nga një trajtë shkurtër e përemrit vetor. Duke marrë shkas nga fakti se trajta e shkurtër është gjithnjë e pranishme në rastin e kundrinës së zhdrejtë Rrushi⁴⁵³ thekson se ajo nuk mund të shërbejë si mjet ndihmës për të dalluar komponentët e gjymtyrëzimit aktual. Në vijim do rendisim gjashtë skemat e mundshme të vendosjes së kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë në fjalinë dëftore në gjuhën shqipe bashkë me variantet përkatëse për çdo model.

I.Rendi S – P – O2 (kryefjalë + kallëzues + kundrinë e zhdrejtë) është rend i drejtë neutral. Ky rend është i ngjashëm me modelin e sipërpërmendur të kundrinës së drejtë.

1) S(t) – (P – O2)(r)

Është rend neutral me theks logjik mbi kundrinën e zhdrejtë e cila është e lidhur ngushtësisht me kallëzuesin, me të cilin formojnë së bashku remën e thënies. Kryefjala, njihet nga konteksti dhe është temë e thënies. Sipas Rrushit është tipi që ndeshet më shumë me këtë rend gjymtyrësh. Ligjërohet me një pauzë të dallueshme qartazi që ndan temën nga rema.:

Mësuesi i thirri **dikujt**.

⁴⁵² Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 544

⁴⁵³ Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 67

Shpresat tona u ngjanin **baticave dhe zbaticave**.

Ajo shenjë i përngjasonte **gërmës**.

2) rend neutral me theks mbi kundrinën e zhdrejtë, e cila është temë e thënies. Ajo shoqërohet dhe me pjesë përforcuese. Kryefjala dhe konteksti janë dhënë nga konteksti dhe së bashku formojnë remën e përbërë. :

Kjo skemë ia kishte kaluar edhe **përfytyrimit më komik**.

3)rend shprehës emocional me theks logjik mbi kallëzuesin, i cili është remë e thënies. Kryefjala dhe kundrina e zhdrejtë njihen nga konteksti dhe formojnë së bashku temën e thënies. Gjatë ligjëritimit bëhen dy pauza, që shërbejnë për të ndarë remën e ndërvendosur mes dy temave.:

(vali përsëri qesh.) kjo s'para i pëlqente **Bektashit**.

Shtëpia iu mërzi **plakut Mere**.

4)rend shprehës emocional me theks mbi kryefjalën, e cila së bashku me kallëzuesin formojnë remën e përbërë të thënies. Kundrina e zhdrejtë është dhënë nga konteksti dhe është temë e thënies. Ky tip sipas Rrushit ndeshet shumë rrallë.:

Djersë të ftohta duhet t'i kenë shkuar **djalit**.

II. Kryefjalë + kundrinë e zhdrejtë + kallëzues. Në këtë rast kemi një rend me vendosje të anasjelltë të kundrinës së drejtë. Ky rend ndeshet rrallë. Tipat kumtues aktualë që realizohen me të, siç do i shohim në vijim janë gjithashtu të pakët.

1)rend neutral me theks logjik mbi kallëzuesin, i cili është remë e thënies. Nga konteksti janë dhënë kryefjala dhe kundrina e zhdrejtë, që kanë shkallë të lartë shquarsie dhe janë tema të thënies. Në mjaft raste kallëzuesi shoqërohet dhe me pjesëza mohuese. Gjatë ligjëritimit ka dy pauza, ku e para që shërben për të ndarë temat nga njëra tjetra është më pak e ndjeshme, ndërsa e dyta ndan remën.;

Bukuria e qytetit **atij** si hynte në punë.

Ky udhëtim **atij** nuk i pëlqente.

Kjo **mua** më mungonte.

2)rend shprehës emocional me theks mbi kundrinën e zhdrejtë, e cila shoqërohet nga pjesëza përforcuese dhe është remë e thënies. Kryefjala dhe kallëzuesi, që njihen nga konteksti formojnë temën e përbërë. Gjatë ligjëritimit kemi dy pauza, nga të cilat është më e qartë ajo që ndan komponentin e parë të temës nga rema.:

Unë edhe **nënës** do ti them...

Gjyshja edhe **babit** s'ia kursente, edhe **nënës**.

Sipas Rrushit⁴⁵⁴: Ky tip është i vetmi, kur kundrina e zhdrejtë e shprehur me përemër vector të vetës së parë ose të dytë është e domosdoshme për fjalinë.: p.sh.:

Po Tana **mua** më ka ngjarë ma, tëpkë.

III. Rendi Kundrinë e zhdrejtë + kryefjalë + kallëzues. Me këtë rend, i cili ndeshet rrallë realizohen tre tipa kumtues aktual.

1)rend neutral me theks logjik mbi kallëzuesin, i cili së bashku me kryefjalën formojnë remën e përbërë të thënies. Kundrina e zhdrejtë, ka shkallë të lartë shquarësie dhe e cila njihet nga konteksti është temë e thënies. Gjatë ligjërimit kemi një pauzë mjaft të gjatë, që ndan temën nga remë.:

Asaj diçka iu kujtua.

2)rend neutral me theks mbi kallëzuesin, i cili shoqërohet me pjesëza mohuese, është remë e thënies. Kryefjala dhe kundrina e zhdrejtë, njihen nga konteksti dhe janë temë të thënies. :

Mua kjo nuk më pëlqen.

3)rend shprehës emocional me theks logjik mbi kryefjalën, e cila është remë e thënies. Nga konteksti janë dhënë kundrina e zhdrejtë dhe kallëzuesi, të cilët formojnë temën e thënies.

(Së keqes nuk u duhen prerë degët...) **Së keqes** trangu dhe rrënjët i duhen prerë.

IV.Rendi Kundrinë e zhdrejtë+ kallëzues + kryefjalë. Ky është një rend mjaft i shpeshtë i gjymtyrëve në fjalinë e thjeshtë dëftore. Sipas Rrushit⁴⁵⁵: Ai mund të quhet rend tipik i anasjelltë për modelin që po analizojmë. Për këtë rend kemi katër tipa kumtues aktual.

1)rend neutral me theks mbi kallëzuesin, i cili është i lidhur ngushtë semantikisht me kryefjalën dhe së bashku formojnë remën e përbërë të thënies. Kundrina e drejtë ka një shakallë të lartë shquarësie, njihet nga konteksti dhe është temë e thënies. Në këtë rend të gjymtyrëve ky është tipi që ndeshet më shpesh. Gjatë ligjërimit bëhet një pauzë mjaft e ndjeshme, e cila ndan temën nga rema.:

Kompozimit i mungonte diçka.

⁴⁵⁴ Rrushit, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f.70

⁴⁵⁵ Po aty, f. 71

Plakut i ndritën sytë.

Atij iu kujtuan fjalët e letrës.

2)rend neutral me theks mbi kryefjalën, e cila është remë e thënies. Kundrina e zhdrejtë dhe kallëzuesi janë dhënë nga konteksti dhe së bashku formojnë remën e përbërë.:

(Ai vetëm bënte kafetë.) **Klientëve** u shërbente kamarierja.

(Barra e kuzhinës i takoi sime mëje.) Zanës me sa duket i takoi muzika.

3)rend shprehës emocional me theks mbi kallëzuesin, i cili është remë e thënies. Kundrina e zhdrejtë dhe kryefjala njihen nga konteksti, kanë shkallë të lartë shquarësie dhe janë tema të thënies. Ky gjymtyrëzim sipas Rrushit⁴⁵⁶: *përcaktohet edhe nga semantika e foljes. Në rolin e kallëzuesit dalin një numër i kufizuar foljesh që shprehin gjendje shpirtërore dhe miratim apo mosmiratim të diçkaje; Në shembujt e mëposhtëm në shumicën e rasteve del folja pëlqej. Kallëzuesi mund të shoqërohet dhe me pjesëza mohuese. Gjatë ligjërimit bëhen dy pauza, nga të cilat e para është më e ndjeshme.:*

Mua më pëlqejnë rrugët e fshatit tim.

Ty të pëlqen Dritani.

Mua më prekën këto fjalë.

Zanës s'po i pëlqente Mira.

4)rend shprehës emocional me theks mbi kundrinën e zhdrejtë, e cila mund të shoqërohet edhe me pjesëza përforcuese, është remë e thënies. Kallëzuesi dhe kryefjala, njihen nga konteksti dhe së bashku formojnë temën e përbërë. Ligjërohet me një pauzë që shërben për të ndarë temën nga rema.:

Djalit i trembem unë, djalit.

Mua më ka ngjarë Zana.

Edhe zotit K i duhen raportet.

Edhe mua më janë grirë gjysmat e putrave...

V.Rendi kallëzues + kryefjalë + kundrinë e zhdrejtë është karakteristik për stilin tregues, të ngjashëm me atë të prozës popullore. Me të realizohen tre tipa kumtues aktual.

⁴⁵⁶ Rrushit, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 71

1)rend neutral me theks mbi kundrinën e zhdrejtë, e cila ka shkallë të lartë shquarësie dhe mund të shoqërohet edhe me pjesëza përforcuese, është remë e thënies. Kryefjala dhe kallëzuesi, të cilët njihen nga konteksti, janë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin dhe formojnë temën e përbërë. Ligjërohet me një pauzë të dallueshme qartazi.:

Iu prish rehati edhe **atij**.

I erdhi rradha edhe **këtij**.

I erdhi rradha, më në fund, edhe **gjermanit**.

2)rend shprehës emocional me theks logjik mbi kryefjalën. Vihet re më shumë në stilin bisedor. Kryefjala dhe kallëzuesi, kushtëzojnë semantikisht njëri tjetrin dhe formojnëremë e përbërë të thënies. Kundrina e zhdrejtë, e cila është e njohur nga konteksti, është temë e thënies.:

Ma ka thënë Spirovica **mua**.

Po i shkante koha **pambukut**.

Dhe u hyri lezeti **njerëzve**.

Na është mësuar lëkura **ne**.

3)rend shprehës emocional me theks mbi kallëzuesin, i cili është remë e thënies. Kryefjala dhe kundrina e zhdrejtë njihen nga konteksti dhe janë tema të thënies.:

I duhej kjo **Faslliut**.

Nuk më takon ajo para **mua**.

VI.rendi Kallëzues + kundrinë e zhdrejtë + kryefjalë. Ky është një rend që vihet re rrallë me të cilin realizohen dy tipa kumtues aktual.

1)rend neutral me theks mbi kryefjalën, e cila është remë e thënies. Kallëzuesi dhe kundrina e drejtë njihen nga konteksti dhe së bashku formojnë temën e përbërë të thënies.:

I kishte thënë **plakut** një shok.

2)rend shprehës emocional me theks logjik mbi kundrinën e zhdrejtë, e cila bashkë me kallëzuesin formojnë remën e përbërë të thënies. Kryefjala njihet nga konteksti dhe është temë e thënies.:

Nuk i besonte gjumit **llogaritari**.

I përngjan **malësorit**.

Nuk ingjan fare **asaj** kjo vajzë.

6.3.Rendi i kundrinës me parafjalë në fjalinë e thjeshtë dëftore

Në gjuhën shqipe vendosja e kundrinës me parafjalë është e lirë në varësi të vlerës së informacionit që synohet të përçohet. Sipas Buchholz/ Fidler: “Das Präpositionalobjekt kann die gleiche Position wie das Akkusativ oder Dativobjekt einnehmen. In der Grundreihenfolge ist es allgemein rhematisch.”⁴⁵⁷/Kundrina e zhdrejtë me parafjalë mund të marrë të njëjtin pozicion si kundrina e drejtë dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë . Në vendosjen bazike ajo përfaqëson zakonisht remën. Në vijim do japim gjashtë skemat e mundshme ë vendit të kundrinës së drejtë në fjalinë dëftore duke i ilustruar me shembuj.

Pra mund të themi se kur kundrina me parafjalë përbën remën, të renë që kumtohet, në stilin neutral vendoset pas kallëzuesit, zakonisht në fund të fjalisë: kryefjalë + kallëzues + kundrinë me parafjalë

I.Ai vështrim ngazëllimtar është zëvendësuar **nga një vështrim i menduar e si ëndërrues**.

Vajza ishte veshur **me rroba ushtarake**.

Dhoma e gatimit qe mbushur **me avull**.

Ajo mendonte **për detyrën e saj**.

II.kryefjalë + kundrinë me parafjalë + kallëzues

Gazetari **për këtë** nuk ka shkruar.

III.Ndërsa kur kundrina me parafjalë përbën temën, të njohurën dhe nuk mban theksin logjik, ajo i prin kallëzuesit, qëndron zakonisht në krye të fjalisë duke na dhënë rendin: kundrinë e zhdrejtë me parafjalë + kryefjalë + kallëzues:

Për çështje të stilit ne nuk do të polemizojmë.

IV.Rendi kundrinë e zhdrejtë me parafjalë + kallëzues + kryefjalë:

Prej kësaj mund të rrjedhin pasoja të rënda.

Për këtë nuk i pati shkruar Verës.

⁴⁵⁷ Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987,f. 544

V. kallëzues + kryefjalë + kundrinë e zhdrejtë me parafjalë:

Merreshin që të gjithëme **blegtori**.

VI. kallëzues + kundrinë e zhdrejtë me parafjalë + kryefjalë

Dëshmojnë **për një zhvillim të tillë** edhe rezultatet e fundit.

6.4.Rendi në fjalinë e thjeshtë dëftore i kundrinës së drejtë dhe kundrinës së zhdrejtë.

Ky model sintaksor i përbërë nga katër elementë me të cilët teorikisht do të mund të formoheshin njëzetekatër variante me rende të ndryshme, por në studimin e tij Rrushi ka vërejtur gjashtëmbëdhjetë variante⁴⁵⁸. Me secilin prej tyre mund të realizohen disa tipa kumtues aktual. Dukeqenëse ne për këtë punim interes përbën vetëm rendi i kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë në raport me njëra tjetrën, do të përmend vetëm rastin kur kundrina e drejtë ndodhet para së zhdrejtës dhe anasjelltas.

D)Rendi Kryefjalë – kallëzues – kundrinë e drejtë- kundrinë e zhdrejtë. Ky është rend i drejtë dhe më i përhapuri i këtij modeli. Sipas Buholc/ Fidler⁴⁵⁹ “*Die Objekte erscheinen im allgemeinen in dieser Anordnung, wenn das Dativobjekt das Rhema bildet.*” Të dyja kundrinat mund të kenë shkallë të njëjtë shquarësie, ose si në rastin e shembullit të fundit ku kundrina e drejtë njihet nga konteksti, ndërsa kundrina e zhdrejtë jo.”:

Elda po i shkruan **letërnjë shoku**.

Mësuesja u dha **sqarime disa nxënësve**.

Shkrimtari ua kushtoi këtë roman **shokëve të luftës**.

II)Rendi kryefjalë – kallëzues – kundrinë e zhdrejtë – kundrinë e drejtë. Siç vihet re në këtë rend kundrinat kanë këmbyer vendet. Në këtë rast kundrina e drejtë është remë e thënies. Sipas B/F të dyja kundrinat kanë të njëjtën gradë shquarësie, ose si në rastin e fjalisë së dytë ku kundrina e zhdrejtë jepet nga konteksti, ndërsa kundrina e drejtë përfaqëson të renë. Ky rend nuk gjen përdorim të shpeshtë në gjuhën shqipe.:

Gruaja i dha **vajzës një dardhë**.

Populli i jepte **kësaj ushtrie përkrahje të gjithanshme**.

⁴⁵⁸ Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983, f. 82- 96

⁴⁵⁹ Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, f. 546

6.5.Rendi në fjalinë e thjeshtë dëftore i kundrinës me parafjalë në raport me kundrinën e drejtë, dhe kundrinën e zhdrejtë.

Ky model sintaksor i përbërë nga katër ose pesë elementë me të cilët teorikisht do të mund të formoheshin përkatësisht njëzetekatër ose tridhjetë variante me rende të ndryshme. Me secilin prej tyre do të mund të realizoheshin disa tipa kumtues aktual. Dukeqenëse për këtë punim interes përbën vetëm rendi i kundrinës së zhdrejtë me parafjalë në raport me kundrinën e drejtë dhe të zhdrejtë, do të përmend vetëm rastin kur kundrina e zhdrejtë me parafjalë vendoset para ose pas kundrinës së drejtë dhe/osekundrinës së zhdrejtë.

Drendi kryefjalë – kallëzues – kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë – kundrinë e zhdrejtë me parafjalë. Ky është rend i drejtë dhe njëkohësisht rendi që ndeshet më shpesh. Siç do vërehet nga shembujt kundrina e zhdrejtë me parafjalë vendoset në fund të fjalisë, pas kundrinës së drejtë dhe/ ose asaj të zhdrejtë. Kundrina e zhdrejtë përfaqëson remën.

Mustafa Qemali e kishte kthyer **Turqinë e prapambetur të sulltanëve në një “Turqi modernë”**.

Veterani u foli **pjesëmarrësve mbi ngjarje të luftës antifashiste.**

II) Rendi kundrinë e zhdrejtë me parafjalë – kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë – kallëzues –kryefjalë. Ky rend nuk haset shpesh në gjuhën shqipe. Është i mundur kur kundrina e zhdrejtë me parafjalë përfaqëson temën.

Për këtë nuk i kishte shkruar **nënës djali.**

Me jetën shoqërore nxënësit i lidh edhe puna.

KREU IX - TRAJTIM PËRQASËS I RENDIT TË KUNDRINËS NË GJUHËN GJERMANE DHE ATË SHQIPE

Objekt i kreut të shtatë dhe të tetë të këtij punimi ishte studimi i funksioneve dhe veçorive të rendit të fjalëve në përgjithësi dhe kundrinës në veçanti në fjalinë e thjeshtë dëftore në gjuhën gjermane dhe atë shqipe. Siç u theksua dhe në hyrjen e kreut për këto çështje ka patur pak punime të thelluara, gjë që e vështirësoi punën.

Rendi i gjymtyrëve në të dyja gjuhët kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm dhe kryen në fjali disa funksione. Kriter bazë për renditjen e gjymtyrëve në fjali në gjuhën gjermane dhe atë shqipe është kryesisht vlera e përmbajtjes së informacionit që duam të përcjellim. Ashtu si në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe megjithëse rendi i gjymtyrëve në fjali është kryesisht i lirë, pra gjymtyrët mund të qëndrojnë në pozicione të ndryshme në fjali, ekzistojnë dhe disa rregulla dhe gjithashtu disa përjashtime.

Në gjuhën gjermane rendi i gjymtyrëve në fjali përcaktohet kryesisht nga vlera e informacionit që ato bartin, ku gjymtyrët me vlerën më të lartë të informacionit renditen në fund të fjalisë. Kriteret morfologjik luajnë një rol të rëndësishëm për të renditur gjymtyrët në Mittelfeld, pasi forma shërben në përcaktimin e vlerës së informacionit. Konkretisht renditja është kronologjike:

- gjymtyrë të shprehura me përemra pronor dhe reflektiv
- gjymtyrë të shprehura me emra të shquar dhe përemra dëftor dhe pronor
- gjymtyrë të shprehura me emra të pashquar
- përemra të papërcaktuar.

Siç është përmendur më lart, gjuha gjermane në dallim nga shqipja ka karakteristike ndarjen në dy pjesë të kallëzuesit të përbërë, dhe përfshirjen e pothuaj të gjitha gjymtyrëve të tjera të fjalisë ndërmjet pjesës së parë (P1) dhe pjesës së dytë (P2) apo pjesëve të tjera (Pn) të kallëzuesit, duke formuar kornizën e fjalise. Këto pjesë të kallëzuesit përbëjnë dhe skeletin e fjalisë gjermane. Me pozicionet e tyre të përcaktuara P1, P2, ato formojnë tri fusha karakteristike për gjuhën gjermane në të cilat gjejnë vend gjymtyrët e fjalisë (Vorfeld, Mittelfeld/Satzfeld, Nachfeld).

Përsa i përket gjuhës shqipe rendi i fjalëve është një nga mjetet më të rëndësishme sintaksore, që në kuadrin e thënies, kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm dhe kryen funksione të ndryshme kumtesore, stilistikore e gramatikore. Lidhur me këto funksione duhet pranuar në mënyrë relative dhe fakti se gjuha shqipe ka rend të lirë të fjalëve.

Funksioni themelor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe është ai kumtues, pra shprehja e përbërësve të gjymtyrëzimit aktual të fjalisë, temës dhe remës. Në ligjërimin neutral, në cdo fjali të dhënë, gjymtyrët që bëjnë pjesë në temë vendosen në fillim, ndërsa gjymtyrët që bëjnë pjesë në remë vendosen në fund të fjalisë. Këtë funksion rendi i fjalëve e kryen së bashku me theksin logjik, si dhe me ndihmën e mjeteve të tjera me

karakter leksikor e gramatikor. Në gjuhën shqipe shumica e tipave kumtues aktual ndërtohen me rend fjalësh neutral (temë – remë), çka tregon qartë rolin e rëndësishëm kumtues të rendit të fjalëve.

Funksioni dytësor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe ashtu si dhe në atw gjermane, është ai stilistikor apo shprehës emocional, kur rendi i fjalëve nuk shërben më për të dalluar temën nga rema. Në këtë rast kemi rend afektiv apo shprehës emocional, joneutral me vendosje të anasjelltë të përbërësve të gjymtyrëzimit aktual (remë-temë). Ky funksion vihet re më tepër në stilin bisedor.

Rëndësi të veçantë në gjuhën shqipe veçanërisht në ligjërimin me shkrim luan dhe roli gramatikor i rendit të fjalëve, kur ai ndihmon për të përcaktuar funksionet sintaksore të gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Në këtë rast mund të flitet për rend të ngulitur të fjalëve. Mund të themi se rend të ngulitur në gjuhën shqipe kanë përgjithësisht në disa raste disa gjymtyrë të shkallës së dytë, (ku përfshihet dhe kundrina) që vendosen pranë gjymtyrëve nga të cilat varen. Gjithashtu në rastet kur ato mund të zënë dy pozicione, vendosja konkrete aktuale përcaktohet nga arsye kumtuese e stilistike, po edhe nga arsye kuptimore e strukturore. Në raste më të rralla është i detyrueshëm rendi i drejtë i gjymtyrëve edhe për arsye gramatikore, për të dalluar funksionet sintaksore të formave homonime.

Kur në një fjali të thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe kemi praninë e një kundrine, qoftë kundrinë e drejtë, kundrinë e zhdrejtë, apo kundrinë e zhdrejtë me parafjalë janë të mundur gjashtë variacione të rendit të gjymtyrëve të fjalisë. Për secilën prej këtyre gjashtë varianteve ekzistojnë përkatësisht disa tipa kumtues aktual, të cilat në bazë të vendosjes së temës dhe të remës mund të jenë neutral, ose shprehës emocional.

Për gjuhën shqipe, si një mjet i veçantë që ndihmon për të përcaktuar përbërësit e gjymtyrëzimit aktual, mund të shihet dhe prania e mosprania e trajtës së shkurtër përemërore të kallëzores, që shënon përkatësisht tematizimin ose rematizimin e kundrinës së drejtë. Rol të ngjashëm me atë të trajtës së shkurtër të kallëzores për shqipen luan dhe trajta e plotë e përemrave vetorë të vetës së parë e të dytë në funksionin e kundrinës e të kryefjalës.

Trajta e shkurtër në rastin e fjalive me kundrinë të drejtë e shenjon kundrinën e drejtë kur kjo e fundit përfaqëson temën, dhe anasjelltas nuk e shenjon kundrinën e drejtë kur kjo e fundit është remë e thënies. Në këtë mënyrë trajta e shkurtër është reflektim i karakterit tematik të kundrinës së drejtë dhe përbën një mjet të rëndësishëm shprehës në kuadër të gjymtyrëzimit aktual.

Ndërsa në rastin e kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë kemi gjithmonë shenjim të saj me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, si kur kundrina e zhdrejtë është temë, ashtu dhe në rastin kur është remë e thënies.

Kushtet morfologjike luajnë një rol shumë të rëndësishëm veçanërisht në rendin e kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë në gjuhën gjermane, ndërsa për gjuhën shqipe nuk vlejné këto rregulla, psh. në rastin kur në gjuhën gjermane kundrina e zhdrejtë dhe ajo e drejtë shprehen me emra, rendi është i tillë: e zhdrejte/ e drejtë, ndërsa kur shprehen me përemra rendi është i kundërt: e drejtë/ e zhdrejtë. Në gjuhën shqipe nuk është e rëndësishme nëse kundrinat janë shprehur me emër apo përemër, por rendi i kundrinës së drejtë dhe asaj të zhdrejtë varen nga vlera e informacionit që dëshiron të përcjellë folësi apo shkruesi. Pra zakonisht tema vendoset para remës. Në raste të rralla kur duam ta theksojmë veçanërisht remën ajo mund të vendoset para temës në të dy gjuhët. Gjithashtu në dy gjuhët kundrina e zhdrejtë mund të vendoset para, ose pas kundrinës së drejtë, në varësi të asaj çka duam të theksojmë.

Ndryshe nga gjuha shqipe në atë gjermane ekziston dhe kundrina e rasës gjinore, e cila duke qenë e lidhur ngushtësisht me foljen renditet në fund të fjalisë para pjesës së dytë të kallëzuesit P2.

Dhe në rastin e kundrinës me parafjalë vërejmë disa ndryshime mes dy gjuhëve, p.sh. kundrinat me parafjalë në gjuhën gjermane kanë të veçantë sepse kallëzuesi i tyre kushtëzon parafjalën p.sh. warten auf. Kundrinat me parafjalë në gjuhën gjermane vendosen në fund të fjalisë, para pjesës së dytë të kallëzuesit P2, pamvarësisht nga vlera e informacionit që ato përçojnë, ndërsa në gjuhën shqipe vendosja e tyre është e lirë në varësi të vlerës së informacionit që synohet të përçohet.

Përfundime

Për hartimin e këtij punimi pati mjaft vështirësi natyrash nga më të ndryshmet. Para së gjithash, letërsia shkencore, sidomos për temën e punimit është e varfër në gjuhën shqipe, por ajo nuk është dhe aq e pasur edhe në gjuhën gjermane. Në gjuhën shqipe dhe për gjuhën shqipe u hulumtua nëpër gramatika të gjuhës shqipe dhe nëpër artikuj të veçantë, të botuar nëpër gazeta e revista të ndryshme nga studiues shqiptarë të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë, të cituar në bibliografi, ku, ndër të tjera, bëhet fjalë edhe për gjymtyrët e fjalisë. Vlen të thuhet se këta artikuj kanë ndihmuar së tepërmi në mbarështrimin e lëndës së analizuar. Gjithashtu dhe në gjuhën gjermane u bazova në gramatika të ndryshme, artikuj shkencorë dhe disa punime monografike që munda të gjeja. Gjithsesi vetë bibliografia e vënë në fund të punimit tregon se ajo nuk është vjelë shterueshëm.

Kundrimi i kundrinës dhe rendit të saj në fjali në të dy gjuhët është bërë edhe me ndihmën e analizës së togfjalëshit, duke marrë shkas dhe nga thënia e sintaksologut të shquar shqiptar Spiro Floqi: *“Një klasifikim shkencor i gjymtyrëve të dyta mund të jetë plotësisht i mundshëm vetëm kur të jetë studjuar në mënyrë të thellë struktura dhe marrëdhëniet e shprehura në tipat e ndryshëm të togfjalëshave...”*⁴⁶⁰

Me kalimin e kohës, në shkencën e gjuhësisë janë zhvilluar modele të ndryshme gramatikore, të cilat e kanë zanafillën e tyre tek gramatika me orientim nga logjika nga e cila u zhvillua e më pas ajo tradicionale e deri tek gramatika transformuese gjenerative e ditëve të sotme.

Gramatika tradicionale përdor terminologjinë dhe metodat e huazuara nga gjuha dhe gramatika latine, pa patur shumë parasysh aspektet funksionale dhe komunikative tëgjuhës. Në përgjithësi mund të thuhet se drejtimin logjik- gramatikor, i cili mbizotëroi në mënyrë absolute deri në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, e gjejmë të përfaqësuar në disa raste edhe në teorinë e sotme sintaksore. Në formën e tij më të skajshme ai u mbështet në paralelizmin e plotë të logjikës e të gramatikës, duke i vështuar kategoritë gramatikore e sidomos ato sintaksore, si pasqyrim i drejtpërdrejtë e nganjëherë madje dhe si produkt i kategorive logjike, e madje duke u njehsuar shpeshherë me to. Ai shfaqet në forma të ndryshme, që shkojnë nga një logjicizëm absolut dhe i ngurtë e deri në vështime më elastike e të gjera, gjithsesi duke paraqitur mjaft mangësi.

Përfaqësuesit më tipikë të këtij drejtimi e njehsuan gjuhën me mendimin, duke e parë atë si një shprehje të plotë e të përpiktë të kategorive dhe raporteve logjike, si diçka të përhershme, të pandryshueshme. Faktet dhe ndërtimet aq të larmishme sintaksore futen në skema të përgjithshme të logjikës formale, nuk merret fare parasysh ose nënvleftësohet forma e tyre. U vu shenja e barazisë mes gjykimit logjik dhe njësive sintaksore themelore, fjalisë, e cila u quajt një gjykim i shprehur me fjalë, dhe u fol për një skemë universale të saj. U lanë mënjanë ndryshimet cilësore të kategorive

⁴⁶⁰ Floqi, Spiro, Togfjalëshat mbimërorë në gjuhën e sotme letrare shqipe, Sf., 1981, n.2, f. 66.

gramatikore të të kategorive gramatikore të afërta nga kuptimi, s'u moën parasysht ngjyrimet dalluese, si dhe u vështruan pak ose aspak veçoritë e mënyrës së shprehjes së tyre. Strukturat sintaksore u paraqitën në mënyrë shumë skematike, duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur materialit real gjuhësor dhe vëzhgimit të tij.

Në këto gramatika thuhet gjithashtu se vetëm foljet kalimtare janë të afta të marrin kundrinë, duke përjashtuar kështu kategorinë e foljeve kalimtare të zhdrejta, dhe, si përfundim, në këto gramatika mungon kundrina e zhdrejtë me parafjalë.

Gjithsesi në të dy gjuhët ajo shërben dhe sot, si bazë për mësimin e gjuhës në tekstet shkollore.

Ndërsa gramatika me orientim nga përmbajtja, (teori gramatikore kjo, që e gjejmë vetëm në gjuhën gjermane dhe jo në atë shqipe), përpiqet të përfshijë në shqyrtim veçanërisht përmbajtjen e shprehjeve gjuhësore. Fjalitë përcaktohen sipas kuptimit që ato mbartin dhe jo sipas formës, në mënyrë që të bëjë të mundur të kuptuarit e botëkuptimit të gjuhës në shqyrtim.

Hans Glinci është përfaqësuesi kryesor i sintaksës së ashtuquajtur operacionale, i cili u përpoq ta kuptonte sistemin gjuhësor nëpërmjet eksperimenteve me materialin gjuhësor. Për të bërë të mundur të kuptuarit e gjymtyrëve të fjalisë, ai sajoi të ashtuquajturat prova të tingullit dhe postimit.

Një drejtim tjetër i gjuhësisë është dhe strukturalizmi, i cili frymëzohet nga Sosyri (Saussure) me termat e tij 'langue' dhe 'parole'. Në strukturalizëm lidhja e elementëve të fjalisë bëhet me anë të mjeteve formale, ku kuptimi i tyre nuk luan asnjë rol. Elementet përshkruhen dhe klasifikohen më tej, në mënyrë që të përfshihet dhe kuptimi i tyre. Sosyrit i referohen ndër të tjera gramatika e dependencës.

Gramatika e dependencës futi termin e valencës së foljes. Ajo merr për të mirëqenë se të gjitha gjymtyrët e fjalisë varen nga folja dhe në këtë mënyrë analizon raportet e elementeve me njëri tjetrin. Këto raporte paraqiten më pas në një pemë (Baumogramm).

Modeli i gramatikës transformuese gjenerative, i cili është modeli më popullor i momentit në hapësirën gjermanishtfolëse, u bë i njohur për herë të parë nga Çomski në 1957. Ky model tejet shkencor, përpiqet të hulumtojë tërësinë e rregullave të një gjuhe me anë të transformimeve të strukturave të thella të gjuhës në strukturën e sipërfaqes së saj. Gjenerimi i fjalisë bëhet me ndihmën e rregullave të transformimit të ndarjes në konstituente. Ato paraqiten pastaj në një diagram pemë, e cila njëkohësisht paraqet dhe funksionet e pjesëve të fjalisë. Kjo mund të kryhet si me fjali të thjeshta, ashtu dhe me fjali të komplikuar.

Zhvillimi i mëtejshëm i modeleve gramatikore në fushën e gjuhësisë, si dhe lindja e modeleve të reja, është një proces i pandërprerë. Në këtë punim u përfshinë pjesë të zhvillimit të tij deri në ditët e sotme.

Si përfundim und të thuhet se në të dyja gjuhët, mënyra më e përshtatshme dhe e pranueshme e analizës së përbërjes së fjalisë, mbetet teoria e gjymtyrëve. Ajo vazhdon të përdoret gjerësisht duke dalë në variante të ndryshme. Zbërthimi i fjalisë në gjymtyrë dhe përcaktimi i mëtejshëm i tyre, që përkojnë në përgjithësi me ndarjen e thënies në njësi kuptimore e strukturore të dallueshme, është shumë i rëndësishëm për zbulimin e raporteve sintaksore që vendosen në kuadrin e fjalisë, të lidhjeve mes elementeve të mendimit të shprehur prej saj. Këto lidhje pasqyrojnë raportet mes sendeve dhe dukurive të realitetit objektiv.

Për klasifikimin dhe përkufizimin e saktë të kundrinës, duhet shmangur si logjicizmi, i cili studion vetëm raportet kuptimore në formën e tyre të përgjithësuar logjike, ashtu edhe formalizmi, i cili merr parasyh vetëm shprehjen gramatikore. Për trajtimin sa më të drejtë të kësaj kategorie sintaksore, parim bazë duhet të jetë uniteti dialektik i përmbajtjes dhe formës, duke pasur gjithmonë në mendje faktin se nuk ka gjithmonë simetri të plotë. Një raport kuptimor mund të shprehet nganjëherë në forma të ndryshme gramatikore. Marrim si shembull hapësirën fizike (vendin), e cila mund të shprehet me një ndajfolje, ose me një fjalë emërore, emër ose përemër, me ose pa parafjalë, me fjalë të lidhura me bashkim ose me drejtim me fjalët që plotësojnë. Dhe anasjelltas emri, si kategori morfologjike, me të cilin mund të shprehen raporte kuptimore të ndryshme, p.sh. me emër përveç kundrinës mund të shprehen dhe kryefjala, kallëzuesi emëror, përcaktorët dhe rrethanorët. Me lidhjen e drejtimit mund të dalin tri kategoritë e gjymtyrëve të dyta, që shprehin tri kategori raportesh.

Në vijim do paraqes ndarazi të përbashkëtat dhe dallimet e kundrinës në gjuhën gjermane dhe atë shqipe, përfundime këto të dala nga ky punim.

Të përbashkëtat:

Përsa i përket termit të përdorur për kundrinën, vërehet se në dy gjuhët fillimisht janë përdorur terma të tjerë nga këta që ndeshen sot.

Kështu në gramatikën e gjuhës gjermane, kundrina deri në mesin e shekullit të 19 nga gjuhëtarë të ndryshëm u quajt fjalë që shpreh qëllimin (Zweckwort), fjalë që shpreh përshtatje (Aneignuswort), shtojcë (Beifügung) dhe fjalë që shpreh synimin (Zielwort). Më pas, në mesin e shekullit 19, në gramatikën e gjuhës gjermane, gjejmë për herë të parë të përdorur termin nga Beker 'Objekt'. Ky term në gjuhën gjermane gjeti përdorim të gjerë veçanërisht në tekset shkollore, ku ndeshet dhe sot. Atë e ndeshim në të gjitha gramatikat me orientim tradicional si dhe ato që përfaqësojnë gramatikën me orientim nga përmbajtja. Në gramatikat me orientim nga teoria e valencës dhe dependencës haset termi 'Ergänzung', i cili gjithashtu është një term i njehsuar në këto gramatika. Në gramatikën gjenerative të gjuhës gjermane kundrina quhet 'komplement'.

Ndërsa në gjuhën shqipe në fillim të shekullit 20, kundrinën si njësi gramatikore, e ndeshim për herë të parë tek Xanoni, me termin 'përkryesa' dhe 'objekt'. Ky i fundit

mesa duket i huazuar nga ndonjë gjuhë tjetër, është përdorur më vonë dhe nga Cipo. Një shekull më vonë, Xhuvani ishte i pari gjuhëtar që përdor termin që njohim dhe sot 'kundrinë'. Këtë term e përdorin më vonë dhe gjuhëtarë të tjerë si Sheperi, Rrota, Myderizi, Prifti etj. Gjithashtu në gjuhën shqipe ndeshet dhe termi, 'kundrinor' i përdorur në libra shkollorë të gramatikës së gjuhës shqipe si dhe nga Çeliku, në sintaksën e tij me orientim nga teoria e valencës dhe dependencës. Përnaska jep një tjetër term për kundrinën duke e quajtur 'kundranor', term ky i huazuar sipas tij nga Riza. Ndërsa në gramatikën gjenerative në gjuhën shqipe ndeshet me termin e huazuar nga anglishtja, 'argument'.

Përsa i përket gramatikës tradicionale në të dyja gjuhët vihet re se fillimisht ajo ishte e lidhur ngushtë me logjikën. Ndërsa më vonë mund të flitet për një gramatikë të mirëfilltë tradicionale. Ndërsa në tekstet gramatikore të viteve të fundit të cilat bazohen tek gramatika tradicionale duke përdorur dhe terminologjinë e saj, vërehen veçanërisht në ato të gjuhës gjermane dhe elemente nga teori të tjera gramatikore të zhvilluara më vonë, prandaj përgjithësisht dhe është e vështirë të bëhet një ndarje e qartë se kujt teorie i përkasin.

Kundrina me parafjalë në të dy gjuhët u dallua si gjymtyrë më vete shumë më vonë se kundrinat e tjera përkatësisht ato të rasës kallëzore, dhanore dhe gjinore në gjuhën gjermane dhe e drejta dhe e zhdrejta në gjuhën shqipe. Në gjuhën gjermane ishte Blatz në fund të shekullit 19, i cili dalloi për herë të parë kundrinën me parafjalë, ndërsa në gjuhën shqipe ajo veçohet për herë të parë nga gjuhëtari Rrota, në mesin e shekullit 20.

Në të dyja gjuhët kemi:

-kundrinën e rasës kallëzore (Akkusativobjekt) në gjuhën gjermane, e cila shprehet me një emër a fjalë emërore të rasës kallëzore, gjegjësjë e së cilës është kundrina e drejtë në gjuhën shqipe, e cila gjithashtu shprehet me një emër a fjalë emërore të rasës kallëzore;

- kundrinën e rasës dhanore (Dativobjekt) në gjuhën gjermane, e cila shprehet me një emër a fjalë emërore të dhanore, gjegjësjë e së cilës është kundrina e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, e cila gjithashtu shprehet me një emër a fjalë emërore të rasës dhanore;

-kundrinën me parafjalë (Präpositionalobjekt) në gjuhën gjermane, e cila shprehet me një emër a fjalë emërore të shoqëruar me një parafjalë, a lokucione parafjalore, gjegjësjë e së cilës është kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe, e cila gjithashtu shprehet me një emër a fjalë emërore të shoqëruar me një parafjalë, a lokucione parafjalore.

Në të dyja gjuhët, veçanërisht në në tekstet shkollorë ose ato të mësimin të gjuhës së huaj, për identifikimin e gjymtyrëve të fjalisë në përgjithësi e kundrinës në veçanti, gjen përdorim metoda analitike, me anë të pyetjes analitike që i drejtohet kallëzuesit. Kjo

metodë kërkon gjithashtu të kuptuarit intuitiv paraprak të fjalisë, i cili përfshihet në formulimin e pyetjeve. Këto pyetje orientohen tek raportet morfologjike, në këtë rast, të rasës. Këtë e tregon dhe formulimi abstrakt i pyetjeve: ‘wer/ kush?’, ‘was/ çfarë?’, ‘wen/ kë?’, ‘wem/ kujt’, ‘wessen/ i kujt’. Në një fjali konkrete duhet zgjedhur përkatësisht njëra prej tyre.

Një temë e shumëpërfolur në pothuaj të gjitha tekstet gramatikore, në të dyja gjuhët është dhe vështirësia në klasifikimin e kundrinës. Në disa raste mund të hasen vështirësi në kuptimin dhe interpretimin e fakteve konkrete gjuhësore, duke qenë se caqet mes këtyre kategorive të gjymtyrëve të fjalisë nuk janë gjithmonë qartësisht të dallueshme, duke çuar kështu në shfaqjen e raste të ndërmjetme apo sinkretike, ose në ato të asimetrisë mes përmbajtjes dhe formës.

Ka kështu në të dyja gjuhët, fakte gjuhësore që qëndrojnë mes kundrinave dhe rrethanorëve.

Takimet si dhe gërshetimet kuptimore krijojnë nganjëherë vështirësi nga më të ndryshmet për të përcaktuar saktë gjymtyrën. Në të tilla raste përcaktimi i saj duhet bërë duke diktuar vlerat kuptimore e veçoritë gramatikore zotëruese.

Nga sa u tha më lart, në mënyrë që të kemi një përcaktim dhe klasifikim sa më të saktë të gjymtyrëve të fjalisë në gjuhën gjermane, duhet të bazohemi si tek përmbajtja ashtu dhe tek forma, pra duhet të mbështetemi edhe në raportet kuptimore, dhe në veçoritë gramatikore. Duhet të vështrohet kështu, funksioni sintaksor e raportet kuptimore të gjymtyrës, shprehja e saj morfologjike dhe format e lidhjes gramatikore me gjymtyrën e plotësuar prej saj. Duhet të merren parasysh në raste të caktuara dhe shprehja morfologjike si dhe kuptimi leksikor i gjymtyrës së plotësuar, e po ashtu dhe i vetë gjymtyrës së dytë të dhënë.

Në të dyja gjuhët kundrina mund të jetë një gjymtyrë e detyrueshme ose fakultative.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane, ashtu si dhe kundrina e drejtë në atë shqipe, shpreh zakonisht një objekt, një send, ndërsa kundrina e rasës dhanore dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë shpreh zakonisht një qenie të gjallë, një njeri. Kjo vihet re dhe në rastin kur kemi në një fjali në të njëjtën kohë dy kundrina, dhe të rasës kallëzore dhe dhanore ose të drejtë dhe të zhdrejtë pa parafjalë, përdoret kundrina e drejtë për të shprehur send dhe kundrinën e zhdrejtë pa parafjalë për të shprehur qenie të gjallë.

Kundrina në të dyja gjuhët sundohet zakonisht nga folje e më rrallë nga mbiemra.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe kundrina e drejtë në gjuhën shqipe, është kundrina që haset më shpesh në të dy gjuhët.

Ashtu si kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe kundrina e drejtë në gjuhën shqipe shprehen me anë të një gjymtyrë në rasën kallëzore. Duke qenë një gjymtyrë në

rasën kallëzore, në të dy gjuhët mund të gjendet me pyetjen “wen/ kë?” për frymorët dhe “was/ çfarë? për sendet”.

Në gramatikën me orientim nga përmbajtja si dhe në disa tekste gramatikore të gjuhës gjermane, në klasifikimin semantik që i bëhet kundrinave, kundrina e rasës kallëzore klasifikohet dhe si kundrinë e drejtë e madje në disa raste njehsohet me të, duke qenë se përkufizohet si gjymtyra, e cila përfaqëson zakonisht objektin e prekur direkt nga një veprim ose një ndodhi, dmth nga veprimi i foljes. Në përkufizimin e kundrinës së drejtë në të dy gjuhët ndërthuren kriteret semantike (të prekurit në mënyrë të drejtpërdrejtë) me ato sintaksore (raporti i ngushtë sintaksor me foljen).

Në të dyja gjuhët ato shprehin përgjithësisht të njëjtat nuanca semantike, si p.sh: një frymor ose send që preket nga një veprim ose mbi të cilin bie veprimi, një frymor, për të cilin dëshmohet diçka rreth gjendjes së tij trupore dhe shpirtërore, kuptimin e një shprehjeje foljore, atë çka zotëron dikush, një gjendje, një veçori ose një funksion, që ka dikush etj.

Gjithashtu, në rrafshin semantik, në gjuhën gjermane bëjmë dhe dallimin ndërmjet kundrinës së brendshme dhe asaj të shkakut, të cilat përkojnë respektivisht me kundrinën me karakter tautologjik dhe kundrinën e brendshme në gjuhën shqipe dhe asaj të ndikimit në gjuhën gjermane, e cila përkon me kundrinën e të jashtme në gjuhën shqipe.

Kundrina e brendshme në gjuhën gjermane apo kundrina me karakter tautologjik në gjuhën shqipe, përsërit në formë emërore atë çka është shprehur nga folja. Kundrina dhe folja në këtë rast kanë të njëjtën rrënjë fjalëformuese, ose rrënjë fjalëformues të lidhura ngushtësisht semantikisht mes tyre.

Kundrina e shkakut në gjuhën gjermane përkon me kundrinën e brendshme në gjuhën shqipe. Në këtë rast objekti i përcaktuar nga kundrina egziston në sajë të veprimit të kryer nga folja, dmth është rezultat i veprimit të shprehur prej saj.

Kundrina e rasës kallëzore e ashtuquajtur e ndikimit sipas funksionit semantik në gjuhën gjermane, përkon me kundrinën e jashtme në gjuhën shqipe. Objekti i përcaktuar nga kundrina në këtë rast pëson një ndryshim me anë të veprimit të shprehur nga folja. Gjithashtu vërehet se objekti i përcaktuar nga kundrina egziston që më parë, panvarësisht veprimit të shprehur nga folja.

Karakteristikë e kundrinës së rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe e asaj të drejtë në atë shqipe është kthimi i saj në kryefjalë, kur folja që plotëson ajo shndërrohet në pësore. Gjithashtu në të dyja gjuhët këto kundrina bëhen përcaktor të rasës gjinore (Genitivattribut) në rastin e emëzimit të foljes së fjalisë.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe ajo e drejtë në gjuhën shqipe, zakonisht sundohet nga folje. Ashtu si kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane, dhe ajo e drejtë në atë shqipe shpesh hasen me folje të caktuara kalimtare.

Kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane dhe ajo e drejtë në gjuhën shqipe, përcakton më shpesh një send sesa një frymor.

Në të dyja gjuhët, përkatësisht kundrina e rasës kallëzore dhe kundrina e drejtë munde të hasen së bashku me një kundrinë të rasës dhanore ose të zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe:

Gjithashtu në të dyja gjuhët, mund të ndeshet dhe së bashku me një kundrinë me parafjalë në gjuhën gjermane ose kundrinë të zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe.

Në gjuhën gjermane ashtu si dhe në atë shqipe, ka gjithashtu raste ku në të njëjtën fjali mund të hasen përkatësisht dy kundrina të rasës kallëzore ose dy kundrina të drejta.

Në të dyja gjuhët në aspektin morfologjik, të gjitha pjesët e ligjëratës dhe togefjalëshat që shfaqen si kryefjalë mund të kryejnë funksionin e kundrinës së rasës kallëzore ose atë të drejtë në gjuhën shqipe, meqë pjesët e ligjëratës mund të kryejnë funksione të ndryshme në fjali. Si në gjuhën gjermane dhe atë shqipe ajo mund të shprehet me emra, përemra, numërorë, pjesë të emëruara të ligjëratës, ndërtime foljore, togefjalësh, fjali të nënrenditur, ligjëratë të drejtë

Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe kundrina e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, shprehen me gjymtyrë në rasën dhanore. Duke qenë një gjymtyrë në rasën dhanore, në të dyja gjuhët mund të gjendet me pyetjen “wem?/kujt?”.

Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, përcakton më shpesh një frymor sesa një send. Në rastet kur përcakton një send ose abstrakt, varet përgjithësisht nga folje, të cilat shprehin një ngjarje ose gjendje.

Në gramatikën me orientim nga përmbajtja si dhe në disa tekste gramatikore të gjuhës gjermane kundrina e rasës dhanore përmendet dhe me termin e përdorur në gjuhën shqipe ‘kundrinë e zhdrejtë’ (indirektes Objekt’), e cilapërkufizohet si kundrinë që preket në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga veprimi i shprehur.

Gjithashtu semantikisht, kundrina e rasës dhanore dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë shprehin përgjithësisht të njëjtat ngjyime, si p.sh. vetën në dëm ose në dobi të së cilës kryefjala kryen veprimin (e quajtur dhanore e lirë komodi/ inkomodi në gjuhën gjermane), shënon zakonisht pritësin dhe mund të shprehë vetën së cilës i drejtohet veprimi(dhanore e lirë posesive në gjuhën gjermane), vetën së cilës i lihet apo i jepet diçka, vetën së cilës i kumtohet apo i shpallet diçka, vetën që ka të bëjë me diçka ose vetën së cilës i shkaktohet diçka, një frymor ose send, nga tërësia e së cilit, i referohemi vetëm një pjese, vetën që vëmë në dijeni, që e informojmë ose vetën me të cilën komunikojmë, etj..

Në të dyja gjuhët ajo shpreh zakonisht objekt të jashtëm, dmth objekt që ekziston pavarësisht veprimit.

Kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane si dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, sundohet zakonisht nga folje.

Ashtu si kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, zakonisht nuk pësojnë asnjë ndryshim gjatë kthimit të fjalisë në pësore.:

Në të dyja gjuhët këto kundrina kthehen në përcaktorë parafjalorë (Präpositionalattribut) gjatë emëzimit të foljes së fjalisë.

Njëlloj si kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe atë të zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, mund ta ndeshim në një fjali përkatësisht bashkë me një të rasës kallëzore dhe/ ose kundrinë me parafjalë si dhe kundrinë të drejtë, ku kjo e fundit shpreh një send ndërsa kundrina e zhdrejtë frymor dhe/ ose kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë.

Në të dyja gjuhët kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe mund të shprehet me emër, përemër, togfjalësh, pjesë të emëruar të ligjëratës fjali të nënrenditur.

Ndryshe nga llojet e tjera të kundrinave, si në rastin e fjalive me kundrinë me parafjalë në gjuhën gjermane ashtu edhe në rastin e fjalive me kundrinë të zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe, folja nuk përcakton një rasë por një parafjalë të caktuar. Në këtë rast parafjala ka një funksion të ngjashëm me atë të rasës, dmth kundrina me parafjalë apo ajo e zhdrejtë me parafjalë pasohet nga eptimi i një rase të caktuar, që nuk varet direkt nga folja, por jepet me ndihmën e një parafjale.

Në të dyja gjuhët në raste shumë të rralla në kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane si dhe ajo e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe mund të drejtohet nga një mbiemër.

Në të dyja gjuhët kundrina me parafjalë dhe ajo e zhdrejtë me parafjalë gjenden me anë të përemrave pyetës të shoqëruar me parafjalën përkatëse: “Për kë? Me kë? Me çfarë?” në gjuhën shqipe dhe ‘wen/ kë’ apo ‘wem/ kujt’ në rastet kur emri i kundrinës me parafjalë përcakton një frymor në gjuhwn gjermane.

Në të dyja gjuhët këto kundrina mund të shprehen me emër të shoqëruar me parafjalë, përemër të shoqëruar me parafjalë, pjesë të emëruar të ligjëratës, togfjalësh të shoqëruar me parafjalë, fjali të nënrenditur.

Kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane, ashtu si kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe, mund të kthehet në përcaktorë gjatë emëzimit të foljes së fjalisë.

Ashtu si kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane dhe kundrina e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe, qëndron si rregull e pandryshuar gjatë shndërrimit të fjalisë në pësore.:

Gjithashtu në të dy gjuhët ato mund të shfaqen në fjali e vetme, apo bashkë me kundrina të tjera, përkatësisht kundrinë të rasës kallëzore ose me kundrinë të drejtë, kundrinë të

rasës dhanore ose kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë, kundrinë me parafjalë ose kundrinë të zhdrejtë me parafjalë

Në të dyja gjuhët është gjithashu e mundur që kundrina me parafjalë ose ajo e zhdrejtë me parafjalë të zëvendësohen përkatësisht nga një kundrinë rase (kallëzore, dhanore ose gjinore) në gjuhën gjermane dhe anasjelltas si dhe nga një kundrinë e drejtë ose e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Në të dyja gjuhët, kundrina me parafjalë dhe kundrina e zhdrejtë me parafjalë mund të ngatërrohet lehtësisht me rrethanorin.

Përsa i rendit të fjalëve, mund të thuhet se si në gjuhën gjermane, ashtu dhe në atë shqipe, rendi i fjalëve është një nga mjetet më të rëndësishme sintaksore, që në kuadrin e thënies, kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm dhe kryen funksione të ndryshme kumtesore, stilistikore e gramatikore. Lidhur me këto funksione duhet pranuar në mënyrë relative dhe fakti se gjuha shqipe ka rend të lirë të fjalëve.

Rendi i gjymtyrëve në të dyja gjuhët kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm dhe kryen në fjali disa funksione. Kriter bazë për renditjen e gjymtyrëve në fjali në gjuhën gjermane dhe atë shqipe është kryesisht vlera e përmbajtjes së informacionit që duam të përcjellim. Ashtu si në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe megjithëse rendi i gjymtyrëve në fjali është kryesisht i lirë, pra gjymtyrët mund të qëndrojnë në pozicione të ndryshme në fjali, ekzistojnë dhe disa rregulla dhe gjithashtu disa përjashtime.

Ndryshimet:

Hartimi i gramatikave në përgjithësi dhe i sintaksës në veçanti në gjuhën gjermane daton shumë më herët se në gjuhën shqipe. Për këtë arsye kundrina si njësi gramatikore në gjuhën gjermane ndeshet në gramatikat e fillimit të shekullit 19, ndërsa në gjuhën shqipe një shekull më vonë, në fillim të shekullit 20. Përsa i përket termit të përdorur për kundrinën, vërehet se në dy gjuhët fillimisht janë përdorur terma të tjerë nga këta që ndeshen sot.

Përsa i përket klasifikimit të mëtejshëm të kundrinës në gramatikën tradicionale, vihet re një ndryshim thelbësor mes dy gjuhëve. Në gjuhën gjermane mesa shihet përparësi i jepet aspektit gramatikor, ndërsa në gjuhën shqipe atij semantik. Kjo vërehet në terminologjinë e përdorur në dy gjuhët.

Kështu në gjuhën gjermane kundrina në gramatikën tradicionale, sipas kriterit formal gramatikor të rasës, në kundrinë të rasës kallëzore, kundrinë të rasës gjinore, kundrinë të rasës dhanore dhe kundrinë me parafjalë. Këtë ndarje e gjemë tek Schulz/ Grizbah, Helbig, Duden, Kadzadej, Henshel/ Veid, etj. Por ajo ndeshet dhe në gramatikën e Myderrizit dhe Rrotës në gjuhën shqipe, të cilët e ndajnë kundrinën në kundrinë të rasës kallëzore dhe kundrinë të rasës dhanore.

Ndërsa në gjuhën shqipe, kundrina ndahet në bazë të aspektit semantik në të drejtë e të zhdrejtë. Këtë ndarje në gjuhën shqipe e vërejmë për herë të parë tek Xanoni, e më tej tek të gjithë gjuhëtarët e tjerë të gramatikës tradicionale të gjuhës shqipe si Xhuvani, Sheperi, Rrota, Myderrizi, Cipo, Prifti, Përnaska, etj.. Kjo ndarje vërehet dhe tek gramatika e Çelikut megjithëse kjo gramatikë, bazohet në teorinë e valencës. Por kjo ndarje përmendet dhe në disa gramatika tradicionale, të gjuhës gjermane, si p.sh. ajo e Henshel/ Veid, Kyrshner e Linke/ Nusbaumer/ Portman. Ky është gjithashtu dhe klasifikimi tipik i gramatikës me orientim nga përmbajtja në gjuhën gjermane e cila e ndan kundrinën në të drejtë e të zhdrejtë.

Një tjetër ndarje e kundrinës sipas aspektit semantik është dhe ajo në kundrinë e brendshme dhe e jashtme, të cilën e ndeshim rrallë në gjuhën gjermane, ndërsa në gjuhën shqipe u pa për herë të parë tek Sheperi e më tej tek Cipo, Prifti e Përnaska. Në gjuhën gjermane në gramatikat e hulumtuara për këtë punim u ndesh vetëm tek Henshel/ Veid.

Një tjetër ndryshim në gramatikat e dy gjuhëve, që bie veçanërisht në sy është se gjuhëtarët e ndryshëm të gjuhës gjermane, veçanërisht ata të shekullit 19 dhe 20 si Humboldi, Grimi, Bekeri, por dhe më vonë në gramatikat gjenerative të bazuara në teorinë e Çomskit etj., e shihnin gramatikën dhe i interpretonin faktet gjuhësore/ gramatikore të lidhura ngushtë me filozofinë dhe sociologjinë, duke përfshirë ndër të tjera dhe ndikimin e shoqërisë në gjuhësi. Gjithashtu metoda historike krahasuese e gjuhëve zinte vend qendror në gramatikat e gjuhës gjermane të shekullit 19. Këto aspekte nuk shihen në gramatikat e gjuhës shqipe. Këto të fundit merren vetëm me aspektet gjuhësore gramatikore.

Gjithashtu vërehet se teorinë e ndryshme gramatikore nuk zhvillohen paralelisht në të njëjtin hark kohor në të dy gjuhët. Vihet re se gramatikat e gjuhës gjermane në të njëjtin hark kohor janë më të 'përparuara', përse i përket koncepteve dhe teorive të reja gramatikore. Madje teori të ndryshme, si psh. ajo e gramatikës me orientim nga përmbajtja nuk trajtohen fare në gjuhësinë shqiptare. Dhe përse i përket teorive më të fundit si psh. ajo e valencës dhe dependencës dhe ajo gjenerative të trajtuara në këtë punim, vërehet se në gjuhën shqipe ato janë lëvruar shumë më vonë se në gjuhën gjermane dhe nga shumë pak gjuhëtarë. Në gjuhën shqipe ndryshe nga ajo gjermane dominon trajtimi tradicional i sintaksës. Ndërsa në gjuhën gjermane vërehet se përgjithësisht gjuhëtarët në vitet e fundit, bazohen tek gramatika e valencës dhe dependencës dhe tek ajo gjenerative.

Kundrina në gramatikën tradicionale të gjuhës gjermane konsiderohet si gjymtyrë kryesore e fjalisë. Në këtë mënyrë, kundrinën në gjuhën gjermane i jepet një rëndësi e veçantë, duke e vendosur në një rang me kryefjalën dhe kallëzuesin. Ndërsa në gramatikën tradicionale të gjuhës shqipe, gjymtyrë kryesore të fjalisë konsiderohen vetëm kryefjala dhe kallëzuesi, që shihen si baza e fjalisë. Kundrina së bashku me rethanorin dhe përcaktorin, si gjymtyrë të dyta. Kundrina konsiderohet si gjymtyra e

dytë më e rëndësishme, duke qenë se konsiderohet shpeshherë si e domosdoshme për kuptimin dhe plotësimin strukturor të fjalisë. Emërtimin gjymtyrë të dyta në gjuhën shqipe e kanë jo për peshën që ato kanë në kuptimin e dhënë, por për shkak të të rolit që ato luajnë në organizimin e fjalisë, duke qenë se janë të varura nga gjymtyrë të tjera, të cilat i plotësojnë dhe përcaktojnë më nga afër. Në gjuhën gjermane gjymtyrë të dyta konsiderohen gjymtyrët që nuk përcaktohen nga kallëzuesi dhe nuk i përkasin strukturës bazë së fjalisë. Tek gjymtyrët e dyta në gjuhën gjermane bëjnë pjesë disa emra në rasën dhanore, ndër to disa dhanore të lira, si dhe përcaktori kallëzuesor. Përcaktori në gjuhën gjermane nuk konsiderohet si në gjuhën shqipe si gjymtyrë më vete, por si pjesë e gjymtyrës që përcakton më nga afër.

Tipike për përcaktimin e gjymtyrëve të fjalisë në gramatikën tradicionale në gjuhën gjermane, janë provat e frymëzuara nga Glinci, ku dy më të rëndësishmet konsiderohen prova e zëvendësimit (Ersatzprobe) dhe ajo e spostimit (Verschiebeprobe). Po t'i plotësojë këto dy kushte gjymtyra është gjymtyrë fjalie.

Në gjuhën shqipe janë të shumta rastet e ndërmjetme mes kundrinës e përcaktorit. Ndërsa në gjuhën gjermane mund të shfaqen vështirësi në disa raste dhe në dallimin mes kundrinave dhe gjymtyrëve të tjera të dorës së dytë, siç janë dhanoret e lira apo kallëzuesori kundrinor

Gjithashtu ndryshime vërehen dhe në mënyrën e përkufizimit të kundrinës në të dy gjuhët. Kështu për gjuhën gjermane në tekste të ndryshme gramatikore, të bazuara në gramatikë tradicionale ajo përkufizohet si vijon:

Sipas fjalorit njëgjuhësh Wahrig kundrina në gjuhën gjermane, përkufizohet si pjesë e fjalisë, e cila është një plotës emëror i kallëzuesit, marrë nga latinishtja ' obiectum', pjesorja e shkuar e ' obicere' "të vendosësh përballë".⁴⁶¹

Në leksikun e shkencës së gjuhësisë nga Bussmann jepet një tjetër shpjegim për termin 'kundrinë, i cili përcaktohet si termi i përmbledhur për shumë funksione sintaksore në gjuhët si gjermanishtja, anglishtja, që në varësi të llojit të gjuhës ndonjëherë dallohet ana morfologjike (nëpërmjet rasës obliquus) ose nga pozicioni (nëpërmjet pozicionimit të kryefjalës) dhe sipas rregullit karakterizon vetën ose rrethanën, me të cilën lidhet veprimi (përcaktuar nga folja).⁴⁶²

Sipas Shulc/ Griesbah⁴⁶³, Kundrina janë të gjitha rolet e përshkrimit të situatës që nuk janë kryefjalë. Situata = Ngjarje/ gjendje + rolet. Numri i kundrinave, një, ose dy kundrina, përcaktohet nga ngjarja dhe nga folja që përcakton ngjarjen.

⁴⁶¹Wahrig, *Deutsches Wörterbuch*, München 2006, f.1086)

⁴⁶²Bußmann., H „Lexikon der Sprachwissenschaft" Stuttgart 1983, f. 540-541

⁴⁶³ Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996, f. 336

Sipas Helbig⁴⁶⁴, kundrina është një grup emëror ose parafjalor, i cili është i detyrueshëm ose fakultativ dhe varet nga kallëzuesi. Në aspektin morfologjik shprehet me një emër në rasën kallëzore, dhanore, gjinore ose me një parafjalë + emër, ose me anë të përemrit vetor përkatës.”

Sipas Henshel Veidt⁴⁶⁵, kundrina i qëndron përballë kryefjalës në filozofi si dhe në gramatikë si objekt i perceptimit, njohjes, mendimit dhe veprimit. Kundrina në gramatikë lidh synimin direkt ose indirekt të veprimit të shprehur nga folja. Tek gjuhët me fleksion qëndron në një rasë oblique, e cila drejtohet ose direkt nga folja, ose me ndihmën e një parafjale, në rastin e fundit kemi të bëjmë me kundrinë me parafjalë.

Sipas Zomerfeld/ Shtarke, kundrina është një gjymtyrë, pjesë e lidhjes së kallëzuesit (Prädikatsverband), rasa e së cilës (kallëzore, dhanore, rrallë gjinore) ose parafjala përcaktohet me anë të sundimit (Reksion).⁴⁶⁶

Ndërsa në tekste të ndryshme gramatikore të gjuhës shqipe, bazuar në të njëjtën teori gramatikore, gjejmë përkufizimet e mëposhtme:

Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe të Akademisë së Shkencave, kundrina është gjymtyrë e dytë e fjalisë, mbi të cilën bie veprimi i foljes që shërben si kallëzues.⁴⁶⁷

Sipas sintaksës së gjuhës shqipe të Akademisë së shkencave, kundrinat janë gjymtyrë të dyta me të cilat shprehen raporte objektore në mes një veprimi a tipari dhe objektit të tij, zakonisht ndërmjet një emri a një fjale tjetër emërore, të lidhur me drejtim me një folje a mbiemër. Më së shumti ato shënojnë objektin e veprimit që shpreh folja.⁴⁶⁸

Tek Prifti, ajo përkufizohet si gjymtyra e varur e fjalisë së zgjeruar, tregon sendin mbi të cilin bie direkt ose tërthorazi veprimi i gjymtyrës nga e cila varet.⁴⁶⁹

Sipas Gjuha shqipe 3⁴⁷⁰ kundrina trajtohet si gjymtyrë e dytë e fjalisë që varet zakonisht nga gjymtyrë të shprehura me folje dhe me mbiemra, me të cilët vihet në marrëdhënie objektore (kundrinore).

Klasifikimi dhe përkufizimi i kundrinës si u nënvizua më sipër në gjuhën gjermane ashtu dhe në atë shqipe varet nga faktorë morfologjik dhe semantikë. Por duke u nisur

⁴⁶⁴ Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993, f. 111

⁴⁶⁵ Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990, f.325

⁴⁶⁶ Sommerfeld, Karl- Ernst/ Starke, Günter: *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen 1998, f. 211

⁴⁶⁷ Akademia e Shkencave të Shqipërisë, “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë 1980

⁴⁶⁸ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, II, Sintaksa, Tiranë, 2002, f. 209

⁴⁶⁹ Prifti, Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1972, f. 109

⁴⁷⁰ Gjuha shqipe 3, f. 41

dhe nga përcaktimi kundrinë e rasës kallëzore (Akkusatiobjekt), kundrinë e rasës dhanore (Dativobjekt) dhe kundrinë e rasës gjinore, (Genitivobjekt), rezulton se në gjuhën gjermane dominon më shumë faktori gramatikor morfologjik, ndërsa në gjuhën shqipe kundrinë e drejtë dhe e zhdrejtë, dominon më shumë ai semantik.

Në gjuhën gjermane kemi dhe fenomenin gramatikor të sundimit (Reksion) të foljeve, pra që folje të caktuara kërkojnë një rasë të caktuar. Shumica e foljeve në gjuhën gjermane sundojnë rasën kallëzore, por ka dhe folje që sundojnë rasën atë dhanore ose gjinore, si dhe folje që sundojnë dy rasa, zakonisht atë kallëzore ose dhanore. Gjithashtu ka dhe parafjalë që bashkë me folje të caktuara kërkojnë një rasë të caktuar.

Në ndryshim nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe, në raste të rralla, kundrina mund të sundohet dhe nga një emër ose ndajfolje.

Në ndryshim nga gjuha shqipe, në gjuhën gjermane egziston dhe një kundrinë e katërt, ajo e rasës gjinore. Ndërsa në gjuhën shqipe, një dukuri gramatikore, e cila nuk egziston në gjuhën gjermane, është ajo e shenjimit të kundrinës së drejtë e të zhdrejtë të gjuhës shqipe me trajta të shkurtra të përemrit vetor

Përveç pyetjeve të përbashkëta, kundrina e drejtë në gjuhën shqipe, mund të gjendet dhe me pyetjet “cilin?”, “cilën?”.

Në gjuhën shqipe, në raste të rralla kur kemi të bëjmë me kundrinë të drejtë të brendshme kemi folje jokalistare. Ndërsa në gjuhën gjermane në raste të rralla kur kundrina e rasës kallëzore nuk kthehet në kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësore, folja është e mesme relative ose ndryshe quhet pseudo- kalimtare . Në gjuhën gjermane egziton një listë foljesh të cilat kërkojnë vetëm rasën kallëzore. Një numër i vogël foljesh i pranon të dyja rasat, si atë dhanore dhe kallëzore. Një numër i vogël foljesh pranon dy rasa: dhanore dhe kallëzore, kallëzore dhe gjinore, si dhe rasën kallëzore dhe parafjalë. Në gjuhën gjermane ka dhe folje që mund të marrin kundrinë të dyfishtë të rasës kallëzore. Në këtë rast, kundrina që shpreh frymor vendoset përpara asaj që shpreh send.

Në gjuhën gjermane kundrina e rasës kallëzore, në raste të rralla mund të sundohet nga mbiemra, ndërsa kundrina e drejtë në gjuhën shqipe mund të sundohet nga emra.

Ndryshe nga gjuha shqipe, kundrina e drejtë në gjuhën gjermane në raste të rralla mund të shprehet dhe me anë të një gjymtyre në rasën dhanore.

Në ndryshim nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe, kundrina e drejtë mund të shoqërohet me trajtë të shkurtër në disa raste. Kjo do të thotë se mund të shprehet nga një trajtë e shkurtër në rasën kallëzore, dukuri e cila në gjuhën gjermane nuk ekziston.

Trajta e shkurtër e kallëzores përdoret përgjithësisht në rastet kur :

- Kundrina e drejtë i përket temës por nuk mban theksin kryesor të fjalisë.

- Kur emri bërthamë i grupit emëror është një përemër dëftor i vetës së tretë që shpreh një frymor apo një send, të cilat janë të njohura për shkaqe konstitutive dhe kontekstuale.

Rrethanat e përdorimit të kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër varen më së shumti nga veçoritë gramatikore të kundrinës dhe nga kushtet e procesit të komunikimit, veçanërisht nga lidhjet me kontekstin. Këto vërehen mbi të gjitha në lidhjen e ngushtë midis kundrinës së drejtë të shprehur me trajtë të shkurtër, ndarjes temë-remë dhe intonacionit.

Nga ana tjetër një veçori që nuk ndodh në gjermanisht është se kundrina e drejtë në raste të veçanta mund edhe të eliminohet.

Në gjuhën gjermane ashtu si dhe në atë shqipe, ka gjithashtu raste ku në të njëjtën fjali mund të hasen përkatësisht dy kundrina të rasës kallëzore ose dy kundrina të drejta. Në rastin kur ndeshim dy kundrina të drejta në gjuhën shqipe, njëra kundrinë e drejtë shenjohehet nga trajta e shkurtër përemrit vetor.

Në ndryshim nga gjuha shqipe, një kundrina e rasës kallëzore në gjuhën gjermane mund të kombinohet edhe me një kundrinë të rasës gjinore.

Kundrina në gjuhën gjermane mund të shprehet me përemra vetor dhe reflektiv, ndërsa në gjuhën shqipe mund të shprehet me të gjithë llojet e përemrave.

Në ndryshim nga gjuha shqipe, në gjuhën gjermane, kundrinën e rasës kallëzore e ndeshim të shprehur me korrelatin “es”(faktin që). Korrelatin ‘es’ mund ta ndeshim në paskajoret e zgjeruar por dhe në fjalitë e nënrenditura. Në të dyja rastet korrelati është shumë i rrallë dhe ndeshet në disa folje të veçanta që shprehin një gjendje emocionale, si p.sh: *urrej, ndjej neveri, më vjen keq, dua, parapëlqej, etj..*

Kundrina e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, shprehet gjithmonë me një gjymtyrë në rasën dhanore, ndërsa në gjuhën gjermane përveç kundrinës së rasës dhanore, mund të jenë kundrina të zhdrejta dhe disa kundrina të rasës gjinore dhe kundrina me parafjalë. Një ndryshim tjetër është dhe ndarja e kundrinës së zhdrejtë në gjuhën shqipe, në kundrinë të zhdrejtë pa parafjalë dhe kundrinë të zhdrejtë me parafjalë.

Në ndryshim nga njëra tjetra, kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane mund të sundohet dhe nga një mbiemër, ndërsa ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe mund të sundohet nga një emër.

Qëllimi i kësaj vepre ishte shpëtimi dhe dhënia brezave që vijnë, i fjalëve e i teksteve shqipe.

Në raste shumë të rralla, gjatë kthimi të fjalisë në pësore, kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane kthehet në kryefjalë. Bëhet fjalë për një formë të veçantë të kthimi të fjalisë në pësore, të quajtur ‘Rezipientenpassiv’, i cili realizohet me ndihmën e foljes *bekomen/ marr*.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm mes kundrinës rasës dhanore në gjuhën gjermane dhe asaj të zhdrejtë në gjuhën shqipe, është dhe është fakti se kundrina e zhdrejtë pa parafjalë shenjohe gjithmonë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor.

Gjithashtu në ndryshim nga gjuha gjermane, njëlloj si kundrina e drejtë dhe ajo e zhdrejtë pa parafjalë në gjuhën shqipe, mund të eliminohet në raste të caktuara. Dhe në këtë rast kemi shenjimin e saj me trajtë të shkurtër të përemrit vetor.

Në gjuhën shqipe kundrina e zhdrejtë pa parafjalë mund të shprehet me të gjithë llojet e përemrave, ndërsa kundrina e rasës dhanore në gjuhën gjermane mund të shprehet vetëm me përemra vetorë.

Një dukuri gramatikore, e cila nuk egziston në gjuhën gjermane, është ajo e shenjimit të kundrinës së drejtë e të zhdrejtë të gjuhës shqipe me trajta të shkurtra të përemrit vetor.

Shenjimi i kundrinës, është një dukuri sintaksore e cila në rafshin morfologjik shprehet me anë të vendosjes së një shenjuesi pranë foljes që lidhet me kundrinën. Shenjuesit e kundrinës reflektojnë disa karakteristika të caktuara të kundrinës, atë të rasës (shenjuesit e kundrinës dalin në rasën kallëzore si reflektim i kundrinës së drejtë, dhe në rasën dhanore si reflektim i kundrinës së zhdrejtë) si dhe karakteristika të numrit dhe gjinisë. Prania e kundrinës së drejtë, dhe të zhdrejtë pa parafjalë shenjohe zakonisht nga trajta e shkurtër e përemrit vetor, që vihet menjëherë para ose pas foljes, në kushte të caktuara edhe midis temës e mbaresës vetore të foljes.

Më konkretisht prania e kundrinës së drejtë të shprehur me emër, përemër a togfjalësh zakonisht shenjohe me anë të trajtës së shkurtër të përemrit vetor të vetës së parë e të dytë njëjës e shumës në rasën kallëzore.

Vetëm në kushte të caktuara ligjërimore prania e kundrinës së drejtë nuk shenjohe nga trajta e shkurtër e përemrit vetor. Ndërsa prania e kundrinës të zhdrejtë pa parafjalë shenjohe në çdo situatë ligjërimore me anë të trajtës së shkurtër të përemrit vetor.

Trajta e shkurtër e përemrit vetor është e pranishme edhe kur situata konkrete e ligjërimit ose konteksti e bëjnë të panevojshme praninë e vetë kundrinës së drejtë e asaj të zhdrejtë:

Ndonjëherë prania e një trajte të shkurtër të përemrit vetor të vetës së parë ose të dytë, është vetëm mjet i përdorur për qëllime stilistikore, për t'i dhënë më gjallëri ligjërimit nëpërmjet lidhjes së veprimit me subjektet e tjerë; është dhanorja e quajtur nga disa studiues “dhanore etike”. Ajo gjen përdorim zakonisht në gjuhën popullore dhe në letërsinë artistike.

Nëse në një fjali gjejmë njëkohësisht një kundrinë të drejtë e një të zhdrejtë, kemi gjithmonë të pranishëm një shenjues të kundrinës të rasës dhanore. Por nëse edhe kundrina e drejtë i përmbush kriteret për shenjimin e saj me një trajtë të shkurtër, atëherë

kemi praninë njëkohësisht të dy shenjësve të kundrinave, një shenjës të kundrinës në rasën dhanore dhe një në rasën kallëzore:

Në rastin e kundrinës më parafjalë, ndryshimi kryesor mes dy gjuhëve është se në gjuhën gjermane këtë parafjalë nuk mund ta zgjedhim, por është e lidhur direkt me foljen ose mbiemrin në raste të rralla, p.sh. **denken an** etwas/ jemanden/ të mendosh për diçka/ dikë; **achten auf** etwas/ jemanden/ të kujdesesh për diçka/ dikë; **Angst haben vor** etwas/ jemandem/ të kesh frikë nga diçka/ dikush; **sich fürchten vor** etwas/ jemandem/ të trembesh nga diçka/ dikush. Një numër i vogël foljesh në gjuhën gjermane lejojnë zgjedhjen mes dy parafjalëve.

Në gjuhën gjermane dallojmë kundrinë me parafjalë në rasën kallëzore dhe dhanore, ndërsa në gjuhën shqipe dallojmë kundrinë të zhdrejtë me parafjalë ose shprehje parafjalore në rasën emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore. Vlen të theksohet se gjuha shqipe është e vetmja gjuhë indoevropiane që sundon parafjalë në rasën emërore.

Kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane sundohet nga folje jokalmtare relative, ndërsa ajo e zhdrejtë me parafjalë në gjuhën shqipe plotëson një folje kalimtare ose jokalmtare, në formën veprorë ose joveprorë.

Në ndryshim nga gjuha gjermane, në gjuhën shqipe kundrina e zhdrejtë me parafjalë në raste të rralla mund të drejtohet nga një emër prejfoljor ose nga një ndajfolje.

Në ndryshim nga gjuha shqipe, në gjuhën gjermane, në rastet kur emri i kundrinës me parafjalë përcakton një send apo abstrakt, pyetja analitike që shërben për identifikimin e saj, bëhet me anën e një ndajfolje pronominale.

Në rastin kur kundrina me parafjalë në gjuhën gjermane shprehet me një fjali të nënrenditur ose ndërtim paskajorë, parafjala e kërkuar nga folja zhduket. Në këtë rast, kemi shpesh praninë e korrelatit të shprehur me ndajfolje pronominale **da(r)**, i cili sipas rastit mund të jetë i detyrueshëm ose fakultativ.

Në gjuhën gjermane, në rastet kur emri i kundrinës me parafjalë i referohet një sendi apo abstrakti emri i kundrinës me parafjalë mund të zëvendësohet me një 'Pronominaladverb'/ ndajfolje pronominale, ndërsa në gjuhën shqipe zëvendësohet nga përemri vetor.:

Në gjuhën shqipe, kundrina e zhdrejtë me parafjalë mund të kthehet në kryefjalë gjatë kthimit të fjalisë në pësorë.

Në gjuhën gjermane në ndryshim nga gjuha shqipe egziston dhe kundrina e rasës gjinore. Kjo kundrinë shprehet me anë të një emri, përemri, togfjalëshi, pjesë të tjera të emëruara të ligjëratës në rasën gjinore, ose fjali të nënrenditur. Ajo gjendet me anë të pyetjes analitike 'wessen'/ kujt.

Në ditët e sotme kjo kundrinë gjen përdorim mjaft të rrallë. Ajo sundohet nga folje jokalmtare relative. Ashtu si tri kundrinat e tjera të gjuhës gjermane, kundrina e rasës

gjinore përveç se nga folja, mund sundohet dhe nga një mbiemër. Atë mund ta ndeshim në stilin arkaik letrar, në gjuhën juridike, disa shprehje të ngurta si dhe në disa ndërtime refleksive. Ajo zëvendësohet shpesh nga kundrina e rasës kallëzore ose ajo me parafjalë.:

Kundrina e rasës gjinore nuk pëson asnjë ndryshim gjatë kthimit të fjalisë në pësore, ndërsa në rastin e emëzimit të foljes së fjalisë, kundrina e rasës gjinore kthehet në përcaktor parafjalor.

Shpeshherë, kundrina e rasës gjinore mund të transformohet në një kundrinë me parafjalë. Ajo mund të shfaqet dhe së bashku me një kundrinë të rasës kallëzore. Në këtë rast kundrina e rasës kallëzore i referohet një frymori, ndërsa ajo e rasës gjinore një sendi.

Funksioni themelor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe është ai kumtues, pra shprehja e përbërësve të gjymtyrëzimit aktual të fjalisë, temës dhe remës. Në ligjërimin neutral, në çdo fjali të dhënë, gjymtyrët që bëjnë pjesë në temë vendosen në fillim, ndërsa gjymtyrët që bëjnë pjesë në remë vendosen në fund të fjalisë. Këtë funksion rendi i fjalëve e kryen së bashku me theksin logjik, si dhe me ndihmën e mjeteve të tjera me karakter leksikor e gramatikor. Në gjuhën shqipe shumica e tipave kumtues aktual ndërtohen me rend fjalësh neutral (temë – remë), çka tregon qartë rolin e rëndësishëm kumtues të rendit të fjalëve.

Funksioni dytësor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe është ai stilistikor apo shprehës emocional, kur rendi i fjalëve nuk shërben më për të dalluar temën nga rema. Në këtë rast kemi rend afektiv apo shprehës emocional, joneutral me vendosje të anasjelltë të përbërësve të gjymtyrëzimit aktual (remë-temë). Ky funksion vihet re më tepër në stilin bisedor.

Rëndësi të veçantë në gjuhën shqipe veçanërisht në ligjërimin me shkrim luan dhe roli gramatikor i rendit të fjalëve, kur ai ndihmon për të përcaktuar funksionet sintaksore të gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Në këtë rast mund të flitet për rend të ngulitur të fjalëve. Mund të themi se rend të ngulitur në gjuhën shqipe kanë përgjithësisht në disa raste disa gjymtyrë të shkallës së dytë, (ku përfshihet dhe kundrina) që vendosen pranë gjymtyrëve nga të cilat varen. Gjithashtu në rastet kur ato mund të zënë dy pozicione, vendosja konkrete aktuale përcaktohet nga arsye kumtuesore e stilistikore, po edhe nga arsye kuptimore e strukturore. Në raste më të rralla është i detyrueshëm rendi i drejtë i gjymtyrëve edhe për arsye gramatikore, për të dalluar funksionet sintaksore të formave homonime.

Kur në një fjali të thjeshtë dëftore në gjuhën shqipe kemi praninë e një kundrine, qoftë kundrinë e drejtë, kundrinë e zhdrejtë, apo kundrinë e zhdrejtë me parafjalë janë të mundur gjashtë variacione të rendit të gjymtyrëve të fjalisë. Për secilën prej këtyre gjashtë varianteve ekzistojnë përkatësisht disa tipa kumtues aktual, të cilat në bazë të vendosjes së temës dhe të remës mund të jenë neutral, ose shprehës emocional.

Për gjuhën shqipe, si një mjet i veçantë që ndihmon për të përcaktuar përbërësit e gjymtyrëzimit aktual, mund të shihet dhe prania e mosprania e trajtës së shkurtër përemërore të kallëzores, që shënon përkatësisht tematizimin ose rematizimin e kundrinës së drejtë. Rol të ngjashëm me atë të trajtës së shkurtër të kallëzores për shqipen luan dhe trajta e plotë e përemrave vetorë të vetës së parë e të dytë në funksionin e kundrinës e të kryefjalës.

Trajta e shkurtër në rastin e fjalive me kundrinë të drejtë e shenjon kundrinën e drejtë kur kjo e fundit përfaqëson temën, dhe anasjelltas nuk e shenjon kundrinën e drejtë kur kjo e fundit është remë e thënies. Në këtë mënyrë trajta e shkurtër është reflektim i karakterit tematik të kundrinës së drejtë dhe përbën një mjet të rëndësishëm shprehës në kuadër të gjymtyrëzimit aktual.

Ndërsa në rastin e kundrinës së zhdrejtë pa parafjalë kemi gjithmonë shenjim të saj me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, si kur kundrina e zhdrejtë është temë, ashtu dhe në rastin kur është remë e thënies.

Kushtet morfologjike luajnë një rol shumë të rëndësishëm veçanërisht në rendin e kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë në gjuhën gjermane, ndërsa për gjuhën shqipe nuk vlejné këto rregulla, psh. në rastin kur në gjuhën gjermane kundrina e zhdrejtë dhe ajo e drejtë shprehen me emra, rendi është i tillë : e zhdrejte/ e drejtë, ndërsa kur shprehen me përemra rendi është i kundërt: e drejtë/ e zhdrejtë. Në gjuhën shqipe nuk është e rëndësishme nëse kundrinat janë shprehur me emër apo përemër, por rendi i kundrinës së drejtë dhe asaj të zhdrejtë varen nga vlera e informacionit që dëshiron të përcjellë folësi apo shkruesi. Pra zakonisht tema vendoset para remës. Në raste të rralla kur duam ta theksojmë veçanërisht remën ajo mund të vendoset para temës në të dy gjuhët. Gjithashtu në dy gjuhët kundrina e zhdrejtë mund të vendoset para, ose pas kundrinës së drejtë, në varësi të asaj çka duam të theksojmë.

Ndryshe nga gjuha shqipe në atë gjermane ekziston dhe kundrina e rasës gjinore, e cila duke qenë e lidhur ngushtësisht me foljen renditet në fund të fjalisë para pjesës së dytë të kallëzuesit P2.

Dhe në rastin e kundrinës me parafjalë vërejmë disa ndryshime mes dy gjuhëve, p.sh. kundrinat me parafjalë në gjuhën gjermane kanë të veçantë sepse kallëzuesi i tyre kushtëzon parafjalën p.sh. warten auf. Kundrinat me parafjalë në gjuhën gjermane vendosen në fund të fjalisë, para pjesës së dytë të kallëzuesit P2, pamvarësisht nga vlera e informacionit që ato përçojnë, ndërsa në gjuhën shqipe vendosja e tyre është e lirë në varësi të vlerës së informacionit që synohet të përçohet.

Së fundi mund të thuhet se pavarësisht punës së palodhur për realizimin e këtij punimi, pavarësisht nga analizat strukturoro-semantike në të, ai nuk mund të jetë kurrsesi shterues, prandaj mbetem me bindjen se ka ende shumë punë për tu bërë. Gjithsesi do

ndiheshat vërtet e lumtur nëse i ka sjellë një ndihmesë sado të vogël studimit përfaqësues të kësaj kategorie sintaksore kaq të rëndësishme për organizimin e fjalisë.

Bibliografi

Abraham, Werner: Einleitung. – In: Abraham, Werner (Hg.): *Satzglieder im Deutschen. Vorschläge zur syntaktischen, semantischen und pragmatischen Fundierung.* – Tübingen: Narr, 1982, S. 7-39.

Abraham, Werner: *Die Unterscheidung von direktem und indirektem Objekt in den kasuslosen Sprachen und im Deutschen.* – In: Deutsch als Fremdsprache. Zeitschrift für Theorie und Praxis des Deutschunterrichts für Ausländer. 20/5, 263-270 1983.

Abraham, Werner: *Terminologie zur neueren Linguistik.* 2., völlig neu bearb. u. erw. Aufl. Bd. 2. – Tübingen: Niemeyer (Germanistische Arbeitshefte) 1988.

Agalliu, Fatmir: *Mbi një çështje të rendit të fjalëve.* - GjJ 8/1988, 2, 73-80.

Agani, H., *Ç'shoh të diskutueshme në "Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme, Fjala,* Prishtinë, 01.02.1975, f. 7; 15.02.1975, f. 7; 01.03.1975, f. 7; 15.03.1975, ff. 7-8.

Agani, H., *Përsiatje rreth një sinkretizmi në shqipe (Rasat gjinore, dhanore e rrjedhore në gjuhën shqipe), Fjala,* Prishtinë, 1976, 20, f. 7; 22, f. 7; 1977, 1, ff. 6-7.

Ajeti, Idriz, *Kërkime gjuhësore,* Prishtinë, 1978.

Ajeti, Idriz, *Për historinë e marrëdhënieve të hershme gjuhësore shqiptare-sllave.* SF 1972/4.

Ajeti, Idriz, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes,* I, Prishtinë, 1982.

Ajeti, Idriz, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes,* II, Prishtinë, 198.

Ajeti, Idriz, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes,* III, Prishtinë, 1985.

Ajeti, Idriz, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes,* IV, Prishtinë, 1992, 167 f.

Akademia e shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe,* II, Morfologjia, Tiranë, 1976, 400 f.; III,

Akademia e shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Sintaksa,* (Sintaksa e fjalisë), maket, 1, Tiranë, 1983, 241 f.; 2, Tiranë, 1983, 238 f.; III, Sintaksa (Sintaksa e periudhës), maket, 1, Tiranë, 1976, 246 f.; 2, Tiranë, 1976, 170 f.; 2, (Vijim), Tiranë, 1976, 295 f.

Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe,* I, Morfologjia, Tiranë, 1995, 452 f.;

Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe,* II, Sintaksa, Tiranë, 2002

Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Istituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe III, Sintaksa (I.sintaksa e fjalisë), (1989), ribotim Tiranë 2002

Akademia e shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Istituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, 2273 f.

Akademia e shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Istituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984, 1518 f.

Altmann, Hans; Hahnemann, Suzan: *Syntax fürs Examen, Studien Arbeitsbuch*, Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht 2007.

Bariq, Henrik. *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*. Prishtinë 1955.

Bausewein, Karin: *Akkusativobjekt, Akkusativobjektsätze und Objektsprädikate im Deutschen: Untersuchungen zu ihrer Syntax und semantic*, Tübingen: Nimeyer 1990.

Beci, Bahri: *Gramatika e Gjuhës Shqipe*, Tiranë: EDFA, 2004.

Becker, Karl Ferdinand: *Ausführliche deutsche Grammatik als Kommentar der Schulgrammatik*; Frankfurt am Main 1836

Becker, Karl Ferdinand: *Ausführliche deutsche Grammatik als Kommentar der Schulgrammatik*; Frankfurt am Main 1837

Becker, Karl Ferdinand: *Organism der Sprache*; Frankfurt am Main 1841

Blatz, Friedrich: *Neuhochdeutsche Grammatik mit Berücksichtigung der historischen Entwicklung der deutschen Sprache*; Bd. 1 Karlsruhe 1895; (Nachdruck: Hildesheim, New York 1970)

Blatz, Friedrich: *Neuhochdeutsche Grammatik mit Berücksichtigung der historischen Entwicklung der deutschen Sprache*. 3., völlig neubearbeitete Auflage 2. Bd.: Satzlehre (Syntax). – Karlsruhe 1896 (Nachdruck: Hildesheim, New York 1970).

Bokshi, Besim. *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*. Prishtinë 1984.

Bokshi, Besim, *Rruga e formimit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë 1980.

Bopp, Franz, *Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen*. Abhandl., d. Preuss. Akad.d.Wissenschaften. Phil. - hist. Kl. 1854.

Brani, Sh., *Për hir të qartësisë të përsëritet kundrina*, Rilindja, 19.08.1977, f. 13.

Brani, Sh., *Përsëritja e kundrinës me trajta të shkurtra, Çështje të normës letrare*, Prishtinë 1980, ff. 241-246.

Brugmann, Karl - Delbrück, Berthold, *Grundriß der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*. II. Band., III. Teil. Strassburg 1916.

Buchholz, Oda, *Zur Frage der Verdoppelung, der Objekte im Albanischen*, Actes du Premier Congrès International des Etudes Balkaniques et Sud-Est Européennes, VI, Linguistique, Sofia, 1968, ff.711-724.

Buchholz, Oda, *Zur Verdoppelung der Objekte im Albanischen*, Linguistische Studien, 34, Reihe A. Arbeitsberichte, Berlin, 1977, 227 f.

Buchholz, Oda, *Zu Verben, die durch ein Objekt und ein Objektprädikat ergänzt werden*, Linguistique balkanique, XX, Sofia, 1977, 1-2, ff. 147-159.

Buchholz, Oda, *Mbi gërshetmin e aspekteve morfologjike e sintaksore te rasat në gjuhën shqipe*, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filozofike, VII-1977, pp. 143-158.

Buchholz, Oda, Beyrer, A., Fiedler, Wielfried, Kostov, K., *Zur Rektion des Verben in den Balkansprachen*, Linguistische Studien, 43, Reihe A. Arbeitsterrichte, Berlin, 1977.

Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Zur Stellung der Objektzeichen in der albanischen Literatursprache der Gegenwart und bei Gjon Buzuku*, Akte des Internationalen Albanologischen Kolloquiums, Innsbruck 1972, Innsbruck 1977, ff.433-458.

Buchholz, Oda, Fiedler, Wielfried, *Albanische Grammatik*, Kröner Verlag, Leipzig, 1987, 582 f.

Bußmann, Hadumod: *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart 1983.

Buxheli, Ludmilla, *Togfjalëshat me parafjalën për në gjuhën shqipe*, Studime filologjike, 1977, N. 2, ff. 29-49.

Buxheli, Ludmilla, *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë 2007

Bünting, Karl- Dieter; Bergenholtz, Henning, *Einführung in die Syntax. Grundbegriffe zum lesen eine Grammatik*, 3.Auflage, Beltz Athenhäum, Weinheim 1995.

Bünting, Karl- Dieter: *Einführung in die Linguistik*. 15. Aufl., Frankfurt am main: Athenäums Studienbücher 1996.

Camaj, Martin, *Lehrbuch der Albanischen Sprache*, Harrassowitz, Wiesbaden, 1969, ff.X + 136.

Camaj, Martin, *Albanian Grammar*, Harrassowitz, Wiesbaden, 1984, ff. XVI + 337.

Chomsky Noam, *Strukturat sintaksore*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 2011.

Cipo, Kostaq, *Sintaksa*, Shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1952 .

Coseriu, Eugenio: *Geschichte der Sprachphilosophie. Von den Anfängen bis Rousseau*. Neu bearb. und erw. von Jörn Albrecht. – Tübingen, Basel: Francke (UTB 2266) 2003.

Cook, V. J. / Newson, Mark: *Chomsky's Universal Grammar*. 3. Aufl. – Malden, Oxford, Victoria: Blackwell, 1998.

Çabej, Eqerem: *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* (pjesa e parë), Tiranë 2008: Shtëpia botuese Dituria.

Çabej, Eqerem. *Mbi disa dukuri të historisë së gjuhës shqipe të para në lidhje me gjuhët e tjera ballkanike*. SF 1979/4.

Çabej, Eqerem. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*; vëll. I. Tiranë 1982.

Çabej, Eqerem. *Studime etimologjike në fushë të shqipes.*; vëll. II, Tiranë 1976.

Çeliku, Mehmet, *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën letrare shqipe*, Studime filologjike, 1972, 1, ff. 85-109.

Çeliku, Mehmet, *Lokucionet parafjalore emërore në gjuhën letrare shqipe*, Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, Tiranë, 1975.

Çeliku, Mehmet, *Parafjalët foljore dhe disa çështje të formësimit të tyre*”, botuar fillimisht në “Gjuha jonë”, nr. 4, 1990

Çeliku, Mehmet. (2008). *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde*, Tiranë: Ilar.

Çeliku, Mehmet: *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, vështrim i ri teorik, Ilar, Tiranë 2012.

Çeliku, Mehmet; Karapinjalli, M.; Stringa, F., *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Ilar, Tiranë 2007.

Da Lecce, Fr. Maria. *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*. Roma 1716.

Daka, Palok, *Bibliografi e studimeve dhe e artikujve për gjuhën shqipe*(1945-1974), Tiranë, 1975, 361 f.

Daka, Palok, *Bibliografi e gjuhësisë dhe e onomastikës shqiptare*, 1975-1976: Studime filologjike, 1977, 4, ff. 195-215; 1977-1978: Studime filologjike, 1980, 2, ff. 183-214; 1979: Studime filologjike, 1981, 1, ff. 189-228; 1980: Studime filologjike, 1982, 3, ff. 223-285; 1981: Studime filologjike, 1983, 2, ff. 197-256; 1982: Studime filologjike, 1984, 1, ff. 193-250; 1983: Studime filologjike, 1985, 4, ff. 97-167; 1984: Studime filologjike, 1986, 2, ff. 177-240.

Daka, Palok, *Bibliografi retrospektive e gjuhësisë dhe e onomastikës shqiptare*, Tiranë, 1984, I (1879-1921); II (1922-1940); III (1941-1944).

De Saussure, Ferdinand; *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 2002.

Demiraj, Shaban, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, I, Tiranë, 1960, 96 f.

Demiraj, Shaban, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, II, Tiranë, 1961, 304 f.

Demiraj, Shaban, *Rreth kategorisë së shquarësisë e të pashquarësisë në gjuhën shqipe*, *Studime filologjike*, 1969, 4, ff. 145-157.

Demiraj, Shaban, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970.

Demiraj, Shaban, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972, 296 f.

Demiraj, Shaban, *Veçoritë e lakimit në sistemin përemëror të gjuhës shqipe*, *Studime filologjike*, 1973, 4, ff. 67-89.

Demiraj, Shaban, *Sistemi i lakimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1975, ff. 275.

Demiraj, Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Shtëpia botuese Fokus, Shkup 2004.

Demiraj, Shaban e të tjerë, *Libri i gjuhës shqipe*, 2, Tiranë, 1985

Demiraj, Shaban, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, I, Tiranë, 1986, 1166 f.

Dodi, Anastas, *Ndarja aktuale e fjalisë dhe intonacioni në gjuhën shqipe*, *Gjuha jonë*, 1986, 4, ff. 5-16.

Demiraj, Shaban: *Gjuha shqipe dhe historia e saj*. Tiranë 1988

Domi, Mahir; Hajvari, N: *Gramatika e gjuhës shqipe*, pjesa I për klasën VII të shkollës tetëvjeçare, botim i Institutit të studimeve dhe botimeve shkollore, shtypshkronja Mihal Duri, Tiranë 1965.

Domi, Mahir: *Gramatika e gjuhës shqipe. Sintaksa*. Tiranë 1957

Domi, Mahir: *Çështje të përgjithshme të sintaksës*, SF 1980, 3, f 12.

Domi, Mahir. *Probleme të historisë së formimit të gjuhës shqipe, arritje dhe detyra*. SF 1982/3-4.

Dhima, Thoma, *Probleme të njërive sintaksore (Togfjalëshi dhe sintagma)*, SF, Tiranë 2007, nr.3-4, f. 73-86.

Dhimo, Ali, *Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme*, *Studime filologjike*, 1965, 2,.

Dreyer, Hilke; Schmitt, Richard. *Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik*, Ismaning: Hueber, 1998.

Duden. *Die Grammatik*. 4, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Wien, Leipzig, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 1994

Duden. *Die Grammatik*. 7, völlig neu erarb. und erw. Aufl. – Mannheim, Leipzig, Dien, Zürich: Dudenverlag (Duden 4) 2006.

Dürscheid, Christa: *Zur Positionierung der adverbialen Kasus im Deutschen*. – In:

- Haftka, Brigitta (Hg.): Was determiniert Wortstellungsvariation? Studien zu einem Interaktionsfeld von Grammatik, Pragmatik und Sprachtypologie. – Opladen: Westdeutscher Verlag, 1994, S. 123-137.
- Dürscheid, Christa: *Die verbalen Kasus des Deutschen. Untersuchungen zur Syntax, Semantik und Perspektive.* – Berlin, New York: de Gruyter (studia linguistica germanica 53), 1999
- Dürscheid, Christa: *Syntax. Grundlagen und Theorien.* 4., überarbeitete und ergänzte Auflage. Göttingen: Vandenhoeck & Ruprecht (=Studienbücher zur Linguistik, Band 3) 2007.
- Eichler, Wolfgang; Bünting, Karl- Dieter, *Deutsche Grammatik*, 6 Auflage, Beltz Athenäum, Frankfurt 1996.
- Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik*, Stuttgart: Metzler ,1989
- Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik.* Bd. 1: Das Wort. 3., durchges. Aufl. – Stuttgart, Weimar: Metzler, 2006a.
- Eisenberg, Peter: *Grundriss der deutschen Grammatik.* Bd. 2: Der Satz. 3., durchges. Aufl. – Stuttgart, Weimar: Metzler, 2006b.
- Engel, Ulrich. *Deutsche Grammatik*, Heidelberg: Julius Gross, 1996.
- Engel, Ulrich: *Syntax der deutschen Gegenwartssprache.* 3., völlig neu bearb. Aufl. – Berlin: Erich Schmidt, 1994.
- Ernst, Peter: *Germanistische Sprachwissenschaft.* – Wien: Facultas 2004.
- Eroms, Hans- Werner. *Syntax der deutschen Sprache*, Berlin/ New York: de Gruyter, 2000.
- Fiedler, Wielfried.: *Zur Typologie der grammatischen Interferenz zwischen den Balkansprachen im Bereich der Konnektive.* Linguistische Studien - Reihe A. Berlin 1975.
- Fillmore, Charles J.: *The Case for Case.* – In: Bach, Emmon / Harms, Robert T. (Hg.): *Universals in Linguistic Theory.* – New York [u.a.]: Holt, Rinehart and Winston, 1968, S. 1-88.
- Floqi, Spiro, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1968, 1, ff. 75-82.
- Floqi, Spiro, *Mbi disa çështje të rendit të fjalëve në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1969, 2, ff 125-141.
- Floqi, Spiro, *Rreth modeleve të fjalisë në shqipen e sotme*, Studime filologjike, 1978, 3, ff. 25-51.

Floqi, Spiro, *Togfjalëshat mbiemërorë në shqipen e sotme letrare*, 1, Studime filologjike, 1981, N. 2, ff. 63-87;

Floqi, Spiro, *Togfjalëshat mbiemërorë në shqipen e sotme letrare*, 2, Studime filologjike, 1981, 2, ff. 93-111.

Floqi, Spiro, *Togfjalëshat me parafralën nga në shqipen e sotme letrare*, Studime filologjike, 1992, N. 1-4, ff. 23-34.

Floqi, Spiro: *Disa vrojtime për rendin e fjalëve në periudhë*. - *SFil* 30(13)/1976, 3, 113-125.

Frashëri, Sami: *Shkronjëtorja*, Bukuresht: Shtypshkronja e shoqërisë Dritë 1886

Frashëri, Sami: *Vepra V*, Prishtinë, 1979

Glinz, Hans: *Geschichte und Kritik der Lehre von den Satzgliedern in der deutschen Grammatik*; Diss. 1947

Glinz, • Hans: *Grammatiken im Vergleich*; Tübingen 1994

Gallmann, Peter; Sitta, Horst (1992): *Satzglieder in der Wissenschaftlichen Diskussion und in Resultatsgrammatiken*. –f. 137-181.

Goetze, Lutz; Hess- Luettich, Ernest W.B.. *Grammatik der deutschen Sprache*, München: Bertelsmann 2002.

Graffi, Giorgio. *Sintaksa, Strukturat e ligjërit*, Tiranë: Dituria, 2003.

Graffi Giorgio, *Ç' është gramatika gjenerative*, Shtëpia botuese Toena, Tiranë2008.

Graeser, Andreas: Aristoteles (384-321 v. Chr.). – In: Borsche, Tilman (Hg.): *Klassiker der Sprachphilosophie. Von Platon bis Noam Chomsky*. – München: C.H. Beck, 1996, S.33-47.

Greenberg, Joseph H. : *Some Universals of Grammar with Particular Reference to the Order of Meaningful Elements*. – In: Greenberg, Joseph H. (Hg.): *Universals of Language*. 2.Aufl. – Cambridge, MA: MIT Press, 1966, S. 40-70.

Grewendorf, Günther: *Minimalistische Syntax*. – Tübingen, Basel: Francke (UTB 2313), 2002

Grewendorf, Günther: *Noam Chomsky*. – München: C.H. Beck (bsr 574) 2006.

Grimm, Jacob [1898]: *Deutsche Grammatik*. Bd. 4. Hg. von Gustav Roethe und Edward Schröder. – Hildesheim: Georg Olms (Documenta Linguistica. Quellen zur Geschichte der deutschen Sprache des 16.-19. Jahrhunderts. Hg. von Ludwig Erich Schmitt) 1967

Grimm, Jacob: *Deutsches Wörterbuch von Jacob Grimm und Wilhelm Grimm*. 32 Bände. Leipzig 1854-1960.

Hajdaraj, A., *Rreth përdorimit të trajatave të shkurtra të vetorëve*, Rilindja, Prishtinë, 24.03.1982, f.

Hahn, Georg von. Albanesische Studien. Wien 1853

Halimi, M., *Për përdorimin e drejtë të parafjalëve në, pa dhe për*, tek Gjuha shqipe, Prishtinë, 1988, 1, f. 39-42.

Haos, O., "Zum 'Objektanzeigenden Pronomen' der Balkansprachen", *Acta linguistica*, 1973, 1-2, ff. 121-127.

Hajvari, N., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Sintaksa për klasën e VII, Tiranë, 1967.

Hajvari, N., *Gramatika e gjuhës shqipe*, sintaksa për klasën VIII, Tiranë, 1968.

Haselbach, Gerhard: *Grammatik und Sprachstruktur. Karl Ferdinand Beckers Beitrag zur Allgemeinen Sprachwissenschaft in historischer und systematischer Sicht.* – Berlin: de Gruyter 1966.

Heringer, Hans Jürgen: *Grammatik und Stil. Praktische Grammatik des Deutschen.* – Berlin: Cornelsen, 1995.

Helbig, Gerhard, *Deutsche Grammatik. Grundfragen und Abriss*, 2. Aufl., München 1993.

Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Leitfaden der deutschen Grammatik*, Berlin/ München: Langenscheidt 2000.

Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langenscheidt Verlag Enzyklopädie, 1991

Helbig, Gerhard; Buscha, Joachim. *Deutsche Grammatik*, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Leipzig, Berlin, München: Langenscheidt Verlag Enzyklopädie, ribotim 2007

Henschel, Elke; Weydt, Harald. *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin/ New York: de Gruyter 1990.

Hubbard, Philip, *The syntax of the albanian verb complex*, Ph.D., University of California at San-Diego, 1980, 179 + XX ff.

Hysa, Enver, "Përemri", A.SH.R.P.S.SH., *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, Tiranë, 1976, ff. 178-190.

Internet:

<https://www.lernhelfer.de/schuelerlexikon/deutsch-abitur/artikel/wilhelm-von-humboldt-zur-sprache>

<http://www.zeno.org/Philosophie/M/Humboldt,+Wilhelm+von/Ueber+die+Verschiedenheiten+des+menschlichen+Sprachbaues/2.+Von+der+Natur+der+Sprache+und+ihrer+Beziehung+auf+den+Menschen+im+Allgemeinen>

https://www.christianlehmann.eu/termini/index.html?https://www.christianlehmann.eu/termini/generative_grammatik.html

<http://germazope.uni-trier.de/Projects/WBB/woerterbuecher/dwb/wbgui?lemid=GL03581>; Februar 2007

John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 2001.

Jokl, Norbert, *Marrëdhëniet e afrisë së shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane*. SF 1967/3

Jungen, Oliver; Lohnstein, Horst: *Einführung in die Grammatiktheorie*. – München: Wilhelm Fink (UTB 2676) 2006.

Jungen, Oliver; Lohnstein, Horst: *Geschichte der Grammatiktheorie. Von Dionysios Thrax bis Noam Chomsky*. – München: Fink 2007.

Kadzadej, Brikena. *Deutsche Syntax*, Tiranë: Shblu 2006

Kastrati, Jup, "Punimet rreth sintaksës shqipe", *Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik Dvjetçar të Shkodrës*, Shkodër, 1969, 8, pp. 29-46.

Kastrati, Jup, *Histori e gramatologjisë shqiptare, (1635-1944)*, Prishtinë, 1980.

Kastrati, Jup, : *Histori e albanologjisë, (1945-1997)*, shtëpia e librit, fondacioni Soros, Tiranë 2000

Kelmendi, Tafil, "I kontribuoj zhvillimit apo kontribuojnë (për) zhvillimin", *Çështje të normës letrare*, Prishtinë, 1980.

Kelmendi, Tafil, "Kundrimi i disa termave të sintaksës shqipe", *Rilindja*, 04. 1988, ff. 12-13.

Koleci, Flora; Turano, Giuseppina: *Hyrje në sintaksën gjenerative të gjuhës*, Shblu, Tiranë 2011

Koni, Etleva: Fjalitë pyetëse tërësore në gjuhën angleze dhe shqipe, larmia e shprehjes së tyre në gjuhën shqipe si rrjedhojë e rendit të lirë të fjalëve. - *BShSSHSh* 41/2011, 237-248.

Kostallari, Androkli, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë 1973, 188 f.

Kryeziu, Bahtijar: Rreth mosrespektimit të rendit të fjalëve në fjali në shtypin tonë. - *GjSh* 22/2004, 1, 42-44.

Kryeziu, Bahtijar: Shtrembërime të rendit të fjalëve në shtypin tonë. - *KGj* 1/2003, 1, 75-78.

Kürschner, Wilfried: *Grammatisches Kompendium. Systematisches Verzeichnis grammatischer Grundbegriffe*. 4., ergänzte u. bearb. Aufl. – Tübingen / Basel: Francke (UTB 1526) 2003.

Libri i gjuhës shqipe 3, (Për shkollën e mesme pedagogjike dhe të gjuhëve të huaja), Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1985

Likaj, Ethem. Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe. Tiranë 1984.

Likaj, Et'hem: Raporte të nyjave dhe të rendit të gjymtyrëve. - *Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare. Përmbledhje e ligjëratave, referimeve, kumtesave dhe e diskutimeve*. Tiranë, 19-31 gusht 1996. - Akademia e Shkencave - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë - Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë. Toena. Tiranë, 1996, f. 633-639.

Linke, Angelika/ Nussbaumer, Markus/ Portmann, Paul: *Studienbuch Linguistik*. 2. Auflage. Tübingen: Niemeyer 1994.

Linke, Angelika/ Nussbaumer, Markus/ Portmann, Paul R.: *Studienbuch Linguistik*. 5., erw. Aufl. – Tübingen: Niemeyer (Reihe Germanistische Linguistik 121) 2004.

Lukaj, Jak, "Të kombinojmë përmbajtjen me formën në klasifikimin e gjymtyrëve të dyta të fjalisë", *Buletin shkencor*, Shkodër, 1980, 1, ff. 189-200.

Lukaj, Jak, "Përemrat vetorë dhe vetat", *Buletin shkencor*, Shkodër, 1981, XVIII, 2, ff. 207-211.

Lukaj, Jak, "Rreth mëvetësisë së kufizuar të emrit të pashquar në funksion kryefjale në shqipen e sotme", *Studime filologjike*, 1987, 3, ff. 131-138.

Martinet, Andre, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 2002.

Memushaj, Rami: *Hyrje në gjuhësi*, Shtëpia botuese Dituria, Tiranë 2004.

Memushaj, Rami: *Gjuhësia gjenerative*, Shblu, Tiranë 2008.

Meyer, Gustav. *Über die Stellung des Albanesischen im Kreis der indogermanischen Sprachen*. BB VIII (1884).

Miklosich, Franz, *Die Slavischen Elemente im Albanischen mit einer Einleitung*. Albanische Forschungen, I. Wien 1870.

Miklosich, Franz, *Die romanischen Elemente im Albanischen*. Albanische Forschungen, II. Wien 1870.

Mita, Josif: Për rendin e fjalive të periudhave kohore në gjuhën shqipe. - *Cinque secoli di cultura albanese in Sicilia Atti del XXVIII Congresso Internazionale di Studi albanesi 16-19 Maggio 2002 Giornate di studi offerte a Antonino Guzzetta. A cura di Matteo Mandalà*. A. C. Mirror. Palermo, 2003, 467-474.

Mita, Josif: Për vendin e fjalisë kohore në periudhë. - *GjJ* 22/2002, 1-2, 38-47.

Mita, Josif: Rendi i fjalëve dhe gjymtyrëzimi aktual i fjalive të varura kohore dhe vendore. - *SFil* 62(45)/2008, 1-2, 107-125.

Mita, Josif, : Struktura e sintagmave në gjuhën shqipe, Studime Albanologjike, Tiranë 2000, f. 27-41.

Mogensen, Jens Erik: Die Termini ‚direktes‘ und ‚indirektes‘ Objekt. Zu ihrem Gebrauch in ausgewählten Grammatiken und Nachschlagewerken. – In: Halwachs, Dieter W./ Stütz, Irmgard (Hg.): *Sprache – Sprechen – Handeln*. Akten des 28. Linguistischen Kolloquiums, Graz 1993. Bd. 1. – Tübingen: Niemeyer (Linguistische Arbeiten 320), 1994, S. 147- 154.

Myderrizi, Osman, *Gramatika e Re e shqipes*, për shkollat e mesme”, vëllimi I, fonologji e morfologji, shtypshkronja Gutenberg Tiranë 1944.

Newmark, Leonard, *Structural Grammar of Albanian*, Bloomington, 1957.

Newmark, Leonard, "An albanian case system", *Studia gratulatoria*, Amsterdam, 1962

Newmark, Leonard, Hubbard, Philip, Prifti, Peter, *Standard Albanian: a reference grammar for students*, Stanford, California, 1982.

Palmer, Frank: *Grammatical Roles und Relations*. – CUP, Cambridge 1994.

Përnaska, Remzi, "Kundrina", në: *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, III, Sintaksa, (I.Sintaksa e fjalisë), (Maket), 1, Tiranë, 1983, ff. 215-241.

Përnaska, Remzi, "Rreth disa çështjeve të kundrinës në gjuhën shqipe, *Studime filologjike*, 1970, 4, ff. 93-102.

Përnaska, Remzi, Bubani, Loredan, Bobrati, Sabahedin, *Gramatika e gjuhës shqipe*, 2, për shkollën pedagogjike, Tiranë, 1973, 288.

Përnaska, Remzi, "Një rast i veçantë i rendit të gjymtyrëve në fjalinë e përbërë në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1979, 1, ff. 155-159.

Përnaska, Remzi, "A janë përemra ‘trajtat e shkurta të përemrave vetorë’ në shqipen e sotme?", *Studime filologjike*, 1982, 4, ff. 199-212.

Përnaska, Remzi, "Kundrina", në: *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, III, Sintaksa, (I.Sintaksa e fjalisë), (Maket), 1, Tiranë, 1983, ff. 215-241.

Përnaska, Remzi., "Çështje të kundrinorit në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1983, 4, ff. 179-199.

Përnaska, Remzi, "Çështje të bashkëpërshtatjes ndërmjet trajtës së shkurtër të përemrit vetor dhe kundrinës", *Studime filologjike*, 1984, 4, ff. 119-125.

Përnaska, Remzi, "Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë dhe gjymtyrëzimi aktual në gjuhën shqipe", *Studime filologjike*, 1986, 2, ff. 101-106.

Përnaska, Remzi, *Kundranori me parafjalë në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2000.

Përnaska, Remzi: *Bashkësia e të ashtuquajturave trajta të shkurtrëra të përemrave vetorë dhe zgjedhimi nënanor- kundrinor (subjektor- objektor) sui generis në gjuhën e sotme shqipe*. Konferencë shkencore: *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë 2012

Pittner, Karin; Berman, Judith: *Deutsche Syntax, Ein Arbeitsbuch*, Narr, Tübingen 2004

Piitulainen, Marja-Leena: *Zum Problem der Satzglieder in der deutschen Grammatik der Gegenwart*. – Jyväskylä: Universität Jyväskylä (Studia philologica Jyväskyläensia 14) 1980.

Plank, Frans: Preface. – In: Plank, Frans (Hg.): *Objects. Towards a Theory of Grammatical Relations*. – Orlando, Florida, London: Academic Press, S. viif. 1984

Porzig, Walter. *Die Gliederung des indogermanischen Sprachgebietes*. Heidelberg 1954.

Prifti, Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1972

Prifti, Stefan, "Problemi i klasifikimit të gjymtyrëve të dyta të fjalisë", *Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë, 1986, ff. 335-346.

Primus, Beatrice: *Cases and Thematic Roles. Ergative, Accusative and Active*. – Tübingen: Niemeyer (Linguistische Arbeiten 393) 1999.

Pullum, Geoffrey K.: Word order universals and grammatical relations. – In: Cole, Peter / Sadock, Jerrold (Hg.): *Syntax and Semantics 8: Grammatical Relations*, Academic Press, New York 1977, 249-277.

Rama, A., "Përdorimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë", *Rilindja*, 05. 03.1983.

Ramers, Karl Heinz: *Einführung in die Syntax*. 2. Aufl. – Paderborn: Wilhelm Fink (UTB 2174) 2007.

Riza, Selman. *Emrat në shqipe. Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit*. Tiranë 1965.

Riza, Selman, *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë 1994

Robins, Robert H., *Historia e gjuhësisë, Shtëpia botuese Dituria*, Tiranë 2007.

Rrushi, Thoma: *Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë dëftore*, Tiranë, 1983

Rushi, Thoma: *Funksioni gramatikor i rendit të fjalëve në gjuhën shqipe*. - *SFil* 37(20)/1983, 4, 47-56.

- Rushi, Thoma: *Rendi i dy përcaktorëve të një gjymtyre*. - *GjJ* 3/1983, 2, 46-53.
- Rushi, Thoma: *Çështje të normës letrare në rendin e fjalëve në shqipen e sotme*. - *SFil* 39(22)/1985, 1, 117-121.
- Rushi, Thoma: *Rendi i gjymtyrëve të shkallës së dytë*. - *SFil* 42(25)/1988, 1, 105-112.
- Rushi, Thoma: *Rreth rendit të gjymtyrëve në fjalinë dëftore*. - *SFil* 37(20)/1983, 1, 71-85.
- Rushi, Thoma: *Vëzhgime për rendin e fjalëve në fjali*. - *GjJ* 9/1989, 4, 39-45.
- Rrokaj, Shezai, *Strukturalizmi klasik në gjuhësi*, Shblu, Tiranë 2002.
- Rrokaj, Shezai: *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Shblu, Tiranë, 2005.
- Rrota, Justin, *Syntaksa e gjuhës shqipe, për klasën II, III, IV. K. U. Të shkollave të mesme, Shtypshkronja At Gjergj Fishta, Shkodër, 1943.*
- Schaller, Helmut Wilhelm, *Die Balkansprachen. Eine Einführung in die balkanphilologie*, Heidelberg 1975
- Schmidt, Claudia Maria (1994): "Zur syntaktischen Position indirekter Objekte im Deutschen: Pollockische Sätze oder Larsonische VPs?" – In: Haftka, Brigitta (Hg.): *Was determiniert Wortstellungsvariation? Studien zu einem Interaktionsfeld von Grammatik, Pragmatik und Sprachtypologie*. – Opladen: Westdeutscher Verlag, S. 197-217.
- Sheperi, Ilija Dilo, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskënishtes*, (për shkollat e mesme), Shtëpia botuese Vlora, Vlorë, 1927.
- Seyfert, Gernot: *Zur Theorie der Verbgrammatik*. – Narr, Tübingen 1976
- Sihler, Andrew Littleton: *Language History. An Introduction*. – Benjamins, Amsterdam 2000
- Schulz, Dora; Griesbach, Heinz, *Grammatik der deutschen Sprache*, Hueber, München 1996.
- Shuteriqi, Dhimitër, "Mendime e vërejtje rreth gramatikës shqipe", *Buletin i Institutit të Shkencave*, Tiranë 1951, 2, ff.47—70, 3-4, ff. 15-63.
- Shuteriqi, Dhimitër, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1965, 233 f.
- Sommerfeld, Karl- Ernst/ Starke, Günter: *Einführung in die Grammatik der deutschen Gegenwartssprache*, Tübingen 1998
- Thomaj, Jani, "Mbi rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjizmave të shqipes", *SFil* 20(3)/1966, 1, 151-161.
- Totoni, Menella, Bubani, L., Dako, N , Bobrati, S., *Libri i gjuhës shqipe për klasën VII*, Tiranë, 1971,.143 f.
- Totoni, Menella: *Libri i gjuhës shqipe 2*, për shkollat e mesme, Tiranë 1978, f.66-80

Totoni, Menella, *Gjymtyrët e fjalisë (kryefjala, kallëzuesi, përcaktori, përcaktori kallëzuesor)*, Disertacion për gradën "Kandidat i shkencave", Tiranë, 1980,

Totoni, Menella, "Çështje të gjymtyrëve të fjalisë", *Studime filologjike*, 1981, 3, ff. 109-114.

Totoni, Menella: Rendi i gjymtyrëve në fjalitë e nënrenditura dhe problemi i ndikimit të greqishtes. - *Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare. Përmbledhje e ligjëratave, referimeve, kumtesave dhe e diskutimeve. Tiranë, 19-31 gusht 1996.* - Akademia e Shkencave - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë - Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë. Toena. Tiranë, 1996, f. 641-649.

Totoni, Menella: Ndërtimet me emra foljorë prapashtesorë, *Gjuha jonë*, 1982, nr.1.

Totoni, Menella: "Rreth rendit dhe trajtës së gjymtyrëve plotësuese", *GjJ* 3/1983, 2, 71-74.

Totoni, Menella, *Sintaksa e gjuhës shqipe: fraza e përbërë*, Shtëpia botuese Arbëria, Tiranë 2012.

Topalli, Kolec, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Shtëpia botuese Kristalina, Tiranë 2011, 1740 f.

Topalli, Kolec, *Bazat e gramatikës historike të shqipes*, Shtëpia botuese Plejad, Tiranë 2011, 301 f.

Topalli, Kolec, *Sistemi rasor i emrave të shqipes*, Shtëpia botuese Plejad, Tiranë 2009, 470 f.

Topalli, Kolec, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Shtëpia botuese Plejad, Tiranë 2010, 667 f.

Topalli, Tefë,: *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa e fjalisë, sprovë monografike*, Instituti i studimeve albanologjike, Shkodër 2011.

Topalli, Tefë, ; Dushi, Orjeta: *Fjalorth terminologjik konceptual shpjegues i sintaksës gjenerative, shtëpia botuese Vizion, Tiranë 2011.*

Topalli, Tefë; Haxhi, Artan, : *Leksion i gjuhëtarëve të sotëm shqiptarë*, Instituti i studimeve albanologjike, Shkodër 2013.

Trask, Robert Lawrence: *Language and Linguistics. The Key Concepts.* 2. Aufl. Hg. von Peter Stockwell. – Routledge, London 2007.

Vokshi, Hasan, "Objekti i dyfishtë-për përdorimin e dyfishtë të disa rasave në shqipet", *Përparimi*, Prishtinë 1955, 4, ff. 211-215.

Wahrig, *Deutsches Wörterbuch*, München 2006

Welke, Klaus, *Einführung in die Satzanalyse. Die Bestimmung der Satzglieder im Deutschen.*, de Gruyter Berlin / New York 2007

Welke, Klaus, *Valenztheorie und Konstruktionsgrammatik.* (MS) – Erscheint in: *ZGL* 2009/1.

- Wegener, Heide, *Der Dativ im heutigen Deutsch*. – Tübingen, Narr, 1985.
- Wegener, Heide, Gibt es im Deutschen ein indirektes Objekt? – In: *Deutsche Sprache* 14, 1986, f. 12-22.
- Wildgen, Wolfgang, *Kognitive Grammatik. Klassische Paradigmen und neue Perspektiven*. – Berlin, New York: de Gruyter, 2008.
- Wöllenstein–Leisten, Angelika/ Heilmann, Axel/ Stepan, Peter/ Vikner, *Deutsche Satzstruktur. Grundlagen der syntaktischen Analyse*. Tübingen 1997.
- Xanoni, Aleksandër, *Gramatika shqyp*, Shkodër: Shtypshkronja e Zojës Papërlyeme, 1909.
- Xhuvani, Aleksandër, *Sintaksa shqip*, ‘Pjes’ e parë për Klasët e ulta të shkollave të mesme,’ Shtëpia botuese Luarasi, Tiranë 1920.
- Xhuvanit, Aleksandër, “*Parafjalët*”, Studime Filologjike, Tiranë 1964, I
- Zifonun, Gisela / Hoffmann, Ludger / Strecker, Bruno: *Grammatik der deutschen Sprache*. Bd. 2., de Gruyter, Berlin, New York 1997

ANEKSI 1

Foljet me parafjalë në rasën dhanore

<p>abhängen von abheben von ändern an anfangen mit auffordern zu aufhören mit sich auseinandersetzen mit beginnen mit sich beschäftigen mit bestehen aus einladen zu sich entschließen zu sich entwickeln zu sich erholen von sich erkundigen nach erzählen von erziehen zu fehlen an folgen aus fragen nach führen zu sich fürchten vor gehören zu gratulieren zu halten von handeln mit</p>	<p>handeln von hindern an hören von sich hüten vor sich irren in kommen zu leben von leiden an leiden unter liegen an meinen zu sich melden bei passen zu profitieren von rechnen mit reden von sich richten nach riechen nach rufen nach schimpfen mit schließen aus schmecken nach sich schützen vor sehen nach sich sehnen nach sprechen mit</p>	<p>sprechen von sich streiten mit teilnehmen an telefonieren mit träumen von sich treffen mit sich trennen von überreden zu sich unterhalten mit sich unterscheiden von sich verabreden mit verbinden mit vergleichen mit sich verloben mit verstehen von sich verstehen mit verwechseln mit wählen zu wählen zwischen warnen vor werden zu wissen von zweifeln an zwingen zu</p>
---	---	---

Foljet me parafjalë në rasën kallëzore

<p>abstimmen über achten auf ankommen auf antworten auf sich ärgern über aufpassen auf sich aufregen über ausgeben für sich bedanken für sich bemühen um beraten über berichten über beschließen über sich beschweren über sich bewerben um sich beziehen auf bitten um danken für denken an diskutieren über sich drehen um sich eignen für sich entscheiden für sich entschuldigen für erinnern an</p>	<p>sich erinnern an ersetzen durch folgen auf sich freuen auf sich freuen über gehen um sich gewöhnen an glauben an halten für sich halten an sich handeln um hören auf hoffen auf informieren über sich informieren über sich interessieren für kämpfen für kämpfen gegen klagen über kommen auf sich kümmern um lächeln über lachen über nachdenken über</p>	<p>protestieren gegen reagieren auf reden über schimpfen über sein für sein gegen sorgen für sich sorgen um sprechen über stehen auf stimmen für stimmen gegen streiten über tun für sich unterhalten über unterrichten über sich verlassen auf sich verlieben in vermieten an verzichten auf sich vorbereiten auf wählen in warten auf sich wenden an sich wundern über</p>
--	--	--

ANEKSI 2

Lista e plotë e mbiemrave qe sundojnë rasi në gjuhën gjermane:

Mbiemra që sundojnë rasën kallëzore:

gewohnt, leid, los, müde, satt, schuldig, überdrüssig, wert

Mbiemra që sundojnë rasën dhanore:

ähnlich, angeboren, angemessen, angenehm, begreiflich, behilflich, bekannt, bequem, beschwerlich, böse, dankbar, eigen, eigentümlich, ergeben, erwünscht, feind, fern, fremd, gefährlich, gefällig, gegenwärtig, geläufig, gemäß, gemeinsam, genehm, gerecht, gewachsen, gleich, gleichgültig, günstig, heilsam, klar, lästig, lieb, möglich, nahe, nahestehend, neu, nützlich, peinlich, recht, schädlich, schuldig, treu, überlegen, verhasst, vertraut, verständlich, verwandt, verwandt, wert, wichtig, willkommen.

Mbiemra që sundojnë rasën gjinore:

bar, bedürftig, bewusst, fähig, gewiss, gewärtig, kundig, ledig, mächtig, müde, sicher, schuldig, überdrüssig, voll, wert, würdig.

Mbiemra që sundojnë parafjalë dhe rasën dhanore (+ D):

abhängig von + D, ansässig in + D, anständig zu + D, arm an + D, aufgelegt zu + D, befreundet mit + D, begabt in + D, behaftet mit + D, behilflich bei + D, beliebt bei + D, bereit zu + D, berufen zu + D, besessen von + D, brav zu + D, ehrlich zu + D, einverstanden mit + D, entfernt von + D, entschieden in + D, erfahren in + D, ersichtlich aus + D, fähig zu + D, fern von + D, fertig mit + D, frech zu + D, frei von + D, fruchtbar an + D, geneigt zu + D, geschickt in/bei + D, gewandt in + D, heimisch in + D, herzlich zu + D, höflich zu + D, hungrig nach + D, gierig nach + D, grob zu + D, interessiert an + D, klar zu + D, kombinierbar mit + D, krank vor + D, kritisch gegenüber + D, matt von/vor + D, nett zu + D, reich an + D, schwach gegenüber + D, schuld(ig) an + D, sicher vor + D, starr vor + D, stumm vor + D, überzeugt von + D, unschuldig an + D, vereinbar mit + D, vergleichbar mit + D, verhasst bei + D, verliebt in + D, verschieden von + D, verträglich mit, zufrieden mit + D, verwurzelt in/mit + D, voll von/mit + D.

Mbiemra që sundojnë parafjalë dhe rasën kallëzore (+A)

angenehm für +A, angewiesen auf +A, ärgerlich über +A, aufgeschlossen für +A, bedenklich für +A, bedeutungslos für +A, bequem für +A, berühmt für +A, besorgt um +A, beständig gegen +A, bezeichnend für +A, bitter für +A, charakteristisch für +A, dankbar für +A, eifersüchtig auf +A, eingebildet auf +A, empfänglich für +A, empfindlich gegen +A, erfreulich für +A, fest gegen +A, froh über +A, gefährlich für +A, gefasst auf +A, genug für +A, gespannt auf +A, gesund für +A, gewöhnt an +A, gleichgültig gegen +A, glücklich über +A, grausam gegen +A, haftbar für +A, hart

gegen +A, heilsam für +A, immun gegen +A, interessant für +A, nachteilig für +A, neidisch auf +A, neugierig auf +A, nötig für +A, nützlich für +A, passend für +A, scharf auf +A, schmerzlich für +A, stolz auf +A, teuer für +A, unempfindlich gegen +A, verständlich für +A, vorteilhaft für +A, wichtig für +A, wütend auf +A, zornig auf +A, zuständig für +A.

Mbiemra që sundojnë parafjalë dhe rasën dhanore (+ D), si dhe parafjalë dhe rasën kallëzore (+A)

begierig auf +A/nach +D, bekannt für +A/mit +D, bewandert in +D/auf +A, blind gegen +A/gegenüber +D/für, böse zu +D/auf +A, einig in +D/über +A, geeignet für +A/zu +D, gut für +A/zu +D, reif für +A/zu +D, streng zu +D /gegen +A, taub gegen +A/auf +D